



QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

**PROGRAM NACIONAL PËR MIRATIMIN E SË DREJTËS SË
BASHKIMIT EVROPIAN
- REVIZIONI 2012-**

**Shkup
16 dhjetor 2011**

PËRMBAJTJA

I KRITERET POLITIKE.....	
II KRITERET EKONOMIKE.....	
3.01 QARKULLIMI I LIRË I MALLRAVE.....	
3.02 QARKULLIMI I LIRË I PUNËTORËVE	
3.03 E DREJTA E THEMELIMIT DHE LIRIA E DHËNIES SË SHËRBIMEVE.....	
3.04 QARKULLIMI I LIRË I KAPITALIT	
3.05 FURNIZIMET PUBLIKE.....	
3.06 E DREJTA E SHOQËRIVE TREGTARE.....	
3.07 E DREJTA E PRONËSISË INTELEKTUALE.....	
3.08 POLITIKA E KONKURENCËS.....	
3.09 SHËRBIMET FINANCIARE	
3.10 SHOQËRIA INFORMATIKE DHE MEDIUMET.....	
3.11 BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL.....	
3.12 SIGURIA E USHQIMIT, POLITIKA VETERINARE DHE FITOSANITARE.....	
3.13 PESHKATARIA.....	
3.14 POLITIKA E TRANSPORTIT.....	
3.15 ENERGJETIKA.....	
3.16 TATIMIMI.....	
3.17 UNIONI EKONOMIK DHE MONETAR.....	
3.18 STATISTIKA.....	
3.19 POLITIKA SOCIALE DHE PUNËSIMI.....	
3.20 NDËRMARRJET DHE POLITIKA INDUSTRIALE.....	
3.21 RRJETET TRANSEVROPIANE.....	
3.22 POLITIKA RAJONALE DHE KOORDINIMI I INSTRUMENTEVE STRUKTUREORE.....	
3.23 JURISPRUDENCA DHE TË DREJTAT THEMELORE.....	
3.24 DREJTËSI, LIRI DHE SIGURI.....	
3.25 SHKENCA DHE HULUMTIMI	
3.26 ARSIMI DHE KULTURA.....	
3.27 MJEDISI JETËSOR.....	
3.28 MBROJTJA E KONSUMATORËVE DHE SHËNDETIT.....	
3.29 UNIONI DOGANOR.....	
3.30 MARRËDHËNIET E JASHTME.....	
3.31 POLITIKA E JASHTME, E SIGURISË DHE E MBROJTJES.....	
3.32 KONTROLLI FINANCIAR.....	
3.33 DISPOZITA FINANCIARE DHE BUXHETORE.....	
IV KAPACITETET ADMINISTRATIVE.....	
V PËRPILIMI I VERSIONIT MAQEDONAS TË ACQUIS.....	
VI INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN.....	

I. KRITERET POLITIKE

1.1 DEMOKRACIA DHE SUNDIMI I SË DREJTËS

ZGJEDHJET

Në lidhje me procesin zgjedhor, Qeveria vazhdoi t'i adresojë rekomandimet tjera të OSBE/ODIHR nga zgjedhjet e zbatuara në vitin 2009. Me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit zgjedhor (Gazeta zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 44/2011) u arrit reformë e e mëtejshme në sistemin zgjedhor. Në ligj janë implementuar standardet ndërkombëtare për zbatimin e zgjedhjeve si dhe rekomandimet e Komisionit të Venecias dhe raportet e OSBE/ODIHR në lidhje me zgjedhjet presidenciale dhe lokale të zbatuara në vitin 2009. Ndryshimet, krahas të tjerave përmbajnë përmirësime në lidhje me dispozitat për votimin e diasporës, përgjegjësinë e medieve gjatë fushatës zgjedhore, ndërkaq theks i veçantë i është dhënë financimit të fushatës zgjedhore e kështu me radhë. U ndërmorën edhe aktivitete të rëndësishme për pastrimin e listës zgjedhore.

Në lidhje me rekomandimet për përforcimin e kapaciteteve të administratës zgjedhore, në fazë përfundimtare është procedura për punësim të 11 personave në Sektorin për listë zgjedhore prej të cilëve 4 në seksionin në KSHZ dhe 7 në seksionet rajonale. Në bashkëpunim me OSBE-në u realizuan seri trajnimesh për të punësuarit në shërbimin profesional dhe njësitë rajonale të KSHZ që përfshijnë trajnime për trajnues, planifikim strategjik, përforcim të shkathtësive prezantuese e të tjera.

Në lidhje me rekomandimet për zgjidhjen e problemit me rastet e supozuara të frikësimit, me mbështetje të OSBE-së është bërë trajnim i të punësuarve në KSHZ, ndërkaq kjo pjesë ishte përfshirë edhe në suazat e trajnimeve për organet zgjedhore (komisionet zgjedhore komunale dhe këshillat zgjedhorë). Njëherit gjatë zgjedhjeve është hapur linjë telefonike falas nga Avokati i Popullit.

Më prill 2011 u shpallën zgjedhje të parakohshme parlamentare me çka Kuvendi i Republikës së Maqedonisë u shpërnda. Zgjedhjet e parakohshme parlamentare u mbajtën më 5 qershor 2011 dhe të njëjtat u mbajtën në pajtim me standardet ndërkombëtare. Në pajtim me Raportin përfundimtar për zgjedhje të parakohshme parlamentare 2011 të OSBE/ODIHR, zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Republikën e Maqedonisë janë karakterizuar si kompetitive, transparente dhe të mirëzbatuara në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë. Raporti i OSBE/ODIHR-it jep edhe rekomandime për avancimin e mëtejshëm të procesit zgjedhor në disa fusha, si: mekanizma mbrojtës për ndarje të shtetit nga partia gjatë zgjedhjeve, kontroll të të dhënave në listën zgjedhore, rastet e frikësimit, saktësimi i dispozitave nga Kodi zgjedhor dhe çështja e medieve. Me qëllim të avancimit të procesit zgjedhor dhe adresim të rekomandimeve nga Raporti final i OSBE/ODIHR nga zgjedhjet e mbajtura në vitin 2011, do të bëhet analizë e Raportit përfundimtar të OSBE/ODIHR për zgjedhjet e parakohshme parlamentare 2011 dhe do të formohet Komitet menaxhues.

KUVENDI

Për sigurim të shkallës së lartë të koordinimit në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe programim të punës së Kuvendit, çka është dëshmuar si mekanizëm efektiv në sigurimin e dialogut politik, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë edhe në vitin 2012 do të vazhdojë me mbajtjen e takimeve të rregullta me koordinatorët e grupeve parlamentare. Në to do të marrin pjesë përfaqësues të caktuar të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë në lidhje me propozimet e Qeverisë në pajtim me Rregulloren për koordinim të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.

Edhe në vitin 2011 Rregullorja e punës së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë u zbatuar në mënyrë të kënaqshme, ashtu që edhe në vitin 2012 pritet kontinuitet i zbatimit të papenguar dhe efikas të zbatimit të Rregullores së punës të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.

Për sigurimin e konsensusit të përgjithshëm politik dhe shoqëror në lidhje me realizimin e agjendës evropiane, Këshilli nacional për euronitegrime (KNEI) dhe Komisioni për çështje evropiane (KÇE) të Kuvendit në vazhdimësi kanë organizuar debate për prioritetet kryesore të Agjendës Evropiane të Republikës së Maqedonisë. Këto dy trupa në vitin 2012 do të vazhdojnë me organizim të debateve publike për zgjidhjet ligjore kryesore në pajtim me NPAA 2012 dhe do të vazhdojnë me aktivitetet e tyre në promovimin e qasjes konsensuale dhe debatin gjithpërfshirës për realizimin e prioritetëve nga procesi i aderimit të Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian.

Me qëllim të implementimit të Programit Nacional për miratimin e legjislacionit të Bashkimit Evropian për vitin 2012, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë do t'i japë përparësi miratimit të ligjeve me të cilat bëhet harmonizim me legjislacionin evropian.

Në vitin 2012, në suazat e takimeve të rregullta koordinuese me Kryetarin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, do të vazhdohet me sigurimin e konsensusit rreth çështjeve për implementimin e Marrëveshjes Kornizë dhe funksionimin e Parimit të Badenterit. Funksionaliteti i Komitetit do të zhvillohet në pajtim me zgjidhjet ligjore në fuqi, veçanërisht Ligjin për Komitetin për marrëdhënie ndërmjet bashkësive të Republikës së Maqedonisë.

Më vitin 2012 do të vazhdohet me implementimin e dispozitave të Ligjit për Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe trajnimin e kapacitetit personal të përforcuar të shërbimeve kuvendore. Do të vazhdohet me realizimin e debateve mbikëqyrëse dhe publike në Komisionet kuvendore.

Instituti i themeluar parlamentar në fillim të vitit 2012 do të ekipohe me të punësuar dhe pritet të fillojë t'i japë analizat hulumtuese me çka do të sigurohet qasje më e mirë në informatat në të gjitha partitë parlamentare.

Në tremujorin e parë të vitit 2012 pritet bashkërisht të miratohet Kodeksi etik për deputetët.

QEVERIA

Për sigurim të përkushtimit për përcjellje të vazhdueshme të obligimeve që rezultojnë nga procesi i integritit evropian, Qeveria edhe më tej do t'i fillojë seancat e saj me para-pikë për statusin e procesit të integritit në BE dhe përmes seancave të rregullta tematike për çështje të Agjendës Evropiane dhe plotësimin e obligimeve që Republika e Maqedonisë i ndërmerr në drejtim të plotësimin të kriterëve nga Kopenhaga. Vitin e kaluar kanë vazhduar takimet e strukturave koordinuese të BE-së për përcjelljen e realizimit të obligimeve nga integritet në BE nëpërmjet takimeve të rregullta të Komitetit punues për integritet evropian dhe Nënkomitetit të vet. Edhe në periudhën e ardhshme këto dy trupa punues do të vazhdojnë në bazë të rregullt të përcjellin realizimin e obligimeve nga NPAA, SSA, IPA e të tjera.

Zbatimi i procesit të decentralizimit

Zbatimi i procesit të decentralizimit dhe zhvillimi i vetadministrimit lokal në vitin e ardhshëm do të përcillet dhe evaluohet në pajtim me dokumentin e ri programor Programi për zbatimin e procesit të decentralizimit dhe zhvillimin e vetadministrimit lokal 2011-2014 dhe Planet Aksionale të tij, qëllimi kryesor i të cilave është zbatimi efikas dhe përcjellja e zhvillimit të qëndrueshëm lokal, zhvillim i mëtejshëm i sistemit komunal të financimit dhe reduktimi i dallimeve fiskale, promovimi i mekanizmave për menaxhimin participues në nivel lokal, si dhe përmirësimi i lëvrimin të shërbimeve dhe fuqizimi i kapacitetit institucional dhe administrativ të njësive të vetadministrimit lokal. Për atë qëllim do të miratohet Plan aksional për realizim të Programit për decentralizim dhe zhvillim të vetadministrimit lokal, për periudhën 2012-2014.

Edhe më tej mekanizëm koordinues për përcjellje dhe koordinim të procesit të decentralizimit mbetet Grupi punues për decentralizim që punën e vet do ta planifikojë nëpërmjet Planit aksional përkatës. I njëjti në mënyrë operative do të demonstrojë në çfarë mënyre do të përcjellë dhe koordinojë procesin e decentralizimit dhe zhvillimit të vetadministrimit lokal. Shkalla e realizimit të programit do të përcillet përmes këtij grupi punues i cili në fund të vitit do të dërgojë Raport për zbatimin e programit për zbatimin e procesit të decentralizimit dhe zhvillim të vetadministrimit lokal në vitin 2012.

Për përcjellje efektive të zbatimit të Programit dhe Planit aksional të tij, grupi punues për decentralizim do të miratojë Metodologji për vlerësim të zbatimit të Programit për zbatimin e procesit të decentralizimit dhe zhvillim të vetadministrimit lokal 2011-2014. Metodologjia do të përshkruajë mënyrën në të cilën do të përcillen dhe vlerësohen aktivitetet e parapara në Planet aksionale për zbatimin e Programit.

Metodologjia do të përmbajë indikatorë që do të jenë të qartë dhe meritore me qëllim të mund në mënyrë më efektive të përcillet realizimi i aktiviteteve të hartuara në Planin aksional për realizim të Programit për decentralizim dhe zhvillim të vetadministrimit lokal, për periudhën 2012-2014 dhe të vlerësohet nëse të njëjtat kanë arritur efektin e dëshiruar.

Konsultimet me BNJVL-në dhe me njësitë e vetadministrimit lokal do të vazhdojnë të realizohen nëpërmjet pjesëmarrjes së BNJVL-së në Grupin punues për decentralizim dhe trupat tjerë të resorit. Në konsultim të përbashkët me BNJVL dhe NJVL do të përpilohet Marrëveshje për bashkëpunim ndërmjet Qeverisë së RM-së dhe BNJVL-së në lidhje me implementimin e Programit për zbatim të procesit të decentralizimit dhe zhvillim të vetadministrimit lokal.

Procesi i decentralizimit në vitin 2011 e shënon edhe transferin e menaxhimit të tokës ndërtimore në pronësi shtetërore të komunave të cilat i plotësojnë kriteret e domosdoshme menaxhuese dhe teknike, që filloi të zbatohet nga korriku.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë me realizim të planit për mbështetje dhe zbatim të reformave për ngritjen e kapacitetit administrativ dhe fiskal dhe qasje në bllok dotacionet ka ndërmarrë aktivitete të rëndësishme që kanë rezultuar me hyrje në 5 komuna të reja në fazë të dytë nga decentralizimi fiskal. Nga 01 janar 2012 në 83 komuna dhe Qyteti i Shkupit do të financohen kompetencat e transferuara në arsim, mbrojtjen sociale dhe kulturë me bllok dotacione. Gjatë vitit 2012 pritet edhe komuna e fundit (Plasnicë) të hyn në fazën e dytë të decentralizimit fiskal.

Nëpërmjet përkufizimit të kushteve më liberale dhe më transparente për ngarkim me borxh janë zmadhuar mundësitë për financim të projekteve investuese të cilat për komunat janë bërë më të arritshme me ndryshimet në zgjidhjet ligjore. Poashtu, Ministria e Financave ka prezantuar mundësi të re, komunat t'i financojnë nevojat e tyre nëpërmjet emetimit të obligacioneve komunale.

Ministria e Financave në periudhën e ardhshme do të vazhdojë me reformat në drejtim të përmirësimit të kapacitetit administrativ dhe financiare të komunave, me çka do të përmirësohet efikasiteti i arkëtimit të të hyrave personale, si dhe dhënie më efikase dhe më me përgjegjësi të shërbimeve për qytetarët. Në këtë proces, mbështetje e rëndësishme do të sigurohet nëpërmjet UNDP, përkatësisht projekti që është në rrjedhë "Shërbime sociale për mbështetje të zhvillimit social dhe lidhje".

REFORMAT NË ADMINSTRATËN PUBLIKE-shihni edhe në Kreun IV Kapacitetet adminsitrativ

Qeveria e Republikës së Maqedonisë në bazë të përvojave krahasuese dhe të ekspertëve, vlerësoi se Reforma në administratën publike duhet të përqendrohet në një organ të administratës shtetërore (**Ministria e shoqërisë informatike dhe administratës**) me qëllime strategjike dhe të planeve të ndërmerren masa të organizuara dhe të koordinuara për implementimin e këtij procesi. Në pajtim me ndryshimet në Ligjin për organizim dhe punë të organeve të administratës shtetërore ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 167/2010), një pjesë e të punësuarve të cilët kanë punuar në procesin e reformave në administratën publike nga Ministria e Drejtësisë, Sekretariati i përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Sekretariati për çështje evropiane dhe Agjencia për nëpunës shtetërorë janë marrë nga Ministria për shoqëri informatike dhe administratë. Në pajtim me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për nëpunës shtetërorë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 167/10), Agjencia për nëpunës shtetërorë ka vazhduar të punojë si Agjenci për administratë, si organ i pavarur shtetëror përgjegjës para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë ka shprehur angazhimin e madh politik për reformën në administratën publike nëpërmjet themelimit të **Grupit special për reforma në adminsitratën publike** në suazat e Marrëveshjes për stabilizim dhe asocim (MSA) në të cilën si bashkëkryesues nga njëra anë është Qeveria e Republikës së Maqedonisë, ndërkaq në anën tjetër është Komisioni Evropian. Dialogu ndërmjet dy anëve zhvillohet në format tanimë të vendosur dy herë në nivel vjetor. Me qëllim të dhënies së qëllimeve dhe udhëzimeve të qarta të avancimit të procesit, në vitin 2011 **Komiteti për reforma në administratën publike** me të cilin kryeson Kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, vazhdoi të mbajë takime në të cilat është shqyrtuar progresi i realizuar në reforma. Takimi i Komitetit dhe realizimi i obligimeve të ndërmarra paraqet prioritet crucial për vitin 2012.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë në dhjetor 2010 e miratoi **Strategjinë për reforma në administratën publike 2010-2015**, si dhe Planin aksional përkatës për zbatimin e Strategjisë. Në pajtim me Planin për punën e Ministrisë për shoqëri informatike dhe administratë, në vitin 2012 do të vazhdojë me realizimin e aktiviteteve të caktuara në Planin aksional nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të caktuara në Planin aksional nëpërmjet fuqizimit shtesë të kapaciteteve të vet për koordinim të procesit të reformës në adminsitratën publike. Në vitin 2012, MSHIA do të përfundojë procedurën për instalimin e ISO standardeve për cilësi në administratën publike.

Inspektorati Shtetëror Administrativ (ISHA) kryen aktivitete të cilat kanë të bëjnë me realizimin e funksionit të inspeksionit administrativ. Në pajtim me ndryshimet e Ligjit për organizim dhe punë të organeve të administratës shtetërore ISHA është në përbërje të MSHIA.

Në lidhje me avancimin e reformave në administratën publike, më 2012 do t'i qaset **Analizës së aplikimit të Ligjit për nëpunës shtetërorë dhe Ligjit për nëpunës publikë**. Në analizë do të merret parasysh përfshirja e të punësuarve të cilët duhet të kenë status të nëpunësit shtetëror dhe publik, përfshirja e administratës shtetërore dhe publike, institucionet të cilat duhet të jenë të përfshira me status të tillë. Poashtu, do t'i qasemi përgatitjes së analizës së lidhur me çështjet e punësimit dhe mobilitetit në administratën shtetërore dhe publike, instituti i punës provuese, të drejtat dhe obligimet e nëpunësve shtetërorë dhe publikë, analizë e sistemit të pagave

dhe kompensimeve të pagave për nëpunësit shtetërorë dhe publikë, përgjegjësia e nëpunësve shtetërorë dhe publikë, përgjegjësia disiplinore dhe materiale, vlerësimi i nëpunësve shtetërorë dhe publik, pushimi i punësimit dhe mbrojtja e të drejtave të nëpunësve shtetërorë dhe publikë.

Në lidhje me avancimin e udhëheqjes së resurseve njerëzore, MSHIA në vitin 2012 do të vazhdojë me realizimin e projektit "Krijimi i administratës me të cilën menaxhohet në bazë të kompetencave dhe është e orientuar në performimin e të punësuarve". Në suazat e këtij projekti u përgatit **Metodologjia për menaxhim me resurset njerëzore e bazuar në kompetencat si dhe Analiza dhe përgatitja e procedurave të brendshme të cilat e mundësojnë aplikimin e kompetencave në administratë**. Prioritet i MSHIA në periudhën e ardhshme paraqet vendosja e Sistemit për menaxhim me performimin (Performance Management System).

Me ndryshimet e Ligjit për nëpunësit shtetërorë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 167/10) që kanë filluar të aplikohen nga 01.01.2011, janë realizuar ndryshime esenciale të procesit të vlerësimit të nëpunësve shtetërorë, me ç'rast periudha për vlerësimin në vend të një viti është reduktuar në gjashtë muaj dhe kompetenca për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave nga vlerësimi i Agjencisë për nëpunës shtetërorë i është kaluar Ministrisë për shoqëri informatike dhe administratë. Si rezultat i këtyre ndryshimeve ligjore MSHIA miratoi edhe Rregullore të re për mënyrën dhe procedurën e vlerësimit të nëpunësve shtetërorë, përmbajtjen e raporteve dhe formularin për vlerësim ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 58/11).

MSHIA, në pajtim me konkluzionin e Komitetit për reforma në administratën publike, formoi **Grup punues** të përbërë prej përfaqësuesve të institucionit, Agjencisë për administratë, Ministrisë së drejtësisë, Ministrisë së financave, Byrosë për zhvillim të arsimit pranë Ministrisë për arsim dhe shkencë dhe Lidhjes së Sindikatave të Maqedonisë, **që do ta përkufizojë mënyrën optimale të vlerësimit të nëpunësve në Republikën e Maqedonisë** (mënyrën e vlerësimit, kornizën kohore, lidhshmërinë e vlerësimit me karrierën e nëpunësve dhe implikimet financiare të vlerësimit). Grupi punues do të përpilojë zgjidhjet e reja për ndryshim të sistemit të vlerësimit. Pas miratimit të ndryshimeve nga ana e Qeverisë, do të bëhen ndryshime në aktet relevante ligjore dhe nënligjore, do të zbatohen trajnime për implementimin e tyre në praktikë, ndërkaq paralelisht me aktivitetet e lartpërmendura, do të sigurojë softuer për përcjellje elektronike dhe analizë të vlerësimit të nëpunësve. Në plan afatmesëm do të avancohet Regjistri për nëpunësit shtetëror përmes krijimit të e-dosjeve për të punësuarit në administratën shtetërore.

Një prej kompetencave të MSHIA në pajtim me Ligjin për organizim dhe punë të organeve të administratës shtetërore dhe Ligjin për nëpunës publik është mbajtja e Regjistrit të nëpunësve publikë. Për këtë qëllim është miratuar Rregullore për formën dhe përmbajtjen e formularëve për evidentimin e të dhënave për nëpunësit publikë, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 61/2011). Rregullorja bashkë me Kreun IX të Ligjit për nëpunës publikë është bazë për formimin e "Regjistrit të nëpunësve publikë-RNP",

Në këtë kontekst bëhet zgjidhje sistemore për mbajtjen e bazës së të dhënave për nëpunësit publikë. Në vitin 2012 do të vazhdojë me aktivitetet për aftësimin e sistemit për evidencë të nëpunësve publikë në Regjistrin për nëpunës publikë të sapothemeluar. Gjatë vitit 2012 do të fillojë me dhënien e të dhënave nga RNP.

Nga viti 2011, Ministria për shoqëri informatike dhe administratë ka ndërmarr edhe obligimin për zbatim të vazhdueshëm të trajnimeve gjenerike të të gjithë nëpunësve shtetërorë.

Në lidhje me aktivitetet për **Strategjinë për trajnime 2009-2011** realizohet përgatitja e programeve të veçanta arsimore për trajnim (kurikulume) për të gjitha trajnimet e parapara me Programin vjetor për trajnim gjenerik të nëpunësve shtetërorë për vitin 2011, përveç kurikulumit për "Trajnimin e ri për aplikim konsistent të Ligjit për menaxhim elektronik".

Me mbështetje të njësisë së formuar në suazat e IPA projektit 2007 – "Ndihmë teknike për Agjencinë për nëpunës shtetërorë", është përgatitur dokumenti për **Kritere dhe standarde për trajnim dhe udhëzim për përdorim të tyre**, seleksionimi i trajnuesve si temë e veçantë është përpunuar në mënyrë plotësuese.

Në vitin 2012 do t'i qasemi përgatitjes së **Sistemit nacional për koordinim të aftësimin dhe trajnimin profesional të nëpunësve shtetërorë në Republikën e Maqedonisë dhe Strategji për trajnim të administratës në Republikën e Maqedonisë 2012-2014**. Në vitin 2012 do të fillohet me aktivitete për miratimin e programit vjetor për trajnime gjenerike për vitin 2013.

Në lidhje me avancimin e mëtejshëm të koordinimit për planifikim të përfaqësimit të drejtë në administratën publike ndërmjet MSHIA dhe Sekretariatit për zbatimin e Marrëveshjes kornizë (SZMK) në vitin 2012 do të formohet grup punues ndërresorjal nga përfaqësuesit e MSHIA, SZMK dhe Agjencisë për realizimin e të drejtave të bashkësive (ARDB). Qëllimi i grupit punues do të jetë

përgatitja e Metodologjisë për planifikim të nevojës për punë sipas përfaqësimit të drejtë dhe adekuat në administratën publike.

Me ndryshimet dhe plotësimet e miratuara në Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative si dobi e veçantë për qytetarët ka nisur vendosja e **sistemit njësportel në administratën publike**. Me sistemin njësportel është e mjaftueshme që qytetari të drejtohet në institucionin, ndërkaq personi zyrtar që e udhëheq procedurën është i obliguar me detyrë zyrtare të jep të dhënat e kërkuara. Zbatimi i këtij projekti është në drejtim të thjeshtëzimit të procedurave për qytetarët dhe vendosjen e administratës së orientuar kah shfrytëzuesit përfundimtarë.

Iniciativa "Ditar civil" është përgjigje e kërkesës për zgjidhjen e problemeve në të cilat hasin qytetarët në ndërveprimin e përditshëm me organizatat ose institucionet të cilat sigurojnë shërbime publike. "Ditari civil" është paraparë si vegël për iniciativa dhe ide me të cilat do të ishte ngritur niveli i standardeve në dhënie e shërbimeve dhe atë në mënyrën më adekuate nga ana e administratës. Nëpërmjet instrumentit Ditari civil do të instalohet **Formular për vlerësimin e shërbimeve nga ana e shfrytëzuesve**, që paraqet pyetësor të thjeshtë me të cilin qytetarët shfrytëzues të shërbimeve të caktuara janë pyetur për mënyrën, shpejtësinë, afatin kohor për fitimin e shërbimit dhe njëkohësisht paraqet mundësi për dhënie e propozimit për avancimin e mënyrës së dhënies së shërbimeve.

Gjatë vitit 2011 Agjencia për administratë, kryesisht, është përqendruar në zbatimin e kompetencave të caktuara në Ligjin për nëpunës shtetërorë dhe ato që kanë rezultuar pas nisjes së aplikimit të Ligjit për nëpunësit publikë (24 prill 2011), veçanërisht në pjesën e procedurave për seleksionim dhe punësim dhe vendosje për ankesa dhe kundërshtime të nëpunësve shtetërorë dhe publikë, si organ i shkallës së dytë.

Duke pasur parasysh prioritetet strategjike në vitin 2012, Agjencia për administratë do të vazhdojë me angazhimet për: Vendosje të sistemit të vetëm dhe konsistent të shërbimit shtetëror, nëpërmjet kontrollimit dhe miratimit të harmonizimit të akteve për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës së organeve të administratës shtetërore; avancim të mëtejme të sistemit të sapovendosur për seleksionim dhe punësim të nëpunësit publik, në bazë të parimeve të profesionalizmit dhe kompetencës dhe respektimit të parimit të përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të pjesëtarëve të bashkësive, si dhe sigurim të mbrojtjes së të drejtave të nëpunësve shtetërorë dhe publikë, të cilat rezultojnë nga marrëdhënia e nëpunësit, duke vendosur në shkallë të dytë për ankesat dhe kundërshtimet e tyre.

Në funksion të një prej prioritetëve strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë – integrimi në Republikën e Maqedonisë në Bashkimin Evropian, Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, si një prej institucioneve kryesore bartës të këtij procesi, edhe më tej me sukses do të vazhdojë me realizimin e serisë së masave dhe aktiviteteve të cilat në masë të madhe do të kontribuojnë për implementimin e papenguar të këtij prioriteti strategjik. Përkatesisht, masat dhe aktivitetet të Sekretariati i përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë do t'i zbatojë do të jenë të drejtuar në përmirësimin e procesit të transparencës dhe përgjegjësisë së administratës si dhe fuqizim të mëtejme të kapaciteteve administrative për aderim në Bashkimin Evropian.

Reformat në polici

Ministri i punëve të brendshme e ka nënshkruar Aktin për sistematizim të vendeve të punës në Ministrinë e punëve të brendshme. Në periudhën shkurt-mars 2011, është realizuar procesi i vlerësimin të të punësuarve në Ministri. Në pajtim me dispozitat e Rregullores për trajnim në Ministrinë për punë të brendshme, do të përgatitet Strategji për trajnim të të punësuarve në Ministrinë e punëve të brendshme, ku do të përkufizohen qëllimet dhe parimet për zbatimin e trajnimit, sistemit të trajnimit dhe target grupet që do të përfshihen me të njëjtën. Njëkohësisht, do të rregullohet mënyra e financimit dhe rreziqet që rezultojnë me themelimin e sistemit për trajnim në Ministri.

Është miratuar Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për punë të brendshme, qëllimi primar i të cilit është krijimi i bazës juridike dhe mundësisë që Ministria e punëve të brendshme t'ia ndërpresë marrëveshjen për punësim personit të autorizuar zyrtar, pas mbushjes së stazhit pensional prej 40 viteve, pa marrë parasysh moshën e tij, si dhe punëtorit i cili ka fituar të drejtën për pension i takon kompensim i njëfishtë në formë të kompensimit të njëherëshëm.¹

Gjatë vitit 2012 do të vazhdojë procesi i monitorimit të implementimit jo vetëm të Ligjit për punë të brendshme por edhe të ligjeve tjera në kompetencat e ministrisë. Forma dhe mënyra e monitorimit do të caktohet në fillim të vitit 2012.

Gjatë vitit 2012 do të përgatitet akt intern me të cilin do të përkufizohen standardet e përgjithshme normative të cilat duhet t'i plotësojnë hapësirat për mbajtje në stacionet policore, në pajtim me të cilat do të bëhet analizë e kapaciteteve ekzistuese si dhe plan për tejkalimin e mangësive të konstatuara, përkatësisht do t'i qaset rinovimit të një pjese të hapësirave për mbajtje.

Në periudhën e kaluar kanë vazhduar trajnimet për pjesëtarët e ministrisë². Qendra për trajnim ka buxhet të veçantë në lartësi prej 50569000 denarëve (822.000 euro). Në buxhetin e ri të Qendrës për trajnime janë planifikuar 36925961 denarë (600.000 euro).

Për nevojat e procesit të reformave në polici janë akorduar 13456928000 (22.000.000 euro), derisa për vitin 2012 janë paraparë 1082323400 (17.600.000 euro).

Spektori për kontrollë të brendshme dhe standarde profesionale do të përpilojë Programë të re për Parandalimin e Korrupsionit në Ministrinë e punëve të brendshme Plan aksional për realizim, si dhe Programë për punë të Sektorit për kontrollë të brendshme dhe standarde profesionale në të cilën do të përfshihen trajnimet e të punësuarve.

SISTEMI GJYQËSOR (*shih Kreu 23 – Jurisprudenca dhe të drejtat themelore*)

Për përforcimin e mëtejme të pavarësisë, paanshmërisë, profesionalizimit dhe transparencës së gjyqësorit, gjatë vitit 2012, do të vazhdohet me aktivitete për realizimin e risive në kornizën juridike në lidhje me zgjedhjen e gjyqtarëve, përcjelljen dhe vlerësimi e punës së gjyqtarëve sipas kriterëve të reja, sistemi i karrierës në avancimin e gjyqtarëve, financimi i gjyqtarëve, si dhe aktivitete për sigurimin e qasjes më të lehtë dhe më të shpejtë të qytetarëve në drejtësi.

Këshilli për reforma gjyqësore, që është kompetent për përcjelljen e efekteve nga reformat në jurisprudencë, do të vazhdojë me mbajtjen e rregullt të takimeve.

Për shkak të përcaktimit të mëtejme të nevojave për resurse njerëzore në jurisprudencë, Këshilli gjyqësor dhe Këshilli i prokurorëve publikë në qershor 2011 kanë miratuar Strategji për përcaktimin e numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë (2011-2013), me të cilën është planifikuar që numri i tre gjeneratave të ardhshme të dëgjuesve të trajnimit fillestar në Akademinë për gjyqtarë dhe prokurorë publikë të jetë 43 kandidatë dhe për implementimin e tij Këshilli gjyqësor i RM-së dhe Këshilli i prokurorëve publikë të RM-së në periudhën e ardhshme do të përgatisin Programe për aplikimin e kriterëve për përcaktimin e numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë për 2014-2019.

Poashtu, Këshilli gjyqësor i RM-së dhe Këshilli i prokurorëve publikë në vitin 2012 do të realizojnë Plane për zgjedhje të gjyqtarëve dhe prokurorëve prej gjeneratës II dhe III të kandidatëve nga AGJPP, si dhe do të ndërmerren aktivitete për realizim të planit për zgjedhje të prokurorëve publikë të gjeneratës së katërt.

Për reduktim të ndikimit të pushtetit ekzekutiv në gjyqësor, në korrik 2011 u miratuan ndryshime dhe plotësime të Ligjit për Këshillin gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, me të cilat është hequr e drejta për votë e ministrit të Drejtësisë në Këshillin gjyqësor, si dhe ndryshime dhe plotësime të Ligjit për prokurorë publikë, me të cilat ministri i Drejtësisë nuk është më anëtar i Këshillit të prokurorëve publikë. Këshilli gjyqësor dhe Këshilli i prokurorëve publikë nga shtatori 2011 i mbajnë mbledhjet e tyre në pajtim me këto ndryshime.

Gjatë vitit 2012, Këshilli gjyqësor i RM-së në nivel mujor do të informojë për aktivitetet në lidhje me zgjedhjen dhe shkarkimin e gjyqtarëve, për seanca publike për debat lidhur me parashtrësat dhe ankesat nga qytetarët dhe personat juridikë për punën e gjyqtarëve, si dhe në mënyrë të vazhdueshme do të njoftojë për procedurat për punë joprofesionale dhe të pandërgjegjshme dhe përgjegjësi disiplinore, ndërkaq do të përpilojë edhe Raport për përcjellje dhe vlerësim të punës së gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave për vitin 2011. Gjithashtu edhe Këshilli i prokurorëve publikë, në nivel mujor do të njoftojë për aktivitetet në lidhje me zgjedhjen, shkarkimin e prokurorëve publikë, kurse në bashkëpunim me PPRM në mënyrë të vazhdueshme do të njoftojë për procedura për punë joprofesionale dhe të pandërgjegjshme dhe përgjegjësi disiplinore. Për rregullimin e statusit, të drejtave, obligimeve, përgjegjësive të nëpunësve të prokurorisë publike, si

dhe sistemi i pagave dhe kompensimeve, në vitin 2012 është paraparë të miratohet Ligj për shërbimin e prokurorisë publike.

Për avancimin e mëtejme të financimit të gjyqësorit, është miratuar Program vjetor për investime kapitale, realizimi i të cilit deri në dhjetor 2011 është 83,01%. Buxheti i pushtetit gjyqësor për vitin 2011 në raport me vitin 2010 është zmadhuar për 6.511.000 denarë dhe është 1,750,412,000 denarë, derisa në vitin 2012 buxheti është zmadhuar për 1,87% (ose 32.721.000 denarë) dhe është 1.784.133.000 denarë.

Për implementim të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për buxhet gjyqësor, në vitin 2012 do të fillohet me rritje graduale të buxhetit gjyqësor për 0,1%, deri në arritjen në 0,8% të BPV deri në vitin 2015.

Për shkak të avancimit të planifikimit dhe menaxhimit me buxhetin gjyqësor, do të përgatitet Analizë e shpenzimeve rrjedhëse të punës së gjykatave.

Tërësisht janë rinovuar 11 ndërtesa gjyqësore në gjykatat themelore⁴, ndërkaq në rrjedhë është ndërtimi i Gjykatës Penale në Shkup, si dhe ndërtim të objektit të ri të Prokurorisë publike.

Për profesionalizim të mëtutjeshëm të gjyqësorit janë ndërmarrë aktivitete për implementimin e Ligjit për Akademinë e gjykatësve dhe prokurorëve publikë, me miratimin e të gjitha akteve nënligjore, janë përpiluar teste psikologjike, ndërkaq në përgatitje janë edhe testet për integritet. Akademia për gjyqtarë dhe prokurorë publik, vazhdoi me zbatimin e trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm. Në lidhje me zgjedhjen e kandidatëve të AGJPP, prej 71 kandidatëve të gjeneratës së I, II dhe III deri tani janë zgjedhur gjithsej 51 kandidatë (32 gjyqtarë dhe 19 prokurorë publik). Gjenerata e katërt prej 9 kandidatëve, e kryen trajnimin praktik më 18.11.2011 ndërkaq në dhjetor 2011 është zbatuar provimi përfundimtar. Akademia e gjyqtarëve dhe prokurorëve publik në vitin 2012 në bashkëpunim me Këshilli gjyqësor të RM-së dhe Këshillit të prokurorëve publik, do të vazhdojë me aktivitete për pranim të gjeneratës së pestë të kandidatëve për trajnim fillestar, si dhe do të vazhdojë me realizimin e mëtutjeshëm të Programeve për trajnim fillues dhe të vazhdueshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe të nëpunësve gjyqësor dhe të prokurorisë publike.

Në drejtim të sigurimit të së drejtës së garantuar me kushtetutë për ankesë në kontestet administrative, Gjykata Supreme Administrative është formuar më 30 qershor 2011, dhe për funksionimin e vet efikas janë zgjedhur 13 gjyqtarë dhe Kryetar i Gjykatës, si dhe është ekuipuar me 12 nëpunës. Për përforcimin e mëtejme të kapaciteteve të Gjykatës administrative, janë zgjedhur 7 gjyqtarë dhe Kryetar i gjykatës, me çka numri i përgjithshëm i gjyqtarëve është 29³. Mbetet të zgjedhen edhe 3 gjyqtarë. Poashtu, janë punësuar 9 persona të ri, ashtu që numri i përgjithshëm i administratës është 43 persona.

Në drejtim të rritjes së efikasitetit të jurisprudencës, kanë filluar të aplikohen Ligjin për menaxhim me lëndë gjyqësore, ndryshimet në Ligjin për procedurë kontestimore, si dhe ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për përmbarrim, implementimi i të cilit do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2012. Përveç kësaj, në vitin 2012 do të përpilohet Raport për aplikimin e Ligjit për përmbarrim në lidhje me transferin e lëndëve ekzekutive dhe do të vazhdohet me emërimin e përmbarruesve për vendet vakante për përmbarrim. Me qëllim të përcjelljes së punës së gjykatave, do të përpilohen raporte gjysmëvjetore për situatën me tejkalimin e prurjes dhe reduktimin e mbetjes së lëndëve.

Në drejtim të përmirësimit të implementimit të ndërmjetësimit në lëndë civile dhe tregtare, gjatë vitit 2012 do të realizohet MATRA Projekt për mbështetje e avancimit të ndërmjetësimit në RM.

Me qëllim të vendosjes së statistikës gjyqësore, është miratuar Metodologji për mbajtjen e statistikës së unifikuar në bazë të (Go just) udhëzime në suazat e Komisionit Evropian për efikasitet të drejtësisë (SEREJ), për implementimin e të cilës në vitin 2012, është paraparë të realizohet projekt për blerje dhe testim të aplikimit softuerik për gjenerimin e tabelave dhe raporteve për punë të gjykatave, që do të jenë funksionale prej vitit 2013.

Në lidhje me reformën në drejtësinë ndëshkimore, gjatë vitit 2012, do të vazhdohet me realizimin e aktiviteteve për implementimin e Ligjit për procedurë penale, nëpërmjet miratimit të ndryshimeve të ligjeve nga aspekti i harmonizimit me LPP, aktet nënligjore, si dhe zbatimin e trajnimit për gjyqtarë, prokurorë publik, pjesëtarët e Ministrisë së punëve të brendshme, Policinë financiare, Drejtorinë doganore dhe avokatët. Poashtu, PPRM, do të miratojë Vendim për formimin e qendrës për hulumtime, si dhe do të ndërmerren aktivitete përforcimin e kapaciteteve të prokurorive publike.

POLITIKA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT (shih Kreu 23 – Jurisprudenca dhe të drejtat fundamentale)

Në drejtim të përforsimit dhe përmirësimit të politikës për parandalimin e korrupsionit, gjatë vitit 2011 janë ndërmarrë aktivitete për implementimin efikas të zgjidhjeve të reja, realizimi i GREKO Rekomandimeve nga rrethi III i evaluimit, përforsimi i bashkëpunimit ndër-institucional, bashkëpunimi në luftën kundër krimit të organizuar, si dhe përgatitja e Programit Shtetëror të ri për parandalimin dhe represionin e korrupsionit dhe për parandalimin e konfliktit të interesave me Planin aksional, me të cilat do të vazhdohet gjatë vitit 2012.

Trupi ndërresorjal për luftë kundër korrupsionit, që do të përcjell dhe koordinojë aktivitetet kundër korrupsionit gjatë vitit 2012 do të vazhdojë me mbajtjen e rregullt të takimeve.

Gjatë vitit 2011 me sukses janë realizuar të gjitha 13 GREKO rekomandimet nga rrethi III i evaluimit⁴, në suazat e të cilave janë miratuar Ligji për ndryshime dhe plotësime të Kodit penal; Ligji për ndryshime dhe plotësime të Kodit zgjedhor dhe Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për financimin e partive politike, implementimi i të cilëve do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2012. Gjithashtu, janë zbatuar trajnime për përforsimin e kapaciteteve të gjyqtarëve, prokurorëve publik dhe pjesëtarëve të policisë, për rrushfetin aktiv dhe pasiv të arbitrave të vendit dhe të huaj të përfshirë nëpërmjet konceptit të personit zyrtar, në pajtim me Konventën Ndërkombëtare për korrupsion të Këshillit të Evropës, që do të vazhdojnë në vitin 2012. Ministria e drejtësisë më prill 2012 do të informojë Qeverinë për konkluzionet nga Raporti i GREKO-s për harmonizim të Republikës së Maqedonisë me rekomandimet nga rrethi III i evaluimit. Republika e Maqedonisë gjatë vitit 2012 do të ndërmerr aktivitete për përgatitje të Rrethit të katërt të evaluimit të Republikës së Maqedonisë nga ana e GREKOS, në temën – parandalim të korrupsionit lidhur me anëtarët e parlamentit, gjyqtarët dhe prokurorët publikë.

Për realizim të rekomandimit të KE për kontroll sistemor të përmbajtjes së deklaratave për konflikt të interesave, në rrjedhë është miratimi i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për konflikt të interesave, në pajtim me të cilin do të miratohet akt nënligjor me të cilin do të rregullohet mënyra e kontrollimit të përmbajtjes së deklaratave për interes të personave të zgjedhur dhe të emëruar dhe do të veprojë sipas lëndëve për konflikt të mundshëm të interesave.

KSHPK, miratoi Programin e ri shtetëror për parandalim dhe represion dhe reduktim të dukurisë së konfliktit të interesave 2011-2015. KSHPK në vazhdimësi do të përcjell realizimin e aktiviteteve të parapara në Planin aksional të Programit shtetëror për parandalimin dhe represionin e korrupsionit dhe parandalimin dhe reduktimin e dukurisë së konfliktit të interesave 2011-2015.

KSHPK në vitin 2012 do të vazhdojë me kontroll të të dhënave nga fletankesat e personave të zgjedhur dhe të emëruar në pajtim me sistemin e vendosur për kontroll, dhe Kriteret për mënyrën e përcaktimit të fletankesave.

Sa i përket rekomandimeve në lidhje me financimin e zgjedhjeve parlamentare nga qershor 2011. KSHPK përpiloi Informatë për aplikim të dispozitave ligjrore në zgjedhjet e parakohshme parlamentare 2011. Enti shtetëror për revizion, në periudhën shtator-dhjetor 2011 ka kryer revizion të raporteve financiare të 17 partive politike (që marrin pjesë në zgjedhjet e parakohshme parlamentare qershor 2011) për çka në janar 2012 do të përpilojë Raport me rekomandime nga revizionet e kryera të partive politike që do t'i shpall në ueb faqen e vet. Poashtu në vitin 2012 do të kryejë revizione të partive politike nga aspekti i zbatimit të rekomandimeve. Njëkohësisht, në pajtim me ndryshimet e fundit të Ligjit për financim të partive politike, Enti Shtetëror për revizion do të ketë kompetencë të kryejë mbikëqyrje mbi punën materialo-financiare të partive politike dhe në rast të parregullsive të konstatuara në raportin vjetor financiar të partisë politike, do të mund të parashtrijë kërkues për ngritjen e procedurës për kundërvajtje ose paraqitje te prokurori publik kompetent në afat prej 30 ditëve nga dita e konstatimit të parregullsive.

Më vitin 2012 do të miratohen ndryshime dhe plotësime të Ligjit për parandalimin e korrupsionit, me qëllim të rregullohet mbrojtje sistemore dhe institucionale e personave të cilët dëshirojnë të paraqesin raste të korrupsionit, si dhe çështja e integritetit.

Në pajtim me rekomandimet nga Raporti i Komisionit Evropian për progresin e realizuar të Republikës së Maqedonisë, do të bëhen ndryshime në Ligjin për përcjellje të komunikimeve që kanë të bëjnë me autorizimin e Ministrit të punëve të brendshme në pjesën e përcjelljes së komunikimeve.

Me qëllim të zbatimit të dispozitave të konfiskimit të zgjeruar dhe pasurimit ilegal nga Ligji për ndryshime dhe plotësime të Kodit penal gjatë vitit 2012, AGJPP do të vazhdojë me realizimin e

trajtimeve në këto tema për gjyqtarët dhe prokurorët publik. Njëkohësisht, do të mbikëqyret dhe njoftohet për raste eventuale të konfiskimit të zgjeruar dhe pasurim jolegal.

Do të vazhdohet me realizimin e aktiviteteve për implementimin e Ligjit për procedurë penale, nëpërmjet miratimit të ndryshimeve të nevojshme të ligjeve nga aspekti i harmonizimit me LPP, miratimi i akteve nënligjrore, ndërkaq do të miratohet Vendimi për formim të qendrës hulumtuese dhe do të ndërmerren edhe aktivitete për përforcimin e kapaciteteve kadrovike të prokurorive publike.

1.2. TË DREJTAT E NJERIUT DHE MBROJTJA E PAKICAVE

(për më shumë informata shih në pjesën 3.23.3 Të drejtat fundamentale)

1.2.1 Respektimi i së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut

Gjatë vitit 2011 është ratifikuar Konventa e të drejtave të personave me invaliditet dhe Protokollin Fakultativ i Konventës si dhe Harta Sociale e Evropës e reviduar. Republika e Maqedonisë edhe në periudhën e ardhshme do të vazhdojë me harmonizimin e mëtutjeshëm të legjislacionit nacional me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut me ratifikimin e Hartës Evropiane për gjuhë rajonale ose të pakicave.

Do të vazhdojnë aktivitetet përforcimin e sistemit nacional për realizim në kohë dhe efikas të vendimeve të KEDNJ. Në drejtim të përforcimit të njohurive për të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut do të vazhdojnë trajnimet në lidhje me Konventën Evropiane për të drejtat e njeriut që janë zbatuar në periudhën e kaluar. Ka vazhduar praktika e përkthimit, shpalljes dhe dërgimit të vendimeve nga KEDNJ te gjyqtarët dhe institucionet e përfshira në rastin konkret.

Në pajtim me dispozitat ligjrore është formuar Byro për përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë pranë Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut.

1.2.2. Të drejta civile dhe politike

Është paraparë përforcim administrativ i Sektorit për kontroll të brendshëm dhe standarde profesionale (SKBSP) pranë Ministrisë së punëve të brendshme të nis me ditë të hapura për qytetarët në të cilat do të mund të informohen për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut gjatë aplikimit të autorizimeve policore, si dhe të japin vërejtje dhe sugjerime konkrete. Është paraparë furnizim i sektorit me pajisje për sigurim të pavarur të provave për kryerësit e veprave penale nga radhët e policisë dhe ministrisë. Do të vazhdojë bashkëpunimi me Avokatin e Popullit dhe sektorit joqeveritar dhe mbajtja e trajnimeve të përbashkëta për të njëjtit.

Ka nisur procedurë gjyqësore kundër një anëtar të njësisë policore Tigrat për vrasje të kryer gjatë kohës pas zgjedhjeve në Shkup.

Në fushën e reformës së sistemit të burgut, në vazhdueshmëri realizohen aktivitete për ndërtim, rikonstruim dhe furnizim të institucioneve penitenciare, si dhe aktivitete për përmirësim të trajtimit me personat e gjykuar. Tërësisht është përfunduar rinovimi i krahut të pestë në SHNP Idrizovë dhe kullave për rojë derisa për degën e dytë në rrjedhë është procedura për rinovimin e saj. Gjatë vitit 2012 si dhe në afat të mesëm, do të vazhdohet me aktivitetet për ndërtim të objekteve të reja SHNP Idrizovë, SHEP i ri në Tetovë, ndërtim përfundimtar i burgut Kumanovë dhe rinovim dhe ndërtim të burgut Shkup⁵.

Janë ndërmarr masa të cilat kanë të bëjnë me trajtimin psikosocial të personave të gjykuar që abuzojnë drogë, e që janë në vuajtje të dënimit me burg në SHNP Idrizovë. Do të përpilohet Program për trajtim dhe do të përpilohet Strategji për mbrojtje shëndetësore në institucionet ndëshkimoro-korrigjuese dhe edukativo-korrigjuese me qëllim të përmirësimit të mbrojtjes shëndetësore të personave të gjykuar. Janë ndërmarr më shumë aktivitete për përforcimin e kapaciteteve administrative, si trajnime për drejtorët dhe personat udhëheqës në burgjet, trajnimet për udhëheqësit e sektorit për sigurim dhe sektorit për risocializim, përgatitje të procedurave dhe Protokolle për procesim të të punësuarve në institucionet ndëshkimoro-korrigjuese dhe edukativo-korrigjuese. Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve do të vazhdojë me zbatimin e trajnimeve të obligueshme të të punësuarve në SHNP dhe SHEP, si në afat të shkurtë ashtu edhe në afat të mesëm. Deri në mes të vitit 2013 do të përpilohet Strategji për zhvillim të shërbimit të probacionit në Republikën e Maqedonisë. Do të vazhdojnë edhe aktivitetet për eliminimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit në institucionet ndëshkuese-përmirësuese dhe zbatimi i mbikëqyrjeve të rregullta,

të jashtëzakonshme dhe kontrolluese. Deri në fund të muajit shtator 2012, do të përpilohet Doracak për kryerjen e mbikëqyrjes profesionale të instruktorëve.

Deri në mes të vitit 2013 do të zhvillohet komizë efektive për sistemit e burgjeve nëpërmjet të përpunimit të Strategjisë Nacionale për zhvillim të sistemit të burgjeve në Republikën e Maqedonisë. Në periudhën e ardhshme do të vazhdojë edhe implementimi i aktiviteteve tjera të parapara me IPA Projektin 2009 "Ndërtim të kapaciteteve të institucioneve për zbatimin e ligjit për trajtim adekuat të personave të paraburgosur dhe të gjykuar" dhe IPA Projektit 2010 "Mbështetje e mëtejshme për gjyqësor të pavarur, përgjegjës, profesional dhe efikas dhe promovim të dënimit me kusht dhe masave alternative".

Sa i përket rekomandimit të Parlamentit Evropian nga viti 2007 për përcjelljen e rastit të paraburgim të supozuar jashtëgjyqësor të Kaled El Masri, me kërkesë të avokatit të paditësit, që është në vuajtje të dënimit me burg në Gjermani, prej ku duhet të çlirohet në shkurt 2012, do të pritet dëshmimi i tij dhe oferta e materialit të provave për deklaratën.

Ka vazhduar të implementohet Ligji për ndihmë juridike falas. Janë përpiluar ndryshime të Ligjit për ndihmë juridike falas për shkak të inkuadrimit të azil-kërkuesve në kategorinë e shfrytëzuesve të së drejtës për ndihmë juridike falas. Në Regjistrin e organizatave që japin ndihmë juridike falas, janë regjistruar gjithsej 4 organizata.

Në lidhje me lirinë e të shprehurit, në shtator 2011, Qeveria dhe Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë kanë filluar dialog për çështje të lidhura me punën e mediave. Është formuar grup punues që përpilon Plan Aksional me masa për ndryshimet e nevojshme ligjore, implementimi i drejtë i ligjeve, koncentrim të mediave, dekriminalizim të shpifjes dhe gjitha çështjeve tjera relevante nga fusha e punës së mediave. Në pajtim me Katalogun për trajnim të vazhdueshëm obligativ të Akademisë për trajnim të gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë për periudhën shtator-dhjetor 2011 janë mbajtur trajnime për gjyqtarë dhe prokurorë publikë për jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut, për lirinë e të shprehurit.

Në lidhje me lirinë për mendim, vetëdije dhe religjion, në vazhdueshmëri implementohet Ligji për kisha, bashkësi religjioze dhe grupe religjioze.

Pjesëmarrje e sektorit civil në procesin e miratimit të vendimeve dhe mëtej do të mbështetet nëpërmjet implementimit të Strategjisë për bashkëpunim me sektorin civil. Në pajtim me Ligjin për shoqata dhe fondacione, në tremujorin e parë të vitit 2012 është paraparë formim i Komisionit për ndarje të organizatave të interesit publik.

1.2.3 Të drejtat ekonomike dhe sociale

(shih edhe *Kreu 3.19 - Politika sociale dhe punësimi*)

Në drejtim të harmonizimit të mëtejshëm me legjislacionin evropian në periudhën e ardhshme do të miratohet dhe do të fillojë implementimi i Ligjit për mundësi të barabarta të femrave dhe meshkujve⁶. Gjatë vitit 2012 do të vazhdojnë përpjekjet për implementimin e Planit Nacional për aksion për barazi gjinore 2007-2012, ndërkaq do të miratohet edhe Strategji për barazi gjinore. Për shkak të implementimit më efikas të rregullativës dhe programeve nga fusha e barazisë gjinore, do të formohet grup këshilldhënës ndërresorjal për mundësi të barabarta të femrave dhe meshkujve. Do të vazhdojnë aktivitetet për përforcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit me njësitë e vetadministrimit lokal dhe mekanizmave për mundësi të barabarta të femrave dhe meshkujve në nivel nacional dhe lokal.

Në drejtim të futjes së konceptit gjinor në politikat gjinore, do të përpunohet Strategji për buxhetim gjinor me përgjegjësi. Do të përpunohet Plan Nacional Aksional për implementimin e Rezolutës 1325 të KB për promovimin e dhe avancimin e pjesëmarrjes së femrave në krijimin e politikave paqësore dhe inkuadrimit të tyre më të madh në trupat ku miratohen vendime si dhe promovim të rolit të tyre në proceset paqësore dhe zgjidhjen paqësore të situatave konfliktuoze. Në afat të mesëm do të evaluohet Plani Nacional ekzistues për aksion për barazi gjinore (2013-2017) dhe do të përforcohen kapacitetet e mekanizmave për barazi gjinore në nivel nacional.

Është miratuar Plani Nacional Aksional i dytë për avancimin e pozitës shoqërore të femrës Rome, ndërkaq janë realizuar edhe punëtori për masat aktive për punësim, të drejtat nga mbrojtja shëndetësore dhe sociale dhe realizim të të drejtave të njeriut, parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi.

Gjatë vitit 2012, është themeluar qasje multisektoriale në mbrojtjen e viktimave të dhunës familjare nëpërmjet përpilimit të Protokollit të përbashkët në rast të dhunës familjare. Në nivel lokal

janë formuar 30 trupa koordinues lokal të cilët punojnë në parandalimin dhe implementim praktik të Protokollit për veprim të strukturave profesionale. Në vazhdueshmëri implementohet Programi për përforsim ekonomik të viktimave të dhunës familjare ndërkaq nëpërmjet trajnimeve në vazhdueshmëri përforsohen kapacitetet e punëtorëve profesional⁷. Në bazë të praktikave pozitive të vendeve për këshilla për punë me kryerësit e dhunës familjare në Shkup gjatë vitit 2011 është hapur, mëtej edhe do të hapen vende të tilla për këshilla edhe në qytetet tjera të territorit të RM-së. Për ngritjen e vetëdijes publike për paraqitje të dhunës familjare në vitin 2011 ka filluar fushata nacionale për dhunë familjare me moton "Bashkë të dalim nga errësira e dhunës". Gjatë vitit 2012 do të revidohet Strategjia Nacionale për mbrojtje nga dhuna familjare për periudhën 2012-2015 dhe do të zbatohen hulumtime nacionale për përfaqësimin e dhunës familjare te personat në moshë si dhe hulumtime nacionale për caktimin e përfaqësimit të dhunës familjare në gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë.

Në fushën e të drejtave të fëmijëve, për implementim të plotë të Ligjit për drejtësi për të mitur do të punohet në përmirësimin e cilësisë së kujdesjes dhe mbrojtjes së fëmijëve në rrezik dhe kryerësve të mitur të veprave penale. Është paraparë hapje e institucioneve të vogla grupore si formë e re për trajtim dhe mbrojtje të këtyre personave në nivel lokal dhe nacional.

Në vitin 2012 do të vazhdojë implementimi i Planit Aksional për parandalim dhe ballafaqim me keqpërdorimin seksual të fëmijëve dhe pedofili 2009-2012 dhe do të bëhet revidim i të njëjtit në pajtim me rezultatet e fituara nga hulumtimi për situatën me keqpërdorimin seksual të fëmijëve dhe pedofili në Republikën e Maqedonisë. Në mënyrë plotësuese, do të fillojë fushatë mediale për senzibilizimin dhe ngritjen e vetëdijes publike për këtë problem. Poashtu, do të insistohet të avancohet sistemi koordinues i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve qeveritare si dhe bashkëpunimi ndërmjet institucioneve qeveritare dhe organizatave joqeveritare që e mbulojnë këtë problematikë.

Në drejtim të reduktimit të dukurisë së fëmijë në rrugë, do të përhapet rrjeti i qendrave tranzit për fëmijë në rrugë në komunën e Ohrit, ndërkaq do të hapet edhe qendër ditore për fëmijë në rrugë në komunën e Prilepit. Do të punohet nëpërforsimin e kapaciteteve profesionale të personave profesional me fëmijë në rrugë dhe në rritjen e aktiviteteve parandaluese në drejtim të reduktimit të rrezikut për abuzim ekonomik dhe fizik të fëmijëve. Do të vazhdojnë edhe trajnimet e punëtorëve profesional në Qendrat për punë sociale.

Për shkak të përmirësimit të cilësisë së kujdesjes dhe mbrojtjes së fëmijëve në rrezik dhe kryerësve të mitur të veprave penale do të punohet në hapjen e dhomave të vogla grupore për fëmijë me probleme edukativo-sociale dhe hapësira të përshtatshme për fëmijë në të gjitha Qendrat për punë sociale.

Deri në fund të muajit mars 2012, në drejtim të harmonizimit të legjislacionit nacional me Konventën e Kombeve të bashkuara për të drejtat e fëmijut, do të bëhet revidim i planit nacional për aksion për të drejtat e fëmijëve 2006-2015.

Në lidhje me personat kategori vulnerabile sociale dhe/ose persona me pengesa në zhvillim, në vazhdueshmëri është implementuar Strategjia Nacionale e Reviduar për barazimin e të drejtave dhe mundësi të personave me invaliditet 2010-2012.

Në suazat e realizimit të procesit të deinstitutionalizimit gjatë vitit 2012 dhe 2013 planifikohet hapje e shërbimeve në Shkup dhe në rajonin Negotinë-Kavadarci-Veles. Në periudhën e ardhshme paraprinë hapje e 1 qendre ditore për fëmijë me autizëm në Shkup dhe 1 qendër ditore në komunën Strumicë për ngritjen e kujdesit për fëmijë me pengesa në zhvillim, derisa në afat të mesëm përsëri është paraparë hapje e qendrave të tilla ditore në komunat Kratovë, Vallandovë dhe Lipkovë.

Në fushën e politikës për parandalimin e korrupsionit, janë realizuar trajnime për trajnues që kanë trajnuar rreth 300 përfaqësues nga njësitë e vetadministrimit lokal dhe bashkësive rajonale. Janë organizuar tryeza të rrumbullakëta në komunat dhe shkollat fillore për shkak të informimit të qytetarëve për konceptin, bazat dhe format e diskriminimit si dhe për tema në lidhje me mbi femrën, trafikimin me njerëz dhe barazinë gjinore. Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi është bërë tërësisht operativ dhe filloi të veprojë sipas parashtrësive të parashtruara. Prej gjithsej 57 parashtrësive të parashtruara, për 25 është miratuar mendim, ndërkaq për të tjerat procedura është në rrjedhë. Në vazhdimësi janë ndërmarr aktivitete për ngritjen e vetëdijes publike për problemin e diskriminimit nëpërmjet prezantimit të rregullt medial, botimeve dhe distribuimit të materialit promovues dhe vendosje në ueb faqen e Komisionit www.kzd.mk. Është vendosur

bashkëpunim i rregullt me Avokatin e Popullit të RM-së, me Komisionin për mundësi të barabarta të femrave dhe meshkujve në Kuvendin e RM-së, me Ministrinë për punë dhe politikë sociale, me komisionet për mundësi të barabarta në suazat e njësive të vetadministrimit lokal, si dhe me gjithë faktorët tjerë relevant në këtë fushë. Janë miratuar Rregullore dhe Plan Strategjik për punën e Komisionit. Në periudhën e ardhshme do të përpunohet bazë e të dhënave për parashtresat e pranuar në bazë të diskriminimit.

Është përipiular Strategji Nacionale për barazi dhe mosdiskriminim në bazë të gjinisë, përkatësisë etnike, personave me moshë të ndryshme dhe persona me nevoja të veçanta që mbulon periudhën 2012-2015.

1.2.4 Respektimi dhe mbrojtja e pakicave, të drejtat kulturore

Sekretariati për zbatimin e Marrëveshjes Kornizë ka vazhduar me ndërmarrjen e aktiviteteve të drejtuara në avancimin e përfaqësimit të drejtë të përfaqësuesve të gjitha bashkësive etnike, procesi i decentralizimit, përdorimi i gjuhës së bashkësive joshumicë dhe sistemi arsimor.

Është shënuar 10 vjetori nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Ohrit në të cilën ishte konfirmuar përcaktimi i fuqishëm për vazhdim me zbatim të plotë të gjitha akteve normative që kanë rezultuar nga Marrëveshja e Ohrit. Në periudhën e ardhshme do të miratohet Plan Strategjik i Sekretariatit për periudhën 2012-2014.

Në drejtim të përmirësimit të përfaqësimit të drejtë në administratën shtetërore dhe publike, gjatë vitit 2011 janë realizuar dy konkurse nga viti 2010 për gjithsej 79 nëpunës shtetërorë. Në rrjedhë janë konkurset për 328 nëpunës shtetërorë prej të cilëve 250 të dedikuara për bashkësitë më të vogla etnike. Në periudhën e ardhshme në bashkëpunim me Ministrinë për shoqëri informatike do të punohet në zhvillim të planit për harmonizim të ofertës dhe kërkesës së punësimeve sipas K5 programit me qëllim që të njëjtat të përgjigjen në nevojat e vërteta të punësimit në organet e administratës.

Janë miratuar ndryshimet e Ligjit për përdorim të gjuhës që e flasin së paku 20 përqind të qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe në njësitë e vetadministrimit lokal. Gjatë vitit 2012 do të miratohet Plan aksional për përdorim të gjuhëve. Veç kësaj, janë miratuar edhe ndryshime të Ligjit për përdorim të flamujve.

Me qëllim të promovimit të marrëdhënieve ndëretnike në përpunje me marrëveshjen kornizë, janë ndarë 11.000.000,00 denarë për aktivitete programore të shoqatave dhe fondacioneve.

Janë ndërmarrë angazhime për promovim dhe implementim të Strategjisë për arsim të integruar. Sekretariati për zbatimin e marrëveshjes kornizë ka formuar grup punues që do të shqyrtojë Strategjinë për arsim të integruar dhe do të tejkalohen mospajtimet rreth grupit të dytë tematik.

Ka vazhduar të zbatohet Projekti për përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike që implementohet në Kumanovë, Kërçovë dhe Strugë. Është formuar forum ndërmjet njësive të vetadministrimit lokal dhe biznes komunitetit të tre komunave, janë zbatuar trajnime për ligjet që i tangojnë bashkësitë më të vogla etnike, janë zbatuar trajnime për përmirësimin e koordinimit dhe komunikimit ndërmjet pushtetit qendror, njësive të vetadministrimit lokal, sektorit civil dhe mediave.

Në periudhën e kaluar kanë vazhduar përpjekjet në fushën e inkluzionit të romëve. Republika e Maqedonisë ka ndërmarrë kryesimin me Dekadën e inkluzionit të romëve. Është mbajtur edhe takim pune në temën Inkluzion i romëve dhe romëve refugjatë, në bashkëpunim ndërmjet përfaqësuesve të Komisionit Evropian, institucioneve relevante nacionale, bashkësisë ndërkombëtare dhe organizatave lokale joqeveritare. Konkluzionet operative nga i njëjti janë shndërruar në plan përkatës aksional për përmirësimin e inkluzionit të romëve dhe romëve refugjatë. Pas miratimit të planit nga ana e Qeverisë implementimi i të njëjtit në mënyrë të rregullt do të mbikëqyret. Në Buxhetin për vitin 2012 janë siguruar mjete për implementim të Dekadës së Romëve në shumë të përgjithshme prej 45.990.000,00 denarë. Për kryesimin me Dekadën në anën tjetër, janë siguruar 1.800.000,00 denarë.

Në suazat e aktiviteteve që zbatohen për punësim, është përpiluar Plani Operativ për programe aktive dhe masa për punësim 2012-2013. Në të gjitha programet dhe masat e parapara për punësim nga Plani operativ për 2012-2013 si target grup janë përfshirë romët. Përfshirja e romëve në programet dhe masat nga Plani aksional do të realizohen në bashkëpunim me APRM dhe QIR.

Në pjesën e arsimimit të romëve, vazhdon implementimi i Projektit "Inkluzion të fëmijëve-romë në kopshtet fëmijërore" në vitin shkollor 2011-2012. Janë paraparë aktivitete për përmirësimin

e kapaciteteve të prindërve-romë, fëmijët e të cilëve janë inkuadruar në projektin, përmirësim të shkathtësive sociale dhe gjuhësore të fëmijëve-romë si dhe inkuadrim të pushteteve lokale në përmirësimin e integritit të fëmijëve-romë. Vazhdoi implementimi i Projektit për dhënien e bursave dhe mentorim të nxënësve romë nga viti i parë deri në vitin e katërt të arsimit të mesëm. Në vitin shkollor 2011/12 është siguruar mbështetje financiare e 600 nxënësve.

Në pjesën e shëndetësisë, filloi implementimi i programit për ndërmjetësues shëndetësorë romë. Aktivitetet në periudhën e ardhshme do të drejtohen në ndërtimin e kapaciteteve të 16 ndërmjetësuesve shëndetësorë romë në 8 komuna.

Në pjesën e infrastrukturës, do të vazhdojë implementimi i Memorandumeve të nënshkuara me njësitë e vetadministrimit lokal.

Për momentin funksionojnë 9 Qendra Informative Rome, ndërkaq në periudhën vijuese do të hapet edhe një QIR shtesë në Shkup. Do të botohet material promovues për bashkësinë romë në lidhje me funksionimin dhe rolin e zyrave juridike mobile. Do të vazhdohet me trajnimet për ndërtim të kapacitetet e të punësuarve në QIR.

Në suazat e IPA 2008 "Përkrahje e implementimit të Strategjisë së romëve", në drejtim të përforsimit të strukturave koordinuese operative romë në nivel nacional dhe lokal për implementimin e Strategjisë së romëve, do të vazhdojë zbatimi i trajnimeve për ndërtim të kapaciteteve të palëve relevante¹⁸, përforsim të dialogut me shoqërinë civile dhe promovim të prioriteteve të Strategjisë së Romëve si pjesë e politikave nacionale dhe sektoriale. Përveç kësaj, planet ekzistuese aksionale lokale, do të revidohen dhe do të sigurohet mbështetje financiare për implementim të prioriteteve të tyre.

Në suazat e kryesimit të Republikës së Maqedonisë me Dekadën e Romëve 2005-2015, është paraparë mbajtje e konferencës rajonale për problemin e personave pa dokumente si follow-up në lidhje me rekomandimet e pranuar nga konferenca e realizuar "Mundësimi i qasjes së Romëve në dokumentet për dokumentacion personal - sfidë rajonale", realizuar më qershor 2010.

Filloi aksioni për identifikimin e personave të cilët nuk janë të evidentuar në librat amë. Në fazën e parë të zgjidhjes së këtij problemi, fokusi do të vendoset në personat të cilët aspak nuk janë në evidencë, derisa në fazë të dytë do të përfshihen personat që nuk kanë dokumente personale, shtetësi të rregulluar ose janë me status të shtetasve të huaj.

1.3. ÇËSHTJE RAJONALE DHE OBLIGIME NDËRKOMBËTARE

Republika e Maqedonisë, në suazat e politikës së saj proaktive për zhvillim të marrëdhënieve ndëretnike dhe bashkëpunim rajonal, do të vazhdojë me angazhim të përforsuar në drejtim të avancimit të mëtejme dhe pasurim të bashkëpunimit si në plan bilateral ashtu edhe në kontekst të iniciativave rajonale.

Në bashkëpunimin, theks do të vihet në:

- Avancim të bashkëpunimit politik në të gjitha nivelet, duke përfshirë edhe nivelin e ekspertëve, në funksion të proceseve të integritimeve evropiane, ndërkaq veçanërisht të çështjeve të interesit më të gjerë rajonal, si janë: Bashkëpunimi ndërkufitar, transporti dhe energjetika, mbrojtja dhe avancimi i mjedisit jetësor, lufta kundër krimit të organizuar, lufta kundër korrupsionit, bashkëpunimi policor dhe doganor, trafikimi joligjor me njerëz, imigracioni ilegal dhe riadmissioni, menaxhimi me kufijtë dhe mbrojtja shëndetësore.

- Promovim të bashkëpunimit në suazat e Procesit për stabilizim dhe asociim me Bashkimin Evropian, nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve përkatëse bilaterale me shtetet të cilat kanë lidhur Marrëveshje për stabilizim dhe asociim me Bashkimin Evropian.

- Implementim të prioriteteve në suazate Procesit për bashkëpunim me Evropën Juglindore (PBEJL), Këshilli për bashkëpunim rajonal (KBR), Iniciativa e Evropës Qendrore (IEQ) dhe SECI/SELEC-qendra në Bukuresht.

- Vazhdim të aktiviteteve në suazat e CEFTA – Marrëveshje e Evropës Qendrore për tregti të lirë (Central European Free Trade Agreement), pjesëmarrje në aktivitetet dhe ngjarjet në suazat e Bashkësisë Energjetike për Evropën Juglindore dhe intensifikim të aktiviteteve për përmbushjen e obligimeve nga Marrëveshja për themelim të bashkësisë energjetike, Marrëveshja për hapësirë ajërore unike evropiane (ESAA), si dhe pjesëmarrje në negociatat për Bashkësi Transportuese.

- Përforsim të bashkëpunimit në suazat e projekteve trilaterale (kufitare).

- Republika e Maqedonisë vazhdon të jetë aktor aktiv dhe konstruktiv në plan rajonal, duke dhënë kontribut thelbësor për thellimin e mëtutjeshëm të marrëdhënieve të mira fqinjësore, bashkëpunimin rajonal dhe përforsim të sigurisë rajonale. Maqedonia kryeson/udhëheq me disa projekte/qendra rajonale – MARRI (Migration, Asylum, Refugees Regional Initiative), RACVIAC

(Center for Security Cooperation), Rrjeti shëndetësor i steteve nga EJL (NALAS), Grupi përhershëm punues për zhvillim rajonal rural (SWG), ndërkaq me përfaqësuesit e vet merr pjesë edhe në Këshillin për bashkëpunim rajonal dhe SEKI. Më vitin 2011, Maqedonia ishte kryesuese e Forumit Evropian për reduktimin e rreziqeve nga katastrofat (European Forum for Disaster Risk Reduction - EFDRR).

Republika e Maqedonisë ka shprehur interes për anëtarësim në Iniciativën e Adriatikut-Jonit, më prill 2011 gjatë kryesimit të Malit të Zi me të njëjtin. Në periudhën prej qershor 2012 deri më 2013, Republika e Maqedonisë do ta marrë kryesimin me PBEJL, ndërkaq rrjedhimisht është pjesë e Treshit Menaxhues të PBEJL.

Në marrëdhëniet ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe **Republikës së Shqipërisë**, në këtë periudhë vëmendje e veçantë i kushtohet projekteve infrastrukturore, lidhjes rrugore dhe hekurudhore, Korridori 8, lidhja energjetike, bashkëpunimi intensiv dhe konstruktiv në suazat e iniciativave rajonale dhe institucioneve ndërkombëtare dhe organizatave, veçanërisht në fushën e proceseve eurointegruese. Ministri i punëve të jashtme i Republikës së Maqedonisë dhe zëvendës kryeministri dhe ministri i punëve të jashtme i Republikës së Shqipërisë, më 14 dhjetor 2011 në Tiranë kanë nënshkruar Marrëveshje për ndryshime dhe plotësime të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Këshillit të ministrave të Republikës së Shqipërisë për udhëtime të ndërsjella të qytetarëve, nënshkruar më 2008, me çka do të mundësohet qytetarët e dy shteteve të hyjnë, dalin, kalojnë dhe në afat të mesëm të qëndrojnë deri në tre muaj në çdo periudhë gjashtëmujore, llogaritur nga dita e hyrjes së parë, me letërnjoftimet e vlefshme biometrike.

Mbahet trendi pozitiv i zhvillimit të marrëdhënieve bilaterale me **Republikën e Kosovës**. Republika e Maqedonisë në mënyrë të rregullt e riafirmon gatishmërinë të transferojë përvojat e veta nga procesi eurointegruer. Prioritet i ndërsjellë është avancimi i bashkëpunimit ekonomik, veçanërisht në fushën e energjetikës, infrastrukturës dhe transportit.

Pritet hapje e kalimit të ri rajonal kufitar Bellanoc-Stançiq, zgjerimi i rrjetit të infrastrukturës (autostrada Shkup-Prishtinë), lidhje energjetike (largpërçues Shkup-Prishtinë) dhe modernizim të kalimeve kufitare Bllacë dhe Jazhincë. Bashkëpunimi ndërmjet dy shteteve është pasuruar me nënshkrimin e marrëveshjeve të shumta nga fushat e interesit për dy shtetet.

Në marrëdhëniet bilaterale ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe **Republikës së Serbisë** shënohet hapja e kalimit të ri kufitar, ndërkaq është nënshkruar edhe marrëveshje për kalimin e kufirit me letërnjoftime biometrike. Republika e Maqedonisë ka nisur lidhje të marrëveshjes për bashkëpunim me Serbinë në kontekst të procesit të aderimit në BE.

Sa i përket bashkëpunimit bilateral ekonomik është paraparë edhe nisja me punë e Zyrës së Dhomës Ekonomike e Republikës së Serbisë në Republikën e Maqedonisë.

Republika e Maqedonisë ka përcaktim të fuqishëm për zhvillim të marrëdhënieve ndërfqinjësore dhe bashkëpunim bilateral me **Republikën e Greqisë** mbi parimet e besimit dhe respektimit të ndërsjellë. Republika e Maqedonisë është e interesuar për intensifikimin e kontakteve politike dhe dialogut me Republikën e Greqisë, me qëllim të gjendet zgjidhje e ndërsjellë e pranueshme për kontestin e imponuar nga Greqia, nën patronazhin e KB-së.

Në vitin 2011 Republika e Maqedonisë dhe **Republika e Bullgarisë** kanë nënshkruar Memorandum për bashkëpunim në integrimet evropiane dhe euroatlantike, është hapur Qendër e përbashkët për bashkëpunim policor dhe doganor, ka hyrë në fuqi Marrëveshja ndërmjet dy shteteve për bashkëpunim ekonomik, ndërkaq nga fillimi i vitit 2011, tregtia me produkte industriale ndërmjet dy shteteve është liberalizuar tërësisht.

Të dyja shtetet demonstrojnë gatishmërinë e tyre për aktivitete konkrete në fushën e projekteve ekonomike, infrastrukturore dhe energjetike me domethënie për të dyja shtetet dhe rajonin.

Në lidhje me marrëdhëniet bilaterale me **Malin e Zi** shënohet nënshkrim i Marrëveshjes për bashkëpunim në kontekst të procesit të aderimit në BE ndërmjet qeverive të dyja shteteve.

Vitin e ardhshëm pritet nënshkrim i marrëveshjes ndërmjet qeverive për kalimin e kufirit me letërnjoftime biometrike. Intensifikimi i marrëdhënieve bilaterale dhe bashkëpunim ndërmjet dy shteteve do të vazhdojë edhe në periudhën e ardhshme, veçanërisht në plan ekonomik me organizim të biznes forumeve si dhe performim të përbashkët në lidhje me çështje të interesit vital rajonal.

Marrëdhëniet ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe **Bosnjë dhe Hercegovinës** i karakterizon mbajtja e rregullt e takimeve dhe kontakteve në të gjitha nivelet, ndërkaq janë intensifikuar konsultimet bilaterale në nivel të ekspertëve.

Në periudhën e ardhshme pas konstituimit të Këshillit të ministrave të Bosnjë dhe Hercegovinës, pritet thellim i marrëdhënieve dhe bashkëpunimit dhe ndërmarrjes së aktiviteteve të parapara, veçanërisht në plan të nënshkrimit të marrëveshjeve/kontratave të harmonizuara, si dhe organizim të biznes forumit.

Marrëdhëniet bilaterale me **Republikën e Kroacisë** në vazhdueshmëri vlerësohen si shumë të mira. Të dyja palët mbajnë dialog të rregullt dhe këmbëjnë përvoja në lidhje me arritjet në zbatimin e reformave, për shkak të plotësimit të kriterëve për anëtarësim. Mbahen takime të rregullta bilaterale në nivel politik, shtetëror, parlamentar, ekonomik dhe kulturor.

Maqedonia përshëndet finalizimin e suksesshëm të negociatave për anëtarësim me të drejta të plotë të Kroacisë në BE dhe ka interes për kontinuitet të mëtutjeshëm në komunikimin dhe ndarjen e përvojave të Kroacisë nga procesi i negociatave dhe aderues. Në periudhën e ardhshme pritet intensifikim edhe në marrëdhëniet ekonomiko-tregtare.

Marrëdhëniet me **Republikën e Turqisë** janë në nivel të lartë dhe ato i karakterizon frymë e miqësisë, si dhe përcaktim i fuqishëm për mirëkuptim të ndërsjellë, shkallë e lartë e besimit dhe mungesa e çështjeve të hapura apo të kontestueshme, si dhe bashkëpunim i suksesshëm në të gjitha fushat e interesit të përbashkët. Cilësia e marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve në më shumë segmente arrin shkallë të partneritetit strategjik.

Në periudhën e ardhshme dy shtetet do të vazhdojnë me konsultime të rregullta bilaterale dhe këmbim të përvojave, ndër të tjerat, në lidhje me çështjet e procesit të integritit në BE. Theksi do të fokusohet edhe në bashkëpunim ekonomik. Në vitin 2012, ndër të tjerat, pritet hapje e Qendrave Kulturoro-informative të Republikës së Maqedonisë në Stamboll dhe të Republikës së Turqisë në Shkup.

OBLIGIME NDËRKOMBËTARE

Republika e Maqedonisë ka vazhduar edhe më tej tërësisht të bashkëpunojë me **Tribunalin Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavinë**. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë më 19 korrik 2011 miratoi interpretim autentik të nenit 1 të Ligjit për amnisti. Aplikohet për të gjithë kryerësit e veprave penale të lidhura me konfliktin në vitin 2011, me përfundim më datën 26 shtator 2001, përveç për personat të cilët kanë kryer vepra penale të lidhura dhe në lidhje me konfliktin në vitin 2001, ndërkaq kundër të cilave Tribunali Ndërkombëtar prë përmjekjen e personave përgjegjës për shkelje të rëndë të së drejtës ndërkombëtare humanitare në territorin e ish Jugosllavisë nga vitin 1991, ka ngritur procedurë. Me këtë janë mbyllur katër lëndët e kthyera nga Tribunali.

Gjatë lidhjes së marrëveshjes bilaterale me SHBA-në për marrjen e civilëve amerikanë nga jurisprudenca e Gjykatës Ndërkombëtare Penale, Republika e Maqedonisë ka marrë parasysh udhëzimet e BE-së nga muaji shtator 2002. Marrëveshja është lidhur në bazë joreciproke, përkatësisht ka të bëjë me vetëm shtetas të SHBA-ve dhe nuk ndikon në obligimet të cilat Maqedonia i ka ndërmarr me ratifikimin e Statutit të Romës. Marrëveshja nuk përjashton mundësinë që kryerësve eventual të veprave penale t'u gjykohet në Maqedoni ose ato të dorëzohen në SHBA në procedurë të mëtejshme. Në pajtim me udhëzimet e BE-së, me Marrëveshjen parashihet mundësi për ndërprerjen e saj, me kërkesë të njëjës prej palëve nënshkruese.

II KRITERET EKONOMIKE

2.1. EKZISTIMI I EKONOMISË FUNKSIONALE TREGTARE

Stabiliteti makroekonomik

Ruajtja e stabilitetit makroekonomik dhe vendosja e rritjes ekonomike të bazave të qëndrueshme të shëndosha, si dhe mbajtja e politikës së koordinuar fiskale dhe monetare, mbeten imperativ edhe në periudhën e ardhshme afatmesme.

Politika makroekonomike në periudhën e ardhshme afatmesme do të përqendrohet në përmirësimin e mëtutjeshëm të ambientit afarist, politikës tatimore dhe doganore të investimeve të drejtpërdrejta të huaja dhe stimulim të aktivitetit investues, si dhe zhvillim të kapitalit njerëzor dhe infrastrukturën ekonomike të shtetit.

Me politikën makroekonomike në periudhën 2012-2014 sigurohen kushte për aktivitet të rritur ekonomik nëpërmjet politikës së qëndrueshme fiskale, e cila në koordinim me politikën monetare do të kontribuojë për arritjen e qëndrueshmërisë së pozitës eksterne të shtetit dhe sigurim të nivelit të inflacionit që do ta mbështesë aktivitetin ekonomik në shtet. Politika

makroekonomike në periudhën e ardhshme do të paraqet garanci për rritje të qëndrueshme ekonomike në Republikën e Maqedonisë nëpërmjet nivelit të qëndrueshëm të borxhit publik dhe nivel të matur të deficitit buxhetor, në kombinim me kursin stabil devizor.

Politika monetare

Politika monetare edhe në vitin 2012 do të fokusohet në ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, si komponent përbërës të stabilitetit makroekonomik, nëpërmjet ruajtjes së kursit stabil devizor të denarit në raport me euron. Si kontinuitet i vitit 2011, edhe 2012 do të shoqërohet me pasiguri të madhe në lidhje me lëvizjet globale dhe problemet aktuale në euro-zonën. Në këtë kontekst, sfidat themelore të politikës monetare në vitin 2012 janë të lidhura me pasigurinë në lidhje me krizën e borxhit në euro-zonën dhe ndikimin e vet mbi rritjen e BE-së, si partneri jonë më i rëndësishëm tregtar, si dhe ndikimi mbi rritjen ekonomike, lëvizjet në tregun devizor dhe ndikimet potenciale eksterne mbi inflacion. Rrjedhimisht, politikat makroekonomike edhe në vitin 2012 do të jenë të fokusuar në përcjelljen e rregullt të lëvizjeve në ekonominë vendase dhe rrethinën ndërkombëtare dhe sipas nevojës do të ndërmerren masa në drejtim të mirëmbajtjes së stabilitetit makroekonomik.

Inflacioni

Në vitin 2012 pritet ngadalësim i konsiderueshëm i rritjes së çmimeve, gjatë shkallës së projektuar të inflacionit prej rreth 2%. Projektimi për vitin 2012 është bazuar mbi presupozimin për reduktimin e çmimit të naftës dhe të ushqimit, si dhe të relativisht inflacionit më të ulët të huaj. Këto presupozime janë në pajtim me lëvizjet e pritura të ekonomisë globale. Në mënyrë plotësuese, projektimi i inflacionit për vitin 2012 përfshin edhe rritje të çmimit të energjisë elektrike dhe ngrohjes në fillim të vitit. Në kontekst të shkallës më të ulët të inflacionit krahasuar me vitin e kaluar, duhet të merret parasysh edhe baza e lartë krahasuese, veçanërisht nga gjysma e parë e vitit 2011. Në vitin 2012 nuk priten presione nga ana e kërkesës vendase, përkatësisht dinamika e inflacionit do të kushtëzohet kryesisht nga faktorët nga ana e ofertës. Politika monetare, sikur edhe deri tani, do të jetë e orientuar në mirëmbajtjen e stabilitetit e kursit devizor, si udhëheqës nominal që është në funksion të mirëmbajtjes së stabilitetit të çmimeve.

Rreziqet për projektimet e inflacionit për vitin 2012 janë kryesisht në drejtim teposhtë dhe kanë të bëjnë me problemet aktuale financiare në euro-zonën, që imponojnë pasiguri në aspekt të trajektorisë së ardhshme të çmimeve botërore dhe efektit të tyre bartës mbi çmimet vendore. Njëkohësisht, realizim eventual i rreziqeve negative për rritjen ekonomike të ekonomisë vendore do të kishte shkaktuar presion shtesë në drejtim teposhtë mbi çmimet.

Në dy vitet e ardhshme, 2013-2014, pritet inflacioni të jetë relativisht i ulët dhe stabil, me ç'rast do të kishte lëvizur rreth 2%. Në afat të mesëm, lëvizja e inflacionit do të jetë nën ndikim të lëvizjes së çmimeve botërore të produkteve bazike, por edhe të dinamikës së aktivitetit ekonomik në ekonominë vendore.

Aktiviteti ekonomik

Faktorët e jashtëm në vitin 2012 pritet të kenë kontribut më të matur mbi rritjen ekonomike. Në këto bazë, rritja ekonomike në Republikën e Maqedonisë për vitin 2012 pritet të jetë rreth 4,5%. Rritja e BPV-së pritet të nxitet nga kërkesa vendore. Bruto investimet pritet të realizojnë shkallën më të lartë të rritjes, të projektuar në nivel prej 8,5%, me ç'rast politika fiskale nëpërmjet rritjes së planifikuar të shpenzimeve kapitale pritet në mënyrë të konsiderueshme të kontribuojë në rritjen e investimeve në ekonomi. Në këto suaza, janë planifikuar investime në infrastrukturën rrugore dhe hekurudhor, që e lidh shtetin me partnerët kryesor tregtar, investimet në pjesën e energjertikës në drejtim të rritjes së prodhimit vendas të energjisë dhe lidhjes më të mirë të rrjetit me shtetet fqinjë, investime në infrastrukturën komunale, përmirësim të kushteve në sistemin arsimor dhe shëndetësor, si dhe investime në kulturë dhe qendrat sociale.

Konsumi përfundimtar gjithashtu pritet të japë kontribut pozitiv drejt rritjes ekonomike, me ç'rast projektimi i rritjes së konsumit personal gjatë vitit 2012 është rreth 4%, ndërsa rritja e konsumit publik është projektuar në nivel prej 1,4%. Në lidhje me shkëmbimin e jashtëm tregtar pritet ngadalësim i butë i rritjes pozitive. Në bazë reale, projektimi i rritjes së eksportit të mallrave dhe shërbimeve është 7,7% ndërsa importi pritet të rritet për 7% gjatë vitit 2012.

Vitet e kaluara të periudhës së analizuar, megjithatë, pritet përsheptimi i rritjes ekonomike globale dhe forcimi gradual i besimit të investuesve, që do të rezultojë me intensifikimin e këmbimeve të jashtme tregtare dhe financiare në shtet.

Kështu, gjatë periudhës 2013-2014 pritet intensifikim i caktuar i BPV, në 5% gjatë vitit 2013 dhe 5,5% gjatë vitit 2014. Gjatë kësaj periudhe, gjithashtu edhe gjatë vitit 2012, pritet rritja ekonomike të lëvizë nga kërkesa vendase. Rritja reale e bruto investimeve është projektuar në nivel rreth 10%. Rritja e konsumit privat gjatë kësaj periudhe pritet të jetë stabile, projektuar në 4,2% gjatë vitit 2013 dhe 4,5% gjatë vitit 2014. Projektimet e tilla bazohen në lëvizjet e pritura të tregut të punës, tendenca e pritur e rritjes së roqave, projektimet e rritjes së kreditimit të popullsisë, si dhe pritjet e rritjes së matur të transferimeve private nga vendet e huaja. Rritja e konsumit publik pritet të jetë i matur, duke lëvizur ndërmjet 1,8% dhe 2,5%. Në lidhje me këmbimin e jashtëm tregtar, në pajtim me supozimet për tendencat ekonomike globale, si dhe aktiviteti i investimeve të pritura në zonat industriale zhvillimore teknologjike, pritet dinamizëm i butë i rritjes së këmbimit të jashtëm tregtar. Në afat më të gjatë pritet përmirësim i caktuar i eksportit, ndërsa në afat më të shkurtë përmirësimi i strukturës së importit, duke pasur parasysh atë se realizimi i këtyre investimeve supozon edhe import më të madh të të mirave industriale. Shkalla reale e rritjes të eksportit gjatë vitit 2013 pritet të jetë 9,5%, ndërsa importi pritet të ketë rritje me shkallë prej 8,5%. Gjatë vitit 2014 projektimet e rritjes të eksportit dhe importit janë 9% dhe 8,1% në mënyrë përkatese.

Tregu i punës

Rritja ekonomike e paraparë gjatë periudhës 2012 - 2014 pritet të ketë ndikim pozitiv mbi lëvizjen e tregut të punës. Sipas projekteve pritet rritja mesatare vjetore e numrit të të punësuarve të jetë ndërmjet 3% dhe 3,5%. Kjo megjithatë, do të rezultojë me reduktimin e numrit të të papunësuarve për rreth 2,5% mesatarisht për periudhën e analizuar. Zmadhimi i punësimeve pritet edhe nga rritja e forcës së punës, projektuar në 1% dhe 1,6% për periudhën e analizuar. Lëvizjet e tilla implikojnë shkallë të punësimit gjatë vitit 2014 të rritet në 42,5% ndërsa shkalla e papunësisë të reduktohet në rreth 27%. Popullsia aktive gjatë vitit 2014 pritet të arrijë 58,3% të popullsisë së aftë për punë. Në periudhën e analizuar rritja reale e roqës mesatare bruto pritet të lëvizë ndërmjet 1,5% dhe 4% ndërsa rritja reale e neto roqës mesatare pritet të jetë më e lartë, si rezultat i reduktimeve të planifikuara në shkallë të kontributeve sociale dhe rritjes graduale të liritimit tatimor. Në bazë të kësaj, rritja reale e neto roqës mesatare gjatë vitit 2012 është projektuar në nivel prej rreth 2%, ndërsa gjatë vitit 2014 shkalla e rritjes pritet të jetë 4,5%.

Sektori i jashtëm

Pas thellimit të deficitit të llogarisë rrjedhëse gjatë vitit 2011, në dy vitet e ardhshme pritet stabilizim i tij. Gjegjësisht, gjatë vitit 2012, deficitit i llogarisë rrjedhëse pritet të jetë në nivelin e vitit 2011 (4,8% të BPV). Komponentët themelorë të llogarisë rrjedhëse, pritet të shënojnë lëvizje divergjente. Gjegjësisht, pritet ngushtimi gradual i deficitit tregtar, përkundër tendencës së ngadalësimit të vogël të pjesëmarrjes së neto të hyrave në bazë të transferove private në BPV. Ngushtimi i deficitit tregtar bazohet në rritjen më të shpejtë të pritur të eksportit në raport me rritjen e importit. Në suazat e deficitit tregtar, pritet deficit tregtar i energjisë stabile, në pajtim me tendencën e ulët të kostos së naftës dhe nivelit të ulët të kostos së energjisë elektrike. Ngushtimi i projektuar i deficitit tregtar pritet të rezultojë nga përmirësimi i saldo jo - energjike, ku bartës kryesor pritet të jetë përmirësimi i saldosit tregtar në këmbimin e produkteve kimike dhe në këmbimin e ushqimit. Në lidhje me dinamikën e pritur të ngadalësuar të transferimeve private, duhet të theksohet se paraqet normalizimin e tyre gradual, me përjashtim të nivelit të arritur gjatë vitit 2010. Kompozimet tjera të llogarisë rrjedhëse, kategoritë shërbime dhe të ardhura, gjatë vitit 2012 pritet të mbahen në nivel relativisht stabil.

Gjatë periudhës 2013 - 2014, deficitit i llogarisë rrjedhëse pritet të shënojë uljen e mëtejme graduale edhe në vitin 2014 të jetë diçka nën 4% të BPV. Kjo ulje e deficitit pritet të rezultojë nga përmirësimi i mëtejme i saldosit tregtar, me ç'rast në vitin 2014 kjo do të jetë 20% të BPV dhe do të jetë më e ulët për përafërsisht 3 pikë të përqindjes së BPV në raport me vitin 2011. Ulja e tillë e deficitit tregtar është në pajtim me dinamizmin e pritur të aktivitetit ekonomik, duke pasur parasysh kontributin e kapaciteteve të reja bazuar në kapital të huaj. Njëkohësisht pritet përshtatja e mëtejme e uljes së transferimeve private, me çka gjatë vitit 2014 ato do të jenë 16,7% të BPV për çka rreth 1 përqindje e poenëve në raport me vitin 2011. Te kategoria e të hyrave pritet rritje e deficitit, që kryesisht rezulton nga shpenzimet e pritura më të larta në bazë të të ardhurave të investimeve të huaja të drejtpërdrejta, ndërsa saldoja të shërbimeve pritet edhe më tutje të jetë në nivel pozitiv dhe stabil.

Projektimi i saldosit të llogarisë rrjedhëse të bilancit pagesor për periudhën 2012 - 2014 shoqërohet me rreziqe. Gjegjësisht, lëvizjet e ekonomisë globale paraqesin faktor të rëndësishëm të rrezikut për lëvizjet në bilancin pagesor të ekonomisë maqedonase në afat të mesëm, në veçanti

në kushte të pa sigurisë së zmadhuar në përgjithësi. Nga ana tjetër, është fakt se rritja graduale e numrit të kapaciteteve eksportuese në ekonomi, që në afat të mesëm duhet të rezultojë me diversifikimin e eksportit, përmirësimi i performancave të eksportit, si dhe përforsimi i fleksibilitetit të ekonomisë në lidhje me shokun e jashtëm.

Neto të hyrat në llogarinë fiskale kapitale gjatë vitit 2012 pritet të jetë afër 8% të BPV që është e ngjashme me përqindjen e nivelit për vitin 2011. Komponentë kryesorë të , të hyrave kapitale pritet të jenë të ardhura në bazë të investimeve të huaja të drejtpërdrejta dhe ngarkimin me borxh të shtetit në vendet e huaja në pajtim me deficitin buxhetor të projektuar për vitin 2012 dhe konstruksionin financiar për financimin e tij. Neto të ardhurat të llogarisë kapitale - fiskale për periudhën 2013 - 2014 pritet të jenë relativisht stabil, gjatë çka mesatarisht do të jetë rreth 7,2% të BPV. Stabilizimi gradual i veprimeve financiare globale, reduktimi i pasigurisë dhe përmirësimi i perceptimeve të investitorëve të huaj, janë faktorët të cilët do të veprojnë në drejtim të rritjes së rrjedhojave private financiare. Në mënyrë konsekuente, investimet e huaja të drejtpërdrejta pritet gradualisht të rriten, duke u afruar në nivel karakteristik për vitet e performancave më të mira të këtij aspekti. Dinamika e tillë paraqet rritje të matur të investimeve të huaja të drejtpërdrejta deri në vitin 2014 për rreth 2 përqindje të ponëve të BPV, krahasuar me vitin 2011. Me rimëkëmbjen e ekonomisë vendase pritet edhe niveli përkatës i ngarkimit me borxh të sektorit privat, me çka sektori privat gjatë periudhës 2012 - 2014 të shënojë rritje të matur.

Në pajtim me lëvizjet e projektuara të llogarisë rrjedhëse dhe financiare, bruto rezervat revizore për periudhën 2012 - 2014 pritet të shënojë rritje të vazhdueshme dhe të mbahet në nivel prej rreth katër muaj mbulim të importit të mallrave dhe shërbimeve të secilit vit të ardhshëm. Niveli i tillë i rezervave revizore është në funksion të mbështetjes së strategjisë për targetimin e kursit të devizave.

Projektimi i të ardhurave kapitale në periudhën e ardhshme tre vjeçare lidhet me pasiguri të madhe duke pasur parasysh kushtëzimin e lartë të lëvizjeve dhe sentimentin e tregjeve globale financiare, në periudhë jashtëzakonisht të ndjeshme pas tronditjeve më të mëdha financiare.

Financat publike

Qëllimet e politikës fiskale do të ngelin të orientuara kah rruajtja e stabilitetit makroekonomik dhe mbështetjes së ekonomisë maqedonase përmes përmirësimit të cilësisë së financave publike, para së gjithash përmes rritjes së vëllimit të investimeve kapitale, duke mbajtur llogari për pozitën e jashtme tregtare dhe rruajtjen e kursit stabil të denarit. Gjatë kësaj, shkalla e deficitit buxhetor do të jetë e matur për ekonominë, në suazat e kriterit të Mastrikut.

Të ardhurat e projektuara për buxhetin qeveritar të konsoliduar gjatë periudhës së ardhshme tre vjeçare shënojnë rënie relative si pjesëmarrje në BPV, edhe atë prej 34,7% të BPV gjatë vitit 2011 në 32,6% gjatë vitit 2014. Si rezultat i kontinuitetit gjatë zbatimit të politikës buxhetore të disiplinuar dhe konsolidimit të përforsuar të shpenzimit publik, shpenzimet e përgjithshme gjatë periudhës 2011 - 14, gjithashtu, do të realizojnë ulje prej 37,2% gjatë vitit 2011 në 34,8% gjatë vitit 2014.

Ana e shpenzimeve të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë për periudhën 2012- 2014 është dizajnuar në funksion të mbështetjes së rimëkëmbjes së ekonomisë maqedonase, kalimin e pasojave të periudhës në krizë dhe rritja e investimeve në projekte infrastrukturore. Kështu, është planifikuar përmirësimi i strukturës së shpenzimeve me pjesëmarrje të rritur në shpenzimet kapitale prej 13,1% gjatë vitit 2011 në 16,5% 2014, për llogari të reduktimit të shpenzimeve rrjedhëse prej 86,9% - 2011 në 83,5% - 2014, respektivisht për 3,4 p.p. Ndryshimi pozitiv në strukturën e shpenzimeve publike është e nevojshme për shkak të realizimit të shkallëve të parapara për rritje ekonomike dhe korrespondon me përcaktimin për vazhdimin e konsumit buxhetor restriktiv në pjesën e shpenzimeve jo produktive dhe të ardhurave nga investimet për financimin e projekteve kapitale, si nga burime vendase, ashtu edhe të huaja (IPA dhe mjete kreditore).

Në pajtim me projektimet e të hyrave dhe shpenzimeve të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë në periudhën e ardhshme afatmesme është planifikuar deficieti të realizohet në nivel prej 2,5- 2,2% të BPV.

Duke pasur parasysh nivelin e matur të borxhit publik dhe shtetëror, gjatë periudhës 2012 deri 2014 ekziston hapësirë për rritje të matur të aktivitetit investues përmes përdorimit të mbështetjes kreditore gjatë kësaj pa u cenuar mbajtja afatgjate e nivelit të ngarkimit të shtetit me borxh.

Në këtë drejtim gjatë vitit 2012 - 2014 projektohet rritje e borxhit shtetëror, si rezultat i investimeve të reja në sferën e infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore, ujësjellës dhe kanalizim,

objekte sportive, ndërtim të banesave sociale, si dhe investime në sferën e arsimit, të cilat do të implementohen nga ana e organeve të administratës shtetërore.

2) Veprimi i lirë reciprok i forcave tregtare (privatizimi)

Aktivitetet ekonomike në Republikën e Maqedonisë bazohen në pronësi dominuese private me funksionimin e plotë të ekonomisë së tregut në bazë të parimeve të veprimeve të lira të ndërsjella të ofertës dhe kërkesës.

Procesi i mëtejme i privatizimit përfshin ristrukturimin e sektorit publik (Hekurudhat maqedonase, Ndërmarrja shtetërore për ekonomizim me hapësira banesore dhe afariste, NP Makedonija pat, Posta e Maqedonisë etj.), me përcaktimin e mundësisë për shitjen e mëtejme të pjesëve të ndara prej tyre, përfshirë edhe shitjen e disa nga veprimtarive, si dhe shitje të aksioneve të shtetit ose të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor.

Në suazat e procedurës për privatizim të katër kompanive të mëdha: EMO SHA Ohër, OHIS SHA Shkup, Kombinati i duhanit SHA Prilep dhe Eurokompozit SHA Prilep, gjatë vitit 2010 janë realizuar shpallje publike për shitjen e aksioneve të shtetit dhe të Fondit për SPI, të cilat përfunduan pa sukses. Shpallja e re publike për grumbullimin e ofertave për shitjen e 65,15% të kapitalit të shoqërisë EMO SHA Ohër, përfundoi në korrik 2011 pa ofertë.

Në vijim është hartimi i ligjit të ri i cili do të rregullojë privatizimin e kapitalit shtetëror.

3) Mosekzistimi i barrierave për hyrje dhe dalje nga tregu

Një nga prioritetet strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë është përmirësimi i biznes-klimës në bazë të vazhdueshme në Republikën e Maqedonisë. Për këtë qëllim përmes revidimit sistemor dhe të vazhdueshëm të rregullativës aktuale në Republikën e Maqedonisë do të thjeshtësohen dhe eliminohen formalitetet joesenciale dhe pengesat administrative të cilat e ngarkojnë punën e përditshme dhe veprimin e bizneseve dhe qytetarëve me çka do të mundësohet përmirësimi i rregullativës ligjore, rritja e kapaciteteve të trupave rregullator të cilat mbikëqyrin tregun dhe do të vendoset dialog i rregullt me biznes bashkësinë.

Republika e Maqedonisë gjatë vitit 2012 do të hyjë si shteti i gjashtë në botë në bazë të indikatorit hapje biznesi dhe shteti i parë në Evropë. Në drejtim të zbatimit të rekomandimeve të World Bank, Doing business. Gjatë vitit 2011 u lëshuan në përdorim sistemi elektronik për regjistrimin e shoqërive tregtare përfshirë edhe integrimin operativ dhe funksional të bazave të të dhënave të Agjencisë për punësim, fondin e sigurimit pensional dhe invalidor dhe Fondin e sigurimit shëndetësor, në sistem njësportel. Sistemi elektronik për përdorimin e procedurave falimentuese, Regjistri elektronik i personave të cilët nuk mund të themelojnë dhe të menaxhojnë dhe persona të cilët janë të penguar ose kanë pushuar të kryejnë funksionet themelore në organin e menaxhimit të shoqërisë tregtare, Sistem elektronik për paraqitje dhe regjistrim në regjistrin e depozitave dhe Sistemi elektronik për paraqitje dhe regjistrim në regjistrin për lizing.

Gjatë vitit 2011 u miratua Strategjia kombëtare për standarde elektronike në këmbim të të dhënave të natyrës financiare dhe afariste. Implementimi i saj do të kryhet nga viti 2012 me projektin Metabaza qëllimi i së cilës është deri në fund të vitit 2014 të gjitha të dhënat të cilat në pajtim me dispozitat për punën afariste të shoqërive tregtare, me karakter financiar dhe biznesi, të mund të sinkronizohen dhe të tregohen me HBRL format dhe secili investues (vendas ose i huaj) në mënyrë përkatëse do të mund të analizojë dhe marrë vendimet në lidhje me suksesin financiar të shoqërisë. Njëkohësisht kjo do të paraqesë interoperabilitet ndërmjet regjistrave të Regjistrit qendror, Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë, Bursës Maqedonase, Sistemit interbankar të Kliringut, Komisionit për letra me vlerë. Strategjia parasheh Regjistri qendror të jetë bartës i të a.q. XBRL juridikcionit në Republikën e Maqedonisë si pjesë e rjetit botëror për përdorimin dhe lidhjen me përdorimin e XBRL. Varësisht nga progresi i projektit dhe tempos së realizimit të IPA TAIB 1, është paraparë mbështetje për implementimin e Strategjisë për XBRL në suazat e IPA 2012 Zhvillim i sektorit privat.

Reforma rregullatore

Kompetenca për përcjelljen dhe koordinimin e procesit të projekteve të cilat kanë të bëjnë me Reformën rregullatore e merr përsipër Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

Gijotina rregullatore

Projekti Gijotina rregullatore në vazhdimësi zbatohet në më tepër faza në drejtim të uljes së procedurave burokratike për biznes sektorin dhe qytetarët. Në vijim është implementimi me sukses i masave të fazës së dytë dhe të tretë të Gijotinës rregullatore, me të cilat është arritur mënjanimi i numrit të madh të barrierave administrative, si dhe thjeshtësimi i numrit të madh të procedurave për lëshimin e miratimeve dhe lejeve për bërjen e biznesit.

Si vazhdim i këtij projekti, e në drejtim të avancimit plotësues së veprimit afarist dhe thjeshtësimit të procedurave për bërjen e biznesit përmes dialogut të vazhdueshëm me biznes komunitetin, Qeveria e Republikës së Maqedonisë filloi projekt të ri - "Gijotina rregullatore për thjeshtësimin e dispozitave dhe reduktimin e shpenzimeve të zejtarëve", qëllimi i të cilave do të jetë reduktimi i ngarkesës administrative të zejtarëve. Në fillim të vitit 2012 planifikohen konsultime të reja dhe fillimi i fazës së katërt të Gijotinës rregullatore - "Përparësi për të vegjlit", ku fokusi vendoset mbi thjeshtësimin e kushteve për punë të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Vlerësimi i ndikimit të rregullativës

Obligimi ligjor për të gjitha ministritë për zbatimin e Vlerësimit të ndikimit të shkallëve të rregullativës, hyri në fuqi më datë 01.01.2009, për të gjitha propozim - ligjet (përveç për ligjet të cilat miratohen me procedurë urgjente).

Si mbështetje teknike e RIA procesit, është formuar Regjistri unik elektronik i rregullave (ENER) i cili u mundëson palëve të interesuara në mënyrë elektronike të japin komente dhe propozime drejtpërdrejt deri te institucionet kompetente. Deri në fund të Nëntorit 2011, në Regjistrin unik elektronik të rregullave janë futur 1744 dispozita aktuale, prej të cilave 451 janë propozim-ligje të cilat kanë qenë të qasshme për komente dhe të cilat kanë kaluar procesin RIA.

Në drejtim të ndërtimit të vazhdueshëm të kapacitetit administrativ për zbatimin e RIA procesit dhe avancimin e tij, gjatë vitit 2011 me sukses u zbatua projekti i quajtur si " Rregulativa më e mirë për biznes në Maqedonis" në suazat e së cilës zbatohen më tepër analiza për implementimin e reformave rregullatore në Republikën e Maqedonisë dhe janë miratuar disa dokumente të rëndësishme: Doracak për zbatimin e mirë të konsultimeve dedikuar për biznes komunitetin dhe administratën publike, Kodeks për konsultime me publikun gjatë kohës së përgatitjes së rregullativës, Udhëzim për mënyrën e veprimit gjatë punës së ministrive për kyçjen e palëve të prekura në procedurë për hartimin e ligjeve, si dhe Rekomandime dhe Plan veprim për përmirësimin e reformës rregullatore në Maqedoni. Me qëllim implementimin e tyre gjatë vitit 2012 do të zbatohen aktivitetet në vijim:

- formimi i Trupit qendror për rregullativë më të mirë dhe ndërtimi i kapaciteteve të saj;
- përmirësimi i kornizës juridike për vlerësimin e ndikimit të rregullativave,
- zgjerimi i përfshirjes së Vlerësimit të ndikimit të rregullativës, mbështetje gjatë zbatimit të saj në Parlament dhe gjatë bërjes së ex-post analizës,
- ndërtimi i vazhdueshëm i kapaciteteve të ministrive dhe Trupit qendror për teknika dhe metoda për përmirësimin e hartimit të ligjeve.

Dalja nga tregu

Në suazat e aktiviteve të Ministrisë së Ekonomisë, gjatë vitit 2011 dukshëm u përforcua kapaciteti institucional dhe transparenca gjatë zhvillimit të procedurave falimentuese në Republikën e Maqedonisë, përmes përmirësimit të programeve për trajnim dhe kalimin e provimit për drejtues të falimentimit, zgjerimi i dialogut për të gjithë aktorët e kyçur në procedurën falimentuese, përforcimin kadrovik të Odës së drejtuesve falimentues dhe ndihmës teknike për trajnim të trajnuesve për të drejtën e falimentimit dhe procedura për falimentim.

Njëkohësisht Ministria e Ekonomisë në vazhdimësi zbaton program për edukim dhe trajnim të kandidatëve për drejtues të falimentimit si dhe bën monitorimin e punës së tyre përmes Odës së drejtuesve falimentues.

Gjatë vitit 2011 është vendosur sistem elektronik për përcjelljen e procedurave të falimentimit, me çka u mundësua përcjellja e procedurave të falimentimit në të gjitha fazat e saj me çka do të japë raporte javore dhe mujore për prolongimin eventual dhe vonesën e fazave individuale dhe detektimin e lehtë të vonesës te personat përgjegjës në procedurë.

Gjatë vitit 2012 është paraparë të bëhen ndryshime të Ligjit për falimentim në drejtim të ankandit elektronik të pronës në falimentim dhe ndarjes elektronike të lëndës falimentuese si dhe

obligimi ligjor për drejtues falimentues për azhurnim elektronik të procedurave falimentuese përmes sistemit për e- falimentim.

Në suazat e projektit IPA 2011 ndihmë teknike për implementimin e legjislacionit për falimentim janë paraparë mjete prej 1.000.000 euro për ndihmë teknike gjatë përfundimit të kapaciteteve të Ministrisë së Ekonomisë, gjyqësorit dhe drejtuesve falimentues për marrjen më të shpejtë dhe më efikase të veprimeve në procedurë falimentuese të cilat do të realizohen gjatë vitit 2013.

4) Sistemi juridik përkatës (rregullimi i të drejtave pronësore, zbatimi i ligjeve dhe marrëveshjeve, dhe efikasiteti i sistemit gjyqësor në lidhje me çështjet ekonomike)

Rregullimi i të drejtave pronësore

Procesi i instalimit të Kadastrës së patundshmërive në gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë vazhdoi edhe gjatë vitit 2011 dhe në pajtim me planin aksional të Agjencisë për kadastrë të patundshmërive përqindja e kadastrës së instaluar të patundshmërive është 99,87%.

Agjencia e kadastrës së patundshmërive, gjatë vitit 2011 i realizoi aktivitetet si vijon:

Instalim i sistemi të ri për regjistrimin e patundshmërive - E- kadastrë në njësitë rajonale të Kavadarit, Negotinës, Kratovës, Kriva Pallankës, Shën Nikollës, Probishtipit, Resnjës, Strugës, Kumanovës, Dibrës, Kërçovës, Gjevgjelisë, Vallandovës, Manastirit dhe Prilepit. (Roll - out e e - kadastrës)

Inspektim në statusin e lëndëve në njësitë rajonale të Shkupit dhe Kavadarit, Negotinës, Kratovës, Kriva Pallankës, Shën Nikollës, Probishtipit, Resnjës, Strugës, Kumanovës, Dibrës, Kërçovës, Gjevgjelisë, Vallandovës, Manastirit dhe Prilepit.

Sportele elektronike për shfrytëzues personal (E - sportele) në njësitë ku është implementuar E-kadastra.

Këqyrje papagesë në përmbajtjen e listës pronësore pa hipoteka, për të gjithë qytetarët përmes ueb faqes së AKP.

AKP - portali me 2D dhe 3D ueb servis (ueb servis për këqyrje në Planin digjital të kadastrës me analizë të ortofoto dhe ueb servis për këqyrje në hartat topografike të RM-së dhe incizime ortografike)

Përpunimi i Hartës digjitale topografike të R. së Maqedonisë (përmasa 1:25000)

Lëshimi i aktzotërimit për cilindo qytet ku është në zbatim E-kadastra, pavarësisht nga vendi i paraqitjes së kërkesës, për momentin është e qasshme për të gjitha qytetet ku është në përdorim e-kadastra , ndërsa deri në qershor të 2012 për gjithë shtetin

Projekt i hartuar për instalimin e rrjetit nivelmatik;

Dizajnimi i modelit të të dhënave dhe standardeve për të dhëna gjeo-hapësinore

Aktivite të planifikuara afatshkurtra

Gjatë vitit 2012 AKP vazhdon me implementimin e aktiviteve në vijim:

Sportel elektronik për shfrytëzues profesionistë (E-sportele) për gjithë shtetin deri më qershor 2012.

Këqyrje në statusin e lëndëve për gjithë shtetin, Q2 2012.

Roll-out i sistemit të ri për regjistrimin e E-kadastrës në njësitë tjera të KN Q2 2012.

Njoftimi i qytetarëve për statusin e lëndëve përmes sms dhe e-mail , Q3 2012.

MAKPOS i lëshuar në përdorim komercial - Q1 2012.

Strategji të hartuar për INDHH (Infrastrukturë Nacionale të të Dhënave Hapësinore)- Q2 2012.

Lëshimi i aktzotërimeve përmes internetit - Dyqan elektronik -Q4 2012

Përsosja e aplikimeve për këqyrje në aktzotërim dhe kërkimi i adresave me analizë të të dhënave nga lista G- Q2 2012.

Harmonizimi i të dhënave dhe përsosja e sistemit E-kadastrë me analizë grafike të patundshmërive - Q4 2012

Rishpërndarja e lëndëve për zgjidhjen e tyre në njësitë e PL me implementimin e E-kadastrës, Q1 2013.

Instalimi i Help desk qendrës, Q1 2012.

Instalimi i servisit për përdorimin e të dhënave grafike nga ana e NJVL Q2 2013.

E-banka Q1 2013

Digjitalizimi i origjinaleve të arkivave - Q4 2013,

Regjistër i instaluar për njësi hapësinore Q3 2012,

E-komerc (internet) fillim Q2 2014,

Aktivite të planifikuara afatmesme

Në suazat e aktivitetit të AKP për avancimin e punës së Agjencisë në periudhën e ardhshme afatmesme janë planifikuar më tepër aktivitete.

rrjeti i instaluar nivelmanik dhe gravimetrik në territorin e RM-së -Q4 2013;

Hartimi i WEBGIS (Ueb Sistem informativ gjeografik) të AKN sipas INSPIRE direktivës - Q4 2-13.

Instalimi i INDHH (Infrastrukturë Nacionale të të Dhënave Hapësinore) të paktën dy ministri të lidhura - Q4 2013.

Integrimi i ERP sistemit për menaxhim dhe planifikim me resurset e AKN) - Q4 2013.

Digjitalizimi i planeve të kadastrës për gjithë territorin e R.M-së Q4 2013.

Biznes kontinuitet/ Disaster recovery Q3 2013

Përsosja e aplikimeve WEB GIS me përmbajtje të re me 3D -Q1 2014.

Instalimi i arkivit digjital Q1 2014,

POS virtual shërbime, Q4 2013.

Instalimi i tregtisë elektronike, - E- commerce Q2 2014.

Hartimi i hartave topografike digjitale në përmasa 1:50.000 dhe përmasa tjera më të vogla 2015.

Përshtatja e Sistemeve referuese gjeodezike shtetërore me Standardet evropiane 2015.

Zbatimi i ligjeve dhe marrëveshjeve

Për përforcimin e mëtejshëm të pasigurisë, paanshmërisë, profesionalizimit dhe transparencës së gjyqësorit, gjatë vitit 2011 janë ndërmarrë aktivitete për realizimin e zgjidhjeve të reja ligjore nga viti 2010, në pjesën e zgjedhjes së gjykatësve, kontrollimi dhe vlerësimi i punës së gjykatësve sipas kriterëve të reja, vendosja e kushteve të reja dhe ripërkufizimi i procedurave për përcaktimin e ushtrimit të funksionit gjykatës në mënyrë jo profesionale, vendosja e sistemit të karrierës në avancimin e gjykatësve, rritja e transparencës gjatë punës së tyre, përmirësimi i financimit të gjykatave përmes përcaktimit të përqindjes fikse në shumë prej 0,8% të BPV, si dhe siguri i të drejtës të garantuar me kushtetutë, për ankesë në konteste administrative.

Për shkak të rritjes së efikasitetit të gjyqësorit, filluan me zbatimin e Ligjit për menaxhim me lëndët gjyqësore, ndryshime të Ligjit për procedurë kontestimore, si dhe ndryshime dhe plotësime të Ligjit për përmbarrim.

Për implementimin e Ligjit për menaxhim me lëndë gjyqësore, me të cilin sigurohet zbatimi i plotë dhe efikas i AKMIS softuerit dhe rregullohet mënyra dhe afatet për shpalljen e vendimeve gjyqësore më 04.04.2011, është miratuar Doracaku për shpallje dhe kërkim të vendimeve gjyqësore në ueb faqen e gjykatave. UEB- faqet e gjykatave janë funksionale dhe qytetarët mund të marrin informata për punën e tyre dhe vendimet, të cilat në pajtim me ligj, gjykatat patjetër i publikojnë në afat prej 2 dite. Gjithashtu, palët mund të paraqesin kërkesë për marrjen e ekzemplarëve nga vendimi gjyqësor i cili në afat prej 24 orë pa kompensim i dorëzohet personit në mënyrë elektronike.

Në drejtim të rritjes së efikasitetit të gjykatave dhe formimin e biznes klimës të volitshme nga 09.09.2011 filloi të zbatohet Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurë kontestimore, me të cilin reduktohet kohëzgjatja e procedurës, instalohet dërgimi elektronik dhe incizimi tonik në seanca gjyqësore, instalohet mediacioni si mënyrë alternative e zgjidhjes së kontesteve.

Gjithashtu, me qëllim gjykatat të shkarkohen nga lëndët, në pajtim me Ligjin për përmbarrim 01.07.2011 filloi procedura për transferimin e rreth 402.272 lëndëve të kryera nga gjykatat te noterët dhe përmbarruesit.

Me këto aktivitete reformuese lëndët e pakontestueshme si lëndët e trashëgimisë, urdhëresat pagesore të lëshuara në bazë të vërtetshmërisë së tyre, lëndë të përmbarruara të cilat ndodhen te gjykatat dhe pagesa e detyrueshme e gjobave me para në procedura penale dhe kundërvajtëse, janë marrë nga kompetencat e gjykatave dhe janë transferuar në kompetencë të noterëve, përmbarruesve dhe Drejtorisë së të Hyrave Publike.

Për afirmimin e mediacionit si mënyrë alternative të zgjidhjes së kontesteve, në mars të vitit 2011 është miratuar Plan aksional me masat për promovimin e procedurës, të strukturuar në tre pjesë: Pjesa normative, Zbatimi i trajnimeve dhe Promovimi i procedurës për mediacion. Gjithashtu me ndryshimet e Ligjit për procedurë penale, Ligjin për kundërvajtje, Ligjin për drejtat e të miturve, Ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve, janë paraparë dispozita për informimin e palëve për mediacion.

PRIORITETE AFATSHKURTRA

Për rritje të mëtejme të efikasitetit dhe transparencës së gjyqësorit, gjatë vitit 2012, do të vazhdohet me aktivitete për realizimin e risive në kornizën juridike për sigurimin e qasjes më të shpejtë dhe më të lehtë të qytetarëve në drejtësi.

Gjatë vitit 2012 do të hartohet Raport për zbatimin e Ligjit për përmbarim në lidhje me transparencën e lëndëve të përfunduara dhe do të vazhdohet me emërimin e përmbaruesve për vendet e lira.

Në drejtim të përmirësimit të implementimit të mediacionit në lëndët tregtare dhe civile, gjatë vitit 2012 do të realizohet MATRA Projekti për mbështetjen e avancimit të zbatimit të tij në RM.

SEKTORI FINANCIAR I ZHVILLUAR MJAFTUESHËM

Sistemi financiar në RM karakterizohet me strukturë relativisht të thjeshtë, nga aspekti i llojit të institucioneve financiare dhe asortimentit të produkteve dhe shërbimeve të cilat i ofrojnë.

Në suazat e arkitekturës financiare, bankat kanë rolin kryesor, me çka në masë më të madhe i kushtëzojnë lëvizjet në sistemin financiar.

Sektori bankar

Gjendjet në sektorin bankar

Sistemi bankar në RM përbëhet nga 17 banka dhe 8 kursimore. Bankat kanë pozitë dominante me pjesëmarrje prej mbi 98% në aktivitetin total të sistemit bankar. Nga aspekti i pronësisë, 13 banka janë në pronë dominuese të huaj, 8 prej tyre janë filiale të bankave të huaja. Bankat në pronësi zakonisht të aksionarëve të huaj dominojnë në treg (me pjesëmarrje 90% në aktivin e përgjithshme, kredi, depozita, kapital dhe të ardhura). Pjesa më e madhe (rreth 80%) e kapitalit të huaj në sistemin bankar të RM-së buron nga shtetet anëtare të BE-së. Bankat në pronë të shtetit marrin pjesë me mbi 3% në aktivin e përgjithshëm të sistemit bankar.

Aktivitetet e bankave vazhduan të rriten. Më 30.09.2011 aktiva e përgjithshme ishte 321,2 miliardë denarë, shkalla e saj vjetore e rritjes 11,6% (12% shtator 2011). Depozitat e subjekteve jo financiare janë shtytësi kryesor i rritjes së aktivës. Më 30.09.2011 ajo ka qenë 225,9 miliardë denarë dhe realizuan rritje vjetore prej 11,7% (9,8% në shtator 2011). Preferencat për kursim në valutë vendase vazhduan edhe gjatë 2011. Nga aspekti i strukturës sektoriale, depozitat e popullsisë ende janë dominante në depozitat e përgjithshme. Kreditë e aprovuara të subjekteve jo financiare janë kategoria dominuese në aktivën e sistemit bankar. Ato më 30.09.2011 ishin 199,3 miliardë denarë. Shkalla e tyre vjetore përfshirë shtatorin 2011 ishte 8,3% (7,9% në shtator 2011).

Indikatorët për cilësinë e portofolit kreditor të bankave shënuan përmirësim të dukshëm krahasuar me shtatorin e 2010. Pjesëmarrja e kredive jo funksionale në kreditë e përgjithshme janë ulur në 9,8% nga 10,6% më 30.09.2010. Rreziku mesatar i portofolit kreditor të bankave, për periudhën prej një vjet janë ulur për 0.2 p.p dhe më 30.09.2011 ishte 6,6%. Kreditë jo funksionale janë mbuluar plotësisht me korigjim të ndarë të vlerës (101,9% më 30.09.2011).

Likuiditeti i sistemit bankar është stabile dhe në nivel relativisht të lartë. Për periudhën prej një vjet likuiditeti i mjeteve të bankave u rrit për 18,9% dhe në fund të shtatorit 2011 ishte 93,3 miliardë denarë. Pjesëmarrja e likuiditeteve mjeteve të përgjithshme të bankave ka qenë 29,9% dhe ato mundësojnë mbulimin e depozitave të ekonomive familjare prej 58,8%.

Rreziku valutor dhe rreziku nga ndryshimi i shkallëve të interesit në portofolin e aktiviteteve bankare janë më pak të rëndësishme në portofolin e përgjithshëm të bankave dhe lëvizin në suazat e kufijve të përcaktuar.

Bankat në vazhdimësi mbajnë solvencë të lartë dhe stabile. Gjatë gjithë periudhës së krizës dhe pas krizës nuk u paraqit nevoja për likuiditet dhe mbështetje financiare nga shteti për bankat. Shkalla adekuate e kapitalit në fund të shtatorit 2011 ka qenë 16,7%. Shkalla "Tier 1" ka qenë 14%. Rezultatet e stres - testimit, zbatuar nga Banka popullore tregojnë rezistencë të kënaqshme të sistemit bankar dhe bankave të caktuara ndaj shock-eve të ndryshme.

Në fund të shtatorit 2011, sistemi bankar tregon fitim në shumë prej 257 milion denarë. Kthimi i aktivës dhe kthimi i kapitalit është 0,1% dhe 1% në mënyrë përkatëse (në fund të shtatorit 2010: 0,5% dhe 4%).

Prioritete në fushën e sistemit bankar

Prioritete themelore në sektorin bankar edhe më tutje do të mbesin ruajtja e stabilitetit të sistemit bankar, rritja e intermediacionit financiar, qasje e lehtë deri te kreditë dhe harmonizimi i mëtejme i kornizës juridike me legjislacionin e BE-së në pjesën e veprimtarisë bankare dhe supervizionit bankar.

Në vazhdimësi do të përcillen ndryshimet konkurrencte në nivel ndërkombëtar dhe evropian të BE-së, në veçanti në pjesën e cila ka të bëjë me masat për përmirësimin e gjendjeve të bankat dhe formimi i të a.q. bridge bank. Menjëherë pas miratimit të direktivave përkatëse, Republika e Maqedonisë do t'i qaset transponimit të tyre përkatës.

Theks i veçantë do t'i vihet bashkëpunimit të institucioneve të Republikës së Maqedonisë me trupat përkatës të supervizionit në Bashkimin Evropian dhe shtetet anëtare.

Gjatë vitit 2012 do të sigurohet parakushtet kadrovike dhe teknike të nevojshme për hartimin dhe zbatimin e rregullativës për aderimin e mëtejme nga Bazeli 2. Hartimi i kësaj rregullative do të zhvillohet gjatë vitit 2013.

Përgatitjet për zbatimin e Bazeli 3, përmes përcaktimit të të dhënave të nevojshme për përlogaritjen e indikatorëve për likuiditet dhe solvencë, filluan gjatë gjysmës së dytë të vitit 2011 dhe do të vazhdojnë edhe vitin e ardhshëm.

Tregu i sigurimit

Gjendjet në tregun e sigurimit

Tregun e sigurimeve në Republikën e Maqedonisë e përbëjnë 15 shoqëri të sigurimit, 16 shoqëri brokere të sigurimit dhe 5 shoqëri për përfaqësimin e sigurimit. Katër shoqëri të sigurimit kryejnë punët e sigurimit të jetës, 11 tjerat kryejnë punët e sigurimit në grupin e sigurimit jo-jetë.

Në tremujorin e tretë të vitit 2011 shoqëritë e sigurimit në RM kanë realizuar bruto premi në shumë totale prej 5.163 milionë denarë, prej të cilave 306,5 milionë denarë (5,94%) rezultojnë nga sigurimi i jetës, ndërsa 4.856 milionë denarë (94,06%) nga sigurimi jo-jetë. Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, është shënuar rritje e premi e polisuar bruto (në tekstin e mëtejme PPB) të të dyja grupet e sigurimit. Te sigurimi jo-jetësor është shënuar rritje prej 8,61%, ndërsa rritja e premisë për sigurimin e jetës është më e madhe 33,03%. Rritja e bruto premisë në total për të dyja grupet e sigurimit ka qenë 9,81%.

Analizuar sipas klasave të sigurimit, në grupin e sigurimit jo-jetë, rritje më të madhe absolute të bruto premisë gjatë tremujorit të tretë të 2011 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar është shënuar te sigurimi i përgjegjësisë automobilistike, ose 180,7 milion denarë (7,98%), sigurimi i pronës (së bashku për klasat 8 dhe 9) rritja në shumë absolute prej 171,7 milion denarë, ose 20,6% krahasuar me periudhën e njëjtë për 2010, te sigurimi i aviacionit (kasko dhe përgjegjësi), rritja e premisë në shumë absolute prej 86,6 milion denarë ose 221,89%, te sigurimet e mallrave në transport ka rritje të premisë në shumë prej 4,8 milionë denarë ose 9,10%, më pas, rritja e premisë së sigurimit nga humbja financiare në shumë absolute prej 1,2 milionë denarë (76,48%) dhe rritje e premisë të ndihma turistike prej 5,8 milionë denarë, rritje për 5,28%. Nga ana tjetër, ulje drastike, si në shumë absolute ashtu edhe relative është shënuar te sigurimi i përgjegjësisë së përgjithshme (-14,3 milionë denarë ose ulje prej 13,44%), sigurimi nga fatkeqësi-aksident (-31,1 milionë denarë ose rënie prej 6,85%), sigurimi i automjeteve- kasko (-10,2 milionë denarë ose rënie prej 1,73%) dhe sigurim shëndetësor vullnetar (-9,7 milion denarë ose rënie prej -69,24%). Rritja e bruto premive të sigurimi i jetës në shumë absolute është 76 milionë denarë (33,03%), si rezultat i rritjes së premive të polisave të shoqëritë aktuale për sigurimin e jetës si dhe themelimi i dy shoqërive të reja për sigurimin e jetës.

Në tremujorin e tretë të vitit 2011 shoqëritë e sigurimit kanë paguar bruto dëme dhe shuma të siguruar, në total për jo-jetë dhe jetë, në shumë prej 2.115 milionë denarë, respektivisht shënohet rritje prej 6,38% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Shoqëritë për sigurim jo-jetë në tremujorin e tretë të vitit 2011 kanë paguar bruto dëme në shumë prej 2.062 milionë denarë, respektivisht për 115 milionë denarë më tepër se vitin e kaluar periudhën e njëjtë. Nga ana tjetër shoqëritë e sigurimit të jetës në tremujorin e tretë të vitit 2011 kanë paguar bruto dëme në shumë prej 52,8 milionë denarë, respektivisht për 11,7 milionë denarë më tepër se vitin e kaluar periudhën e njëjtë (rritje për 28,43%).

Prioritete në sferën e tregut të sigurimeve

Prioritete kryesore në sektorin e sigurimeve edhe më tej ngelin ruajtja e stabilitetit të sistemit të sigurimeve dhe harmonizimi i mëtejshëm dhe afrimi me direktivat evropiane, në pjesën e sigurimeve.

Deri në fund të vitit 2012 është planifikuar miratimi i Ligjit të ri për sigurim në të cilin do të transponohet direktiva e Be-së 2009/138/KE (Solvency II).

Me qëllim të sigurimit dhe funksionimit efikas dhe ligjor të kontrollit të tregut dhe mbrojtjes së të drejtave të pronarëve dhe shfrytëzuesve të sigurimit, planifikohet vendosja dhe implementimi përkatës i rregullave të supervizionit, standardeve dhe parimeve të harmonizuara me rregullat e Asociacionit Ndërkombëtar për Supervizion të Sigurimit.

Tregu i kapitalit

Gjendjet në tregun e kapitalit

Përfundimisht më 30.09.2011 në Bursën Maqedonase janë gjithsej 32 kompani, me kapitalizim të përgjithshëm të tregut prej 486,82 milionë euro, që paraqet rritje prej rreth 2,05% në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2010.

Përfundimisht më 30.09.2011, kanë punuar gjithsej 4 shoqëri për menaxhim me fondet investuese të cilat menaxhojnë me 8 fonde të hapura investuese. Vlera e përgjithshme e mjeteve të fondeve investuese të hapura gjatë kësaj periudhe ka qenë 4,14 milionë euro që paraqet rritje prej 77.39% në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2010.

Themelimi i fondeve të reja investuese gjatë periudhës janar - shtator 2011 në RM, si dhe rritja e mjeteve me të cilat menaxhojnë fondet investuese aktuale është me rëndësi të madhe për lëvizjen e mëtejme dhe zhvillimin dinamik të tregut të kapitalit në RM.

Gjatë periudhës janar - shtator 2011 kanë punuar gjithsej 8 shoqëri për menaxhim me fonde private të cilat kanë menaxhuar 13 fonde private me vlerë të përgjithshme prej 13.22 milionë euro. Gjatë periudhës janar - shtator 2011, janë lëshuar 9 pëlqime për lëshimin e letrave me vlerë, me vlerë të përgjithshme prej 42.6 milionë euro.

Gjatë periudhës së njëjtë, qarkullimi i përgjithshëm i realizuar në Bursën Maqedonase, ka qenë rreth 121,01 milionë euro që krahasuar me periudhën e njëjtë gjatë 2010 paraqet rritje prej rreth 61.32%.

Lëvizja e Bursës Maqedonase periudhën e fundit tregon stabilizim të gjendjeve në treg. Rezultat i stabilizimit të lidhjeve të bursave është rritja e qarkullimit, me ç'rast u rrit edhe likuiditeti. Vlera e indeksit të bursës maqedonase MBI-10 më 30.09.2011 ishte 2.164,01 p.i, që paraqet rritje për 79.97 p.i në raport me 30 .09.2010. Më 30.09.2011 shoqëritë me posedim publik - MBID ka qenë 2305,50 p.i., ndërsa indeksi i flet obligacioneve - OMB ka qenë 118,76 p.i.

Pjesëmarrja e investuesve të huaj në qarkullimin e realizuar gjatë blerjes në Bursën Maqedonase në shtator të 2011 ka qenë 16,29% ndërsa pjesëmarrja e tyre në qarkullimin e realizuar gjatë shitjes së Bursës Maqedonase ka qenë 19,19%. Në drejtim të rritjes së likuiditetit të tregut të letrave me vlerë dhe tërheqja e investimeve të huaja, Komisioni në bashkëpunim me pjesëmarrësit tjerë në tregun e letrave me vlerë do të marrë aktivitete me qëllim të gjitha transaksionet të cilat lidhen në tregun sekondar të mund të barazohen në kohë reale, respektivisht T+0.

Prioritete në sferën e tregut të kapitalit

Në drejtim të harmonizimit të plotë të legjislacionit vendor me pakon UCITS 4 parashihen ndryshime në Ligjin për fonde investuese për vendosje të: fondeve ushqyes (feeder funds) dhe fondeve- pronarë (master funds), të pasaportës evropiane, procedura për bashkime tejkufitare dhe vendore dhe do të sigurohet informimi më i madh i investuesve përmes instalimit të dokumentit si shtesë të prospektit themelor të fondit.

Me qëllim përkufizimin e saktë të instrumentit financiar në të cilat investojnë fondet investuese, gjatë vitit 2012 do të implementohet Direktiva 2007/16/EK.

Komisioni deri në fund të vitit 2012 do të hartojë Strategji për zhvillimin e tregut të kapitalit me të cilën do të parashihet marrja e aktiviteteve për nxitjen e lëshimit të instrumenteve të reja financiare për tregti në tregun sekondar (obligacione kooperative, derivate, vërtetime për letra të huaja me vlerë) me qëllim që t'u mundësohet shoqërive tregtare të paraqiten në bursë dhe të shfrytëzojnë të njëjtën si burim plotësues për financim përmes emisionit të aksioneve.

Komisioni për letra me vlerë (KLV) do të vazhdojë bashkëpunimin me rregullatorët tjerë të rajonit për mbështetjen e aktiviteteve për integrimin e tregjeve për letra me vlerë në rajon përmes themelimit të platformës së përbashkët për tregti, barazim-pranim i rregullave të përbashkëta për transparencë dhe rregulla të përbashkëta për kuotim.

2.2. AFTËSIA PËR PËRBALLJE ME PRESIONIN E KONKURENCËS DHE FORCAT E TREGUT NË SUAZA TË BE-së

1) Sasia e mjaftueshme e kapitalit njerëzor

Reformat e vazhdueshme në drejtim të modernizimit të sistemit arsimor në pajtim me nevojat ekonomike dhe përmirësimi i cilësisë së arsimit janë një nga prioritetet kryesore strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për vitin 2012.

Reformat të cilat zbatohen në sektorin arsimor kryesisht drejtohen kah sigurimi i shkathtësive për punë dhe kualifikime të kapitalit njerëzor në pajtim me nevojat e tregut të punës, lidhja e institucioneve arsimore me partner social, sigurimi i përfshirjes më të madhe dhe cilësi e arsimit, si dhe promovimi i konceptit për mësim gjatë gjithë jetës.

Aktivitetet e parashikuara për vitin 2012 në sektorin e arsimit janë në drejtim të implementimit të mëtejme të reformave të filluara. Në këtë drejtim është parashikuar avancimi i rregullativës ligjore edhe atë përmes:

- Miratimi i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veprimtari shkencore - hulumtuese;
- Miratimit të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për arsim të lartë;
- Miratimit të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për arsim të mesëm;
- Miratimit të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për arsim fillor;
- Miratimit të Ligjit për arsim të mesëm;
- Miratimit të Ligjit për standardin e nxënësve;
- Miratimit të Ligjit për standardin e studentëve;

Në suazat e procesit të decentralizimit, do të vazhdojë përforcimi i institucioneve përmes zhvillimit të mëtejme të rrjetit të shkollave fillore dhe të mesme dhe studimeve të disperzuara për arsim të lartë. Do të ndërmerren aktivitete për përforcimin e vazhdueshëm të kapaciteteve përmes trajnimit të të punësuarve në institucionet relevante për sektorin e arsimit.

Gjatë vitit 2012 do të formohet Këshilli për zhvillimin dhe financimin e arsimit të lartë.

Reformat do të vazhdojnë edhe në drejtim të lidhjes së procesit arsimor me nevojat e ekonomisë nëpërmjet reformave të arsimit të mesëm profesional, arsimit të lartë dhe promovimit të konceptit për mësim gjatë gjithë jetës. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet arsimit sipërmarrës në të gjitha nivelet e sistemit. Me qëllim të mundësimin përsosjes profesionale në sferën e biznes menaxhmentit, bëhen përgatitje për hapjen e Akademisë për menaxherë.

Do të realizohet projekti për pengimin e derdhjes së kadrove (Stop Brain Drain), me qëllim të qëndrojnë në RM studentë/inxhinierë, teknologë të cilët janë shkolluar në vendet e huaja.

Një nga prioritetet kryesore gjatë periudhës që vijon është edhe përforcimi i bashkëpunimit të institucioneve me partnerët socialë dhe institucionet tjera relevante në nivel institucional dhe ndërkombëtar si dhe rritjen e investimeve publike dhe private në sferën e shkencës dhe zhvillimi i teknologjive të reja. Në këtë sferë sfidë kryesore paraqet realizimi i lidhjes praktike të përvojave të arsimit të lartë, njohurive shkencore dhe teknologjike përmes investimit në parqet teknologjike dhe qendrat inovative, të konceptuara përmes sektorit privat dhe publik. Këto prioritete janë përfshirë në Programin Nacional për veprimtari shkencore hulumtuese të RM-së, që duhet të miratohet gjatë vitit 2012. Do të vazhdojnë përpjekjet për rritjen e efektivitetit të pjesëmarrjes në Programin kornizë FP7 2007-2013, me qëllim përfshirjen e deritanishme në projekt me buxhet total prej 7,4 milionë euro të rritet në rreth 10 milionë euro deri në fund të vitit 2013.

Në pajtim me dispozitën e RM-së për ndërtimin e shoqërisë së bazuar në njohuri, do të vazhdojnë dy projektet e mëdha: "Përkthimi i mbi 1000 librave shkencorë, profesionalë dhe librave shkollorë prej të cilave mësohet në universitetet më të mira dhe më renome në SHBA dhe Angli, ndërsa nga sfera e drejtësisë në Francë dhe Gjermani" dhe "Laboratorë 2010/2020" për sigurimin e 190 laboratorëve për institucionet e larta arsimore.

Me Propozim - Buxhetin për vitin 2012, për decentralizimin e arsimit fillor dhe të mesëm në total janë paraparë 12.341.553.000 denarë prej të cilave:

- 8.420.171.000 denarë bllok dotacione për arsimin fillor;
- 3.918.432.000 denarë bllok dotacione për arsimin e mesëm dhe
- 2.950.000 denarë bllok dotacione me dedikim për arsimin fillor;

Në vitin 2012 në fazën e dytë të decentralizimit do të hyjnë edhe 4 komuna. Në fazën e parë të decentralizimit do të ngelë vetëm komuna rurale Pllasnica.

PROJEKTE KAPITALE NË ARSIM DHE SHKENCË

Për vitin 2012 janë paraparë projekte kapitale në pjesën e arsimit dhe shkencës, si vijojnë:
Projekte të përgjithshme për periudhën 2012- 2014:

1. Program për pajisjen e laboratorëve - do të vazhdojë furnizimi me pajisje për laboratorët e universiteteve shtetërore dhe institucioneve publike shkencore, si dhe investime kapitale në infrastrukturën shkencore - hulumtuese. Nga Buxheti themelor i Republikës së Maqedonisë, për realizimin e Programit do të akordohen mjete në shumë prej: 450.678.000 denarë gjatë vitit 2012, 500.000.000 denarë gjatë vitit 2013 dhe 500.000.000 denarë gjatë vitit 2014.

2. Projekti për përkthimin e librave të autorëve me renome - Do të vazhdojë realizimi i projektit kapital të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë "Përkthimi i 1000 librave profesionalë, shkencorë dhe librave shkollorë prej të cilëve mësojnë në universitetet më të mira dhe më me renome në SHBA dhe Angli, ndërsa nga sfera e të drejtës në Francë dhe Gjermani", i cili do të mbështetet me mjete buxhetore në shumë prej: 190.000.000 denarë 2012 dhe 210.000.000 denarë 2013.

3. Projekti për tranzicion dhe përsosje institucionale-Me këtë projekt mbështetet pjesëmarrja e RM-së në programin e shtatë kornizë (FP7) dhe programin Evropa për qytetarët, nëpërmjet kofinancimit kombëtar të biletave hyrëse për program. Për projektin është planifikuar mbështetje buxhetore në lartësi prej: 50.462.000 denarë 2012 dhe 54.618.000 denarë 2013.

4. *Arsimi fillor*: ndërtimi dhe rikonstruktimi i shkollave fillore dhe ndërtimi i sallave sportive - Me qëllim përmirësimin e infrastrukturës së shkollave fillore nëpërmjet ndërtimit të shkollave të reja dhe rikonstruktimit të atyreve ekzistuese, që do të kontribuojë për zbatimin me sukses të reformave, implementimin e plotë të shkollës nëntë vjeçare dhe realizimin e pa penguar të mësimin, në periudhën e ardhshme afatshkurtër do të akordohen mjete buxhetore në lartësi prej: 147.102.000 denarë gjatë vitit 2012, 138.500.000 denarë gjatë vitit 2013 dhe 145.000.000 denarë gjatë vitit 2014. Në drejtim të formimit të kushteve për realizimin e lëndës sport dhe aktivitete sportive në drejtim të kushtimit vëmendje më të madhe shëndetit të gjeneratave të reja, do të vazhdojë ndërtimi i sallave sportive, me investime financiare prej: 221.739.000 denarë mjete buxhetore dhe hua nga Banka e Këshillit Evropian në lartësi prej 92.097.000 denarë gjatë 2012, 138.500.000 denarë mjete buxhetore dhe 90.000.000 denarë hua gjatë vitit 2013, si dhe 145.000.000 denarë mjete buxhetore dhe 95.000.000 hua gjatë vitit 2014.

5. *Arsimi i mesëm*: ndërtimi dhe rikonstruktimi i shkollave mesme dhe ndërtimi i sallave sportive - Me qëllim të përmirësimit të infrastrukturës së shkollave të mesme nëpërmjet ndërtimit të shkollave të reja dhe rikonstruktimit të atyre ekzistuese, që do të kontribuojë për zbatimin me sukses të reformave në veprimtari në drejtim të plotësisht të kushteve për zhvillimin e arsimit , implementimin e arsimit të mesëm të obligueshëm, në periudhën e ardhshme afatshkurtër do të akordohen mjete buxhetore në lartësi prej: 50.000.000 denarë gjatë vitit 2012, 66.500.000 denarë gjatë vitit 2013 dhe 70.000.000 denarë gjatë vitit 2014. Në drejtim të formimit të kushteve për realizimin e lëndës sport dhe aktivitete sportive në drejtim të kushtimit vëmendje më të madhe shëndetit të gjeneratave të reja, do të vazhdojë ndërtimi i sallave sportive, me investime financiare prej: 39.399.000 denarë mjete buxhetore dhe hua nga Banka e Këshillit të Evropës në lartësi prej 30.523.000 denarë gjatë vitit 2012, 80.000.000 denarë mjete buxhetore, si dhe 91.965.000 denarë hua gjatë vitit 2013.

6. Në suazat e komponentës së IV të IPA programit, si pjesë e Shtyllës prioritare 2 "Arsimi dhe trajnimi - investimi në kapital njerëzor përmes përmirësimit të arsimit dhe shkathtësive", me Programin shumëvjeçar operativ "Zhvillimi i resurseve njerëzore 2007 - 2013" implementohen tre tuining projekte: "Mbështetje e modernizimit të sistemit për arsim profesional dhe trajnim", me shfrytëzues përfundimtar Qendrën për arsimim profesional dhe trajnim, buxhet prej 2.076.471€ dhe periudha e realizimit 2011 - korrik 2013; "Mbështetje e integritit të bashkësive etnike në sistemin arsimor", me shfrytëzues përfundimtar Drejtorinë për avancim dhe zhvillimin e arsimit të pjesëtarëve të bashkësive etnike, buxhet prej 1.085.296€ periudha e realizimit mars 2012 - maj 2013; projekt "Mbështetja e ndërtimit të kapaciteteve të Qendrës për arsimin e të rriturve dhe zhvillimi i programit arsim dhe kompletimi i arsimit fillor të personave të paimvolveduar", me shfrytëzues përfundimtar Qendrën për arsimin e të rriturve, buxhet prej 1.725.655€ dhe periudha e realizimit tetor 2011 - nëntor 2013, Për IPA lokacione 2010 dhe 2011 për komponentën IV, janë hartuar dy Lista për identifikimin e operacioneve: "Përforcimi i mësimit gjatë gjithë jetës përmes modernizimit të sistemit për arsimim profesional dhe sistemit të arsimit për të rritur", me buxhet nga IPA fondet 3.491.601€ dhe pjesëmarrje kombëtare 616.165€, , si dhe "Arritja e arsimit cilësor përmes sigurimit të mjedisit të sigurt për mësim për të gjithë bashkësitë etnike", me grant të drejtpërdrejtë prej 2.112.000€, me ç'rast IPA mjete 1.496.000€, pjesëmarrje kombëtare 264.000€ dhe të UNICEF-it 352.000 €.

Politika e punësimit

Në vitin 2011 politikat e punësimit vazhduan në drejtim të rritjes së pjesëmarrjes në tregun e punës dhe uljen e papunësisë strukturore përmes stimulimit të kërkesave në tregun e punës dhe promovimin e sipërmarrësisë, harmonizimin e ofertës dhe kërkesës së forcës së punës në pajtim me nevojat e tregut të punës, përmirësimin e ofertës së forcës së punës, lehtësimin e procesit për transformimin nga shkolla në punë, si dhe uljen e ekonomisë informale, me pjesëmarrje aktive të partnerëve socialë.

Politikat në këtë fushë u zbatuan përmes:

- Implementimit të programeve aktive dhe masave për punësim (në vazhdim është dhënë pasqyrë e aktiviteteve dhe masave me numër të pjesëmarrësve dhe buxheti për vitin 2011);
- Instalimit të praktikës në arsimin formal në pajtim me nevojat e punëtorëve, përcaktuar në pajtim me Rregulloren për mënyrën dhe kushtet për organizimin e mësimit praktik për studentë ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 120/2010);
- Përmirësimit të kushteve për të punësuarit dhe punëdhënësit nga ana e Agjencisë për punësim në RM;
- Aktiviteteve për përforcimin e vazhdueshëm dhe bashkëpunimit të institucioneve relevante në tregun e punës, si dhe përforcimin e kapaciteteve të partnerëve socialë.
- Hartimit të planit aksional për zhvillim ekonomik lokal për Prilepin, Resnjën dhe Krushevën në agroturizëm dhe industrinë e ushqimit.

Në vitin 2011 u vazhdua me implementimin e masave aktive të tregut të përfshira në "Planin operativ për programe aktive dhe masat për punësim për vitin 2011", Projekti "Mbështetje e punësimit të personave të rinj, të papunësuarve kohë të gjatë dhe femrave" si dhe përmes projektit "Vetëpunësim me kreditim" të cilat fokusohen në nxitje dhe mbështetje të personave të papunësuar para së gjithash personave të rinj, femrave, të rriturve, kategorive vulnerable, si dhe programeve për përmirësimin e shkathtësive të personave të papunësuar në pajtim me nevojat e tregut të punës.

Me "Planin operativ për programe aktive dhe masat për punësim për vitin 2011", përmes programeve të ndryshme dhe masave për punësim është paraparë të përfshihen 7.265 persona të papunësuar për çka janë siguruar rreth 500 milionë denarë. Përfundimisht me tetor 2011 janë përfshirë 4.628 persona të papunësuar.

Me implementimin e projektit për "Vetëpunësim me kreditim" është paraparë të përfshihen 800 persona të papunësuar për çka janë siguruar rreth 115 milionë denarë. Përfundimisht me tetor 2011 janë përfshirë 605 persona të papunësuar.

Për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të programeve aktive dhe masave për punësim:

- Start up incentives janë drejtuar në qëndrueshmërinë e bizneseve, targetimin e drejtë të pjesëmarrësve, hartimin e biznes planeve, trajnimin e sipërmarrësve, si dhe ndihmë të mëtejme gjatë viteve të para të ekzistimit të biznesit përmes inkluzionit plotësues në programin për punësim

plotësuese në ndërmarrjet më të suksesshme. Të njëjtat përpos stimulimit të kërkesës së tregut të punës ndikojnë edhe mbi transformimin e ekonomisë informale në formale dhe stimulimin e sipërmarrësisë.

- Programet për trajnim janë dizajnuar në pajtim me kërkesat e punëdhënësve, në bazë të Analizës për nevoja dhe shkathtësi dhe analiza plotësuese të Qendrave për punësim të cilat ofrojnë informata për nevojat e vitit të ardhshëm përmes parashikimeve afatshkurtra të nevojave të tregut të punës dhe lidhjen e ofertës dhe kërkesës. Gjithashtu edhe gjatë vitit 2011 u vazhdua edhe me qasjen individuale, në pajtim me nevojat e tregut lokal. Në drejtim të përforsimit të kapacitetit dhe konstatimit të mangësive u fillua me zhvillimin e metodologjisë për evaluim të trajnimeve për punë të cilat kërkohen në tregun e punës;

- Te Employment incentives merret parasysh qëndrueshmëria e vendit të punës, si dhe ulen mundësitë për paraqitjen e substitution and displacement effects. Të njëjtat para së gjithash janë të drejtuara në stimulimin e punësimit të personave të cilët shumë vështirë mund të kyçen në tregun e punës. Implementohet edhe Pilot - programi për mobilitet të forcave të punës me qëllim të rritjes së mobilitetit intern.

Sfidat kryesore të reformave në tregun e punës janë përkufizuar në pajtim me Strategjinë Evropa 2020 dhe Iniciativat bartëse relevante për politikën e punësimit për çka u hartua Strategjia nacionale për punësim e Republikës së Maqedonisë deri në vitin 2015. Në Strategjinë është dhënë pasqyrë e gjendjes ekonomike dhe gjendjeve në tregun e punës, janë identifikuar sfidat kryesore, janë përkufizuar prioritetet strategjike dhe synimet të cilat duhet të realizohen deri në vitin 2015, si dhe politikën të cilat duhet të rezultojnë me realizimin e synimeve. Aktivitetet konkrete, institucionet kompetente dhe mjetet financiare janë përkufizuar në Planin aksional nacional për punësim në RM 2011 - 2013 dhe i njëjti është hartuar në pajtim me Udhëzimet e integruara të Evropa 2020 për politikën ekonomike dhe politike për punësim në shtetet anëtare të BE-së të cilat përfshijnë politikën mikroekonomike (udhëzimi 6) dhe udhëzimet për punësim (7,8,9 dhe 10). Në procesin e hartimit të Strategjisë dhe Planit aksional u siguroi TALEX misioni i ekspertëve me qëllim që ekspertët të shteteve të huaja anëtare të BE-së të sigurojnë ndihmë dhe udhëzime për përmirësimin e cilësisë së dokumentit si dhe lidhje me qëllimet e Evropa 2020.

Në shtator 2011 filloi implementimi i Twinning Projektit "Mbështetja e politikave për punësim", kofinancuar përmes IPA Komponentës IV.

Me qëllim që të përforsohen kapacitetet e institucioneve dhe të shihet efikasiteti i programeve për trajnim për punët e kërkua, filloi përgatitja e metodologjisë për vlerësimin e të njëjtave.

Në bazë të kontrollit të rregullt të implementimit të programit aktiv dhe masave për punësim, si dhe synimeve të përcaktuara dhe prioritetëve të cilat duhen realizuar, është hartuar Plani operativ për program aktiv dhe masat për punësim për vitin 2012 - 2013.

Në periudhën e ardhshme afatshkurtër do të vazhdohet realizimi i Twinning Projektit "Mbështetja e politikave për punësim". Synimi kryesor i këtij projekti do të jetë siguri i mbështetjes për vendosjen e sistemit për parashikim afatgjatë në tregun e punës dhe zhvillimi i kapaciteteve në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale dhe të gjitha organet dhe institucionet tjera relevante dhe partnerët socialë për parashikime afatgjata në tregun e punës, si dhe për monitorim, evaluim dhe njoftim për politikën e punësimit. Me implementimin e këtij projekti do të bëhet vlerësimi i kapaciteteve aktuale për planifikim afatgjatë, do të krijohet sistem për planifikim afatgjatë përmes masave përkatëse, teknikave, procedurave, kornizës institucionale. Në lidhje me këtë do të sigurohet trajnimi i personave për planifikim afatgjatë në tregun e punës, do të përforsohet bashkëpunimi ndër institucional dhe koordinimi në lidhje me parashikimet afatgjate në tregun e punës, do të zhvillohet bashkëpunimi me partnerët social në lidhje me planifikimin afatgjatë. Me zhvillimin e sistemit për përcjelljen dhe vlerësimin e politikave për punësim, do të bëhet vlerësimi i politikave, do të identifikohen sfidat, do të formohet sistem i detajuar për përcjelljen dhe vlerësimin e politikave dhe programeve për punësim në pajtim me kërkesat e Strategjisë Evropiane 2020, do të instalohen indikatorë të nevojshëm për plotësimin e obligimeve evropiane dhe inkluzion të plotë të udhëzimeve për punësim.

Do të vazhdohet me implementimin e politikave të cilat janë në drejtim të rritjes së punësimit dhe reduktimit të shkallës së papunësisë. Si prioritet kryesor në pjesën e politikave për punësim në afat të shkurtër, edhe më tej ngel rritja e pjesëmarrjes në tregun e punës dhe ulja e papunësisë strukturore. Përpos kësaj do të vazhdohet me implementimin e politikave aktive për punësim të cilat stimulojnë kërkesë në tregun e punës, harmonizim me ofertën dhe kërkesën e forcës së punës, rritjen e punësimit të personave të papunësuar, përfshirjen e personave me invaliditet dhe kategori

tjera vunerabile në tregun e punës, kontrollime tjera vijuese të implementimit të aktiviteteve të politikave për punësim, evaluimi i rezultateve të arritura nga implementimi i programit dhe masave, si dhe shfrytëzimi i këtyre rezultateve dhe vlerësimeve në ciklin e krijimit të programeve dhe masave për punësim.

Do të bëhet vlerësimi i efekteve të masave për trajnim të punëve deficitare, me çka do të shihen efektet e realizimit të tyre dhe do të jepen udhëzime për efikasitet më të madh.

Në afat të mesëm do të vazhdohet me aktivitete për përforsimin e mëtejshme të kapaciteteve të subjekteve relevante në planifikim, krijim, implementim, monitorim dhe vlerësim, përforsim i bashkëpunimit ndërinstitucional për suksesin e politikave për punësim përmes trajnimeve, seminareve dhe punëtorive, si dhe inkluzioni i partnerëve socialë në procesin e krijimit dhe implementimit të politikave për punësim.

Aktivitetet e planifikuara për rritjen e punësimit do të realizohen në vazhdimësi të përspejtuar me rritjen e mjeteve dhe numrin e personave të përfshirë me program aktiv dhe masa për punësim në pajtim me nevojat e tregut të punës. Politikat do të orientohen në nxitje dhe mbështetje të punësimit të personave të papunësuar të cilët vështirë përputhen në tregun e punës, për shkak të rritjes së mundësisë për punësimin e tyre dhe konkurrencës në tregun e punës, si dhe reduktimin e ekonomisë informale.

2) Sasia e mjaftueshme e kapitalit fizik

Investimet në kapitalin fizik

Politika zhvillimore e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për investim në infrastrukturën publike të shtetit në afat të shkurtër dhe të gjatë bazohet në dinamikën e aktivitetit investues. Aktiviteti pritet të rezultojë me optimizimin e përdorimit të kapaciteteve aktuale, rikonstruktimin dhe modernizimin e infrastrukturës publike në funksion në sigurimit të ekonomisë dhe efikasitetit më të madh, si dhe më herët të përfundojnë projektet ekonomike duke pasur parasysh opsionet e shpenzimit më të vogël.

Në Programin për investime publike në RM 2011- 2013, gjatë përcaktimit të prioritetëve kihën parasysh politikat zhvillimore sektoriale dhe projektet infrastrukturale prioritare të përfshira në Programin për punën e Qeverisë së RM-së, dokumentacioni projektues në dispozicion dhe mundësitë reale për sigurimin e mjeteve për investime kapitale të: (1) Buxheti i shtetit; (2) fondet; (3) mjete personale të investuesve; (4) banka vendase; (5) donacione; (6) kredi të huaja, në pajtim me Strategjinë afatshkurtër për menaxhim me borxhin publik. Vitet e ardhshme pritet edhe përdorimi gradual i mjeteve të fondeve paraaderuese të Bashkimit Evropian.

Programi për investime publike 2011 -2013 përfshin 78 projekte investuese rrjedhëse. Shpenzimet e përgjithshme për këto projekte vlerësohen me shumë prej 2.290.090 eurosh. Pjesë e mjeteve, në shumë prej 503,44 milionë euro, janë realizuar deri në fund të vitit 2010. Realizimi i sasisë së caktuar të aktiviteteve investuese, me shumë prej 291,98 milionë euro, planifikohen pas vitit 2013. Me këtë, gjatë periudhës 2011 - 2013 parashihet se do të realizohen 1 479,49 milionë euro, respektivisht gjatë vitit 2011 543,79 milionë euro. Nga mjetet e përgjithshme të parashikuara me Programin për periudhën 2011 - 2013 për zhvillimin e infrastrukturës ekonomike do të akordohen 648,26 milion euro ose 43,8%, ndërsa për zhvillimin e infrastrukturës joekonomike 831,42 ose 56,2% të mjeteve të përgjithshme.

Investimet në energjetikë

Investime të cilat planifikohen në energjetikë u takojnë katër llojeve në vijim:

1. Prodhimi i energjisë elektrike
2. Lidhje interkonektuese
3. Burime rigjeneruese të energjisë
4. Zhvillimi i sistemit të gasifikimit

Investimet të cilat planifikohen në energjetikë para së gjithash kanë të bëjnë me rikonstruktimin e infrastrukturës aktuale elektro - energjike dhe ndërtimin e infrastrukturës së re, kapaciteteve të reja për prodhimin e energjisë elektrike, me qëllim të garantimit të sigurisë më të madhe në furnizimin me energji, lidhja me rrjetet energjike rajonale, si dhe përfshirja më e madhe procentuale në burimet rigjeneruese të energjisë në konsumin e energjisë.

Gjatë vitit 2012 pritet të zgjedhet ofertuesi më i mirë me konkurs publik për ndarjen e koncesionit për ujë për prodhimin e energjisë elektrike të HEC Çebren dhe HEC Galishte dhe pjesëmarrje në partneritetin privat publik me SHA ELEM dhe të zbatohet zgjidhja e ofertuesit më të

mirë. Gjatë vitit 2012 do të nënshkruhen 26 Marrëveshje të reja për koncesion për ujë për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentrale energjike për gjithsej 26 hidrocentrale elektrike të vogla me rreth 29MW kapacitet të instaluar, si dhe do të zbatohet procedurë e re për ndarjen e koncesionit për ujë për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet elektrike të vogla.

Në vitin 2011 u lidh marrëveshje për hua për ndërtimin e largpërçuesit Shtip-Nish dhe filluan aktivitetet për ndërtim. Ndërtimi i këtij largpërçuesi do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2012. Në lidhje me largpërçuesin Manastir-Elbasan filloi përpunimi i Fizibiliteti studimit dhe Studmit për ndikimin mbi mjedisin jetësor në suazat e Western Balkan Investment Framework. Për mbindërtimin e mundshëm të largpërçuesit aktual 220 kV në 400 kV nivel të tensionit ndërmjet Maqedonisë dhe Kosovës, operuesit e sistemit elektronërçues të të dyja shteteve gjatë vitit 2011 nënshkruan Memorandum për mirëkuptim për përpilimin e fizibiliteti studimit. Gjatë vitit 2012 do të analizohen planet dhe analizat për ndërtimin e mundshëm të këtij largpërçuesi.

Në vitin 2010 u finalizua Fizibiliteti studimi për sistemin e gazsjellësit në RM me projekt ideor. Në studimin janë dhënë analizat teknike dhe ekonomike për: gjendjen aktuale për ndërtimin e sistemit të gazsjellësit, rajonal, ndërkombëtar dhe kushtet tjera për zhvillim, propozime dhe mënyra e ndërtimit të sistemit në pajtim me kushtet në Evropën Juglindore dhe më gjerë dhe hulumtime për mundësinë për shfrytëzimin e gazit gjatë periudhës së ardhshme 20 - 30 vjeçare. Në lidhje me shpërndarjen e gazi pritet gjatë vitit 2012 të fillojnë aktivitetet për hartimin e vizibiliteti studimit për zhvillimin e rrjeteve distributive të gasifikimit.

Më 9 prill 2011 është lidhur Marrëveshje për kredi ndërmjet SHA ELEM dhe kFw Bankës për ndërtimin e parkut me erë të elektranave në Iartësi prej 32,9 milionë euro.

Më 10 nëntor 2011 Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe SHA ELEM kanë nënshkruar marrëveshje për kredi në Iartësi prej 65 milionë euro për ndërtimin e hidrocentralit elektrik Ura e Boshkos e cila ka kapacitet të instaluar prej 70 MW. Ndërtimi i elektranës do të zhvillohet 4 vitet e ardhshme.

Gjatë vitit 2013 dhe 2014 planifikohet të fillojnë projekte më konkrete në pjesën e elektroenergjetikës dhe pjesës së sektorit të gazsjellësit me çka do të rritet siguria gjatë furnizimit me energji në Republikën e Maqedonisë.

Gjatë vitit 2013 dhe 2014 parashihet të shpallen më tepër konkurse publike ndërkombëtare për dhënie me koncesion të ujit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentrale të vogla dhe të fillojë ndërtimi konkret i gazsjellësve magjstral.

Në RM momentalisht institucion kompetent për menaxhim me rezervat e naftës dhe derivateve të naftës është Drejtoria për rezerva të detyrueshme të naftës dhe derivateve të naftës.

Drejtorja është formuar me Ligjin për formimin e Drejtorisë për rezerva të detyrueshme të naftës dhe derivateve të naftës, me qëllim të menaxhimit më racional dhe efikas me rezervat e mallrave të naftës dhe derivateve të naftës, si dhe harmonizimit me legjislacionin Evropian. Drejtoria filloi me punë më 01.06.2009, kur u emërua drejtori i Drejtorisë. Mjetet për funksionimin e saj në 6 muajt e parë janë siguruar nga Buxheti i RM-së, ndërsa në periudhën në vijim do të financohet me të ardhura personale.

Në vitin 2010, Qeveria e RM-së i filloi negociatat bilaterale për lidhjen e mundshme të sistemit nacional të gazsjellësit me gazsjellësit fqinj internacional dhe sigurimin e sasive të nevojshme të gazit, si dhe sigurimin e mjeteve financiare nga institucione financiare ndërkombëtare për ndërtimin e sistemit nacional të gazsjellësit.

Në bazë të Fizibiliteti studimit të hartuar për sistemin e gazsjellësit, është hartuar projekt ideor për gjithë sistemin nacional në gjatësi prej 849 km, sipas të cilit hartohen Projekte themelore dhe realizuese për prioritetet e vijës rrugore magjstrale në gjatësi prej 410 km i ndarë në 5 segmente rrugore. Pritet dokumentacioni teknik të hartohet deri në fund të vitit 2011.

Hartimi i dokumentacionit projektues për katër segmente rrugore do të përfundojnë deri në fund të dhjetorit 2011, ndërsa hartimi i dokumentacionit projektues për segmentin e pestë rrugor do të përfundojnë deri në fund të marsit 2012.

Ndërtimi i segmentit rrugor Kleçovc-Shtip-Hamzali- Stojkovë kufi me R. e Greqisë në gjatësi prej 170 km do të financohet me mjete të siguruar nga "Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së RM dhe Qeverisë së Federatës Ruse për rregullimin e obligimit të ish-BRSS-së sipas përlllogaritjeve të kryera lidhur me shkëmbimin e mallrave ndërmjet BRSS-së së mëparshme dhe ish-SFRJ-së". Planifikohet ndërtimi të fillojë vitin 2012 të përfundojë 2015. Ndërtimi i segmentit rrugor Shkup - Tetovë - Gostivar dhe ndërtimi i segmentit rrugor Shtip - Negotinë - KEC Negotinë- Kavadar - Prilep - Manastir dhe KEC Manastir- Kremenicë kufi me R e Greqisë do të financohet me hua nga

BERZH-i dhe BIE-ja, si fazë e parë. Ndërtimi planifikohet të fillojë 2013 dhe të përfundojë deri në fund të 2015. Si fazë e dytë e huas BERZH/ BIE do të financohet segmenti rrugor Gostivar KEC Oslomej - Kërçovë, Hamzali - Novo Sellë - kufiri me R. e Bullgarisë dhe pjesa tjetër e gazsjellësit magjstral të sistemit nacional gazsjellës në RM. Këto segmente rrugore planifikohen të fillojnë 2015 (2017) dhe të përfundojnë deri në vitin 2022.

Komunikacioni ajror

Në prill të vitit 2011 u bë hapja solemne e aeroportit të rikonstruktuar Shën Apostulli Pal-Ohër. Në aeroportin në fjalë është bërë rikonstruktimi i parkingut aktual, rinovimi i objekteve në kargo qendrën, ndërtimi i VIP objektit, stacioni për pastrim, rikonstruktimi i objektit administrativ, furnizimi i mjeteve të reja për patrullim dhe zjarrfikës, si dhe furnizimi i pajisjes së re në mënyrë që aeroporti të punojë në pajtim me standardet ndërkombëtare.

Në shtator të 2011 është bërë hapja solemne e aeroportit të rikonstruktuar "Aleksandri i madh". Koncesioneri "TAV Maqedoni" ndërtoi objekt të ri terminal prej 40.000 m², vazhdimin e pistës për fluturim dhe aterim për 500 m, ndërtimi i parkingut, rrugë dytësore me rrugë lidhëse, furnizimi i instalimit të sistemit për navigacion, ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme komunale, ndërtimi i objektit administrativ, ndërtimi i terminalit të ri kargo, ndërtimi i stacionit të ri zjarrfikës, parking të ri për mjete fluturuese, si dhe furnizimin e pajisjes së re që aeroporti të funksionojë në pajtim me standardet ndërkombëtare - Shkup.

Ndërtimi rrugëve

Në vitin 2011 u hap segmenti rrugor Tabanovc-Kumanovë me gjatësi prej 7,5 km.

Me përfundimin e segmentit rrugor Demir Kapi - Smokvicë, Korridori Panevropian 10 i cili kalon nëpër gjithë shtetin duke lidhur kufijtë e Republikës së Serbisë dhe Greqisë do të jetë në nivel të autostradës. Ndërtimi pritet të fillojë në tremujorin e parë të 2012 me kohëzgjatje 48 muaj plus periudhë garantuese prej 24 muaj.

Projekti Demir Kapi - Smokvicë në gjatësi prej 28 km do të realizohet me mjete nga IPA Komponenti për Zhvillim Rajonal, Qeveria e RM-së, BERZH-i dhe BIE-ja.

Përpos Korridoreve, Qeveria e RM-së u kushtoi vëmendje edhe rindërtimit të rrugëve rajonale dhe lokale.

Gjatë vitit 2011 përfundimisht më 15.11.2011 janë përfunduar gjithsej 56 rrugë lokale të financuara përmes Bankës Botërore dhe BERZH-it. Gjithashtu janë përfunduar edhe të gjitha rrugët rajonale të financuara përmes Bankës Botërore.

Hekurudhat

Mjetet buxhetore të dedikuara për mirëmbajtje investuese të infrastrukturës hekurudhore aktuale 298.806.000,00 denarë, ndërsa kompensimi i shpenzimeve me interes publik në transportin hekurudhor të udhëtarëve është 229.000.000,00 denarë.

Investime me ndihmë të huaj në hekurudhë

Korridori X - hekurudha

Në lidhje me Korridorin X - hekurudha në rrjedhë është projekti për hartimin e studimeve projektuese dhe dokumentacionit projektues për segmentet hekurudhore në gjatësi të Korridorit 10 dhe segmentit 10d, respektivisht përgatitja e studimit për arsyeshmërinë, studime për analizën e shpenzimeve dhe përfitimeve, studime për vlerësimin e ndikimit mbi mjedisin jetësor si dhe përpilimin e projekteve të reja në pajtim me nevojën për kompletimin e dokumentacionit projektues për segmentet hekurudhore Kumanovë - Deladrovç, Draçevë - Veles dhe Manastir - Kremenicë. Pritet deri në fund të dhjetorit 2011 të lidhet marrëveshje me konsultuesin që do të përpilojë projekt dokumentacion deri në mesin e 2013.

Gjatë vitit 2011 filloi edhe projekti për rehabilitimin dhe ndërtimin e stacionit hekurudhor në Shkup. Qëllimi i këtij projekti është pasagjerëve t'u lehtësohet qasja deri te stacionet dhe peronet me theks të veçantë për personat me nevoja të veçanta. Rehabilitimi i stacioneve hekurudhore pritet të fillojë kah viti 2012 dhe të përfundojë kah viti 2013.

Gjatë vitit 2011, për mjetet e siguruara me kredi nga EBOR filloi procedura për zgjedhjen e firmës ndërtimore e cila do të kryejë remont të segmenteve Tabanovcë - Kumanovë në gjatësi prej 11,7 km dhe Miravci - Smokvicë. Të njëjtat planifikohen të përfundojnë deri në fund të 2012. Nga ana e NP "Hekurudhat e Maqedonisë" - Infrastruktura Shkup janë përpiluar projekte për remont të segmentit nga Nogaevci - Negotinë.

Gjatë vitit 2012 planifikohet të fillojë projekti Remont me Rikonstruktimin e segmenti (hekurudhës) Manastir-Kremenicë (kufi me Greqinë) si pjesë e segmentit 10D të Korridorit 10. Procedura për tenderim për ndërtim duhet të fillojë në tremujorin e 2012 ndërsa marrëveshja për ndërtim të lidhet në mesin e vitit 2013. Punët ndërtimore planifikohen të kryhen deri në fund të 2015.

Korridori VIII - hekurudha

Gjatë vitit 2012 planifikohet Hartimi i vizibiliteti studimit dhe ESIA për remontin Kumanovë - Deve Bair kufiri me R e Bullgarisë.

Në gjysmën e parë të 2012, konsultuesi duhet të hartojë projektet themelore për rehabilitimin e aksit Kumanovë - Beljanovcë, si dhe dokumentacionii tenderitpërzgjidhjen e firmëspërndërtimecilado tërealizojëpunëndërtimorepërrehabilitim. Deri në fund të 2012 të lidhet marrëveshje me firmën ndërsa punët të zhvillohen në periudhë 2 vjeçare, 2013 - 2015.

Deri në fund të 2012 planifikohet konsultuesi të fillojë me hartimin e projektit themelor realizues për hekurudhën nga Kërçova deri në Lin, kufi me Shqipërinë me gjatësi prej 62,6 km, të përfundojë deri në fund të 2014.

3) NVM dhe pjesëmarrja e ndërmarrjeve të vogla

Ndërmarrjet e vogla, të mesme dhe mikro (NVMM) janë lloji dominues i ndërmarrjeve në ekonominë e RM-së. Gjatë vitit 2010 numri i tyre ka qenë 61.647 dhe shënon rritje të vogël krahasuar me vitin 2009 kur numri i tyre ka qenë 61.262. NVMM paraqesin 99,71% të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve aktuale me çka konfirmohen si pjesëmarrës të rëndësishëm në ekonomi si tërësi dhe kreatorë të rëndësishëm të prodhimit shoqëror. Numri në rritje i NVMM absorbon pjesën më të madhe të fuqisë punëtore, duke kontribuar për zvogëlimin e papunësisë. Gjatë vitit 2010 është vërejtur ulje e vogël e numrit të të punësuarve në ndërmarrjet mikro, ndërsa zmadhimi i numrit të ndërmarrjeve të mesme krahasuar me vitin 2009. Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve 80,22% janë të angazhuar në ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme.

Në tabelën më poshtë është dhënë pjesëmarrja e NVM në ekonominë nacionale në raport me numrin e të punësuarve dhe madhësinë e ndërmarrjes.

-Struktura në %-

	Numri i të punësuarve:			Numri i ndërmarrjeve aktive		
	2008	2009	2010	2008	2009	2010
Mikro	8.90	9.98	9.42	71.93	72.52	72.53
Të vogla	1.67	2.34	2.23	26.92	26.33	26.28
Të mesme	7.78	7.19	8.57	0.83	0.84	0.90
Total NVM	8,35	9,50	0,22	99,68	99,69	99,71
Të mëdha	1.65	0.50	9.78	0.32	0.31	0.29
Total	00,0	00,0	00,0	0	100,0	100,0

Politikat dhe aktivitetet për mbështetjen dhe zhvillimin e NVM rezultojnë nga Strategjia nacionale për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në RM 2002- 2013, programi vjetor i NVM dhe BE Akti për biznese të vogla.

Në pajtim me këto dokumente periudhën e kaluar është realizuar, si vijon:

1. Janë kofinancuar aktivitetet programore të biznes inkubatorëve, projekte të natyrës jofinanciare për mbështetje të NVM të qendrave rajonale dhe biznes qendrave në komunat, projekte për mbështetjen dhe zhvillimin e zejtarisë së dhomës të zejtarëve dhe aktivitetet e QEIIIM.
2. Vazhdoi me realizimin e sistemit të vauçerëve të këshillimit dhe info pultin si projekt të Agjencisë për mbështetje të sipërmarrësve në RM, ndërsa janë realizuar më tepër ngjarje për promovimin e sipërmarrësisë dhe mësimin sipërmarrës.
3. Është miratuar Strategjia për zhvillimin e zejtarisë në RM 2012-2020.
4. Në fazë të përgatitjes është "Strategjia për inovacione të RM-së 2012 - 2020"
5. Në vazhdimësi janë realizuar Projekti "Ndërtimi i kapaciteteve për formimin e ekonomisë bazuar në njohuri" (Fondacioni zhvillimor austriak).

Gjatë vitit 2012 do të implementohen masa dhe aktivitete për përmirësimin e sipërmarrësisë dhe konkurrencës së NVM të parapara me Strategjinë nacionale për zhvillim të NVM në RM 2002 - 2013 dhe masa dhe aktivitete në pajtim me Strategjinë për zejtarin në RM. Gjithashtu gjatë vitit 2012 do të realizohen aktivitete të përcaktuara me programin vjetor për NVM parashihet t'u jepet mbështetje: biznes inkubatorëve, implementimit të ISSO, NASSR, HALLALL standardeve për cilësi, sipërmarrjes së femrave, promovimit të zejtarisë, punimeve të dorës autentike maqedonase si dhe organizimi i aktiviteteve promovuese (BE java e sipërmarrësve, Java Globale e sipërmarrësve, Ditët e sipërmarrësve në RM) dhe do të vazhdohet me realizim dhe do të rrumbullakësohet "Ndërtimi i kapaciteteve për formimin e ekonomisë bazuar në njohuri". Dokumenti "Strategjia për inovacione në RM 2012 - 2020" pritet të miratohet gjatë vitit 2012.

Gjatë periudhës 2012-2014 në përgjithësi aktivitetet do të orientohen në përfundimin e infrastrukturës institucionale për mbështetjen e NVM dhe zejtarisë, përmirësimi i ambientit afariste dhe përmirësimi i konkurrencës dhe inovacioneve bazuar në parimet e Aktit për biznese të vogla (Small Business Act) dhe Strategjisë për inovacione në RM 2012 - 2020.

4) Ndikimi i shtetit mbi konkurrencën (përmes politikës tregtare, politikës së konkurrencës, ndihmës shtetërore, IDH, mbështetjes së NVM, etj.)

Politika e mbrojtjes së konkurrencës zbatohet në funksion të sigurimit të shkallës së rritur të konkurrencës së lirë të tregut vendor.

Legjislacioni për ndihmë shtetërore përfshin Ligjin për kontroll të ndihmës shtetërore ("Gazeta Zyrtare e RM-së 145.10) si dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të ligjit.

Harmonizimi i legjislacionit kombëtar me BE acquis vazhdoi edhe gjatë vitit 2011. Qeveria e RM-së në tetor 2011 miratoi 2 dispozita të cilat rezultojnë nga Ligji për kontroll të ndihmës shtetërore ("Gazeta Zyrtare e RM-së 145/10), si vijon:

1. Dispozita për kushtet dhe procedurën për ndarjen e ndihmës me rëndësi të vogël (de minimis) ("Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 141/11) dhe
2. Dispozita për mënyrën dhe procedurën për parashtrimin e njoftimit për ndarjen e ndihmës shtetërore, si dhe procedurën për kryerjen e mbikëqyrjes mbi ndihmën shtetërore aktuale ("Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 142/11).

Njëkohësisht, Komisioni për mbrojtjen e konkurrencës gjatë vitit 2011 në pjesën e ndihmës shtetërore miratoi 11 aktvendime (të cilat janë miratuar janar - nëntor) dhe 10 mendime.

Në lidhje me prioritetet e periudhës në vijim është parashikuar miratimi i dispozitës për Zhvillim rajonal, mirëpo ende nuk është përcaktuar afati për miratim dhe emri i saktë i dispozitës.

Në drejtim të përforcimit të kapacitetit administrativ të Komisionit për mbrojtjen e konkurrencës janë paraparë trajnime për punëtorët për zbatimin efikas të Ligjit për kontroll të ndihmës shtetërore dhe akte nënligjore përmes aktiviteteve të parashikuara me Tuning Projektin "Ndihmë për Komisionin për mbrojtje të konkurrencës për kontroll të ndihmës shtetërore" - nga IPA 2009.

Njëkohësisht, janë planifikuar edhe trajnime dhe studime të cilat punojnë lëndë të ndihmës shtetërore, për ofruesit e ndihmës shtetërore, biznes komunitetit, gazetarë, përmes aktiviteteve të parashikuara me Tuning Projektin "Ndihmë për Komisionin për mbrojtjen e konkurrencës për kontroll të ndihmës shtetërore" - IPA 2009.

Në afat të mesëm do të vazhdojë harmonizimi i mëtejshëm i legjislacionit vendor me atë të BE-së aqis në pajtim me ndryshimet relevante të tij.

Promovimi i investimeve të drejtpërdrejta të huaja

Në Republikën e Maqedonisë janë përcaktuar prioritetet e sektorëve strategjikë për investim, si vijojnë: sektori energjetik, industria për prodhimin e komponentëve të automjeteve, teknologjia informatike - komunikatave, bujqësi dhe përpunimi i ushqimit, industria farmakologjike, tekstili, ndërtimtaria dhe turizmi.

Në pajtim me të dhënat e Bankës Popullore prurjet e investimeve të huaja në 8 muajt e parë të vitit 2011 janë 197,3 milionë euro, që shënon rritje krahasuar me vitin e kaluar. Në tabelë është dhënë pasqyrë kronologjike e prurjeve të IDH në RM.

Prurjet e IDH në R. e Maqedonisë dhe pjesëmarrja e tyre strukturore në BPV

Në milionë euro

Viti	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011 -VIII
Shuma total	100,4	60,7	7,2	44,8	06,0	99,9	45,0	59,1	97,3
Pjesëmarrja e IDH në BPV	,4	,0	,7	,8	,8	,2	,2	,3	,6

Burimi: Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë

Agjencia për investime të huaja dhe promovim të eksportit - AIHPE është institucioni kryesor i cili është i angazhuar për promovimin e investimeve dhe promovimin e eksportit. Agjencia vazhdon intensivisht të punojë drejt sigurimit të aftercare që para së gjithash, ka të bëjë me ndihmën e investuesve të huaj dhe sigurimin e shërbimeve të ndryshme prej kur kompanitë të kenë marrë vendim për të investuar në shtet. Në lidhje me procesin e promovimit ekonomik, momentalisht aktivisht punojnë 18 promotorë ekonomikë të akomoduar në Ambasadat dhe PDK-të në shtete të ndryshme të botës, SHBA, Indi, Kinë, Japoni dhe Katar, numri i të cilëve në mënyrë plotësuese do të rritet. Promotorët ekonomik, përpos punës së prezantimit dhe promovimit të shtetit të investuesit e mundshëm, paralelisht punojnë edhe në promovimin e eksportit.

Tërheqja e investuesve të huaja në zonat zhvillimore industriale teknologjike paraqet një nga prioritetet e Qeverisë. Drejtoria e ZZHT kryen punët lidhur me themelimin, zhvillimin dhe kontrollin e zonave ZHIT. Në rast se Qeveria e Republikës së Maqedonisë është themelues i këtyre zonave, Drejtoria e ZZHT kryen punët me kompetencë të themeluesit të zonës në emër të Qeverisë së R.M-së. Në Republikën e Maqedonisë janë parashikuar 11 zona të tilla, në varësi prej

asaj në cilën fazë të Themelimit, ndërtimit dhe zhvillimit gjenden, zonat ZHTI janë përkufizuar në tre grupe.

Në grupin I janë zonat që mund t'u ofrohen shfrytëzuesve të interesuar pas përfundimit të infrastrukturës themelore dhe këtu bëjnë pjesë ZZHIT SHKUP 1 (140 ha), ZZHIT SHKUP 2 (96 ha), ZHIT SHTIP (206 ha) ZZHIT TETOVË (94 ha). Zonat tjera janë në fazë të finalizimit të marrëdhënieve pronësore - juridike dhe fillimit me ndërtimin e infrastrukturës.

Në lidhje me promovimin e eksportit si kompetencë e re që i ishte ndarë me ligj Agjencisë për investime të huaja dhe promovim të eksportit në vitin 2010, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë së RM-së, ndërsa me përkrahje financiare nga Banka Botërore u përpilua Strategjia për promovimin e eksportit, që u miratua nga ana e Qeverisë.

Kjo strategji paraqet plan se si të zmadhohet vlera e eksportit të kompanive maqedonase për 30% gjatë tre viteve dhe si të avancohet korniza institucionale për promovimin e eksportit. Implementimi i Strategjisë për eksport do të realizohet përmes Planit aksional për promovimin e eksportit për vitin 2012, në bashkëpunim me më shumë institucione dhe projekte donatore. Projekti i ri USAID IDEAS përpiloi Kornizë strategjike dhe biznes model me të cilin përcaktohen sektoret me potencial më të madh eksportues dhe përkufizohen aktivitetet që do t'i kryejë Agjencia në këtë sferë dhe shërbimet që i ofron. Banka Botërore përpiloi vlerësim për konkurrencën maqedonase tregtare duke ofruar rekomandime konkrete për zmadhimin e tyre.

Në vitin 2012 Agjencia për investime të huaja dhe promovim të eksportit e Republikës së Maqedonisë do të vazhdojë me ndjekjen e praktikave më të reja për promovimin e investimeve dhe promovimin e eksportit, do të propozojë risi në pakon e volitshmërive investuese për investuesit potencialë dhe aktivisht do të punojë në koordinim me ministritë kompetente dhe institucionet tjera për lehtësimin e procedurave administrative gjatë shërbimit të investuesve në realizimin e projekteve investuese. Me ç'rast fokusi do të jetë në zmadhimin e interaktivitetit dhe komunikimit me investuesit e përhershëm, identifikimin e pengesave me të cilat ballafaqohen dhe marrjen e veprimeve për mënjanimin e tyre. Gjatë vitit 2012 do të ndërmerren aktivitete për realizimin e Planit aksional nga Strategjia për promovimin e eksportit. Si përforsim plotësues i procesit të promovimit të Republikës së Maqedonisë si biznes i mirë dhe destinacion investues, gjatë muajit janar 2012 në mënyrë plotësuese do të dërgohen në punë 9 promotorë ekonomikë në Britani të Madhe, Belgjikë, Francë, Turqi (Ankara), Kanada, Republikën e Koresë, Itali, Kosovë dhe Holandë. Të njëjtit momentalisht gjenden në trajnim në Agjencinë për investime të huaja dhe promovim të eksportit të Republikës së Maqedonisë. Në mënyrë plotësuese, në vijim është procesi i seleksionimit për promotorët ekonomikë për Kazakistanin.

Me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë dhe realizimit efikas të qëllimeve të vendosura të ASIPI në pjetim me Ligjin, është paraparë që të sigurohet përforsim profesional dhe kadrovik me punësime të reja, si dhe trajnim i vazhdueshëm i të punësuarve ekzistues për praktikën më të mira dhe metodologjitë bashkëkohore për realizimin e promovimit të metodologjive investuese, logjistik më efikase për përmirësimin e shërbimeve të ofruara, bashkëpunim, komunikim dhe përkrahje të target grupeve investuese dhe eksportuese.

Në drejtim të tërheqjes së investimeve të huaja në ZTIZH do të vazhdohet bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet institucioneve.

Politika e konkurrencës, konkurrenca dhe përkrahja e ndërmjarjeve të vogla dhe të mesme

Në drejtim të zbatimit të mëtutjeshëm të reformave ekonomike për përmirësimin e klimës afariste dhe konkurrencës së ekonomisë maqedonase në periudhën e ardhshme do të realizohen dhe do të vazhdojnë të implementohen projekte të reja dhe aktivitete që kontribuojnë për zmadhimin e rritjes ekonomike.

One Stop Shop për investuesit vendas dhe të huaj. Me qëllim të lehtësimit të procesit të fillimit dhe mbajtjes së biznesit në Republikën e Maqedonisë, si dhe mundësimin e investuesve potencialë të gjitha dokumentet e nevojshme për procedura dhe dokumentet e nevojshme që t'i fitojnë nga një vend, Qeveria e Republikës së Maqedonisë zbaton aktivitete për formimin e One Stop Shop për investuesit vendas dhe të huaj (Regjistër). Aktivitetet për realizimin e këtij projekti

janë ndarë në dy komponentë, ku i pari ka të bëjë me skenimin dhe regjistrimin në hartë të licencave dhe lejeve, ndërsa i dyti në kornizën juridike, organizuese dhe teknike. Komponenti i parë i përfshin aktivitetet që përfshijnë identifikimin e të gjitha institucioneve publike që janë përgjegjëse për lëshimin e licencës së caktuar ose lejes, grumbullimin e të dhënave dhe përpilimin e listës së licencave dhe lejeve për mbajtjen e biznesit, zbatimin e hulumtimeve në lidhje me aplikimet dhe bazat e përhershme informatike, standardet komunikuese që shfrytëzohen në institucionet e selektuara, zbatimin e analizës së shpenzimeve të nevojshme për lëshimin e ndonjë licence, kërkesë ose leje dhe përpilim të bazës së të dhënave të kërkesave, licencave dhe lejeve në lidhje me fillimin e biznesit.

Në kuadër të komponentit të dytë, do të përfshihet pasqyra e përvojave dhe praktikave ndërkombëtare, si dhe propozimi i kornizës juridike, organizuese dhe teknike për themelimin e Sistemit njësportel me plan të hollësishëm operacional dhe propozim për mënyrën për zvogëlimin procedurave burokrate gjatë lëshimit të lejeve dhe licencave për ndërtim.

Fillimi i aktiviteteve për formimin e Ekviti Fonde Investuese në Republikën e Maqedonisë, si pjesë e përcaktimit strategjik për përkrahjen e zhvillimit të sektorit privat. Formimi i fondeve të këtitlla ka për qëllim të sigurojë përkrahjen e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, por edhe të mundësojë transfer të teknologjive të reja dhe know - how, si dhe nxitje të aktivitetit investues në këtë sektor. Në mënyrë plotësuese, në çdo kompani portfolio të fondeve do të ketë ndihmë teknike në lloj të vizitës së firmave me veprimtari të njëjtë në BE ose SHBA, sigurim të ekspertëve industriaë, hulumtim primar të tregut, trajnime sipas teknikave moderne të menaxhmentit të ekipit menaxhues dhe ngjashëm.

Mësojmë nga bashkësia e biznesit. Si vazhdim i dialogut tanimë të vendosur me biznes bashkësinë dhe në drejtim të përforcimit të tij, Qeveria e RM-së në periudhën 2012 – 2014 do të vazhdojë ta zbatojë projektin “Mësojmë nga biznes – bashkësia”. Qëllimi i këtij projekti është vështirimi i ideve dhe iniciativave të biznes bashkësisë, që janë në drejtim të përmirësimit të rrethimit afarist, si dhe identifikimit të problemeve kryesore me të cilat ballafaqohen kompanitë gjatë punës të tyre. Për këtë qëllim, ekipet profesionale qeveritare nga institucione të ndryshme për çdo vit do të vizitojnë 150 kompani në gjithë territorin e RM-së. Është paraparë projekti të përfshijë kompanitë me madhësi të ndryshme dhe shkallë të suksesit që do të tregojnë interes të vizitohen nga ana e ekipeve profesionale qeveritare.

Plani aksional për përmirësimin e konkurrencës globale të Republikës së Maqedonisë. Në periudhën e ardhshme, planifikohet revidimi i Planit Aksional për përmirësimin e konkurrencës globale dhe lirive ekonomike sipas Programit për punën e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë (2011 – 2015). Plani aksional për përmirësimin e konkurrencës globale dhe lirive ekonomike do të harmonizohet me biznes bashkësinë në të a.q “Plan master për përmirësimin e konkurrencës globale dhe lirive ekonomike të Republikës së Maqedonise.

Procesi i zmadhimit të konkurrencës së ekonomive maqedonase paraqet një nga prioritetet e politikës ekonomike të Qeverisë, që realizohet përmes përmirësimit të klimës afariste për mbajtjen e biznesit dhe përmes implementimit të më tepër strategjive, politikave dhe programeve që drejtpërdrejt ndikojnë në zhvillimin e sipërmarrësisë, inovacionit, zhvillimit teknologjik, eksportit, tërheqjes së investimeve të huaja e të ngjashme.

Vazhdon impementimi i Politikës industriale të Republikës së Maqedonisë 2009 – 2020, si qasje e integruar dhe proaktive, ndërsa për impelemntimin e saj të suksesshme në rrjedhë është përpilimi i Planit aksional për implementimin e Politikës industriale për vitin 2012 – 2013. Në vitin 2012 pritet fillimi i implementimit të Projektit IPA Komponenti 1 për Përforcimin e kapaciteteve institucionale për implementimin e politikës industriale. Vazhdon koordinimi i ndihmës së donatorëve përmes qasjes programore për përkrahje të politikës industriale.

Në rrjedhë është përpilimi i Strategjisë për inovacione me përkrahje të OECD-së që pritët t'i japë udhëzimet kryesore për qasje të koordinuar në përkrahjen ndaj krijimit të ekonomisë konkurruese të bazuar në njohuri dhe inovacione. Në fazë të miratimit është Strategjia për promovimin e eksportit me plan aksional që do të kontribuojë në përkrahje më efikase të firmave në procesin e internacionalizimit.

Si një nga pesë sferat e intervenimit të parapara në Politikën industriale të RM-së 2009-2020 është zmadhimi i konkurrencës së industrisë maqedonase me nxitjen dhe përforcimin e kllasterëve dhe rrjetëzimin e tyre rajonal dhe ndërkombëtar (qëllimi është ndarja e shpenzimeve, hulumtimi më efikas i tregut, qarkullimi më efikas i punës, kapitalit, teknologjisë, inovacioneve dhe informatave).

Në këtë drejtim, në nivel vjetor miratohet Program i veçantë për përkrahje dhe zhvillim të bashkimit kllasterial, në suaza të të cilave janë paraparë aktivitete për promovim më të mirë të mundësive që i ofrojnë klasterët, trajnim dhe avancim të menaxhmentit të klasterëve, përmirësim të lidhjes (rrjetëzimit) të kllasterëve, si dhe mjetet për formimin e klasterëve të rinj. Forma e klasterëve të bashkimit do të mundësojë zhvillimin e prodhimeve të reja, inovative, me çka do të mundësohet diversifikimi i programeve prodhuese të industrisë.

Prioritetet në periudhën e ardhme do të orientohen drejt përforcimit të bashkëpunimit teknologjik në suaza të klasterëve, me ç'rast në kuadër të çdo kllasteri do të formohet Regjistër i kompanive maqedonase me kapacitet më të madh për inovacione dhe për hulumtim. Ë bashkëpunim me klasterët ekzistues dhe në pajtim me kriteret paraprakisht të përkufizuara, do të matte kapaciteti i kompanive maqedonase që të kryejnë hulumtime që do të zbatoheshin në proceset prodhuese. Në pajtim me këto rangime do të ndërtohet bashkëpunimi ndërmjet firmave, universiteteve, fakulteteve dhe inovatorëve nga Maqedonia.

Me projektin do të përkrahen aktivitetet e orientuara në përkrahje të projekteve të bashkësive të klasterëve me të cilat do të mundësohet nxitja e lidhjes së klasterëve dhe ekonomisë sasiore. Shfaqja e përbashkët e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes klasterëve do të mundësojë zvogëlimin e shpenzimeve për planifikim strategjik, marketing, trajnime dhe hyrje në tregjet e huaja. Që të vazhdohet zhvillimi i iniciativave të klasterëve do të vazhdohet me promovimin e Udhëzimit për klasterë që dedikohet për menaxhmentin e tyre. Do të vazhdohet me përkrahjen e organizimit të seminareve për ngritjen e vetëdijes për bashkimin e klasterëve, përkrahjen e projekteve konkrete të parashtruara nga klasterët, përforcimin e kapaciteteve të klaster – menaxhmentit, si dhe organizimin e debateve për indikatorët për klaster të suksesshëm.

Organizimi i trajnimeve në nivel të klasterit. Teknologët dhe inxhinierët e 10 firmave më të mira nga çdo klaster dhe 5 inovatorët nga sfera përkatëse do të mbajnë ligjërata për praktikat dhe risitë në punën e tyre. Nga ana e saj, Qeveria në bashkëpunim me institucionet ndërkombëtare financiare do të financojë më së paku 2 ligjerues me renome evropiane dhe rajonale nga sfera që të mbajnë ligjërata për arritjet botërore.

5) Integrimi tregtar me BE-në

Republika e Maqedonisë si vend me potencial të vogël dhe të brendshëm tregtar, nga pavarësia e vet, u përcaktua për zbatim të politikës aktive të jashtme tregtare me qëllim të intensifikimit të bashkëpunimit tregtar me vendet nga rajoni dhe më gjerë, përmes liberalizimit dhe lehtësimit të kushteve për zhvillimin e papenguar të eksportit dhe importit të mallrave.

Republika e Maqedonisë në vitin 2011 vazhdoi ta zbatojë politikën tregtare në pajtim me obligimet e ndërmarra ndërkombëtare që rezultojnë nga Marrëveshja për stabilizim dhe asocim, nga anëtarësimi në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT-së), CEFTA dhe marrëveshjet tjera për tregti të lirë me të cilat ndërmerren obligime për regjimin e favorizuar tregtar.

Vendet e BE-së (27) kanë pjesëmarrje më të madhe në këmbimin e përgjithshëm të jashtëm që e realizon Republika e Maqedonisë me botën, që në periudhën janar – shtator 2011 është 56,9%. Indikatorët e bashkëpunimit tregtar ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe BE-së në periudhën janar – shtator 2011 sugjerojnë se ai zmadhohet në lidhje me periudhën e njëjtë nga viti paraprak për 41,2%. Zmadhimi i importit nga BE-ja është për 43,3%, ndërsa zmadhimi i eksportit është 38,2%, me ç'rast deficitin tregtar për periudhën e njëjtë zmadhohet për 56,1%, ndërsa mbulimi i importit u zvogëluar për 2,6 pikë përqindjeje dhe për periudhën janar - shtator nga viti 2011 është 68,7%.

Nga data 01.01.2011, tregtia në sektorin industrial ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe BE-së zhvillohet pa dogana për shkak të përfundimit të periudhës transite prej 10 vjetësh, që vlente deri më 31.12.2010, për zvogëlimin gradual të detyrimeve doganore gjatë importit të prodhimeve nga BE-ja në RM. Gjithashtu, prej 01.01.2012 do të fillojë zbatimi i akumulimit diagonal në pajtim me protokollin përkatës për prejardhjen e mallit nga Marrëveshja për tregti të lirë, të nënshkruar ndërmjet vendeve - anëtare të CEFTA-s me Maqedoninë dhe Serbinë. Konventa rajonale për Rregullat pan-evropiane mediterane dhe preferenciale për origjinën e mallrave, që Republika e Maqedonisë e ka nënshkruar më 15 qershor 2011, me 47 vende – anëtare, do të mundësojë përfshirjen e Republikës së Maqedonisë në Kumulimin pan-evropian mediteran të origjinës së mallrave. Në shtator 2011, Republika e Maqedonisë e ratifikoi Protokolin plotësues për CEFTA 2006 në të cilin është i përmbajtur liberalizimi plotësues i tregtisë me prodhimet bujqësore – ushqimore, zbatimi i të cilave ka filluar nga 13.11.2011. Pas ratifikimit të Protokolit nga vendet tjera anëtare të CEFTA do të mundësohet zbatimi i liberalizimit të ri të tregtisë me produktet bujqësore – ushqimore. Njëkohësisht, RM-ja dhe Republika e Shqipërisë nga 01.01.2012 do t'i heqin kuotat për produkte bujqësore për shkak të zbatimit efektiv të Protokolit plotësues, ndërsa me Republikën e Moldavisë do të vlejné kuotat deri në përfundimin e ratifikimit nga ana e tyre. Gjithashtu, në vitin 2011 pritet të ratifikohet ndryshimi dhe plotësimi i Marrëveshjes për tregti të lirë me Ukrainën, me çka do të krijohen mundësi për liberalizim më të madh në tregtinë me produkte bujqësore dhe ushqimore.

6) Reformat e orientuara në zmadhimin e produktivitetit dhe konkurrencës (bujqësia dhe zhvillimi dhe rural, sektori për prodhimtari, duke përfshirë diversifikimin e bazës industriale)

Gjatë vitit 2012, në pajtim me Strategjinë nacionale për bujqësi dhe zhvillim rural (2007 – 2013), politika bujqësore dhe rurale fokusohen në krijimin e kushteve për zhvillimin e sektorit konkurrues bujqësor – të ushqimit. E njëjta arrihet me krijimin dhe realizimin e politikës për përkrahje të drejtpërdrejtë të prodhimtarisë bujqësore, rregullim të tregjeve përkatësisht përmirësim të cilësisë së produkteve bujqësore, më tutje zhvillim të mjediseve rurale me investime në drejtim të modernizimit të sektorit bujqësor – përpunues, si dhe politikës përkatëse të tokës.

Politika zhvillimore bujqësore zbatohet përmes masave të përkrahjes së drejtpërdrejtë në suaza të Programit për përkrahje financiare për zhvillimin e bujqësisë, ndërsa përkrahja për zhvillimin e mjedisve rurale përkatësisht investime në prodhimtarinë bujqësore përmes financimit kapital nga Programi për përkrahje financiare për zhvillim rural dhe IPARD Programi 2007 - 2013 me përkrahje nga IPA fondet e BE-së të dedikuara për zhvillim rural.

Përkrahja e drejtpërdrejtë (e përfshirë në 115 milionë euro për vitin 2012) është në pajtim me Politikën e përbashkët bujqësore dhe mekanizmat për pagesën e përkrahjes së drejtpërdrejtë përkatësisht pagesat e drejtpërdrejta për krerë dhe për hektarë.

Rregullimi i tregjeve me produkte bujqësore ushqimore siguron kushte për marrëdhënie konkurruese në tregjet bujqësore përmes vendosjes dhe zbatimit të standardeve për cilësi, zmadhim të konkurrencës tek grumbulluesit dhe përpunuesit me nxitjen e investimeve në pikat grumbulluese-distributive dhe përforcim të kushteve teknike–teknologjike për kryerjen e grumbullimit të prodhimeve bujqësore etj..

Masat për zhvillim rural (Programi për përkrahje financiare për zhvillim rural dhe IPARD Programi 2007 – 2013 me përkrahje nga IPA fondet e BE-së të dedikuara për zhvillim rural) janë të orientuara në përmirësimin e konkurrencës dhe efikasitetit tregtar të sektorit bujqësor – ushqimor, ruajtjes së mjedisit jetësor dhe mirëmbajtjes së zonave përmes praktikave agro – ekologjike bujqësore dhe zbatim të praktikës së mirë bujqësore, zhvillimit të ekonomive rurale, përmirësimit të cilësisë së jetës në mjediset rurale dhe përkrahje të iniciativave lokale (LEADER) për zbatimin e strategjive lokale për zhvillimin e mjediseve rurale dhe formim dhe vendosje dhe punë të Grupeve Lokale Aksionale (GLA).

Në mënyrë plotësuese, me realizimin e masave nga Programi për përkrahjen financiare për zhvillim rural zhvillohet turizmi në mjediset rurale, përforcimi i shërbimeve në mjediset rurale përmes edukimit të dhënësve të shërbimeve turistike në mjediset rurale për promovimin dhe përdorimin e etno stilit, promovimin e turizmit të verës, degustimit të ushqimit dhe verës tradicionale maqedonase,

Gjithashtu, përmes Programit për përkrahje financiare për zhvillim rural sigurohet përkrahje për depozitimet investuese për realizimin e projekteve aplikative dhe bazike shkencore - hulumtuese dhe vendosje të rajoneve treguese - demonstruese.

Themelimi i kooperativave bujqësore është e përkrahur me masa nga Programi për përkrahje financiare për zhvillimin rural për përforsimin e kapacitetit për funksionimin e tyre përkatësisht trajnime për menaxherë të cilët do të menaxhojnë me kooperativat bujqësore për përmirësimin e aftësive të tyre të marketingut, organizuese dhe menaxhuese dhe fushatën mediatike për promovimin e kooperativave ekonomike të bujqve dhe inicimin e interesit tek kooperativat potenciale.

Politika bujqësore është në drejtim të shpërndarjes së tokës së tërësishme të lirë bujqësore në pronësi të shtetit prodhuesve bujqësorë, si dhe zgjerimi i aktivitetit bujqësor të tokës private bujqësore që nuk përpunohet nga ana e pronarëve e as që është në tregun e tokës bujqësore, rritje të tokës bujqësore me shkëmbim të parcelave private ndërmjet prodhuesve bujqësorë (2012 - 2014) dhe përmes shkëmbimit të tokës bujqësore private me atë shtetërore, dhënie të tokës bujqësore private në uzusfruk etj..

3.01. QARKULLIMI I LIRË I MALLRAVE

3.01.1. PARIME TË PËRGJITHSHME

GJENDJA RRJEDHËSE

Në vitin 2011, vazhdoi ndjekja e implementimit të masave nga Plani aksional për harmonizim me nenet 28 – 30 (përkatësisht 34 – 36), për realizimin e të cilit Ministria e Ekonomisë dërgoi Informatë të Qeveria e Republikës së Maqedonisë. Obligimi i këtillë është në pajtim edhe me Vendimin e Këshillit të BE-së për parimet, prioritetet dhe kushtet e përmbajtura në Partneritetin për qasje të RM-së për përpilimin e këtij Plani aksional, me standarde për skringing të brendshëm të legjislacionit nacional dhe praktikave administrative për futjen e klauzolave për njohje të ndërsjellë dhe për ndryshimet e nevojshme të njëpasnjëshme. Prej gjithsej 42 masave të cekura për arritjen e harmonizimit me nenet 34 - 36 nga MFBE-ja, 14 masa që kanë efekt të barabartë me kufizimet kuantitative të importit dhe eksportit u ndryshuan ose u abroguan, përkatësisht gjithsej 33% nga numri i përgjithshëm i masave. Në pajtim me dinamikën fillestare të paraparë, 28 masat tjera duhet të zgjidhen deri në muajin shtator të vitit 2012.

Vazhdoi realizimi i aktiviteteve nga institucionet në fjalë që janë shënuar në Strategjinë për zbatimin e legjislacionit për organizata përkatëse horizontale (standardizim, akreditim, metrologji dhe mbikëqyrje të tregut) në sferën e qarkullimit të lirë të mallrave. Kjo Strategji është e evidentuar si prioritet afatshkurtër në pajtim me Partneritetin për qasje të Republikës së Maqedonisë në BE. Ministria e Ekonomisë më 17.10.2011, përmes Sekretariatit për Çështje Evropiane dorëzoi te Komisioni Evropian tekt anglez të Raportit për realizimin e masave nga Strategjia për periudhën janar 2010 – qershor 2011.

Aktivitetet e parapara në strategji që kanë të bëjnë me stërvitjen dhe trajnimet e të punësuarve të IARM-së, ISRM-së dhe BM-së, si dhe për prodhuesit dhe përfaqësuesit e tyre, vlerësuesit dhe ekspertët filluan të realizohen në fillim të vitit 2011 në suaza të Projektit IPA 2008 për infrastrukturën për cilësi. Janë formuar këshilla drejtues që në muajin shkurt i mbajti takimet e para për miratimin e Inception Report për dinamikën e aktiviteteve që duhet të realizohen në periudhë prej 18 - 24 muaj.

Në lidhje me negociatat për lidhjen e Marrëveshjes AKA për shtatë sektorë industrialë (pajisje nën presion, LVD, EMS, pajisje transmetuese nën presion, enë të thjeshta nën presion, makina dhe pjesë nga prodhimet e ndërtimtarisë) gjatë vitit 2011, Ministria e Ekonomisë bëri harmonizim plotësues të dispozitave, në pajtim me rekomandimet e Komisionit Evropian. Komisioni Evropian në muajin shkurt 2010 e dorëzoi në Ministrinë e Ekonomisë propozim – tekstin e Marrëveshjes AKA.

PRIORITETE AFATSHKURTRA

KORNIZA JURIDIKE

Në vitin 2012, do të vazhdojë realizimi i masave në Planin aksional për harmonizim me nenet 34 deri në 36 nga Marrëveshja e funksionimit të BE-së me standarde për skringing të brendshëm të legjislacionit nacional dhe praktikave administrative, për futjen e klauzolave për njohje të ndërsjellë dhe për ndryshimet e nevojshme të njëpasnjëshme në lidhje me kompatibilitetin me këto nene nga MKE-ja.

Në shkurt 2012, Ministria e Ekonomisë do të dorëzojë në miratim te Qeveria e Republikës së Maqedonisë Raport për realizimin e masave nga Plani aksional në vitin 2011. Raporti i miratuar do të përkthehet në gjuhën angleze dhe do të dorëzohet në KE për informim.

Deri në fund të vitit 2012, planifikohet të finalizohen negociatat për lidhjen e Marrëveshjes AKA ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe BE-së, për shtatë sektorët industrialë (pajisje nën presion, pajisje transmetuese nën presion, pajisje nën tension të ulët, makina dhe pjesë nga prodhimet e ndërtimitarisë), që janë lëndë e negociatave.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Në periudhën në vijim do të punohet në përforcimin e kapaciteteve administrative në Ministrinë e Ekonomisë dhe institucionet tjera kompetente që marrin pjesë në procesin e përpilimit dhe zbatimit të dispozitave juridike të Republikës së Maqedonisë, dispozitat e reja nga qasja globale, e re dhe e vjetër.

PRIORITETE AFATMESME

Implementimi i Strategjisë për zbatimin e *acquis-it* për organizatat përkatëse horizontale (standardizim, akreditim, metrologji dhe mbikëqyrje të tregut) së bashku me datat e synuara dhe përgjegjësitë e qarta për vendosjen dhe zbatimin efikas të masave ligjvënëse dhe përforcim të kapaciteteve administrative në sektorë të ndryshëm.

Zbatimi i sistemit RAPEX nga ana e Inspektoratit shtetëror të tregut dhe komunikimi me organe tjera inspektuese në Republikën e Maqedonisë kompetente për produktin e sigurtë të tregut të brendshëm në RM.

3.01.2. MASAT HORIZONTALE

Korniza juridike për rregullim të sferave të akreditimit, standardizimit, metrologjisë, mbikëqyrjes së tregut dhe vlerësimit të përputhshmërisë rumbullakësohet në Republikën e Maqedonisë. Gjatë vitit 2010 dhe 2011, janë miratuar shumë ligje dhe akte nënligjore në të cilat transponohen direktivat e reja të BE-së.

3.01.2.1. STANDARDIZIMI

GJENDJA RRJEDHËSE

Instituti për Standardizim i Republikës së Maqedonisë (ISRM) i përmbushi 9-të kushtet për anëtarësim të plotësuqishëm në Komitetin Evropian për Standardizim (CEN) dhe në Komitetin Evropian për Standardizim Elektroteknik (CENELEC), e paraqiti Aplikimin dhe gjatë vitit 2012 pret të vijë misioni vlerësues nga Komiteti Evropian për Standardizim (CEN) dhe Komiteti Evropian për Standardizim Elektroteknik (CENELEC). Pas vlerësimit të tyre të parë votohet në organizatat e lartpërmendura (27 anëtare të BE-së, 3 të EFTA-s dhe Kroacisë, me ç'rast nevojitet konsensus). ISRM-ja është anëtar i plotfuqishëm i Organizatës Ndërkombëtare për Standardizim – ISO (International Organization for Standardisation), anëtar asociativ i Komisionit Ndërkombëtarë Elektroteknik - IEC (International Electrotechnical Commission) dhe anëtar shoqërues në Komitetin Evropian për Standardizim – CEN (European Committee for Standardisation) dhe në Komitetin Evropian për Standardizim Elektroteknik - CENELEC (European Committee for Electrotechnical Standardisation).

Në vitin 2011, numri i të punësuarve në ISRM është 20.

Deri në dhjetor të vitit 2011, ISRM-ja ka miratuar rreth 22 000 standarde evropiane dhe ndërkombëtare dhe dokumente tjera të standardeve si standarde maqedonase nga të cilat rreth 3000 janë të lidhura me Direktivat nga qasja e re. Numri i standardeve të tërhequra konfliktuozet dhe të pandryshueshme që ishin me shenjë MKS JUS është 11 300.

Gjatë vitit 2011 në procedurën e formimit janë 2 Komitetet e reja teknike (DUHANI DHE METALURGJIA) dhe është bërë një riorganizim i Komitetit ekzistues teknik (në bazë të Industrisë strategjike në RM dhe PVB) me çka numri i përgjithshëm është 26 Komitete teknike (ISRM KT).

ISRM-ja në mënyrë permanente lëshon Publikime mujore ku botohet debati publik dhe miratimi i standardeve. Në ueb faqen e re që në të njëjtën kohë është e lidhur me bazat e të dhënave të ISRM-së, janë azhurnuar informata aktuale nga sfera e standardizimit maqedonas, ndërkombëtar dhe evropian, bëhet kërkimi në bazat e të dhënave, shihet çdo standard në cilin nivel është në hierarkinë e miratimit, janë të arritshme komente të draft standardeve, ndërsa me fjalëkalim u mundësohet anëtarve të Komitetit teknik të mbikëqyrin se çfarë ndodh në nivelin evropian dhe ndërkombëtar në sferën e tyre. Shitja e standardeve është në format elektronik.

Janë përpiluar Ligji, Statuti dhe të gjitha Rregulloret të lidhura me procesin e miratimit dhe shënimit të standardeve, punën e KT dhe TP dhe SO që duhet plotësisht të harmonizohen me Rregullat e brendshme të Trupave Evropian për Standardizim;

Janë notifikuar-publikuar të gjitha standardet e miratuara ndaj Trupave Evropian për Standardizim (TES), ndërsa është shënuar edhe standardi i parë i pastërt maqedonas. Njëkohësisht filloi vendosja e aktivitetit certifikues të ISRM-së si sferë e re nga fushëveprimi i tij në punë.

Në fushën e bashkëpunimit rajonal, në vitin 2011, ISRM-ja nënshkroi marrëveshje për bashkëpunim me Institutin e Serbisë, Kroacisë dhe të Kosovës për Standardizim.

Në fazë përfundimtare është vendosja e ISO 9001:2009 në ISRM.

PRIORITETE AFATSHKURTRA

Në sferën e standardizimit dhe certifikimit janë paraparë aktivitetet si vijojnë:

- Miratimi i Ligjit, Statutit dhe të gjitha Rregulloreve të lidhura me procesin e miratimit dhe shënimit të standardeve, punës në KT dhe TP dhe SO që duhet të jenë plotësisht të harmonizuara me Rregullat e brendshme të Trupave Evropian për Standardizim;
- Vazhdimi i bashkëpunimit aktiv me trupat evropian për standardizim dhe trupat nacional për standardizim;
- Përfundimi i kapacitetit kadrovik me përmbarues të rinjë në pajtim me Rregulloren për sistematizim të punëve dhe detyrave në ISRM;
- Zhvillimi i mëtutjeshëm të Certifikimit.
- Përshejtimi i procesit për përkthim të standardeve evropiane në gjuhën maqedonase;
- Lëshimi i certifikatës së parë nga ISRM-ja për ISO 9001.
- Realizimi i trajnimeve për:
 - rregulla dhe praktikë të standardizimit evropian dhe ndërkombëtarë;
 - procedura për përpilim, miratim të standardeve evropiane dhe ndërkombëtare në trupa punues teknik ndërkombëtarë dhe evropian;
- certifikim sipas ISO 9001.
- Mirëmbajtja e pajisjes IT dhe furnizimi i pajisjeve të reja, furnizim i sistemeve të licencuara, furnizimi i sistemeve dhe programeve të licencuara operative;
- Fushata promovuese; organizim të punëtorive tematike dhe lëshim të publikimeve tematike, afisheve, trakteve dhe distribuim me qëllim të përfshirjes aktive të bashkësisë së biznesit dhe palëve tjera të interesuara në procesin e standardizimit; dhe
- Botimi i Tabelës së shpalljeve për standardet e miratuara maqedonase;

PRIORITETE AFATMESEME

Në sferën e standardizimit janë paraparë aktivitetet si vijojnë:

- Zbatimi i Strategjisë nacionale për vendosjen dhe zbatimin efikas të masave ligjvënëse dhe përfundimi i kapaciteteve administrative të institucioneve që e përbëjnë infrastrukturën për cilësi (standardizim, akreditim, metrologji, vlerësim të përputhshmërisë, mbikëqyrje të tregut);
- Krijimi i të hyrave të reja përmes certifikimit dhe trajnimeve.

3.01.2.2. AKREDITIMI

GJENDJA RRJEDHËSE

Qeveria e RM-së e miratoi Ligjin e ri për akreditim ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 120/2009), që është i miratuar me Kreun I dhe Kreun II nga rregullativa (BE) nr. 765.2008 dhe Ligjin për institucionet. Në pajtim me obligimet nga ky ligj, Këshilli i Institutit për Akreditim të Republikës së

Maqedonisë (IARM) e miratoi Statutin e ri dhe i njëjti është miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë me Vendim nr. 51 – 1095/1 në mars të vitit 2010 (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 39/2010). Gjatë vitit 2010 IARM-ja bëri revizion të të gjitha akteve interne të IARM-së, për shkak të harmonizimit të tyre me Ligjin e ri për akreditim dhe Statutin e ri.

Instituti për Akreditim i Republikës së Maqedonisë (IARM) është anëtarë i plotësfuqishëm i Organizatës Evropiane për Akreditim – EA (European co-operation for Accreditation) nga viti 2007 dhe anëtar shoqëruës i Organizatës Ndërkombëtare për Akreditim të Laboratorëve ILAC (International Laboratory Accreditation Cooperation) nga viti 2008.

IARM-ja bashkëpunon me trupat nacionalë për akreditim të shteteve tjera para së gjithash nga rajoni dhe ka nënshkruar marrëveshje bilaterale me trupat nacional për akreditim të Serbisë, Malit të Zi, Shqipërisë, Kroacisë, Bullgarisë, Turqisë, Kosovës dhe Moldavisë.

Rregullat për akreditim në Republikën e Maqedonisë janë të harmonizuara me standardet evropiane dhe ndërkombëtare (seria EN 45000 dhe seria ISO 17000), rregullativën dhe udhëzimet e EA, IAF-së (International Accreditation Forum) dhe ILAC, si dhe praktikën e mirë evropian në atë sferë.

Në muajin shkurt 2009, IARM-ja parashtroi aplikacion te EA-ja për nënshkrimin e Marrëveshjes për njohje të ndërsjellët të rezultateve (MLA). Në muajin dhjetor 2009 u realizua vizita paravlerësuese e ekipit nga EA-MLA. Në tetor 2010 IARM-ja dorëzoi informatë te ekipi i EA-MLA-së për mënjanimin e të gjitha vërejtjeve të dhëna në raportin nga paravlerësimi dhe kërkoi zgjerim të për kalibrim. Në periudhën 23 – 28 tetor 2011 ekipi nga EA- MLA e realizoi misionin vlerësues dhe në përgjithësi dha notë pozitive, ashtu që pritet Marrëveshja MLA të nënshkruhet kah fundi i vitit 2012.

Në muajin shkurt 2011 filloi të implementohet projekti IPA 2008: “Ndihmë teknike për ndërtimin e kapaciteteve të Institutit për Akreditim (IARM), përmes të cilit janë zbatua 15 misione të ekspertëve dhe është furnizuar dhe instaluar Data management software.

Në vitin 2011 janë zbatuar trajnime të vlerësuesve dhe ekspertëve dhe personave të interesuar juridik për akreditim dhe atë:

- trajnime të organizuara nga ana e IARM-së;
- trajnime të organizuara përmes Institutit Gjerman të Metrologjisë (PTB);
- 9 trajnime të organizuara përmes projektit IPA 2008.

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në IARM është 16. Numri i përgjithshëm i vlerësuesve dhe ekspertëve është i evidentuar në Listën e vlerësuesve dhe ekspertëve, që ka arritur 21 vlerësues teknikë, 16 vlerësues udhëheqës, në trajnim ka 22 vlerësues, kandidatë për vlerësues ka 6 dhe 101 (prej të cilëve 31 janë aktivë).

Përfundimisht me muajin nëntor 2011, IARM-ja ka akredituar 91 trupa për vlerësim të përputhshmërisë. 11 personave juridikë të akredituar u është hequr akreditimi.

Në vitin 2011 IARM-ja organizoi pritje solemne me rastin e 9 Qershorit, Ditës botërore të akreditimit, në të cilën, IARM-ja akordoi Certifikata për akreditimin e trupave të akredituar në periudhën qershor 2010 – maj 2011 dhe njëkohësisht u mbajt promovimi i projektit IPA 2008.

Në periudhën 28 – 29 shtator 2011 në Ohër, në organizim të Institutit për Akreditim të Republikës së Maqedonisë u mbajt Konferenca rajonale për akreditim.

Në vitin 2011, IARM-ja lëshoi raport vjetor për punën e vet, që ka për qëllim promovimin e akreditimit dhe njoftimin e publikut me punën e IARM-së.

PRIORITETE AFATSHKURTRA

Në vitin 2012 do të realizohen aktivitetet, si vijojnë:

- Akreditimi i trupave për vlerësimin e përputhshmërisë (laboratore, trupa të certifikuar, trupa inspektues);
- Nënshkrimi i Marrëveshjes për njohje të ndërsjellë (MLA) me Organizatën Evropiane për Akreditim (EA);
- Realizimi i trajnimeve për:

- Vlerësues,
- Vlerësues udhëheqës,
- Klientë potencialë,
- Skema të reja të akreditimit.
- Përforcimi i bashkëpunimit me ministritë në pjesën e autorizimeve/notifikimeve të trupave për vlerësim të përputhshmërisë, përkatësisht përkufizim të qartë të detyrave ndërmjet tyre në lidhje me procedurat për vlerësimin e përputhshmërisë;
- Përforcimi i infrastrukturës teknike të IARM-së përmes punës permanente të komiteteve teknike dhe komiteteve sektoriale;
- Realizimi i projektit IPA 2008 deri në fund të muajit gusht 2012;
- Përforcim i bashkëpunimit me trupat për akreditim nga rajoni; dhe
- Fushata promovuese, organizimi të punëtorive dhe botimi i publikimeve.

PRIORITETE AFATMESME

Në vitin 2013 do të realizohen aktivitetet, si vijojnë:

- Zbatimi efikas i sistemit të vendosur për akreditim;
- Zvogëlimi i periudhës nga parashtrimi i aplikacionit deri në akordimin e akreditimit që do të rezultojë me zmadhimin e numrit të trupave të akredituar për vlerësimin e përputhshmërisë (laboratore, trupa certifikues, trupa inspektues);
- Përforcimi i kapaciteteve kadrovike në IARM për zbatimin e papenguar të vlerësimit për sferat për të cilat kërkohet akreditim;
- Zbatimi i Strategjisë nacionale për futjen dhe zbatimin efikas të masave ligjvënëse dhe përforcim të kapaciteteve administrative të institucioneve që e përbëjnë infrastrukturën për cilësi;
- Përforcimi i infrastrukturës teknike përmes punës permanente të komiteteve teknike/sectoriale, që do t'u përgjigjen kërkesave specifike për akreditim në sektorë të ndryshëm;
- Zhvillimi i skemave të reja për akreditim;
- Nënshkrimi i MLA për gjithë përfshirjen.

3.01.2.3 METROLOGJIA

GJENDJA RRJEDHËSE

Byroja për metrologji (BM) është organ në përbërje të Ministrisë së Ekonomisë që ka rol udhëheqës në suaza të sistemit nacional për metrologji dhe i kryen detyrat dhe obligimet në sferën e metrologjisë shkencore, industriale dhe ligjore. Byroja për metrologji është institucion kompetent për zbatimin e Ligjit për metrologji ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 55/02, 84/07, 120/09 и 136/11), Ligjit për kontrollin e sendeve nga metale të çmueshme ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 23/95 dhe 22/07) dhe është organ për aprovim në pajtim me Ligjin për automjete ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 140/08). Byroja për metrologji bashkëpunon me organizata të specializuara ndërkombëtare dhe rajonale (OIML, CGPM, EURAMET, WELMEC, IAAO), në të cilat Byroja e prezanton Republikën e Maqedonisë. Nga viti 2007 BM është firmosëse e MRA-së – Aranzhmanit ndërkombëtar për njohjen e certifikatave për kalibrim, të lëshuara nga institutet nacionale metrologjike, firmosës të MRA-së. Nga viti 2009 BM u bë anëtar i Organizatës ndërkombëtare të trupave të autorizuar për analizë dhe certifikim të sendeve nga metalet e çmueshme - IAAO.

Nga maji 2010, Byroja e metrologjisë është edhe anëtare e plotfuqishme e EURAMET-it. Byroja e metrologjisë fitoi anëtarësim me të drejta të plota në organizatë pas prezantimit të suksesshëm të arritjeve dhe përmbushjes së kritereve të përcaktuara në aktet e EURAMET-it, para anëtarëve të Asamblesë së përgjithshme të EURAMET-it.

Ligji për metrologji fillimisht i miratuar në vitin 2002, është i harmonizuar me kërkesat dhe praktikat evropiane në tërësi. Direktiva për njësitë matëse 80/181 KEE është e transponuar në Rregulloren për definicionet, emrat dhe simbolet, rajonin dhe mënyrën e zbatimit, obligimin për përdorim dhe mënyrën e shkrimit të njësive ligjore matëse ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 104/2007). Direktivat 76/211/KEE dhe 2007/45/BE për prodhime të paketuara transponohen në Rregulloren për mënyrën dhe procedurën për kryerjen e mbikëqyrjes metrologjike dhe kërkesat që prodhimet e paketuara duhet t'i përmbushin në lidhje me sasinë dhe shmangiet e lejuara nga sasinë e shënuara dhe lista e sasive nominale të prodhimeve të paketuara matëse ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr.

83/2009). Ligji për metrologji është ndryshuar në muajin tetor 2009 që të mundësohet për transponimin e Direktivës për instrumentet matëse - MID (2004/22/BE) dhe Direktivës për enë për matje shishe (75/107/KEE). Rregullore për masat ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 17/2010), si transpozicion i MID dhe Rregullore për kërkesa esenciale për shishe që shfrytëzohen si enë matëse ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 147/2010), si transpozicion i 75/107/KEE, u miratuan në vitin 2010. Gjithashtu, Direktiva 76/766/KEE që ka të bëjë me tabelat alkoolike është transponuar në "Rregulloren për mënyrën dhe procedurën për realizimin, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e materialeve referente të certifikuar për alkool ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 150/2010) dhe Direktiva 76/765/KEE që ka të bëjë me alkoolometrat e transponuara në Rregulloren për alkoolometra dhe areometra për alkool ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 157/2010),

Direktiva për peshore joautomatike 90/384/KEE është transponuar në Rregulloren për peshoret joautomatike që, për dallim nga të lartëpërmendurat janë rregulloret e cekura, u miratua në bazë të Ligjit për siguri të prodhimeve. Kohë më parë, kjo rregullore u zëvendësua me Rregullore të re për mënyrën e vlerësimit të përputhshmërië së peshoreve joautomatike ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 142/2011), me të cilën transponohet Direktiva 2009/23/KEE dhe u miratua në bazë të Ligjit për metrologji.

Në vitin 2010 u miratua edhe Plani strategjik për zhvillim të Byrosë për metrologji dhe infrastrukturë metrologjike në Republikën e Maqedonisë 2010 – 2012, që themelohet në vizionin për zhvillimin e ardhshëm të sistemit nacional metrologjik, aktivitetet e të cilin tërhiqen në pothuajse të gjitha segmentet nga përditshmëria. Ai paraqet dokument gjithëpërfshirës që përmban faktorë për zbatimin e asquis në pjesën e metrologjisë, së bashku me datat e synuara dhe përgjegjësitë e qarta për vendosjen dhe zbatimin efikas të masave ligjvënëse dhe përforcimin e kapaciteteve administrative në sektorë të ndryshëm.

Në suaza të Byrosë funksionojnë tetë laboratorë për kalibrim. Shtatë prej tyre, përkatësisht laboratorët për masë, presion, gjatësi dhe kënd, vëllim dhe qarkullim, dendësi, temperaturë dhe energji elektrike janë në funksion. Laboratori për kohë dhe frekuencë është vetëm fazë fillestare e zhvillimit. Në suaza të Sektorit për verifikim, metale të çmueshme dhe homologji funksionon laborator i specializuar për analizë të metaleve të çmueshme për qëllimet e kontrollit të sendeve të punuara nga metale të çmueshme. Paisja metrologjike e BM-së është e furnizuar përmes projektit EU KARD SMAQVa (2002 – 2005) dhe projektit BERIS (2008 - 2010).

Vijueshmëria e matjeve është vendosur përmes kalibrimit të etalonëve referentë të BM-së në institutet nacionale metrologjike.

Katër nga laboratorët (masa, temperatura, vëllimi dhe qarkullimi dhe presioni) të BM-së janë në proces të akreditimit. Vlerësimi fillestar i Sistemit për menaxhim në cilësi, në nëntor 2011 është bërë nga ana e Institutit për akreditim të Republikës së Maqedonisë. Përfundimisht me muajin nëntor 2011, janë lëshuar gjithsej 438 certifikata për kalibrime të mjeteve për matje, ndërsa në pjesën që ka të bëjë me matëset ligjore të rregulluara, është bërë verifikimi i 22.000 matësve mekanikë dhe 55.000 elektrikë.

Realizimi i projektit IPA 2008 filloi në janar të vitit 2011. Qëllimi kryesor i këtij projekti është të kontribuojë për qarkullimin më të mirë të mallrave dhe përmirësimin e tregtisë me BE-në përmes përmirësimit të infrastrukturës metrologjike në Republikën e Maqedonisë. Me këtë projekt, janë identifikuar më shumë prioritete që përmes zhvillimit të Byrosë, do të kontribuojnë në avancimin e infrastrukturës për cilësinë në vend: përforcimi i kapaciteteve të laboratorëve për kalibrim dhe verifikim, përkrahja e procesit të harmonizimit dhe implementimit të legjisllacionit nga qasja e re dhe e vjetër, Përgatitja e laboratorëve për akreditim në pajtim me ISO/IEC 17025, anëtarësimi i vendit në trupat relevantë evropianë dhe ndërkombëtarë. Ngritja e vetëdijes publike dhe informimi për rëndësinë e metrologjisë.

Përfundimisht me muajin nëntor 2011, numri i të punësuarve në BM është 32 nëpunës shtetërorë, prej të cilëve 13 janë inzhiner - laborant në qendrën laboratorike për kalibrim, 14 në Sektorin për verifikim, metale të çmueshme dhe homologjim dhe 5 në Seksionin për punë të përgjithshme dhe të përbashkëta. Plotësimi i strukturës organizuese të Byrosë për metrologji është 29%.

PRIORITETE AFATSHKURTRA

Nga sfera e **metrologjisë** planifikohet:

- Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për metrologji në drejtim të futjes së mbikëqyrjes inspektuese mbi përdorimin e mjeteve matëse nga sfera ligjore.
- Harmonizimi me aktet nacionale nënligjore me dokumentet ndërkombëtare normative
- Punësime të reja në pjesën për metrologji shkencore dhe ligjore dhe në pjesën për punë juridike dhe financiare;
- Furnizimi i pajisjes metrologjike për operacionalizim të laboratorëve për kalibrim, si dhe pajisje të nevojshme për përkrahjen e aktiviteteve të Laboratorëve për verifikim të mjeteve matëse mekanike dhe elektrike, veçanërisht në pjesën për vlerësimin e përputhshmërisë së matësve (NAWI dhe MID);
- Prezantimi i sistemit për menaxhim me cilësi në pajtim me ISO 17025 para EURAMET TK – Q;
- Realizimi i programit për zhvillim – IPA 2008 ndihmë teknike dhe materiale dhe përkrahje për implementimin e legjislacionit në sferën e qarkullimit të lirë të mallrave dhe infrastrukturës për cilësi;
- Përgatitja për akreditimin e laboratorëve/Akreditim/mirëmbajtje të akreditimit të laboratoreve në pajtim me ISO/IEC 17025;
- Pjesëmarrja aktive në punën e komiteteve teknike të EURAMET, grupeve të punës të WELMEC dhe IAAO;
- Pjesëmarrja në projekte të krahasimeve laboratorike, të organizuara në nivel rajonal dhe projekte të interkrahimeve në suaza të EURAMET-it;
- Rikalibrimi i etalonëve në Institutin nacional metrologjik me mundësi të regjistruara matëse dhe të kalibrimit në bazën e BIPM (Byroja ndërkombëtare për pesha dhe masa)
- Trajnime të specializuara të kuadrit profesional nga BM në sferën e metrologjisë shkencore/industriale (kalibrime të matësve dhe deseminim të njësive matëse) dhe ligjore (verifikim të matësve);
- Organizimi i seminareve dhe punëtorive me qëllim të përforsimit të infrastrukturës metrologjike dhe
- Lidhja e marrëveshjeve bilaterale për bashkëpunim me institucionet në Republikën e Serbisë, Republikën e Kroacisë dhe Republikën e Malit të Zi.

PRIORITETE AFATMESME

Në sferën e **metrologjisë** planifikohet:

- Harmonizimi me aktet nacionale nënligjore me dokumentet ndërkombëtare normative;
- Pjesëmarrja aktive në punën e komitetit teknik të EURAMET-it;
- Pjesëmarrja aktive në grupet punuese për në WELMEC;
- Akreditimi i laboratorëve (madhësi elektrike, madhësi të dimensionuara, dendësi) sipas sistemit për menaxhim me cilësi në pajtim me ISO 17025;
- Pjesëmarrja në projektet e krahasimeve ndërlaboratorike;
- Shpallja e etalonëve nacionalë të njësive matëse (presion, temperaturë) varësisht nga rezultatet nga projektet e interkrahimeve;
- Implementimi i standardit ndërkombëtarë ISO 17020 në sektorin për verifikim;
- Trajnime të specializuara të kuadrit profesional nga BM - ja në sferën e zbatimit të metodave për kontrollin e neto përmbajtjes në prodhimet e paketuara dhe enët për matje, si dhe trajnimet në pajtim me Planin akonal të propozuar për përgatitjen dhe emërimin e BM-së për trupin për vlerësim të përputhshmërisë në sferën e MID dhe NAWI;
- Shfrytëzimi i resurseve vendase para se gjithash të institucioneve arsimore për edukimin me qëllim dhe formimin e etalonëve nacional në sferën ku BM-ja nuk ka mundësi; dhe
- Regjistrimi i mundësive matëse dhe kalibruese në laboratorët e BM-së në bazën e BIPM;

3.01.2.4 VLERËSIMI I PËRPUTHSHMËRISË (TESTIMI/CERTIFIKIMI/KONTROLLI)

GJENDJA RRJEDHËSE

Vlerësimi i përputhshmërisë rregullohet me Ligjin për sigurinë e prodhimeve dhe Ligjin për automjete. Ministri i Ekonomisë i autorizon personat e interesuar juridikë të bëjnë vlerësimin e përputhshmërisë së prodhimin teknik dhe identifikimin/gjendjen teknike dhe përmirësimin e automjetit. Kreditimi i zbatuar konsiderohet si supozim për përmbushjen e kushteve për autorizimin e personave juridikë. Autorizimi për vlerësimin e përputhshmërisë së prodhimit teknik bëhet në pajtim me Urdhëresën për procedurën për miratimin e Vendimit për autorizimin e personit juridik për kryerjen e vlerësimit të përputhshmërisë, mënyrën e njoftimit për përfitimin e cilësisë së trupave për vlerësimin e përputhshmërisë, mënyrën e njoftimit për abrogimin e Vendimit për autorizim dhe forma dhe përmbajtja e regjistrit të trupave për vlerësimin e përputhshmërisë ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 157/07).

Autorizimi për identifikim, gjendja teknike dhe dhënia e pëlqimit për automjetin bëhet në pajtim me nenin 56 nga Ligji për automjete.

ë vitin 2010 dhe 2011, ministri i Ekonomisë në pajtim me Ligjin për siguri të prodhimeve miratoi Vendime për autorizimin e personave të rinj juridikë, edhe atë:

- 4 subjekte juridike për sigurinë e makinave (persona transportues, platforma për shkallë, transportues industrial dhe tj.) në pajtim me rregulloren për sigurinë e makinave ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 123/09) në të cilën është e transponuar direktiva 2006/42/KE;
- 3 persona juridikë për verifikimin e njësisë (Moduli "G") në pajtim me Rregulloren për lëshimin në treg të ashensorëve dhe pajisjeve të sigurisë për ashensorë ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 23/07) në të cilën është e transponuar direktiva 95/16/KE;
- 1 person juridik për testimin e llojit të ashensorëve (Moduli "B") në pajtim me Rregulloren për lëshimin në treg të ashensorëve dhe pajisjeve të sigurisë për ashensorë ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 23/07) në të cilën është e transponuar direktiva 95/16/KE;
- 1 subjekt juridik për inspektime periodike dhe përdorim të sërishëm të pajisjes transmetuese nën presion në pajtim me Rregulloren për pajisje transmetuese nën presion ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 17/07; 122/09; 99/10) në të cilën është e transmetuar direktiva 1999/36/KE;

Numri i përgjithshëm i personave të autorizuar juridikë është 7 dhe të emëruarit janë të evidentuar në regjistrin e trupave të autorizuar për vlerësimi e përputhshmërisë që shpie në Ministrinë e Ekonomisë. Gjithashtu, Vendimet e tyre për autorizim janë shpallur në ueb faqen e Ministrisë së Ekonomisë.

Në vitin 2010 dhe 2011, ministri i Ekonomisë në pajtim me Ligjin për automjete miratoi gjithsej 18 Vendime për autorizim, prej të cilave 10 vendime kanë të bëjnë me autorizimin e subjekteve juridike për kryerjen e identifikimit dhe vlerësimin e gjendjes teknike të automjeteve dhe 8 vendime për autorizimin e shërbimit teknik për dhënien e pëlqimit për automjete.

PRIORITETE AFATSHKURTRA

Në vitin 2012, do të vijojnë autorizime të reja të trupave për vlerësimin e përputhshmërisë pas kërkesës së parashtruar nga personat juridik në pajtim me procedurën për autorizim.

Në suaza të Institutin për akreditim të Republikës së Maqedonisë ekziston Qendër trajnimi në të cilën kryhen trajnime përkatëse të personave të inteersuar juridik. Trajnimet për vitin 2012 janë planifikuar të jenë për procedurat për akreditim në lidhje me standardet 17020 për trupa inspektues, 17024 për trupa certifikues dhe 17025 për laboratore, në pajtim me Projektin IPA 2008.

PRIORITETE AFATMESME

Në sferën e vlerësimit të përputhshmërisë planifikohet të përforcohet numri i trupave maqedonas që do të jenë të pranishëm në RM gjatë kryerjes së vlerësimit për përputhshmërinë për prodhimet maqedonase.

Notifikimi i trupave për vlerësimin e përputhshmërisë në Komisionin Evropian do të ndjek pas lidhjes së Marrëveshjes AKA ose me anëtarësimin e RM-së në BE.

Ministri i Ekonomisë është institucion kompetent për zbatimin e procedurës për notifikimin e trupave për vlerësimin e përputhshmërisë.

3.01.2.5 MBIKËQYRJA E TREGUT

GJENDJA RRJEDHËSE

Mbikëqyrja e tregut rregullohet në Ligjin për mbikëqyrje të tregut, në të cilin transponohen pjesë nga Kreu I, Kreu III dhe Kreu IV nga Rregullativa 765/2008 ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 48/2010). Në këtë ligj përkufizohet koordinimi i mbikëqyrjes së tregut nga kompetencat e organeve inspektuese, me formimin e Trupit koordinues për mbikëqyrjen dhe lehtësimin e shkëmbimit të të dhënave dhe informatave. Inspektorati shtetëror i tregut kryeson me këtë Trup koordinues. Qeveria e RM-së miratoi Vendim për emërimin e koordinatorit, zëvendëskoordinatorit, sekretarit dhe anëtarëve të Trupit koordinues për mbikëqyrje të tregut ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 90/2010) nga 5 korriku 2010.

Për punën e Trupit koordinues për mbikëqyrje të tregut, Qeveria e RM-së miratoi Program nacional për koordinimin dhe marrjen e masave efektive për mbikëqyrje të tregut për vitin 2011 dhe 2012 ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 146/2010) nga 8 nëntori 2010. Në suaza të programit ekziston afat kohor për veprim të organeve inspektuese për ligje të veçanta dhe akte nënligjore që e rregullojnë çështjen e sigurisë së prodhimeve.

Koordinimi i trupit koordinues, si dhe punët administrative teknike kryhen nga Inspektorati shtetëror i tregut. Trupin koordinues e përbëjnë 12 anëtarë nga organet për mbikëqyrjen e tregut, dhe atë: Inspektorati shtetëror i punës, Inspektorati shtetëror për inspeksion teknik, Inspektorati shtetëror sanitar dhe shëndetësor, Agjencia për ushqim dhe veterinar, Inspektorati shtetëror për ambient jetësor, Agjencia për komunikime elektronike, Drejtoria doganore, Byroja për barna, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve dhe Ministria e Ekonomisë - sektori për treg të brendshëm.

Mbahen takime të rregullta (e më së paku një herë në muaj) për realizimin e masave nga Programi. Për shkallën e realizimit të masave nga Programi, Trupi koordinues detyrohet të përpilojë raport në vitin rrjedhës për vitin paraprak dhe ta dorëzojë në Qeverisë e RM-së për informim në pajtim me nenin 8 paragrafi 3 nga Ligji për mbikëqyrje të tregut. Njëkohësisht, në pajtim me nenin 8 paragrafi 4 nga ligji në fjalë, raporti do të publikohet në ueb faqen e Ministrisë së Ekonomisë.

Më 4 shkurt 2011, anëtarët e organeve inspektuese nga Trupi koordinues dhe Drejtoria doganore nënshkruan Memorandumin për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin e ndërsjellët. Qëllimi i lidhjes së këtij memorandumi është në bashkëpunim të ndërsjellët që të identifikohen rajonet specifike dhe prodhimet për zbatimin e kontrollit të prodhimeve që futen në tregun e RM-së dhe zbatimi i parimeve të përgjithshme të shenjës "CE", me ç'rast duke mbajtur llogari për parimet për vlerësim të rrezikut, kërkesat dhe shkëmbimi i informatave ndërmjet Drejtorisë doganore nga ana e organeve inspektuese nga ana tjetër. Pas nënshkrimit të Memorandumit, Trupi koordinues organizon mbikëqyrje inspektuese tek më shumë subjekte, që lëshojnë në treg lodra të fëmijëve, vegla ndihmëse mjekësore dhe pajisje telekomunikative. Gjatë vitit 2011 janë zbatuar 269 kontrole të përbashkëta nga Trupi koordinues dhe atë rreth 80% nga mbikëqyrjet inspektuese janë kontrolli i subjekteve me lodra fëmijërore, ndërsa 20% të tjerat janë vegla ndihmëse mjekësore dhe tj.

Më 22 – 23 shtator 2011, Ministria e Ekonomisë në bashkëpunim me përfaqësuesit nga Trupi koordinues zbatoi trajnime për nëpunësit doganorë për zbatimin e rregulloreve dhe ligjeve për sigurinë e prodhimeve dhe prodhimeve të ndërtimitarisë në lidhje me shenjën CE dhe dokumentacionin e nevojshëm që e shoqëron prodhimin gjatë hyrjes në RM.

Në kompetencë të Inspektoratit shtetëror të tregut gjatë vitit 2010 janë realizuar gjithsej 331 kontrole dhe janë miratuar gjithsej 75 aktvendime të subjekteve juridike për parregullsitë e përcaktuara të prodhimet që plasohen në treg. Në periudhën janar – qershor 2011, ISHT-ja realizoi gjithsej 121 kontrole, jashtë nga kontrollet që i kryen në suaza të Trupit koordinues për mbikëqyrje të tregut.

Inspektorati shtetëror i tregut në drejtim të modernizimit të punës së vet në muajin dhjetor 2010, implementoi aplikimin softuerik, me të cilin mundësohet komunikimi i brendshëm ndërmjet seksioneve në suaza të ISHT, si dhe vendosje të procedurave të vetme në realizimin e aktiviteteve të punëve.

Për përmirësimin e punës transparente të ISHT-së janë përpiluar:

- ueb faqe, që mundëson qasje të drejtpërdrejtë të paraqitjes elektronike të dokumentacionit, në fletëparaqitje dhe parashtresa dhe
- udhëzues për punën e ISHT, për afaristët dhe konsumatorët.

PRIORITETE AFATSHKURTRA

Në muajin shkurt 2011, do të pasojë përpilimi i Raportit vjetor për punën e Trupit koordinues për mbikëqyrjen e tregut në pajtim me aktivitetet që janë propozuar në Programin nacional për mbikëqyrje të tregut për vitin 2011.

Është paraparë përpilimi i Programit nacional për koordinimin dhe marrje të masave për mbikëqyrje të tregut për vitin 2012 dhe 2013.

Në drejtim të zbatimit të drejtë të rregulloreve dhe ligjeve për siguri të prodhimeve dhe prodhimeve të ndërtimitarisë në lidhje me shenjën CE dhe procedurën për vlerësimin e përputhshmërisë, në vitin 2012 është paraparë zbatimi i trajnimeve për biznes bashkësinë në suaza të odave ekonomike.

PRIORITETE AFATMESME

Në afat të mesëm janë paraparë aktivitetet si vijojnë:

- Përpilimi i Raportit vjetor për punën e Trupit koordinues për mbikëqyrjen e tregut në pajtim me aktivitetet që janë propozuar në Programin nacional për mbikëqyrje të tregut për vitin 2013.
- Zbatimi i sistemit RAPEX nga Inspektorati shtetëror i tregut në bashkëpunim me organet tjera shtetërore kompetente për mbikëqyrje të tregut në susza të Programit nacional për mbikëqyrje të tregut dhe programet e tyre të veçanta vjetore kur një prodhim i dyshimtë do të paraqitet në sistem se paraqet rrezik serioz të tregut.

PËRKRAHJA E HUAJ

1. Projekti IPA për komponentin I për infrastrukturë të cilësisë, për përforsim të kapaciteteve në sferën e standardizimit, akreditimit dhe metrologjisë, që filloi të realizohen në shkurt 2011;

2. IPA 2008 Projekt rajonal për infrastrukturë të cilësisë për Ballkanin Perëndimor dhe Turqisë në shkurt 2009 për periudhë prej dy vjetësh. Projekti financohet nga Komisioni Evropian dhe EFTA, ndërsa në zbatimin e tij është përfshirë edhe CEN (Komiteti Evropian për standardizim). Për realizimin e aktiviteteve të planifikuara projekti vazhdoi deri në 3 qershor 2011. Në suaza të aktiviteteve, kryesisht janë mbajtur trajnime praktike për të punësuarit nga trupat për infrastrukturë të cilësisë: akreditim, standardizim, metrologji, vlerësim të përputhshmërisë (ME) dhe mbikëqyrje të tregut e pjesëmarrje në trajnime praktike në sferat siç janë tregu i brendshëm dhe mbikëqyrja e tregut, të punësuarit fituan përvojë të nevojshme për kryerjen e detyrave, trajnime për testim profesional që të krijohet rrjeti nga laboratorët në sektorët që janë të rëndësishëm në periudhën paraaderuese dhe t'i trajnojë menaxherët dhe të punësuarit në laboratore dhe trupa nacional për akreditim që të kryejnë testim profesional sipas Standardeve evropiane përmes përforsimit të trupave për infrastrukturë të cilësisë zbatohet gjithë projekti, që të lehtësohet tregti rajonale dhe qarkullimi i lirë i mallrave, të avancohet konkurrenca e ekonomisë në rajon dhe t'i përgatit vendet për negociatat e ardhshme me BE-në. Ky projekt vazhdon për 30 muajt e ardhshëm, duke filluar nga muaji tetor 2011, kur u mbajt Takimi i parë i Steering Committee në Bruksel.

3.01.3. QASJA E VJETËR E LEGJISLACIONIT PËR PRODHIME

PRODHIME TË KOZMETIKËS

GJENDJA RRJEDHËSE

Harmonizimi me legjislacionin nacional në sferën e sigurisë së produkteve kozmetike është kryer dhe në vijim është implementimi i tij.

Ministria e Shëndetësisë është institucion kompetent për zbatimin e dispozitave nga Ligji për siguri të produkteve kozmetike, akteve nënligjore dhe për ndjekjen e implementimit të legjislacionit nacional dhe harmonizimit të vazhdueshëm me legjislacionin evropian, si dhe me përpunimin teknik në atë sferë.

Inspektorati shtetëror shëndetësor dhe sanitar në mënyrë permanente kryen kontrollin e zbatimit të legjislacionit. Në funksion të përforsimit të kapaciteteve të ISHSHS në këtë sferë gjatë vitit 2011 janë mbajtur trajnime për praktikën e mirë prodhuese të produkteve kozmetike dhe një punëtori TAIEX për inspeksionin dhe verifikimin e praktikës së mirë laboratorike të produkteve kozmetike.

Instituti për shëndet publik, si institucion i autorizuar shtetëror nga ministri i Shëndetësisë në mënyrë të vazhdueshme bën testimin dhe kontrollin e cilësisë së preparateve kozmetike nga importi dhe nga prodhimtaria e brendshme dhe i implementon aktet e miratuara nënligjore në lidhje me kontrollin e përqendrimit të florit dhe ëmbëlsusve artificial në pastat për dhëmbë, si dhe ndjekje të përmbajtjes së konservanëve, ngjyrës dhe filtrave UV në produktet kozmetike.

PRIORITETE AFATSHKURTRA

Deri në fund të vitit 2012, planifikohet të kryhet analizë e dispozitave nga Ligji për siguri të produkteve kozmetike në lidhje me rregullativën e re të BE-së për kozmetikë.

Planifikohet trajnimi i të punësuarve në ISHP për metodat për analizë të parametrave të caktuar në produktet e kozmetikës.

PRIORITETE AFATMESME

Në afat të mesëm planifikohet formimi i njësisë organizuese në MSH që do të jetë e detyruar për përpilimin e legjislacionit nacional në sferë, ndjekjen e implementimit të legjislacionit nacional dhe harmonizimin e vazhdueshëm me legjislacionin evropian, si dhe me përparimin teknik në atë sferë.

BARNA PËR PËRDORIM NË MJEKËSINË HUMANE

GJENDJA RRJEDHËSE

Në muajin nëntor 2011 u publikua Metodologjia për mënyrën e formimit të çmimeve të barnave dhe Byroja për barna e planifikon implementimin e saj pas hyrjes në fuqi në muajt e ardhshëm.

Në rrjedhë janë ndryshime dhe plotësime të Ligjit për barna dhe vegla ndihmësemjekësore, që harmonizohet me të Drejtën e BE-së në pjesën e rregullimit të çështjes për import paralel të barnave.

KORNIZA JURIDIKE

Procedurat legale dhe kërkesat në lidhje me barnat rregullohen me Ligjin për barna dhe vegla ndihmëse mjekësore ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 106/07).

Në korrik 2010 janë bërë ndryshime dhe plotësime të Ligjit për barna dhe vegla ndihmëse mjekësore ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 88/2010). Me ndryshimet bëhet harmonizimi i periudhës së vlefshmërisë së autorizimit të marketingut për barna dhe afati ndryshohet prej tetë deri në pesë vjet, në pajtim me të Drejtën e BE-së. Gjithashtu, futet një kohë e papërcaktuar e vlefshmërisë së regjistrimit ë barnave verbale, barnave tradicionale dhe të barnave homeopatike. Në pjesën e kuadrit për kryerjen e veprimtarisë – qarkullim me pakicë (në barnatore) bëhet harmonizim që ka të bëjë me numrin e personave të punësuar me arsim mesëm dhe të lartë. Përveç kësaj, me Ligjin bëhet edhe plotësimi që të krijohet bazë për miratimin e metodologjisë për mënyrën e formimit të çmimeve të barnave, që miratohet me procedurë qeveritare.

Të gjitha aktet nënligjore në sferën e barnave (gjithsej 24) janë miratuar dhe publikuar në periudhën 2008 - 2009. Me ato është arritur shkallë e lartë e harmonizimit të rregullativës nacionale për barna me të Drejtën e BE-së në këtë sferë. Ato janë të arritshme në ueb faqen e Byrosë për barna www.reglek.com.mk

KORNIZA INSTITUCIONALE

Byroja për barna është organ në përbërje të Minsitrisë së Shëndetësisë dhe është kompetente për punët menaxhuese dhe profesionale për barnat për përdorim human në RM.

KAPACITETI ADMINISTRATIV

Byroja për barna i implementon të gjitha procedurat legale dhe kërkesat për barna.

Vazhdon trajnimi i të punësuarve nga Byroja për barna në suaza të Projektit IPA me Agjencinë evropiane për barna, në mënyrë permanente që nga muaji shkurt 2008 në drejtim të përsosjes së shkathtësive rregullatore në sferat profesionale.

PRIORITETE AFATSHKURTRA

Pasojnë aktivitete për formimin e çmimeve për të gjitha barnat që jepen në recetë, në pajtim me metodologjinë e re që e miratoi Qeveria e RM-së në nëntor 2011.

Pas miratimit të ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit për barna që janë propozuar në muajon nëntor 2011 në Kuvendin e RM-së, do të ndjek miratimi i Rregullores për import paralel të barnave dhe implementim të kësaj procedure.

KIMIKALET

GJENDJA RRJEDHËSE KORNIZA JURIDIKE

Me miratimin e Ligjit të ri për kimikale u kontribua në zvogëlim të efektit negativ nga përdorimi i kimikaleve në shëndetin e njerëzve dhe ambientin jetësor, vendosjen e qarkullimit të lirë të mallrave me qëllim që të zmadhohet mbrojtja nga kimikalet dhe arritjes së zhvillimit të qëndrueshëm në RM, përmes vendosjes të sistemit përkatës për plasman dhe shfrytëzim të kimikaleve në lidhje me rrezikun që të njëjtit i sjellin dhe kapacitetet përkatëse institucionale dhe krijimi i veglave administrative.

Gjatë vitit 2011 u vazhdua procesi i transponimit të legjislacionit evropian në legjislacionin nacional.

Në bazë të Ligjit për kimikale, u miratuan aktet nënligjore si vijojnë.

- Lista e ndalimeve dhe kufizimeve për përdorimin e kimikaleve ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 57/2011) që i transponon kërkesat nga Rregullativa REACH 1907/2006

- Lista e substancave me rezik të lartë (që shkaktojnë brengosje), ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 156/2011) që i transponon kërkesat nga Rregullativa REACH 1907/2006

- Rregullorja për mënyrën në të cilën bëhet vlerësimi i sigurisë së kimikaleve dhe përmbajtjen e raportit të sigurisë së kimikaleve. ("Gazeta Zyrtare e RM-se" nr. 82/2011), duke transponuar masën e BE-së 32006R1907

- Rregullorja për metodat për përcaktimin e biodegradimit të substancave sipërfaqësore aktive në detergjente, si dhe metodat referente për testim dhe analizë të detergjenteve ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 74/2011), duke transponuar masën e BE-së 32004R0648;

- Rregullorja për të dhënat për përmbajtjen e detergjenteve që duhet të cekën në paketim, si dhe rregullat e përgjithshme dhe të veçanta të shënimit në paketimin e detergjenteve;

- Rregullorja për listën e të dhënave për përmbajtjen e detergjenteve, ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 84/2011), duke transponuar masën e BE-së 32008R0689;

- Rregullorja për rastet në të cilat zbatohet procedura PIC dhe përmbajtja e kërkesës për zbatimin e procedurës PIC, ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 82/2011), që e transponon masën e BE-së 32008R0689;

- Rregullorja për rastet në të cilat zbatohet procedura e njoftimit paraprak, rastet në të cilat nuk nevojitet zbatimi i mëtutjeshëm i procedurës të njoftimit paraprak, përmbajtja e njoftimit për eksport dhe dokumente që dorëzohen për shkak të zbatimit të procedurës së njoftimit paraprak ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 82/2011), duke transponuar masën e BE-së 32008R0689;

- Lista e kimikaleve dhe prodhimeve eksporti i të cilëve ndalohet ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 82/2011), duke transponuar masën e BE-së 32008R0689;

- Rregullorja për listën e të dhënave për përmbajtjen e detergjenteve, ("Gazeta Zyrtare e RM-se" nr. 84/2011), duke transponuar masën e BE-së 32004R0648

- Rregullorja për metodat për testim të kimikaleve ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 127/2011), duke transponuar masën e BE-së 32008R0440

Në fillim të muajit tetor 2011 Qeveria e RM-së e miratoi Raportin për gjendjen me kimikalet në Republikën e Maqedonisë dhe Planin aksional nacional për qasjen strategjike në menaxhimin me kimikale.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Në nëntor të vitit 2011 u formua Trupi intersektorial për kimikale që do të sigurojë përmirësim të bashkëpunimit intersektorial për zbatimin e Ligjit për kimikale dhe në të marrin pjesë përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Ambientit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Ekonomisë, Ministrisë së Financave – Drejtorisë doganore, Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve dhe përfaqësues të Shoqatës për industri kimike.

Përfaqësuesit nga RM-ja morën pjesë në takimet e rregullta të grupit për REACH dhe CLP (CARACAL) në Bruksel, si dhe në takimin e 10-të të Autoriteteve nacionale të Konventës për

ndalimin e armëve kimike të shteteve nga Evropa lindore, në të cilën morën pjesë edhe përfaqësues nga RM-ja.

Për informimin e të gjitha palëve të tanguara për obligimet që rezultojnë nga Ligji i ri dhe Rregullativa REACH, u organizuan dy punëtori njëditore, në bashkëpunim me Odën Ekonomike të Republikës së Maqedonisë.

PRIORITETE AFATSHKURTRA KORNIZA JURIDIKE

Në këtë periudhë do të vazhdojë transponimi i legjislacionit të BE-së në sferën e kimikaleve në legjislacionin nacional me miratimin e akteve nënligjore që rezultojnë nga Ligji i ri për kimikale, ndërsa njëkohësisht do të punohet në azhurnimin dhe plotësimin permanent të Listës nacionale të substancave të klasifikuara; Lista e substancave me rrezik të lartë (që shkaktojnë brengosje), Lista e ndalimeve dhe kufizime për përdorim dhe Lista e substancave aktive në prodhimin biocid.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Në vitin 2012 do të vazhdojë regjistrimi i të gjithë personave juridikë dhe fizikë të cilët punojnë me kimikale. Për qëllim të shkëmbimit të të dhënave dhe menaxhimit të integruar me kimikalet Byroja e barnave vazhdoi të mbajë Regjistrin e integruar të kimikaleve që do të përbëhet nga Regjistri i kimikaleve dhe Regjistri i prodhimeve biocide. Ky Regjistër do të përmbajë edhe të dhëna për preparatet për mbrojtjen e bimëve.

Edhe në këtë periudhë do të vazhdojë përforsimi i kapaciteteve institucionale të institucioneve kompetente nga rajoni i kimikaleve përmes punësimeve të reja në Sektorin për kimikale në Byronë për barna dhe zbatimit të trajnimeve të të punësuarve dhe të inspektorëve përgjegjës për implementimin e dispozitave nga Ligji për kimikale.

Si aktivitet permanent ngel koordinimi i aktiviteteve të REACH Held Desk-ut dhe rrjetëzimi i tij me help des-qet ekzistuese të regjistruara në Bashkimin Evropian dhe me institucionin përgjegjës në nivel të BE-së përkatësisht Agjencisë evropiane për kimikale (ESNA) me seli në Helsinki.

PRIORITETE AFATMESME KORNIZA JURIDIKE

Në këtë periudhë do të vazhdojë transponimi i asquis së BE-së në legjislacionin nacional në pjesën e kimikaleve në bazë të Ligjit për kimikale. Me ç'rast planifikohet të miratohen aktet nënligjore si vijojnë:

- Rregullore për sasi të kufitare të substancave të reja për të cilat kërkohen teste plotësuese, lloji dhe përfshirja e testeve, si dhe metodat për testim në bazë të të cilave të dhënat e fituara për qëllimin e njëjtë nga notifikuese tjetër mund të shfrytëzohen, me qka do të transponohet masa e BE-së 31967L0548.

- Rregullore për cilësitë e substancës për të cilën mund të përdoret emri alternativ kimik, si dhe përmbajtja e kërkesës për përdorimin e emrit alternativ kimik me të cilin do të transponohet masa 32006R1907.

AUTOMJETE

GJENDJA RRJEDHËSE

Në vitin 2011 Ministria e Ekonomisë bëri plotësim të Ligjit për automjete ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 53/2011) në të cilën janë përcaktuar forma dhe përmbajtja e kërkesës dhe dokumentacionit të nevojshëm për lëshimin e lejes për licencë të vetme të automjeteve për shkak të zbatimit përkatës të Institutit "heshtja është aprovim".

PRIORITETE AFATSHKURTRA

Në vitin 2012 do të vijojë ndryshimi i Ligjit për automjete në pajtim me rekomandimet e personave juridikë për përmirësimin e tekstit të Ligjit në funksion të zbatimit më të mirë dhe më praktik dhe realizimit të versionit të konsoliduar të Direktivës 2007/46/KE, Rregullativës 1060/2008; 78/2009; 79/2009; 385/2009; 661/2009; 371/2010; 582/2010; 678/2011 dhe Direktivës 2010/19/KE

Është paraparë autorizim i personave të rinj të interesuar juridikë për kryerjen e identifikimit/notimit të gjendjes teknike të automjeteve dhe licencës individuale të automjeteve.

TEKSTILI DHE MBATHJET

GJENDJA RRJEDHËSE

Në sferën e tekstilit është bërë ndryshim dhe plotësim i Rregullores për procedurën për zgjedhjen e metodave për analizë kuantitative të përzierjeve të dy komponentëve për fibra tekstile ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 21/10), në të cilën është e transponuar Direktiva 2006/2/BE. Komisioni Europian më 3 dhjetor 2010 njoftoi se Rregullorea është tërësisht e harmonizuar me këtë Direktivë dhe Direktivën 96/73/KE.

PRIORITETE AFATSHKURTRA

Në vitin 2012 do të vijojë ndryshimi i Rregullores për procedurën për zgjedhjen e metodës për analizë kuantitative të përzierjeve dy komponentëshe të fibrave tekstile, në të cilën transponohet Direktiva 2009/121.BE për metodat e caktuara për analikomponentëshve të përzierjes nga fibrat binare të tekstilit (përkufizim të metodave për testimin për melanin).

3.01.4. QASJE E RE DHE GLOBALE E LEGJISLACIONIT PËR PRODHIME

GJENDJA RRJEDHËSE

KORNIZA JURIDIKE

Janë transponuar një pjesë e konsiderueshme e direktivave nga qasja e re dhe pason implementimi. Në vitin 2010, Ministria e Ekonomisë e miratoi Listën e standardeve konform Ligjit për siguri të prodhimeve ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 52/10). Me shpalljen e kësaj liste, numri i përgjithshëm i standardeve të EN-së si standarde të MK-së është 3268, që do të thotë se numri i nevojshëm i standardeve që i përcjellin direktivat nga qasja e re janë plotësisht të publikuara dhe të njëjtat zbatohen nga ana e sektorit privat.

Njëkohësisht në vitin 2011 u miratuan ndryshime të rregulloreve në pajtim me Ligjin për siguri të prodhimeve në të cilat rregullohet vlerësimi i përputhshmërisë së prodhimeve nga trupat e notifikuar ose të autorizuar për vlerësimin e përputhshmërisë nga vendet anëtare të BE-së që importohen në RM, nëse në RM nuk ekzistojnë trupa të autorizuar, dhe atë:

- Rregullore për ndryshimin e Rregullores për lëshimin në treg të stabilimenteve të telit të dedikuara për transportin e personave ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 113/2011);
- Rregullore për ndryshimin e Rregullores për lëshimin në treg të pajisjeve të sigurisë për ashensorë ("Gazeta Zyrtare e RM-se" nr. 113/2011);
- Rregullore për ndryshimin e Rregullores për siguri të makinave ("Gazeta Zyrtare e RM-se" nr. 113/2011);
- Rregullore për ndryshimin e Rregullores për pajisje elektroteknike të dedikuar për punën në rajon të caktuar të tensionit ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 113/2011);
- Rregullore për ndryshimin e Rregullores për pajisje transportuese nën presion ("Gazeta Zyrtare e RM-se" nr. 113/2011);
- Rregullore për ndryshimin e Rregullores për lëshimin në treg të pajisjes për mbrojtje personale ("Gazeta Zyrtare e RM-se" nr. 113/2011);
- Rregullore për ndryshimin e Rregullores për kompatibilitet elektromagnetik të pajisjes elektrike ("Gazeta Zyrtare e RM-se" nr. 113/2011);
- Rregullore për ndryshimin e Rregullores për enë të thjeshta nën presion ("Gazeta Zyrtare e RM-se" nr. 113/2011);
- Rregullore për ndryshimin e Rregullores për kërkesat për efikasitet të kaldajave të reja të ujit të nxehtë në të cilat digjen karburantet e lëngshme ose të gazta ("Gazeta Zyrtare e RM-se" nr. 113/2011)
- Rregullore për ndryshimin e Rregullores për aparate të gazit ("Gazeta Zyrtare e RM-se" nr. 113/2011);
- Rregullore për ndryshimin e Rregullores për pajisje nën presion ("Gazeta Zyrtare e RM-se" nr. 113/2011);
- Rregullore për ndryshimin e Rregullores për pajisje transportuese nën presion ("Gazeta Zyrtare e RM-se" nr. 113/2011);

Ministria e Transportit dhe Lidhjeve në vitin 2010 dhe 2011 i miratoi aktet nënligjore si vijojnë në suaza të Ligjit për siguri të prodhimeve, edhe atë:

- Rregullore për pajisje terminale telekomunikative dhe të radios ("Gazeta Zyrtare e RM-se" nr. 170/2010) nga 29 dhjetori 2010, në të cilën është e transponuar Direktiva 1999/005/KE;
- Rregullore për kërkesat esenciale për prodhimtari, plasim në treg dhe lëshim në përdorim të objekteve lundruese për rekreacion ("Gazeta Zyrtare e RM-se" nr. 6/2011) nga 17 janari 2011 në të cilën është e transponuar Direktiva 94/25/KE, e plotësuar me Direktivën 2003/44/KE. E njëjta është e dorëzuar te KE-ja për komente më 17 qershor 2011.
- Rregullore për lodra të fëmijëve ("Gazeta Zyrtare e RM-se" nr. 149/2010)
- Komisioni evropian më 7 mars 2011 i dërgoi komentet për rregulloren, sipas të cilave ME-ja përpiloi ndryshimin e rregullores dhe të njëjtën e dërgoi përmes SEP sërish në KE për miratim më 20 maj 2011. Më 19 gusht janë pranuar komentet nga KE-ja për ndryshimet e kryera të Rregullores. Në vijim është harmonizimi i ndryshimeve të reja të Rregullores me Sekretariatit për legjislacion, në pajtim me komentet e fundit nga KE-ja.

Ministria e Ekonomisë përpiloi ndryshim të Ligjit për siguri të prodhimeve në të cilin janë inkorporuar vërejtjet dhe komentet e të dy Drejtorive të përgjithshme të KE-së, Drejtorisë së përgjithshme për ndërmarrje dhe Drejtorisë së përgjithshme për konsumatorë dhe shëndetësi publike. Propozim – ndryshimet e ligjit përmes SEP deri në KE janë dërguar më 07.03.2011. Mendimi final është fituar nga ndërmarrjet e DP-së në KE 17 qershor 2011, pritet mendim nga konsumatorët e DP-së dhe shëndetësisë publike.

Me ndryshimin e Urdhëresës për procedurën për njoftimin e KE-së për miratimin e dispozitave teknike dhe të paharmonizuara, specifikimet teknike dhe standardet ("Gazeta Zyrtare e RM-se" nr. 44/2011) nga 5 prilli 2011, për shkak të harmonizimit me anëtarët të cilët kanë të bëjnë me ISRM-në për nevojat për aplikimin e tyre për anëtarësim me të drejta të plota në CEN/CENELEC. ISRM-ja për paraqitjen e kërkesës për anëtarësim me të drejta të plota në CEN/CENELEC me pikën 4.2 alinenë 6 nga Doracak 12 – Koncepti i shoqërimit me CEN/CENELEC, si vijon: „t'i njoftojë Qendrën menaxhuese CEN dhe/ose CENELEC Sekretariati qendror për të gjitha projektet nacionale dhe të zbatojnë pezullimin "Standstill" në punën nacionale në pajtim me procedurë për sigurimin e informatave në fushën e standardeve, siç është dhënë në Direktivën 98/34/BE, duhet të fillojë me njoftim para se të parashtrorë kërkesë zyrtare për anëtarësim me të drejta të plota. ISRM-ja parashtrorë kërkesë zyrtare në CEN/CENELEC në muajin dhjetor 2011.

Në suaza të projektit IPA 2008, një nga aktivitetet e ISRM-së është përkrahja në përpilimin e dokumentacionit të nevojshëm për parashtrimin e kërkesës zyrtare për anëtarësim në CEN/CENELEC.

Në suaza të Ligjit për prodhime të ndërtimtarisë ("Gazeta Zyrtare e RM-se" nr. 39/06 dhe 86/08), që është plotësisht i harmonizuar me Direktivën për prodhime të ndërtimtarisë 89/106/KE dhe Direktivën 93/68/KEE për shenjën CE, Ministria e Ekonomisë në vitin 2010 e miratoi:

1. Listën për plotësimin e Listës së standardeve nacionale maqedonase që janë pranuar, standarde të harmonizuara ("Gazeta Zyrtare e RM-se" nr. 37/2010). me këtë listë, Ministria e Ekonomisë i publikoi të gjitha standardet EN për siguri të prodhimeve të ndërtimtarisë si standarde të MK-së.

2. Këshilli i ISRM-së ka formuar shtatë grupe pune në suaza të Komitetit teknik 30 EUROKODE, në të cilat janë përfshirë përmes tridhjetë ekspertëve nga kjo sferë. Në përgatitje janë EUROKODET si vijojnë, përkatësisht:

- EN 1990-EC0 – Baza për përlllogaritjen e konstruksioneve
- EN 1991 -EC1 Veprime të konstruksioneve
- EN 1991 –EC2 Përlllogaritje të konstruksioneve të betonit
- EN 1991 –EC3 Përlllogaritje të konstruksioneve të çelikut
- EN 1991 –EC4 Përlllogaritje të konstruksioneve të mprehta nga çeliku dhe betoni.
- EN 1991 –EC5 Përlllogaritje të konstruksioneve të drurit
- EN 1991 –EC6 Përlllogaritje të konstruksioneve të ndërtimtarisë
- EN 1991 –EC7 Përlllogaritje gjeoteknike
- EN 1991 –EC8 Përlllogaritje të rezistencës sizmike të konstruksioneve
- EN 1991 –EC9 Përlllogaritje të konstruksioneve nga alumini.

Në përgatitje janë 4 (katër) Anekse nacionale të (katër) Eurokodeve dhe atë të EC0,EC1, EC 7 dhe EC 8 Planifikohet që EUKODET të miratohen deri në fund të vitit 2011.

PRIORITETE AFATSHKURTRA KORNIZA JURIDIKE

Planifikohet të miratohen akte të reja nënligjore gjatë vitit 2012:

Në kompetencë të Ministrisë së Ekonomisë

1. Urdhëresa për kornizën e përbashkët për shënimin e prodhimeve dhe notifikimin e trupave për vlerësimin e përputhshmërisë në KE, në të cilën do të transponohet Vendimi 768/2008 për kornizën e përbashkët për shënimin e prodhimeve. Me miratimin e kësaj Urdhërese do të pushojë të vlejë Urdhëri për mënyrën e shënimit (notifikimit) të trupave për vlerësimin e përputhshmërisë në KE, në të cilën transponohet Vendimi 93/465.

2. Ndryshimi i Urdhëresës për procedurën për njoftimin e KE-së për miratimin e dispozitave teknike dhe të paharmonizuara, specifikimeve teknike dhe standardeve, për shkak të harmonizimit të neneve që kanë të bëjnë me ISRM-në për nevojat për aplikimin e tyre për anëtarësim me të drejta të plota në CEN/CENELEC dhe komentet e direktivës 98/48/KE.

3. Harmonizimi i mëtutjeshëm i rregulloreve në pajtim me Ligjin për siguri të prodhimeve në pajtim me rekomandimet e fundit nga KE-ja dhe përgjigjet e Ministrisë së Ekonomisë për respektimin e rekomandimeve (rregullore për pajisjet nën presion), rregullore për enët e thjeshta nën presion, rregullore për pajisjen transportuese nën presion, rregullore për kompatibilitet elektromagnetik, rregullore për pajisje në tension të ulët, rregullore për lodra të fëmijëve etj.).

4. Ndryshimi i Ligjit për siguri të prodhimeve në pajtim me rekomandimet e Ndërmarrjeve të DP dhe Konsumatërove të DP dhe shëndetësisë publike në KE.

5. Përgatitja e eurokodeve të kërkuara nga bashkësia e biznesit për ndërtimtari.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Përforsimi i sektorit për tregun e brendshëm në Ministrinë e Ekonomisë, që është kompetent për qarkullimin e lirë të mallrave me të dy punësimet ereja.

PRIORITETE AFATMESME

Rrumbullakimi i kornizës juridike nga transpozicioni i direktivave nga qasja e re dhe globale dhe implementimi i tyre i plotë, si dhe futja e klauzolave në legjislacionin nacional për njohje të ndërsjellët të rezultateve.

VEGLAT NDIHMËSE MJEKËSORE

GJENDJA RRJEDHËSE

Në pajtim me Ligjin për barna dhe vegla ndihmëse mjekësore ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 106/07) janë miratuar aktet e domosdoshme juridike në të cilat transponohet Direktiva 93/42/KEE për vegla ndihmëse mjekësore.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Sektori për vegla ndihmëse mjekësore në Byronë për barna që është organ në përbërje të Ministrisë së Shëndetësisë, është kompetent për përpilimin dhe zbatimin e dispozitave juridike nga sfera e veglave ndihmëse mjekësore.

Në Sektorin për vegla ndihmëse mjekësore janë punësuar 4 farmaceut të diplomuar.

Infrastruktura teknike për standardizim nga sfera e veglave ndihmëse mjekësore që rregullohet me tre Direktiva evropiane (90/385/KEE; 93/42/KEE dhe 98/79/KE) përbëhet nga:

- Komiteti teknik TK 10 - Automjete për udhëtim, traktorë dhe mekanizim të ISRM-së që i miratoi standardet e lidhura me automjetet mjekësore dhe sistemet për shpëtim dhe

- Këshilli i ISRM-së që me anë të procedurës së përsheptuar i miratoi standardet tjera në lidhje me këto direktiva.

Sipas ndryshimit të fundit të këtyre Direktivave:

- prej 39 standarde të harmonizuara evropiane, 33 standarde të harmonizuara evropiane, që japin supozim për përputhshmërinë në sferën e zbatimit të Direktivës 90/385/KEE, janë miratuar si standarde maqedonase.

- prej 267 standarde të harmonizuara evropiane, 228 standarde të harmonizuara evropiane, që japin supozim për përputhshmërinë në sferën e zbatimit të Direktivës 93/42/KEE, janë miratuar si standarde maqedonase.

- prej 30 standarde të harmonizuara evropiane, 26 standarde të harmonizuara evropiane, që japin supozim për përputhshmërinë në sferën e zbatimit të Direktivës 98/79/KEE, janë miratuar si standarde maqedonase.

Në të ardhmen ekspertët nga ISRM-ja për standardizimin e përgjithshëm do t'i miratojnë standardet e harmonizuara nga këto direktiva dhe standardet e paharmonizuara nga sfera e veglave ndihmëse mjekësore.

Standardet e miratuara nga ISRM-ja janë shpallur në gazetën zyrtare në pajtim me Ligjin për barna dhe vegla ndihmëse mjekësore në vitin 2010 nga ana e Byrosë për barna.

PROCEDURA PËR VLERËSIMIN E PËRPUTHSHMËRISË

Procedura për vlerësimin e përputhshmërisë që duhet të kryehet nga trupat për përputhshmërinë për veglat ndihmëse mjekësore dhe kushtet për formimin e trupave rregullohet në aktet nënligjore. Ekzistimi i trupave në RM, varet nga mundësitë dhe nevojat që krijohen në treg.

Nga zbatimi i Ligjit për barna dhe vegla ndihmëse mjekësore dhe akteve nënligjore për vegla ndihmëse mjekësore, në RM nuk ka trup të regjistruar për vlerësimin e përputhshmërisë për vegla ndihmëse mjekësore.

Procedura për shënimin e prodhimit vendor që dedikohet për tregun e brendshëm të BE-së se kërkesat esenciale janë përmbushur për sigurinë e tij që ta kryejnë trupat notifikues që janë regjistruar në KE me numër të veçantë të regjistrimit të vendit - anëtar nga i cili rrjedh.

MBIKËQYRJA E TREGUT

Në suaza të Byrosë për barna funksionon seksioni për mbikëqyrje inspektuese që e kontrollon tregun në RM me vegla ndihmëse mjekësore.

3.01.5. MASA PROCEDURALE

GJENDJA RRJEDHËSE PROCEDURA PËR NOTIFIKIM

Procedurat për notifikim rregullohen në Urdhresën për procedurën për njoftimin e KE-së për miratimin e dispozitave teknike dhe të paharmonizuara, specifikimeve teknike dhe standardeve ("Gazeta Zyrtare e RM-se" nr. 107/2007) në të cilën transponohet Direktiva 98/34/KE, në pajtim me nenin 32 paragrafi 1 nga Ligji për sigurinë e prodhimeve.

Procedura për zbatimin e procedurave për notifikim do t'i kryejë Ministria e Ekonomisë për dispozitat teknike dhe ISRM-ja për miratimin e standardeve dhe specifikimeve teknike.

Në lidhje me procedurat për notifikim në OBT, Republika e Maqedonisë ka formuar sistemin notifikues me anëtarësimin e vet në OBT në prill 2003. Sistemi notifikues i RM-së rregullohet në Ligjin për ratifikimin e Protokollit për qasje të RM-së në OBT ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 7/2003). ISRM-ja emërohet si Trup informativ për arritjen e informatave për dispozitat teknike, standardet dhe procedurat për vlerësimin e përputhshmërisë.

PRIORITETE AFATSHKURTRA

Procedurat fillestare për notifikim, Ministria e Ekonomisë do t'i fillojë me lidhjen e Marrëveshjes AKA për njohjen e sektorëve industrial që janë lëndë e negociatave ose me aderimin e RM-së në BE, ndërsa Instituti për standardizim me anëtarësim me të drejta të plota në CEN/CENELEC.

Ministria e Ekonomisë dhe Instituti për standardizim planifikojnë që pas lidhjes së Marrëveshjes AKA të qasen në punën e Komitetit për notifikimin e dispozitave teknike në KE:

ARMËT

GJENDJA RRJEDHËSE

Në vitin 2011, u miratuan tre rregullore nga ana e Qeverisë së RM-së për implementim të Ligjit për kontrollin dhe vulosjen përkatësisht shënimin e armëve të zjarrit dhe municionit që është harmonizuar me Direktivën 91/477/KEE të ndryshuar nga ana e Direktivës 2008/51/KE, edhe atë:

- Rregullore për mënyrën e kontrollit dhe vulosjes përkatësisht shënimit të armës së zjarrit dhe municionit dhe vulës dhe shenjave të vulosjes përkatësisht shënimit ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 73/2011);
- Rregullore për formën dhe përmbajtjen e formularëve të vërtetimeve për rezultatet nga kontrollimi, vulosja dhe shënimi i armës së zjarrit dhe municionit, etiketën (banderolën) për shënimin e municionit si dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrave të kontrollimit të kryer dhe vulosjes, përkatësisht shënimit të armës së zjarrit dhe municionit ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 73/2011); dhe
- Rregullore për kushtet në aspekt të kapaciteteve materiale – teknike dhe kuadrit profesional për kryerjen e veprimtarisë së kontrollimit dhe vulosjes, përkatësisht shënimit të armës së zjarrit dhe municionit, që i përmbushin personat e autorizuar juridikë ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 73/2011).

TRASHËGIMIA KULTURORE

GJENDJA RRJEDHËSE

Në Drejtorinë për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, në vazhdimësi ndiqet gjendja e import/KEsportit të palejuar dhe futja në vende të huaja e trashëgimisë kulturore dhe merren masa preventive për reduktimin e mundësive për paraqitjen e rrezikut nga veprimet e tilla.

Në lidhje me masat horizontale të theksuara gjatë vitit 2009, të cilat kanë të bëjnë me 5 aktpaditë penale të paraqitura për tjetërsimin dhe futje ilegale të lëndëve të cilat kanë vetinë e trashëgimisë kulturore në gjykatën themelore në Kumanovë, Negotinë, Gostivar dhe Gjevgjeli, gjatë vitit 2010 janë miratuar aktgjykime të plotfuqishme gjyqësore për kryerësit e veprës. Sende të lëvizshme të marra në mënyrë joligjore me aktgjykime gjyqësore përherë konfiskohen dhe vendosen në institucionet kompetente të muzeve (gjithsej 115 sende arkeologjike, 845 monedha dhe 2 ikona).

Gjatë vitit 2010 është realizuar përpunimi operativ i "Fallangës" në të cilën janë përfshirë 26 kryerës të veprave penale kundër trashëgimisë kulturore dhe janë konfiskuar rreth 1000 sende të lëvizshme dhe arkeologjike. Procedura gjyqësore për këtë rast ka filluar dhe pritet të përfundojë gjatë vitit 2011. Ky aksion i madh operues presim në të ardhmen në mënyrë preventive të ndikojë në drejtim të reduktimit të këtij lloji të krimit.

KONTROLLI I KUFIJVE TË JASHTËM

GJENDJA RRJEDHËSE

Drejtoria doganore vazhdimisht punon në përgatitjen dhe implementimin e zgjidhjeve sistemore për lehtësimin e mëtejme dhe përshpejtimin e transportit dhe tregtisë.

Në periudhën në vijim Drejtoria doganore ishte e orientuar në harmonizimin e mëtejme me kërkesat në fushën e doganës për pranim të konventave për transit të përbashkët dhe anëtarësim në BE, analizimin e gjendjes aktuale dhe komunikimit të ndërsjellë me biznes komunitetin për përcaktimin e mundësive për thjeshtësimin e mëtejme të procedurave import eksport, reduktimin e shpenzimeve të operatorëve ekonomik, në veçanti në zbatimin e veglave informatike moderne.

KORNIZA JURIDIKE

Në këtë drejtim gjatë periudhës në vijim janë miratuar ndryshime dhe plotësime të Ligjit doganor ("Gazeta Zyrtare e RM-së nr." 48/10) me të cilat është vendosur korniza juridike për deklaratë doganore elektronike të detyrueshme dhe për dërgimin elektronik të informatave për paralajmërim të nisjes dhe mbërritjes së mallit nga dhe në rajonin doganor të RM-së.

Me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit doganor saktësisht janë përkufizuar dispozitat në lidhje me:

- procedurën për transit, deklaratat e përgjithshme doganore dhe informim paraprak për import, eksport dhe transit.
- sigurimin e borxhit doganor me mundësimin e: gamës më të gjerë të instrumenteve për sigurimin me cilësi të njëjtëpagesa e borxhit doganor në këste me sigurimin përkatës dhe zbatimin e normës së interesitfleksibilitet në kohëzgjatjen e lëshimit të mallit doganor me pagesë të prolonguar të borxhit doganor dhe fleksibilitet më i madh i pagesës së borxhit doganor;
- rregullimin e evidencës kontabiliste, afateve, rrogës dhe njoftimeve për borxh doganor të shkaktuar në baza të ndryshme.

Me ndryshimet e Ligjit për tarifë doganore është formuar korniza juridike për vendosjen e Tarifës doganore të integruar - TARIM në të cilën janë integruar të gjitha masat tarifore dhe jo tarifore, në pajtim me dispozitat aktuale në RM. Drejtoria doganore përcaktohet si administrues i TARIM.

LIDHJA DHE INTEROPERABILITETI ME SISTEMIN INFORMATIKE TË BE-së

Drejtoria doganore vazhdoi me hartimin e SOCD të ri (sistemi për përpunimin e deklaratave doganore) i cili duhet të zëvendësojë softuerin e vjetruar ACSCUDA, të mundësojë bazë teknike për mjedis pa letra në punën doganore, si dhe kompatibilitet për lidhje me sistemin informativ evropian.

Në suazat e projektit për mbështetje teknike për përmirësimin e IKT sistemeve doganore, financuar nga IPA 2007 programi, janë hartuar IKT dokumente strategjike për lidhjen e sistemit informativ doganor të shteteve anëtare të BE-së dhe Komisionin Evropian, specifikime teknike për softuerët themelorë për lidhjen e IKT sistemit doganor të BE-së, ndërsa është furnizuar edhe pajisja kompjuteristike.

Konkretisht Qeveria e RM-së miratoi:

- Strategji për zhvillim të teknologjive informatike dhe komunikuese,
- Strategji për implementimin e interoperabilitetit për anëtarësim në BE,
- Strategji për implementimin e sistemit të përbashkët transit të BE-së dhe
- Plan projekt nacional për implementimin e NCTS.

Përmes sigurimit të mjeteve në suazat e IPA 2008 fondeve, gjatë vitit 2010 është zbatuar procedura dhe është lidhur marrëveshje për punimin e softuerit për qasje në sistemin e ri doganor të kompjuterizuar të BE-NCTS1 dhe për kontroll të cilësisë.

Në shkurt dhe mars të 2011 filloi realizimi i marrëveshjes për përpunimin e NCTS dhe për mbështetje të instalimit të tij.

THJESHËSIMI DHE PËRSHPEJTIMI I PROCEDURAVE DOGANORE DHE TATIMORE

Importi për përpunim aktiv paraqet aktivitet të madh të rëndësishëm në Republikën e Maqedonisë. Për shkak të karakterit të punës që shpesh kërkon përshtatje të shpejtë ndaj porosive të partnerëve të huaj, është tepër me rëndësi shpejtësia e dërgimit dhe përpunimit dhe lëshimit të këtyre llojeve të pëlqimeve.

Për përsheptimin e këtyre procedurave është aplikimi elektronik për dhënien e pëlqimit për import për përpunim aktiv. Përmes këtij aplikimi, përpos formës në letër, operatorët ekonomikë edhe përmes internetit në faqen e Drejtorisë doganore mund të paraqesin kërkesat e tyre, me çka dukshëm reduktohet koha për administrimin e tyre dhe procedimin dhe rritet transparencja dhe kontrolli. Megjithatë forma në letër ngel e obligueshme përderisa nuk bëhen ndryshimet ligjore të cilat do të mundësojnë legjitimitetin e dokumentacionit elektronik. Gjatë mbindërtimit të aplikimeve me nënshkrim digjital, ngarkimi elektronik i importit dhe instalimi i mundësisë për aplikim elektronik dhe marrja e pëlqimeve për lloje tjera të procedurave doganore me efekt ekonomik.

Gjithashtu, Drejtoria doganore u mundëson kompanive dhe shfrytëzuesve tjerë të përdorin internet portalin e EDMS për parashtrim elektronik të kërkesave deri te Drejtoria doganore. Në këtë mënyrë, kompanitë, përpos në formë të shkruar, nga hapësirat e tyre afariste edhe në formë elektronike mund të aplikojnë deri te organet kompetente doganore, me çka e gjithë procedura për marrjen e pëlqimeve të cilat i jep Drejtoria doganore bëhet shumë më efikase. Deri në miratimin e bazës përkatëse ligjore për paraqitjen e dokumenteve në mënyrë elektronike elektronike, si dhe deri te mundësimi i përdorimit të nënshkrimit digjital, detyrimisht të parashtrohet edhe kërkesa edhe në formë të shkruar në letër.

Në rrjedhë është vendosja e nënshkrimit elektronik të kërkesave elektronike.

PËRSOSJA E SISTEMIT ELEKTRONIK NJËSPORTEL PËR LËSHIMIN E LEJEVE PËR IMPORT DHE EKSPORT DHE KUOTAVE TARIFORE-EXIM

Në mars të vitit 2011, përfundoi faza e dytë e avancimit të EXIM sistemit (shtator 2009 - mars 2011), në kuadër të përgatitjes së përfunduar të sistemit për integrimin dhe shkëmbimin e të dhënave me Sistemin për përpunimin e deklaratave doganore - SOCD. Është bërë edhe integrimi me TRACES like sistemin e Drejtorisë për Veterinari dhe janë implementuar funksione tjera, të cilat shfrytëzuesve të organeve shtetërore të sistemit u mundësojnë evidencë elektronike dhe administrim të regjistrave në kompetencë të tyre. Është bërë integrimi në procedurën e administrimit elektronik të lejeve për transport nga ana e Ministrisë për Transport dhe Lidhje dhe

evidentimi i tyre, kontrollimi i kalimeve kufitare nga Drejtoria Doganore. Si rezultat i versionit të ri, është rritur siguria e qasjes së shfrytëzuesve në sistem dhe është mundësuar operatorët ekonomikë të marrin shërbime më cilësore dhe më të shpejta.

Synimi esencial i vendosjes së sistemit njësportel është të lehtësohet dhe përshpejtohet qasja dhe këmbimi i të dhënave dhe dokumenteve përmes institucioneve kompetente, si dhe ndërmjet institucioneve dhe biznes komunitetit në përgjithësi. Konkretisht, projekti siguron kushte për parashtrim elektronik të , të gjitha të dhënave eksportuese dhe importuese vetëm një herë në një vend, gjatë çka garantohet koordinimi më efikas dhe zbatimi i kontrollit tej kufitar dhe procedurave inspektuese.

Si rezultat i progresit të Republikës së Maqedonisë në këtë fushë, Komisioni Evropian përfshiu RM-në të marrë pjesë në Grupin punues për „Single Window”. Qëllimi i grupit të punës ka qenë hartimi i specifikimit funksional në të cilën do të përkufizohen standardet e përbashkëta themelore të Bashkimit në këtë pjesë. Në bashkëpunim me SCO është hartuar edhe Studimi në të cilin do të promovohen përvojat e RM-së në zhvillimin e konceptit një sportel. Gjithashtu duhet të publikohet si pjesë e Programit "Ndihmë për tregti" („Aid for Trade”) të Organizatës Tregtare Botërore.

ROLI I INSTITUCIONALIZUAR I DREJTORISË DOGANORE PËR MBIKËQYRJE TË TREGUT

Në pajtim me Ligjin për siguri të produkteve dhe Ligjit për mbikëqyrje të tregut, në shkurt 2011 Drejtoria doganore nënshkroi Memorandum për mirëkuptim të ndërsjellë dhe bashkëpunim me organet e mbikëqyrjes të tregut, që paraqet element të rëndësishëm në vendosjen e sistemit efikas të mbikëqyrjes së tregut. Për koordinim më efikas të kontrollit të tregut dhe këmbim të lehtësuar i të dhënave dhe informatave është formuar Trupi koordinativ për mbikëqyrjen e tregut. Për aktivitetet e saj trupi informon Qeverinë e RM-së.

Në prill të vitit 2011 Drejtoria doganore miratoi Udhëzim për zbatimin e Ligjit për mbikëqyrjen e tregut me të cilën rregullohet zbatimi i Ligjit për kontroll të tregut në lidhje me zbatimin e kontrollit të produkteve të cilat futen në tregun e RM-së. Kontrollimi i produkteve të cilat futen në tregun e RM-së zbatohet nga ana e njësisë organizative e Drejtorisë doganore kompetente për lëshimin e mallrave në qarkullim të lirë, ose njësi tjera organizative të cilat kanë kompetenca për zbatimin e kontrollimit gjatë lëshimit të mallrave në qarkullim të lirë.

PROJEKTI I RI PËR VENDOSJEN E SISTEMIT UNIK ELEKTRONIK TË INTEGRUAR PËR ANALIZË TË RREZIKUT (SAR)

Gjatë vitit 2010 Qeveria e RM-së miratoi Elaboratin për instalimin e SAR në të cilin do të përfshihen të gjitha institucionet të cilat bëjnë kontrollin mbi importin dhe transitin e mallrave. SAR do të mundësojë përpunim elektronik të kritereve për analizë zë rrezikut të, të gjitha organeve inspektuese njëkohësisht, gjatë futjes së parë të , të dhënave për hyrje dhe transit të mallit në sistemin elektronik për përpunimin e deklaratave doganore. Njëkohësisht, SAR do të përshpejtojë procedurën për zbatimin e formaliteteve të nevojshme në kalimet kufitare dhe do të formojë kushte për kryerjen e „One Stop Shop“ kontrollit në një vend, nga ana e të gjitha institucioneve të cilat kryejnë kontrollim inspektues. Shkëmbimi i informatave të nevojshme ndërmjet organeve kompetente në moment të duhur, do të mundësojë rritjen e efikasitetit gjatë selektimit të qëllimeve të vërteta. Gjatë përkufizimit të proceseve të punës të organeve inspektuese lidhur me analizën e rrezikut dhe përgatitjen e specifikimit funksional.

NDËRTIMI I KALIMIT KUFITAR BLLACË (KUFIRI MAQEDONAS - KOSOVAR)

Në qershor të 2010 filloi ndërtimi i kalimit kufitar Bllacë aksi kalimtar në kufirin maqedonas - kosovar. Projekti është i financuar me kredi të Bankës Botërore në suazat e Projektit të dytë për përshpejtimin e transportit dhe tregtisë në Evropën Juglindore. Kalimi i ri, i cili do të mundësojë qarkullim më të shpejtë të automjeteve dhe pasagjerëve, do të lëshohet në funksion për 14 muaj.

LABORATORI DOGANOR

Gjatë instalimit të standardit ISO 17025, bazë për praktikë të mirë laboratorike, që është parakusht për akreditimin e laboratorit doganor, i cili gjendet në Institutin për kimi të Fakultetit matematik- natyror. Akreditimi i laboratorit doganor do të mundësojë rezultatet e analizave në laboratorët doganor të njihen ndërkombëtarisht.

Periudhën e kaluar laboratorit doganor përmes trajnimeve të specializuara punoi në perfeksionimin e test metodave të zgjedhura të publikuara në rregullativa relevante të BE-së si dhe

zbatimi i tyre praktik në pajtim me kërkesat e standardit ISO 17025 në drejtim të përgatitjes për akreditim.

PRIORITETE AFATSHKURTRA

Gjatë vitit 2012 Drejtoria doganore planifikon të punojë në zbatimin e aktiviteteve si vijon:

- Thjeshtësimi dhe përsheptimi i procedurave doganore dhe tatimore;
- Modernizimi i sistemit elektronik njësportel për lëshimin e lejeve për eksport dhe import dhe kuota tarifore - EXIM;
- Roli i institucionalizuar i Drejtorisë doganore për kontroll të tregut;
- Projekt i ri për instalimin e sistemit elektronik të integruar për analizë të rrezikut (SAR);
- Ndërtimi i kalimit kufitar Bllacë (kufiri maqedonas - kosovar);

PRIORITETE AFATMESME

Në afat të mesëm janë planifikuar këto aktivitete:

- Lidhje dhe interoperabilitet me sistemet informatike të BE-së;
- Akreditim të laboratorit doganor për plotësimin e standardit ISO 17025;
- Instalimi dhe implementimi i Sistemit të ri për përpunim të deklaratave doganore dhe dokumenteve të akcizave (SPDDDA) – zgjidhej në komizat e procedurave doganore dhe të akcizave do të sigurojë Drejtorinë doganore menaxhim me deklaratat doganore dhe dokumentet e akcizave (parashtrim, pranim, evidentim, përpunim, arkivim), kontroll të lëvizjes së mallrave të akcizave dhe këmbim të porosive elektronike në suazat e kryerjes automatike administrative të operacioneve, efikasitet në zbatimin e kontrolleve rreth detyrimeve doganore të arkëtuara dhe të kthyer, akcizave, taksave dhe detyrimeve tjera, lehtësim të tregtisë nëpërmjet qarkullimit të përsheptuar të mallrave, përmirësim të sigurisë së zinxhirit të furnizimit, në pajtim me standardet e Bashkimit Evropian dhe Organizatës Doganore Botërore.

3.02 QARKULLIMI I LIRË I PUNËTORËVE

3.02.1 QASJA NË TREGUN E PUNËS

GJENDJA RRJEDHËSE

Në drejtim të avancimit të Ligjit për punësim dhe punë të të huajve (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 70/07, 05/09, 35/10 и 148/11) gjatë vitit 2011 është propozuar dhe miratuar Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për punësim dhe punë të të huajve (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 148/2011). 148/2011). Me propozim-ligjin është vendosur instituti “heshtja është aprovim” me çka është themeluar mekanizmi i ngritjes së procedurës, nëse organi i shkallës së parë (Agjencia për punësim) në afat prej 45 ditëve nuk miraton aktvendim lidhur me kërkesën e parashtruar për fitimin e llojit përkatës të lejes së punës.

Baza qendrore për të huajt është operative me çka bëhet lidhje e ndërsjellë elektronike e institucioneve që janë të involvuara në procesin e dhënies së lejeve për punë. Baza e re e vendosur qendrore për të huajt në masë të konsiderueshme lehtëson mënyrën e punës së institucioneve të involvuara (MPJ, MPB dhe APRM) të cilat në procesin e lëshimit të lejeve për punë duhet të këmbëjnë lloj të caktuar të informatave për të huajt që kanë aplikuar për lloj të caktuar të lejes për punë.

PRIORITETE AFATSHKURTRA

Duke pasur parasysh lëvizjet e imigracionit, për vitin 2012 është planifikuar

1. Përpilimi i “Metodologjisë për vlerësim të potencialit për imigracion në Republikën e Maqedonisë” me çka vendosja e metodologjisë, Enti Shtetëror për Statistikë në periudhë të caktuar prej 2 viteve do të kryejë analizë të qëllimeve të imigracionit përkatësisht potencialit të imigracionit të popullatës.

2. Në drejtim të mënjanimit të barrierave për investim në Republikën e Maqedonisë janë përgatitur ndryshime të Ligjit për punësim dhe punë të të huajve me qëllim të lehtësimit shtesë të procedurave për fitimin e lejes për punë për të huajt në pozita të larta në kompani që janë me domethënie të madhe në Republikën e Maqedonisë, të cilat do të miratohen në periudhën e ardhshme.

PRIORITETE AFATMESME

Do të caktohet kornizë kohore indikative në lidhje me mundësimin e qasjes së shtetasve të Bashkimit Evropian në vendet e lira të punës në sektorin publik në periudhën pas aderimit të Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian pas çka do të qasemi në ndryshime të legjislacionit ekzistues në Republikën e Maqedonisë.

3.02. 2 EURES GJENDJA RRJEDHËSE

Agjencia për Punësim e Republikës së Maqedonisë në punën e vet vazhdimisht i zbaton aktivitetet në vijim, me sistem elektronik regjistrim/çregjistrim të marrëdhënies së punë në agjencinë për punësim në RM, aplikim të ISKO klasifikimit të profesioneve në evidencat që mbahen në Agjencinë për Punësim të Republikës së Maqedonisë (APRM), implementim të softuerit të shërbimeve elektronike për personat që kërkojnë punë dhe punëdhënësit nëpërmjet ueb portalit të APRM.

Klasifikimin e reviduar nacional i profesioneve (në pajtim me klasifikimin ndërkombëtar të profesioneve ISKO 2008) që është miratuar në mars 2011 nga ana e QRM-së, APRM-ja ka filluar ta shfrytëzojë në punën e përditshme.

Qendrat servimore për imigracion në Shkup dhe Manastir, si pjesë e rrjetit të qendrave në vazhdimësi i kryejnë aktivitetet e tyre rrjedhëse: mbajnë trajnime dhe këshillime për tema të caktuara, sigurojnë informata, këshilla dhe udhëzim të imigrantëve dhe kandidatëve potencial, sigurojnë informata për punë dhe studim në shtetet e jashtme, japin informata për procedurat për fitimin e vizës, punë ose leje për qëndrim, arritshmëri në s'stem'n shëndetësor dhe arsim në shtetet e jashtme dhe informata tjera të dobishme. Përvoja në këtë fushë do të aplikohet në aktivitetet e mëtutjeshme si përgatitje në EURES rrjetin.

Gjatë muajit maj 2011 janë furnizuar dy qendra të reja imigracioni në Strumicë dhe Tetovë, të cilat kah fundi i muajit qershor kanë filluar me aktivitetet e tyre.

Në suazat e programit për bashkëpunim bilateral ndërmjet MPPS dhe GIP internacional (Ministria për punë, marrëdhënie shoqërore, familje, solidaritet dhe jetë urbane në Republikën e Francës) më 30 qershor, 1 korrik 2011 është mbajtur prezantim prë EURES nga ana e misionit të ekspertëve në RM.

PRIORITETE AFATSHKURTRA

Në fillim të vitit 2012 do të fillohet me procedurat për hapjen e qendrave të reja shërbyese për imigracion.

Agjencia për punësim në Republikën e Maqedonisë do të vazhdojë me implementimin e vazhdueshëm të aktiviteteve të parapara në Planin aksional të masave dhe aktiviteteve për përgatitjen e APRM për pjesëmarrje në EURES.

PRIORITETET AFATMESME

Agjencia e punësimit e Republikës së Maqedonisë do të vazhdojë në vazhdueshmëri t'i zbatojë aktivitetet e parapara me planin aksional të masave dhe aktiviteteve për përgatitjen e APRM për pjesëmarrje në EURES.

3.02.3 KOORDINIMI I SISTEMEVE PËR SIGURIM SOCIAL

Gjendja rrjedhëse

Në Republikën e Maqedonisë në mënyrë aktive punohet në lidhjen dhe zbatimin e marrëveshjeve bilaterale për sigurim social. Gjatë vitit 2011 filluan të zbatohen këto marrëveshje:

- Më 1 prill 2011 filloi të zbatohet Marrëveshja për sigurim social me Australinë.
- Me 1 gush 2011 filloi të zbatohet Marrëveshja për sigurim social me Malin e Zi.
- Më 1 nëntor 2011 filloi të zbatohet Marrëveshja për sigurim social me Kanadanë.

Në Shkup prej 08. - 09.02.2011, u mbajtën ditë këshillëdhënëse për zbatimin e Marrëveshjes për sigurim social me theks të veçantë për zgjidhjen e çështjeve për përcaktimin e stazhit të sigurimit dhe procedurës për realizimin e të drejtës së pensionit mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë, ku morën pjesë rreth 120 persona të siguruar.

Me qëllim të avancimit të qasjes në të drejtën sociale të qytetarëve, më 18 tetor 2011 Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë organizoi tryezë të rumbullakët me temë Marrëveshjet ndërkombëtare për sigurim social ku morën pjesë përfaqësues të institucioneve kompetente, sektori joqeveritar dhe qytetarë të interesuar.

Gjatë vitit 2011 u mbajtën trajnime me temë "Ngritja e kapaciteteve dhe zhvillimi insitucional në procesin e negociatave për nënshkrimin e Marrëveshjeve për sigurim social" dhe "Trajnimi rajonal për mbrojtje sociale dhe koordinim.

Në tetor 2011 Qeveria e RM-së e shqyrtoi dhe miratoi Propozim-ligjin për pagimin e pensionit dhe kompensimeve pensionale të sigurimit të detyrueshëm financiar me sigurim kapital dhe i njëjti gjendet në procedurë të kuvendit.

Vazhdojnë aktivitetet për bashkëpunim në sferën e sigurimit social ndërmejt Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Kosovës. Më 12 prill 2011 u mbajt takim mes ministrave të punës së politikës sociale të Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Kosovës në të cilin u përcaktuan aktivitetet për zgjidhjen e çështjeve nga sfera e sigurimit pensional.

Në sferën e rregullimit bilateral të sigurimit social me vende të tjera gjatë vitit 2011 filluan negociatat për nënshkrimin e marrëveshjeve bilaterale për sigurim social me Republikën e Shqipërisë. Në periudhën prej 16-20. 05. 2011 në Shkup, delegacione të Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë i filluan negociatat për nënshkrimin e Marrëveshjes për sigurim social mes këtyre dy vendeve.

Më 14 dhe 15 nëntor 2011 disa delegacione të Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Sllovenisë mbajtën negociata për harmonizimin e dispozitave të Marrëveshjes për sigurim social me Rregullativën për koordinim të sistemeve për sigurim social 883/2004.

Në periudhën 22-24 nëntor u mbajtën negociata për nënshkrimin e Marrëveshjes administrative për zbatimin e marrëveshjes për sigurim social me Italinë. Aktivitetet për nënshkrimin sa më të shpejtë të kësaj marrëveshje janë intensifikuar.

PRIORITETE AFATSHKURTRA

Në sferën e rregullimit bilateral të sigurimit social me vende të tjera gjatë vitit 2012 do të iniciohet procedura për nënshkrimin e marrëveshjeve bilaterale për sigurim social me Sllovakinë dhe Francën.

Me Shqipërinë do të mbahet rrethi i dytë i negociatave për harmonizim të tekstit të Marrëveshjes për sigurim social.

Parashihet mbajtja e ditëve të hapura në të cilat qytetarët e interesuar do të njoftohen me zbatimin e marrëveshjesve bilaterale për sigurim social.

PRIORITETE AFATMESME

Më tremujorin e parë të vitit 2013 pritët fillimi i projektit "Përforcimi i kapaciteteve për implementim efektiv për të drejtën e BE-së në sferën e lëvizjes së lirë të punëtorëve" në kuadër të komponentit IPA 2010 I.

Në sferën e rregullimit bilateral të sigurimit social me vende të tjera gjatë vitit 2012 do të iniciohet procedura për nënshkrimin e marrëveshjeve bilaterale për sigurim social me Suedinë, Britaninë e Madhe dhe Hungarinë.

3.02.4 KARTELA EVROPIANE PËR SIGURIM SHËNDETËSOR

GJENDJA RRJEDHËSE

Kartela evropiane për sigurim shëndetësor (EHIC)

Në prill 2011 u nënshkrua Marrëveshja për shfrytëzimin e kartelës evropiane për sigurim shëndetësor (EHIC) në territorin e Republikës së Maqedonisë në takimin me përfaqësuesit e Organit lidhur me sigurimin shëndetësor të Belgjikës dhe me zbatimin prej 1 korriku 2011. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje, Fondi për Sigurim Pensional të Maqedonisë (FSPM) ka nënshkruar gjithsej shtatë marrëveshje për EHIC.

Në bazë të përvojës pozitive në zbatimin e kartelës evropiane për sigurim shëndetësor në territorin e Republikës së Maqedonisë, Fondi për sigurim shëndetësor të Maqedonisë ka ngritur iniciativë për nënshkrimin e Marrëveshjeve të tilla edhe me vendet tjera anëtare të BE-së.

PRIORITETE AFATSHKURTRA

Kartela evropiane për sigurim shëndetësor (EHIC)

1. Gjatë vitit 2012 planifikohet nënshkrimi i Marrëveshjes për shfrytëzimin e kartelës evropiane për sigurim shëndetësor në territorin e Republikës së Maqedonisë me Republikën e Rumanisë.

2. Gjithashtu planifikohet pranimi i iniciativës për nënshkrimin e Marrëveshjes me Republikën e Austrisë.

Me nënshkrimin e Marrëveshjes me këto vende, Fondi për sigurim shëndetësor i Maqedonisë do të nënshkruajë Marrëveshje për shfrytëzimin e kartelës evropiane për sigurim shëndetësor në territorin e Republikës së Maqedonisë me këto vende anëtare të BE-së me të cilat Republika e Maqedonisë ka nënshkruar Marrëveshje për sigurim social, dhe me të cilat ekziston mundësia për nënshkrimin e të njëjtës.

PRIORITETE AFATMESME

Kartela evropiane për sigurim shëndetësor (EHIC)

Varësisht nga hyrja në fuqi e marrëveshjeve për sigurim social të nënshkruara me Republikën e Hungarisë dhe Republikën e Italisë fondi për sigurim shëndetësor i Maqedonisë planifikon që në vitin 2013 ta nënshkruajë Marrëveshjen për EHIC me Hungarinë, si dhe të ngritë iniciativë për nënshkrimin e Marrëveshjes për EHIC me Italinë dhe e njëjta të nënshkruhet në vitin 2013.

GJENDJA RRJEDHËSE

Kartela evropiane për sigurim shëndetësor

Është përgatitur plani aksional i FSSHM për zbatimin e projektit, sistemi për mbrojtjes shëndetësore elektronike (SMSHE) dhe i njëjti në rrjedhë realizohet. Sipas planit të kontraktuar të Planit aksional janë lëshuar KESH për të punësuarit në FSSHM dhe për një pjesë të punëtorëve shëndetësor në qytetin e Velesit. Për punëtorët të tjerë shëndetësor të institucioneve shëndetësore janë zgjedhur dhe përpunuar të dhëna për dhënien e KSHE, derisa për të punësuarit në administratën shtetërore dhe publike, persona të papunë dhe të pasiguarur në asnjë bazë dhe pensionistë, në mënyrë intensive grumbullohen dhe përpunohen të dhënat për lëshimin e KSHE.

U miratua Ligji për ndryshimin e Ligjit për sigurim shëndetësor me të cilin rregullohet çmimi, vlera dhe mënyra se si do të kompensohen harxhimet për dhënien e KSHE. Në rrjedhë është ridizajni i sistemit informativ i FSSHM i cili përfshinë definimin e bazës së re qendrore për të dhënat, plotësimin e bazës dhe spastrimin e të dhënave për personat e siguruar dhe obliguesit për pagim të kontributeve për sigurim shëndetësor dhe centralizimin e aplikacioneve për shkak se sistemi rrjedhës punon me 30 baza shpërndarëse për të dhënat. Plotësimi i bazës për personat e siguruar në FSSHM bëhet në koordinim me këto institucione: SPIM, APRM, DPP dhe MPB.

PRIORITETE AFATSHKURTRA

Gjatë vitit 2012 do të vazhdohet me grumbullimin dhe përpunimin e kërkesave për lëshimin e KSHE në pajtim me dinamikën e vërtetuar në Planin aksional të FSSHM për vitin 2012. Të dhënat të cilat do të personalizohen do të dërgohen sipas kuartalit gjatë tërë vitit 2012 dhe në gjysmën e parë të vitit 2013.

Gjatë vitit 2012 planifikohet përfundimi i fazës së parë të ridisenjimi i sistemit informativ të FSSHM i cili i cenon bazat e të siguruarve, obliguesve tatimor për pagimin e kompensimit për sigurim shëndetësor dhe centralizimin në pjesën e aplikacioneve.

Në të gjithat institucionet shëndetësore do të mundësohet shfrytëzimi i SKSHE me funksionalitetin e saj të parë - kontrollin e kontributit pagesor për sigurim shëndetësor.

PRIORITETE AFATMESME

Varësisht nga implementimi i përshtatja e sistemeve informative shëndetësore dhe integrimi i tyre me IS të FSSHM, planifikohet gjatë vitit 2013 të fillohet me futjen e kompletit të gjerë në të dhënat e KSHE. Me këtë KSHE gradualisht do të marrë rolin e legjitimacionit shëndetësor dhe plotësisht do ta zëvendësojë atë ekzistuese.

3.03 E DREJTA E THEMELIMIT DHE LIRIA E DHËNIES SË SHËRBIMEVE

3.03.1 E DREJTA E THEMELIMIT

GJENDJA RRJEDHËSE

Në rrjedhë është zbatimi i Projektit Gijotina rregullativa - faza 3, në kuadër të cilave masat e realizuara deri tani u thjeshtuan një numër i madh i procedurave administrative përmes zvogëlimit të dokumentacionit të nevojshëm, detyrimeve dhe zbatohen procedurat e domosdoshme për fillimin e biznesit në vend.

Përfundoi Projekti sistemi një sportel - faza 2 me të cilën mundësohet themelimi i plotë i zgjidhjeve elektronike dhe përfundimi i procedurës për regjistrim në regjistrin tregtar përmes formës elektronike. U lëshuan në përdorim sistemi elektronik për regjistrimin e shoqërive tregtare duke përfshirë edhe integrimin operativ dhe funksional elektronik në bazën e të dhënave në Agjencinë e punësimit, Fondi për sigurim pensional dhe invalidor dhe Fondi për sigurim shëndetësor në sistemin një sportel, Sistemi elektronik për përcjelljen e procedurave të falimentimit, Regjistri elektronik i personave të cilët nuk mund të themelojnë dhe të menaxhojnë edhe persona të cilët janë të penguar ose të cilët kryejnë funksionet e tyre në organin, e menaxhimit të shoqërisë tregtare, Sistemi elektronik për parashtrim dhe regjistrim në regjistrin e pengës dhe sistemin elektronik për parashtrim dhe regjistrin në regjistrin e lizingut.

Në drejtim të lehtësimit të procesit për fillimin dhe udhëheqjen e biznesit në vend, si dhe mundësimin e të gjitha informacioneve të nevojshme për procedurat dhe dokumentet e nevojshme që të merren nga një vend, Qeveria e Republikës së Maqedonisë filloi me aktivitete për formimin e Sistemit një sportel për persona të juridik dhe fizik vendas dhe të huaj. Formimi i një regjistri të tillë do të mundësojë nga njëri vend të merren informatat e përkrahjes, ndërmjetësimi dhe ndihma teknike lidhur me procedurat dhe dokumentet e nevojshme për fillimin e biznesit në vend.

PRIORITETET AFATSHKURTRA

Në vitin 2012 planifikohet vazhdimi i projektit Gjilotina rregullativa - me fillimin e fazës së katërt të Gijotinës rregullativ - "Përparësi të vegjëleve", ku theksi do të vihet në thjeshtimin e kushteve për punë të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe zbatimi i aktiviteteve të parapara ligjvënëse në planin aksional për harmonizimin me direktivën për shërbime me qëllim të eliminimit të barrierave dhe thjeshtësimin e procedurave për dhënien e lejeve.

Plotësimi i planit aksional përmes analizës së rregullativës ekzistuese me qëllim të identifikimit të kërkesave të pa arsyeuara për fillimin dhe udhëheqjen e biznesit në vend dhe niveli i thjeshtësimit dhe implementimit do të vazhdojë gjatë vitit 2012.

Në kuadër të Projektit sistemi një sportel për investitor vendas dhe të huaj planifikon fillimin e realizimit të projektit i cili do të zhvillohet në dy faza. Në fazën e parë planifikohet skenimi i gjendjeve me sistemin për dhënien e lejeve dhe licenca në vend dhe të jepet propozim-vendimi për vendosmërinë organizative dhe mënyra për funksionimin e këtij sistemi.

Planifikohet shfrytëzimi i ndihmës teknike nga Programi TAIEX për vizita studimore në vendet anëtare në të cilat plotësisht është e zbatuar Direktiva për shërbime.

PRIORITETE AFATMESME

Në afat të mesëm planifikohet vendosja e "Pikës së vetme për kontakt" si dhe obligimi i direktivës për shërbime. Realizimi i Projektit sistemi një sportel për investitor vendas dhe të huaj është në drejtim të përgatitjeve për vendosjen e "Pikës së vetme të kontaktit".

3.03.2 LIRIA E DHËNIES SË SHËRBIMEVE

GJENDJA RRJEDHËSE

Plani aksional për harmonizim me Direktivën për shërbime realizohet në pajtim me dinamikën e paraparë. Janë realizuar aktivitete ligjvënëse në pjesën e thjeshtimit të procedurave për dhënien e licencave, shkurtimin e afateve dhe harxhimet gjatë nxjerrjes së tyre, implementimi i parimit "heshtja është miratim" dhe mundësimi i dhënies së shërbimeve ndërkufitare.

Ministria e Ekonomisë si koordinator i procesit për harmonizim me Direktivën për shërbime e përcjellë realizimin e Planit aksional në bazë të raporteve nga organet e drejtorisë kompetente për zbatimin e aktiviteteve të parapara.

PRIORITETE AFATSHKURTRA

Analiza për harmonizimin e legjislacionit në sektorin e shërbimeve me Direktivën 32006L0123 do të vazhdojë gjatë vitit 2012 dhe në bazë të rezultateve të analizës, do të plotësohet Planit aksional.

Planifikohet përgatitja e draft tekstit të Ligjit për shërbime në të cilin do të transponohet Direktiva 32006L0123. Me këtë ligj do të krijohet korniza juridike për harmonizim me rregullativën në sektorin e shërbimeve në vend me kërkesë të Direktivës, duke përfshirë edhe kërkesën për dhënien e shërbimeve ndërkufitare. Ekzistimi i kornizës ligjore do të mundësojë pengimin e vendosjes së pengesave të reja gjatë përgatitjes së rregullativës në të ardhmen në sektorin e shërbimeve. Ligji për shërbime do të kontribuojë për lehtësimin e procesit të realizimit të Planit aksional në zbatimin e aktiviteteve të legjislacionit për implementimin e dispozitave në kundërshtim me direktivën.

PRIORITETE AFATMESME

Në afat të mesëm planifikohet miratimi i Ligjit për shërbime. Me ligjin dhe planin aksional do të sigurohet e drejta e themelimit dhe dhënia e shërbimeve pas aderimit në BE dhe funksionit si pjesë e tregut të vetëm të BE-së.

3.03.3 SHËRBIMET POSTARE

GJENDJA RRJEDHËSE KORNIZA JURIDIKE

Baza fillestare për rregullimin e tregut të shërbimeve postare është Ligji për shërbime postare i miratuar në vitin 2010 (Gazeta Zyrtare e RM nr. 158/10). Dispozitat ligjore në pajtim me Direktivën 2008/6/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit lidhur me hapjen e mëtejme dhe vendosjen e konkurrencës në tregun e shërbimeve postare. Në bazë të këtij ligji nga ana e Agjencisë për posta janë miratuar 11 akte nënligjore të shpallura në Gazetën Zyrtare nr. 95 dhe 146 nga 2011.

Gjatë vitit 2011, Agjencia për posta ka vazhduar me aktivitete të lidhura me rregullimin e tregut të shërbimeve postare, përmes dhënies së autorizimeve për sigurimin e shërbimeve postare, mbikëqyrjen e vazhdueshme të dhënësi dhe shërbimi universal i operatorëve të tjerë në ç'rast duke i identifikuar parregullsitë në terren dhe marrjen e aktiviteteve të caktuara për nivelin e sanksionimit.

Me qëllim që të sigurohet zbatimi i rregullativës të lidhur me kualitetin e sigurimit të shërbimeve universale, në bazën e të dhënave të dorëzuara nga dhënësi i shërbimeve universale - Posta e Maqedonisë, Agjencia për Posta ka përgatitur raport për kualitetin e sigurimit të shërbimeve universale. Të dhënat janë të marra në bazë të matjes së kryer nga ana e institucionit të pavarur në periudhën tetor-dhjetor 2010.

Duke pasur parasysh përmbushjen e nevojave të shfrytëzuesve nga sigurimi i shërbimeve postare është indikator më i madh nga kualiteti i sigurimit të shërbimeve, Agjencia për posta edhe këtë vit ka realizuar hulumtimin e kënaqësisë së shfrytëzuesve përmes kompanisë së pavarur.

Ka filluar realizimi i aktiviteteve të lidhura me vendosjen e kontabilitetit të posaçëm të dhënësit në shërbimin universal, për qëllimin e të cilës Agjencia e Postave në vazhdueshmëri bashkëpunon me dhënësin e shërbimit universal dhe e përcjellë vendosjen e kontabilitetit të posaçëm.

Në fushën e çrrënjësjes së konkurrencës së pa rregullt të tregut, Agjencia e Postave ka realizuar Hulumtim të tregut të zi ilegal postar në Republikën e Maqedonisë në kuadër të Projektit "Transport i pa autorizuar dhe shpërndarje të dërgesave postare me automjete taksi dhe automjete të komunikacionit për udhëtar ndërkombëtar dhe hekurudhor" aktivitet i cili do vazhdojë edhe gjatë tërë vitit 2012.

Në vitin 2011 u realizua ndihme eksperte TAIEK në pjesën e qasjes së rrjetit postar dhe deri në shërbimet postare në kuadër të shërbimeve universale.

Të punësuarit nga Agjencia e Postave rregullisht marrin pjesë në trupat punues dhe në seancat plenare të organizuara nga ana e ERGP- Grupi Evropian për Rregullator Postar.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Ministria e transportit dhe lidhjeve është institucioni kompetent për përgatitjen e Ligjit për shërbim postar, ndërsa përgatitja e legjislacionit sekondar është në kompetencë të Agjencisë së Postave.

Mbikëqyrja mbi zbatimin e këtij ligji dhe aktet nënligjore nga ana e subjekteve të tregut e zbatojnë persona të autorizuar nga Agjencia e Postave.

PRIORITETET AFATSHKURTRA KORNIZA JURIDIKE

Në vitin 2012 është paraparë është përcjellja e mëtejshme e rregullativës evropiane dhe marrja e aktiviteteve përkatëse për nivelin e implementimit në legjislacionin vendas.

Agjencia e Postave do të vazhdojë me aktivitete të lidhura me implementimin e Ligjit për shërbime postare dhe krijimin e kushteve për hapjen e mëtejme të tregut të shërbimeve postare. Liberalizimi i plotë duhet të ndodhë në vitin 2015 periudhë e cila duhet të kontribuojë për përmirësimin e kualitetit të shërbimeve dhe krijimin e kushteve të barabarta për punë për të gjithë subjektet e interesuar.

Revizioni i lejeve ekzistuese për sigurimin e shërbimeve postare me aktet e reja nënligjore në pjesën e të drejtave dhe obligimeve të dhënësve do të jetë aktivitet të cilin Agjencia do ta realizojë në periudhën vijuese, si dhe dhënin e autorizimeve të përgjithshme të subjekteve të reja të tregut.

Mbikëqyrja e tregut të shërbimeve postare do të sigurohet në bazë të Programit vjetor në të cilin do të përfshihen të gjithë dhënësit e shërbimeve postare, si dhe kryerjen e mbikëqyrjes mbi subjektet të cilat në mënyrë jo të rregullt i kryejnë shërbimet postare, përkatësisht kryejnë shërbime pa leje paraprakisht të marrë nga Agjencia e Postave.

Përcjellja dhe kontrolli i procesit të vendosjes së sistemit për kontabilitet të posaçëm dhe alokacion të harxhimeve për dhënësin e shërbimeve postare, të filluar në vitin 2011 do të vazhdojë edhe në vitin e ardhshëm si aktivitet i cili është me domethënie të posaçme edhe për financimin e harxhimeve neto për sigurimin e shërbimeve universale.

Projekti "Transport i pa autorizuar dhe shpërndarje e dërgesave postare me automjete taksi dhe automjete të komunikacionit ndër urban dhe ndërkombëtar do të vazhdojë edhe në vitin 2012 qëllimi i të cilit do të jetë zbatimi i fushatës për ngritjen e vetëdijes publike për parregullsi dhe dëme nga shfrytëzimi i llojit të tillë të transportit dhe shpërndarjes së dërgesave postare.

Për zbatimin e legjislacionit sekondar krahas punëve të tjera parashihen edhe aktivitete të lidhura me :

- Grumbullimin e të dhënave nga të gjithë operatorët postar dhe përgatitjen e Raportit statik për lëvizjen e dërgesave postare, duke marrë parasysh edhe madhësinë e dërgesave postare, të hyrat e realizuara nga sigurimi i dërgesave postave, zhvillimi i kapaciteteve tek operatorët;

- Përcjelljen e kualitetit të sigurimit të shërbimeve universale dhe përgatitjen e raportit për kualitetin e realizuar të sigurimit të shërbimeve postare. Të dhënat do të shfaqen për matjen e kryer gjatë tërë vitit 2011. Të dhënat do të japin pasqyrim të plotë për kualitetin e sigurimit të shërbimeve dhe prej ku do të nxirren konkluzione dhe masat e parapara për përmirësimin e mëtejshëm.

- Agjencia e Postave në vazhdueshmëri edhe në vitin 2012 vazhdon me aktivitetet e saj dhe kryerjen e punëve për kujdes dhe mbrojtje të shfrytëzuesve të shërbimeve postare dhe kujdes për sigurimin e të drejtës dhe komunikime postare pa pengesë. Në pikëpamjen e procedurave të reklamimit aktivitet i planifikuar është krijimi i programit për udhëheqjen e të dhënave për ankesat e paraqitura, kundërshtimet, reklamacionet, në mënyrë të ndryshme (me telefon, elektronike, e-mail, personalisht, me shkrim me post etj) me të cilën në mënyrë precize do të shënohen të gjitha vërejtjet dhe ankesat nga ana e shfrytëzuesve të shërbimeve postare të arritura në Agjencinë e Postave.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Përforcimi i kapaciteteve të Agjencisë së Postave do të zbatohet përmes trajnimeve të vazhdueshme për ngritje plotësuese për të punësuarit dhe përmes realizimit të bashkëpunimit të rregullt me trupat rregullator të vendeve tjera.

Do të vazhdohet me aktivitete në ERGP - Grupi Evropian i Rregullatorëve Postar në pajtim me grupet e formuara të punës dhe me zbatimin e aktiviteteve të rregullta për përforcimin e vetëdijes publike për domethënie dhe rolin e agjencisë përmes ligjeratave, takimeve me përfaqësues dhe operatorë postar dhe shfrytëzues të shërbimeve postare.

Bashkëpunimi me programin TAIEX edhe më tutje do të jetë prioritet në punën e Agjencisë për posta si mundësi për përfitimin e diturisë më të madhe dhe përvojës në sigurimin e shërbimeve postare.

PRIORITETE AFATMESME

KORNIZA JURIDIKE

Ministria e Transportit dhe Lidhjeve do ta përcjellë dhe harmonizojë legjislacionin vendas me legjislacionin e Bashkimit Evropian përmes ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit për shërbime

postare, në ç'rast duke i vërtetuar qëllimet themelore dhe aktivitetet të cilat duhet të merren, ndërsa janë me domethënie strategjike për zhvillimin tregut në shërbimet postare.

Agjencia e Postave do t'i përforcojë kapacitetet e saj administrative në sektorë të ndryshëm dhe do të punojë në implementimin e plotë të rregullativës nga sfera e shërbimeve postare, do të kryejë mbikëqyrje mbi zbatimin e rregullativës nga ana e subjekteve të tregut dhe të krijojë kushte për konkurrencë efikase dhe kushte për hapje të plotë të tregut të shërbimeve postare.

3.03.4 NJOHJA E NDERSJELLË E KUALIFIKIMEVE PROFESIONALE

GJENDJA RRJEDHËSE

Pas miratimit të Ligjit për pranimin e kualifikimeve profesionale ("Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 171/10") që paraqet kornizë nacionale për miratimin e dispozitave të Direktivës 32005/36 të BE-së, filluan aktivitetet për përgatitjen e realizimit të projektit "Ndërtimi i kapaciteteve në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës në sferën e kualifikimit profesional", të financuar nga ana e Ambasadës britanike në Republikën e Maqedonisë.

Projekti filloi me implementim prej 01.08.2011 dhe i njëjti do të zgjasë deri më 31.03.2013. Qëllimi i projektit është përmes UK NARIC, të ndërtohet kapaciteti i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës me qëllim të përmirësimit të koordinimit të procesit për pranimin e kualifikimeve profesionale. Në pajtim me Memorandumin për mirëkuptim, të nënshkruar mes Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ambasadorit të Britanisë së Madhe në Republikën e Maqedonisë, rezultati i projektit do të jetë:

- Korniza organizative e definuar me role të qarta dhe përgjegjësi të institucioneve të cilat janë kompetente për pranimin e kualifikimeve profesionale;
- Kapacitete të përmirësuara dhe koordinim të grupit ndër resor për kualifikime profesionale;
- Korniza e përmirësuar juridike për përforcimin e procesit të kualifikimit profesional;
- Metodologjia për regjistrimin e profesioneve të rregullt.

Më 13.09.2011 në Shkup, u mbajt takimi i parë iniciativë i përfaqësuesve të bartësve të projektit dhe palëve të prekura të cilët do të jenë të përfshirë në procesin e pranimin të kualifikimeve profesionale, në të cilin u prezantuan obligimet të cilat dalin për Republikën e Maqedonisë, me implementimin e dispozitave nga Direktiva 2005/36 e BE-së, aktivitetet e projektit si dhe pritjet e palëve të prekura nga ky proces.

Nga ana e MASH u morën hapa për fillimin e realizimit të aktiviteteve nga projekti dhe u dorëzuan kërkesa në institucione të caktuara për nominimin e pjesëmarrësve në grupet ndër resore të këtij projekti, i cili në periudhën e ardhshme pritet të rritet në grupin e punës ndër resor për pranimin e kualifikimeve profesionale në pajtim me dispozitat e Ligjit.

PRIORITETET AFATSHKURTRA

Aktivitetet të cilat realizohen në vitin 2012, janë paraparë në pajtim me dinamikën e realizimit të projektit si dhe Ligji për pranimin e kualifikimeve profesionale ("Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 171/10").

Aktivitetet të cilat do të realizohen në kuadër të Projektit:

1. *Mars 2012* - Protokollin për punë i grupeve ndër resore të punës për kualifikimet profesionale;
2. *maj 2012* - Korniza e propozuar institucionale për kualifikime profesionale në Republikën e Maqedonisë;
3. *Qershor 2012* - Rekomandimet e propozuara për ndryshimin e Ligjit për kualifikime profesionale;
4. *Shtator 2012* - Metodologjia për regjistër i profesioneve të rregullta (procedura të definuar hyrëse, forma, nivele të qasjeve, lloje të informacioneve hyrëse, mirëmbajtje etj.)

Aktivitete të cilat realizohen në pajtim me obligimet e Ligjit për kualifikime profesionale ("Gazeta Zyrtare e RM nr. 171/10"):

1. *Mars 2012* - formimi i grupit të punës ndër resor për pranimin e kualifikimeve profesionale nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë;
2. *Qershor 2012* - Nominim i koordinimit nacional nga ana e MASH;
3. *Dhjetor 2012* - Miratimi i akteve nënligjore të cilat dalin nga ligji.

Në pajtim me paragrafin 2,3,dhe 4 të nenit 58 të këtij ligji, afati i fundit për plotësimin e këtyre aktivitete është 31.12.2012.

3.04 QARKULLIMI I LIRË I KAPITALIT

3.4.1 QARKULLIMI I KAPITALIT DHE PAGESAT

GJENDJA RRJEDHËSE

Baza fillestare për rregullimin e qarkullimit të kapitalit dhe pagesa rrjedhëse në Republikën e Maqedonisë paraqet Marrëveshje për stabilizim dhe asocim mes Republikës së Maqedonisë dhe Bashkimit Evropian të nënshkruar në vitin 2001. Në pajtim me obligimet të ndërmarra me këtë Marrëveshje, Ligji për punë devizore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 34/2001; 49/2001; 103/2001; 54/2002, 32/2003, 51/2003 81/2008, 24/11 dhe 135/11) parasheh liberalizim gradual të lëvizjes së kapitalit varësisht nga afati dhe lloji i tij.

Pikërisht, me Ligjin për punë devizore është realizuar liberalizimi i plotë i investimeve të drejtpërdrejta, kreditë komerciale dhe borxhet financiare, si dhe kreditë me afat të depozituar mbi 1 vit. Me dispozitat e Ligjit për liberalizimin e kredive financiare me afat të depozitimit më të vogël se 1 vit, obligimet e parapara që të implemendohet faza e dytë e zbatimit të SSA.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Ligjin për punë devizore e përgatit Ministria e Financave. Dispozitat nënligjore me të cilat sigurohet implementimi më efikas i ligjit i miraton Ministria e Financave, Banka Popullore dhe Komisioni për letra me vlerë. Zbatimin e Ligji për punë devizore, në kuadër të kompetencave të saj e kryen; Ministria e Financave, Inspektorati shtetëror revizor, Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë, Regjistri qendror dhe Komisioni për letra me vlerë.

PRIORITETE AFATSHKURTRA

KORNIZA JURIDIKE

Gjatë vitit 2012 pritet që Republika e Maqedonisë të hyjë në fazën e dytë të Marrëveshjes për stabilizim dhe asocim. Pas skadimit të etapës së parë të SSA, me Ligjin për punë devizore parashihet liberalizimi i plotë i punës së letrave me vlerë nga vlera dhe investimi në kompetencat nga ana e rezidentëve në vende të huaja.

Me hyrjen në fuqi në etapën e dytë të Marrëveshjes për stabilizim dhe asocim dhe ndërprerjes së vlefshmërisë së neneve të cekura në dispozitat kalimtare të Ligjit për punë devizore të cilat kanë të bëjnë me këtë shkallë më të lartë të liberalizimit, Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë do të kryejë harmonizim përkatës të akteve nënligjore në kompetencë të tij.

PRIORITETE AFATMESME

KORNIZA JURIDIKE

Pas skadimit të etapës së dytë të SSA-së, me dispozitat kalimtare të Ligjit për punë revizore parashihet liberalizimi i punëve depozitare nga ana e rezidentëve në vende të huaja.

3.04.2 SISTEMI PAGESOR

GJENDJA RRJEDHËSE

Qarkullimi pagesor në vend është përcaktuar me Ligjin për qarkullim pagesor (Gazeta Zyrtare e Republikës nr. 113/07, 22/08, 159/08, 133/09, 145/10 dhe 35/11) dhe rregullativa nënligjore e cila del nga dispozitat e këtij ligji.

Gjatë vitit 2011 vazhduan me punë grupet punuese në Këshillin Nacional për Sisteme të pagesës për implementimin e drejtimeve të veçanta strategjike nga Strategjia për zhvillim të sistemit të pagesës në Republikën e Maqedonisë (2011-2007) me të cilën identifikohen sferat në pjesën e instrumentit të pagimit. Transferet e kredisë, ngarkimet me top në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe kartelat pagesore të cilat duhet të kenë ndryshime me qëllim të afrimit drejt standardeve SEPA. Në mënyrë intensive punohet në implementimin e praktikës së projektit për vendosjen e skemës për ngarkim të drejtpërdrejtë me borxh (Direct Debit Scheme) e cila do të jetë në shtojcë të rregullave SEPA (SEPA Rulebook). Është bërë analiza e Direktivës 2007/64 për servise pagesore të tregut të brendshëm të tregut dhe është studiuar përvoja e disa bankave qendrore në vend të anëtarëve të BE-së. Gjithashtu, në bashkëpunime Bankën qendrore të Holandës u organizua konferenca e katërt për sisteme pagesore dhe sisteme për barazimin e letrave me vlerë me qëllim të anëtarëve të

grupeve të punës për çështje të lidhura me sisteme pagesore në nivelin evropian dhe nxitjen e bashkëpunimit e bankës qendrore në nivel rajonal. Janë bërë drejtime të propozim strategjisë për strategjinë e re për zhvillim të sistemit të pagimit në Republikën e Maqedonisë (2012-2016).

Ministria e Financave është kompetente për përgatitjen e Ligjit për qarkullim pagesor. Miratimi i akteve nënligjore të cilat dalin nga ky ligj është në kompetencë të Ministrisë së Financave dhe Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë. Mbikëqyrjen mbi punën e sistemit pagesor e kryen Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë. Banka Popullore i miraton edhe aktet nënligjore të cilat dalin nga Ligji për punë revizore, ndërsa miratimi i qarkullimit pagesor me vendet e huaja.

PRIORITETET AFATSHKURTRA KORNIZA JURIDIKE

Gjatë vitit 2012 është paraparë edhe përcjellja e funksionimit të qarkullimit pagesor në vend, në pajtim me Ligjin për qarkullim pagesor dhe pjesëmarrjen në përpunim të Strategjisë për zhvillim të sistemit pagesor të Republikës së Maqedonisë në vitin 2012-2016.

Me qëllim të implementimit të suksesshëm të Direktivës 2007/64 për sisteme të pagimit në tregun e brendshëm është formuar grup i punës në kuadër të BPRM-së në pajtim me rekomandimet e Analizës së kryer të Direktivës 2007/64 për servise pagesore në tregun e brendshëm, me qëllim të identifikimit të pjesëve përkatëse në Direktivë si dhe risitë të cilat dalin nga ndryshimet eventuale nga aspekti i detyrave dhe përgjegjësi të BPRM në pjesën e rregullimit dhe licencimit të institucioneve të ardhshme të pagimit. Në atë drejtim, kah fundi i vitit 2012 pritet shfrytëzimi i ndihmës teknike të siguruar përmes IPA 2010 për implementimin e Direktivës 2007/64 për sisteme të pagimit në tregun e brendshëm dhe definimin e dispozitave të Direktivave të cilat duhet të transponohen në legjislacionin vendas. Gjithashtu, planifikohet organizim i konferencës së pestë për sisteme pagesore dhe sisteme për barazimin e letrave me vlerë në bashkëpunim me Bankën qendrore të Holandës për të cilën krahas direktivës 2007/64, më gjerësisht do të përfshihen edhe tema të lidhura me infrastrukturën pagesore dhe zhvillimin e saj në nivel evropian.

Në gjysmë vjetorin e vitit 2012 pritet të fillojë zbatimi i projektit IPA "Pasqarim i nevojave juridike dhe organizative, si dhe nevoja për resurse për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë", në kuadër të cilës do të jenë të definuara edhe aktivitetet në sferën e sistemit pagesor për periudhën e ardhshme me qëllim të harmonizimit me standardet institucionale dhe kornizën operative në Sistemin evropian të bankave qendrore (ESCB) dhe Banka Qendrore Evropian.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Spektori për sistem financiar, Spektori për sistem të kontabilitetit, qarkullimi pagesor është kompetent për kornizën juridike nga sfera e sistemit pagesor, për shkak të efikasitetit në kryerjen e punëve është paraparë punësim i një personi në Sektorin e sistemit të kontabilitetit, qarkullimit pagesor dhe revizionit.

PRIORITETE AFATMESME KORNIZA JURIDIKE

Gjatë vitit 2013 planifikohet miratimi i kornizës së nevojshme ligjore për implementimin e Direktivës 2007/64 për servise pagesore në tregun e brendshëm.

3.04.3 PENGIMI I LARJES SË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

GJENDJA RRJEDHËSE

Në prill të vitit 2011, kanë hyrë në fuqi ndryshimet dhe plotësimet e ligjit për pengimin e larjes së parave dhe të ardhurave tjera nga vepra ndëshkuese dhe financimi i terrorizmit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 4/08, 57/10 dhe 35/2011), me të cilat bëhet harmonizimi me Ligjin për mbikëqyrje inspektuese, zbatohet pakoja e masave të miratuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë për përparimin e politikës ndëshkuese dhe përmirësimin e klimës së biznesit në Republikën e Maqedonisë.

Në nëntor 2011 u miratua Strategjia nacionale për luftë kundër larjes së parave dhe financimit të terrorizmit (2012-2014). Si dokument strategjik me afat të mesëm Strategjia Nacionale për luftë kundër larjes së parave dhe financimit të terrorizmit përcakton kompleksin gjithëpërfshirës të aktiviteteve të cilat duhet të realizohen nga ana e të gjitha institucioneve relevante siç janë subjektet të obliguara që të marrin masa dhe veprime për pengimin e larjes së parave dhe financimit të terrorizmit, organet e mbikëqyrjes, Drejtoria për pengimin e larjes së parave dhe financimit të terrorizmit, organet shtetërore për ndjekjen e kryerësve të veprave penale larjes së parave dhe financimit të terrorizmit. Me realizimin e aktiviteteve të planifikuara pritet përparimi i sistemit për pengimin e larjes së parave dhe financimit të terrorizmit në Republikën e Maqedonisë dhe rritjen e shkallës së efikasitetit të tij.

Për implementim efikas të komizës juridike për luftë kundër larjes së parave dhe financimit të terrorizmit, është vendosur komiza juridike të cilën në përgjithësi e përbëjnë këto trupa.

- Drejtoria për pengimin e larjes së parave dhe financimit të terrorizmit, e cila duke i kryer kompetencat e saj vepron si organ qendror kompetent për grumbullimin, përpunimin dhe dërgimin e të dhënave për qëllime të pengimit të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit;
- Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Policisë Financiare dhe Prokurori Publik për luftë kundër krimit të organizuar - organe të cilat veprojnë sipas raporteve të dërguara nga ana e Drejtorisë për qëllime të pengimit të larjeve të parave dhe financimit të terrorizmit;
- Drejtoria e Doganës - si organ i cili i përcjellë të hyrat dhe të dalat e parave të gatshme nga RM-ja, dhe
- Organet të cilat kryejnë mbikëqyrje mbi zbatimin e masave dhe veprimeve për pengimin e larjes së parave dhe financimit të terrorizmit nga ana e subjekteve: Banka Popullore, Agjencia për supervizion dhe sigurim, Komisioni për letra me vlerë, MAPAS, Drejtoria e të Hyrave Publike dhe Agjencia e Postave.

PRIORITETET AFATSHKURTRA KORNIZA JURIDIKE

FATF-ja në takimin e tij plenar në shkurt të vitit 2012 duhet t'i miratojë 40+9 të reviduar Rekomandimet për pengimin e larjes së parave dhe financimit të terrorizmit, të cilat në vitin 2013 hyjnë në fuqi dhe paraqesin bazë për zbatimin e rrethit 4^{OT} të evolucionit të sistemeve për pengimin e larjes së parave dhe financimit të terrorizmit. Sistemi për pengimin e larjes së parave dhe financimit të terrorizmit në RM duhet të jetë evaluar në kuadër të rrethit 4^{OT} të evaluimit nga ana e Komitetit Moneyval gjatë vitit 2013. Për qëllimet e prezantimit të rezultateve më të mira në procesin e evauimit është i nevojshëm që Ligji për pengimin e larjes së parave dhe financimit të terrorizmit që të jetë i harmonizuar me rekomandimet e reviduar të FATF. Duke pasur parasysh këtë është e nevojshme të përgatitet Ligji i ri për pengimin e larjeve të parave dhe financimit të terrorizmit deri në fund të vitit 2012.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Janë planifikuar trajnime të vazhdueshme dhe edukim të personave të punësuar në Drejtorinë dhe në organet tjera kompetente të cilat i parashohin masat dhe veprimet për pengimin e larjes së parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe financimit të institucioneve jo efikase.

Gjithashtu, është planifikuar ngritje e sistemit elektronik për grumbullimin e të dhënave përpunimi automatik dhe kategorizimi, analiza e rasteve dhe gjenerimi i raporteve në Drejtori. Përparimi në kapacitetet informatike duhet të mundësojë që të gjitha subjektet e angazhuara, në formë elektronike, përmes ueb aplikacionit të dërgojnë raporte për transaksione të dyshimta.

PRIORITETE AFATMESME KORNIZA JURIDIKE

Në afat të mesëm, në periudhën prej vitit 2013 deri në 2014, në pajtim me Strategjinë nacionale për luftë kundër larjes së parave dhe financimit të terrorizmit, është planifikuar:

1. Harmonizimi i rregullativës ligjore për preventivë të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit,

Ngritja plotësuese institucionale, mbajtja dhe përparimi i kapaciteteve teknike të Drejtorisë. Sistemi efikas i bashkëpunimit të ndër institucional dhe

Përforcimi i bashkëpunimit institucional, plotësim në mënyrë të rregullt të obligimeve të cilat dalin nga anëtarësimi i organizatave ndërkombëtare dhe organizimi i realizimit të rrethit të katërt të evaulimit të Komitetit Moneyval.

3.05 FURNIZIME PUBLIKE

3.05.1 PARIME TË PËRGJITHSHME

GJENDJA RRJEDHËSE

Në sferën e furnizimeve publike vazhduan aktivitetet në pikëpamjen e zhvillimit të kornizës juridike, institucionale dhe kapaciteti administrativ, masat për parandalim dhe represion të korrupsionit në furnizimet publike të parapara në Strategjinë për zhvillim të sistemit për furnizime publike në Zyrën e furnizimeve publike për periudhën 2010-2012.

Kah fundi i vitit 2011, filloi Twining projekti i partnerit gjerman ku janë paraparë më shumë aktivitete në pikëpamjen e përforcimit plotësues të sistemit të furnizimeve publike.

Është miratuar rregullorja për emërimin dhe plotësimin e Rregullores për mënyrën e shfrytëzimit të sistemit elektronik për furnizime publike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 170/2010) nga 29.12.2010 me të cilën mundësohet në procedurat që përfundojnë me e-ankandin të mundet si kriter për ndarjen e marrëveshjeve për furnizime publike të shfrytëzohet oferta më e volitshme ekonomike. Njëkohësisht kjo Rregullore harmonizohet edhe me rregullativën juridike për mbrojtjen e të dhënave personale në Republikën e Maqedonisë.

Është miratuar Rregullore e re për programin, mënyrën dhe realizimin e mbajtjes së provimit, lartësia e kompensimit, si dhe forma dhe përmbajtja e vërtetimit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 18/2011) nga ana e ministrit të Financave në shkurt të vitit 2011. Me këtë rregullore vendoset obligimi për të gjithë trajnuesit e ardhshëm dhe personat e trajnuar që t'i përcjellin ndryshimet e Ligjit për furnizime publike përmes modulit për ngritjen plotësuese të diturive ekzistuese.

Gjatë vitit 2011 është miratuar edhe Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për furnizime publike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 53/2011), i cili ka për qëllim përmirësimin e punës në Komisionin shtetëror për ankesa të furnizime publike si servis i palëve në procedurat për ndarjen e marrëveshjeve për furnizime publike.

Përforcimi i kuadrit në Zyrën e furnizime publike vazhdoi edhe gjatë vitit 2011, me të cilën numri i punësimeve të rregullta në Zyrë arrin 23 persona. Zyra i ka përpunuar dhe vërtetuar kompetencat e nevojshme dhe shkathtësitë e nëpunësve të cilët punojnë në sferën e furnizimeve publike dhe i dorëzon në Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

Në shkurt dhe mars 2011 u realizua misioni i notimit në sferën e furnizimeve publike nga ana e përfaqësuesve të SIGMA-s. Raporti nga realizimi i Misionit të vlerësimit u prezantua në tetor në prani të 70 përfaqësuesve nga ministria, organe të tjera kontraktuese dhe organizata jo qeveritare të cilat punojnë me problematikën e furnizimeve publike. Përfaqësuesit e Zyrës morën pjesë edhe në takimet e Komitetit këshillëdhënës për furnizime publike edhe për grupet e punës të KE-së me qëllim të njoftimit me tendencë të kësaj sfera në BE.

Zyra është e përfshirë në projektin rajonal të IPA-s për trajnime të trajnuesve për furnizime publike në vendet e rajonit IPA dhe Turqisë, që e realizon Qendra ndërkombëtare e trajnimit dhe Organizata ndërkombëtare e punës (ITC/ILO).

Përfaqësuesit e Zyrës për furnizime publike morën pjesë si ligjërues të katër trajnimeve për 80-pjesëmarrës (gjykatës, prokurorë publikë dhe bashkëpunëtorë profesionalë), të organizuar nga ana e Akademisë për trajnime të gjykatësve dhe prokurorëve publikë.

Në kuadër të bashkëpunimit me Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës zyra për furnizime publike në këtë periudhë ka realizuar dy trajnime për zbatimin e Ligjit për furnizime publike.

Trajnimi i kuadrit të punësuar në Zyrën për furnizime publike paraqet aktivitet të vazhdueshëm si në atë ekzistues, ashtu edhe në kuadrin e sapo pranuar. Ky trajnim është zhvilluar përmes pjesëmarrjes së seminareve, punëtorive dhe këmbimit të përvojave me ekspertë të huaj me të cilët Zyra ka të vendosur bashkëpunim.

PRIORITETET AFATSHKURTRA KORNIZA JURIDIKE

Prioritetet e Tuining projektit shfrytëzues të cilit është Zyra, do të jetë harmonizim i mëtejshëm i legjislacionit evropian, si dhe implementim i praktikave të mira në furnizimet publike të cilat i zbaton Republika Federale e Gjermanisë si vend anëtar i BE-së.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Në vitin 2012, do të realizohet Twining projekti ku janë paraparë më shumë aktivitete në pikëpamjen e përfortimit plotësues të sistemit të furnizimeve publike. Janë paraparë analiza plotësues për nevojat e të punësuarve në pikëpamjen e trajnimeve të posaçme varësisht nga specifika e vendeve të punës në të cilat punojnë.

Me qëllim të ndërtimit të vazhdueshëm të kapaciteteve të organeve kontraktuese Zyra do të fillojë me dhënien e certifikatave të nëpunësve të cilët punojnë në furnizime publike. Gjithashtu do ta sjellë kodeksin për sjelljen e nëpunësve të cilët punojnë në sferën e furnizimeve publike.

Në vitin 2012 do të realizohet faza e dytë e projektit rajonal të IPA-s për trajnime t[rajnuesve për furnizime publike në vendet e rajonit IPA dhe Turqisë, që e realizon Qendra ndërkombëtare e trajnimit dhe Organizata ndërkombëtare e punës (ITC/ILO).

Zyra për furnizime publike gjatë vitit 2012, do ta thellojë bashkëpunimin e vendosur me institucionet të cilat janë kompetente për përcjelljen e sistemeve për furnizime publike në vendet e Ballkanit jugperëndimor, me të cilën do të mundësohet këmbimi i përvojave të cilat kanë të bëjnë me procesin e integritetit në BE.

PRIORITETE AFATMESME KORNIZA JURIDIKE

Byroja në vazhdueshmëri do të bëjë përcjelljen e kornizës juridike me qëllim të përmirësimit të saj dhe në përputhje me këtë bën ndryshime konkrete dhe plotësime të akteve nënligjore ose ndërrimin e tyre me të reja.

Në periudhën e afatit të mesëm parashihet përgatitja dhe miratimi i Strategjisë nacionale për sistemin e furnizimeve publike. Në periudhën e ardhshme, do të shqyrtohet mundësia, kompetencat të bëhen të detyrueshme në sistematizim të cilat kanë njësi organizuese ose persona të detyrueshëm për zbatimin e procedurave për ndarjen e marrëveshjeve për furnizime publike.

KONCESIONET DHE PARTNERITETI PRIVAT PUBLIK

GJENDJA RRJEDHËSE

Në Republikën e Maqedonisë nocioni i koncesionit dhe llojeve të tjera të partneritetit publik, llojet, mënyra, kushtet dhe procedura për ndarjen e koncesioneve dhe llojeve të tjera të partneritetit privat publik është rregulluar me Ligjin për koncesione dhe lloje të tjera të partneritetit publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 7/08, 139/08, 64/2009 dhe 52/10).

Gjatë vitit 2011 në pajtim me sugjerimet e SIGMA-s është përgatitur tekst konzistent plotësisht i harmonizuar me legjislacionin evropian nga kjo sferë, në të cilin në mënyrë përkatëse është zbatuar Direktiva 2004/18/BE nga 31 mars 2004.

Propozim-ligji momentalisht është në procedurë të kuvendit dhe pritet miratimi i tij nga ana e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.

PRIORITETET AFATSHKURTRA KORNIZA JURIDIKE

Në vitin 2012, është paraparë miratimi i ligjit nga ana e institucionit ligjvënës dhe hyrja e tij në fuqi, në pajtim me rekomandimet dhe mendimet e SIGMA-s që të miratohen aktet nënligjore të

përcaktuara me ligjin, si dhe ligjet e posaçme nga sfera e koncesionit për shkak të harmonizimit të tyre me dispozitat e Ligjit për koncesione dhe partneritet privat publik, me qëllim të unifikimit të procedurave në këtë sferë.

Gjithashtu, në këtë periudhë planifikohet vendosja e Regjistrimit të marrëveshjeve të ndara për vendosjen e partneritetit privat publik. Regjistri i marrëveshjeve të ndara për vendosjen e partneritetit privat publik vendoset me qëllim të themelimit e bazës së vetme për të dhënat për marrëveshje të nënshkruara në këtë sferë dhe përcjellje të vazhdueshme për të njëjtat (ndryshime) deri në realizimin e tyre përfundimtar.

Do të formohet edhe Këshilli i ri për partneritet privat publik si dhe trupi përkatës i Qeverisë së RM-së në sferën e partneritetit privat publik, i cili do të kryejë promovimin e partneritetit privat publik, do të propozojë projekte për partneritet privat publik dhe do të japë iniciativë me propozime për ndryshime të dispozitave në këtë sferë.

PRIORITETE AFATMESME KORNIZA JURIDIKE

Në këtë periudhë planifikohet varësisht nga mundësitë financiare të përgatitura në zgjidhjen e softuerit për mënyrën e udhëheqjes së Regjistrimit në marrëveshjet e ndara për themelimit e partneritetit privat publik dhe përgatitjen e Udhëzimit (Doracakut) për koncesione dhe partneritet privat publik.

Propozohet përforcimi i rolit të Këshillit për partneritet privat publik i cili në pajtim me kompetencat e përcaktuara me ligjin do të ketë qasje në përgatitjen e Strategjisë për koncesione dhe partneritet privat publik.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Në periudhën afat shkurte në bashkëpunim edhe me ndihmën teknike të SIGMA-s janë planifikuar trajnime, edukime dhe këmbime të përvojave për të punësuarit në Sektorin e koncesionit dhe PPP. Si prioritete janë organizuar më shumë seminare, punëtori dhe trajnime si për të punësuarit në sektor edhe për anëtarët e komisioneve për zbatimin e procedurave për ndarjen e koncesioneve në organet e administratës shtetërore, njësitë e vetadministrimit lokal, Qyteti i Shkupit, ndërmarrjet publike, si dhe operatorë të tjerë ekonomik lidhur me marrëveshjet për koncesione/ partneriteti privat publik dhe mjetet juridike.

Me qëllim të realizimit të aktiviteteve të lartpërmendura Sektori i koncesionit dhe partneritetit privat publik do të ekipojë në mënyrë plotësuëse me kuadër të ri, në pajtim me nevojat e tyre për realizimin e rregullt të kompetencave ligjore.

3.05.2 NDARJA E MARRËVESHJEVE PUBLIKE

GJENDJA RRJEDHËSE

Rritja e transparencës në ndarjen e marrëveshjeve publike. Janë të konsiderueshme përfitimet e e-furnizimeve në pikëpamjen e rritjes së transparencës, konkurrencës dhe efikasitetit në procedura për ndarjen e marrëveshjeve për furnizime publike. Në vitin 2011 kufiri i e-furnizimeve të detyrueshme u ngrit në më së paku 70% nga vlera e plotë e vlerësuar në të gjitha marrëveshjet publike.

Në vitin 2011 vazhdoi me punë Qendra për përkrahje të dobishme. Ky sistem paraqet edhe një mënyrë të sigurimit të këshillave dhe dhënies së ndihmës në organet kontraktuese dhe operatorët ekonomik në pajtim me kompetencat ligjore në Zyrën për Furnizime Publike.

U përcaktuan kapacitetet e nevojshme dhe shkathtësitë për nëpunësit të cilët punojnë në sferën e furnizimeve publike, me qëllim të unifikimit të detyrave të punës dhe kualifikimeve të këtyre nëpunësve.

Me qëllim të sigurimit të zbatimit të unifikuar të rregullativës për furnizime publike edhe gjatë vitit 2011 vazhdoi në kontinuitet përmirësimi i dokumenteve të tenderit.

Edhe gjatë vitit 2011, Zyra me resurset e saj në mënyrë aktive ka punuar për përforcimin e kapacitetit të organeve kontraktuese përmes zbatimit të trajnimeve. Zyra ka realizuar shtat trajnime me temë: "Kapaciteti i ri i E- ankandëve". Janë trajnuar 540 pjesëmarrës në ç'rast pjesëmarrësit u informuan për mundësinë në procedurat që përfundojnë me e-ankand si kriter për ndarjen e marrëveshjes për furnizime publike që të shfrytëzohet edhe oferta më e volitshme ekonomike.

Në pikëpamjen e Planit të edukimit për vitin 2011 për organet kontraktuese dhe operatorët ekonomik në këtë periudhë u mbajtën 14 trajnime, ku morën pjesë 242 pjesëmarrës, 200 organe kontraktuese dhe 42 operatorë ekonomik. Në trajnime u përfshi edhe moduli për ndeshje të interesit dhe korrupsioni në furnizimet publike.

Bashkëpunimi me organet shtetërore si: Endi shtetëror për revizion (ESHR), Komisioni shtetëror për pengimin e korrupsionit, Komisioni për mbrojtje nga konkurrenca dhe Komisioni shtetëror për ankesa të furnizimeve publike, kishin sukses gjatë tërë vitit. U mbajt punëtori me ESHT për këmbimin e përvojave në pikëpamjen e revizionit në procedurat për ndarje të marrëveshjeve për furnizimeve publike. Gjithashtu, me sukses u mbajt punëtorja së bashku me Komisionin shtetëror për ankesa të furnizimeve publike dhe Komisioni shtetëror për pengimin e korrupsionit.

PRIORITETE AFATSHKURTRA KORNIZA JURIDIKE

Trendi i shfrytëzimit të e-furnizimeve do të kontribuojë për lehtësimin e shfrytëzimit të sistemit për furnizime publike në Republikën e Maqedonisë. Duke filluar nga 1 janari 2012 kufiri i e-furnizimeve të detyrueshme nga vlera e plotë e vlerësuar në të gjitha marrëveshjet publike do të ngritet për 100%. Me qëllim të sigurimit të vetëmbrojtjes së Sistemit të sofistikuar elektronik për furnizime publike (SEFP), si dhe për shkak ndërtimit të tij plotësues do të miratohet lista e tarifave për shfrytëzimin e tij. Do të zbatohet edhe Projekti - Portal për furnizime të vogla deri në fund të vitit 2012.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Në vitin 2012 vazhduan rregullisht trajnimet në pajtim me dinamikën e vërtetuar me Planin për edukim për furnizime publike. Do të punohet zbatimin e kompetencave të përcaktuara dhe shkathtësitë për nëpunësit të cilët punojnë në sferën e furnizimeve publike, me qëllim të unifikimit të detyrave të punës dhe kualifikimeve të këtyre nëpunësve.

Lidhur me të dhënat e statistikës dhe punës së gjykatave për rastet e korrupsionit në furnizimet publike shihni në Kapitullin 23 Jurisprudenca dhe të drejtat fundamentale; rajoni politika kundër korrupsionit.

PRIORITETE AFATMESME KORNIZA JURIDIKE

Përfitimi kryesor nga realizimi i suksesshëm i projektit Twining do të jetë përmbushja e nevojave të organeve kontraktuese dhe interesave të operatorëve ekonomik në sferën e furnizimeve publike përmes vendosjes së sistemit të qëndrueshëm dhe efikas të sistemeve për furnizime publike.

Gjithashtu në afat të mesëm do të kryhet ngritja plotësuese e dokumenteve të tenderit, doracakë, udhërrëfyes.

Lidhur me të dhënat e statistikës dhe punës së gjykatave për rastet e korrupsionit në furnizimet publike shihni më shumë në Kapitullin 23 Jurisprudenca dhe të drejtat fundamentale; rajoni politika kundër korrupsionit.

3.05.3 MJETE JURIDIKE

GJENDJA RRJEDHËSE

Në ligjin për furnizime publike të Republikës së Maqedonisë, lidhur me mbrojtjen juridike të transponuar me direktivat e Bashkimit Evropian të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen juridike në procedurën për ndarjen e marrëveshjeve për furnizime publike . 31989L0665, 31992L0013 и 32007L066.

Gjegjësisht, me Ligjin për furnizime publike formohet Komisioni Shtetëror për ankesa për furnizime publike (KSHAFP), si organ shtetëror i cili është i pavarur në punën e tij dhe ka cilësinë e personit juridik. Komisioni shtetëror është i përbërë nga kryetari dhe katër anëtarë të emëruar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë. Të njëjtit, funksionin e kryejnë në mënyrë profesionale. Për përcaktimin e mënyrës së punës dhe veprimit sipas procedurave të ankesës në procedurat e ndarjes së marrëveshjeve për furnizime publike në pajtim me ligjin, është përgatitur Rregullorja e punës së Komisionit shtetëror për ankesa për furnizime publike.

Me zgjidhjet e reja ligjore është bërë një hap kualitativ përpara në rregullimin e mbrojtjes juridike në procedurat për ndarje të marrëveshjeve për furnizime publike. Pikërisht, me formimin e komisionit shtetëror për ankesa të furnizimeve publike u siguroi baza për mbrojtje të shpejtë dhe efikase në procedura për ndarjen e marrëveshjeve për furnizime publike. Kompetencat e Komisionit shtetëror përfshijnë vendimmarrje për ligjshmërinë dhe lëshimet dhe marrjet e veprimeve si dhe për ligjshmërinë e vendimeve të miratuara në procedurat për ndarjen e marrëveshjeve për furnizime publike.

Për shkak të vendosjes së masave kundër korrupsionit dhe mekanizmave si dhe integritet në punën e Komisionit shtetëror, dhe afrimin e sistemit të mbrojtjes juridike deri në operatorët e interesuar ekonomik, të cilët vlerësojnë se janë të cenuar të drejtat e tyre në procedura të caktuara për ndarjen e marrëveshjeve për furnizime publike, por edhe njoftim të publikut të gjerë me punën e Komisionit shtetëror, funksionon ueb faqja e Komisionit shtetëror për ankesa të furnizimeve publike (www.dkzjn.gov.mk). Ueb faqja e Komisionit shtetëror administrohet me mjete personale financiare edhe nga ana e të punësuarve të Komisionit shtetëror. Ueb-faqja e Komisionit shtetëror bazohet në informacionet për punën e përditshme të Komisionit shtetëror dhe praktika e saj juridike në sferën e furnizimeve publike, si dhe në të shpallen të gjitha ankesa e arritura të bazë ditore dhe për të gjitha vendimet e miratuara pa ndërmjetësim pas përfundimit të seancës dhe ekspedicionit të tyre.

Për përforcimin e kapacitetit administrativ të shërbimit profesional të Komisionit shtetëror për ankesa të furnizimeve publike në procesimin e lëndëve të ankesave, gjatë vitit 2011, kuadri administrativ u rrit me dy punësime të reja dhe Komisioni shtetëror tani numëron 14 të punësuar. Me kuadrin e ri administrativ vazhdoi ri ekipimi i shërbimit profesional në Komisionin shtetëror për ankesa të furnizimeve publike.

PRIORITETET AFATSHKURTRA KORNIZA JURIDIKE

Do të vazhdojnë përpjekjet për afrimin e zgjidhjeve të reja ligjore në organet kontraktuese dhe në operatorët ekonomikë për sistemet e reja të mbrojtjes juridike të cilat janë të përcaktuara me Ligjin për furnizime publike.

Bashkëpunimi i mirë i Komisionit shtetëror për ankesa për furnizime publike me Zyrën për furnizime publike do të thellohet edhe në periudhën e ardhshme, në veçanti në fushën e punëve të përbashkëta në përpjekjet që të përmirësohet sistemi i mbrojtjes juridike në furnizimet publike. Bashkëpunimi do të vazhdojë edhe në fushën e punës së përbashkët të ndryshimeve dhe plotësimeve të kornizës juridike që e rregullon sistemin e mbrojtjes juridike.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Komisioni shtetëror do të vazhdojë me pjesëmarrje në punëtoritë dhe trajnimet në të cilat do të marrin pjesë organet kontraktuese dhe operatorët ekonomikë në vitin 2012 me temë mjetet juridike në procedurat për furnizime publike.

Komisioni shtetëror për ankesa të furnizimeve publike dhe shërbimi i tij profesional administrativ vazhdon me përmirësimin e kushteve për punë, para së gjithash me mjetet financiare që i kanë në dispozicion në buxhetin e tyre. Komisioni shtetëror do të vazhdojë të pajiset me pajisje më të sofistikuar kompjuterike, furnizime dhe zhvillim të zgjidhjeve softuerike.

Në këtë drejtim Komisioni shtetëror planifikon si fazë fillestare me zbatimin e DMS- Document Management System, Sistem për menaxhim me dokumente, mbledhja elektronike, e cila përfshinë punën arkivore - pranimin, regjistrimin e lëndëve në evidencën afariste, shpërndarjen e tyre deri tek përmbaruesit, përpunimin e lëndëve, vendosjet e tyre në mbledhje, përpunimin e vendimit dhe ekspeditën e vendimit. Softueri dhe hardueri tashmë është furnizuar dhe instaluar në Komisionin Shtetëror dhe pritet zbatimi i tij me periudhën e testimit të punës në gjysmën e parë të vitit, pas kësaj periudhe Komisioni shtetëror do të fillojë ta shfrytëzojë në punën e tij të rregullt.

Në drejtim të përforcimit të kapacitetit të plotë të Komisionit shtetëror për ankesa të furnizimeve publike për implementimin e kornizës vendase juridike për furnizime publike, si dhe direktivat përkatëse dhe praktikën në BE, do të vazhdojnë trajnime për anëtarët dhe këshilltarët profesional të Komisionit shtetëror për ankesa të furnizimeve publike edhe në vitin 2012 përmes pjesëmarrjes në seminare, punëtori dhe vizita të tjera studimore.

PRIORITETE AFATMESME KORNIZA JURIDIKE

Do të vijojnë risitë të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen juridike në Unionin Evropian dhe do të zbatohen në rregullativën vendase. Përparimi i mëtejshëm i mbrojtjes juridike, do të jetë prioriteti me afat të mesëm. Do të vazhdojë me trajnime në këtë sferë në bashkëpunim me Komisionin shtetëror. Përforcimi i mëtejshëm i kapaciteteve administrative të Komisionit shtetëror do të realizohet përmes punësimeve të reja të personelit administrativ në Shërbimin profesional, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e resurseve njerëzore, si dhe rritjen e mjeteve buxhetore në përgjithësi, ndërsa në veçanti në furnizimin me pajisje të Komisionit shtetëror me teknologji përkatëse informatike - komunikuese dhe softuer.

Komisioni shtetëror punon në afrimin e punës së tij me opinionin, me qëllim të afrimit deri te opinionin i gjerë dhe mirëkuptimin e rregullt të rolit të Komisionit shtetëror në sistemin e furnizimeve publike. Kjo do të realizohet edhe përmes përpunimit të Strategjisë për komunikim dhe prezantim publik të Komisionit shtetëror, pjesëmarrje në debate mediale dhe shpallje të shkrimeve gazetareske dhe shkrime të tjera me tema të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen juridike në furnizimet publike, si dhe përpunimin e përmbledhjeve periodike në miratimin e vendimeve me komente.

PËRKRAHJA E HUAJ

Përmes IPA 2008 janë siguruar mjete për realizimin e Projektit për përkrahjen e sistemit të furnizimeve publike për përfundimin e mëtejshëm të kapaciteteve të Komisionit shtetëror që ka filluar me realizim në qershor 2011 dhe do të zgjasë deri në fund të marsit 2012. Qëllimet e projektit janë përkrahja e Komisionit shtetëror dhe janë në drejtim të: 1. Rritjes së kapaciteteve të Komisionit shtetëror, përmes përpunimit të trajnimeve, planeve dhe programeve për të punësuarit në Komisionin shtetëror, përmirësimin e dispozitave ekzistuese duke i përfshirë edhe aktet e brendshme të Komisionit shtetëror me rekomandime për përmirësimin e mekanizmave operative, dhe organizimin e vizitës studimore në institucion të ngjashëm për mbrojtje juridike në furnizimet publike në ndonjë shtet të Bashkimit Evropian. 2. Përforcimit të kapaciteteve profesionale të sistemit nacional për mbrojtje juridike, përgatitet edhe dërgimi i trajnimeve dhe seminareve për opinionin e gjerë, duke i përfshirë edhe organet kontraktuese dhe operatorët ekonomik rreth mundësive dhe mënyrës për realizimin e mbrojtjes juridike, si dhe përgatitjen e analizës së aktgjykimeve gjyqësore të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në procedurat për furnizime publike dhe shpalljen e tyre publike në ueb faqen e Komisionit shtetëror, dhe 3. Fushatës për rritjen e vetëdijes për mbrojtje juridike në furnizimet publike, përmes përpunimit dhe shtypjes së broshurave, fletushkave etj, përmirësimin e përmbajtjes së ueb faqes së Komisionit shtetëror, përpunimin e Doracakut për mbrojtje juridike në furnizimet publike dhe mbajtjen e konferencave për promovimin e aktiviteteve të Komisionit shtetëror.

3.06 E DREJTA E SHOQËRIVE TREGTARE

3.06.1 E DREJTA E SHOQËRIVE TREGTARE

GJENDJA RRJEDHËSE KORNIZA JURIDIKE

Në vitin 2011 me miratimin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shoqëri tregtare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 24/11) bëhet harmonizimi i plotë me Deklaratën 32003L0058, për shkak të vendosjes së plotë të kornizës juridike për rregullim elektronik të kërkesave dhe propozimeve për kërkesën e regjistrimit të shoqërive tregtare përmes internetit. Janë realizuar obligimet për vërtetim të noterisë në marrëveshjet për shoqëri dhe nënshkrimet për përfaqësuesit (drejtorët) e shoqërive kur të njëjtat dërgohen përmes formës elektronike dhe bëhet shkurtimi i mëtejshëm i afateve të procedurës për likuiditet vullnetar të shoqërive tregtare. Me këtë ligj bëhet edhe saktësimi plotësues i një anëtarit të Direktivës 32007L0036 për realizimin e të drejtës së aksionarëve të asamblesë aksionare në shoqëritë tregtare aksionet e të cilës kotojnë në bursë dhe me Direktivën 32005L0056 për bashkëngjitje tej kufitare të shoqërive tregtare.

U miratua Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sistemin njësportel ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/2011). Ligji për harmonizim me Direktivën 32003L0058 për udhëheqjen e regjistrimit tregtar dhe regjistri i personave të tjerë juridik që të mundësohet regjistrimi i plotë elektronik i shoqërive tregtare me shfrytëzimin e internetit dhe regjistrimit elektronik me certifikatë digjitale.

Me miratimin e Ligjit për grupe ekonomike evropiane ku transponohet Rregullativa 31985R2137 për Grupe ekonomike të interesit evropian (Gazeta Zyrtare nr. 158/2011). Qëllimi i vendit që të rumbullakohet procesi i harmonizimit të Acquis evropiane për lëvizjen tej kufitare të shoqërive tregtare. Ligji për grupe ekonomike të interesit evropian do të hyjë në fuqi në ditën e anëtarësimit të plotë të Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Komisioni kompetent për sferën E drejta e shoqërive tregtare është Ministria e Ekonomisë. Sektori për punë juridike në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë e përcjellë implementimin dhe avancimin e kornizës juridike për shoqëritë tregtare dhe sistemin njësportel përmes të cilit shoqëritë tregtare i realizojnë obligimet për zbardhjen e dokumenteve në regjistrin tregtar dhe regjistrin e llogarive vjetore.

Regjistri qendror me sistemin njësportel paraqet pikë kyçe për këmbimin e të dhënave përmes formës elektronike me institucione të tjera dhe organe të përfshira në procedurën e regjistrimit të shoqërive tregtare dhe zbardhjen e të dhënave të tjera financiare dhe të dhëna afariste në pajtim me ligjin (Drejtoria e të hyrave publike, bankat afariste, shtëpia e Kliringut – sistemet interbankare të kliringut, Depozitari qendror për letra me vlerë, Bursa e Maqedonisë për letra me vlerë, Komisioni për letra me vlerë, lizing dhe shoqëritë e sigurimeve dhe noterët). Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë është anëtar aktiv i Regjistrimit evropian të biznesit.

PRIORITETE AFATSHKURTRA

KORNIZA JURIDIKE

Në vitin 2012 do të miratohet Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shoqëritë tregtare i cili do të harmonizohet me Direktivën 32007L0063 lidhur me kërkesën për përgatitjen e raportit të ekspertit të pavarur në rast të bashkimit, ndarjes së shoqërive tregtare publike me përgjegjësi të kufizuar, Direktiva 32006L0068 për themelimin e shoqërive publike me përgjegjësi të kufizuar, ndryshimet dhe ruajtjen e kryegjësë së tyre. Në ligj do të harmonizohen edhe nenet nga Direktiva e shtatë 31983L0349 për kushtet për përgatitjen e llogarive të konsoliduara.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Do të implementohet Projekti Metabazë për implementim të Strategjisë për standardin XBRL në Republikën e Maqedonisë, që praktikisht domethënë Interoperabilitet mes Regjistrimit qendror të Republikës së Maqedonisë, Komisionit për letra me vlerë, Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, Bursës së Maqedonisë dhe Depozitarit Qendror për letra me vlerë.

PRIORITETE AFATMESME

KORNIZA JURIDIKE

Do të zbatohet Rekomandimi 32005H0162 dhe Rekomandimi 32004H0913 për përmirësimin e menaxhimit korporativ në kodekset ekzistuese për menaxhim më të mirë kooperativ.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Do të vijojë funksioni i Sistemit njësportel faza III në Republikën e Maqedonisë.

3.06.2 KONTABILITETI DHE REVIZIONI

KONTABILITETI

GJENDJA RRJEDHËSE

KORNIZA JURIDIKE

Në vitin 2011 u miratua Rregullorja për format dhe përmbajtjen e llogarisë vjetore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 52/2011), me të cilin si element të ri të llogarisë vjetore përcaktohen vërejtje sqaruese. Gjithashtu në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë" numër 107/2011 u shpall standardi ndërkombëtar për paralajmërim financiar për subjekte të vogla dhe të mesme (IFRS for SMEs), si pjesë përbërëse e Rregullores së kontabilitetit. Zbatimi i standardit është nga 1 janari 2012.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Ministria e Financave, Sektori i sistemit financiar, përkatësisht Sektori për sistem të kontabilitetit, qarkullimi i pagesës dhe revizioni me pesë të punësuar është kompetent për kornizën juridike dhe aktet tjera juridike të rëndësishme për sistemin e kontabilitetit dhe për harmonizimin e legjislacionit të Maqedonisë me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Korniza institucionale i përfshinë (në pajtim me Ligjin për shoqëri tregtare): Regjistri qendror dhe Drejtoria e të Hyrave Publike. Në pajtim me ligjet të cilat i rregullon kjo materie, në rrjetin institucional për këtë aktivitet janë të përfshirë edhe këto institucione: Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë, Agjencia për supervizion të sigurimit, Agjencia për supervizion për sigurim me financim kapital pensional dhe Komisioni për letra me vlerë.

PRIORITETE AFATSHKURTRA KORNIZA JURIDIKE

Ministria e Financave ka përgatitur Propozim-ligj për kryerjen e punëve të kontabilitetit. Me propozim-ligjin përcaktohet kryerja e punëve të kontabilitetit, kushtet për kryerjen e punëve të kontabilitetit, subjektet të cilat kryejnë punë kontabilitetit, kushtet për dhënien e provimit profesional për kontabilitet dhe kontabilist të autorizuar. Me këtë propozim-ligj jepet mundësia për formimin e Institutit të kontabilitetit dhe kontabilistëve të autorizuar të Republikës së Maqedonisë dhe rregullohet kompetenca e tij, organizimi dhe puna. Propozohet që mbikëqyrjen e punës së Institutit ta kryejë Ministria e Financave.

Në pajtim me dispozitat e propozuara Instituti i kontabilitetit dhe kontabilistët e autorizuar të Republikës së Maqedonisë duhet të themelohet deri në fund të vitit 2012.

Për shkak të zbatimit të dispozitave të Propozim-ligjit, Ministria e Financave në periudhën prej një viti nga miratimi i Ligjit për kryerjen e punëve të kontabilitetit do të japë vërtetime për kontabilist dhe vërtetimi për kontabilist të autorizuar. Ministria vërtetimet do t'i japë në bazë të plotësimit të kriterëve të arsimit dhe numrin e plotë të përvojës në udhëheqjen e kontabilitetit.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Ministria e Financave, Sektori për sistem financiar, përkatësisht Sektori për sistem të kontabilitetit, qarkullimi pagesor dhe revizioni është kompetencë për kornizën juridike të sistemit të kontabilitetit.

PRIORITETE AFATMESME KORNIZA JURIDIKE

Në pajtim me nevojat do të kryhet harmonizimi i mëtejme i kornizës nacionale juridike për informim financiar me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Ministria e Financave në pajtim me Ligjin për kryerjen e punëve të kontabilitetit do të japë vërtetime për kontabilist dhe vërtetimi për kontabilist të autorizuar deri në organizimin e provimit të parë për kontabilist përkatësisht kontabilist të autorizuar nga ana e Institutit të kontabilistëve dhe kontabilistë të Republikës së Maqedonisë.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Në pjesën e kontabilitetit Ministria e Financave e Republikës së Maqedonisë, Sektori për sistem financiar, përkatësisht Sektori për sistem të kontabilitetit, qarkullimi pagesor dhe revizioni do të mbetet kompetent për kornizën juridike për sistemin e kontabilitetit dhe për harmonizimin e mëtejme të legjislacionit nacional me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Korniza institucionale do t'i përfshijë (në pajtim me Ligjin për shoqëri tregtare): të gjitha shoqëritë tregtare, Regjistrin qendror; Drejtorinë e të Hyrave Publike; Komisionin e letrave me vlerë dhe kompanitë për konsultim ekonomik, juridik dhe financiar. Në pajtim me ligjet të cilat e rregullojnë këtë materie, në rrjetin institucional për këtë aktivitet janë përfshirë edhe këto institucione: Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë, Agjencia për supervizion të sigurimit, Agjencia për supervizion për sigurim me financim kapital pensional si dhe Komisioni për standardet ndërkombëtare të kontabilitetit në institucionin për revizorë të autorizuar.

REVIZIONI

GJENDJA RRJEDHËSE KORNIZA JURIDIKE

Në pjesën e revizionit gjatë vitit 2011 me propozim të Institutit të revizorëve të autorizuar (IRARM), Ministria e Financave ka lëshuar një aktvendim për kryerjen e punëve të revizionit të

shoqërive për revizion dhe një aktvendim për kryerjen e punëve për revizion të revizorit të autorizuar - tregtar individual në pajtim me dispozitat kalimtare të Ligjit për revizion (në rrjedhë është procedura për dhënien e 2 lejeve për punë për shoqërinë e revizionit, në pajtim me dispozitat kalimtare).

Gjatë vitit 2011 Instituti i revizorëve të autorizuar të Republikës së Maqedonisë. (IRARM) ka realizuar dy provime për arritjen e titullit revizor i autorizuar dhe tetë persona të cilët e kanë dhënë provimin, ministri i Financave u ka dhënë vërtetim për arritjen e titullit revizor i autorizuar (në rrjedhë është procedura për dhënin e 3 vërtetimeve për revizorë të autorizuar, në pajtim me dispozitat kalimtare).

Në periudhën prej qershorit deri në dhjetor 2011 u mbajtën trajnime për shkak të përsosmërisë të vazhduar profesionale me kohëzgjatje prej 65 orë.

Në qershor 2011 IRARM ka përgatitur: Raport për kontrollin e zbatuar të kualitetit të shërbimeve revizore. Në korrik IRARM e miratoi Planin vjetor për kontrollin e kualitetit për vitin 2011 dhe gjatë muajit gusht kanë filluar kontrollet për kontrollin e kualitetit. Gjithashtu gjatë vitit 2011 IRARM e miratoi : Planin vjetor për punën e IRARM-së për vitin 2011, Planin financiar të IRARM-së për vitin 2011 dhe Raportin vjetor për punën e IRARM-së për vitin 2010. Gjatë vitit 2011 IRARM-ja ka shqiptuar masa disiplinore të një shoqërie për revizion të një individi të autorizuar revizor-individual dhe tridhjetë e gjashtë revizorë të autorizuar.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Ministria e Financave, Sektori i sistemit financiar, përkatësisht Sektori për sistem të kontabilitetit, qarkullimi i pagesës dhe revizioni me pesë të punësuar është kompetent për kornizën juridike dhe aktet tjera juridike të rëndësishme për sistemin e revizionit dhe për harmonizimin e legjislacionit të Maqedonisë me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

PRIORITETE AFATSHKURTRA

KORNIZA JURIDIKE

Në pajtim me Ligjin për revizion, Këshill për përparimin dhe mbikëqyrjen e revizionit do t'i miratojë edhe aktet e parapara për punën e tij. IRARM do t'i harmonizojë aktet e veta në pajtim me dispozitat e ligjit të ri.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Ministria e Financave, Sektori për sistem financiar, përkatësisht Sektori për sistem të kontabilitetit, qarkullimi pagesor dhe revizioni do të jetë kompetent për kornizën juridike nga sfera e revizionit dhe për shkak të efikasitetit më të madh në realizimin e detyrave është paraparë përforcimi i Sektorit të sistemit të kontabilitetit, qarkullimi pagesor dhe revizioni me punësime të reja (për punësimet në shumë në Kapitullin 9 Shërbime financiare).

Në pjesën e revizionit, në pajtim me Ligjin për revizion, Qeveria e Republikës së Maqedonisë miraton Vendim me të cilin do të vendoset Këshilli për përparimin dhe mbikëqyrjen e revizionit si trup i pavarur, me autorizimet publike. Në këshillin për përparimin dhe mbikëqyrjen e revizionit për shkak të realizimit të punëve teknike administrative të lidhura me punën e tij janë paraparë punësime.

Gjatë vitit 2012, IRARM do të realizojë më shumë aktivitete të rregullta: Realizimi i provimeve për arritjen e titullit revizor, mbajtja e trajnimeve për përsosmëri profesionale, kryerja e kontrollit të kualitetit për vitin 2012. Gjatë vitit 2012, Instituti i revizorëve të autorizuar të Republikës së Maqedonisë planifikon të punësojë edhe kontrollorin e dytë të kualitetit.

PRIORITETE AFATMESME

KORNIZA JURIDIKE

Në pjesën e revizionit, do të vazhdojë edhe harmonizimi i mëtejshëm i Ligjit për revizion me Direktivën 32006L0043.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Në pjesën e revizionit, Ministria e Financave e Republikës së Maqedonisë, përkatësisht Sektori i sistemit të kontabilitetit, qarkullimi pagesor dhe revizioni në kuadër të Sektorit për sistem financiar do të mbetet kompetent për kornizën juridike për sistemin e revizionit si dhe për harmonizimin e mëtejshëm të legjislacionit nacional me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Do të përforcohet Sektori i sistemit të kontabilitetit, qarkullimit pagesor dhe revizionit me pesë persona të rinj (për punësimet më shumë në kapitullin 9 - shërbime financiare).

Për shkak të rritjes së efikasitetit në realizimin e detyrave do të punësohen pesë persona të rinj në Këshillin për avancimin dhe mbikëqyrjen e revizionit.

Do të ndërtohet kapaciteti i Institutit për revizion të autorizuar me punësime të reja, por gjithashtu edhe për institucionet më të mëdha rregullator (Komisioni për letra me vlerë, Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë, Agjencia për supervizion të sigurimit (ASS), MAPAS etj) të cilat e përcjellin zbatimin e Standardeve ndërkombëtare për informim financiar (SNIF) përkatësisht kujdesen për zbardhjen në kohë dhe të plotë për të dhënat financiare të përgatitura në pajtim me SNIF.

3.07 E DREJTA E PRONËSISË INTELEKTUALE

3.07.1 TË DREJTAT AUTORIALE DHE TË DREJTAT E NGJASHME

GJENDJA RRJEDHËSE **KORNIZA JURIDIKE**

Ka pasur plotësim të Ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtave të ngjashme (LDADN), që u shpall në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 51 të 13.04.2011- për shkak harmonizimit horizontal për të gjitha ligjet me ndryshim përkatës dhe plotësim të ligjit për procedurë të përgjithshme administrative - vendosjen e procedurës për miratimin e aktit juridik (të ashtuquajtur) "heshtja e administratës". Në bazë të këtij plotësimi të ligjit u miratua edhe Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e kërkesës për miratimin e vendimeve për dhënien e lejes për menaxhim kolektiv për të drejtat e autorit dhe të drejtave të ngjashme ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 104/11).

Qeveria e Republikës së Maqedonisë e miratoi Vendimin për lartësinë e kompensimit të vetëm nga shumimi i shfrytëzimit privat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 151/11).

Qeveria e Republikës së Maqedonisë me Vendim emëron kryetar dhe anëtar të Komisionit për ndërmjetësimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të ngjashme ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 106/11).

Ministria e Kulturës formon Grup pune për përpunimin e metodologjisë për vlerësimin e të drejtave të autorit dhe të drejtat e ngjashme, programi për trajnimin dhe realizimin e provimit profesional për vlerësues, për shkak të realizimit të Ligjit për vlerësim.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Në sektorin për të drejta e autorit dhe të drejtat e ngjashme në vitin 2011 ende ka vetëm katër (4) nëpunës shtetërorë.

Komisioni për ndërmjetësim për të drejtat e autorit dhe të drejtat e ngjashme tashmë ka mbajtur (5) mbledhje dhe në pajtim me Ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e ngjashme dhe Rregulloren jep mendim për Propozim-tarifën e shfrytëzimit të veprave muzikore të autorit të SHMDMA (Shoqëria e mbrojtjes e të drejtave muzikore dhe të autorit), (Organizata e vetme për menaxhim kolektiv - MK) dhe mban procedurë për ndërmjetësim (mediatim) për nënshkrimin e marrëveshjeve për ri emitim kabllovik (Marrëveshje e përgjithshme e licencuar dhe Marrëveshje të licencuar) mes SHMDMA (në emër për llogarinë e: CISAK - asocimi ndërkombëtar i organizimit të MK të autorëve dhe kompozitorëve, EBU - asociacioni i servisit publik i radiodifuzionit, AXHIKOA - asociacioni ndërkombëtar i MK për bartës të drejtave të veprave audiovizuele dhe VG - Asociimi medial i televizioneve private satelitore në Evropë) dhe katër (4) operatorë kabllovik nga Maqedonia.

Në kuadër të përkrahjes së organizatave për menaxhim kolektiv në zbatimin e SHMDMA-s, Ministria e Kulturës (MK) për Shoqërinë e mbrojtjes muzikore për të drejtat e autorit "SHMDA" - Shkup (SHMDA) ia lëshoi ose i dha leje për menaxhim kolektiv (MK) (Vendim i shpallur në "Gazetën Zyrtare të RM " nr. 65/11). Gjithashtu SHMDA i miratoi dhe i shpalli, në pajtim me ligjin rregulloret e tij: për shfrytëzimin me Tarifa dhe për shpërndarje të kompensimeve të autorit (të shpallura në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 154/11).

Kërkesa për leje të MK-së për drejtat e artistëve - realizues të Shoqërisë së MK-së për të drejtat e ngjashme të artistëve realizues nga Republika e Maqedonisë KOMIP, Shkup në procedurën juridike u refuzua.

Ueb faqen e MK për DADN (www.copyright.gov.mk) si pjesë e ueb faqes integrale të MK-së plotësohet me rrjedhat përkatëse dhe përmbajtjet e domosdoshme, si aktivitet i vazhdueshëm.

PRIORITETE AFATSHKURTRA KORNIZA JURIDIKE

MK do të emërtojë trup të posaçëm për DADN nga ekspertë të shquar, të pavarur dhe të jashtëm.

MK do të vazhdojë me participim në përpunimin e ligjit të ri për veprimtari të radiodifuzionit, si dhe për participim në përpunimin e shkresave të tjera të lidhura me DADN -në.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Në pajtim me kompetencat, do të vazhdohet me përkrahjen e themelimit të organizatave për menaxhim kolektiv, ndërsa puna e SHDMA-s ekzistuese, së paku një herë në vit kontrollohet.

Do t'i vihet kujdes programit përkatës për informimin dhe organizimin e opinionit më të ngushtë profesional (përmes Projektit TAIEKS për zbatimin e Ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e ngjashme), si dhe opinionit më i gjerë i të drejtave të autorit dhe të drejtave të ngjashme.

MK vazhdoi me implementimin e obligimeve të Ligjit për vlerësim - për zbatimin e programit për trajnime dhe për zbatimin e provimit profesional për vlerësuar.

PRIORITETE AFATMESME 2013-2014 KORNIZA JURIDIKE

Do të përcillet zbatimi i LDADN

Do të përcillen trendet ndërkombëtare të DADN -së dhe dispozitat në nivel të BE-së dhe asociacione të tjera ndërkombëtare dhe analiza të mundësive për nivelin e transponimit të legjislacionit vendas, si dhe do të iniciohen ndryshimet e mëtejme dhe plotësimet e dispozitave që janë në lidhje me LDADN.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Sektori për SHDMA në afat të mesëm deri në vitin 2014 duhet t'i përforcojë së paku tetë 8 - 10 nëpunës shtetërorë të kualifikuar dhe trajnuar.

Do të vazhdojë përkrahja e shoqërive kolektive në pajtim me kompetencat dhe mundësitë e MK.

Do të vazhdojë aktivitetet për përforcimin e vetëdijes publike, informimi dhe arsimi i opinionit për DADN.

Do të organizohen aktivitete të vazhdueshme për aftësimin profesional dhe përsosjen e kuadrove nga Sektori i DADN në MK, por edhe në organe të tjera shtetërore.

3.07.2 TË DREJTA TË PRONËSISË INDUSTRIALE

GJENDJA RRJEDHËSE

KORNIZË JURIDIKE

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e miratoi **Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pronësi industriale** ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 24/11).

Ndryshimet janë në drejtim të harmonizimit horizontal të Ligjit për pronësi industriale me Ligjin për cilësi të produkteve bujqësore, me çka konstatohet mbrojtje e titujve gjeografik që kanë të bëjnë me produktet bujqësore. Një prej ndryshimeve më të rëndësishme që parashikohen me Ligjin është dhënia e mundësisë së Inspektorit Tregtar Shtetëror gjatë zbatimit të mbikëqyrjes në lidhje qarkullimin e të drejtave të mbrojtura të pronësisë industriale menjëherë t'i merr produktet me të cilën është kryer cenim i të drejtës së mbrojtur nga pronësia industriale dhe të dorëzojë në gjykatën kompetente. Poashtu me Ligjin instalohet mundësi për barazim para ngritjes së procedurës për kundërvajtje.

Me qëllim të lehtësimit të procedurës për njohjen e patentave, Kuvendi miratoi **Ligjin për ratifikim të Marrëveshjes për zbatimin të nenit 65 të Konventës Evropiane për Patenta – Marrëveshja e Londrës** ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 132/11) me të cilën përmes lehtësimit të regjimit të përkthimit, në mënyrë të konsiderueshme zvogëlohen shpenzimet për përkthim të patentave evropiane. Me regjimin e ri gjuhësor kërkesat për patenta janë gjithmonë të arritshme në gjuhën zyrtare të shtetit në të cilin patenta evropiane është e regjistruar, derisa shkresat e patentave nuk janë të nevojshme (përveç në rast të kontestit në lidhje me patentën evropiane).

Është miratuar **Ligji për plotësimin e Ligjit për mbrojtje të topografisë së qarqe integrale** ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 136/2011) për shkak të vendosjes së institutit "heshtja është miratim", çka paraqet harmonizim horizontal me Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Në Entin shtetëror për pronësi industriale (ESHPI) janë punësuar gjithsej 32 nëpunës shtetërorë, në 4 sektorë dhe 13 seksione.

Përfaqësues prej ESHPI në mënyrë aktive kanë marrë pjesë në punën e Organizatës Botërore për pronësi intelektuale (OBPI) dhe Organizata Evropiane për Patenta (OEP). Të punësuarit nga ESHPI kanë marrë pjesë në 5 seminare, 2 konferenca, 3 panaire, 4 trajnime dhe 1 kongres.

Në përputhje me Planin aksional për bashkëpunim bilateral me Organizatën Evropiane për Patenta (OEP) gjatë vitit 2011 janë organizuar katër seminare: për domethënien e të drejtave nga pronësia intelektuale dhe janë botuar katër publikime.

Nëpërmjet Akademisë Evropiane për Patenta (AEP), në suazat e bashkëpunimit me OEP, përfaqësues të ESHPI kanë marrë pjesë në tre seminare dhe një punëtori.

Duke pasur parasysh rëndësinë e ngritjes së vetëdijes publik për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale, ESHPI ka ndërmarrë aktivitete të rregullta të lidhura me përforcimin e vetëdijes publike: 4 ligjerata për 80 studentë në Fakultetin Juridik "Justiniani Parë" dhe trajnim prej dy ditëve të studentëve në ESHPI; mbështetje dhe pjesëmarrje në dy manifestime dhe në tre panaire në drejtim të stimulimit dhe afirmimit të zbulimeve; shënim të Ditës së shenjtë të pronësisë intelektuale nëpërmjet librit "Masa për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale në shtetet e Ballkanit Perëndimor", publikim të porosisë së drejtorit të përgjithshëm të OBPI në ueb faqen e ESHPI dhe nëpërmjet mjeteve për informim publik; zbatim të aksionit për shkatërrim publik të produkteve të konfiskuara, nga ana e Trupit koordinues për pronësi intelektuale (TKPI) dhe pjesëmarrje në Konferencën për pronësi intelektuale.

Në Ekspozitën Ndërkombëtare nr. 31 të shpikjeve, avancimeve teknike, produkteve të reja dhe krijimtarisë së të rinjve MAKINOVA-EKONOVA 2011, ESHPI nëpërmjet përfaqësuesve të vet, anëtarë të Komisionit Vlerësues Ndërkombëtar ka ndarë shpërblime për patentë të paraqitur ose të mbrojtur dhe për inovator të ri.

Me qëllim të promovojnë shpikjen maqedonase në suaza ndërkombëtare, në Ekspozitën Ndërkombëtare të ideve, shpikjeve, produkteve të reja - IENA 2011, janë prezantuar pesë shpikje të inovatorëve maqedonas, të cilëve u janë ndarë medalje e argjendit dhe bronz nga gjuria profesionale ndërkombëtare dhe numër i madh i shpërblimeve speciale nga asociacionet dhe

shoqatat nga fusha e zbulimit. ESHPI për pjesëmarrjen dhe kontributin e vet në promovimin e zbulimeve për herë të dytë fitoi diplomë nga Enti Turk për Patenta.

Më 22 dhjetor është mbajtur manifestim tradicional "Patentë e vitit".

Në suazat e aktiviteteve të Ministrisë për ekonomi, në janar 2011 janë miratuar:

Programi për implementim të politikës industriale në Republikën e Maqedonisë për vitin 2011 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 3/11), me të cilën janë siguruar mjete buxhetore për mbështetje të subjekteve afariste me kompensim të pjesës së shpenzimeve për punësim të hulumtuesve të rinj dhe për komercializim të inovacioneve të patentuara dhe Programi për zhvillim të sipërmarrësisë, konkurrencës dhe inovativitetit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në vitin 2011 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 3/11), me të cilën janë siguruar mjete buxhetore për mbështetje të subjekteve afariste me kompensim të pjesës së shpenzimeve për parashtrim të paraqitjes ndërkombëtare për patentë, përkatësisht kërkesë për kontrollim të plotë të paraqitjes.

Më tetor 2011, në Manastir, në organizim të Agjencisë për mbështetje të sipërmarrësisë në Republikën e Maqedonisë (AMSRM) dhe Enti Shtetëror për pronësi industriale, ka mbajtur seminar: "Mbështetje të inovativitetit dhe konkurrencës së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe mbrojtje të të drejtave të pronësisë intelektuale", ndërkaq në dhjetor në organizim të AMSRM - seminar për mbrojtjen e produkteve bujqësore dhe ushqimore me patenta për cilësi (patentë e mbrojtur e origjinës, patentë gjeografike dhe patentë për specialitet të garantuar tradicional) të produkteve bujqësore dhe ushqimore, si dhe përparësitë që i ofrojnë këto patenta si mundësi për rritje të konkurrencës dhe shpikjes në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Përfaqësues të ESHPI kanë marrë pjesë dhe kanë pasur prezantime në takimin e rregullt të Trupit Këshilldhënës të Drejtorisë doganore, dhomave ekonomike dhe asociacioneve tjera; në takimin e Grupit teknik për të drejtat e pronësisë intelektuale në Iniciativën e Venecias për bashkëpunim të administratave doganore nga Ballkani Perëndimor dhe Turqia.

ESHPI ka marrë pjesë edhe në koordinimin e aktiviteteve në të gjitha institucionet e përfshira në zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.

PRIORITETE AFATSHKURTRA KORNIZA JURIDIKE

Në mënyrë të vazhdueshme do të përcillen ndryshimet në direktivat evropiane dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

Ministria e ekonomisë do të përpilojë Metodologji për vlerësim të të drejtave të pronësisë industriale, programi për trajnim dhe për zbatim të provimit profesional të vlerësuesve, për shkak të zbatimit të Ligjit për vlerësim.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Për përforsim të kapacitetit të ESHPI në vitin 2012 do të punësohen persona të rinj dhe do të vazhdojë në kontinuitet përsosja profesionale e të punësuarve.

Trajnimi i të punësuarve në ESHPI dhe të subjekteve tjera të sistemit për mbrojtje, do të realizohet nëpërmjet seminareve nacionale dhe rajonale, qëndrimeve studimore dhe aktivitete tjera nëpërmjet bashkëpunimit me OBPI, OEP, AEP dhe bashkëpunim tjetër bilateral.

ESHPI do të vazhdojë me zbatimin e aktiviteteve të rregullta përforsimin e vetëdijes publike për domethënien e pronësisë industriale (ligjërata, takime me përfaqësues të ekonomisë në nivel komunal, organizim të manifestimeve, pjesëmarrje në panaire, ekspozita dhe ngjashëm).

Në suazat e bashkëpunimit të ESHPI dhe OEP do të zbatohet Plani aksional për bashkëpunim (2010-2012).

Do të zbatohet Programi për bashkëpunim me OBPI.

Do të miratohet Program për zhvillim të sipërmarrësish, konkurrencës dhe krijimtarisë së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në vitin 2012, me të cilin do të sigurohet mbështetje e subjekteve afariste me kompensim të pjesës së shpenzimeve për parashtrim të paraqitjes për patentë, përkatësisht kërkesë për kontrollim të plotë të paraqitjes.

Drejtoria doganore do të ndërmerr aktivitete për sigurim të mjeteve financiare për realizim të fushatës publike për ngritjen e vetëdijes për pasojat e dëmshme mbi shëndetin nga përdorimi dhe shfrytëzimi i produkteve të falsifikuara, veçanërisht të popullata më e re. Propozim-programi për realizim të fushatës është në fazë përfundimtare të përgatitjes.

PRIORITETE AFATMESME KORNIZË JURIDIKE

Do të ratifikohet Marrëveshja e Najrobot për mbrojtje të Simboleve Olimpikë.

Në mënyrë të vazhdueshme do të përcillen ndryshimet në direktivat evropiane dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

KORNIZË INSTITUCIONALE

Në ESHPI do të punësohen persona të rinj në vitin 2012 dhe 2013. Njëkohësisht do të mbahet niveli i gatishmërisë teknike, do të vazhdohet me trajnimin e të punësuarve në ESHPI dhe subjektet tjera të përfshira në sistemin e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale.

ESHPI do të vazhdojë me zbatimin e aktiviteteve të rregullta përpërforcimin e vetëdijes publike për domethënien e pronësisë industriale (ligjerata, takime me përfaqësues të ekonomisë, organizim të manifestimeve, pjesëmarrje në panaire, ekspozita dhe ngjashëm).

Do të vazhdojë të zbatohet bashkëpunimi me Organizatën Evropiane për Patenta dhe me Organizatën Botërore për pronësi intelektuale.

3.7.3 ZBATIMI

GJENDJA RRJEDHËSE

KORNIZË JURIDIKE

Në suazat e masave që janë përfshirë në Strategjinë për pronësi intelektuale në vitin 2012 është përgatitur dhe miratuar Informatë për zbatim të aktiviteteve nga Strategjia për pronësi intelektuale në pajtim me Planin aksional për periudhën prill-dhjetor 2010.

Në janar është miratuar Statuti i ri i Akademisë për gjyqtarë dhe prokurorë publik (AGJPP) (G. zyrtare e RM-së nr.12/11), ndërkaq më prill 2011 edhe aktet tjera nënligjore – rregullore me të cilat më afër rregullohen segmente të caktuara nga puna e Akademisë.

Ministria për Drejtësi ka miratuar Programin për dhënien e provimit profesional për ekspert në fushën e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale, në pajtim me nenin 11 paragrafi 3 të Ligjit për ekspertizë.

Drejtoria doganore e Republikës së Maqedonisë miratoi Strategji për mbrojtje të të drejtave të pronësisë intelektuale 2011-2013 dhe Plan aksional për zbatim të Strategjisë për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Më qershor është miratuar Rregullore për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për zbatim të Ligjit për masa doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale (G. zyrtare e RM-së nr.82/11) me të cilën janë abroguar kompensimet e përcaktuara për përpunim të kërkesës për ndërmarrje të veprimeve doganore dhe për përpunim të kërkesës për vazhdim të afatit të kërkesës për ndërmarrje të veprimeve doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Më tetor është miratuar Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për masa doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale (G. Zyrtare e RM-së nr. 135/11) me të cilën saktësohen obligimet e bartësve të së drejtës, mosrealizimi i të cilës ka pasojë, pezullim të vendimit për pranim të kërkesës për ndërmarrje të veprimeve doganore dhe humbje të së drejtës të parashtrohet kërkesë e re në afat prej një viti nga dita e vendimit të plotfuqishëm për shfuqizim.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Ministria e ekonomisë miratoi Programin për mbrojtjen e konsumatorëve për periudhën 2011-2012 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 3/11), në bazë të nenit 123 të Ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve. Në suazat e Programit, në vitin 2011, janë realizuar fushata mediale në 3 qytete (Strumicë, Kërçovë dhe Prilep) në temën "Ngritja e vetëdijes së konsumatorëve për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve gjatë përdorimit të produkteve të falsifikuara dhe të piraterisë me të cilat cenohen të drejtat e pronësisë industriale, të drejtat autoriale dhe të drejtat e ngjashme".

Akademia për gjyqtarë dhe prokurorë publikë në kornizat e Programit për trajnim fillestar të gjeneratës së katërt të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë publik, ka organizuar ligjërata në fushën e zbatimit të së drejtave të pronësisë intelektuale në kohëzgjatje prej 8 orëve mësimdhënëse në mësimdhënien teorike dhe trajnimin praktik në gjykatat dhe prokuroritë. Në suazat e trajnimit të vazhdueshëm, gjatë vitit 2012, Akademia realizoi 15 trajnime nga fusha e të drejtave të pronësisë intelektuale për 302 pjesëmarrës prej të cilëve 283 pjesëmarrës nga jurisprudenca: 176 gjyqtarë, 70 prokurorë publik, 29 këshilltar/bashkëpunëtor gjyqësor, 10 këshilltar/bashkëpunëtor profesional të prokurorive dhe 17 pjesëmarrës të institucioneve tjera – 6 përfaqësues prej **DPI**, 8 përfaqësues të **CU** RM, 1 përfaqësues të ESHPI dhe përfaqësues të Këshillit për radiodifuzion. Prej 15 trajnimeve të përmendura, një është zbatuar si "Trajnim I trajnuesve për drejtat e pronësisë intelektuale" – nivel I avancuar, në të cilën morrën pjesë 13 pjesëmarrës (10 gjyqtarë dhe 3 prokurorë publik). Një prej trajnimeve të trajnuara, Akademia realizoi me ndihmë të huaj nëpërmjet IPA Programit rajonal për drejtat e pronësisë intelektuale. Në dhjetor është mbajtur Konferenca nacionale për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, në të cilën morrën pjesë 55 përfaqësues prej të gjitha institucioneve të përfshira në mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale, prej të cilave 33 gjyqtarë, 3 bashkëpunëtorë gjyqësor dhe 6 prokurorë publik.

Në Inspektoratin Tregtar Shtetëror në vitin 2011 janë punësuar 5 persona.

Drejtoria doganore ka vendosur portal të jashtëm për parashtrim elektronik të kërkesave për ndërmarrje të veprimeve doganore në sistemin EDMS, si bazë e të dhënave të kërkesave të pranuar që është vendosur në intranet portalin e Drejtorisë doganore për përdorim intern dhe këmbim të informatave ndërmejt njësisive organizative.

Trupi koordinues për pronësi intelektuale (TKPI), si bartës kryesor i aktiviteteve në luftën kundër falsifikimeve dhe piraterisë zbatoi gjithsej nëntë aksione të koordinuara dhe dy aksione publike për shkatërrim të produkteve të konfiskuara me të cilat cenohen të drejtat e pronësisë intelektuale, pas procedurave të përfunduara gjyqësore. Në pajtim me Programin operativ për luftë kundër piraterisë dhe falsifikimit, TKPI në vitin 2011 filloi me aktivitete promovuese përpërforcimin e vetëdijes publike për domethënien e beneficioneve nga mbrojtja e të drejtave të pronësisë intelektuale nëpërmjet organizimit të tribunave publike edukative në komunat më të mëdha në Republikën e Maqedonisë. Janë mbajtur dy tribune në Kumanovë dhe në Shkup për më shumë se 100 pjesëmarrës.

Përfaqësues të TKPI kanë mbajtur prezantime në Universitetin American College; kanë marrë pjesë në trajnim seminarin për identifikim të markave tregtare në organizim të SNB-REAKT U.A., dhe në seminar për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale të organizuar nga Drejtoria Doganore e Republikës së Maqedonisë në bashkëpunim me Shërbimin doganor të Holandës.

Përfaqësues nga Inspektorati Shtetëror I Tregut kanë marrë pjesë në "Konferencë për pronësi intelektuale", të organizuar nga Dhoma Ekonomike Amerikane, në "Seminar për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale" të organizuar nga Drejtoria doganore dhe në seminar për "Mbrojtje juridiko-kundërvajtëse të të drejtave të pronësisë industriale" të organizuar nga Akademia për trajnim të gjyqtarëve dhe prokurorëve publik.

Është miratuar dokumenti projektit për pronësi intelektuale (fuqizim të kapaciteteve për zbatim efikas të të drejtave të pronësisë intelektuale), IPA 2011 Komponenti 1.

PRIORITETE AFATSHKURTRA

KORNIZA JURIDIKE

Në vitin 2012 do të përgatitet revizion I Planit aksional për zbatimin e Strategjisë për pronësi intelektuale dhe do të miratohet Plani aksional i reviduar.

Poashtu do të miratohet Metodologji për përcjellje statistikore dhe përpunim statistikor të të dhënave për zbatim të të drejtave të pronësisë intelektuale dhe të fillojë të implementohet.

Koordinues i aktiviteteve për përgatitje dhe implementim të Metodologjisë për përcjellje statistikore dhe përpunim statistikor të të dhënave për zbatim të të drejtave të pronësisë intelektuale është Ministria e drejtësisë.

Drejtoria doganore do të përgatisë ndryshime dhe plotësime të reja të Ligjit për masa doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale me të cilat do të saktësohen obligimet e bartësve të të drejtave për dërgimin e të dhënave të lidhura me mallrat origjinal (para se gjithash për vlerën e prodhimit të origjinaleve), do të përcaktohet afat konkret në të cilin bartësit e të drejtës do të jenë të obliguar të zbatojnë shkatërrim të mallit për të cilin Drejtoria doganore në procedurë më të thjeshtë ka miratuar leje për shkatërrim, ndërkaq njëkohësisht cenon të drejtën e pronësisë intelektuale, si dhe do të përcaktojë të drejtën e Drejtorisë doganore pas skadimit të afatit të caktuar për shkatërrim vet të zbatojë procedurë për shkatërrim të mallit konkret, ndërkaq shpenzimet për shkatërrim të jenë në kuriz të bartësit të së drejtës. Njëkohësisht, në bashkëpunim me Minsitrinë e drejtësisë të kryejë revidim edhe të politikës ndëshkimore të vendosur me këtë ligj, me mundësi të futjes së përgjegjësisë për kundërvajtje për personat që kanë paraqitur për hyrje, dalje ose tranzit të mallrave që cenojnë të drejtë të pronësisë intelektuale.

Në mënyrë përkatëse me miratimin e ndryshimeve ligjore, Drejtoria doganore do të përgatisë ndryshime dhe plotësime të Rregullores për aplikim të Ligjit për masa doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale, ndërkaq veçanërisht në formularin e Kërkesës për ndërmarrje të veprimeve doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Do të vazhdohet me trajnim të të punësuarve në institucionet e përfshira në sistemin e zbatimit të të drejtave dhe do të vazhdojnë trajnime të specializuara të gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë nga fusha e pronësisë intelektuale.

Drejtoria doganore në kornizat e procedurë për blerje të softuerit të ri për përpunim të deklaratve doganore dhe dokumenteve të akcizave SPDDDA, parasheh aplikacion të ri për evridentim të konfiskimeve në bazë të cenimit të të drejtave të pronësisë intelektuale, ndërkaq me vënien në funksion të këtij aplikacioni në mënyrë të konsiderueshme do të avancohet sistemi i mbajtjes së evidencës së kërkesave të pranuar për ndërmarrjen e veprimeve doganore dhe mallrave të mbajtura për të cilat ekziston dyshim se cenojnë të drejtën e pronësisë intelektuale.

Ndërtimi i sistemit të mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale do të vazhdojë të realizohet nëpërmjet zbatimit të Programit të TKPI, me çka do të rritet efikasiteti në realizimin e të drejtave. Aktivitetet e TKPI dhe të institucioneve tjera në zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale do të fokusohen në eliminimin e falsifikateve dhe piraterisë.

Me qëllim të eliminimit më efikas të falsifikateve dhe piraterisë, ESHPI parashtroi tre TAIEKS paraqitje për nevojat e Trupit koordinues për pronësi intelektuale: TAIEX punëtori “Krim i organizuar në fushën e pronësisë intelektuale”, TAIEX misioni ekspertëve: “Luftë kundër ilaçeve të falsifikuara si lëndë e përndjekjes penale” dhe TAIEX qëndrim studimor: “Mbrojtje e pronësisë intelektuale nga cenimi nëpërmjet internetit”.

Do të zbatohen aktivitete përgatitëse për realizim të IPA 2011 Komponenti 1, për fuqizim të kapaciteteve të institucioneve për zbatim efikas të të drejtave të pronësisë intelektuale.

Mbrojtja e të drejtave të pronësisë intelektuale edhe në periudhën e ardhshme do të jetë prioritet në punën e Inspektoratit Shtetëror Tregtar dhe do të vazhdojë të realizohet me intensitet të zmadhuar, në bazë të Programit vjetor dhe Aktiviteteve të planifikuara operative.

Në suazat e Programit për mbrojtjen e konsumatorëve 2011-2012, të Ministrisë së ekonomisë, për vitin 2012 është paraparë promovim i broshurave dhe materialeve tjera promovuese për të drejtat e konsumatorëve në pajtim me legjislacionin nga fusha e mbrojtjes së konsumatorëve. Në suazat e programit është paraparë edhe përpunim i materialit promovues për të drejtat e pronësisë intelektuale.

Në dhjetor 2012 Qeveria do të miratojë Programin për mbrojtjen e konsumatorëve për periudhën 2013-2014.

Akademia për gjyqtarë dhe prokurorë publikë gjatë vitit 2012 në kornizat e trajnimit fillestar të gjeneratës së pestë të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë publik, në pjesën e ligjëratave teorike do të realizojë ligjëratat nga fusha e zbatimit të të drejtave të pronësisë intelektuale.

Në kornizat e trajnimit të specializuar të gjyqtarëve dhe prokurorëve publik nga sfera e pronësisë intelektuale, gjatë vitit 2012, janë paraparë Konferenca rajonale për zbatim përkatësisht mbrojtje të pronësisë intelektuale që do të organizohet në bashkëpunim edhe me mbështetje financiare të partnerit të huaj (UNECE - Komisioni Ekonomik i KB për Evropën) dhe 6 trajnime, me gjithsej 200 pjesëmarrës, në organizim të pavarur të Akademisë.

Në suazat e trajnimit të vazhdueshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve publik, do të mbahet Seminar rajonal nga fusha e të drejtës së patentës që do të realizohet në bashkëpunim edhe me mbështetje financiare të Akademisë Evropiane të Patentave.

PRIORITETE AFATMESME KORNIZA JURIDIKE

Do të përcillen tendencat ndërkombëtare në zbatimin e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale.

Do të miratohet Strategji për pronësi intelektuale (2013-2016) dhe do të fillojë implementimi i Strategjisë në pajtim me Planin aksional.

Drejtoria doganore pas miratimit të rregullativës së re për masa doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale, që do të zëvendësojë rregullativën ekzistuese 1383 prej 2003, do të bëhet harmonizim i Ligjit për masa doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale. Poashtu Komisioni Evropian do të miratojë rregullativë të re për aplikim të masave doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale, që do të zëvendësojë rregullativën ekzistuese 1891 prej 2004, do të harmonizohet Rregullorja për aplikim të ligjit për masa doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Në vazhdueshmëri do të përforcohen kapacitetet teknike dhe kadrovike të institucioneve nëpërmjet punësimeve të reja, furnizim të pajisjes së domosdoshme teknike dhe trajnime të vazhdueshme të subjekteve që janë të përfshira në zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Do të zbatohet Programi për mbrojtjen e konsumatorëve për periudhën 2013-2014.

Do të fillojë realizimi i IPA 2011 Komponenti 1, për fuqizim të kapaciteteve të institucioneve për zbatim efikas të të drejtave të pronësisë intelektuale.

Akademia për gjyqtarë dhe prokurorë publikë, do të vazhdojë me realizim të programit për të drejtat e pronësisë intelektuale në pjesën e trajnimit fillestar të trajnimit të vazhdueshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve, përcjellje të risive, ndryshimeve në të gjitha ligjet lidhur me të drejtat e pronësisë intelektuale dhe përcjellje të standardeve evropiane dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale. Akademia do të përgatisë dhe do të botojë doracak për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.

3.08 POLITIKA E KONKURENCËS

3.08.1 ANTITRUSTE DUKE PËRFSHIRË EDHE BASHKIMET

GJENDJA RRJEDHËSE

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, (në tekstin e mëtejshëm: KMK) në vitin 2011 i miratoi Udhëzimet në vijim:

1. Udhëzime për mënyrën e përpilimit të versionit të pabesueshëm të aktvendimeve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (aktvendime të cilat nuk përmbajnë të dhëna të cilat paraqesin sekret afarist) , (shkurt, viti 2011), të harmonizuara me Udhëzimet e DGJ për Konkurrencën për pjesë tregtare në versione të pabesueshme të aktvendimeve për koncentrim (11 dhjetor 2008)

2. Udhëzime për definimin e tregut relevant për qëllimet e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (maj 2011), të harmonizuara me masat e BE 31997Y1209 (01).

3. Udhëzime për kufizimet e ndërlidhura drejtpërdrejt dhe të domosdoshme për realizimin e koncentrimin (nëntor 2011), të harmonizuara me masën e BE 52005XC0305(02).

KORNIZA INSTITUCIONALE

Prej numrit të përgjithshëm të të punësuarve në shërbimin profesional të KMK i cili është 19 nëpunës shtetërorë, në zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës punojnë 6 persona. Gjatë vitit 2011, një pjesë e tyre merret pjesë në më shumë trajnime, punëtori dhe konferenca, duke i përfshirë edhe seminarët në organizim të Qendrës Rajonale për konkurrencë, me seli në Budapest të Hungarisë.

Në vitin 2011, KMK miratoi 2 (dy) aktvendime për përcaktimin e ekzistimit të kontratës së ndaluar/praktikës kontraktuese (të dyja të miratuara në procedurë administrative), 5 (pesë) aktvendime për keqpërdorimin e pozitës dominuese (të gjitha të miratuara në procedurë kundërvajtëse) dhe 14 (katërmëdhjetë) aktvendime për vlerësimin e koncentrimin të ndërmarrjeve (të gjitha të miratuara në procedurë administrative).

KMK, gjatë realizimit të kompetencave të veta vazhdoi të realizojë bashkëpunim të ngushtë me trupat tjerë rregullatorë, veçanërisht me Komisionin Rregullator për Energjetikë, me Këshillin për Radiodifuzion, me Agjencinë për Komunikime Elektronike, si edhe me Byronë për Furnizime Publike, a në përputhje me memorandumet e nënshkruar për bashkëpunim.

PRIORITETE AFATSHKURTRA KORNIZA JURIDIKE

"Në tremujorin e parë të vitit 2012 do të miratohen 9 dekretet në vijim, të cilat rrjedhin nga Ligji për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" me numër 145/10 dhe 136/11) edhe atë:

1. Dekreti për kushtet më të afërme për përjashtimin grupor të llojeve të caktuar të kontratave për transferimin e teknologjisë , për licenca ose për know-how, me të cilën do të transponohet rregullativa 32004R0772 e BE;

2. Dekreti për kushtet më të afërme për përjashtimin grupor të llojeve të caktuar të kontratave për hulumtim dhe zhvillim, me të cilën do të transponohet rregullativa 32010R1217 e BE;

3. Dekreti për kushtet më të afërme për përjashtimin grupor të llojeve të caktuar të kontratave horizontale për specializim, me të cilat do të transponohet rregullativa 32010R1218 e BE;

4. Dekreti për përjashtimin grupor të llojeve të caktuar të kontratave për sigurimi, me të cilat do të transponohet rregullativa 32010R0267 e BE;

5. Dekreti për përjashtimin grupor të llojeve të caktuar të kontratave për distribucionin dhe servisimin e automjeteve, me të cilat do të transponohet rregullativa 32010R0461 e BE;

6. Dekreti për përjashtimin grupor të llojeve të caktuar të kontratave vertikale, me të cilat do të transponohet rregullativa 32010R0330 e BE;

7. Dekreti për formën dhe përmbajtjen e njoftimit për koncentrimin dhe për dokumentacionin e duhur i cili parashtrohet së bashku me njoftimin, me të cilin do të transponohet rregullativa 32004R0802 e BE;

8. Dekret për kushtet më të afërta për kontrata me rëndësi të vogël (*de minimis*), me të cilin do të transponohet masa e BE 52001XC1222(03) dhe

9. Dekreti për kushtet më të përafërta dhe procedura me të cilën Komisioni për Vendosje për Kundërvajtje, vendos për çlirimin ose për zvogëlimin e gjobës, me të cilën transponohet masa 52006XC1208(04) e BE.

KMK në vitin 2012 do t'i miratojë Udhëzimet në vijim:

- Udhëzime për procedurë më të thjeshtë për vlerësimin e koncentrimëve, të cilat do të harmonizohen me Udhëzimet e KE 52005XC0305(03);

- Udhëzime për kufizime vertikale, të cilat do të harmonizohen me Udhëzimet e KE 52001SC0411;

- Udhëzime për zbatimin e nenit 7 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës te kontratat horizontale, të cilat do të harmonizohen me Udhëzimet e KE 52011XC0114(04);

- Udhëzime për konceptin e koncentrimin, të cilat do të harmonizohen me Udhëzimet e KE 52008XC0416(08);

- Udhëzime për zbatimin e nenit 7, paragrafi 3 i Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, të cilat do të harmonizohen me Udhëzimet e KE 52004XC0427(07);

Për shkak të zbatimit më efikas të legjislacionit nga ana e KMK, është parashikuar ndryshimi i nenit 283 i Kodit Penal, me çka do të mundësohet operacionalizim efikas i programit për butësi (leniency programme), i cili u vendos me Ligjin e ri për mbrojtje nga konkurrenca ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 145/10 dhe 136/11).

KORNIZA INSTITUCIONALE

Në drejtim të përforcimit të kapaciteteve administrative të KMK, janë parashikuar punësime të reja deri në fund të vitit 2012 dhe trajnim TAIEX.

PRIORITETE AFATMESME KORNIZA JURIDIKE

Në këtë periudhë do të realizohet harmonizimi i mëtutjeshëm i legjislacionit nacional me EU *acquis*, në përputhje me ndryshimet relevante të të njëjtës.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Kapacitetet administrative të KMK vazhdimisht do të përforcohen me punësime të reja dhe me trajnime TAIEX për anëtarët e KMK dhe për të punësuarit në shërbimin profesional të KMK.

Gjithashtu, do të realizohen edhe aktivitete për ngritjen e vetëdijes te institucionet qeveritare dhe te sektori afarist nëpërmjet botimit të broshurave, organizimit të konferencave dhe të debateve publik për çështjet nga fusha e antitrustit dhe koncentrimëve.

3.08.2 NDIHMA SHTETËRORE

GJENDJA AKTUALE KORNIZA JURIDIKE

Legjislacioni për ndihmën shtetërore e përfshin Ligjin për kontrollin e ndihmës shtetërore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 145.10), si edhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të Ligjit.

Harmonizimi i legjislacionit nacional me EU *acquis* vazhdoi edhe në vitin 2011. Qeveria e Republikës së Maqedonisë, në tetor të vitit 2011 miratoi 2 dekrete të cilat rrjedhin nga Ligji për kontrollin e ndihmës shtetërore edhe atë:

- Dekret për kushtet dhe procedurën për ndarjen e ndihmës shtetërore me rëndësi të vogël (*de minimis*) ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 141/11), me të cilin transponohej rregullativa 32006R1998 e BE dhe
- Dekret për mënyrën dhe procedurën për parashtrimin e njoftimit për ndarjen e ndihmës shtetërore, si edhe procedurën për bërjen e mbikëqyrjes të ndihmës së përhershme shtetërore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 142/11) me të cilën transponoheshin rregullativat e BE 31999R0659 dhe 32004R0794.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Prej numrit të përgjithshëm të të punësuarve në shërbimin profesional të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: KMK), i cili është 19 nëpunës shtetërorë, 5 persona punojnë në zbatimin e Ligjit për kontrollin e ndihmës shtetërore, prej të cilëve 3 (tre) persona ekonomistë dhe 2 (dy) persona juristë.

Gjatë vitit 2011, KMK vazhdoi me aktivitetet lidhur me përforcimin e vetëdijes për kontrollin e ndihmës shtetërore nëpërmjet prezantimit të Ligjit të ri për kontrollin e ndihmës shtetërore në Punëtorinë për ndërtimin e qasjes konzistente në përpilimin e programeve për konkurrencë, të organizuar nga Projekti i USAID-it për përparimin e investimit dhe eksportit.

Komisioni për mbrojtjen e konkurrencës, gjatë vitit 2011, në pjesën e ndihmës shtetërore miratoi 11 aktvendime.

KMK është inkuadruar dhe merr pjesë aktive në grupin e punës për Propozim ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për zonat teknologjike zhvillimore industriale.

PRIORITETET AFATSHKURTRA KORNIZA JURIDIKE

KMK në vitin 2012 do t'i miratojë:

- Rregullat për kushtet dhe procedurën për ndarjen e ndihmës shtetërore rajonale dhe horizontale, me të cilën do të transponohet Rregullativa 32008R0800 e BE dhe
- Udhëzimet për metodologjinë për përcaktimin e nivelit të kompensimit të ndërmarreve të cilave u është besuar kryerja e shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik, të cilat do të harmonizohen me masën 52005XC1129(01) të BE.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Në drejtim të përforcimit të kapaciteteve administrative të KMK në fushën e ndihmës shtetërore, janë planifikuar punësime të reja në Sektorin e kontrollit të ndihmës shtetërore. Në këtë periudhë do të realizohen më shumë trajnime, vizita studimore dhe seminare për të punësuarit në KMK., për zbatimin më efikas të Ligjit për kontrollin e ndihmës shtetërore dhe të akteve nënligjore

në kuadër të Tvinging Projektit "Ndhimja për Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës për kontrollin e ndihmës shtetërore"- komponenti IPA 1 për vitin 2009.

Njëkohësisht, në kuadër të tuining projektit do të realizohen trajnime për gjykatësit të cilët punojnë në lëndët e ndihmës shtetërore, për dhënësit e ndihmës shtetërore, për organet e vetëadministrimit lokal, për bashkësinë afariste dhe për gazetarët.

Në këtë periudhë do të punohet në vendosjen e kontrollit efikas të ndihmës shtetërore, nëpërmjet përpilimit të bazës operative të të dhënave për ndihmën shtetërore, përpilimit të metodologjisë për përpilimin e raporteve vjetore për ndihmën shtetërore dhe për zhvillimin e skemave për ndihmë shtetërore, si edhe përpunimin e metodologjive dhe procedurave me qëllim të lehtësimit të procesit të marrjes së vendimeve.

PRIORITETET AFATMESME KORNIZA JURIDIKE

Në këtë periudhë do të realizohet harmonizimi i mëtutjeshëm i legjislacionit nacional me EU acquis, në përputhje me ndryshimet relevante të tij.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Kapacitetet administrative të KMK vazhdimisht do të përforcohen nëpërmjet të punësimeve, trajnimeve dhe seminareve. Gjithashtu, do të realizohen trajnime për gjykatësit të cilët punojnë në lëndët e ndihmës shtetërore, për dhënësit e ndihmës shtetërore, organet e vetëadministrimit lokal, bashkësinë afariste dhe gazetarët, nëpërmjet aktiviteteve të parashikuara me Tuining projektin "Ndhimja për Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës për kontrollin e ndihmës shtetërore"-komponenti IPA 1 për vitin 2009.

Në këtë periudhë do të vendoset baza operative e të dhënave për ndihmën shtetërore, do të finalizohet metodologjia për përpilimin e raporteve vjetore për ndihmën shtetërore dhe për zhvillimin e skemave për ndihmën shtetërore dhe do të finalizohen metodologjitë dhe procedurat me qëllim të lehtësimit të procesit të marrjes së vendimeve në fushën e ndihmës shtetërore.

3.09. SHËRBIMET FINANCIARE

3.09.1 BANKAT DHE KONGLOMERATET FINANCIARE

GJENDJA AKTUALE

Sistemi bankar i Republikës së Maqedonisë përbëhet prej 17 bankave dhe 8 kursimoreve. Bankat kanë pozitë dominuese me pjesëmarrje prej mbi 98% në aktivitetet e përgjithshme të sistemit bankar.

Në vitin 2011, aktivitetet e bankave vazhduan të rriten. Më 30.09.2011, aktiva e përgjithshme, depozitat e përgjithshme dhe kreditë e përgjithshme, realizuan shkallë vjetore të rritjes prej 11,6%, 11,7% dhe 8,3%, në mënyrë përkatëse (shtator të vitit 2010: 12,0%, 9,8% dhe 7,9%, në mënyrë përkatëse).

Indikatorët për cilësinë e portofolit kreditor të bankave shënuan përmirësim të caktuar krahasuar me shtatorin e vitit 2010. Pjesëmarrja e kredive jofunksionale në kreditë e përgjithshme u zvogëluar në 9,8% prej 10,6% më 30.09.2010. Kreditë jofunksionale janë të mbuluara në tërësi me korrigjimin e veçuar të përgjithshëm të vlerës.

Likuiditeti i sistemit bankar është stabil dhe është në nivel relativisht të lartë. Pjesëmarrja e mjeteve likuide në mjetet e përgjithshme të bankave është 29,9% dhe ato mundësojnë mbulim të depozitave të ekonomive familjare prej 58,8%.

Bankat, mbajnë në mënyrë të vazhdueshme solvencë të lartë dhe stabile. Shkalla e përshtatshmërisë së kapitalit në fund të shtatorit të vitit 2011 është 16,7%. Shkalla "Tier 1" është 14%.

Kthimi i aktivës dhe kthimi i kapitalit më 30.09.2011 është 0,1% dhe 1%, në mënyrë përkatëse.

KORNIZA JURIDIKE

Në vitin 2011, në tërësi u realizuan prioritetet afatshkurtra të definuar në NPAA, me ç'rast theksi ishte vënë në masat e drejtuara kah thellimi i sektorit financiar, rritjen e mundësive për qasje te kapitali dhe rritjen e sigurisë dhe stabilitetit të sektorit.

Në mars të vitit 2011 u miratua Ligji për ndryshimin dhe plotësimin Ligjit për lizing ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 35 prej më 22.03.2011). Me ndryshimet e Ligjit përforcohet funksioni mbikëqyrës i Ministrisë së Financave dhe vendoset obligimi për licencimin e anëtarëve të organeve të administrimit dhe për sigurimin e kapitalit minimal të duhur për themelimin e shoqërisë së lizingut.

Në drejtim të transponimit të tërësishëm të Direktivës 2002/87/KE, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e miratoi Ligjin për supervizion plotësues të konglomeratit financiar. Me Ligjin do të vendosen rregullat për kryerjen e supervizionit të bankave, të shoqërive të sigurimit dhe shtëpive brokere, kur ato paraqesin pjesë të konglomeratit financiar. Gjatë përpilimit të Ligjit në prill të vitit 2011, u realizua Punëtori eksperte në organizim të TAEX-it.

Me qëllim të përcjelljes së vazhdueshme të lëvizjeve në sistemin financiar në Republikën e Maqedonisë dhe ngjarjeve globale, me theks të veçantë në rreziqet e sistemit global financiar, e në drejtim të ruajtjes së stabilitetit të sistemit financiar në vend, Komiteti për stabilitetin financiar vazhdoi të realizojë takime të rregullta.

Në tremujorin e tretë të vitit 2011, u përpilua projekt-rregullativa për kapitalin e duhur për mbulimin e rrezikut kreditor sipas Bazel 2. Në fillim të shtatorit të vitit 2011, kjo projekt-rregullativë u dërgua nëpër bankat të cilat i dorëzuan komentet dhe vërejtjet e tyre, në bazë të të cilave ishte definuar që kjo rregullativë të zbatohet prej më 30.06.2012. Gjithashtu, në përputhje me këtë datë të zbatimit, do të fillojë me zbatim rregullativa për përcaktimin e kapitalit të duhur për mbulimin e rrezikut operativ.

Duke u nisur nga zvogëlimi i rejtingut kreditor të disa vendeve-anëtare të Bashkimit evropian, respektivisht faktit se anëtarësia në Bashkimin evropian ose po në OECD, vetvetiu nuk do të thotë edhe rejting të ulët kreditor, Këshilli i Bankës Popullore, në qershor të vitit 2011 miratoi ndryshime të tre akteve nënligjore edhe atë *Vendimet për limitet e ekspozimit, Vendimet për metodologjinë e përcaktimit të përshtatshmërisë së kapitalit dhe Vendimin për menaxhimin me rrezikun kreditor* të cilat janë botuar në (Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë numër 91 prej më 06.07.2011). Me këto ndryshime u vendos kriter më objektiv gjatë përcaktimit të rrezikut të kërkesave të bankave dhe ky është rejtingu kreditor. Në këtë mënyrë, për dallim nga rregullativa paraprake sipas së cilës si më pak të rrezikshme konsideroheshin kërkesat e bankave të qeverive dhe bankave qendrore të vendeve anëtare të Bashkimit evropian, të Zvicrës, të SHBA, të Kanadasë, Japonisë, Australisë dhe Norvegjisë, me ndryshimet, shkallë më të ulët të rrezikut fitojnë kërkesat dhe instrumentet për sigurim nga qeveritë dhe bankat qendrore të vendeve me rejting kreditor prej së paku BBB-(sipas "Standard dhe Purs") ose Baa3 (sipas "Mudis"). Në këtë mënyrë bëhet harmonizimi edhe me standardet ndërkombëtare të supervizionit (Bazel 2) dhe Direktivën evropiane për themelimin dhe punën e institucioneve kreditore (Directive 2006/48/KE).

Gjatë qershorit dhe korrikut të vitit 2011 u miratua rregullativa nënligjore (4 vendime dhe 1 udhëzim), në bazë të Ligjit të ri për mbrojtjen e konsumatorëve gjatë kontratave për kredi konsumatori që filloi të zbatohet prej më 1 tetor të vitit 2011. Risia në lidhje me aktet nënligjore të cilat vinin nga ligji paraprak, me obligimet e zmadhuara të bankave për njoftim në Bankën Popullore, veçanërisht obligimi i vendosur për transparencë më të madhe të kreditorëve gjatë aprovimit të kredive konsumatore.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Ministria e Financave, respektivisht Sektori për sistem financiar - Seksioni për institucione financiare bankare dhe jobankare, është kompetente për përpilimin e rregullave të cilat kanë të bëjnë me sektorin bankar dhe për harmonizimin e legjislacionit nacional me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Kjo njësi organizative numëron tre të punësuar dhe kapaciteti i tyre administrativ vazhdimisht përforcohet me kryerjen e trajnimeve në vend ndhe jashtë vendit. Deri në fund të këtij viti pritet përforsimi i kësaj njësie organizative me punësime të reja.

Në kuadër të bashkëpunimit në fushën e bankarisë ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Republikës së Maqedonisë dhe Ministrisë së Financave të Mbretërisë së Luksemburgut, a në organizim të ATTF-Agjencisë për transferim të teknologjisë financiare nga Luksemburgu, në qershor të vitit 2011 në Shkup u mbajt seminar kreditor me temën - "Bazel II". Qëllimi themelor i seminarit ishte njohje me dispozitat e Bazel II (shtylla e parë), adresimi i problemeve potenciale që kanë të bëjnë me implementimin e të njëjtit si edhe pasqyrë e shkurtër e Bazel 3. Në seminar morën pjesë përfaqësues të bankave në Republikën e Maqedonisë, të Ministrisë së Financave dhe Bankës Popullore.

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë është organ rregullator dhe supervisor për bankat. Në kuadër të aktiviteteve për zhvillimin e supervizionit, realizohen trajnime të rregullta të të punësuarve për zbatimin e procedurave të supervizionit.

Gjatë vitit 2011, kapaciteti administrativ i të punësuarve në Bankën Popullore, respektivisht Sektorit të Supervizionit, rregullativës bankare dhe stabilitetit financiar, përforcohej në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet realizimit të më shumë trajnimeve për të punësuarit, ndër të cilat edhe:

- Menaxhimi me rrezikun kreditor, ndihma teknike nga bankat qendrore të Gjermanisë dhe Holandës,
- Menaxhimi me rrezikun nga ndryshimi i shkallëve të kamatës në portofolin e aktiviteteve bankare, ndihma teknike nga Banka Qendrore e Holandës,
- TAIEX për qasjen e standardizuar për përcaktimin e kapitalit të duhur për mbulimin e rrezikut kreditor
- TAIEX për përpilimin e rregullativës për qasjet e përparuara sipas Bazel 2
- Bashkëpunimi bilateral me Bankën Qendrore të Sllovenisë, në fushën e procedurave për punë në supervizionin në terren dhe jashtë terrenit (projekti IPA).
- Trajnimi me temën Gatishmëria në kushte të krizës, në organizim të ATTF dhe të Qendër Toronto.

BPRM bashkëpunon me organet supervisorë të bankave të cilat janë pronarë dominues të bankave në Republikën e Maqedonisë, në bazë të memorandumeve të nënshkruara bilaterale për bashkëpunim dhe nëpërmjet kolegjeve të supervizionit (tani për tani mënyra e këtyre e bashkëpunimit funksionon me bankat qendrore të Sllovenisë dhe Greqisë). Gjithashtu, BPRM bashkëpunon edhe me organe të tjera relevante të supervizionit nga vende tjera në bazë të memorandumeve të nënshkruar për bashkëpunim (Shqipëria, Bullgaria, Rusia, Mali i Zi, Serbia, Turqia), si edhe me organe supervisorë vendore dhe me organe të tjera (Komisioni për Letra me Vlerë, Agjencia për supervizion të sigurimit pensional kapital të financuar, Drejtorinë për Parandalimin e Larjes së Parave dhe Financimit e Terrorizmit, Agjencinë për Supervizionin e Sigurimit).

PRIORITETE AFATSHKURTRA

KORNIZA JURIDIKE

Ruajtja e stabilitetit të sistemit financiar, zhvillimi i tij i mëtutjeshëm dhe rritja e ndërmjetësimit mbesin prioritete në fushën e sistemit financiar. Këto prioritete do të realizohen nëpërmjet aktiviteteve në vijim:

- Gjatë vitit 2012 do të bëhet plotësimi i Ligjit për Bankat në drejtim të harmonizimit të mëtutjeshëm me Direktivën bankare 2006/48/KE, në pjesën e dhënies së shërbimeve tejkufitare.
- Në vitin 2012 do të miratohet Ligji për kursimoret, me të cilin do të rregullohet statusi dhe puna e kursimoreve ekzistuese. Për shkak të përforsimit të rolit ndërmjetësues të kursimoreve, veçanërisht për subjektet e vogla, do të rritet shuma e kapitalit fillestar të duhur dhe do të zgjerohet lloji i aktiviteteve financiare që do të mund të bëhen. Aktiviteti është në përputhje me strategjinë EUROPE 2020, Flagship Initiative: Politikë pune për erën e globalizimit, në pjesën e cila ka të bëjë me përmirësimin e qasjes së MSP në burimet e financimit.
- Do të përcillen në mënyrë të vazhdueshme ndryshimet rregullatore në nivel ndërkombëtar dhe të Bashkimit evropian, veçanërisht në pjesën e cila ka të bëjë me masat për

përmirësimin e gjendjes të bankat dhe formimin e të asht.q. bridge bank. Menjëherë pas miratimit të direktivave përkatëse në kuadër të Bashkimit evropian, Republika e Maqedonisë do të fillojë me transponimin e tyre përkatës.

➤ Deri në fund të marsit 2012, do të miratohet metodologjia e re për përshtatshmërinë e kapitalit, e cila përskaj dispozitave për kapitalin e duhur për mbulimin e rrezikut operativ, do ta rregullojë edhe mënyrën e përcaktimit të kapitalit të duhur për mbulimin e rrezikut kreditor. Në periudhën e njëjtë do të miratohet edhe Udhëzimi për zbatimin e kësaj rregullative. Zbatimi i rregullativës do të fillojë më 30 qershor të vitit 2012.

➤ Gjatë vitit 2012 do të sigurohen parakushtet kadrovike dhe teknike të duhura për përgatitjen dhe zbatimin e rregullativës për qasjet vijuese të Bazel 2.

➤ Në vitin 2012 do të fillojnë aktivitetet initiale për përgatitjen e rregullativës për qasjet vijuese për përcaktimin e kapitalit të duhur.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Kapaciteti administrativ i Seksionit për institucione bankare dhe jobankare në Ministrinë e Financave, do të përforcohet me punësimin e një personi me arsim sipëror në afat të shkurtër.

Në periudhën vijuese, për qëllimet e përgatitjes së rregullativës për qasjet vijuese për përcaktimin e kapitalit të duhur sipas shtyllës së parë të Bazel 2, do të punohet në përforsimin e kapaciteteve kadrovike dhe teknike të të punësuarve në Sektorin e supervizionit, rregullativës bankare dhe stabilitetit financiar në Bankën Popullore.

PRIORITETE AFATMESME

KORNIZA JURIDIKE

Pritet që në vitin 2013 të përpilohet rregullativa për qasjet e avancuara për përcaktimin e kapitalit të duhur.

Përgatitjet për zbatimin e Bazel 3, nëpërmjet përcaktimit të të dhënave të duhura për përllogaritjen e indikatorëve për likuiditet dhe solvencë, filluan në gjysmën e dytë të vitit 2011 dhe do të vazhdojnë edhe në vitet e ardhshme, në përputhje me dinamikën e përcaktuar nga Komiteti i Bazelit.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Kapaciteti administrativ i Seksionit për Institucione bankare dhe jobankare në Ministrinë e Financave, do të përforcohet me punësimin e personave të rinj në afat të mesëm.

3.9.2 SIGURIMI DHE SIGURIMI PENSIONAL PROFESIONAL

GJENDJA RRJEDHËSE

Tregun e sigurimeve në Republikën e Maqedonisë e përbëjnë 15 shoqëri të sigurimit, 16 shoqëri brokere të sigurimit dhe 5 shoqëri për përfaqësim në sigurim. Katër shoqëri të sigurimit kryejnë punë të sigurimit të jetës, 11 të tjerat kryejnë punë të sigurimit në grupin e sigurimit jo-jetë.

Në kuadër të ndihmës së aprovuar teknike nga EBRD, Agjencia e zbaton projektin e emëruar "Implementimi i softuerit për qëllime të supervizionit". Qëllimi i këtij sistemi informatik është ta përkrahë procesin e supervizionit, me ç'rast do të mundësojë supervizion on line, shfrytëzim më efikas të resurseve njerëzore në Agjencinë dhe më e rëndësishme, të dhëna të sakta, në kohë dhe efikasitet më të madh. Gjithashtu, sistemi informatik do të mundësojë locim të hershëm të segmenteve problematike në punën e shoqërive të sigurimit dhe zbatimit gradual të qasjes së supëvizionit të bazuar rrezik të sigurimit.

Agjencia për supervizion të sigurimit realizoi shtatë kontrolle në terren prej të cilave pesë në shoqëri të sigurimit, një në shoqëritë brokere të sigurimit dhe një në shoqëri për përfaqësim në sigurim. Dy supervizione u organizuan si të përbashkëta në bashkëpunim me organet rregullatore të Sllovenisë dhe Shqipërisë.

Gjithashtu, gjatë vitit 2011, Agjencia për supervizion të sigurimit, nëpërmjet zbatimit të vazhdueshëm të trajnimeve dhe provimit për përfaqësues në sigurim dhe broker të sigurimit, vazhdoi

me certifikimin e përfaqësuesve dhe brokerave të rinj në sigurim. Gjatë vitit 2011, procesin e trajnimit e kaluan gjithsej 376 persona-përfaqësues respektivisht 130 persona –brokerë të sigurimit. Prej tyre, 352 persona e kanë dhanë me sukses provimin dhe janë pajisur me vërtetim për përfaqësues në sigurim, respektivisht 122 persona e kanë dhënë me sukses provimin dhe janë pajisur me vërtetim për broker sigurimi.

Në nëntor filloi trajnimi për aktuar në organizatën e Agjencisë, me çka në të ardhmen do të mundësohet fitimi i kuadrit të duhur të specializuar për nevojat e industrisë së sigurimit.

Gjatë dhjetorit të vitit 2011, filloi aktiviteti projektues i përkrahur nga Banka Botërore (First Initiative). Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti projektues është përkrahja e reformave në pjesën e sigurimit nga përgjegjësia nga përdorimi i automjeteve, si prodhim sigurimi i cili dominon në portofolët e shoqërive vendore të sigurimit.

Tregu i sigurimit pensional të financuar kapital e përbëjnë 2 shoqëri për menaxhim me fondet pensional të obligueshëm dhe vullnetar, të cilët menaxhojnë me nga një fond pensional të obligueshëm dhe nga një vullnetar. Mjetet e fondeve pensionale ruhen në bankat afariste të cilat e kryejnë funksionin e rojtarit të pronës.

Në përputhje me nenin 26 të Ligjit për automjete ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 140/08), automjetet të cilët marrin pjesë në komunikacionin në rrugë, duhet të jenë të regjistruar, të kenë leje komunikacioni të vlefshme ose vërtetim të vlefshëm për vozitje provuese dhe të jenë të shënuar me targa të përcaktuara të regjistrimit. Automjeti mund të jetë i regjistruar vetëm nëse vërtetohet rregullsia e tij teknike dhe të ketë sigurim të obligueshëm.

Gjatë vitit 2011, Ministria e Punëve të Brendshme, në vazhdimësi ndërmerr aktivitete për zvogëlimin e numrit të automjeteve të cilët marrin pjesë në komunikacionin në rrugë pa qenë të regjistruar, me ç'rast në territorin e Republikës së Maqedonisë, në vitin 2011 janë zbatuar 41 Kontrolle aksionare seleksionuese republikane dhe më shumë se 3000 Kontrolle aksionare seleksionuese lokale në komunikacionin rrugor.

Si rezultat i kontroleve aksionare seleksionuese republikane dhe lokale të cilat Ministria e Punëve të Brendshme i zbaton në territorin e Republikës së Maqedonisë në periudhën prej 01.01.2011 deri në 01.10.2011, janë arritur rezultatet në vijim:

- Janë ngritur 8.880 procedura të kundërvajtjes, kundër shoferëve të cilët kanë drejtuar automjet i cili nuk është i regjistruar në përputhje me rregullativën ligjore,
- Janë ngritur 1.455 procedura të kundërvajtjes kundër shoferëve të cilët kanë drejtuar automjet që nuk është i regjistruar në përputhje me rregullativën ligjore në periudhë prej 30 ditësh prej skadimit të vlefshmërisë së lejes për komunikacion.

KORNIZA JURIDIKE

Korniza juridike themelore me të cilën rregullohet themelimi, kryerja e punëve të sigurimit, punëve të përfaqësimit dhe të ndërmjetësimit në sigurimin dhe supervizionin e sigurimit në Republikën e Maqedonisë, është Ligji për supervizionin e sigurimit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 27/02, 84/02, 98/02, 33/04, 79/07, 8/08, 88/08 dhe 56/09, Ligji për sigurimin e obligueshëm në komunikacion ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 88/05, 70/06 dhe 81/08), Ligji për marrëdhëniet e obligacionit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 18/01, 4/02 dhe 5/03) dhe Ligji për shoqëritë tregtare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 28/04).

Në prill të vitit 2011 u miratua Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për supervizionin e sigurimit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 44/2011).

Ndryshimet e Ligjit janë në pjesën e dispozitave për depozitimin e mjeteve nga kapitali i shoqërive për sigurim me çka u anulua dispozita për kufizimin e depozitimit në patundshmëri prej 10% në një patundshmëri, u futën dispozitat të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen më të madhe të drejtave të sigurveve dhe shfrytëzuesve të sigurimit dhe u vendos kufizimi për mjetet me para në

emër kapitali aksionar i shoqërisë për sigurim të cilat nuk guxojnë të rrjedhin prej huas dhe nuk guxon të jenë lëndë të cilavedo ngarkesave tjera.

Në fund të vitit 2011 u miratua Ligji për depozitimin e Republikës së Maqedonisë në kapitalin aksionar të Evropa Re. Me miratimin e këtij ligji Republika e Maqedonisë do të bashkëngjitet në projektin rajonal të Bankës Botërore për krijimin e kompanisë së specializuar rajonale për risigurimin e rreziqeve nga katastrofat në pronësi të vendeve nga Evropa Juglindore dhe Kaukazit.

Në vitin 2011 Agjencia për supervizion të sigurimit vazhdoi me miratimin e rregullativës nënligjore për sigurim me qëllim të harmonizimit të saj me direktivat e Bashkimit Evropian dhe principet dhe standardet për zbatimin e supervizionit të Asociacionit Ndërkombëtarë të Supervizorëve Sigurues (IAIS). Në këtë drejtim përfundimisht me dhjetorin 2011, Agjencia miratoi 19 akte nënligjore të cilat dalin nga Ligji për supervizionin e sigurimit, ndërsa të cilat rregullojnë çështje nga sfera e licencimit, njoftimit financiar, menaxhimin me rrezik, aspekte të veçuara në pjesën e evidentimit të kërkesave të çdëmtuara nga ana e shoqërive për sigurim, veprimi sipas parashtrësive dhe kundërshtimeve të dorëzuara siguruesit dhe mënyra dhe dokumentacioni i duhur për të marrë leje nga Agjencia për supervizion të sigurimit, në pajtim me Ligjin për supervizion të sigurimit.

Pavarësia buxhetore e MAPAS ishte arritur me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për sigurimin e detyrueshëm pensional të financuar kapital në vitin 2010 (Gazeta Zyrtare e RM nr. 50/2010), në pajtim me të cilat buxheti i MAPAS ishte ndarë nga buxheti i Republikës së Maqedonisë. Në atë drejtim, MAPAS hapi llogari personale në bankën afariste e cila është aktive prej 10.01.2011, me çka vërtetohet pavarësia financiare.

Me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për sigurimin e detyrueshëm pensional të financuar kapital në vitin 2011 u vendosën instrumente të reja financiare në të cilat mund të investohen mjetet e fondeve pensionale edhe atë: aksionet e shoqërisë aksionare me obligime të veçanta për njoftim, dokumente për pjesëmarrje dhe aksione të fondeve investuese private dhe fletobligacione të dhëna nga njësitë e vetadministrimit lokal dhe nga shoqëritë aksionare të vendit të cilat nuk janë banka.

Në vitin 2011, Qeveria e miratoi propozim Ligjin për pagesën e pensioneve dhe kompensimeve pensionale nga sigurimi kapital dhe financiarë pensional, i cili e rregullon tërheqjen dhe shfrytëzimin e mjeteve nga shtylla e dytë dhe e tretë, i cili është në procedurë të kuvendit.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Në sistemin e sigurimit institucioni kompetent për përpunimin e akteve ligjore është Ministria e Financave përkatësisht Sektori për sistemin financiarë, Seksioni për sistemin e sigurimit në të cilin momentalisht është punësuar një person.

Në pajtim me Ligjin për supervizion të sigurimit, Agjencia për supervizion të sigurimit është themeluar si trup i pavarur dhe i mëvetësishëm rregullator, me autorizime publike. Agjencia në suazat e kompetencave dhe autorizimeve të saja kujdeset për funksionimin ligjor dhe efikas të tregut të sigurimit me qëllim mbrojtjen e të drejtave të siguruesve dhe shfrytëzuesve të sigurimit. Në këtë moment, Agjencia ka 20 të punësuar duke i përfshirë edhe anëtarët e angazhuar në mënyrë profesionale të Këshillit të ekspertëve. Kapaciteti administrativ në vazhdimësi përforcohet nëpërmjet pjesëmarrjes në trajnimet dhe stërvitjet e të punësuarve.

MAPAS e përforcoi kapacitetin e vet administrativ me punësimin e 4 personave të rinj të cilët filluan me punë prej 01.12.2011.

PRIORITETE AFATSHKURTRA KORNIZA JURIDIKE

Deri në fund të vitit 2012 është planifikuar miratimi i Ligjit të ri për sigurim në të cilin do të transponohet Direktiva e re e BE-së 2009/138/KE (Solvency II).

Gjatë vitit 2012, ASS parashikon miratimin e 7 akteve nënligjore të cilat dalin nga Ligji për supervizion të sigurimit.

Në pjesën e supervizionit Agjencia për supervizion të sigurimit do të vazhdojë me zbatimin e vazhdueshëm të supervizionit jashtë terrenit.

Gjatë vitit 2012 do të vazhdojnë aktivitetet për përkrahjen e reformave në pjesën e sigurimit nga përgjegjësia nga përdorimi i automjeteve motorike, si prodhim sigures i cili dominon në portfolion e shoqërive të vendit për sigurim.

Në pajtim me rekomandimet e Komisionit Evropian, në vitin 2012 është paraparë të miratohet Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sigurimin e detyrueshëm pensional i financuar kapital me të cilin do të vendoset pavarësia institucionale e MAPAS, përkatësisht kompetencat e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë do të zëvendësohen me kompetencat e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë. MAPAS do të fillojë me përgatitjen e akteve nënligjore të Ligjit për pagesën e pensioneve dhe kompensimeve pensionale nga sigurimi pensional i financuar kapital dhe do të vazhdojë me miratimin e aktet nënligjore nga Ligji për sigurimin e detyrueshëm pensional me financim kapital dhe Ligji për sigurim vullnetar pensional me financim kapital.

Në MAPAS, deri në qershor 2012, do të vazhdojë të zbatohet projekti IPA i cili ka për qëllim futjen e supervizionit i cili bazohet në kontrollin e rrezikut dhe ndërtimin e kapacitetit të MAPAS, si dhe menaxhmenti i përmirësuar organizativ i cili përfshin planifikimin strategjik dhe afarist, proceset afariste , menaxhimin njohurinë/hulumtimin dhe zhvillimin e IT, me çka në përgjithësi do të kontribuohet në harmonizim të supervizionit me praktikën e BE-së.

Në suazat e IPA projektit është angazhuar konsultant për vlerësimin e harmonizimit të rregullave nga sigurimi pensional me financim kapital me rregullat e Bashkimit Evropian. Rregullat e reja, do të krijohen në bazë të praktikës më të mirë të OISP e cila është organizata më e rëndësishme për sektorin pensional përkatësisht e principeve të Bazelit për bankat dhe Principet për solvencë për kompanitë sigures, duke pasur parash atë që sistemi është bazuar në kontributet e definuara, ndërsa jo në kompensimet e definuara.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Në mënyrë plotësuese si vazhdimësi e procesit të përpunimit detal të të dhënave të cilat do të paraqiten nga ana e ekonomive bujqësore, deri në fund të vitit 2013 plotësisht do të vendoset Sistemi për identifikimin e parcelave tokësore (LPIS) të territorit të Republikës së Maqedonisë me regjistrimin e numrit të përgjithshëm të ekonomive bujqësore të futura në RUEB, ndërsa nga aspekti i sistemeve informative, ZPIS do të pasurohet me integrimin e evidentimit të prodhimeve të cilat i plotësojnë standardet e caktuara për kualitetin, ose kanë mbrojtje të kualitetit nga aspekti i origjinës së tyre ose specifikës tradicionale.

3.11.2 RREGGULIMI I PËRBASHKËT I TREGJEVE

GJENDJA RRJEDHËSE

KORNIZA JURIDIKE

Korniza juridike për rregullimin e tregut të bimëve dhe prodhimeve me origjinë bimore dhe shtazore dhe prodhimeve me origjinë shtazore, për momentin e përcakton Ligji për bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 49/10 dhe 53/11) i cili është pjesërisht i harmonizuar me rregullativën ligjore të BE-së dhe me Ligjin për kualitetin e prodhimeve bujqësore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 140/10 dhe 53/11). Krahas këtyre ligjeve, aktet ligjore në vijim janë të lidhura me rregullimin e tregut të këtyre prodhimeve:

- Ligjin për shëndetësi veterinarë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 113/07);
- Ligjin për shëndetësi veterinarë publike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 114/07);
- Ligjin për duhanin dhe për prodhimet e duhanit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 24/06, 88/08, 31/10, 36/11 dhe 53/11)
- Ligjin për themelimin e Agjencisë për përkrahje financiare në bujqësi dhe në zhvillimin rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 72/07 dhe 05/09)
-

Me Ligjin për kualitetin e prodhimeve bujqësore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 140/10 dhe 53/11), janë rregulluar këto prodhime bujqësore me origjinë bimore (drithëra dhe oriz; ushqim për kafshët dhe pemë dhe perime të freskëta), si dhe prodhime me origjinë shtazore (mish gjedhi; vezë dhe mish shpezësh; mish derri; mish të dhurve dhe mish të dhive; qumësht dhe mjaltë dhe prodhime të tjera nga bletët). Në lidhje me këto prodhime, Ligji i rregullon standardet e tyre minimale ose të standardeve për kualitetin e marketingut (plasmnin e tregut, paketimin dhe informimin e konsumatorëve), si dhe metodat për klasifikimin e tyre, kontrollin, kontrollin dhe inspektimin e tregut, janë harmonizuara me standardet rrjedhëse të BE-së në suaza të RRPT të ndryshme, dhe fillimisht me Rregullativën e vetme të BE-së nr. 1234/2007 për RRPT.

Në bazë të Ligjit për kualitetin e prodhimeve bujqësore, në lidhje me Rregullimin e Përbashkët të tregut (RRPT) për prodhimet bujqësore me origjinë bimore dhe shtazore dhe në lidhje me standardet e tregut dhe me marketingun e përgjithshëm të prodhimeve bujqësore, janë miratuar akte nënligjore për shpezët dhe vezët; pemët dhe perimet; mjaltit dhe prodhimeve nga bletët, akte nënligjore në pjesën e standardeve minimale të tregut të drithërave dhe orizit, në tregun për qumësht dhe prodhime të gushtit me të cilat plotësisht janë rregulluar standardet e tregut për qumësht dhe prodhime të qumështit, si dhe akte nënligjore në lidhje me ushqimin për kafshët dhe mishin me të cilat plotësisht rregullohet kjo sferë.

Një pjesë e madhe e aspekteve horizontale të RRPT-së të cilat janë rregulluar për të gjithë tregjet individuale të prodhimeve bujqësore (blerja e intervenimit, ndihma për magazinim, masa të posaçme për mbrojtjen e tregut dhe masat për nxitjen e konsumimit) janë rregulluar në suaza të Ligjit për bujqësi dhe zhvillim rural, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 49/10 dhe 53/11).

Korniza juridike për rregullimin e sektorit të verës është rregulluar në mënyrë plotësuese me Ligjin e ri për verën ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 50/10 dhe 53/11). Krahas Ligjit për verën në zbatim janë edhe rregulloret e miratuara në bazë të ligjit të cilat në mënyrë plotësuese i rregullojnë sferat e mjeteve dhe procedurave ekologjike të cilat zbatohen për prodhimin e verës, metodat për analizë, klasifikim dhe llojeve të rrushit për prodhimin e verës, kushtet për prodhimin e verës, formën, përmbajtjen, dimensionet dhe të dhënat e tjera në etiketimin, përmbajtjen dhe formën e dokumentit shoqërues dhe regjistrat hyrës dhe dalës për prodhimin e rrushit dhe verës, si dhe sferat gjeografike të mbjellura me hardhi rrushi për mbrojtjen e origjinës gjeografike të verës në Republikën e Maqedonisë, listat e emrave të mbrojtur të verave të shënuara me shënim gjeografik dhe rregullat në lidhje me shënimin e sferave të tyre të prodhuara.

Korniza juridike për rregullimin e tregut të duhanit të papërpunuar për momentin e përcaktojnë Ligjin për duhan dhe për prodhime të duhanit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 24/06, 88/08, 31/10, 36/11 и 53/11). Në bazë të Ligjit për duhan dhe prodhime të duhanit janë miratuar edhe akte nënligjore që në mënyrë plotësuese i rregullojnë sferat e blerjes, vendosjes, ruajtjes përpunimin industrial të duhanit; listë evidentuese për prodhimin për prodhimin e duhanit; paraqitja e prodhimit të kontraktuar të duhanit; regjistrim në regjistrin e blerësve të duhanit dhe mënyra e mbajtjes së regjistrit të blerësve të duhanit; vlerësim kualitativ dhe kuantitativ të duhanit të papërpunuar në fletë ; aditivet e lejuara dhe të ndaluara të prodhimeve të duhanit, si dhe kontrollin e duhanit të fermentuar dhe prodhimeve të duhanit.

Krahas kësaj, në qershor 2007 është miratuar Strategjia për zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimit rural për periudhën 2007-2013, ku janë theksuar drejtime, masa dhe aktivitete për zhvillimin vijues të të gjithë prodhimeve të lartpërmendura, si dhe mënyra e organizimit të tregjeve për të njëjtit.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Në suaza të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave organet vijuese dhe njësitë organizative janë kompetente për përgatitjen e rregullativës ligjore dhe zbatimin e masave nga aspekti i rregullimit të tregjeve për prodhimet bujqësore me origjinë shtazore dhe bimore kulturat e specializuara, në pajtim me Sistematizimin e ri të MBPEU-së (të miratuar në shkurt 2011):

- Sektori i bujqësisë, Seksioni i bujqësisë; Seksioni i kopshtarisë, Seksioni i blegtorisë;

- Sektori për analizën e politikës bujqësore; Seksioni për përcjelljen e tregjeve për prodhimet bujqësore-ushqimore; Seksioni për analizën e politikës bujqësore;
- Sektori për marketing dhe kualitetin e prodhimeve bujqësore; Sektori për vreshtari, i verës dhe i pemëve; Agjencia për ushqim dhe veterinar; dhe
- Inspektorati Shtetëror i Bujqësisë; dhe
- Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe në zhvillim rural

Nga aspekti i përforsimit institucional të kapacitetit të organeve që janë kyçur në rregullimin e tregjeve të prodhimeve bujqësore me origjinë shtazore dhe bimore, janë vendosur regjistri Nacional i hardhive të rrushit dhe Sistemit Bujqësor Informativ të Tregut (SBIT) në nivel shtetërorë.

Në drejtim të realizimit të aktiviteteve nga sfera e rregullimit të përbashkët të tregjeve, janë realizuar një numër më i madh i projekteve në sferën e rregullimit të tregjeve: Vendosja e rregullimit të përbashkët të tregut për vezë dhe shpezë G2G08/MK/8/2 (bashkëpunimi bilateral me mbretërinë Holandeze), Programi AgBiz i USAID-it, një numër më i madh i aktiviteteve në suaza të instrumentit TAIEK, si dhe realizimin e projektit në suaza të Komponentit IPA 1 2008, e filluar në gusht 2010, përmes së cilës është siguruar ndihmë teknike për vendosjen e kornizës juridike dhe përforsimit institucional në sferën e rregullimit të përbashkët të tregjeve të prodhimeve bujqësore.

PRIORITETE AFATSHKURTRA

KORNIZA JURIDIKE

Në periudhën deri në shkurt 2012, është paraparë miratimi i Ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit për kualitetin e prodhimeve bujqësore, nga i cili do të dalin gjashtë akte të reja nënligjore miratimi i të cilave është paraparë deri në mars 2012. Në periudhën e njëjtë duhet të miratohen edhe 5 aktet tjera nënligjore që dalin nga Ligji për kualitetin e prodhimeve bujqësore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 140/10). Me këto akte nënligjore rregullohet ndreqja e përbashkët e tregjeve për prodhimet me origjinë bimore dhe shtazore si dhe mbrojtjen e prodhimeve bujqësore dhe të ushqimit me etiketim për mbrojtjen e ushqimit, shënim gjeografik dhe shënim për specialitetin tradicional.

Nga aspekti i **kulturave të specializuara**, në periudhën nga korriku 2012 është paraparë miratimi i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për verën, ndërsa deri në tetor 2012 edhe akte nënligjore të atij ligji.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Nga aspekti i rregullimit të tregjeve të prodhimeve bujqësore me origjinë bimore dhe shtazore, në pajtim me sistematizimin e ri të MBPEU (të miratuar në korrik 2010), u formuan dy sektorë të ri: Sektori për marketingun dhe kualitetin e prodhimeve bujqësore dhe Sektori për vreshtari, industri e verës dhe pemëtari, dhe në vitin 2012 është paraparë përforsimi i seksioneve adekuate në suaza të dy sektorëve të ri, si dhe përforsimi i Seksioneve adekuate në suaza të Sektorit të Bujqësisë dhe Sektorit për analizën e politikës bujqësore me punësime të reja. Nga aspekti i mbikëqyrjes inspektuese mbi zbatimin e masave në suaza të rregullimeve të tregjeve të prodhimeve bujqësore, është paraparë përforsimi i Inspektoratit Shtetërorë për Bujqësi, me punësime të reja më vitin 2012.

Në lidhje me RRPT-në për verë, është paraparë përforsimi i Sektorit për vreshtari, industri të verës dhe pemëtarisë me punësime të reja adekuate më vitin 2012, si dhe përforsimin adekuat të Inspektoratit Shtetërorë për bujqësi në periudhën e njëjtë kohore.

PRIORITETE AFATMESME

KORNIZA JURIDIKE

Nga aspekti i prodhimeve me origjinë bimore dhe shtazore, si dhe kulturat e specializuara, me bazë afatmesme është paraparë miratimi i akteve nënligjore eventuale plotësuese në pajtim me Ligjin për kualitetin e prodhimeve bujqësore ushqimore, të harmonizuara me ndryshimet e RRPT-së për prodhime bujqësore në suaza të BE-së, si dhe ndryshimin e Ligjit për duhanin dhe prodhimeve

të duhanit për shkak të nevojës së harmonizimit me ndryshimet e RRPT-së për prodhimet bujqësore në suaza të BE-së.

Nga aspekti i kulturave të specializuara, është paraparë miratimi i Ligjit për raki dhe pijet alkoolike në vitin 2013.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Për rregullimin e tregjeve të prodhimeve bujqësore me prejardhje bimore dhe shtazore, si dhe tregjet e kulturave të specializuara, është paraparë përfundimi i Seksioneve adekuata në suaza të Sektorit për marketing dhe për kualitetin e prodhimeve bujqësore, Sektori për bujqësi dhe Sektori për analizën e politikës bujqësore më vitin 2013-2014. Në kontekst të mbikëqyrjes inspektuese mbi zbatimin e masave në suaza të rregullimeve të tregjeve të prodhimeve bujqësore, është paraparë edhe përfundimi i Inspektoratit Shtetëror për Bujqësi dhe Inspektorati e Veterinarisë në periudhën 2013-2014.

3.11.3 ZHVILLIMI RURAL GJENDJA RRJEDHËSE KORNIZA JURIDIKE

Në lidhje me **ndihmën paraaderuese të BE-së për zhvillim rural (IPARD), Programi IPARD** është miratuar me Vendim të Komisionit më 25.02.2008. Njëherë, është miratuar akt nacional për zbatimin e IPARD Programit, respektivisht Program për shfrytëzimin e mjeteve të Instrumentit për ndihmën paraaderuese për zhvillimin rural të Bashkimit Evropian (IPARD) për periudhën 2007-2013 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 83/2009). Krahas kësaj Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të Agjencisë për përkrahje financiare në bujqësi dhe në zhvillimin rural (në cilësi të Agjencisë IPARD) miratoi Rregullore për mënyrën dhe procedurën e shfrytëzimit të përkrahjes financiare për masat e zhvillimit rural të financuara nga Komponenti V - IPARD e Instrumentit për ndihmë para aderuese IPA ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 112/2009) me të cilën u definua mënyra e zbatimit të Programit IPARD.

Nga aspekti i akreditimit të strukturës operative IPARD, respektivisht pakos së procedurave të brendshme dhe doracakut për punën e Trupit për menaxhim me Programin IPARD dhe me Agjencinë IPARD, në mars, 2009, NAO lëshoi akreditim nacional të strukturës operative IPARD dhe me anë të deklaratës për përkatshmërisë e filloi procesin e transmetimit të së drejtës për menaxhim me fondet IPARD të Komisionit Evropian respektivisht për miratimin e sistemit për menaxhim të plotë të decentralizuar. Me vendim të komisionit më 18.12.2009, Agjencia për përkrahje financiare të bujqësisë dhe zhvillimit rural dhe Trupi për menaxhim me IPARD-në u akredituan dhe e fituan të drejtën për menaxhim të plotë të decentralizuar me Fondet e BE-së të Komponentit të 5 IPA për zhvillim rural.

Më 02.03.2010 u nënshkrua edhe marrëveshja financiare shumëvjeçare për financimin e Programit IPARD për periudhën 2007-2010.

Në bazë të të drejtës së fituar për menaxhim të plotë të decentralizuar dhe të marrëveshjes së nënshkruar financiare, agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe në zhvillimin rural pranë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë i shpalli dy thirrje publike për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve financiare nga Komponenti e pestë e Instrumentit për ndihmë para aderuese për zhvillimin rural të Bashkimit Evropian.

Financimi Nacional i masave për zhvillim rural zbatohet në pajtim me Programin për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2010 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 23/11, 72/11 dhe 8141/101) dhe Rregullorja për zbatimin e politikës për zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 54/08; 53/09 и 122/09). Krahas kësaj, më vitin 2010, me miratimin e Ligjit të ri për bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 49/10, 53/11) janë përcaktuar dispozitat e hollësishme në lidhje me politikën për zhvillim rural dhe masat për zbatimin e politikës për zhvillim rural, me çka krahas përcaktimit të principeve të përgjithshme të politikës për zhvillim rural dhe përcaktimin e mjediseve rurale, bashkësitë rurale dhe rajonet rurale, ligji e përcakton zbatimin dhe realizimit e qëllimeve prioritare për zgjedhjen e çështjeve zhvillimore në sferat rurale dhe nxitjen e shfrytëzimit të mundësive dhe përparësive për zhvillim rural në Republikën e Maqedonisë.

Në bazë të ligjit, janë botuar këto akte nënligjore: Në ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 96/10": Rregullore për kriteret më të përafërta për përcaktimin e mjediseve dhe kategorive rurale të bashkësive rurale" në pajtim me NPAA ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 45/11), "Listë e bimëve autoktone të vendit dhe të racave autoktone të kafshëve" në pajtim me NPAA-në ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 71/11), "Rregullore për kushtet më të përafërta plotësuese për përkrahjen e masave për zhvillim rural, shpenzimet e pranueshme dhe lartësinë e përkrahjes për shpenzimet e pranueshme për çdo shfrytëzues për masën individuale" në pajtim me NPAA-në ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 89/11), "Listë e mjediseve rurale dhe bashkësive rurale në Republikën e Maqedonisë" në pajtim me NPAA-në ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 89/11), "Rregullore për kushtet më të përafërta plotësuese për përkrahjen e masave për zhvillim rural, për shpenzimet e pranueshme dhe lartësinë e përkrahjes për shpenzimet e pranueshme për një shfrytëzues për masën individuale" ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 124/11) me të cilin është ndërprerë Rregullorja e Gazetës Zyrtare nr. 89/11 dhe "Rregullore për kriteret më të përafërta për zgjedhjen e shfrytëzuesve për masat për zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 124/11)

KORNIZA INSTITUCIONALE

Trupi për menaxhim me IPARD-në, funksionet dhe përgjegjësitë e të cilit kryhen përmes njësive adekuate organizative të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, është përgjegjës për menaxhim me Programin IPARD në pajtim me principet e shfrytëzimit efikas dhe kualitativ të mjeteve të Komponentit V të IPA-së.

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillimin rural është kompetente për zbatimin e masave të politikës për zhvillim rural në pajtim me Programin IPARD dhe me programin vjetor për përkrahje financiare të zhvillimit rural.

Nga aspekti i përcjelljes të Programit IPARD gjatë vitit 2010 u mbajtën dy mbledhje të rregullta të Komisionit për përcjelljen e programit IPARD (mbledhje pranverore më 28 maj 2010 dhe mbledhja në vjeshtë më 16 dhjetor 2010). Është punuar Raporti i Parë Vjetor për përcjelljen e Programit IPARD dhe hulumtimi tematik i mendimit të aplikimeve të thirrjes së parë publike për procedurën e zbatimit të aplikimit, qasjes së informatave për IPARD-në, bashkëpunimit me institucionet kompetente dhe aspekte të tjera.

Janë realizuar një numër më i madh i aktiviteteve për përforcimin e kapacitetit administrativ dhe institucional në suaza të Instrumentit TAIEX, KARDS 2006 Projekt për përkrahjen e përgatitjeve për IPARD (SIPP) dhe bashkëpunim bilateral të donacionit me Republikën e Sllovenisë.

Spektori për zhvillim rural në suaza të ministrisë së MBPEJ është kompetent për realizimin e politikës koherente zhvillimore rurale, si dhe për integrimin e programeve dhe iniciativave të ndryshme për zhvillimin e rajoneve rurale në Republikën e Maqedonisë, si dhe krijimin e politikave për kreditimin e mjediseve rurale dhe të sektorit të bujqësisë. Spektori në bashkëpunim të TAIEX-it mori projekt i cili do të realizohet në periudhën 2011 me qëllim për përforcimin e kapaciteteve të seksionit për politikën e kreditimit. I njëjti është dedikuar për vendosjen e politikave të reja të përkrahjes në bujqësi përmes vendosjes së sistemit të implementimit të inzhinieringut financiar në bujqësinë primare, kapacitetet përpunuese dhe tregtinë me prodhime bujqësore. Në rrjedhë është përgatitja e procedurave për vendosjen e fondit të garantuar kreditor rural nacional, dhe në pajtim me projektin (TAIEX) e shfrytëzojmë Republikën e Lituanisë si sistem i suksesshëm i cili jep rezultate pozitive në sferën e shfrytëzimit të fondeve para aderuese dhe financim të sigurt nga ana e institucioneve financiare.

PRIORITETE AFATSHKURTRA KORNIZA JURIDIKE

Në lidhje me **ndihmën paraaderuese të BE-së për zhvillim rural (IPARD)**, është paraparë përgatitja e propozimit për modifikimin e katërt të Programit të IPARD-së dhe ndryshimi adekuat i akteve nënligjore për zbatimin e Programit IPARD nëse është e domosdoshme.

Si parakusht për menaxhim efikas dhe menaxhim efikas me Programin e IPARD-së vazhdon vazhdimi i aktiviteteve për funksionimin e sistemit për përcjelljen e vlerësimit të zbatimit të Programit IPARD i cili sistem është i domosdoshëm që të jetë plotësisht funksional për shkak të përgatitjes së Raportit të ri Vjetor për implementimin e Programit IPARD i cili duhet të dorëzohet te

Komisioni Evropian kah mesi i vitit 2011. Rezultatet nga aktivitetet për vlerësimin rrjedhës të efikasitetit dhe efikasitetit për zbatimin e Programit IPARD gjatë vitit 2011 do të mbahen në Raportin Vjetor për vlerësimin rrjedhës të Programit IPARD për vitin 2011 i cili duhet të dorëzohet te Komiteti për përcjelljen e IPARD-së kah fundi i vitit 2011.

Për shkak të zbatimit të masës për Ndhimë Teknike nga Programi IPARD, më vitin 2011 paralajmërohen aktivitete për përkrahjen e akreditimit të kësaj mase që të përfundojnë deri në fund të vitit 2011. Nga ky aspekt parashihet finalizimi i procedurave adekuate të brendshme për zbatimin e masës dhe nga ana e Trupit për menaxhim dhe nga ana e Agjencisë për përkrahje financiare në bujqësi dhe në zhvillimin rural. Njëherë parashihet përgatitja e Planit aksional për vendosjen dhe funksionimin e Rrjetit nacional për Zhvillim Rural në Republikën e Maqedonisë dhe me qëllim të përcaktimit të akteve të domosdoshme juridike për funksionimin e rrjetit si dhe kyçjen e aktiviteteve të rrjetit për financim të mjeteve IPARD të dedikuara për ndihmë teknike.

Në periudhën e informimit në kohë të shfrytëzuesve të fondeve IPARD për mundësitë e Programit IPARD, në vitin 2011 do të vazhdojë realizimi i aktiviteteve për publicitet me zbatimin e fushatës në pajtim me Planin Vjetor për komunikim me publikun për Programin IPARD për vitin 2011 të përgatitur në bazë të planit për komunikimin e Programit IPARD 2007-2013 dhe i miratuar nga komiteti për përcjelljen e IPARD-së në mbledhjen e vjeshtës (16 dhjetor 2010).

Aktivitete përgatitore për futjen e zbatimit të masave të reja në suaza të Programit IPARD 2007-2013, në veçanti masa LEADER dhe përmirësimi i trajnimeve në bujqësi. Është paraparë miratimi i akteve nënligjore të Ligjit për bujqësi dhe për zhvillimin rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 49/10) në drejtim të rregullimit të sferës në pajtim me principet për shfrytëzimin e ndihmës IPARD. Nga aspekti i **financimit nacional** i masave për zhvillim rural, më vitin 2010 është paraparë miratimi i një numri të madh të akteve nënligjore që e rregullojnë sferën dhe në pajtim me miratimin e Ligjit të ri për bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 49/10).

Në lidhje me implementimin e plotë të legjislacionit evropian në sferën e zhvillimit rural dhe të përvojave që janë fituar, do të përpunohet ndryshim dhe plotësim i Ligjit për bujqësi dhe zhvillim rural, i cili përfshin tre segmente të rëndësishme për shfrytëzimin e mjeteve të fondit evropian, si dhe të buxhetit nacional dhe ato janë politikat për përkrahjen e kamatave të kredive të dedikuara për zhvillim rural, inzhenering financiar me politikat e garancive nacionale për kreditë rurale deri 70% për fermerë ose 80% për fermerë të rinj prej moshës 18-40 dhe pagesë me avans të marrëveshjeve të nënshkruara për zhvillim rural dhe IPARD.

Nga aspekti i financimit nacional i masave për zhvillim rural, më vitin 2012 është paraparë miratimi i një numri më të madh të akteve nënligjore të cilat plotësisht do ta rregullojnë sferën dhe në pajtim me miratimin e ndryshimeve dhe të plotësimeve të reja të Ligjit për bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 49/10 dhe 53/11), të njëjtat edhe do të përfundohen.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Komiteti për përcjelljen e Programit IPARD do të mbaj mbledhje të rregullta për qëllimet e plotësimit të programit, së paku dy herë në vit më vitin 2012 dhe 2013. Në lidhje me këtë, do të intensifikohet puna dhe mbledhjet e Trupit Ndërkombëtar për zhvillim rural.

Nga aspekti institucional, më vitin 2011 parashihet ndryshimi i akteve për organizimin e sistematizimit për shkak të kyçjes së proceseve të punëve për zbatimin e kornizës juridike për politikën për zhvillim rural në veçanti nga aspekti i menaxhimit me masat e reja të programit në Programin IPARD dhe zbatimit të tij, si dhe për zbatimin e masës për ndihmë Teknike. Në këtë drejtim, do të vazhdohet me përforcimin e njësive organizative të Trupit për menaxhim me IPARD-në dhe në Agjencinë për përkrahje financiare të zhvillimit rural për shkak të sigurimit të pozitave të punës për menaxhimin dhe implementimin e instrumenteve të reja të politikës për zhvillim rural si dhe për zbatimin e kornizës ligjore për bujqësi dhe zhvillim rural. Për të gjithë të punësuarit ekzistues dhe për të punësuarit e ri është planifikuar shfaqe për trajnim adekuat dhe/ose përsosje plotësuese, si dhe vendosjen e sistemit për përcjelljen e realizimit dhe vlerësimin të ndikimit të masave për zhvillim rural. Në këtë drejtim, në vitin 2011 do të fillojë realizimi dhe projekti në kuadër të Komponentit 1 IPA (2008) përmes të cilit do të sigurohet ndihma teknike për vendosjen e kapacitetit administrativ dhe institucional për realizimin e masave agro-ekologjike në MBPEJ dhe në Agjencinë për përkrahje financiare të zhvillimit rural. Projekti në kuadër të Komponentit 1 IPA (2008) për vendosjen e Organizatave të përbashkëta të tregut (SMO) do të sigurojë ndihmë teknike për trajnime të resurseve njerëzore në Agjencinë për përkrahje financiare në zhvillimin rural për

zbatimin dhe kontrollin e masës IPARD për përkrahje të vendosjes së grupeve të prodhuesve. Në drejtim të ndihmës teknike për vendosjen e kapacitetit administrativ dhe institucional për realizimin e masave IPARD dhe instrumentet e reja të vendosura për zhvillim rural do të shfrytëzohet edhe ndihma teknike nga donatorë të tjerë bilateralë dhe multilateralë (Holanda - G2G për masa "Përmirësimi i trajnimeve në bujqësi, dhe të tjerë). Në drejtim të përfundimit të kapaciteteve të MBPEJ dhe Agjencisë, është paraparë realizimi i një numri të më të madh të aktiviteteve në kuadër të Instrumentit TAIEX.

Komiteti për përcjelljen e Programit IPARD do të vazhdojë rregullisht të takohet dy herë në vit.

Në pikëpamjen e koordinimit të politikave për zhvillim rural dhe masat të cilat i marrin institucione të ndryshme do të intensifikohet puna dhe takimi i Trupave ndër resor për zhvillim rural në vitin 2011 dhe për punën e tyre do ta Informojë QRM në pajtim me obligimet të cilat dalin nga Ligji për bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 49/10) më së voni deri në fund të vitit 2011.

Për përfundim të suksesshëm për të gjitha aktet nënligjore të cilat kërkohen në pjesën e politikave për zhvillim rural sipas të cilave bëhet programimi i mëtejshëm i masave për përkrahje, në veçanti në pjesën për rajone me mundësi të kufizuara dhe masa agroekologjike janë të nevojshme ndarje më të mëdha financiare në dy vitet e ardhshme për furnizim të pajisjes teknike me të cilat do të punoheshin të njëjtat. Pas përpunimit të legjislacionit të plotë nënligjor është e domosdoshme përfundimi i kapacitetit me numër dhe në mënyrë profesionale në pjesën e monitorimit të kualiteteve të masave për zhvillim rural dhe nëse indikatorët tregojnë rezultate të mira mund të ketë përpunim të dokumentit kualitativ për 3 vitet e ardhshme (2014-2016). Përpunimi i softuerit për krijimin e politikave të reja në kuadër të masave të vërtetuara.

PRIORITETE AFATMESME KORNIZA JURIDIKE

Për nevojat e realizimit të **ndihmës paraaderuese të BE-së për zhvillim rural (IPARD)**, do të realizohen ndryshimet vjetore të parapara dhe plotësimet e programit (2012,2013) në drejtim të zgjerimit të masave të Programit IPARD me lloje të reja të investimeve në pajtim me Dokumentin shumë vjeçar indikativ dhe në pajtim me qëllimet strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë nga aspekti i shfrytëzimit të fondeve të BE-së përmes komponentit të pestë IPA. Në vitet 2012 dhe 2013 do të vazhdohet me aktivitetet për vlerësim rrjedhës të zbatimit e Programit IPARD gjatë të cilës deri në fund të vitit 2012 dhe 2013 do të përgatitet Raport vjetor për vlerësim rrjedhës të Programit IPARD. Si rezultat i funksionimit të sistemit të përcjelljes së Programit IPARD, kah mesi 2012 dhe 2013 do të dërgohet Raport i rregullt vjetor për zbatimin e Programit IPARD për vitet 2012 dhe 2013.

Komunikimi i Programit IPARD me opinionin do të zhvillohet në bazë të përpunimit të planeve të rregullta vjetore për komunikim me opinionin për Programin IPARD në 2012 dhe 2013.

Lidhur me **financimin nacional** të zhvillimit rural do të miratohen programet për përkrahje financiare për zhvillim rural për vitin 2013 dhe 2014 në programin e parapara dhe shumëvjeçar për përkrahje financiare të zhvillimit rural për periudhën 2011-2012 për vitin 2013 dhe përgatitje për periudhën 2014-2016 për vitin 2014. Është me rëndësi të jetë e realizuar plotësisht në pajtim me buxhetet e parashikuara sipas masave të përcaktuara. Mundësia për bartjen e mjeteve financiare do të jetë vetëm në korniza të masave për analizë më të hollësishme për vazhdimin e përkrahjes financiare për traktorë.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Në afatin e mesëm (në fillim të vitit 2012 dhe 2013) parashihet ndryshimi i akteve për organizimin e sistematizimit për shkak të përfshirjes së proceseve të punës për zbatimin e kornizës juridike për politika të zhvillimit rural dhe menaxhimit efikas dhe efektiv të Programit IPARD dhe zbatimin e masave për ndihmë teknike. Në këtë drejtim, do të vazhdohet me përfundimin e MBPEJ për përfundimin e kapaciteteve të menaxhimit të politikave për zhvillim rural në veçanti të njërive organizuese në përbërje të Trupit për menaxhim me IPARD me punësimin dhe trajnimin e personave tani të punësuar dhe ata që do të punësohen në mënyrë plotësuese. Në atë drejtim, do të vazhdojë përfundimi i potencialit të njeriut dhe kapaciteti i Agjencisë për përkrahje financiare të zhvillimit rural për zbatim financiar efikas të masave në pajtim me politikat për zhvillim rural dhe në veçanti zbatim i Programit IPARD.

Komiteti për përcjelljen e Programit IPARD do të mbajë takime të rregullta për qëllime të përmirësimit të programit, më së paku dy herë në vit në 2012 dhe 2013. Pas kësaj, do të intensifikohet puna dhe takimet e Trupit ndër resor për zhvillim rural dhe me punën e tyre do ta Informoje QRM në pajtim me obligimet të cilat dalin nga Ligji për bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 49/10).

3.11.4 BUJQËSIA ORGANIKE

KORNIZA JURIDIKE

Për shkak të përparimit të politikës ndëshkuese dhe realizimit të plotë të qëllimeve të Ligjit për bujqësi të prodhimit organik përmes rregullimit plotësua të disa çështjeve, u miratua Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prodhimtari organike bujqësore (Gazeta Zyrtare e RM -së nr. 53/11).

"Strategjia nacionale me Plan aksional për bujqësi organike në Republikën e Maqedonisë 2008-2011" me sukses u zbatua.

Në kuadër të Programit për përkrahje financiare të bujqësisë për vitin 2011, nën programi për përkrahje financiare për prodhimtari organike janë paraparë masa me përkrahje të rritur financiare prej rreth 30% për prodhimtari organike lidhur me prodhimtarinë e rregullt dhe përkrahjen plotësuese për përpunimin dhe tregtinë e prodhimeve organike, si dhe mbulimin e 50% të harxhimeve për certifikim të prodhimtarisë organike.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Kompetencën e plotë për rregullimin e sferës së bujqësisë organike në Sferën e Republikës së Maqedonisë e ka Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave (MBPEU) - Sektori bujqësi, Sektori për prodhimtari bujqësore organike.

Në realizimin e masave dhe aktiviteteve të lidhura me prodhimtarinë bujqësore organe marrin pjesë edhe inspektorati i bujqësisë (MBPEU), Agjencia e ushqimit dhe veterinarisë (AUV), Ministria e Ekonomisë, Instituti i akreditimit të RM-së, Instituti për standardizim i RM-së, agjencia e nxitjes së zhvillimit të bujqësisë, Agjencia për përkrahjen e financave në bujqësi dhe zhvillim rural, fakulteti i Bujqësisë, INP Instituti Bujqësor, Lidhja Nacionale e shoqërive organike, Akreditues dhe trupa të autorizuar për kontroll profesional.

Ministrie e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave mban evidencë për personat fizik për kryerjen e kontrollit profesional në prodhimtarinë bujqësore organike.

Sistemi i kontrollit të prodhimtarisë organike në RM është i deleguar në dy trupa të certifikuar të cilët janë të akredituar nga ana e Institutit për akreditim të RM-së. Instituti për akreditim i RM-së është anëtar i EA (European Cooperation for Accreditation) dhe është në proces të jetë nënshkruar i Marrëveshjes multilaterale (EA MLA) në sferën e testimit, certifikimit dhe inspektimit i prodhimeve. Në gjysmën e parë të vitit 2012 pritet nënshkrimi i kësaj marrëveshje. Trupat e certifikatave të RM-së janë të akredituar në bazë të vlerësimit të vendosjes dhe implementimit të sistemit për kualitet në pajtim me kërkesën e standardit EN 45011. Në bazë të akreditimit të marrë nga ana e Institutit për akreditim të RM-së, trupat e certifikimit marrin autorizim nga ana e MBPEU për kryerjen e kontrollit profesional në pajtim me prodhimtarinë organike.

Krahas kësaj, është e vendosur evidencë për kapacitet dhe subjektet e sistemit të prodhimtarisë organike bujqësore në kuadër të Regjistrimit të vetëm të afarizmit bujqësor.

Kontrolli mbi punën e trupave certifikues, si dhe mbikëqyrja e plotë mbi zbatimin e dispozitave të Ligjit për prodhimtari organike dhe dispozitat e miratuara në bazë të njëjtës e kryen Inspektorati shtetëror për bujqësi dhe Agjencia e ushqimit dhe veterinarisë.

PRIORITETE AFATSHKURTRA

KORNIZA JURIDIKE

Në pajtim me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për prodhimtari bujqësore organike (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 53/11) do të miratohen këto akte nënligjore: Rregulla për rregullat e rritjes e gjallesave ujore, Rregullorja për formën, përmbajtjen e formularit të certifikimit se prodhimi, procesi i prodhimit, përgatitja ose lëshimi në qarkullim është në pajtim me rregullat dhe procedura e ligjit, si dhe evidencën të cilën e mbajnë subjektet dhe Rregullorja për formën, përmbajtjen dhe formulari i

certifikatës për përputhshmëri të prodhimitarisë së prodhimeve organike me vendin importues, mënyra e lëshimit si dhe dokumentacioni përcjellës i cili e përkrah dërgesën me prodhime të prejardhjes organike.

Me miratimin e këtyre akteve nënligjore do të mundësohet integrimi i rregullave dhe procedurave të parapara në Rregullativën e Komisionit nr. 1235/2008 të cilat kanë të bëjnë me importin e prodhimeve organike nga vende të treta në kornizën nacionale juridike, si dhe Rregullativën e Komisionit nr. 710/2009 për përcaktimin e rregullave të hollësishme për prodhimtari organike të gjallesave të akuakulturës.

Krahas kësaj, në këtë periudhë kohore do të miratohet edhe realizimi i Programit për nxitjen dhe zhvillimin e bujqësisë organike për vitin 2012.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Është paraparë edhe përforcimi i Sektorit për bujqësi organike, Sektori për bujqësi (C3) me punësim të ri në vitin 2012 dhe Inspektori shtetëror për bujqësi, si dhe trajnime të kuadrit në nivel nacional.

Në drejtim të përforcimit të kapaciteteve të MBPEU, në kuadër të ndihmës parapaderuese të BE-së për vitin 2009, komponenti 1 (IPA-TAIB) do të fillojë me realizimin e projektit Twinning për përforcim institucional për zbatimin e kornizës së re ligjore për prodhimtari bujqësore organike.

PRIORITETE AFATMESME

KORNIZA JURIDIKE

"Strategjia nacionale me Plan aksional për bujqësi organike ne Republikën e Maqedonisë 2012-2011" me sukses u zbatua.

Përgatitja dhe realizimi i Programit për nxitjen dhe zhvillimin e bujqësisë organike për vitet 2013 dhe 2014.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Është paraparë edhe përforcimi i Sektorit për bujqësi organike, Sektori për bujqësi (C3) dhe të Inspektoratit shtetëror për bujqësi në periudhën 2013-2014, si dhe trajnime te tyre.

3.11.5 POLITIKA PËR KUALITET

GJENDJA RRJEDHËSE

KORNIZA JURIDIKE

Me miratimin e **Ligjit për kualitet të prodhimeve bujqësore** në tetor 2010 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 140/2010) **obligimet kryesore dhe aktivitetet ishin të drejtuara në dispozitat shoqëruese** të cilat dalin nga e njëjta. Në vitin 2011, u miratuan në numër i madh i akteve nënligjore, si dhe nga pjesa e rregullimit të tregjeve për prodhimtari bujqësore, standarde për kualitet, klasifikim, shënim të sistemit informativ, ashtu edhe me dispozitat shoqëruese për mbrojtje të prodhimeve bujqësore dhe ushqimore me emrin gjeografik dhe shënimin për specialitet të garantuar tradicional.

Pasi që Republika e Maqedonisë posedon prodhime tradicionale, si dhe prodhime të cilat posedojnë cilësi të posaçme të kualitetit të cilat janë karakteristike për disa rajone, Sektori për marketing dhe kualitet të prodhimeve bujqësore janë të përkushtuara në **përpunimin e akteve nënligjore nga pjesa e III të Ligjit për kualitet të prodhimeve bujqësore**, të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e prodhimeve bujqësore dhe ushqimore me emër gjeografik, si dhe shënimin e specialiteteve të garantuara tradicionale. Një pjesë e dispozitave shoqëruese tashmë janë miratuar, ndërsa aktet tjera nënligjore do të miratohen në fillim të vitit 2012, ashtu që **tërësisht do të formohet korniza juridike** dhe do të mundësohet mbrojtja dhe regjistrimi i disa prodhimeve të caktuara bujqësore dhe ushqimore në pajtim me rregullativën e BE-së 32006R0509, 32006R0510, 32006R1898, 32007R1216 dhe 32008R0628.

Në kuadër të Programit për përkrahje financiare në bujqësi për vitin 2011 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 13/11) u parapa dhe u realizua Nën programi - Përkrahje financiare për standarde për kualitet dhe siguri të ushqimit.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Në pajtim me Ligjin për kualitet të prodhimeve bujqësore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 140/10) dhe ndryshimi i fundit të sistematizimit të MBPEJ, të gjitha aktivitetet nga aspekti i kualitetit dhe mbrojtjes së kualitetit të prodhimeve bujqësore dhe prodhimeve bujqësore-ushqimore, si dhe promovimi i të njëjtave, janë në kompetencë të sektorit për kualitet dhe marketing të prodhimeve bujqësore. Në kuadër të sektorit, Seksioni për standarde dhe kualitet të prodhimeve bujqësore, në të cilin për momentin janë të punësuar 4 persona, është kompetente në mënyrë të drejtpërdrejtë për mbrojtjen e kualitetit të prodhimeve bujqësore.

PRIORITETE AFATSHKURTRA

KORNIZA JURIDIKE

Gjatë vitit 2012, do të miratohen aktet tjera nënligjore në pajtim me Ligjin për kualitet të prodhimeve bujqësore me të cilat rregullohet kualiteti dhe mbrojtja e kualitetit të prodhimeve bujqësore-ushqimore, ndërsa në kuadër të Programit financiar në bujqësi për vitin 2012 do të parashihet edhe Përkrahja për ndihmë financiare për standarde për kualitet dhe siguri të ushqimit.

Për shkak të nevojave të Ndryshimit dhe plotësimit të ligjit për kualitet të prodhimeve bujqësore, realizimi i përpunimit të paraparë të elaborateve dhe mbrojtje të 2 prodhimeve bujqësore zhvendoset deri në shtator 2012.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Në drejtim të përforcimit të kapacitetit institucional, krahas shfrytëzimit të Instrumentit TAIX, në kuadër të ndihmës paraaderuese të BE-së nga Komponenti 1 (IPA-TAIB), do të fillojë me realizimin e projektit Twinning për bashkëpunim administrativ mes MBPEJ dhe vendit anëtar të BE-së për qëllimet e harmonizimit juridik dhe vendosmërisë institucionale të sistemeve për zhvillim dhe mbrojtje të kualitetit të prodhimeve bujqësore-ushqimore, si dhe vendosjen e evidencës të prodhimeve të cilat i plotësojnë standardet duhura për kualitet dhe kanë prejardhje mbrojtëse dhe emër tradicional gjeografik.

PRIORITETE AFATMESME

KORNIZA JURIDIKE

Në këtë periudhë kohore është paraparë përgatitja e elaborateve dhe realizimi i mbrojtjes së shenjave për prejardhjen dhe specialiteti tradicional i prodhimeve bujqësore, si dhe përgatitja e nën programit për kualitet dhe siguri të ushqimit për vitin 2013 dhe 2014 dhe realizimi të njëjtave.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Në kuadër të MBPEJ është paraparë edhe përforcimi i Sektorit për marketing dhe kualitet të prodhimeve bujqësore, Sektori për standard dhe kualitet të prodhimeve bujqësore dhe Seksioni për marketing të prodhimeve bujqësore me punësime të reja në vitin 2013 dhe 2014, si dhe trajnime dhe ngritje plotësuese dhe rrjedhëse të personave të rinj të punësuar nga sfera e mbrojtjes dhe emrit gjeografik, kualiteti i prodhimeve bujqësore dhe promovimi i tyre.

3.12. SIGURIA E USHQIMIT, POLITIKA VETERINARE DHE FITOSANITARE

3.12.1. PARIME TË PËRGJTISHME

GJENDJA RRJEDHËSE

KORNIZA JURIDIKE

Për shkak të zbatimit efikas të kontrolleve oficiale në pajtim me rregullativën 882/2004 në gjysmën e parë të vitit 2011 në bazë të Ligjit për siguri të ushqimit ("Gazeta Zyrtare e RM" 157/2010 dhe 53/2011 u miratua Programi Nacional për mbikëqyrjen e sigurisë së ushqimit dhe i njëjti është shpallur në "Gazetën Zyrtare të RM" nr. 27/2011 nga 03.03.2011 Programi është përpunuar në pajtim me qëllimet dhe prioritetet nga plani kontrollues i integruar shumë vjetor i Agjencisë për ushqim dhe veterinarin.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Më 01.01.2011 në pajtim me Ligjin për siguri të ushqimit ("Gazeta Zyrtare 2 RM" 157/2010 dhe 53/2011) është formuar dhe filloi me punë Agjencia për ushqim dhe veterinarin organ i pavarur i Qeverisë së RM. Agjencia është formuar me bashkimin e kapaciteteve ekzistuese të Drejtorisë për ushqim, organ në përbërje të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Drejtoria për veterinarin, organ në përbërje të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave. Me formimin e Agjencisë është siguruar qasje e integruar për sigurimin e ushqimit në Republikën e Maqedonisë në pajtim me kërkesat Evropiane. Gjithashtu në këtë mënyrë është tejkaluar problemi me përshtatjet në kompetencat që paraprakisht ishin prezent ndërmjet institucionet kompetente për krijimin dhe implementimi i politikave nga sfera e sigurimit të ushqimit dhe veterinarisë. Në drejtim të transpozicionit efektiv të legjislacionit Evropian në nacionalen nga sfera e veterinarisë është filluar revizioni i metodave aktuale për transpozicionin e legjislacionit Evropian nga sfera e veterinarisë, në suazat e Projektit IPA 2008.

Në drejtim të vendosjes dhe përfortimit të formave organizative dhe strukturore të Agjencisë për ushqim dhe veterinarin si institucion i sapoformuar aksent i veçantë është vendosur në menaxhimin me resurset njerëzore analizë të rrezikut dhe zbatimin e sistemit për kontroll të brendshëm në pajtim me nenin 77 nga Ligji për siguri të ushqimit të harmonizuar me rregullativën 2044/882, në të cilin është paraparë zbatimi i kontrollit të brendshëm në mënyrë transparente dhe të pavarur gjithashtu në suazat e projektit IPA 2008 është mbaruar vlerësimi i nevojave për trajnime për të punësuarit nga Agjencia për ushqim dhe veterinarin në nivel qendror dhe lokal. Vlerësimi i nevojave për trajnime për të punësuarit/kuadrit udhëheqës dhe profesional/ nga Agjencia për ushqim dhe veterinarin ishte parakusht për fillimin e aktiviteteve në suaza të projektit të njëjtë për zhvillimin e sistemit për trajnime të Agjencisë për ushqim dhe veterinarin i planifikuar për periudhën e ardhshme trevjetore.

PRIORITETE AFATSHKURTRA KORNIZA JURIDIKE

Draft Strategjia për transpozicionin dhe implementimin e legjislacionit evropian e përfshirë me Kreun 12 përpunimi i të cilit është paraparë si IPA 2008 aktivitet projektues pritet të miratohet nga ana e Qeverisë së RM deri në fund të vitit 2012. Implementimi i Strategjisë së lartpërmendur do të zgjidhet sipas afateve të përmbajtura në planin përkatës për implementimin e të njëjtës. Gjatë vitit 2012 për shkak të harmonizimit të mëtutjeshëm me relevanten EU acquis janë planifikuar ndryshime dhe plotësime të Ligjit për siguri të ushqimit ("Gazeta Zyrtare e RM" 157/2010 dhe 53/2011) do të kryhet harmonizimi me dispozitat nga BE masat vijuese: 32006L1924, 32004R0882, 32004R0852, 32004R0853, 32004R0854, 32005R2073, 32005R2075 dhe 320052074/

Në lidhje me sistemin e sapoformuar për audit dhe kontroll të brendshëm, gjatë vitit 2012 është planifikuar miratimi i akteve nënligjore dhe procedurave për mënyrën e veprimit të Seksionit në pajtim me Vendimin 677/2006 dhe fillimi i auditeve dhe kontrolleve të brendshme sistimore në Agjencinë për ushqim dhe veterinarin.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Kapacitetet administrative të Agjencisë për ushqim dhe veterinarin gjatë vitit të ardhshëm është planifikuar të përfortohen me punësime të reja të 20 këshilltarëve/veterinerë oficial dhe inspektorë shtetërorë për ushqim. Qëllimet dhe prioritetet e politikës për siguri për ushqimin do të përcaktohen me miratimin e Strategjisë për sigurim të ushqimit në Republikën e Maqedonisë për periudhën 2013-2015. Strategjia i ndjek normat ligjore relevante nacionale si dhe trendët e fundit ndërkombëtarë në sferën e sigurisë së ushqimit. Qëllimi thelbësor i Strategjisë është çdoherë qasje deri te ushqimi i shëndetshëm dhe i sigurt për shpenzuesit e fundit, kurse me atë mbrojtja e shëndetit të popullsisë në Republikën e Maqedonisë.

Janë paraparë aktivitete të shumta në suazat e Projektit IPA 2009 për përmirësimin e kornizës institucionale në lidhje me sigurimin e ushqimit edhe atë: a) përpunimi i procedurave për

kontrolle oficiale në bazë të rrezikut, b) përpunimi i planeve kontrolluese në pajtim me planin kontrollues shumëvjeçar në lidhje me kontrollin dhe mbikëqyrjen e ushqimit dhe kontroll të objekteve për ushqim, v) mbindërtim të Sistemit për paralajmërim të shpejtë (RASFF), nëpërmjet vendosjes së softuerit aplikativ dhe lidhjen e të gjithë institucioneve kompetente të përfshira në kontrollin e ushqimit, g) vendosje dhe funksionalitet të plotë të sistemit për analizë të rrezikut në pajtim me Rregullativën 178/2002, d) vendosja e sistemit për menaxhimin me kriza, gj) përforcimi i vijueshmërisë në sferën e sigurimit të ushqimit.

Në suazat e IPA Projektit 2008 vazhdojnë aktivitetet për zhvillimin e sistemit për trajnime të Agjencisë për ushqim dhe veterinari që filluan në fund të vitit 2011. Me sistemin e zhvilluar do të përfshihen: Baza e të dhënave në të cilën në një vend do të përmbahen: Të dhëna për trajnimet sipas sferave tematike, pjesëmarrësit e trajnimeve, koha dhe vendi për mbajtjen e tyre si dhe të dhëna për ligjëruesit si dhe përpunimi i Programit për trajnimet e të punësuarve në Agjencinë për ushqim dhe veterinari. Ekzistimi i sistemit të tillë do të mundësohet pavarësia e institucionit, më saktë zbatimi i papenguar dhe pavarur i nevojave të identifikuara për trajnime të Agjencisë si në nivel qendror ashtu edhe në nivel lokal. Si rezultat i asaj, në mënyrë të rëndësishme do të lehtësohet dhe shpejtohet procesi i përforcimit të kapaciteteve administrative që është e domosdoshme për punën efikase dhe efektive të institucionit dhe çdoherë në pajtim me praktikat më të mira në sferat që janë kompetencë të Agjencisë për ushqim dhe veterinari.

Implementimi i legjislacionit që ka të bëjë me kontrollet e reduktuara (reduced frequency checks) të harmonizuar me legjislacionin relevant Evropian/dispozitat nga 31994D0360 si dhe futja e procedurave të vendeve inspektuese veterinare të kalimeve kufitare pritet të fillojë gjatë gjysmës së dytë të vitit 2012.

PRIORITETE AFATMESME KORNIZA JURIDIKE

Ndryshimet dhe plotësimet e legjislacionit evropian në lidhje me sigurimin e ushqimit do të ndiqen në vazhdimësi nga ana e Agjencisë për ushqim dhe veterinari dhe në mënyrë të njëpasnjëshme do të transponohen në legjislacionin nacional.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Në suazat e Agjencisë është paraparë vendosja e mekanizmave përkatëse për përmirësimin e kapaciteteve administrative (numër i rritur i të punësuarve, trajnime, kontrolli i zotësisë etj.). Përforcimi i kapaciteteve Agjencia për ushqim dhe veterinari nga aspekti i organizimit, menaxhim dhe koordinim do të mundësohet përpunimi i mëtutjeshëm dhe mbindërtimi i sistemeve në kompetencë të saj. Në atë kontekst, janë planifikuar përgatitjet për akreditim të shërbimeve inspektuese të Agjencisë për ushqim dhe veterinari në suazat e Projektit IPA 2009 në pajtim me Standardin Evropian – EN 45004 ose standard tjetër më adekuat për punën e shërbimeve.

Me Projektin IPA 2010 parashikohet furnizimi i harduerit për sistemin, lidhja e të gjithë institucioneve kompetente për sigurimin e ushqimit në një sistem, si dhe tuiningu projekti i cili do të ndihmon në përforcimin e kapaciteteve të Agjencisë për ushqim dhe veterinari në shikim të implementimit të legjislacionit Evropian i cili është i transponuar në nacionalen.

3.12.2. POLITIKA VETERINARE GJENDJA RRJEDHËSE KORNIZA JURIDIKE

Në pajtim me **Ligjin për shëndetësi veterinare** ("Gazeta Zyrtare e RM" 113/07, 24/2011 dhe 136/2011), janë miratuar më shumë akte nënligjore me të cilat në mënyrë detale rregullohen çështjet nga sfera të ndryshme edhe atë:

Nga sfera **masa kontrolluese për sëmundje tek kafshët** janë miratuar: a) Rregullore për masa për ndalimin dhe çrrënjosjen e encefalopateve transmiseve spongioforme ("Gazeta Zyrtare e RM" 57/2011 prej 18.04.2011), në të cilat janë transponimi i dispozitave nga rregullativa 32001R0999 dhe ndryshimet dhe plotësimet e saj me çka është arritur harmonizimi i plotë me BE acquis në lidhje me encefalopatet transmiseve spongioforme – ETS; b) Rregullore për masat për ndalimin dhe çrrënjosjen e Murtajës Afrikane tek thundrakët në Republikën e Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e RM" 95/2011 prej 14.07.2011), e harmonizuar me dispozitat nga: 31992L0035; v) Rregullore për masa për ndalimin dhe çrrënjosjen e sëmundjes së Njukastlit ("Gazeta Zyrtare e RM" 98/2011 prej 19.07.2011), e harmonizuar me dispozitat nga: 31992L0066; dhe g) Rregullore për masa për ndalimin dhe çrrënjosjen e sëmundjes vezikulare tek derrat të shpallur në "Gazeta

Zyrtare e RM” 154/2011 prej 04.11.2011), e harmonizuar me dispozitat nga: 32002L0060, 31992L0119 dhe 32000D0428),

Nga sfera **kushtet për import të kafshëve të gjalla dhe prodhimeve me origjinë shtazore** janë miratuar disa ndryshime dhe plotësime të Rregullores për mënyrën dhe procedurat për importim dhe transit, lista e vendeve të treta nga të cilat është lejuar importimi, forma dhe përmbajtja e certifikatave veterinar-shëndetësore ose dokument tjetër që i shoqëron dërgesa e kafshëve të gjalla, akuakulturë dhe prodhime nga prejardhja shtazore, si dhe mënyra dhe procedura e kryerjes së shqyrtimit dhe kontrollit gjatë importimit dhe transimit të kafshëve të gjalla, akuakulturë dhe prodhime nga prejardhja shtazore (“Gazeta Zyrtare e RM” 53/2010, 86/10 dhe 144/10) dhe të njëjtat janë shpallur në “Gazetën Zyrtare të RM” numër 27/11, 66/11, 72/11, 84/11, 95/11, 114/11 dhe 168/2011. Arsye për miratimin e ndryshimeve dhe plotësimeve gjatë vitit 2011 është harmonizimi në mënyrë plotësuese me dispozitat nga BE legjislacioni që e rregullon kjo sferë e miratuar gjatë 2011 /32011R0605, 32011D0267, 32011R0342, 32011R0427 , 32011R0536, 32011D0512, 32011R0801 dhe 32011R0914/.

procedura 32003R2003, i) Rregullore për mënyrën e zbatimit të masave për pengesën e përkohshme ose të përhershme të prodhimit dhe shitjes së hedhurinave në treg në varësi prej vlerësimit të rrezikut nga hedhurina për shëndetin e njerëzve, kafshëve, bimëve dhe mjedisit jetësorë 32003R2003, j) Rregullore për kushtet nën të cilat hedhurina mund të shitet në treg, përkatësisht të evidentohet, si dhe teprica nga prodhimitaria provuese, nga eksportimi ose nga shfrytëzuesi i fundit 32003R2003, k) Rregullore për formën dhe përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit të prodhuesve të hedhurinave, procedura dhe dokumentacioni për regjistrimin në Regjistrin e prodhuesve, kushtet për evidentimin e hedhurinës në Listën e hedhurinave të cilat prodhohen dhe shiten në treg 32003R2003, dhe l) Rregullore për mënyrën e shitjes në treg të hedhurinave në gjendje rinfuze 32003R2003.

Në kompetencë të **Drejtorisë për material faror dhe për mbëltim** është miratuar Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për material faror dhe për mbëltim (i shpallur në "Gazetën Zyrtare të RM" 171/2010 prej 30.12.2010). Me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit pranohet katalogu i përbashkët Evropian, në mënyrë të njëpasnjëshme anulohen lejet për importimin e material të faror dhe për mbëltim dhe njëherësh kryhet harmonizimi i plotë me masat relevante të BE: 31996L0401, 31966L0402, 31968L0193, 31992L0034, 31998L0056, 32000L0029, 31998L0095, 31998L0096, 32001L0064, 32001D0898, 32001D0897, 32002L0057, 32002L0056, 32002L005, 32002L0054, 32002L0053 dhe 31992L0033. Përveç asaj, gjatë vitit 2011 janë miratuar aktet nënligjore si vijon: a) Rregullore për tregti me material për shumim dhe material mbjellës të pemëve të dedikuara për prodhimtarinë e pemëve të harmonizuara me Direktivat 92/34/KEE dhe 2008/90/ES ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 84/2011 prej 24.06.2011), b) Rregullore për tregti me material mbëltimi nga hardhitë e rrushit e harmonizuar me Direktivën 68/193/KEE ("23/11 prej 24.02.2011). Në pajtim me Ligjin për të drejtat seleksionuese ("Gazeta Zyrtare e RM") është planifikuar të miratohet Rregullore për lartësinë e shpenzimeve për ndarjen e të drejtës së seleksionuar dhe për lartësinë e kompensimit për mbajtjen e të drejtës së seleksionuar. Në këtë mënyrë është rrumbullakuar korniza juridike për farë dhe material mbëltimi dhe të drejta seleksionuese e harmonizuar me legjislacionin Evropian dhe standardet e vlefshme ndërkombëtare.

B) Korniza institucionale

1) Drejtoria Fitosanitare

Gjatë vitit 2011 janë realizuar 3 punësime të personave të cilët punojnë me problematikën e transponimit të akteve nënligjore në suaza të politikës fitosanotare. Është filluar me mbajtjen elektronike të Regjistrit për prodhime për mbrojtjen e bimëve, Regjistrit të prodhuesve, përpunuesve, importuesve dhe shpërndarësve të bimëve, prodhimeve bimore dhe objekte tjera dhe sende dhe Regjistri për dhënien e vërtetimit për verifikimin zyrtarë në repart për përpunim të veçantë të materialit të drurit për paketim.

Drejtoria Fitosanitare prej 01.01.2011 filloi me implementimin e ISO-standardet 9001:2008. Në suazat e programit "Programi për kontrollin e shëndetit të bimëve" në organizimin e DG SANCO gjatë vitit 2011 ishin realizuar disa trajnime në të cilat morën pjesë përfaqësues nga institucionet kompetente për krijimin dhe zbatimin e politikës fitosanitare në Republikën e Maqedonisë. Trajnimet kishin për qëllim përmirësimin e efikasitetit të shërbimeve për kontrollin e shëndetit të bimëve në BE dhe vendet anëtare.

Në periudhën prej 22-25 gusht 2011 u mbajt TAIEX misioni ekspertë me temë Monitoring dhe mbikëqyrje e vendeve bujqësore në të cilën morën pjesë 35 përfaqësues nga institucionet kompetente për politikën fitosanitare në Republikën e Maqedonisë punë e të cilës është e lidhur me problematikën përkatëse.

2) Drejtoria për material faror dhe për mbëltim

Në vitin 2011 u zbatua nga TAIEX – misioni në Sarajevë-BdheH nga sfera e mbrojtjes së bimëve në të cilin ishin ftuar dhe morën pjesë dy përfaqësues nga Drejtoria për farë dhe material mbëltimi. Në organizim të CPVO janë zbatuar trajnimet si vijon edhe atë: 1) Në Anzhe – Francë takim nga sfera e prodhimitarisë së materialit për mbëltim nga kulturat e kopshtit dhe 2) Në Anzhe – Francë mbledhje vjetore e CPVO – Zyra për mbrojtjen e llojeve të reja të bimëve, në të cilën morën pjesë nga një përfaqësues nga Drejtoria për farë dhe material mbëltimi si institucion kompetent nga Republika e Maqedonisë. Trajnimet e lartpërmendura janë me rëndësi të madhe gjatë përgatitjes dhe implementimit të akteve nënligjore nga Ligji për material mbëltimi dhe farorë për bimët bujqësore dhe Ligji për të drejtat seleksionuese.

3) Laboratori Fitosanitar Shtetëror – LFSH

Puna e laboratorit varet nga funksionaliteti i sistemit fitosanitar, më saktë nga puna e inspektimit fitosanitar dhe institucionet kompetente për krijimin e politikës fitosanitare në Republikën e Maqedonisë.

4) Në drejtim të përforsimit të kapaciteteve për kryerjen e kontroleve fitosanitare kufitare në Aeroportin Aleksandri i Madh-Shkup është mbaruar ndërtimi i vendit inspektues për kryerjen e kontrollit fitosanitar të dërgesave nga prejardhja bimore në kalimin kufitar nga ana e koncesionerit të Aeroportit Aleksandri i Madh-Shkup, kompania e Turqisë TAV.

5) Sektori për pylltari dhe gjueti

Në periudhën prej 21-23.03.2011 realizohej misioni ekspertë nga Sllovenia nëpërmjet TAIEX programit për përpunimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit për material reproduktiv nga llojet e drunjve pyjor.

Prioritete afatshkurtra

a) Korniza juridike

Aktivitetet ligjvënëse në lidhje me harmonizimin e mëtutjeshëm të legjislacionit nacional me relevanten BE acquis nga sfera fitosanitare do të vazhdojë edhe në vitin 2012 me miratimin e akteve të parapara nënligjore të cilat dalin nga ligjet e përhershme të cilat e rregullojnë politikën fitosanitare.

Në vitin 2012 **Drejtoria Fitosanitare** do të vazhdojë me aktivitetet për harmonizimin e legjislacionit nacional me BE rregullativat. Për atë qëllim është paraparë miratimi i Rregulloreve si vijon: 1) Në pajtim me Ligjin për shëndetin e bimëve është paraparë miratimi i 14 akteve nënligjore edhe atë:

a) ISPM 01 Urdhër për zbatimin e standardit ndërkombëtarë për principet fitosanitare për mbrojtjen e bimëve dhe zbatimi i masave fitosanitare në tregtinë ndërkombëtare;

b) ISPM 06 Urdhër për zbatimin e standardit ndërkombëtarë për udhëzime për mbikëqyrjeve) ISPM 09 Urdhër për zbatimin e standardit ndërkombëtarë për udhëzime për programet për çrrënjosjen e organizmave të dëmshëm,

g) ISPM 17 Urdhër për zbatimin e standardit ndërkombëtarë për njoftim për organizmat e dëmshëm;

d) ISPM 19 Urdhër për zbatimin e standardit ndërkombëtarë për udhëzime për listat e organizmave të dëmshëm të rregulluar;

gj) ISPM 25 Urdhër për zbatimin e standardit ndërkombëtarë për dërgesa në transit;e) ISPM 31 Urdhër për zbatimin e standardit ndërkombëtarë për metodologjinë e marrjes së ekzemplarëve nga dërgesat;

zh) ISPM 33 Urdhër për zbatimin e standardit ndërkombëtarë për patate, material farorë nga patatja të liruara nga organizmat e dëmshëm për tregti ndërkombëtare;

z) Rregullore për formën dhe përmbajtjen e Listës së llojeve alohtone të organizmave, të harmonizuar me dispozitat nga 32000L0029;

x) Rregullore për kushtet teknike të cilat duhet t'i plotësojë kërkuesi për import dhe shfrytëzimi i llojeve alohtone të organizmave, të harmonizuar me dispozitat nga 32000L0029, i) Rregullore për mënyrën e lidhjes së të dhënave të Drejtorisë Fitosanitare me bazat tjera të të dhënave dhe mënyra e grumbullimit të të dhënave nga bazat tjera të të dhënave, të harmonizuar me dispozitat nga:

32000L0029.

j) Rregullore për mënyrën e mbajtjes së evidentimit, regjistrave dhe bazave të të dhënave të cilat janë lidhur me sistemin informativ, e harmonizuar me dispozitat nga: 32000L0029.

k) Rregullore për përmbajtjen, numrin e anëtarëve dhe metoda e punës së Këshillit Profesional, e harmonizuar me dispozitat nga: 32000L0029.

ll) Urdhër për zbatimin e mbikëqyrjes së posaçme për përcaktimin e prezencës së kërpudhave *Synchytrium endobioticum* (Schilb.) Perc. dhe procedurat për hulumtimin laboratorik, i harmonizuar me dispozitat nga: 31969L0464 dhe

l) Urdhër për zbatimin e standardit ndërkombëtarë për projektimin dhe funksionimin e stacioneve të karantinave për bimë të importuara, e harmonizuar me standardin ndërkombëtarë ISRM 34.

2) Në pajtim me Ligjin për prodhime për mbrojtjen e bimëve për periudhën 01.01.-31.12. viti 2012 është paraparë miratimi i 2 akteve nënligjore si vijon: a) Rregullore për të dhënat e nevojshme, dokumentet dhe procedura për lejimin e prodhimeve, që përmbajnë substanca aktive që nuk janë të përfshirë në listën Aneks 1 të cilët kanë kenë prezent në tregun deri në qershor

1993, e harmonizuar me dispozitat nga BE masat: 31991L0414, dhe b) Rregullore për mënyrën dhe procedurën nën të cilat duhet të kryhen eksperimente ose teste, për hulumtimin dhe zhvillimin që përfshijnë lëshimin e prodhimeve të pa lejuara në mjedisin jetësorë dhe prodhim të cilët janë të dobishëm në mënyrë të ndryshme nga ajo që është lejuar, kushtet hapësinore, kadrovike dhe kushtet tjera për personin fizik apo juridik, e harmonizuar me dispozitat nga BE masat: 31991L0414.

3) Në pajtim me Ligjin për hedhurinat për periudhën 01.01.-31.12.2012 është paraparë të miratohen 3 akte nënligjore edhe atë: a.) Rregullore për formën dhe përmbajtjen e deklaramit për kualitet dhe shënim të hedhurinave, e harmonizuar me dispozitat nga BE masat: 32003R2003, b) Rregullore për mënyrën dhe principet për punën e këshillit profesional, të harmonizuar me dispozitat nga BE masat: 32003R2003 dhe v) Rregullore për lartësinë e shpenzimeve për shqyrtim gjatë kontrollit të hedhurinave të cilat prodhohen, importohen apo shiten në tregun, të harmonizuar me dispozitat nga BE masat: 32003R2003.

Deri më 30 dhjetor 2012 do të miratohet Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për material reproduktiv nga llojet e drunjve pyjorë, me qëllim që të arrihet harmonizimi i plotë me Direktivën 1999/105/KE për marketing të materialit reproduktiv dhe me Rregullativën 1598/2002/KE për përcaktimin e rregulla detale për dhënien e ndihmës së huazuar administrative nga ana e organeve kompetente.

b) Korniza institucionale

Për shkak të përdorimit të përforsimit të mëtutjeshëm të kapaciteteve administrative për vitin 2012 janë planifikuar 5 punësime të reja në **Drejtorinë Fitosanitare** që janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me proceset eurointegruese si dhe 5 punësime të reja në **Laboratorinë Fitosanitare Shtetërore (LFSH)**.

Për zbatimin e standardeve ndërkombëtare për masat fitosanitare, përgatitjen dhe zbatimin e mbikëqyrjes së kulturave bujqësore për implementimin e suksesshëm të akteve nënligjore përkatësisht standardeve ndërkombëtare për masat fitosanitare, të nevojshme janë trajnime për inspektorët fitosanitarë për shkak të njoftimit të tyre detal veçanërisht për mbikëqyrjen e kulturave bujqësore i cili do të fillojë në vitin 2012 me zbatimin praktik në teren të cilin do ta zbatojnë inspektorët fitosanitarë në suazat e Inspektoratit Shtetërorë për Bujqësi.

Gjatë vitit 2012 janë paraparë **5 punësime të reja** për shkak të përforsimit të kapaciteteve të Drejtorisë për farë dhe material mbëltime për shkak të realizimit të suksesshëm të aktiviteteve nga sfera e farës dhe materialit për mbëltime, fillimi i procedurës për etiketim të materialit për mbëltime dhe farorë, zbatimi i post-kontrollit të materialit për mbëltime dhe farorë, mbajtjen e regjistrave të furnizuesve të materialit për mbëltime dhe farorë në Drejtorinë, azhurnimi i listës nacionale të llojit, përpunimin e Biltenit dhe punë tjera profesionale në pajtim me rregullativën ligjore). Gjithashtu, Drejtoria për farë dhe material mbëltime në pajtim me Ligjin për material mbëltime dhe farorë për bimët bujqësore, do të lidh marrëveshje në pajtim me autorizimet e dhëna publike personave juridik për kontrollin profesional të prodhimitarisë së mbjelljeve farore dhe plantacione, postkontroll edhe për hulumtimin e llojeve të farave të bimëve bujqësore, si dhe autorizime publike të laboratorive për hulumtimin e materialit për mbëltime dhe farorë, marrjen dhe ruajtjen e ekzemplarëve definitivë të farave në gen bankat.

Për shkak të nevojës nga përforsimi i mëtutjeshëm i kapaciteteve administrative të **Drejtorisë Fitosanitare** që janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me proceset eurointegruese gjatë vitit 2012 janë planifikuar punësime të reja.

Implementimi i ISO 17025 dhe ISTA, dhe kërkesat e nxjerra nga standardet përkatëse, do të vazhdojnë edhe vitin e ardhshëm 2012, me qëllim që të parashtrohet aplikimi në Institutin për akreditim të Republikës së Maqedonisë (IARM) dhe të akreditohen metodat përkatëse. Puna në LFSH varet nga funksionaliteti i sistemit fitosanitar, më saktë nga puna e inspektimit fitosanitar dhe institucionet kompetente për krijimin e politikës fitosanitare në Republikën e Maqedonisë, përkatësisht nga përgatitja e programeve monitorin dhe zbatimi i të njëjtave në teren. Në këtë periudhë /2012/ do të ndërmerren aktivitete për realizimin e 2 punësimeve të reja dhe për vizitën e studimit nëpërmjet TAIXE programit në pjesën e implementimit të Ligjit për material reproduktiv nga llojet e drunjve pyjorë.

Prioritete afatmesme

Korniza juridike

Në pajtim me Ligjin për shëndetin e bimëve ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 29/05, nr 81/08/ nr 20/09 nr 57/10 nr 17/11 dhe nr 148/11) gjatë vitit 2013 përkatësisht 2014 është paraparë miratimi i

24 akteve nënligjore me çka në mënyrë të veçantë do të ndërmerren standardet tjera ndërkombëtare për masat fitosanitare sipas Konventës Ndërkombëtare për mbrojtjen e bimëve (IPPC) edhe atë: ISPM 02, ISPM 04, ISPM 10, ISPM 11, ISPM 13, ISPM 14, ISPM 16, ISPM 18, ISPM 22, ISPM 24, ISPM 26:2006, ISPM 27, ISPM 29, ISPM 30 dhe ISPM 32, si dhe një pjesë nga dispozitat nga Direktiva 32000L0029.

Në bazë të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për material reprodutiv nga llojet e drunjve pyjorë, deri në fund të vitit 2012 do të miratohen akte nënligjore edhe atë: Rregullore për mënyrën e kryerjes së testeve dhe vlerësimin e rezultateve nga testet krahasuese/gjenetike me të cilin plotësisht do të transponohet Direktiva 1999/105/KE për marketing të materialit reprodutiv pyjor; Rregullore për formën dhe përmbajtjen e "Dokumentit informativ" me të cilin do të transponohet Rregullativa 1598/2002/KE për përcaktimin e rregullave detale për dhënien e ndihmës së ndërsjellë administrative nga ana e organeve zyrtare dhe Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për formën dhe përmbajtjen e vërtetimit për material të pranuar bazë, si dhe formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjen së Regjistrit të materialit të pranuar bazë me të cilin do të transponohet Rregullativa 1597/2002/KE për përcaktimin e rregullave për formën e listave nacionale të materialit themelorë të materialit reprodutiv pyjor.

Korniza institucionale

Me qëllim të implementimit të BE standardeve dhe procedurave, si dhe zbatimi i suksesshëm i legjislacionit nacional, janë paraparë trajnime për personat ekzistues dhe të sapopunësuarit. Drejtoria në vitin 2013 do të vazhdojë me obligimin ligjorë për etiketimin e materialit të certifikuar mbëltimi dhe farorë, e tëra me qëllim për kontroll më të mirë dhe ndjekjen e kualitetit të njëjtit. Ky aktivitet siguron evidentimin e prodhimitarisë së materialit të setifikuar nga llojet dhe kontrolli i materialit për mbëltim dhe farorë i cili lëshohet në tregti. Me qëllim të implementimit të BE standardeve dhe procedurave, si dhe zbatimi i suksesshem i legjislacionit nacional, janë paraparë trajnime për personat ekzistues dhe të sapopunësuarit. Për zbatimin më të mirë të politikës fitosanitare nga sfera e Drejtorisë për farë dhe material mbëltimi e nevojshme është ekipimi i plotë i saj, si dhe 5 për 2012. Me qëllim përforcimin e kapaciteteve të Sektorit për pylltari dhe gjueti planifikohet rritja e numrit të resurseve njerëzore dhe sigurimi i trajnimeve profesionale për të punësuarit.

Është e nevojshme përkrahja e vazhdueshme nga projektet ndërkombëtare për përforcimin e kapaciteteve të **Laboratorit Fitosanitare Shtetërore (LFSH)** dhe sjelljen e laboratorit të jetë krahasuese me laboratoritë e njëjta të BE.

Me Projektin IPA 2010 është paraparë pajisja e objektit për kontrollin fitosanitarë të Kalimit Kufitar në Aeroportin "Aleksandri i Madh"-Shkup.

Për shkak të ndjekjes dhe mbikëqyrjes së organizmave të dëmshme tek bimët pyjore dhe vendosjen e pasaportës për bimët pyjore në suazat e Inspektoratit Shtetërorë për bujqësi, Drejtoria Fitosanitare dhe Labororit Fitosanitare Shtetërore (LFSH) e nevojshme është përforcimi i kapaciteteve të institucionit planifikohet rritja e numrit të resurseve njerëzore dhe sigurimi i trajnimeve profesionale për të punësuarit. Për atë qëllim e nevojshme është gjithashtu edhe punësimi i kuadrit inspektues me profil arsimor inxhinier pyjor dhe trajnimet e të njëjtit për shkak të efikasitetit në kryerjen e kontrollit fitosanitar.

3.13 PESHKATARIA GJENDJA RRJEDHËSE

KORNIZA JURIDIKE

Sfera e peshkatarisë dhe akuakulturës është e rregulluar me Ligjin për peshkatari dhe akuakulturë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 7/2008 dhe 67/2010, 47/2011 dhe 53/2011). Në bazë të ligjit, janë përpunuar dhe janë miratuar 24 rregulla shoqëruese të cilat janë shpallur në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 53 dhe 54 prej vitit 2008 dhe numër 7 dhe 94 prej vitit 2009 93, 117 dhe 162 prej vitit 2010 dhe 24 dhe 109 prej vitit 2011.

Përveç Ligjit për peshkatari dhe akuakulturë, korniza juridike në sferën e përbëjnë edhe një paket i ligjeve nga sfera e veterinarisë, përkatësisht Ligjit për shëndetësi veterinarë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 113/07) dhe Ligji për shëndetësi publike veterinarë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 114/07) si dhe Ligji për Inspektoratin Shtetërorë për bujqësi ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 20/09) dhe rregullat e miratuara shoqëruese në bazë të këtyre ligjeve. Ligjet dhe aktet nënligjore paraqesin bazë për rregullimin e

mëtutjeshëm të materies dhe politikës në sferën e peshkatarisë dhe akuakulturës në pajtim me principet e Politikës së Përbashkët për peshkatari të BE.

Në pjesën e **menaxhimit me resurset, inspektimit dhe kontrollit në peshkatari**, dispozitat nga Ligji për peshkatari dhe akuakulturë dhe rregullat shoqëruese të cilat më afër e rregullojnë këtë materie, kanë të bëjnë me definimin e ujërave për peshkatari, mënyrën e kryerjes së peshkatarisë ekonomike dhe rekreative dhe mjetet e lejuara të peshkatarisë për kryerjen e peshkatarisë, procedurat për rruajtjen e peshqve (akuakultura), si dhe prodhimtaria e materialit për peshkim. Në funksion të shfrytëzimit të përhershëm të peshqve nëpërmjet zhvillimit të qëndrueshëm, në bazë të ligjit, janë përpunuar dhe miratuar bazat e peshkimit për tre rajone të peshkatarisë (liqenet natyrore), nëntë liqene më të mëdha artificiale, për të gjitha pellgjet e peshkimit në Republikën e Maqedonisë me caktimin e zonave rekreative dhe baza peshkimi për akumulacionet më të vogla të territorit të Republikës së Maqedonisë dhe të njëjtat janë shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” nr. 66/11 dhe 145/11.

Aktivitetet strukturore, në pajtim me dispozitat nga Ligji për peshkatari dhe akuakulturë rregullohen nëpërmjet programeve vjetore për përkrahjen financiare në peshkatarinë dhe akuakulturën, të cilat i sjell Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Politika e tregut krahas Ligjit për peshkatari dhe akuakulturë dhe rregullat shoqëruese të cilat kanë të bëjnë me organizimin dhe shoqërimin në peshkatarinë, vendet për shitjen e parë të peshkut si dhe kualitetit, madhësia dhe mënyra e deklarimit të peshqve të cilat vihen në qarkullim është e rregulluar edhe me rregullativën ligjore nga pjesa e veterinarisë e cila ka të bëjë me peshkatarinë dhe akuakulturës.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Në suazat e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, Seksioni për peshkatari dhe akuakulturë (Sektori për bujqësi) është kompetente për përgatitjen, propozimin dhe mbikëqyrjen mbi zbatimin e dispozitave nga ligji për peshkatari dhe akuakulturë, si dhe për çështjet drejtuese dhe profesionale nga sfera e peshkatarisë. Në seksionin për peshkatari dhe akuakulturë janë punësuar dy persona.

Në mënyrë të drejtpërdrejtë përgjegjës për mbikëqyrjen mbi zbatimin e dispozitave nga Ligji për peshkatari dhe akuakulturë është Inspektorati Shtetërorë për bujqësi, i cili është organ në përbërje të MBPEU. Në Seksionin për mbikëqyrje inspektuese nga sfera e peshkatarisë dhe akuakulturës pranë ISHB për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese janë punësuar gjithsej 9 persona, ndërsa në Seksionin për mbrojtjen e ujërave të peshkimit janë punësuar 6 persona.

Mbrojtja shëndetësore e peshqve, si dhe siguria e prodhimeve nga peshkataria të cilat plasohen në tregun janë në kompetencë të Agjencisë për ushqim dhe veterinar.

Për realizimin e aktiviteteve në pjesën e **menaxhimit me resurset, inspektimin dhe kontrollin në peshkatari** nga numri i përgjithshëm i të punësuarve në Seksionin për peshkatari dhe akuakulturë kompetent është një person, ndërsa në pjesën e kontrollit inspektues janë punësuar 4 persona në Seksionin për mbikëqyrje inspektuese nga sfera e peshkatarisë dhe akuakulturës pranë ISHB.

Për realizimin në pjesën e **aktiviteteve strukturore dhe politikës së tregut** në Seksionin për peshkatari dhe akuakulturë kompetent është një person, ndërsa për qëllimet e kryerjes më efikase të mbikëqyrjes dhe kontrollit në sferën janë punësuar 2 persona.

Për realizimin e aktiviteteve në pjesën e **politikës së tregut** për qëllimet e kryerjes më efikase të mbikëqyrjes dhe kontrollit në sferën në ISHB janë punësuar 2 persona.

Përveç kësaj, në suazat e Seksionit për peshkatari dhe akuakulturë, sektori për bujqësi mbahet evidencë për qendrat prodhuese të regjistruara, prodhuesit e materialit të peshkimit nga baseni i peshqve i dedikuar për qarkullim, ruajtësit e peshqve, si dhe shfrytëzuesit (koncesionerët)

e peshqve nga ujërat e hapura për peshkim, me të gjitha të dhënat e nevojshme për mbikëqyrjen e situatave në sferën. Është vendosur edhe regjistri i ndihmës shtetërore në peshkatarinë.

PRIORITETE AFATSHKURTRA

KORNIZA JURIDIKE

Në sferën e peshkatarisë në të ardhmen e afërt, përveç disa plotësimeve të domosdoshme për mbikëqyrjen e procesit euro-integrues, nuk është paraparë miratimi i ligjeve nga kjo sferë.

Rregullat shoqëruese të cilat janë miratuar kanë të bëjnë me **menaxhimin me resurset, inspektimin dhe kontrollin në peshkatari**, ndërsa i saktësojnë në mënyrë të plotë dispozitat rreth shfrytëzimit të resurseve natyrore (peshqit) nëpërmjet rregullimit të plotë të mënyrës së kryerjes së peshkimit rekreativ. Në këtë rajon, për riformim të kornizës juridike janë përpunuar baza të peshkimit për ujërat për peshkim në Republikën e Maqedonisë dhe të njëjtat janë shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë.

Në tremujorin e parë të vitit 2012 në sferën e **aktiviteteve strukturore** është paraparë miratimi i Programit vjetor për përkrahje financiare në peshkatarinë dhe akuakulturën në vitin 2012, me mënyrë/udhëzim për realizimin e të njëjtave, si dhe miratimi i Programit për përparimin e peshkatarisë dhe akuakulturës në Republikën e Maqedonisë për periudhë prej 12 vitesh.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Për përforcimin e kapacitetit administrativ gjatë vitit 2012 në Seksionin për peshkatari dhe akuakulturë parashikohet punësimi i një personi për rajonin e **politikës së tregut**, duke pasur parasysh zgjerimin e vëllimit të punës në sferën, ndërsa për përforcimin e kontrollit inspektues dhe kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese në sferën, në Seksionin për mbikëqyrje inspektuese të peshkatarisë dhe akuakulturës pranë ISHB në vitin 2012 duhet të punësohen 7 persona plotësues.

PRIORITETE AFATMESME

KORNIZA JURIDIKE

Në këtë periudhë kohore do të përpunohen dhe realizohen programet vjetore për përkrahjen financiare në peshkatarinë dhe akuakulturën në vitin 2013 dhe 2014.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Për shkak të zgjerimit të vëllimit të aktiviteteve në sferën e përforcimit të kapacitetit administrativ, në afat të mesëm në Seksionin për peshkatari dhe akuakulturë parashikohet punësimi i një personi, ndërsa në Seksionin për mbikëqyrje inspektuese të peshkatarisë dhe akuakulturës pranë ISHB punësimi i edhe 2 personave.

3.14. POLITIKA TRANSPORTUESE

3.14.1 KOMUNIKACIONI RRUGOR

GJENDJA RRJEDHËSE

KORNIZA JURIDIKE

Qasja në treg

Në pjesën e qasjes në treg ligji amë është Ligji për transport në komunikacionin rrugor me të cilin rregullohen kushtet dhe mënyra e kryerjes së transportit të udhëtarëve dhe mallit në komunikacionin e brendshëm dhe ndërkombëtar rrugor.

Është miratuar Ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për transport në komunikacionin rrugor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 68/04, 127/06, 114/09, 83/10, 140/10, 17/11 dhe 53/11) me qëllim të implementimit të plotë të rregullave nga Bashkimi Evropian. Pikërisht, është transponuar rregullativa 1071/09, me atë që shuma (kapital dhe rezerva) prej më së paku 9000 euro për automjetin e parë dhe nga 5000 euro për secilin automjet të ardhshëm gjatë vërtetimit të stabilitetit financiar të firmave të cilat merren me lloje të ndryshme të transportit në komunikacionin rrugor, filloi të vlejë prej 01.09.2011. Përndryshe, në Ligjin për transport në

komunikacionin rrugor janë implementuar më shumë direktiva dhe rregullativa të Këshillit të Bashkimit Evropian edhe atë: Rregullativa nr. 1071/09/KE, Direktiva 96/96/KE, Direktiva 2000/30/KE, Direktiva 84/647/KEE, Rregullativa 56/83/KEE, Rregullativa 684/92/KEE, Rregullativa 881/92/KEE, Rregullativa 3118/93/KEE, Rregullativa 792/94/KE, Rregullativa 3315/94/KE, Rregullativa 12/98/KE, Rregullativa 2121/98/KE, Direktiva 59/03/KE, Direktiva 94/06/KE.

Infrastruktura rrugore

Në pjesën e infrastrukturës rrugore, Ligji për rrugët publike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 84/08, 52/09, 114/09, 124/10, 23/11 dhe 53/11) i rregullon kushtet dhe mënyrën e ndërtimit, rikonstruktimit, mirëmbajtjen, mbrojtjen, shfrytëzimin, menaxhimin, financimin e rrugëve publike, si dhe mbikëqyrjen. Në Ligjin janë implementuar direktivat si vijon: Direktiva 62/99/KE, Direktiva 52/04/KE.

Materie të rrezikshme

Transporti i materieve të rrezikshme është i rregulluar me Ligjin për transport të materieve të rrezikshme në komunikacionin rrugor dhe hekurudhor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 92/2007; 147/2008; 161/2009; 17/2011 dhe 54/2011) në të cilin janë rregulluar kushtet nën të cilat kryhet transporti i materieve të rrezikshme (përgatitja e materies, ngarkimi, transporti, manipulime të rrugës, istivar, siguri në transportin, pajisjen e automjeteve dhe trajnim i kuadrove). Në Ligjin janë implementuar masat vijuese nga legjislacioni i BE: Direktiva 94/55/KE, Direktiva 2000/61/KE, Direktiva 2001/7/KE, Direktiva 95/50/KE, Direktiva 2001/26/KE, Direktiva 2004/112/KE, Direktiva 1996/35/KE, Direktiva 2000/18/KE, Direktiva 98/91/KE, Direktiva 96/49/KE, Direktiva 2006/90/KE. Në bazë të Ligjit janë miratuar të gjithë aktet nënligjore të cilat dalin nga i njëjti.

Në Ligjin për transportin e materieve të rrezikshme në komunikacionit rrugor dhe hekurudhor, është transponuar një pjesë nga direktiva 94/63/KE e cila ka të bëjë me specifikimet për automjetet cisterna.

Çështje sigurimi

Me Ligjin për kohën e punës, pushimet e detyrueshme të punëtorëve mobil dhe pajisjet për regjistrimin në komunikacionin rrugor rregullohet çështja për futjen e takografëve digjital në automjetet ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 161/09, 17/11 dhe 54/11. Në Ligjin janë imlementuar masat vijuese nga legjislacioni i BE: Rregullativa nr. 3821/85/KEE, Rregullativa 561/2006/KE, Direktiva 2006/22/KE, Direktiva 2002/15/KE.

Me Ligjin për sigurimin e komunikacionit rrugor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 54/07, 86/08, 98/08, 64/09 dhe 161/09) janë përcaktuar masat për sigurimin dhe mbrojtjen e rrugëve, parimet themelore dhe marrëdhëniet e ndërsjella të pjesëmarrësve dhe subjekteve në komunikacionin e rrugëve, rregullat e komunikacionit të rrugëve, shenjat e komunikacionit dhe pajisjet e rrugëve, detyrimet në rast të fatkeqësisë, shoferët, automjetet, pajisjet që duhet t'i kenë automjetet, masat e veçanta të sigurisë e tjerë. Në Ligjin janë imlementuar masat vijuese nga legjislacioni i BE: 2002/85/KE, 1996/53/KE, 1991/671/KE, 1985/3820/KE, 1985/3821/KE, 1991/439/KE, 1997/26/KE, 2002/15/KE, 2004/11/KE, 1992/6/KE, 2000/56/KE, 1996/47/KE, 1996/96, 2003/127, 1989/459/KE, 1988/599/KE.

Në bazë të Ligjit janë miratuar të gjithë aktet nënligjore të cilat dalin nga i njëjti.

Me Ligjin për automjetet ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 140/08), rregullohet kontrolli i automjeteve, regjistrimi i automjeteve dhe kontrolli teknik i automjeteve. Në bazë të Ligjit janë miratuar të gjithë aktet nënligjore të cilat dalin nga i njëjti.

Ministria e Punëve të Brendshme me qëllim të rritjes së sigurimit të komunikacionit të rrugëve, përgatiti dhe miratoi "Program për përparimin e sigurisë në komunikacionin rrugor" i cili zbatohet në teren me qëllim të përmirësimit të sigurisë së gjendjes së rrugëve.

Me Strategjinë nacionale për përparimin e sigurisë së komunikacionit të rrugëve 2009-2014 parashikohen nevoja afatgjate të shtetit për ndërmarrjen e masave të planit dhe aktivitete në pjesën e sigurisë së komunikacionit dhe tregon gatishmëri të shtetit për zgjidhjen e problemeve në këtë segment. Ishte miratuar edhe Plani aksional për zbatimin e strategjisë, në bazë të të cilit maten indikatorë për rritjen e sigurisë së komunikacionit.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Ministria e Transportit dhe Lidhjeve

Organet kompetente për implementimin e punëve që kanë të bëjnë me transportin e udhëtarëve dhe mallrave në komunikacionin e brendshëm dhe ndërkombëtarë rrugor janë:

Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, Inspektorati shtetërorë për transport – organ në përbërje të Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve i autorizuar për mbikëqyrje inspektuese, Ministria e Financave – Drejtoria Doganore dhe Njësitë e Vetadministrimit Lokal.

Në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve ekzistojnë katër seksione në suazat e Sektorit për komunikacionin rrugor dhe infrastrukturë për punën rreth transportit të udhëtarëve dhe mallrave në komunikacionin rrugor dhe infrastrukturës rrugore. Në Sektorin për komunikacionin rrugor dhe infrastrukturë pranë Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve punojnë gjithsej 28 persona.

Në Sektorin për komunikacion rrugor dhe infrastrukturë përfundimisht me nëntorin 2011 janë dhënë:

- 2891 licenca për kryerjen e transportit të mallrave në komunikacionin rrugor dhe
- 583 licenca për kryerjen e transportit të udhëtarëve në komunikacionin rrugor,
- 11713 certifikate për pjesëmarrjen e shoferëve në komunikacionin ndërkombëtarë rrugor dhe
- 5230 certifikate për komponentë profesionale të udhëheqësve ose persona të autorizuar për kryerjen e transportit në kompanitë transportuese.

Ministria e Transportit dhe Lidhjeve është institucion kompetent për përgatitjen e të gjitha akteve juridike të cilat dalin si obligime në pajtim me Ligjin për rrugët publike, ndërsa institucione kompetente për implementimin e Ligjit për rrugët publike janë: Agjencia për rrugët shtetërore dhe Njësitë e vetadministrimit lokal.

Në suazat e Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve punët nga sfera e infrastrukturës rrugore janë në kompetencë të Seksionit për infrastrukturën rrugore në Sektorin për komunikacion rrugor dhe infrastrukturë. Në seksionin janë punësuar dy persona me arsim të lartë.

Në pajtim me Ligjin për Rrugët publike është zgjedhur person juridik për dhënien e shërbimeve ndihmë në rrugë.

Në lidhje me transportin e materieve të rrezikshme në komunikacionin rrugor dhe hekurudhor, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve është organ kompetent për përgatitjen e rregullativës ligjore dhe implementimin e dispozitave ligjore. Në suazat e Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve, në Sektorin për komunikacionin rrugor dhe infrastrukturë funksionon seksioni për transportin e materieve të rrezikshme në të cilin janë punësuar dy persona me arsim të lartë.

Në Sektorin për komunikacion rrugor dhe infrastrukturë përfundimisht me muajin nëntor 2011 janë dhënë:

- 162 certifikata për këshilltarë për siguri gjatë transportit të materieve të rrezikshme
- Dhënësi i autorizuar i kartelave të memories për takografë digjitalë në periudhën e kaluar ka dhënë gjithsej:
- 2945 kartela të memories, prej të cilat: 2713 kartela vozitëse, 191 kartela transportuese, 40 kartela punuese dhe 1 kartelë kontrolluese

Në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve në rrjedhë është furnizimi i pajisjes për kryerjen e kontrollit të përdorimit të takografëve digjital. Është nënshkruar marrëveshja më 25.11.2011 për furnizimin e pajisjes për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese për kontrollin e kohës së vozitjes së shoferëve në komunikacionin rrugor me ndihmën e rregullave për regjistrim a.q. takografë dhe në pajtim me marrëveshjen të njëjtat do të dorëzohen në afat prej 15 ditësh nga dita e nënshkrimit të marrëveshjes. Pas dorëzimit të pajisjeve, përkatësisht më së voni prej 01.02.2012 Inspektorati Shtetërorë për transport dhe Policia e komunikacionit do të fillojnë me zbatimin e kontrolleve me çka në mënyrë të drejtpërdrejtë do të ndikohet mbi përmirësimin e sociales acquis.

Në ditën 29.08.2011 u mbajt mbledhje e Trupit koordinues për sigurinë e komunikacionit të rrugëve me qëllim të shqyrtimit të raportit për aktivitete të realizuara nga "Plani aksional për zbatimin e Strategjisë për përparimin e sigurisë së komunikacionit të rrugëve dhe indikatorët nga institucionet kompetente për aktivitetet e zbatuara". Në bazë të konkludimeve nga mbledhja e mbajtur KPE e informoi KE për aktivitetet e realizuara nga Plani aksional.

Inspektorati Shtetëror i Transportit

Në Inspektoratin Shtetëror të Transportit funksionojnë 3 seksione për mbikëqyrje inspektuese të rrugëve, komunikacionit rrugor dhe transportit. Inspektorati Shtetëror për Transport

ka gjithsej 42 persona të punësuar nga të cilët 10 janë inspektorë për rrugët publike dhe 17 janë inspektorë për komunikacionin rrugor.

Në 2011 (janar-tetor) Inspektorati Shtetërorë për Transport i ka zbatuar kontrollet inspektuese si vijon:

Inspektorët shtetërorë për rrugë përfundimisht me tetor 2011:

- Kanë përpiluar gjithsej 1484 procesverbale për mbikëqyrje të kryera,
- Kanë miratuar gjithsej 271 aktvendime
- Kanë parashtruar gjithsej 244 kërkesa te gjykata për ngritjen e procedurës kundërvajtëse,

- Kanë parashtruar gjithsej 357 kërkesa për ngritjen e procedurës kundërvajtëse te komisioni,

- Kanë dhënë 119 urdhërpagesa dhe
- Kanë dhënë 328 ftesa për arkëtim të gjobës.

Inspektorët shtetërorë për rrugë përfundimisht me tetor 2011:

- Kanë përpiluar gjithsej 3765 procesverbale për mbikëqyrje të mbaruar,
- Kanë miratuar gjithsej 1172 aktvendime
- Kanë parashtruar gjithsej 890 kërkesa te gjykata për ngritjen e procedurës kundërvajtëse,

- Kanë parashtruar gjithsej 684 kërkesa për ngritjen e procedurës kundërvajtëse te komisioni,

- Kanë dhënë 262 urdhërpagesa dhe
- Kanë dhënë 467 ftesa për arkëtimin e gjobës.
- Kanë përjashtuar nga komunikacioni 50 automjete dhe
- Kanë konfiskuar 31 automjete.

Gjithashtu Inspektorati Shtetëror për Transport në punën e vet është i lidhur me Drejtorinë Doganore, ashtu që në pajtim me Ligjin për transport në komunikacionin rrugor Drejtoria Doganore, në kalimin kufitar përkatësisht në vend tjetër ku kryhet mbikëqyrje doganore, kontrollon nëse transportuesi i vendit ose i huaj ka patentë shoferi dhe dokumente tjera përkatëse të përcaktuara me Ligjin për kryerjen e llojit përkatës për transport, si dhe nëse transportuesi e kryen transportin në pajtim me ato dokumente. Nëse përcaktohet se transportuesi në automjetin nuk ka patentë shoferi ose dokument tjetër të nevojshëm ose se të njëjtat nuk i shfrytëzon në mënyrë të rregullt, Drejtoria Doganore do të ndalojë hyrjen ose daljen e automjetit në ose nga Republika e Maqedonisë.

Në rrjedhë është realizimi i projektit për Përforsimin e kapaciteteve administrative dhe operative të Inspektoratit shtetërorë për transport për zbatimin efikas të legjislatives në transportin rrugorë të financuar nëpërmjet mjeteve nga IPA fondet, qëllimi i të cilave është të mundësohet përmirësimi i plotësuar i kapaciteteve operative, të menaxhimit dhe administrative të ISHT që njëherësh do të thotë edhe rritjen e numrit të inspektimeve të kryera. Projekti përfshin zbatimin e trajnimit: “Zbatimi i kontrolleve inspektuese gjatë kryerjes së transportit të udhëtarëve dhe mallrave në komunikacionin rrugorë nga ana e inspektorëve nga Inspektorati Shtetërorë për Transport”. Me trajnimin do të përfshihen 10 persona. Deri në mesin e dhjetorit 2011 do të përgatitet listë e shkurtër e ofruesve të parakualifikuar. Në fazën e rikualifikimit evaluohen 12 firma.

Agjencia e Rrugëve Shtetërore

Në Agjencinë e Rrugëve Shtetërore funksionojnë 4 sektorë, në suazat e të cilave ka 11 seksione dhe 4 seksione të pavarura, ndërsa numri i përgjithshëm i të punësuarve arrin 53 persona.

Në pajtim me Ligjin, Agjencia për rrugët shtetërore përgatit propozim Program vjetor për punët në lidhje me planifikimin, financimin, ndërtimin, rikonstruktimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve shtetërore në Republikën e Maqedonisë. Programin e miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Në lidhje me ripërtëritjen e sinjalizimit të komunikacionit në Republikën e Maqedonisë është përgatitur Projekt për ripërtëritjen e sinjalizimit të komunikacionit për Korridor 10 dhe për rrugët magjistrale. Është nënshkruar Marrëveshja për vendosjen e sinjalizimit horizontal dhe vertikal në autostradën A1/E75: Kalimi kufitar Tabanovc, Rafineria – nyja Milladinovc me trap për pagesë, Aeroporti Aleksandri i Madh-nyja Petrovec me trap për pagesë, kalimi kufitar Bogorodicë. Vlera e marrëveshjes arrin 53.218.000,00 denarë.

Përfundimisht me muajin tetor 2011 numri i përgjithshëm i sinjalizimit të vendosur të komunikacionit në territorin e Republikës së Maqedonisë arrin 3706 shenja.

Në lidhje me modernizimin e stacioneve për arkëtim dhe vendosjen e sistemit elektronik për arkëtim të taksave rrugore për gjatë Korridorit 10, në suazat e kreditit nga EBRD për këtë projekt janë siguruar mjete në shumë prej 17 milionë euro për zgjerimin dhe adaptimin e 5 stacioneve ekzistuese për arkëtim (Rramanli, Petrovec, Sopot, Otovicë dhe Gradsko) dhe ndërtimi i 4 stacioneve të reja për arkëtim (Tabanovc, Negotinë, Demir Kapi dhe Gjevgjeli), si dhe furnizim dhe instalim të sistemit të ri të integruar për arkëtim të taksave rrugore të stacioneve të përmendura për arkëtim. Projekti zhvillohet në 2 faza gjatë së cilës 1 fazë përfshin zgjerimin dhe adaptimin e 5 stacioneve ekzistuese për pagesë dhe 1 stacion i ri për pagesë ndërsa faza 2 përfshinë ndërtimin e 3 stacioneve të reja për arkëtim. Faza e parë ka filluar me shpalljen e shpalljes së përgjithshme për furnizimin e punëve ndërtimore për ndërtimin dhe instalimin e arkëtitimit të taksave në Korridor 10. Gjithashtu është zgjedhur edhe konsultat për ndihmë gjatë implementimit të sistemit për arkëtim të taksës dhe përpunimin e dokumentacionit të tenderit.

Gjithashtu, janë vendosur post-terminale në të gjithë stacionet për arkëtim dhe tash më është mundësuar pagesa në taksat rrugore me kartelë pagesore.

Agjencia për rrugët shtetërore në vitin 2011 i ka aktivitetet vijuese të financuara me ndihmë të huaj:

- Është realizuar ndërtimi i pjesës së autostradës Tabanovc-Kumanovë (Korridori 10) dhe në mënyrë oficiale është lëshuar në përdorim më 08.09.2011. Kostoja totale e projektit arrinte 12,6 milionë euro.

- Segmenti rrugor Demir Kapi-Smokvicë (Korridori 10)- është mbyllur konstruksioni financiar, vlera e punëve ndërtimore arrin 245 milionë euro, ndërsa mjetet janë siguruar nëpërmjet EIB, EBRD dhe IPA. Dokumentacioni i tenderit është plotësisht i harmonizuar me Delegacionin e BE. Në rrjedhë është procedura e tenderit për zgjedhjen e realizuesit, ndërsa hapja publike e ofertave është më 06.12.2011.

- Për segmentet rrugore nga Korridori 8 të cilat ishin një pjesë nga paketat e koncesionit, në Këshillin Ekonomik të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë shqyrtohen mundësitë dhe modelet për realizimin e fazës së pjesëve.

- Projekt për përmirësimin e rrjetit ekzistues rajonal dhe lokal rrugor në shumë prej 70 milion euro i financuar nëpërmjet Bankës Botërore. Përfundimisht me tremujorin e III 2011, nga fillimi i Projektit janë tërhequr 35,9 milionë euro dhe të paguara janë nga mjetet personale për TVSH 7,25 milionë euro.

Projekt për përmirësimin e rrjetit ekzistues rajonal dhe lokal rrugor në shumë prej 50 milionë euro i financuar nëpërmjet EBRD Gjatë vitit 2011 janë tërhequr 7,3 milionë euro.

Gjatë vitit 2011 përfundimisht me 15.11.2011 janë mbaruar gjithsej 56 rrugë lokale të financuara nëpërmjet Bankës Botërore dhe EBRD. Gjithashtu janë mbaruar edhe të gjitha rrugët rajonale të financuara nëpërmjet Bankës Botërore.

Ministria e Punëve të Brendshme

Ministria e Punëve të Brendshme është organ kompetent për implementimin e punëve që kanë të bëjnë me sigurimin dhe kontrollin e komunikacionit të rrugëve. Strukturat kompetente në Ministrinë e Punëve të Brendshme të cilat kujdesen për sigurinë e komunikacionit rrugor janë: Sektori i policisë dhe punëve kriminalistike të Byrosë për siguri publike; 8 Stacione policore për sigurinë e komunikacionit rrugor, 26 Seksione policore për sigurinë e komunikacionit rrugor dhe 3 stacione policore për sigurinë e komunikacionit rrugor të autostradave.

Gjatë vitit 2011 përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Brendshme nga pjesa e preventivës në sigurinë në komunikacionin e rrugëve ka realizuar më shumë fushata dhe aktivitete ndër të cilat:

- Përfaqësimi në medime të nëpunësve të uniformuar policorë në medime elektronike dhe të shtypura në medimeve lokale dhe nacionale (rregullisht)

- Organizimi dhe zbatimi i këshillave të komunikacionit të cilat kanë të bëjnë me të gjithë pjesëmarrësit në komunikacionin, (rregullisht)

- Organizimi dhe zbatimi i aksioneve edukative arsimore për pjesëmarrësit e rinj në komunikacionin për nxënësit nga klasa e parë deri në klasën e katërt "Në mënyrë të sigurt nga shtëpia deri në shkollë" dhe e njëjta kryhet me ndihmën e poligoneve mobil auto-komunikues (rregullisht)

- Fushata për kufizimin e shpejtësisë, (rregullisht)

- Fushata për rrezikun nga menaxhimi me automjet nën ndikimin e alkoolit dhe të substancave tjera psihotrope, (rregullisht)
- Është zbatuar aksioni “Semaforë fëmijërorë” në bashkëpunim me KRSKRR, (rregullisht)

• Gjatë punës së vet në vitin 2011 MPB ka zbatuar 41 kontrolle selektive në nivel republikan me qëllim të rritjes së sigurisë së komunikacionit në rrugë, ndërsa kontrollet e zbatuara janë për:

- Kontrolle të përgjithshme, (pesë kontrolle selektive republikane),
- Drejtim të automjetit nën ndikimin e alkoolit, drogës dhe substancave tjera psihitropike, (gjashtë kontrolle selektive republikane),
- Tejkalimin në kundërshtim me rregullat e komunikacionit të rrugës, (pesë kontrolle selektive republikane),
- Drejtimin e automjetit me shpejtësi të papërshtatshme sipas kushteve të rrugës (gjashtë kontrolle selektive republikane),
- Kontroll të këmbësorëve si pjesëmarrës në komunikacionin, (katër kontrolle selektive republikane),
- Kontroll mbi vozitësin e biçikletës me motor ndihmës, moped, motoçikletë, triçikletë e lehtë, triçikletë, katërçikletë e lehtë dhe katërçikletë dhe personat të cilat transportohen (pesë kontrolle selektive republikane),
- Kontrolli i rregullsisë teknike të taksi-automjeteve dhe autobusë, (pesë kontrolle selektive republikane),
- Mosrespektimi i rregullave në komunikacionin në lidhje me mosdhënien e përparësisë së kalimit, (pesë kontrolle selektive republikane),

Si rezultat i punës së Ministrisë së Punëve të Brendshme, në periudhën prej 01.01 deri 01.10.2011 janë ndërmarrë gjithsej 229 305 masa, nga të cilat:

- Aksidente me kualifikimin e kundërvajtjeve – 5519,
- Kërkesa të parashtruara për ngritjen e procedurës kundërvajtëse - 88871,
- Pjesëmarrës të paralajmëruar në komunikacionin – 19892,
- Patenta shoferi të marra përkohësisht – 3172,
- Sanksione të zbatuara, ndalim për drejtimin e automjetit – 1430,
- Vozitës të udhëzuar në kontroll mjekësor – 48,
- Vozitës të përjashtuar nga komunikacioni – 12321,
- Automjete të përjashtuara nga komunikacioni – 11775,
- Automjete të udhëzuara në kontroll të pa rregullt teknike – 2598,
- Të thirrur në këshilla të komunikacionit për kundërvajtje të bërë komunikacioni – 1854,
- Vozitës të arrestuar – 66,
- Vozitës të mbajtur – 6,
- Marrja e gjakut dhe urinës për analizë – 799 dhe
- Alkotest i përdorur – 40689 dhe kanë treguar shenja të alkoolit – 4407.

Plotësisht është ringjallur regjistrimi i pikëve negative për shoferët e automjeteve të cilët kanë bërë kundërvajtje në pajtim me dispozitat nga Ligji për sigurinë e komunikacionit të rrugëve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 54/07, 86/08, 98/08, 64/09 dhe 161/09).

Gjatë vitit 2011 niveli i sigurisë së komunikacionit të rrugëve është ngritur në nivel më të lartë me vet faktin se është kryer rikonstruktimi i më shumë akseve rrugore të territorit të Republikës së Maqedonisë, ndërsa me atë është kryer ripërtëritja e shenjave të komunikacionit, pajisja dhe sinjalizimi i të njëjtave.

Është formuar dhe fokusuar Trupi koordinues për sigurinë e komunikacionit të rrugëve, qëllimi i të cilit është ndjekja e përparimit në lidhje me realizimin e Strategjisë nacionale, në të cilën përfaqësues të vet kanë të gjitha institucionet dhe personat juridik të cilët kanë kompetencë në cilin do segment nga siguria në komunikacionin e rrugëve.

Ministria e Punëve të Brendshme gjatë vitit 2011 grumbullon dhe kryen analizë të të dhënave me qëllim të zbulimit të pjesëve nga rrugët me rrezik të madh, sipas numrit të aksidenteve të bëra me qëllim që të ndërmerren masa në bashkëpunim me institucionet tjera kompetente për riparimin dhe mënjanimin e tyre.

Ministria e Punëve të Brendshme ka pjesëmarrje aktive në përgatitjen dhe zbatimin e një numri të madh të kampanjave qëllimi i të cilave është rritja e sigurisë së komunikacionit të rrugëve nëpërmjet incizimit dhe emetimit të videove të cilat janë të përfshira në mediumet e shtypura dhe elektronike në Republikën e Maqedonisë.

Këshilli republikan për siguri të komunikacionit të rrugëve

Këshilli republikan për sigurinë e komunikacionit të rrugëve e realizoi planin aksional për vitin 2011 në të gjitha elementet e veta. Indikatorët e Këshillit janë kryesisht pozitive, përveç në aktivitetet të cilat kërkojnë mjetet më të mëdha financiare, por nuk ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi treguesit e sigurisë (përkthimi i librave, furnizimi i literaturës.....). Indikatorit për fëmijët e përfshirë për edukim në komunikacionin 2010/2011 është 102%, indikatorit fëmijë të përfshirë në gara nga sfera e komunikacionit 2010/2011 është 50%, numri i materialeve të incizuara edukative (libër e komunikacionit për më të rinj) indikatorit 2010/2011 është 300%.

Këshilli e përforcoi aktivitetin e vet në sferën e preventivës, edukimit dhe etikës në komunikacionin, por edhe ngritjen e vetëdijes publike për vlerën e sigurisë së komunikacionit. Në atë kuptim është përgatitur program për trajnim për të rinjtë në shkollat e mesme. Është afirmuar vlera e dekadës për siguri të komunikacionit të rrugëve të KB me animimin dhe inkuadrimin direkt të kryetarit të Republikës së Maqedonisë.

Këshilli në bashkëpunim me planin aksional për vitin 2011 organizoi edhe mbledhje për përgjegjësinë individuale dhe korporatave në komunikacionin në bashkëpunim me kryqin e kuq dhe me Armatën e RM-së.

PRIORITETE AFATSHKURTRA KORNIZA JURIDIKE

Qasja në tregun e përbashkët të transportit

Për shkak të rregullimit të plotë të marrëdhënieve në komunikacionin rrugor me vendet nga Evropa, gjatë vitit 2012 planifikohet lidhja e Marrëveshjeve për transportin ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave me vendet me të cilat Qeveria e Republikës së Maqedonisë ende nuk ka lidhur marrëveshje.

- Marrëveshje për transport rrugor ndërkombëtar me Republikën e Çekisë, 31.03.2012.
- Marrëveshje për transport rrugor ndërkombëtar me Mbretërinë e Suedisë, afati 31.12.2012.
- Marrëveshje për transport rrugor ndërkombëtar me Republikën e Finlandës, afat 31.12.2012.
- Marrëveshje për transport rrugor ndërkombëtar me Republikën e Lituanisë, afat 31.12.2012.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Ministria e Transportit dhe Lidhjeve

Secila kompani transportuese në Republikën e Maqedonisë i cila i plotëson kushtet e parapara në Ligjin për transport në komunikacionin rrugor dhe aktet nënligjore të cilat dalin nga i njëjti, mund të aplikojë për marrjen e licencës për kryerjen e llojeve të veçuara të transportit në komunikacionin rrugor. Në vazhdimësi jepen certifikate për pjesëmarrjen e shoferëve në komunikacionin ndërkombëtar rrugor, certifikate për kompetentë profesionale të udhëheqësve ose personave të autorizuar për kryerjen e transportit në kompanitë transportuese.

Në vazhdimësi do të jepen certifikate për transportin e materieve të rrezikshme për shoferët, si dhe certifikate për këshilltar për siguri gjatë transportit të materieve të rrezikshme.

Ministria e Transportit dhe Lidhjeve do t'i dorëzojë raporte gjysëmjetore Trupit koordinues për sigurinë e komunikacionit të rrugëve për aktivitetet e realizuara nga "Plani aksional për zbatimin e Strategjisë për përparimin e sigurisë së komunikacionit të rrugëve dhe indikatorët nga

institucionet kompetente për aktivitetet e zbatuara”. Qëllimi është ndjekja e zbatimit të masave për rritjen e sigurisë në komunikacionin e rrugëve.

Inspektorati Shtetëror i Transportit

Inspektorati shtetëror i transportit në çdo tre muaj do të dorëzojë raporte te Qeveria e Republikës së Maqedonisë për numrin e kontrolleve të kryera nga ana e Inspektoratit Shtetëror për Transport, ndërsa gjithashtu nëpërmjet lajmërimeve për mediumet do të informohet edhe transparenca për kontrollet e kryera dhe dënimet e kumtuara, me çka në mënyrë preventive do të ndikohet mbi qytetarët në ardhmëri të mos bëjnë kundërvajtje.

Më së voni prej 01.02.2012, në vazhdimësi Inspektorati shtetëror për transport dhe Policia e komunikacionit do të zbatojnë kontrolle në kohën e vozitjes së shoferëve në komunikacionin transportues, me çka në mënyrë të drejtpërdrejtë do të ndikohet mbi përmirësimin e acquisit social dhe në rritjen e numrit të inspektimeve.

Në çdo tre muaj do të dorëzohen raporte te Qeveria e Republikës së Maqedonisë për numrin e kontrolleve të kryera nga ana e Inspektoratit Shtetëror i Transportit, ndërsa gjithashtu nëpërmjet lajmërimeve për mediumet do të informohet edhe transparenca për kontrollet e kryera dhe dënimet e kumtuara, me çka në mënyrë preventive do të ndikohet mbi shoferët në ardhmëri të përmbahen me rregullat për kohën e vozitjes dhe pushimit të shoferëve.

Agjencia për rrugë shtetërore

Agjencia për rrugë shtetërore në vitin 2012 i ka aktivitetet si vijon:

Në lidhje me fazën e parë nga Projekti për modernizimin e stacioneve për arkëtim dhe sistemin për pagesë të taksave rrugore për gjatë Korridorit 10 i cili është në rrjedhë, pritet në tremujorin e parë prej vitit 2012 të shpallet tender për zgjerimin dhe adaptimin e 5 stacioneve ekzistuese për pagesë dhe ndërtimin e 1 stacioni të ri për pagesë.

Lidhja e marrëveshjes për ndërtimin e segmentit rrugor Demir Kapi – Smokvicë (Korridori 10) deri në fund të qershorit 2012 (për informata më të hollësishme duhet të shihet Kapitulli 3.21).

Ministria e Punëve të Brendshme

Gjatë vitit 2012 Ministria e Punëve të Brendshme planifikon organizimin dhe zbatimin e aksioneve “Baza të dispozitave dhe rregullave të komunikacionit” dhe “Etikë komunikacioni” në shkolla të mesme shtetërore të territorit të Republikës së Maqedonisë.

Në Vazhdimësi gjatë vitit 2012 përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Brendshme nga pjesa e preventivës në sigurinë në komunikacionin e rrugëve do të realizojnë më shumë fushataa dhe aktivitete ndër të cilat:

- Përfaqësim në medime të nëpunësve të uniformuar policorë në medime elektronike dhe të shtypura në medime lokale dhe nacionale,
- Organizim dhe zbatim të këshillave të komunikacionit të cilat kanë të bëjnë me të gjithë pjesëmarrësit në komunikacionin,
- Organizim dhe zbatim të aksioneve edukative arsimore për pjesëmarrësit e rinj në komunikacionin për nxënës nga klasa e parë deri në klasën e katërt "Në mënyrë të sigurt nga shtëpia deri në shkollë" me ndihmën e poligoneve mobil auto-komunikues
- Fushatë për kufizimin e shpejtësisë,
- Fushatë për rrezikun nga menaxhimi me automjet nën ndikimin e alkoolit dhe të substancave tjera psihotropike,
- Aksioni “Semafori i fëmijëve” në bashkëpunim me KRSKRR

Këshilli republikan për siguri në komunikacionin rrugor

Gjatë vitit 2012 KRSKRR do të vazhdojë me realizimin e aktiviteteve nëpërmjet inkuadrimit të sektorit joqeveritar, në pajtim me Programin dhe planin aksional 2012.

PRIORITETE AFATMESME KORNIZA JURIDIKE

Qasja në tregun e përbashkët të transportit

Për shkak të rregullimit të plotë të marrëdhënieve në komunikacionin rrugor me vendet nga Evropa, do të vazhdojnë aktivitetet për lidhjen e Marrëveshjeve për transport ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave me vendet me të cilat Qeveria e Republikës së Maqedonisë ende nuk ka lidhur marrëveshje edhe atë:

- Marrëveshje për transport rrugor ndërkombëtar me Republikën e Portugalisë, afat 31.12.2013.
- Marrëveshje për transport rrugor ndërkombëtar me Republikën e Irlandës, afat 31.12.2014.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Ministria e Transportit dhe Lidhjeve

Prej 01.01.2013 Ministria e Transportit dhe Lidhjeve do të fillojë me mënyrën e re të dhënies së certifikatave për aftësi profesionale të shoferëve të automjeteve për transportin e materieve të rrezikshme, përkatësisht të njëjtat do të plastifikohen edhe me karakteristika plotësuese siguroese (hologram, UV tekst dhe ngjashëm), me çka në mënyrë të plotë do të harmonizohet me modelin e paraparë në pikën 8.2.2.8.5 nga Marrëveshja Evropiane për transport ndërkombëtarë rrugor të materieve të rrezikshme ADR.

Agjencia për rrugë shtetërore

Agjencia për rrugë shtetërore në afat të mesëm i ka aktivitetet, si vijojnë:

Planifikohet përfundimi i fazës së parë nga projekti për modernizimin e stacioneve për arkëtim dhe sistemit për arkëtim të taksave rrugore përgjatë Korridorit 10 në afat prej 18 muaj nga dita e nënshkrimit të marrëveshjes me ofertuesin më të volitshëm. Pastaj do të vijojë realizimi i fazës 2.

Ndërtimi i autostradës Demir Kapi-Smokvicë në periudhën 2012-2016. (Për informata më të hollësishme duhet të shihet Kapitulli 3.21.)

3.14.2. KOMUNIKACIONI HEKURUDHOR

GJENDJA RRJEDHËSE

KORNIZA JURIDIKE

Ligji për sistem hekurudhor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” 48/10, 23/11). Në shkurt të vitit 2011, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sistemin hekurudhor, me të cilin përcaktohen dispozita për mbikëqyrjen inspektuese në drejtim të harmonizimit me Ligjin për mbikëqyrje inspektuese.

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në shkurt 2011 e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e **Ligjit për siguri në sistemin hekurudhor**, me të cilin përcaktohen dispozita për mbikëqyrjen inspektuese në drejtim të harmonizimit me Ligjin për mbikëqyrje inspektuese. Në prill të vitit 2011 Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për siguri në sistemin hekurudhor me të cilin përcaktohet procedura e “heshtja është miratim” për dhënien e lejes për drejtim të automjetit hekurudhor, të cilën e jep organi për siguri, përkatësisht Drejtoria për siguri në sistemin hekurudhor. Në nëntor 2011, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për siguri në sistemin hekurudhor, me të cilin përcaktohen dispozita me të cilat rregullohet procedura për dhënien e certifikatës për subjektin për mirëmbajtjen e automjeteve hekurudhore, procedura për fitimin e autorizimit për trajnues të autorizuar dhe hulumtues të autorizuar, qendra për trajnim, subjekti i detyruar për mirëmbajtjen e automjeteve hekurudhore si dhe kushtet që duhet t’i plotësojnë punëtorët tjerë hekurudhorë të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë marrin pjesë në komunikacionin hekurudhor.

Ligji për interoperabilitet në sistemin hekurudhor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 17 prej 11.02.2011). Në shkurt të vitit 2011, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e miratoi Ligjin për interoperabilitet në sistemin hekurudhor, me të cili përcaktohen kushtet që duhet të plotësohen që të arrihet interoperabiliteti i sistemit hekurudhor në Republikën e Maqedonisë në mënyrë që është kompatibil me dispozitat nga Ligji për siguri në sistemin hekurudhor. Ky ligj është i harmonizuar me BE rregullën 32008L0057.

Ligji për marrëveshjet për transport në komunikacionin hekurudhor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 55/2007, 148/2011). Në tetor 2011, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e miratoi Ligjin për plotësimin e Ligjit për marrëveshjet për transport në komunikacionin hekurudhor, me të cilin përcaktohen të drejtat dhe obligimet e udhëtarëve gjatë transportit me hekurudhë si dhe e dhënësve të këtij shërbimi. Ky ligj është i harmonizuar me RREGULLATIVËN (KE) nr. 1371/2007 I PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT prej 23 tetor 2007 për të drejtat dhe obligimet e udhëtarëve në komunikacionin hekurudhor.

Në pjesën e akteve nënligjore:

Rregullore për pjesët përbërëse të nënsistemit strukturor dhe funksional të sistemit hekurudhor, e harmonizuar me BE rregullën 32008R0057, aneksi II (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 64/2011).

- Rregullore për kërkesat themelore të cilat duhet t'i plotësojë sistemi hekurudhor, nënsistemet dhe pjesët përbërëse të interoperabilitetit, duke e përfshirë edhe lidhjen e ndërsjellë të nënsistemeve, e harmonizuar me BE rregullën 32008R0057, aneksi III ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 64/2011).

- Rregullore për formën dhe përmbajtjen e kërkesës për dhënien e vërtetimit të parë dhe vërtetimit plotësues për lëshimin në përdorim të automjetit hekurudhor, si dhe formën dhe përmbajtjen e vërtetimit të parë dhe plotësues për lëshimin në përdorim të autimjetit hekurudhor, ndërsa ka të bëjë me automjetet të cilat do t'i harmonizohen me specifikime teknike për interoperabilitetin ose automjete të cilat nuk do të jenë të harmonizuara me STI ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 64/2011).

Program vjetor për financimin e infrastrukturës hekurudhore për vitin 2011 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 08/2011, 27/2011, 81/2011 dhe 151/2011) me të cilin realizohen mjete në lartësi prej 301.556.000,00 denarë, të dedikuara për mirëmbajtjen e hekurudhës.

Marrëveshje për rregullimin e të drejtave dhe obligimeve të ndërsjella për sigurimin dhe realizimin e mjeteve financiare të dedikuara për infrastrukturës hekurudhore për periudhën 2011-2013, është lidhur më **07.07.2011** ndërmjet **Qeverisë së Republikës së Maqedonisë e përfaqësuar nga ministri i Transportit dhe Lidhjeve dhe drejtorit të ndërmarrjes publike për infrastrukturën hekurudhore Hekurudhat e Maqedonisë-Shkup.**

Vendim për caktimin e shërbimit me interes publik në transportin hekurudhor të udhëtarëve për periudhën 2011-2013 numër 51-7929/1 prej 05.01.2011 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 07/2011) dhe është lidhur Marrëveshja për kryerjen e shërbimit rrugor publik si shërbim nga interesi publik në transportin hekurudhor të udhëtarëve dhe kompensimin e një pjese nga humbjet gjatë dhënies së shërbimit për periudhën 2011-2013 ndërmjet ministrit të transportit dhe lidhjeve dhe Drejtorit Gjeneral të HM Transport SHA-Shkup. Për vitin 2011 parashikohet të realizohen mjetet në lartësi prej 229.579.259,00 denarë për kompensimin e një pjese nga humbjet gjatë dhënies së shërbimit rrugor publikë, përkatësisht kompensimi për shfrytëzimin e infrastrukturës hekurudhore gjatë transportit të udhëtarëve.

Marrëveshje për rregullim kufitar të komunikacionit hekurudhor ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës. Më 15.09.2011, në Republikën e Maqedonisë u nënshkruar Marrëveshja, ndërmjet ministrit të Transportit dhe Lidhjeve të Republikës së Maqedonisë dhe ministrit të Infrastrukturës të Republikës së Kosovës.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Ministria e Transportit dhe Lidhjeve – Sektori për hekurudha është kompetent për zbatimin e politikës për zhvillimin e hekurudhave. Në pajtim me Rregulloren për organizimin e vendeve të punës në Sektor ka dy seksione: Seksioni për infrastrukturë hekurudhore dhe Seksioni për transport hekurudhor. Në Sektor gjithsej janë punësuar 6 nëpunës shtetërorë, duke e përfshirë edhe udhëheqësin e sektorit. Në vitin 2011 u realizua 1 punësim i ri, 1 nëpunës shtetërorë doli në pension dhe 1 nëpunës shtetërorë është transferuar në Sektorin tjetër.

Ndërmarrja publike për infrastrukturë hekurudhore Hekurudhat e Maqedonisë-Shkup (drejtor i infrastrukturës hekurudhore), është e detyruar për menaxhim me ndërtimin, rikonstruktimin, remontin, mirëmbajtjen, mbrojtjen e infrastrukturës hekurudhore, organizimin dhe rregullimin e komunikacionit hekurudhor, udhëheqjen me sistemet për rregullimin dhe sigurimin dhe ndarjen e kapaciteteve infrastrukturore si veprimtari me interes publik.

Agjencia për rregullimin e sektorit hekurudhor – ARSSH (trup rregullator)

Siguron punën transparente dhe jodiskriminuese të drejtorit të infrastrukturës, transportuesve, trupave dhe institucioneve të lidhura me punën e hekurudhës si dhe pjesëmarrës tjerë të cilat sigurojnë shërbime hekurudhore në transportin hekurudhor publik. Numri i të punësuarve arrin 4 duke e përfshirë edhe drejtorin. Gjatë vitit 2011, Agjencia përgatiti Raport Vjetor Financiar për llogarinë finale për vitin 2010, Raport për realizimin e programit vjetor për punën dhe zhvillimin e Agjencisë për vitin 2010, Program Vjetor për punën dhe zhvillimin për vitin 2010 dhe Plan vjetor financiar 2011.

Agjencia vendosi komunikim me agjencitë rregullatore nga rajoni, për shkak të këmbimit të informatave në lidhje me punën dhe imlementimit të kërkesave të parapara me BE legjisllacionin (me trupat rregullatore të Kroacisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Serbisë, Bullgarisë, Malit të Zi dhe Kosovës).

Gjatë vitit 2011, u realizua pjesëmarrja në punëtori, takime të punës me agjencitë tjera rregullatore nga vendet e BE-së Holandë dhe Austri.

Agjencia është anëtare e grupit punues të trupave rregullatorë për hekurudha në Drejtorinë Gjenerale për lëvizje në Komisionin Evropian (DG MOVE).

Drejtoria për siguri në sistemin hekurudhor – DSSH (organ për siguri).

Në vitin rrjedhës 2011 Drejtoria për siguri në sistemin hekurudhor (DSSH) duke vepruar në pajtim me kompetencat e saj me kërkesë të transportuesit hekurudhor Hekurudhat e Maqedonisë Transport SHA Shkup lëshoi 11 (njëmbëdhjetë) vërtetime të para për lëshimin në përdorim të automjeteve hekurudhore të cilat nuk janë harmonizuar me specifikimet teknike për interoperabilitet si dhe 25 (njëzetepesë) vërtetime të para për lëshimin e automjeteve hekurudhore të cilat janë të harmonizuara me specifikat teknike për interoperabilitet.

Kërkesa e parashtruar nga ana e Hekurudhës së Sllovenisë Podružnicë Alpe Ballkan Kargo-Shkup, me të cilën kërkonin certifikatë për siguri Pjesa-B, Drejtoria për siguri në sistemin hekurudhor e refuzoi për shkak të asaj që kërkesa ishte e pa kompletuar. Gjithashtu DSSH vendoste sipas kërkesave për dhënien e lejeve për makinistë për drejtimin e automjeteve hekurudhore, të njëjtat i refuzoi duke pasur parasysh zgjidhjen ligjore se procedurën për dhënien e lejeve për makinistë Drejtoria për siguri në sistemin hekurudhor do ta zbatojë pas anëtarësimit të Republikës së Maqedonisë në BE.

DSSH në mënyrë aktive mori pjesë në përgatitjen e ndryshimeve dhe plotësimeve të akteve të caktuara ligjore dhe nënligjore.

Me ndihmën teknike të siguruar si mjete grant, DSSH në 2011 fitoi shërbime profesionale këshillëdhënëse për funksionimin më efikas të Drejtorisë, si organ për siguri dhe mori pjesë në seminare dhe punëtori nga ana e institucioneve ndërkombëtare.

Në mënyrë organizative Drejtoria për siguri në sistemin hekurudhor është organizuar në 2 (dy) sektorë edhe atë Sektori për siguri në sistemin hekurudhor dhe Sektori për mbikëqyrje inspektuese në sistemin hekurudhor. Momentalisht në Drejtorinë janë të punësuar 9 (nëntë) persona duke e përfshirë edhe drejtorin.

Komiteti për udhëheqjen e hetimit gjatë aksidentit të bërë serioz, fatkeqësisë dhe incidentit (trup hetues) Komiteti si trup i përhershëm është i pavarur në organizimin e vet, në sjelljen e vendimeve dhe në punën e vet (drejtori infrastrukturor, transportuesi, organi për siguri, rregullatori i hekurudhës dhe Ministria e Transportit dhe Lidhjeve).

PRIORITETE AFATSHKURTRA KORNIZA JURIDIKE

Në lidhje me kornizën juridike në 2012 do të miratohen ndryshime dhe plotësime të Ligjit për sistemin hekurudhor, me të cilin janë përcaktuar dispozita për rregullimin e plotë të kompetencave të punës së Agjencisë për rregullimin e sistemit hekurudhor, si trup rregullator, në drejtim të kryerjes së kontrollit të kualitetit të shërbimeve të cilat transportuesit hekurudhor iu sigurojnë udhëtarëve në komunikacionin hekurudhor dhe kontroll të kualitetit të shërbimeve të cilat drejtori infrastrukturor iu siguron transportuesve hekurudhorë, futet edhe aneksi për sigurimin për mbulimin obligimeve financiare të kërkuesit-transportues, ndërsa në procedurën për dhënien e lejes për kryerjen e transportit hekurudhor publik dhe dispozitë me të cilën kryerja e transportit hekurudhor publik do t'i lejohen personit privat të vendit apo të huaj juridik pas aderimit të Republikës së Maqedonisë si anëtare e plotfuqishme në Bashkimin Evropian.

Në vitin 2012 do të përpilohen dhe miratohen aktet nënligjore dhe udhëzimet, si vijojnë:

1. Rregullore për formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës dhe udhëzimi për plotësimin e kërkesës për lejen për kryerjen e transportit hekurudhor publik dhe aneksi për sigurimin për mbulimin e obligimeve financiare, formën dhe përmbajtjen e formularit të lejes, formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit për lejes e dhëna, të harmonizuar me COMMISSION RECOMMENDATION of 7 April 2004 on the use of a common European format for licence documents issued in accordance with Council Directive 95/18/KE on the licensing of railway undertakings (*notified under document number C(2004) 1279*) (2004/358/KE), L 113/37, 20.4.2004

2. Rregullore për treguesit e përbashkët sigures, e harmonizuar me COMMISSION DIRECTIVE 2009/149/KE of 27 November 2009 amending Directive 2004/49/KE of the European Parliament and of the Council as regards Common Safety Indicators and common methods to calculate accident costs (Text with EEA relevance) L 313/65, 28.11.2009,

3. Udhëzim për zbatimin e metodave të përbashkëta siguroese gjatë vlerësimit të pajtueshmërisë së kërkesës së marrjes së certifikatës për siguri për kryerjen e transportit hekurudhor publik, i harmonizuar me COMMISSION REGULATION (EU) No 1158/2010 of 9 December 2010 on a common safety method for assessing conformity with the requirements for obtaining railëay safety certificates (Text with EEA relevance) L 326/11, 10.12.2010

4. Udhëzim për zbatimin e metodave të përbashkëta siguroese gjatë vlerësimit të pajtueshmërisë së kërkesës së marrjes së certifikatës për siguri për menaxhimin me infrastrukturës hekurudhore, i harmonizuar me COMMISSION REGULATION (EU) No 1169/2010 of 10 December 2010 on a common safety method for assessing conformity ëith the requirements for obtaining railëay safety certificates (Text ëith EEA relevance) L 327/13, 11.12.2010

5. Udhëzim për zbatimin e metodave të përbashkëta siguroese për vlerësimin e rrezikut dhe metoda për vlerësimin e rrezikut, në pajtim me nenin 6 nga Ligji për siguri në sistemin hekurudhor, i harmonizuar me COMMISSION REGULATION (EC) No 352/2009 of 24 April 2009 on the adoption of a common safety method on risk evaluation and assessment as referred to in Article 6(3)(a) of Directive 2004/49/KE of the European Parliament and of the Council (Text ëith EEA relevance) L 108/4, 29.4.2009

6. Udhëzim për zbatimin e parametrave të cilat zbatohen gjatë kontrollit të automjeteve para se të lëshohen në përdorim, i harmonizuar me COMMISSION DIRECTIVE 2009/131/KE of 16 October 2009 amending Annex VII to Directive 2008/57/KE of the European Parliament and of the Council on the interoperability of the rail system ëithin the Community (Text ëith EEA relevance) Official Journal L 273/12 from 17.10.2009

7. Rregullore për formën dhe përmbajtjen si dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit të llojeve të lejuara të automjeteve COMMISSION IMPLEMENTING DECISION of 4 October 2011 on the European register of authorised types of railëay vehicles (*notified under document C(2011) 6974*) (Text ëith EEA relevance) (2011/665/EU) L 264/32 8.10.2011

8. Rregullore për formën dhe përmbajtjen e regjistrit të infrastrukturës hekurudhore, COMMISSION IMPLEMENTING DECISION of 15 September 2011 on the common specifications of the register of railëay infrastructure (*notified under document C(2011) 6383*) (Text ëith EEA relevance) (2011/633/EU) L 256/1 1.10.2011

9. Udhëzim për lëshimin në përdorim të nënsistemit strukturorë dhe automjeteve hekurudhore COMMISSION RECOMMENDATION of 29 March 2011 on the authorisation for the placing in service of structural subsystems and vehicles under Directive 2008/57/KE of the European Parliament and of the Council (Text ëith EEA relevance) (2011/217/EU), L 95/1, 8.4.2011

Programi vjetor për financimin e infrastrukturës hekurudhore për vitin 2012 do të miratohet me mjetet e përcaktuara për financim.

Raport për realizimin e **Programin vjetor për financimin e infrastrukturës hekurudhore për vitin 2011**, në pajtim me nenin 26 nga Ligji për sistemin hekurudhor për realizimin e programit vjetor për vitin 2011, drejtori i infrastrukturës hekurudhore nëpërmjet Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve dorëzon Raport te Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Në lidhje me qasjen në infrastrukturë do të miratohet Marrëveshje për qasje ndërmjet NP HM Infrastruktura-Shkup dhe HM Transport SHA-Shkup për vitin 2013, si dhe shpalljen e rrejtit për vitin 2013.

Në pjesën e lehtësimit kufitar dhe zvogëlimit të të a.q. pengesa në komunikacionin hekurudhor në vitin 2012 do të miratohen

- Marrëveshja për rregullimin kufitar të komunikacionit hekurudhor ndërmjet Republikës së Serbisë dhe Republikës së Maqedonisë,
- Marrëveshja për rregullimin kufitar të komunikacionit hekurudhor ndërmjet Republikës së Greqisë dhe Republikës së Maqedonisë,
- Ratifikimi për rregullimin kufitar të komunikacionit hekurudhor ndërmjet marrëveshjes, ndërsa me Kosovën do të ratifikohet.

Agjencia për rregullimin e sektorit hekurudhor – ARRSH (trup rregullator)

Agjencia do të mundësojë punë transparente dhe jodiskriminuese të drejtorit infrastrukturor dhe transportuesit hekurudhor. Agjencia do të përgatit program vjetor për punën dhe plan financiar për vitin 2012 dhe Raport vjetor për punën e Agjencisë për vitin 2011, në mënyrë aktive do ta kontrollojë kualitetin e shërbimit të siguruar nga të gjithë pjesëmarrësit në tregun e shërbimeve hekurudhore, si dhe do të kujdeset për respektimin e të drejtave të udhëtarëve të cilët e

shfrytëzojnë hekurudhën si mjet transportues. Deri më 31.03.2012 te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë do të parashtrijë Raport për realizimin e programit vjetor dhe plan financiar për vitin 2011.

Drejtoria për siguri në sistemin hekurudhor – DSSH (organ për siguri).

Për vitin e ardhshëm 2012 Drejtoria do ta miratojë programin vjetor për kryerjen e punëve të mbikëqyrjes inspektuese. Në plan është përpunimi i Drejtorisë për vlerësimin e pajtueshmërisë së kërkesave të parashtruara për marrjen e Certifikatës për siguri për kryerjen e transportit hekurudhor publik dhe Leje për siguri për menaxhimin me infrastrukturën hekurudhore.

Në lidhje me Komitetin për udhëheqjen e hetimit gjatë fatkeqësisë së bërë serioze, aksidentit dhe incidentit (trup hetues) në vitin 2012 do të formohet dhe ekipohet me 3 hetues nga të cilët njëri është hetues përgjegjës, ndërsa në pajtim me ndryshimet dhe plotësimet e miratuara të Ligjit për siguri në sistemin hekurudhor është (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” 48/10, 23/11, 53/11 dhe 158/2011) ku është paraparë Komiteti si trup i përhershëm, të përbëhet prej më së paku dy hetues, të cilët janë persona profesionalë nga sfera e hekurudhës dhe janë në marrëdhënie të rregullt pune në Sekretariatit Gjeneral të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

PRIORITETE AFATMESME KORNIZA JURIDIKE

Gjatë vitit 2013 dhe 2014 do të ndiqen ndryshimet dhe miratimi i direktivave të reja të Bashkimit Evropian të cilat do të harmonizohen me kornizën ekzistuese ligjore të Republikës së Maqedonisë në pjesën e hekurudhës. Gjithashtu do të iniciohet implementimi më i shpejtë dhe ringjallja e transportit të kombinuar sipas rrjetit të hekurudhës në Republikën e Maqedonisë.

Agjencia për rregullimin e sektorit hekurudhor – ARSSH (trup rregullator)

Agjencia do të mundësojë punë transparente dhe jodiskriminuese drejtorit infrastrukturor dhe transportuesit hekurudhor. Agjencia do të përgatitë program vjetor për punën dhe plan financiar për vitin 2013 dhe 2014 dhe në mënyrë aktive do ta kontrollojë kualitetin e shërbimit të siguruar nga të gjithë pjesëmarrësit në tregun e shërbimeve hekurudhore, si dhe do të kujdeset për respektimin e të drejtave të udhëtarëve të cilët e shfrytëzojnë hekurudhën si mjet transportues.

Drejtoria për siguri në sistemin hekurudhor – DSSH (organ për siguri).

DSSH do të propozojë përpunimin e akteve të reja nënligjore nga sfera e sigurisë në sistemin hekurudhor dhe do të mundësohet qasja transportuese në rregullativa ligjore dhe nënligjore të të gjithë pjesëmarrësve të sektorit.

3.14.3 KOMUNIKACION I BRENDSHËN UJOR

Lundrimi i brendshëm në Republikën e Maqedonisë përfshin lundrim të liqeneve natyrore dhe artificiale dhe lundrim në një kanal. Lundrimi zhvillohet për qëllime turistike dhe sport dhe rekreacion. Transport i mallërave nuk kryhet. Në ujërat e brendshëm është i ndaluar transporti i materieve të rrezikshme.

Për momentin nuk zhvillohet lundrimi ndërshtetëror dhe ndërkombëtar, edhe pse për shkak të kufizimit të liqeneve natyrore me shtetet tjera (Republika e Shqipërisë dhe Greqisë), në të ardhmen ekziston mundësia të realizohet lundrimi i këtyllë.

Në pajtim me planin vjetor për mbikëqyrjen mbi legjislacionin e zbatimit të Ligjit për lundrimin e brendshëm për vitin 2010-2011 dhe plan operativ për zbatimin e të njëjtit, gjatë vitit 2011 ishin zbatuar në vazhdimësi nga ana e inspekit për siguri në lundrimin e brendshëm të Kapidanisë së porteve - Ohër.

Në pjesën e kornizës juridike u miratua Rregullorja për kërkesat thelbësore për prodhimtari, shitja në treg dhe vënia në përdorim e mjeteve lundruese për rekreacion “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 6/2011, në të cilën transponohen Direktiva 94/25/KE dhe Direktiva 2003/44/KE. Me rregullorën e kërkesave të përcaktuara thelbësore për prodhimtari, shitje në treg dhe vënie në përdorim të objekteve lundruese për rekreacion dhe e komponentëve për instalim, të cilat kanë të bëjnë me dizajnin, konkurrencën, emisionet e zhurmës, procedurat dhe kushtet për vlerësimin e pajtueshmërisë, shënimi dhe kushtet të cilat duhet t'i plotësojnë trupat për vlerësimin e pajtueshmërisë. Rregullorja mundëson prodhimin dhe shitjen në treg e objekteve lundruese për rekreacion me plotësimin e MKS dhe ISO standarde, që kontribuon për lundrim të sigurt.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Organe kompetente për implementimin e punëve që kanë të bëjnë me sigurinë në lundrimin e brendshëm janë Ministria e Transportit dhe Lidhjeve dhe Kapidania e porteve - organ në përbërje të Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve. Në suazat e Kapidanisë ekziston një seksion me shtatë persona të punësuar.

Gjatë vitit 2011 në pjesën e zbatimit të legjislacionit dhe rregullsisë teknike të lundrimit është kryer kontrolli teknik i anijeve të cilat lundrojnë në ujërat e brendshëm në Republikën e Maqedonisë. Gjatë muajit mars dhe prill nga ana e shoqërisë së pranuar për klasifikim Bureau Veritas, u kryen kontrole teknike të anijeve të cilat lundrojnë në ujërat e brendshëm të Republikës së Maqedonisë. Kontrolli është kryer pas tërheqjes së anijeve në të thatë. Është caktuar klasa e anijeve dhe është vërtetuar aftësia e tyre për lundrim, për çka nga ana e shoqërisë së pranuar për klasifikim janë dhënë certifikate për aftësinë për lundrim.

PRIORITETE AFATSHKURTRA KORNIZA JURIDIKE

1. Deri në fund të muajit qershor 2012 është paraparë të përpilohet propozimligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lundrim të brendshëm, në të cilin do të kryhet transponimi i Direktivës 76/135/KEE prej 20 janar 1976 për pranimin e ndërsjellë të lejeve për lundrimin e anijeve nëpër ujërat e brendshëm dhe Direktiva 78/1016/KEE prej 23 nëntor 1978 për ndryshimin e Direktivës 76/135/KEE dhe Direktivës 87/540/KEE prej 09 nëntor 1978 për qasjen ndaj profesionit transportues të mallrave nëpër rrugë ujore në transportin nacional dhe ndërkombëtar dhe pranimi i ndërsjellë i diplomave, certifikatave dhe provave tjera për kualifikime formale në këtë profesion.

2. Deri në muajin shtator 2012 do të përgatitet Propozim-rregullore për rregulla teknike për përcaktimin e aftësisë për lundrim në barkë dhe peshimi. Me rregullat teknike do të kryhet implementimi i dispozitave nga Direktiva 94/25/KE dhe Direktiva 2003/44/KE, e cila e plotëson Direktivën 94/25/KE. Me përcaktimin e kërkesave teknike për përcaktimin e aftësisë për lundrim në barkë do të sigurohet: 1. siguria e jetës së njerëzve, objekteve lundruese dhe prona, 2. mbrojtja e mjedisit jetësor nga ndotja nga materiet e dëmshme ujëra të zeza dhe hedhurina dhe 3. sigurimi i kushteve të objektit lundrues për transportin e udhëtarëve.

3. Rrumbullakësimi i aktiviteteve për mbarimin e punëve ndërtimore të sanacionit të portit në Ohër. Kjo me qëllim të sigurimit të kushteve të portit në aspektet të kapacitetit të vet, pajisje dhe siguri.

4. Në pajtim me Ligjin për lundrim të brendshëm dhe Planin Vjetor për punën e inspektorit për siguri në lundrimin e brendshëm gjatë vitit 2012 është paraparë me kontrole të rregullta kryerjen e mbikëqyrjes mbi: 1. aftësinë për lundrimin e objekteve lundruese, 2. rrugëve lundruese, porte, venddimërimi, anije dhe plazhe, 3. numri, përbërja dhe aftësia profesionale e anëtarëve të ekuipazhit, 4. transporti i udhëtarëve dhe ngarkimit në aspekt të mbrojtjes së jetës së njerëzve dhe pronës dhe 5. mbrojtja nga ndotja nga objektet lundruese.

3.14.4. KOMUNIKACIONI I KOMBINUAR GJENDJA RRJEDHËSE

Promovimi i sistemeve intermodale dhe multimodale transportuese janë njëra nga qëllimet e Strategjisë transportuese nacionale të Republikës së Maqedonisë (2007-2017), me strategjinë parashikohet edhe të krijohen kushte për transportin e mallrave nëpërmjet dy ose më shumë llojeve të transportit, përkatësisht krijimi i rrjetit multimodal transportues.

Korniza e plotë juridike me të cilën licencohen operatorët multimodalë transportues, do të jetë provokim për të ardhmen e afërt.

Në pajtim me Strategjinë Transportuese Nacionale në Republikën e Maqedonisë do të promovohet:

- Shërbimi efikas nga sistemi "nga dera në derë",
- Arritjet më të reja në BE në lidhje me standardizimin dhe harmonizimin e njësive ngarkuese multimodale,
- Arsimimi dhe trajnimi të cilët do të fokusohen në drejtim të marrëdhënieve operative, marketinge, financiare, ekonomike dhe konkurruese ndërmjet llojeve transportuese dhe zbatimi i tyre në transportin multimodal.

KORNIZA JURIDIKE

Si pjesë e aktiviteteve për harmonizimin e Direktivave dhe Rregullativave Evropiane në legjislacionin e vendit është e dukshme edhe në: Ligjin për sistemin hekurudhor (GZRM 48/2010), Ligjin për siguri në sistemin hekurudhor (GZRM 48/2010) dhe Ligjin për marrëveshjet për transport në komunikacionin hekurudhor (Gazeta Zyrtare e RM nr. 55/07) janë përfshirë dispozita me të cilat rregullohen marrëdhëniet ndërmjet palëve të përfshira në kryerjen e transportit të kombinuar të mallrave.

Në Ligjin e miratuar për rrugët publike në vitin 2008 (Gazeta Zyrtare e RM nr. 84/08) janë futur përvojat pozitive të Evropës dhe është harmonizuar me direktivat Evropiane.

3.14.5. KOMUNIKACIONI AJROR

GJENDJA RRJEDHËSE

KORNIZA JURIDIKE

Ligji për aviacion ("Gazeta Zyrtare e RM" 14/2006, 27/2007, 103/2008 dhe 67/2010) - i rregullon kushtet dhe mënyrën e kryerjes së veprimtarive nga sfera e aviacionit në Republikën e Maqedonisë, e vendos bazën juridike për transformimin e Drejtorisë për aviacion civil e rregullatorit dhe dhënësit të shërbimeve të navigacionit të aviacionit dhe i rregullon taksat e aeroportit. Aktet nënligjore të parapara me këtë Ligj përgatiten në pajtim me standardet e pranuar ndërkombëtare të aviacionit, praktikave të rekomanduara dhe legjislacioni e BE, ICAO, ECAC, JAA/EASA dhe EUROCONTROL. Standardet ndërkombëtare, rregullativat, udhëzimet dhe praktikave të rekomanduara në të cilat aktet nënligjore kryejnë vetëm udhëzim konsiderohen për të pranuar dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë zbatohen. Ky ligj jep bazë për transponimin e masave të BE në aktet nënligjore, ndërsa në vet ligjin në mënyrë të drejtpërdrejtë transponohen 31996L0067 dhe 32008R1008 (në pjesën për public service obligation (PSO)).

Ligji për marrëdhënie obliguese dhe reale juridike në komunikacionin ajrorë ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 85/2008 dhe 148/2011) – i rregullon çështjet në lidhje me të drejtën private në domenin e aviacionit, në lidhje me marrëveshjen për transport, d.m.th aviobileta për transportin e udhëtarëve, përgjegjësia e aviotransportuesve që dalin nga marrëveshja për transport, kompensimi i dëmit, sigurimi dhe ngjashëm. Ky ligj është i harmonizuar me masat e BE si vijon: 32008R1008, 31997R2027, 32002R0889, 32004R0261, 32005R2111, 32004R0785, 31989R2299, 31999R0323 dhe 31993R3089. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë gjatë vitit 2011 e miratoi Ligjin për ratifikimin e Aneksit për ndryshimin e Aneksit I të Marrëveshjes për EZVO ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 98/2009), me të cilin anulohet njëra nga masat e BE të cilat transponohen me Ligj edhe atë, BE Rregullativa 2409/92. Miratimi i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për marrëdhënie obliguese dhe reale juridike në komunikacionin ajror ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 148/2011) ishte në drejtim të transponimit të BE Rregullativës 32008R1008, e cila e anulon BE Rregullativën 31992R2409. Teksti i spastruar i Ligjit për aviacion është shpallur në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 118 prej 06.09.2010.

Me ratifikimin e **Marrëveshjes multilaterale për themelimin e Hapësirës së përbashkët ajrore evropiane (ECAA)**, e nënshkruar më 09.06.2006 në Luksemburg ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 27/2007 dhe 98/2009) për Republikën e Maqedonisë dhe BE janë krijuar kushte të unifikuara për tregun e lirë të shërbimeve në transportin ajror dhe rregullave të unifikuara në sferën e sigurisë, sigurimit, menaxhimit me komunikacionin ajror, sfera sociale dhe mbrojtja e mjedisit jetësorë. Prej vitit 2008 Komiteti i përbashkët i ECAA nuk ka miratuar vendim të ri për revizionin e Aneksit I nga marrëveshja me çka pamundësohet procesi i harmonizimit me masat e BE të miratuara pas vitit 2008.

Në dhjetor 2006 Republika e Maqedonisë e ratifikoi **Marrëveshjen horizontale (Marrëveshje ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe BE-së për disa aspekte të komunikacionit ajror)**, e nënshkruar më 09.06.2006 në Luksemburg ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 127/2006). Qëllimi i saj është ndryshimi ose plotësimi i disa dispozitave nga marrëveshjet bilaterale për komunikacionin e rregullt ajror të cilat Republika e Maqedonisë i ka lidhur me vendet anëtare të BE me qëllim që të njëjtat të harmonizohen me legjislacionin e BE dhe në atë mënyrë të shmangët diskriminimi në komunikacionin ajror në lidhje me vendet tjera anëtare të BE-së.

Marrëveshje bilaterale

Gjatë vitit 2011 ishte nënshkruar Marrëveshja për komunikacionin e rregullt ajror ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë dhe Marrëveshja për komunikacionin e rregullt ajror ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Shtetit të Katarit ndërsa ishte miratuar Marrëveshja për komunikacionin ajror ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Aktet nënligjore të Ligjit për aviacion

Gjatë vitit 2011 janë miratuar një pjesë më e madhe e akteve nënligjore të cilat dalin nga Ligji për aviacion ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 14/2006, 24/2007, 103/2008 dhe 67/2010). Në atë kontekst tash më janë transponuar pesë rregullativa të BE në pajtim me obligimet nga Marrëveshja për Hapësirën përbashkët Evropiane të aviacionit: 32004R0552, 32006R1032, 32006R1033, 32007R0219, 32007R0633, 32007R1265 dhe 32008R0482, 32004R0551, 32005R2150 dhe 32006R0730.

Politika nacionale e aviacionit e Republikës së Maqedonisë paraqet bazë kryesore për definimin e qëllimeve dhe prioriteteve strategjike të Republikës së Maqedonisë në sferën e aviacionit dhe është orientuar në realizimin e prioriteteve në secilën nga sferat e definuara në Marrëveshjen për krijimin e Hapësirës së përbashkët ajrore evropiane, edhe atë: siguri, shërbime të navigacionit të aviacionit, infrastrukturë, sigurim, mbrojtje të mjedisit jetësor, mbrojtje të të drejtave të shpenzuesve, konkurrencë dhe sfera tjera të lidhura me aviacionin në Republikën e Maqedonisë.

Strategjia nacionale për zhvillimin e aviacionit në Republikën e Maqedonisë jep udhëzime për: modernizimin dhe përmirësimin e strukturës së ardhshme organizative të sektorit nacional të aviacionit, plotësimi i standardeve të larta ndërkombëtare për siguri dhe sigurim, përmirësimi i infrastrukturës së aviacionit, mirëmbajtjen e mjedisit jetësor në kushtet e rritjes së vëllimit të komunikacionit ajrorë dhe transportit, menaxhimin me hapësirën ajrore në pajtim me principin qielli i vetëm Evropian, liberalizimi i kushteve në transportin ajrorë, si dhe masat për mbrojtjen e shfrytëzuesve ekzistues dhe të rinj të shërbimeve në transportin ajror në Republikën e Maqedonisë.

Në mënyrë plotësuese në vitin 2011 u miratuan:

Programi nacional për siguri nr. 03-51/20 prej 08.04.2011 i cili ka për qëllim përparimin e sistemeve për menaxhimin me sigurinë dhe arritjen e nivelit të pranueshëm të sigurisë në komunikacionin ajror. Miratimi i Programit nacional për siguri është në pajtim me realizimin e funksionit rregullator dhe përgjegjësinë të cilën e ka Agjencia për aviacion civil në bashkësinë e aviacionit. Miratimi i Programit nacional për siguri është në pajtim me standardet e Organizimit ndërkombëtar për aviacion civil (ICAO) përkatësisht Aneksi 6, Aneksi 11 dhe Aneksi 14 i ICAO të cilat përmbajnë obligimin secili vend anëtarë të miratojë programin e vet për siguri me të cilin do të mundësohet komunikacioni i sigurt dhe efikas i cili është plotësisht i integruar në rrjetin e përgjithshëm transportues.

Programi nacional për lehtësim në aviacion ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 50/11) i cili ka për qëllim zbatimin e obligimit nga ICAO për vendet kontraktuese t'i sigurojnë dhe lehtësojnë formalitetet për kalimin përtej kufitar, të cilat duhet të kryhen për aviacionet të cilat janë përfshirë në komunikacionin ndërkombëtarë dhe udhëtarët e tyre, ekuipazhi dhe ngarkesa. Me këtë program transponohen Aneksi 9 i ICAO dhe Dokumenti 30, Pjesa 1 e ECAC.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Ministria e Transportit dhe Lidhjeve. Kompetencat e Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve - Sektori për aviacion janë përcaktuar në nenin 6 nga Ligji për aviacion. Në këtë moment, ka gjashtë (6) të punësuar të gjithë në punë të rregullt. Më 06 dhe 16.09.2010 Ministria e Transportit dhe Lidhjeve shpalli dy konkurse për punësimin e tre personave në Sektorin për aviacion edhe atë një bashkëpunëtorë të rinj dhe dy këshilltarë. Më 29.10.2010 janë marrë vendime për punësimin e një këshilltari për aeroportet dhe shërbimet e aeroportit dhe një këshilltar për planin strategjik dhe zhvillimin e ekonomik të aviacionit civil (me vlefshmëri prej 01.11.2010), me çka janë realizuar punësimet e parapara sipas NPAA 2010. Më 08.02.2011 është punësuar një (1) person në vendin e punës bashkëpunëtor i ri për aviacion në Seksionin për politikë të aviacionit në Sektorin për aviacion.

Agjencia për aviacion civil Kompetencat e Agjencisë për aviacion civil janë përcaktuar në nenin 7-a nga Ligji për aviacion. Në këtë moment, në Agjencinë për aviacionin civil janë punësuar 60 persona të rregullt me atë që gjatë vitit 2011 nuk kishte punësime të reja.

Dhënësi i shërbimeve për navigacion ajror (ANSP). Në bazë të nenit 60 nga Ligji për aviacion ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 14/2006, 24/2007, 103/2008 dhe 67/2010) për kryerjen e shërbimeve të navigacionit ajror, Qeveria e Republikës së Maqedonisë formoi Shoqëri aksionare në pronësi shtetërore për kryerjen e veprimtarisë dhënësi i shërbimeve të navigacionit të ajror M-NAV SHA Shkup. Agjencia për aviacion civil më 10.03.2010 Shoqërisë aksionare në pronësi shtetërore për kryerjen e veprimtarisë dhënësi i shërbimeve të navigacionit të aviacionit M-NAV SHA Shkup i

lëshoi Vërtetim për aftësi për dhënien e shërbimeve të navigacionit ajror me numër MK-01/2010ANSP M-NAV SHA SHKUP. Vërtetimi është dhënë në pajtim me nenin 10 dhe nenin 53 paragrafi 4 nga Ligji për aviacion, ndërsa në lidhje me Rregullën për mënyrën e dhënies së shërbimeve të navigacionit ajror, si dhe kushtet e veçanta në lidhje me personelin e duhur, pajisja dhe kushtet tjera të veçanta të domosdoshme për punën e sigurt dhe të rregullt ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 114/2008 dhe 117/2009).

Ndërmarrja publike për shërbime të aeroportit "Maqedoni" - Shkup. Shoqëria e re aksionare për shërbime të aeroportit "AEROPORTET E MAQEDONISË" – në pronësi shtetërore është regjistruar në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë më 22.08.2008.

Koncesionari "TAV Maqedoni" SHPKPV. Më 01.03.2010 koncesionari "TAV Maqedoni" SHPKPV e mori operimin me aeroportet "Aleksandri i Madh" - Shkup dhe "Shën Apostulli Pavle" – Ohër. Më 10.03.2011 nga ana e Komisionit është kryer kontrolli teknik, ndërsa në mars 2011 është dhënë leja e përdorimit për aeroportin "Shën Apostulli Pavle" – Ohër.

Komiteti për hetimin e fatkeqësive të aviacionit dhe incidenteve serioze

Ligji për aviacionin parashikon formimin e Komitetit për hetimin e fatkeqësive ajrore dhe incidenteve serioze si trup i pavarur hetues.

Komiteti duhet të jetë i pavarur në mënyrë organizative, funksionale dhe financiare nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, Agjencia dhe nga subjektet e industrisë së aviacionit interesat e të cilëve mund të jenë në konflikt me detyrat dhe autorizimet e tij.

Komiteti nacional për sigurim në aviacionin civil. Në pajtim me programin nacional për siguri të aviacionit, është formuar Komiteti nacional për siguri të aviacionit dhe janë emëruar anëtarët e Komitetit nacional për siguri të aviacionit. Koordinatori nacional për siguri të aviacionit është drejtori i Agjencisë për aviacionin civil.

Komiteti nacional për lehtësimin e transportit në komunikacionin ajror. Në pajtim me programin nacional për lehtësimin e transportit në komunikacionin ajror ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 127/2008) dhe standardet nga Aneksi 9 i Konventës së Çikagos është formuar Komiteti nacional për lehtësimin e transportit në komunikacionin ajror. Mbledhja konstitutive e Komitetit nacional për lehtësimin e transportit në komunikacionin ajror është mbajtur më 01.04.2009. Koordinator nacional për lehtësimin e komunikacionit ajror është drejtori i Agjencisë për aviacion civil.

Komiteti civil-ushtarak për menaxhim me hapësirën ajrore

Në pajtim me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për aviacion ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 67/10) për kryerjen e punëve të lidhura me menaxhimin me hapësirën ajrore dhe shfrytëzimin fleksibil të hapësirës ajrore Qeveria e Republikës së Maqedonisë duhet të formojë Komitetin civil-ushtarak për menaxhimin me hapësirën ajrore.

NDIHMA E HUAJ

Programi për implementimin e rregullativës për Qiellin unik evropian në vendet e Evropës Juglindore ISIS – ISIS Programme

ISIS Programi, i cili ishte joaktiv një periudhë përsëri ishte iniciuar nga ana e Bashkimit Evropian në shtator 2010. Pikërisht, Programi plotësisht e mori ndihmën teknike për rregullat e BE nga sfera e navigacionit. Më 06 dhe 07.09.2010 në Agjencinë për aviacion civil u mbajt mbledhje me përfaqësues nga Sekretariati i ISIS, në të cilën ishte përcaktuar plani aksional për transponimin e BE Rregullativave 551/2004, 552/2004, 2150/2005 dhe 1315/2007. Më 08.09.2010 në Budvë, Mali i Zi u mbajt mbledhje e Trupit Udhëheqës në suazat e ISIS në të cilën u miratuan konkludimet për iniciimin e sërishëm të ISIS Programit. Aktivitetet e Republikës së Maqedonisë për ndihmë teknike nëpërmjet ISIS Programit janë paraparë për vitin 2011, ndërsa në pajtim me Programin nacional për miratimin e të drejtës së Bashkimit Evropian. Mbledhja e ardhshme e trupit udhëheqës u mbajt më 06-07 tetor 2011 në Solin, Kroaci. Në suazat e programit gjatë vitit 2011 Agjencia për aviacionin civil në bashkëpunim me Komisionin Evropian dhe ICAO në periudhën prej 01-03.03.2011 e organizoi punëtorinë për siguri dhe performansa të aviacionit në Shkup.

PRIORITETE AFATSHKURTRA

KORNIZA JURIDIKE

Propozim për miratimin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për aviacion

Miratimi i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për aviacionin është në drejtim të ndryshimit të nenit 12 nga Ligji për aviacion me qëllim të implementimit të Rregullativës (BE) nr.

1794/2006 të Komisionit prej 6 dhjetor 2006 për përcaktimin e sistemit të përbashkët për arkëtimin e shërbimeve të navigacionit ajror dhe për të siguruar burime të qëndrueshme të financimit dhe të pavarësisë financiare të Agjencisë për aviacion civil.

Në kuadër të Programit për implementimin e rregullores për hapësirën unike evropiane në vendet e Evropës Juglindore - ISIS është përcaktuar një plan aksional për transponimin e Rregullativave të BE 551/2004, 552/2004 2150/2005 dhe 1315/2007, si dhe për ndryshimin e nenit 12 nga Ligji për aviacion.

Në mënyrë plotësuese do të parashikohet një mundësi ligjore për dhënien e mbështetjes financiare nga ana e Qeverisë së R.M aviotransportuesve të cilët do t'i shfrytëzojnë aeroportet e Republikës së Maqedonisë.

Në mënyrë plotësuese në tremujorin e parë të 2012 do të miratohet Rregullorja për mënyrën, rregullat dhe kushtet e posaçme për kryerjen e inspektimit të dhënies së shërbimeve të navigacionit ajror.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Formimi i Komitetit civil-ushtarak

Në pajtim me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për aviacion ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 67/2010) për kryerjen e punëve të lidhura me menaxhimin me hapësirën ajrore dhe shfrytëzimin fleksibil të hapësirës ajrore Qeveria e Republikës së Maqedonisë duhet të formojë Komitetin civil-ushtarak për menaxhimin me hapësirën ajrore. Në Komitetin do të marrin pjesë përfaqësues nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia dhe ofruesi i shërbimeve të navigacionit ajror. Punën e Komitetit do ta koordinojë përfaqësuesi nga ofruesi i shërbimeve të navigacionit ajror. Komiteti për punën e vet do të parashtrijë raport te Qeveria e Republikës së Maqedonisë më së voni deri më 31 janar në vitin rrjedhës për vitin paraprak.

Formimi i Komitetit për hetimin e fatkeqësive ajrore dhe incidenteve serioze

Për zbatimin e hetimit teknik të fatkeqësive të aviacionit dhe incidenteve serioze në pajtim me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për aviacionin ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 67/2010) Qeveria e Republikës së Maqedonisë formoi një Komitet për hetimin e fatkeqësive dhe incidenteve serioze të aviacionit si trup i pavarur hetues.

Detyra kryesore e Komitetit hetues është t'i hulumtojë dhe analizojë fatkeqësitë dhe incidentet e rënda me qëllim për të përcaktuar faktet dhe rrethanat në të cilat kanë ndodhur dhe të propozon masa për parandalimin e tyre.

Komiteti duhet të jetë i pavarur në mënyrë organizative, funksionale dhe financiare nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, Agjencia dhe nga subjektet e industrisë ajrore interesat e të cilëve mund të jenë në konflikt me detyrat dhe autorizimet e tij.

Komiteti përbëhet nga tre hetues të cilët i emëron Qeveria e Republikës së Maqedonisë, nga të cilët njëri emërohet për kryetar i Komitetit. Kryetari i Komitetit në rast aksidenti ose incidenti serioz mund të angazhojë ekspertë të jashtëm nga sfera e aviacionit dhe trupa të huaj hetues nga aviacioni civil dhe trupa tjerë të cilët janë të kualifikuar për hetimin e aksidenteve ose incidenteve të rënda të aviacionit.

Kryesimi i Republikës së Maqedonisë me Komisionin e Përhershëm për siguri në navigacionin ajror të Organizatës Evropiane për Siguri në lundrimin ajror-Eurocontrol

Republika e Maqedonisë është anëtare e Organizatës Evropiane për siguri në lundrimin ajror (Eurocontrol -European Organization for the Safety of Air Navigation), prej vitit 1999 dhe që atëherë entitetet ajrore të shtetit marrin pjesë në mënyrë aktive në të gjitha aktivitetet e organizatës.

Në strukturën administrative të Eurocontrol trupi kryesor kultivues është Komisioni i Përhershëm për Sigurinë e Navigacionit Ajror të Eurocontrol (Permanent Commission for the safety of Air Navigation of Eurocontrol) ku anëtarësohen vendet anëtare të përfaqësuara nga ministrat e Transportit, ndërsa vendet anëtare mund të delegojnë më shumë delegatë që të mundësohet përfaqësim adekuat i entiteteve civile shtetërore të aviacionit dhe mbrojtja shtetërore.

Në punën e Komisionit të Përhershëm të Eurocontrol secili vend anëtar pavarësisht nga numri i delegatëve të emëruar ka të drejtë vetëm për një votë në punën e Komisionit (neni 1 pika 1 nga Rregullat për procedurat e Komisionit të Përhershëm).

Në punën e mbledhjeve të Komisionit si anëtarë të përhershëm marrin pjesë ministrat e transportit të vendeve anëtare ose një përfaqësues i cili do të ketë siguruar autorizim nga anëtarët e përhershëm të Komisionit.

NDIHMA E HUAJ

Programi për implementimin e rregullativës për Qiellin unik evropian në vendet e Evropës Juglindore ISIS – ISIS Programme

Programi ISIS, do të vazhdojë të punojë me Republikën e Maqedonisë transponimin e rregullativave tjera të BE-së të cilat nuk ishin transponuar në vitin 2011 dhe do të përfshihet në mënyrë aktive në përpunimin e një studimi të organizimit të hapësirës ajrore të R.M. në FAB-e.

Duke e ndjekur konceptin e "Qiellit unik Evropian", shtetet e Ballkanit ndërmarrin hapa për të ristrukturuar hapësirën ajrore në pjesën e sipërme në bazë të rrjedhës së trafikut, ndërsa jo sipas kufijve nacionale.

Në pajtim me nenin 13 nga Marrëveshja multilaterale për themelimin e hapësirës së përbashkët ajrore evropiane a.q. Marrëveshja SPEA ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 27/2007 dhe 98/2009), palët kontraktuese bashkëpunojnë në sferën e organizimit të komunikacionit ajror me qëllim që të zgjerohet Qielli unik Evropian në SPEA, që të përmirësohen standardet rrjedhëse të sigurisë dhe efikasiteti i përgjithshëm i standardeve të përgjithshme për komunikacionin ajror në Evropë, që të optimizohen kapacitetet dhe të zvogëlohen vonesat.

Raport për propozimin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kontestet administrative, Raporte me propozime për përmirësimin e rregullores gjyqësore dhe çështjeve tjera që ka të bëjnë me punën e gjykatës me propozime për përmirësimin me administrimin e lëndëve resurse njerëzore dhe materiale, është realizuar mjet standard për vlerësim Common Assessment Framework – CAF, është bërë analizë e AKMIS sistemit është miratuar strategji për trajnim për gjykatat administrative dhe bashkëpunëtorëve profesional sipas të cilit janë zbatuar 6 trajnime dhe janë realizuar dy vizita studimore.

Për përmirësimin e sistemit TI, është e përgatitur Studim për realizueshmërinë me propozim zgjidhjet për konekcion të brendshëm të Gjykatës Administrative, organeve shtetërore në pikëpamje të shkëmbimit të të dhënave dhe dokumenteve të cilët janë pjesë përbërëse e shkresave të lëndëve në procedurën administrative gjyqësore.

Në drejtim të sigurimit të qasjes më të lehtë në drejtësinë për qytetarët e RM-së, në të gjitha gjykatat në RM janë hapur 33 zyre për marrëdhënie me publikun, dhe janë emëruar persona përgjegjës për marrëdhënie me publikun, deri te cilët çdo person i interesuar mund të drejtohet me kërkesë për marrjen e informacioneve lidhur me punën e gjykatës dhe rrjedhën e lëndëve.

Në kuadër të Projektit për implementimin juridik dhe të jurisprudencës dhe të përkrahjes institucionale në 2011, ka përfunduar renovimi dhe pajisja KK Manastir, me çka janë rinovuar tërësisht 11 ndërtesa gjyqësore të gjykatave themelore me kompetencë të shtuar në Maqedoni gjithsej me sipërfaqe prej 28.800 m2.

Gjithashtu, në rrjedhë është ndërtimi i ndërtesës së re të Gjykatës Penale në Shkup me sipërfaqe prej 8.826 m2, si dhe ndërtimin e ndërtesës së re të Prokurorisë Publike me sipërfaqe prej 9.620 m2.

DOKUMENTET STRATEGJIKE

- ~ Plani strategjik i Ministrisë së drejtësisë për 2012-2014;
- ~ Strategji për Teknologji informative komunikuese 2007-2010;
- ~ Strategji për reformë të drejtës ndëshkuese prej 2007-2010;
- ~ Program para-aderues ekonomik 2011-2013;
- ~ Strategji për përcaktimin e numrit të gjykatësve dhe prokurorëve publik.

PRIORITETE AFATSHKURTRA

KORNIZA JURIDIKE

Për përforcimin e mëtejshëm të pavarësisë, paanshmërisë, transparencës, profesionalizimit e gjyqësorit , gjatë 2012, do të vazhdohet me aktivitete për realizimin e zhvillimeve në kuadrin ligjor në lidhje me zgjedhjen e gjyqtarëve, kontrollin dhe vlerësimin e gjyqtarëve në bazë të kriterëve të reja, sistemin e përparimit në karrierë të gjyqtarëve, financimin e gjyqësorit, dhe aktivitetet për të siguruar qasje më të lehtë dhe të shpejtë të qytetarëve në drejtësi.

Lidhur me reformën e drejtës ndëshkuese, gjatë 2012 do të vazhdojë realizimi i aktiviteteve për zbatimin e Ligjit për procedurë penale, përmes miratimit të ndryshimeve të ligjeve në lidhje me respektimin e LPK-së, kështu që deri në qershor 2012 do të miratohen ndryshimet për Prokurori Publike, Kodi Penal, Ligji mbi Gjykatat, Ligji për kundërvajtje, Ligji për avokaturë.

Gjithashtu , deri në prill 2012 do të miratohen dhe aktet nënligjore, të cilët dalin nga Ligji për procedurë penale edhe atë: Akti mbi shumën dhe mënyrën e përcaktimit të shpenzimeve në procedurën penale, Akt për mënyrën e incizimit të akuzuarit, Akti për rregullimin, mënyra e mbajtjes dhe ruajtjes së të evidencës ndëshkimore, Akti për mënyrën e marrjes dhe të dërgimit të arrestuarve në burgje dhe kushtet për punë të arrestuarve.

Gjithashtu, JORM do të sjellë vendim për formimin e qendrës kërkimore, dhe do të merren masa për të forcuar kapacitetet e stafit të prokurorive publike.

Me qëllim rregullimin e drejtave detyrimeve dhe përgjegjësi të punësuarve në prokurorit publike , maj 2012 do të miratohet Ligj për shërbimin prokuror publik.

Në drejtim të rregullimit të procedurës para gjykatave kushtetuese, si procedurë e veçantë, e ndryshme nga procedura kontestimore, në 2012 do të qaset drejt përgatitjes së Analizës për nevojën e miratimit të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për konteste administrative.

KORNIZA INSITUCIONALE

Këshilli për reformat gjyqësore gjatë 2012 do të vazhdoj me kontrollin e realizimit të reformës së jurisprudencës, përmes mirëmbajtje së takimeve kordinative.

Në drejtim të mëtejshëm të zbatimit të risive në kuadrin ligjor, Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë, gjatë 2012 në muaj do të informohet mbi aktivitetet lidhur me, shkarkimin përzgjedhjen e gjyqtarëve, takimet publike për diskutim për parashtresat dhe ankesat e qytetarëve dhe personave juridik për punën e gjyqtarëve, si në vazhdimësi do të informoj për procedurat për punën joprofesionale dhe joetike dhe përgjegjësinë disiplinore.

Gjithashtu, RSFM do të përpiloj Raport për kontrollin dhe vlerësimin e punës së gjykatave dhe kryetarët e gjykatave për 2011.

Këshilli i prokurorëve publik, gjatë 2012 në muaj do të njoftoj për aktivitetet lidhur me zgjedhjen, shkarkimin e prokurorëve publik, përderisa në bashkëpunim me PPRM në vazhdimësi do të njoftoj për procedura për punë joprofesionale dhe joadekuate dhe përgjegjësi disiplinore.

Këshilli gjyqësor i RM-së dhe Këshilli i prokurorëve publik gjatë 2012 dot ë realizohen Planet për zgjedhje të gjykatësve dhe prokurorëve publik nga gjenerata e II dhe III kandidatë të AJPP, sipas të cilëve duhet të zgjidhen edhe 20 kandidatë edhe atë:

10 gjykatës(3 gjykatës-II gjenerata dhe 7 gjykata-III gjenerata) dhe 10 prokurorë publik (5 prokurorë publik- II gjenerata dhe 5 prokurorë publik-gjenerata e III, kandidatë, si dhe do të ndërruarin aktivitete për realizimin e planit për zgjedhjen e prokurorëve publik nga gjenerata e katërt.

Për zbatimin e Strategjisë për përcaktimin e numrit të gjykatësve dhe prokurorëve publik për periudhën 2011-2013, këshilli Gjyqësor i RM-së dhe Këshilli i Prokurorëve Publik të RM-së në 2012 dhe 2013 do të përgatisin programe për zbatimin e kriterëve për përcaktimin e numrit të gjykatësve dhe prokurorëve publik për 2014-2019.

Akademia për gjykatës dhe prokurorë publik në 2012 në bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor të RM-së dhe Këshillit të prokurorëve publik, do të vazhdoj me aktivitetet për pranim të gjeneratës së pestë të kandidatëve për trajnim fillestar dhe trajnim të vazhdueshëm të gjykatësve dhe prokurorëve, kuadrit profesional dhe të prokurorisë, si dhe nëpunësve gjyqësor dhe nëpunësve të prokurorisë publike .

Për evidencë të pjesëmarrjes së gjykatësve në edukimin vazhdueshëm, mars 2012 do të përfundojnë aktivitetet për lidhjen e data bazës ndërmjet KSRM dhe AGJPB.

Në maj 2012 do të përfundoj realizimi i aktiviteteve të Projektit IPA 2008''Përforcim i mëtejme i kapaciteteve institucionale të Akademisë për gjykatës dhe prokurorë publik' me çka do të jetë i përgatitur raport final dhe rekomandime nga ana e ekipit projektues.

Me qëllim që të vërtetohen rezultatet nga aplikimi i parimit të transparencës së punës së gjykatave, Gjykata e lartë e RM-së në bashkëpunim me Këshillin gjyqësor të RM-së në vazhdimësi do të informoj për punën e zyrave për marrëdhënie me publikun dhe do të përgatisë raporte gjysmë vjetore për aktivitetet e Zyrave për marrëdhënie me publikun.

Për zbatimin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për buxhetin gjyqësor , në 2012 do të filloj me rritjen në shkallë të buxhetit gjyqësor për 0,1% me qëllim arritjen e 0,8% të BPB deri më 2015.

Për avancimin e mëtejme të planifikimit dhe menaxhimit me buxhetin gjyqësor, Këshilli gjyqësor buxhetor do të përgatisë analizë të shpenzimeve rrjedhëse nga puna e gjykatave.

Me qëllim kontrollin e punës së gjykatave , Ministria e drejtësisë, në bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor të RM-së dhe Gjykatës së Lartë, do të përgatisë Raporte gjysmë vjetore për gjendjen me mbizotërimin e derdhjes dhe zvogëlimin të pjesës së mbetur të lëndëve, në bazë të të dhënave nga gjykatat themelore, 4 –gjykata të apelit, Këshilli Administrativ dhe Gjykata e Lartë Administrative.

Në 2012 do të përgatitet raport për zbatimin e ligjit kryerje lidhur me transferin e lëndëve të përbarimit dhe do të vazhdoj me emërimin e përbaruesve për vende të paplotësuara të përbaruesve.

Në drejtim të përmirësimit të zbatimit të medimit në lëndët qytetare dhe tregtare, gjatë 2012 do të realizohet MATRA Projekti për përkrahjen e avancimit të zbatimit të medimit në RM.

Për zbatimin e Metodologjisë për udhëheqjen e statistikës së unifikuar gjyqësore, në 2012, është paraparë që të realizohet projekt për furnizimin dhe testimin e aplikimit të suotverit për gjenerimin e tabelave dhe raporteve për punë të gjykatave, të cilat do të jenë funksionale deri më 2013.

Dhe gjatë 2012. AGJPB do të vazhdoj për zbatimin e trajnimeve të vazhdueshme për gjykatës, këshilltarë dhe nëpunës gjyqësor në Gjykatën Administrative dhe Gjykatën e lartë administrative. Njëkohësisht , në prill 2012 do të përfundoj realizimi i aktiviteteve nga Projekti IPA 2007''Më efikase, efektive dhe funksionim modern të Gjykatës administrative''.

Do të përgatitet raport final dhe rekomandim nga ana e ekipit projektues, gjithashtu me qëllim përforcimin e kapaciteteve të gjykatësve.

Lidhur me reformën e drejtës ndëshkuese , gjatë 2012, do të vazhdohet me realizimin e aktiviteteve për zbatimin e Ligjit për procedurë penale, përmes zbatimit të trajnimeve për gjykatës, prokurorëve publik, përfaqësuesve të Ministrisë së punëve të brendshme, Policisë financiare, Administratë doganore dhe avokatët.

Në kuadër të IPA projektit 2009 për Përkrahjen e zbatimit të reformës së sistemit penal juridik, do të ndërmerren aktivitetet për përforcimin e kapaciteteve të prokurorëve publik, policia e judikaturës dhe institucionet e ngelura relevante me qëllim zbatimin e kornizës së re ligjore, si dhe

aktivitetet për rritjen e efikasitetit në zbatimin e kornizës penale ligjore dhe sigurimin e harmonizimit ndërmjet ligjeve të reja të miratuara.

Me qëllim vendosjen e sistemit funksional IKT në prokurori publike, në 2012 do të përgatitet Studim për nevojat vendosjes së soutverit për menaxhim me lëndë në prokurorit publike, vendosjes së internetit, përpunimit të ueb faqeve dhe lidhjes së rrjetit të gjitha prokurorive publike.

PRIORITETE AFATMESME

KORNIZA JURIDIKE

Aktivitetet në jurisprudencë , afatmesme do të jenë të drejtuar drejt përforcimit të mëtejme të pavarësisë, efikasitet, si dhe zbatimit të vazhdueshëm të reformës së drejtës ndëshkuese.

Në afat të mesëm Këshilli Gjyqësor buxhetor do të vazhdojë me aktivitetet për zbatimin e ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për buxhet gjyqësor, me të cilin është paraparë përqindje fikse prej 0,8% të BPB, i cili do të rritet në shuma të barabarta, ashtu që në 2013, do të arrihet përqindja prej 0,6% deri në 2014 prej 0,7% dhe në 2015 prej 0,8%.

KORNIZA INSITUCIONALE

Akademia për gjykatës dhe prokurorë do të vazhdoj me realizim të mëtejme të Programeve për trajnim fillestar dhe të vazhdueshëm të gjykatësve dhe prokurorë, kuadri profesional gjyqësor dhe prokurorë, si dhe nëpunësit gjyqësor dhe prokurorë publik.

Këshilli gjyqësor dhe Këshilli i prokurorëve publik, do to vazhdoj me aktivitetet për plotësimin e vendeve të lira gjyqësore përkatësisht publike, në pajtim me Strategjinë për përcaktimin e numrit të gjykatësve dhe prokurorëve publik për periudhën 2011-2013.

Në 2013 do të vazhdoj realizimi i aktivitete të parapara në kuadër të Projektit IPA 2009 për Përkrahjen në zbatimin e reformës së sistemit penal juridik.

"Në 2013-2014 është paraparë të filloj projekti IPA 2010"Përkrahje e mëtejme për gjyqësi të pavarur, përgjegjëse, profesionale dhe efikase", me qëllim përforcimin e kapaciteteve të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të prokurorëve publik për kryere efikase të kompetencave të tyre të lidhura me zgjedhjen e dhe shkarkimin e gjykatësve dhe prokurorëve publik, planifikimin e kapaciteteve njerëzore. udhëheqjen e lëndëve gjyqësore dhe transparencë në jurisprudencë.

Në 2013 do të gjenerohen raporte për punën e gjykatave në pajtim me Metodologjinë për udhëheqjen e statistikës së unifikuar gjyqësore.

3.23.2. POLITIK ANTIKORRUPTUESE GJENDJA RRJEDHËSE

KORNIZA JURIDIKE

Në drejtim të përforcimit dhe përmirësimit të politikës anti korruptuese, gjatë 2011, në vazhdimësi ndërmerren aktivite për zbatimin efikas të zgjidhjeve të reja ligjore , realizimin e GREKO Rekomandimet të rrethit të II të evalvimit, përforcimit të bashkëpunimit ndërinstucional për luftë kundër kriminalitetit të organizuar dhe korrupsionit , si dhe përgatitjen e Programit të ri Shtetëror për preventiv dhe represion të korrupsionit dhe për parandalimin e konfliktit të interesit me Plan Aksionar.

Gjatë 2011 me sukses janë realizuar të gjitha 13 rekomandime nga rrethi i III i evalvimit të GREKO. Ashtu lidhur me inkriminimet dhe financimin e partive politike janë miratuar këto ligje janë miratuar këto ligje:

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal(të miratuar më 11.04.20011) me të cilin janë bërë ndryshimet në pjesën e veprave penale të shitblerjes aktive dhe pasive, janë

vendosur vepra të reja penale "dhënien e shpërblimeve të paautorizuar" dhe Dhënie të shpërblimit" dhe "Dhënie të shpërblimit për ndikim kundërligjor", bëhet zgjerimi i sektorit të inkriminuar në sektorin privat, si dhe parashihet kumtimin e detyrueshëm të ndalesës ndëshkimore për shfrytëzimin e mjeteve për financim të partive politike të buxhetit të Republikës së Maqedonisë.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Zgjedhor (miratuar më 02. 04.2011), me të cilën përcakton aktivitetet dhe kohëzgjatja e fushatës zgjedhore, përcaktohet hapja e detyrueshme e llogarisë së veçantë bankare për fushatën zgjedhore, u caktua përgjegjësia për organizatorin e fushatës zgjedhore të mbajë regjistër të donacioneve të marra, të dorëzojnë deklaratat periodike financiare dhe raport përfundimtar financiar pas fushatës zgjedhore Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, Entit shtetëror për Revizion dhe Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, të cilat janë të detyruar të njëjtat publikisht t'i shpallin në mënyrë publike.

Ligji për ndryshimin e Ligjit për financimin e partive politike (të miratuar në vitin 19. 10.2011), të cilit u dha rolin udhëheqës të një institucioni për të përcaktuar se çfarë kompetence Enti shtetëror për revizion të bëjë mbikëqyrje veprimet financiare partive politike në rast të parregullsive në raportin vjetor financiar të partisë politike të paraqesë një kërkesë për inicimin e procedurës penale ose kërkesën tek prokurori publik kompetent në afat prej 30 ditësh nga dita e përcaktimit të parregullsive.

Për realizimin e rekomandimit të KE për kontroll të përmbajtjes së deklaratave për konflikt të interesave, në procedurë të kuvendit është Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për konflikt të interesave, me të cilin është paraparë miratimi i akteve nënligjore për mënyrën kontrollit të deklaratave për konflikt të interesave.

KORNIZA INSITUCIONALE

Trupi ndërresorial, në mënyrë të rregullt mban takime për koordinimin e aktivitete kundër korrupsionit, me ç'rast më 28.11.2011 është mbajtur takimi i gjashtë.

Për realizimin e GREKO rekomandimi (III rreth i evalvimit) në konkluzion me nëntor 2011 janë mbajtur gjithsej 8 trajnime me temën "Blerje përmes konceptit të personit zyrtar ", me pjesëmarrje të gjithsej 199 pjesëmarrës.

Lidhur me realizimin e GREKO rekomandimeve të rrethit III rreth i evalvimit, Ministria e përgatiti Informacion për statusin e realizimit të rekomandimeve të GREKO- Rrethi i tretë i evalvimit, i cili është miratuar nga ana e Qeverisë së RM-së më 28.09.2011.

Në janar 2011 KSHPK solli raport dhe analizë të statusit të realizimit të aktiviteteve nga Plani Aksionar për zbatimin e Programit shtetëror për preventiv dhe zvogëlim të shfaqjes së konfliktit të interesave maj 2008 –dhjetor 2010, në pajtim me realizimin e aktiviteteve është 72% Përderisa në prill 2011 është miratuar "Vlerësim për realizimin e Programit shtetëror preventiv dhe represion të korrupsionit 2007-2011" në pajtim me të cilën realizimi është 74%.

KPSHK, e miratoi Programine ri Shtetëror për preventiv dhe represion të korrupsionit dhe preventiv dhe zvogëlim të shfaqjes së konfliktit të interesave 2011-2015, është përpiluar në bashkëpunim me SÇE dhe Ministrisë së Drejtësisë, si dhe përkrahjen teknike të Delegacionit të Bashkimit Evropian dhe UNDP.

Më 09.12.2011 në Ditën ndërkombëtare për luftë kundër korrupsionit, në organizim të KSHPK është mbajtur promovim të Programit me Planin Aksionar. Me programin shtetëror janë përfshirë 11 sektorë prioritarë edhe atë:

Sektori politik, Sektori Publik, Sektori Publik, Arsim dhe Sport Shëndetësi dhe Punë dhe Politik Sociale, sektori i Jurisprudencës, Organe Kontrolluese për zbatimin e ligjit, Administratë publike, Vetadminsitrim lokal dhe Medieme dhe Shoqëri qytetare dhe Administratë doganore.

KPSHK në 2011, filloi me vërtetim sistematik të listave anketuese, në pajtim me Kriteret për mënyrat për përcaktimin e listave anketuese të 122 të funksioneve publike të pushtetit ligjvënës;28

lista anketuese prej 124 bartës të funksioneve publike të pushtetit ekzekutiv, dhe 89 lista anketuese prej 913 bartës të funksioneve publike të pushteti gjyqësor.

Gjithashtu në qershor 2011 KPSHK parashtroi 29 kërkesa për hulumtimin e pronës dhe gjendjes pronësore Drejtorisë për të hyra publike.

Lidhur me rekomandimet lidhur me financimin e zgjedhjeve parlamentare qershor 2011. KPSHK përgatiti Informacion për zbatimin dispozitave ligjore në zgjedhjet e parakohshme parlamentare 2011, në të cilën janë përmbajtur të dhëna për veprimet e partive politike-organizatorë të kampanjave zgjedhore, raporte të përgjithshme financiare për financimin e kampanjës zgjedhore.

Disk në prill 2011 përgatiti Informacion për realizimin e Protokollit për bashkëpunim për preventiv dhe represion të korrupsionit dhe konfliktit të interesave për periudhën prej 01.01.2010 – 31.03.2011, si raport për shkallën e realizimit të Planit Strategjik për avancimin e marrëdhënieve me publikun.

Në 2011 në vazhdimësi u realizuan trajnime për luftë kundër korrupsionit:

Gjatë 2011 MIOA realizoi 2 trajnime me temën: Masa antikorrupive dhe Etikë në shërbimin shtetërorë pjesëmarrje të 45 nëpunësve shtetëror (27 të pushtetit qendror dhe 18 të pushtetit lokal).

Gjithashtu, janë mbajtur gjithsej 4 trajnime për nëpunësit doganor me temën luftë kundër korrupsionit, kriminalitetit të organizuar dhe kriminalitetit , etikës dhe parandalimit të korrupsionit dhe ndërtimit të mjedisit korrupsioni të punës.

Akademia e gjykatësve dhe prokurorëve publik gjatë 2011 realizoi 7 trajnime për gjykatës dhe prokurorë publik me temën "parandalimin konflikti të interesave" në të cilën marrin pjesë gjithsej 153 pjesëmarrës.

Në drejtim të zbatimit të suksesshëm të ndryshimeve të LP, AGJPB gjatë 2011 realizoi gjithsej 5 trajnime për gjykatës, prokurorë publik dhe përfaqësues të institucioneve relevante me temën: "Konfiskim i zgjeruar" në mënyrë të kundërligjshme përfitimin e pronës dhe përgjegjësisë së personave juridikë "gjithsej 154 pjesëmarrës.

Komisioni për qasje të lirë në informacione me karakter publik, gjatë 2011 ka vepruar gjithsej 387 ankesa, nga të cilat 273 ankesa janë parashtruara për arsye të heshtjes së administratës, 32 janë parashtruar kundër aktvendimeve me të cilën ndërpritet procedura për arsye të mos posedimit të informacionit dhe 40 kundër përgjigje nga poseduesit e informacioneve nga të cilët kërkuarit ishin të pakënaqshëm.

Komisioni në periudhën prej 9 maj deri më 1 qershor, mbajti dhjetë trajnime rajonale me temën: "E drejta e qasjes së lirë në informata me karakter publik".

Enti shtetëror për revizion në pajtim me Programin vjetor për punë në periudhën shtator - dhjetor 2011 bëri revizion të raporteve financiare të 17 partive politike, të cilët marrin pjesë në zgjedhjet e parakohshme parlamentare (qershor 2011).

Në drejtim të ngritjes së profesionalizimit dhe edukimit të subjekteve të cilët janë pjesëmarrës aktiv në procedurat për ndarjen e marrëveshjeve për furnizime publike, Byrosë për furnizime publike gjatë 2011 organizoi 14 trajnime, në të cilën morën pjesë 242 pjesëmarrës, 200 organe kontraktuese dhe 42 operatorë ekonomik.

Lidhur me transparencën e marrëveshjeve për furnizime publike shiko Kreun 3.05.
Furnizime publike

Lidhur me aktivitetet për vendosjen e Bazës së të dhënave Nacionale të zbulimit shiko Kreun 3.24.6 *Bashkëpunim policor dhe lufta kundër kriminalitetit të organizuar.*

DOKUMENTET STRATEGJIKE:

~
Program shtetëror për preventiv dhe represion të korrupsionit dhe preventiv dhe zvogëlim të shfaqjes së konfliktit të interesave 2011-2015;

Plan strategjik të KSHPK për përparimin e marrëdhënieve me publikun.

PRIORITETE AFATSHKURTRA

KORNIZA JURIDIKE

Në 2012, do të miratohet akt nënligjor me të cilën do të rregullohet mënyra e kontrollit të përmbajtës së deklaratave të interesave. Në pajtim ndryshimet dhe plotësimet e reja të Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave.

Në 2012 do të sillen ndryshime dhe plotësime të Ligjit për parandalimin të korrupsionit, me qëllim që të rregullohet sistematike dhe mbrojtje institucionale të personave të cilat duan të paraqesin raste të korrupsioneve, si dhe çështja e integritetit.

Byroja për furnizime publike në mars 2012 do të miratoj Rregullore për KODEKSIN për mirësjellje gjatë zbatimit të furnizimeve publike dhe Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Programit për realizimin e edukimit për furnizime publike.

KORNIZA INSITUCIONALE

Lidhur me realizimin e GREKO rekomandimeve nga rrethi i tretë i evalvimit, në prill 2012 Ministria e Drejtësisë do të informoj Qeverinë për konkluzionet të Raportit të GREKO për harmonizimin e RM-së me rekomandimet e rrethit të III të evalvimit.

Gjatë 2012 do të vazhdohet me zbatimin e tyre. Gjithashtu , do të vazhdohet me trajnimet për përforcimin e kapaciteteve të gjykatësve, prokurorëve publik dhe përfaqësuesve të policisë, për blerjen aktive dhe pasive të arbitrave vendas dhe të huaj, të përfshirë përmes konceptit të personit zyrtar, në pajtim me Konventën penale për korrupsion të Këshillit të Evropës.

Në pikëpamje të rrethit të katërt të evalvimit të Republikës së Maqedonisë nga ana e GREKO, gjatë 2012 do të ndërmerren aktivitete për përgatitjen e rrethit të katërt të evalvimit të RM-së nga ana e GREKO, me temën-preventiv të korrupsionit lidhur me anëtarët të parlamentit, gjykatësve dhe prokurorëve publik.

KSHPK në vazhdimësi do ta përcjell realizimin e aktiviteteve të parapara në Planin Aksionar të Programit Shtetëror për preventiv dhe represion të korrupsionit , dhe preventiv dhe zvogëlim të shfaqjes së konfliktit të interesave 2011-2015.

Në pajtim me ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave dhe aktin e sjellë nënligjor, KSHPK në vazhdimësi do të informoj për përmbajtën e deklaratave për interesave të personave të zgjedhur dhe të emëruar dhe do të vepron për lëndë për konflikt të mundshëm të interesave.

KSHPK në vazhdimësi i grumbullon dhe publikon në ueb faqen e saj listat anketuese dhe e përcjell gjendjen pronësore të personave të zgjedhur dhe të emëruar, me çka gjatë 2012 do të vazhdoj me kontrollim të të dhënave nga listat anketuese për personat e zgjedhur dhe të emëruar në pajtim me sistemin e vendosur për kontroll, dhe kritereve për mënyrën e përcaktimit të listave anketuese.

Dhe gjatë 2012. KSHPK do të miratoj plan të ri strategjik për avancimin e marrëdhënieve me publikun të Komisionit shtetëror për periudhën 2012-2014.

Gjithashtu , gjatë 2012 do të vazhdoj me zbatimin e Protokollit të KSHPK për bashkëpunim për preventiv dhe represion të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, me çka KSHPK do të përgatisë Raport për zbatimin e Protokollit.

Gjatë 2012 KSHPK në bashkëpunim me AGJPB do të vazhdojnë me zbatimin e trajnimeve për rreziqe nga korrupsioni, masa preventive dhe ngritjen e vetëdijes publike. Ministria për shoqëri informatike dhe administratë publike, do të zbatoj trajnim për masa antikorrupsive dhe Etika në shërbimin shtetëror. Gjithashtu Administrata doganore do të vazhdoj me trajnime të vazhdueshme të nëpunësve doganor.

Për zbatimin e Ligjit për financim të partive politike, Enti shtetëror për revizion në pajtim me revizione të realizuara të partive politike në janar 2012 do të përgatisë raport me rekomandime të revizioneve të kryera të partive politike dhe të njëjtat do t'i shpall në ueb faqen e saj, me çka në 2012 do ta përcjell kryerjen e rekomandimeve nga ana e partive politike.

Njëkohësisht, në pajtim me ndryshimet e fundit të Ligjit për financim të partive politike, Enti shtetëror për revizion do të ketë kompetencë të bën mbikëqyrje mbi punën materiale financiare të partive politike dhe në rast të parregullsive të përcaktuara në raportin vjetor financiar të partisë politike, do të mund të parashtroj ankesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje ose fletëparaqitje prokurorit kompetent publik në afat prej 30 ditë nga dita e përcaktimit të parregullsive.

Gjithashtu KSHPK rregullisht do të informoj për masat e ndërmarra dhe iniciativave të parashtruara për procedura të ngritura për parregullsi eventuale të përcaktuara në raportet vjetore financiare të partive politike, raporte për donacione dhe raporte për kampanja zgjedhore.

Trupi ndëresorjal për luftë kundër korrupsionit gjatë 2012 do të vazhdoj me mbajtjen e takimeve kordinuese me çka rregullisht do të informoj për takimet e mbajtura dhe temat e diskutimit.

Me qëllim zbatimin dispozitave për konfiskim të zgjeruar dhe pasurimin e paligjshëm të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Kodit Penal gjatë 2012, AGJPB do të vazhdoj me zbatimin trajnimeve të këtyre temave për gjykatës dhe prokurorë publik. Njëkohësisht, do të kontrollohet dhe njoftohet për rastet eventuale të konfiskimit të zgjeruar dhe pasurimit të paligjshëm.

Në kuadër të projektit Tvinig të Byrosë për Furnizime Publike i cili filloi në fund të 2011 të paraparë më tepër aktivitete në pikëpamje të përforcimit plotësues të sistemit të furnizimeve publike. Me qëllim ndërtimin në vazhdimësi të kapaciteteve të organeve kontraktuese Byroja do të filloj me certifikimin e nëpunësve të cilët punojnë në furnizimet publike.

Lidhur me transparencën e marrëveshjeve për furnizime publike shiko Kreun
3.05. *Furnizime publike*

PRIORITETE AFATMESME

KORNIZA JURIDIKE

Do të vazhdojë zbatimi i mëtejshëm efikas i luftës kundër korrupsionit, përmes zbatimit të kornizës juridike, si dhe realizimin e aktiviteteve nga Programi shtetëror për preventivë dhe represion të korrupsionit dhe Programit Shtetëror për preventivë dhe zvogëlim të shfaqjes së konfliktit të interesave me Planin Aksional.

KORNIZA INSITUCIONALE

KSHPK në afat të mesëm, do të vazhdoj me kontrollin e realizimit të aktiviteteve të përcaktuara me Planin Aksional të Programit Shtetëror për preventivë dhe represion të korrupsionit dhe Programit Shtetëror për preventivë dhe zvogëlim të shfaqjes së konfliktit të interesave, me çka do të dorëzohen njoftime për shkallën e realizimit të Planeve Aksionare.

KSHPK do të vazhdoj me realizimin e mëtejshëm të aktiviteteve të përcaktuara në Planin strategjik për marrëdhënie me publikun 2012-2014.

Në kuadër të IPA 2010-“Përkrahje për preventivë efikase dhe luftë kundër korrupsionit”, do të do sigurohet përmirësimi i zbatimit të kornizës nacionale të legjislacionit për luftë kundër korrupsionit, përforcimi i mekanizmave nacionalë për preventivë dhe luftë kundër korrupsionit, bashkëpunimi i përforcuar ndërmjet Komisionit Shtetëror për parandalimin e korrupsionit, organeve të jurisprudencës, organet kompetente për realizimin e ligjit dhe institucioneve tjera relevante në sferën e mbulimit, preventivës dhe sanksionimit të veprave korruptuese penale.

Për rritjen e transparencës së financimit të partive politike Enti Shtetëror për Revizion do të vazhdojë me shpalljen e raporteve përfundimtare të revizionit në ueb faqen e tij.

Lidhur me aktivitetet për vendosjen e Bazës së të dhënave Nacionale të zbulimit shiko Kreun 3.24.6 Bashkëpunim policor dhe luftë kundër kriminalitetit të organizuar.

3.23.3 TË DREJTAT FUNDAMENTALE

(të shihet dhe në pjesën I-kritere politike, 1.02. Të drejta të njeriut dhe mbrojtja e pakicave)

GJENDJA RRJEDHËSE

1.2.1 Respektim i të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut

Në drejtim të ratifikimit të mëtejshëm të instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ishin ratifikuar Konventa për të drejtat e personave me invaliditet dhe Protokolli Fakultativ drejt së njëjtës si dhe Konventa e Reviduar Evropiane Sociale.

Në 2011 vazhdoi praktika për dorëzimin e aplikacioneve në Gjykatën Kushtetuese për të drejtat evropiane (GJEDNJ) kundër RM-së si dhe dorëzimin e ankesave Qeverisë së Republikës së Maqedonisë në përgjigje. Në mënyrë plotësuese, GJEDNJ me vendim prej 3 Nëntor 2011, e shpalli si efikase mjetin vendas juridik para Gjykatës së Lartë për mbrojtjen e drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm.

Akademia për trajnim të gjykatave dhe prokurorëve publik në mënyrë të rregullt realizoi trajnime me Konventën Evropiane për të drejtat e njeriut.

Ishte formuar Byroja për përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë para Gjykatës Evropiane për të drejtës së njeriut në pajtim me Ligjin për përfaqësim të RM-së para KEDNJ.

Vazhdoi praktika e përkthimit, shpalljes dhe dorëzimit të vendimeve të KEDNJ deri te gjykatat dhe institucioneve të përfshira në lëndën konkrete.

1.2.2. Të drejtat qytetare dhe të drejtat politike

Ka filluar Projekti "Ditë e hapur" në Sektorin e punëve të kontroll brendshme dhe standarde profesionale të cilët qytetarët mund të informojnë për të drejtat bazë të njeriut dhe drejtave gjatë zbatimit të autorizimeve policore, të japin vërejtje konkret dhe sugjerime.

Filloi procedura gjyqësore kundër anëtarit të njësisë policore Tigrat për vrasje të kryer gjatë kohës së Grumbullimit post-zgjedhore në Shkup.

Lidhur me reformën sistemit të burgjeve, në vazhdimësi realizohen aktivitetet për ndërtimin, rekonstruimin, pajisjen, si dhe aktivitetet për përmirësimin e trajtimit me persona të dënuar.

Në mënyrë complete ka përfunduar renovimi i anës së pestë në SHNP Idrizovë dhe kullat e rojtarëve përderisa për anën majtë në rrjedhë është procedura për renovimin tyre.

Në mënyrë plotësuese, filloi ndërtimi i Burgut Kumanovë. Ishin ndërmarrë masa që kanë të bëjnë me trajtimin psikosocial i personave të gjykuar të cilët keqpërdorin drogë, dhe janë në mbajtje të dënimit me burg në SHNP Idrizovë.

Në drejtim të forcimit të kapaciteteve administrative në administratën e burgut, gjatë 2011 u realizuan tre cikle të trajnimit të drejtorëve dhe personave udhëheqës në burgjet në kuadër të administratës MATRA ENPAP Projektit "Përforcimi i kapaciteteve menaxhuese në sistemin e penetenciar të RM"-së.

Në kuadër të Projektit ishin përpunuar Procedura dhe Protokolle për vendosjen e të punësuarve në institucionet ndëshkimore përmirësuese dhe edukuese përmirësuese. Në mënyrë plotësuese, në pajtim me Programin për trajnim fillestar dhe të vazhdueshëm dhe kontroll të njohurive dhe aftësive ishin realizuar trajnime të detyrueshme të udhëheqësve të sektorit për sigurim dhe sektorin për risocializim në INP dhe ILP, si dhe trajnime të punësuarve në sektorin për

risocializim në SHNP Idrizovë dhe Burgut në Shkup. Janë realizuar edhe trajnime me përkrahje të instrumentit për ndihmë teknike TAIEX.

Me qëllim vendosjen e shërbimeve probacile, ishte përgatitur analizë komparative për shërbimet probacile dhe studime fizibiliteti për vendosjen e shërbimit probacil në Republikën e Maqedonisë.

Lidhur me rekomandimin e Parlamentit Evropian të 2007 për kontrollin e rastit të ashtuquajturit paraburgim të Kallet El Masri, me kërkesë të avokatit të paditësit, i cili gjendet në mbajtjen e dënimit burg në Gjermani, nga ku duhet të jetë lëshuar në shkurt të 2012 do të pritet në dëshmimin e tij dhe ofrimin e materialit provë për përcaktimin.

Ishin përgatitur ndryshime të Ligjit për ndihme papagesë juridike për arsye të përfshirjes së kërkuësve të azilit në kategorinë e shfrytëzuesve të drejtës së ndihmës juridike pa pagesë. Në regjistër të organizatave të cilët japin ndihmë juridike pa pagesë, janë regjistruar gjithsej 4 organizata.

Lidhur me lirinë e shprehjes, në shtator 2011, Qeveria dhe Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë filloi dialogu për çështjet e lidhura me punën e medimeve si proces i hapur dhe i vazhdueshëm, i cili do të vazhdojë në emër të ndërtimit të standardeve më të mira demokratike lidhur me lirinë e medimeve. Është formuar grup pune i cili përgatitë plan aksionar me masa për nevojat e ndryshimeve ligjore, zbatimin e drejtë të ligjeve, koncentrik i medimeve, dekriminalizimin e shpifjes dhe të gjitha çështjet tjera relevante nga sfera e punës së medimeve.

Në pajtim me Katalogun për trajnim të detyrueshëm të Akademisë për trajnime dhe prokurorë publik për periudhën shtator-dhjetor 2011 ishin mbajtur trajnime për gjykatës dhe prokurorë publik në jurisprudencë të Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut, për lirinë e shprehjes.

Lidhur me lirinë e mendimit, këshillit dhe religjionit, në vazhdimësi zbatohet Ligji për kishat, bashkësitë fetare dhe grupet religjioze.

1.2.3 Të drejtat ekonomike dhe sociale (të shihet dhe Kapitulli 3.19 *Politika sociale dhe punësimi*)

Lidhur me drejtat e grave dhe barazinë gjinore, ishte përpunuar ligj i ri për mundësi të barabarta të fermave dhe meshkujve në drejtim të harmonizimit me legjislacionin evropian nga sfera.

Filloi zbatimi i projektit trevjeçar, i përkrahur nga UN women, në drejtim të futjes së konceptit gjinor në politikat buxhetore, Mistrira për Punë dhe Politikë Sociale.

Ishte miratuar Plani i dytë Nacional për përparimin e gjendjes shoqërore të gruas Rome. Ishin realizuar 6 punëtori (në Koçanë, Shtip dhe Kumanovë) të Romeve të papunësuar kishin mundësi të njihen me masat aktive për punësim, drejtave të mbrojtjes shëndetësore dhe sociale dhe realizimin e të drejtave të njeriut, parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi dhe për tejkalimin e tretmanit të jobarabartë nga ana e nëpunësve shtetëror gjatë qasjes dhe kërkesës së shërbimeve të caktuara të institucioneve.

Gjatë 2011, është vendosur qasje multisektore e koordinuar në mbrojtjen e viktimave të dhunës familjare përmes përgatitjes së Protokollit të përbashkët për veprim në rast të dhunës familjare.

Në nivelin lokal janë formuar 30 trupe lokale koordinatave të cilët punojnë në preventivën e zbatimit praktik të Protokollit për veprimin e strukturave profesionale.

Në vazhdimësi zbatohet programi për forcimin ekonomik të viktimave të dhunës familjare përmes tre programeve sipas llojit të masave aktive për punësim në tregun e punës për

vetëpunësim, punësim i subvencionuar dhe kualifikim/rikualifikim. Në vazhdimësi përforcohen kapacitetet e punëtorëve profesional përmes trajnimeve.

Me qëllim që të sigurohet baza vendore të trajnerëve të cilët punojnë në trajtimin e kryerësve të dhunës familjare në këshill dhënien për kryerës të dhunës familjare me sukses janë trajnuar 14 persona profesionalë për punë për kryerës të dhunës familjare.

Në mënyrë plotësuese, ishte hapur këshillëdhënia e parë për punë me kryerësit e dhunës familjare në Shkup.

Në drejtim të ngritjes së vetëdijes publike për paraqitjen e dhunës familjare në 2011 filloi kampanja për dhunën familjare me logon "Së bashku të dalim nga errësira e dhunës", e cila emetohet në të gjitha mediumet nacionale

Janë përgatitur afishe dhe fletushka në: Gjuhë maqedonase, shqipe, rome, dhe turke.

Në sferën e drejtave të fëmijëve, në vazhdimësi realizohen aktivitetet në drejtim të përshtatjes dhe rekonstruimit të kapaciteteve ekzistuese institucionale për arsye të intervenimit më të shpejtë, pranimit, tretmanit, mbrojtjes, risocializimit dhe reintegrimit të fëmijëve në rrezik dhe kryerësve të moshës së re të veprave penale.

Në pajtim me Programin Vjetor të Këshillit Shtetëror për delikucencë të të miturve, gjatë 2011., Këshilli në mënyrë të rregullt morri pjesë në seancat këshillave lokale të cilët rezultuan me konstituimin e këshillave komunal për shkëlje e të miturve në Prilep, Kavadar, Negotinë dhe Shkup.

Ishin iniciuar reforma të caktuara në veprimin urgjent në planin e përforsimit të kapaciteteve dhe kushteve në institucionet përkatëse për kryerjen e sanksioneve dhe në vazhdimësi përcillet zbatimi i Strategjisë Nacionale për shkëlje të të miturve. Këshilli gjatë 2011 mbajti 12 mbledhje.

Lidhur me personat socialë të prekur dhe/ose personave me pengesa në zhvillim, në vazhdimësi zbatohet Strategjia e reviduar nacionale për bashkimin e drejtave dhe mundësive me invaliditet 2010-2020.

Në drejtim të përmirësimit të kushteve në spitalet psikiatrike, gjatë 2011 është kryer rekonstruim i plotë i seksionit kronik të grave dhe seksionit geriatrik Psikiatrik Demir Hisar. Për IPSH Spital Psikiatrik "Negorc"-Gjevgjeli në tërësi është rinovuar seksioni kronik i gruas së bashku me kuzhinën dhe dhomën e bukës dhe trapezarinë dhe pjesët sanitare në gjithë spitalin.

Hospitalizimi është lloj i pasionit. Në rrjedh është analiza për nevojën e kuadrit të mesëm medicinal(infermierë, motra medicinave etj). Pacientët janë të angazhuar me terapi pune në Spitalin Psikiatrik "Negorc"-Gjevgjeli dhe në Spitalin Psikiatrik Demir Hisar. Këto aktivitete pune dhe në të dyja institucionet realizohen si terapi pune me kontroll të vazhdueshëm të personit mjekësor-terapeut.

Në rrjedhë është përgatitja e programit personal për trajnim dhe ushtrimin e personelit të ri të pranuar si edukim të vazhdueshëm të të njëjtit si dhe Protokolle për mirësjellje adekuate të personelit mjekësor ndaj pacientëve si dhe të zbatohet trajnimi i vazhdueshëm i personelit të mesëm mjekësor (infermierë dhe infermiere).

Në të gjitha institucionet psikiatrike në vende të dukshme dhe të lehtë të arritshme ishin vendosur kuti për ankesa me çka janë ruajtur principet e besueshmërisë dhe diskrecionit janë ruajtur. Janë mënjanuar të gjithë lëndët të cilat mund të jenë të përdorura si armë e ftohtë, dhe të cilat janë lehtë të arritshme për pacientët.

Lidhur me Entin Special Demir Kapi ku vendosen personat me retardim të rëndë dhe shumë të rëndë mental në Pajtim me Planin dhe Programin për punë filloi me riedukim intensiv psiko motorik të shfrytëzuesve, me të cilën angazhohet përmes qasjes dhe shfrytëzimit të potencialeve ekzistuese të shfrytëzuesve të arrihen maksimum në aftësitë e tyre psikofizike përkatësisht të nxitet pavarësia e tyre, zhvillimi dhe korrigjimi i të folurit, zhvillimit të motorikes dhe rregullat elementare të sjelljes.

Në mënyrë plotësuese, është qasur drejt renovimit të Seksionit për përkujdesje, mbrojtje shëndetësore dhe rehabilitim ku janë të vendosur persona me retardim më të rëndë mental. Në

drejtim të rritjes së mundësisë pjesa më e madhe e ditës së shfrytëzuesve ta tejkalojnë ë hapësirën e hapur, ishte rinovuar fusha e lojës ku numri më i madh i kohës së vet shfrytëzuesit e tejkalojnë.

Në kuadër të realizimit të procesit të deinstitutionalizimit të shfrytëzuesve me pengesa në zhvillimin mental mbi 18 vite të IP Enti Special Demir Kapi, gjatë 2011 e riformuar është shërbimi i dytë për përkrahjen e banimit në bashkësi në territorin e qytetit të Shkupit. Në moment funksionojnë dy shërbime me 15 njësi banesore për banim të organizuar me përkrahjen të cilët vendosen 64 shfrytëzues.

Në sferën e politikës anti-diskriminuese, në drejtim të zbatimit efektiv të Ligjit për parandalimit dhe mbrojtjes së diskriminimit, ishin realizuar trajnime të trajnuesve me të cilën ishin përfshirë 24 persona (koordinator lokal për mundësi të barabarta dhe përfaqësues të OJQ-ve).

Personat e trajnuar prej 12 qyteteve në RM bënë trajnimin e 300 përfaqësuesve të njësisve të vetadministrimit lokal dhe bashkësive vendore. Në mënyrë plotësuese, në kuadër të programit qytetarë aktiv gjatë 2011 në Qytetin e Shkupit (Gjeorgje Petrov, Karposh, Çair) ishin organizuar 6 tryeza të rrumbullakëta në komunat dhe shkollat fillore me qëllim informim e qytetarëve për konceptin e diskriminimit, bazat e diskriminimit dhe llojet e diskriminimit si dhe temat e lidhura me dhunën mbi gruan, tregtinë me njerëz dhe barazinë gjinore. Komisioni për mbrojtjen nga diskriminimi ngeli tërësisht operativ dhe filloi të veprojë ndaj parashtresave të parashtruara.

Nga gjithsej 57 parashtresa të dorëzuara, për 25 është sjellë mendim. Pas parashtresave të ngelura, procedura është në rrjedh. Janë marrë vazhdimisht veprime për të rritur ndërgjegjësimin publik në lidhje me problemin e diskriminimit përmes paraqitjes së medie, shtypjen dhe shpërndarjen e materialeve promovuese dhe krijimin e ueb faqes së internetit të Komisionit www.kzd.mk. Është vendosur një bashkëpunim të rregullt me Avokatin e Popullit të Republikës së Maqedonisë, me Komisionin për mundësi të barabarta për femrat dhe meshkujt në kuadër të Parlamentit të RM-së, Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, mundësi të barabarta komisionet brenda njësisve të vetadministrimit lokal, si dhe të gjithë faktorët tjerë relevant në këtë sferë.

Ishte miratuar Plani Strategjik për punën e Komisionit.

Është përgatitur Strategji kombëtare për barazinë dhe mosdiskriminimin në bazë të gjinisë, përkatësisë etnike, njerëz të moshave të ndryshme dhe me njerëzit me aftësi të kufizuara, që mbulon periudhën 2012-2015 me qëllim sigurimin e përmirësimit të vazhdueshëm në realizimin e të drejtave dhe mundësive të barabarta.

1.2.4 Respektimi dhe mbrojtja e pakicave, të drejtave kulturore

Sekretariati për zbatimin e Marrëveshjes kornizë vazhdoi me marrjen e aktiviteteve që kanë për qëllim promovimin e pjesëmarrjes së barabartë të përfaqësuesve të të gjitha bashkësive etnike, procesin e decentralizimit, përdorimin e gjuhës dhe bashkësive jo shumicë dhe sistemit arsimor.

U shënua 10 vjetori i nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit në të cilën u confirmua angazhimi i fortë për të vazhduar zbatimin e plotë të akteve normative që dalin nga Marrëveshja e Ohrit.

Në drejtim të përmirësimit të përfaqësimit të barabartë në dhe administratën shtetërore dhe publike gjatë 2011 janë realizuar dy shpallje të 2010 për 79 nëpunës civil. Në rrjedhë janë 328 shpallje të nëpunësve shtetëror nga të cilat 250 për pjesëtarët e bashkësive më të vogla etnike. Në vitin 2011 u botuan shpallje për gjithsej 249 përmbaues.

Janë miratuar ndryshimet e Ligjit për përdorim të gjuhës që e flasin së paku 20% të qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe në njësitë e vetadministrimit lokal. Gjatë 2012 do të jetë miratuar Plani Aksionar për përdorimin e gjuhëve.

Në mënyrë plotësuese ishin miratuar ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për përdorimin e flamujve.

Me qëllim promovimin e marrëdhënieve ndëretnike në pajtim me marrëveshjen kornizë, ishin ndarë 11.000.000,00 denarë për aktivitete programore të shoqatave dhe fondacione.

Në pajtim me angazhimin për të krijuar ndryshim të qartë dhe të rëndësishëm në qasjen e përgjithshme në sistemin arsimor në përputhje me realitetin multietnik në Republikën Maqedonisë u zhvilluan takime të lartë strategjike Arsimit i integruar, në përputhje me Strategjinë, është futur dhe

vepron në komunën e Çairit (klasa të arsimit të integruar në gjuhën maqedonas dhe shqipe), dhe shkollat në komunën Jegunovcë (në gjuhën maqedonase dhe shqipe), Vasilev dhe Strumicë (klasa maqedonase-turke), ku përmes aktiviteteve jashtë mësimore, nxënësit të mësojnë gjuhën e bashkësive tjera etnike.

Në kuadër të projektit për përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike që zbatohen në Kumanovë, Strugë dhe Kërçovë është themeluar forum ndërmjet njësive të vetadministrimit lokal dhe komunitetit të biznesit të tri komunave, janë realizuar trajnime për ligjet që prek bashkësitë më të vogla dhe mbikëqyrje të ligjeve të reja që janë të lidhura ngushtë me integrimin evropian, trajnime për përmirësimin e koordinimit dhe komunikimit mes njësive të vetadministrimit lokal, shoqërisë civile dhe mediat dhe përmirësimi i bashkëpunimit dhe komunikimit ndërmjet pushtetit qendror, shoqërisë civile dhe medieve.

Në kuadër të aktiviteteve që ndërmerren për punësimin e romëve, është përgatitur Plan i ri operativ për programet dhe masat aktive për punësim për vitin 2012-2013 programeve dhe masave për punësim do të bëhen trajnime për të papunët romë për profesione të caktuara përmes mësimin teorik e cila do të realizohet përmes institucioneve relevante dhe praktike - të mësimdhënies, e cila do të zbatohet në bashkëpunim me punëdhënësit relevant të interesuar.

Vazhdoi zbatimi i projekti për dhënie e bursave dhe mentorimin e nxënësve romë nga viti I deri IV i arsimit të mesëm. Në vit shkollor 2011/12 ishte siguruar përkrahje financiare e 600 nxënësve.

Në pjesën e shëndetësisë, filloi zbatimi i programit për mediator rom të shëndetësisë.

Gjatë 2011 është bërë rialokimi i RIC në bashkëpunim me njësitë e vetadministrimit lokal. Për momentin funksionojnë 9 qendra informative Rome. Përmes zyrave Mobile për ndihmë juridike në bazë të zyrave ekzistuese në RIC i Shkup Dellqevë dhe Shtip realizohen, aktiviteteve të këshillimit për të drejtat e romëve.

Filloi aksioni për identifikimin e personave që nuk janë regjistruar në regjistrat amë. Është formuar trup punues i përfaqësuesve të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, Ministrisë së Brendshme dhe Administratës për mbajtjen e regjistrave amë të evidencës që vazhdimisht i shqyrton dhe i diskuton konstatimet nga terreni. Në fazën e parë të zgjidhjes së këtij problemi, fokusi do të jetë në personat të cilat aspak nuk i kemi në evidencë, ndërsa në fazën e dytë do t'i përfshijë personat që nuk kanë dokumente personale, të rregulluar statusin e shtetësisë së të huajve.

Gjatë periudhës raportuese janë marrë gjithsej prej 45 lëndë nga tre lagje në Shkup. Lëndët më tutje do t'i dorëzohen Drejtorisë për mbajtjen e librave amë të evidencave së bashku me MPB për klasifikimin e lëndëve dhe fillimin e procedurës për zgjidhjen e lëndëve që zgjidhen, ndërsa në rastet në të cilat ka nevojë për trajtim të mëtejshëm do të kthehet në ndryshe MPPS, e cila do të vazhdojë të kërkojë mekanizëm shtesë për zgjidhjen e tyre.

Agjencia për realizimin e të drejtave të bashkësive përpunoi bazë të dhënash për kushtet dhe përfaqësimin e barabartë të bashkësive në nivelit qendror dhe lokal. Në mënyrë plotësuese ishte përpunuar baza e të dhënave të shoqatave të qytetarëve dhe fondacioneve të cilat në dispozitat e tyre ligjore kanë paraparë edhe avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave të bashkësive në RM.

Është realizuar fushatë për regjistrimin e popullsisë të ekonomive familjare dhe banesave, duke vizituar 12 rrethe të regjistrimit, ndarja e materialeve promovuese, organizimin e tribunave dhe takimeve me qytetarë me qëllim pjesëtarëve të bashkësive në Republikën e Maqedonisë për t'u njohur me të drejtat e tyre të regjistrimit.

Ishte zbatuar Projekti për forcimin e kapaciteteve të Agjencisë në kuadër në të cilën janë realizuar më shumë trajnime për trajnimin e punëtorëve dhe 3 trajnime ishin të përfshirë edhe përfaqësues të shoqërisë civile. Agjencia e përgatiti Planin Strategjik për 2012-2014 dhe Programi vjetor për 2012.

Lidhur me respektimin e privatësisë është miratuar strategjia për mbrojtjen e të dhënave personale në Republikën e Maqedonisë për periudhën 2012-2016. U miratuan ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Është përcaktuar metodologjia për mbikëqyrjen e zbatimit të dokumenteve strategjike të Drejtorisë .

Vazhdimisht zbatohet projekti - IPA 2008, Mbështetjen e Drejtorisë për Mbrojtjen e të dhënave personale, gjatë vitit ishte zbatuar dhe IPA projekti mbështetjen në përgatitjen e propozim dokumenteve strategjike, dhe hulumtim i opinionit publik në mesin e punëtorëve të medimeve. Është realizuar projekti - Qasja në vendimet gjyqësore dhe të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale.

Drejtorja organizoi Konferencë Ndërkombëtare për qasje strategjike për zhvillimin e mekanizmave për mbrojtjen e të dhënave personale. Vazhdoi trajnimi permanent i kontrollorëve dhe përpunuesve programi vjetor dhe kërkesat plotësuese. është forcuar, mbikëqyrja e inspektionit, ndërsa u realizua një numër i madh i mbikëqyrjeve të jashtëzakonshme që rrjedhin nga paraqitjet e qytetarëve në të dhënat e tyre personale.

Është blerë dhe vënë në funksionim pajisje e re informatike dhe automjete zyrtare për kryerjen e mbikëqyrjes së inspektionit vazhdimisht regjistri qendror azhurnohet për përmbledhjet e të dhënave personale që i udhëheqin kontrollorët dhe regjistrohen të dhëna për oficerin për mbrojtjen e të dhënave personale. Ishte përgatitur Plani Vjetor për mbikëqyrje të inspektionit për 2010 dhe 2011.

Drejtorja numëron 20 të punësuar, për të cilët programet vjetore për trajnime për të punësuarit janë siguruar trajnime gjenerike, dhe trajnime të specializuara për mbrojtjen e të dhënave personale janë sfera specie si dhe të certifikuara me ICO trajnime për inspektionin sigurisë informatike.

PRIORITETE AFATSHKURTRA

Korniza Juridike

1.2.1 Respektimi të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut

Mbindërtimin e SKPV me qëllim kontrollin automatik dhe të centralizuar në gjatësinë e qëndrimit të të huajve.

3.24.5. BASHKËPUNIMI GJYQËSOR NË LËNDËT PENALE DHE CIVILE

GJENDJA RRJEDHËSE

KORNIZA JURIDIKE

Në 2010 Republika e Maqedonisë e nënshkroi protokollin e tretë plotësues të Konventës për ekstradimin e Këshillit të Evropës. Në rrjedhë është procedura për ratifikimin e të njëjtit.

Në prill 2011 janë nënshkruan tre marrëveshje dypalëshe ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Kosovës, për ndihmë juridike në çështjet penale, ekstradimin, transferimin e personave të dënuar.

Në prill 2011 me amendamentin XXXII është bërë ndryshimi të Kushtetutës maqedonase, e cila përcakton se një qytetar i Republikës së Maqedonisë nuk mund të ekstradohet në një shtet tjetër, përveç në bazë të një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar, me vendim të gjykatës.

Në 2011 Ministria e drejtësisë së RM-së nënshkroi dy marrëveshje bilaterale për ekstradim, edhe atë: Marrëveshje ekstradimi me Republikën e Kroacisë të nënshkruar në 31.10.2011 dhe marrëveshje ekstradimi me Malin e Zi nënshkruar më 04.10.2011, e cila është rregulluar dhe nxjerrjen e qytetarët e vet, për format më të rënda të korrupsionit, krimin të organizuar dhe pastrimit të parave.

Në 30.11.2011 Ministri i Drejtësisë së RM-së nënshkroi tri marrëveshje dypalëshe me Republikën e Serbisë, marrëveshje për ndihmë juridike në çështjet civile dhe penale, traktat ekstradimi dhe një marrëveshje për zbatimin e ndërsjellë të vendimeve gjyqësore në çështjet penale.

Më 04.10.2011 u nënshkrua Protokollin për bashkëpunim mes Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Maqedonisë dhe Ministrisë së Drejtësisë së Bosnje-Hercegovinës që do të promovojë bashkëpunimin midis dy vendeve në fushën e drejtësisë dhe të ndihmës ndërkombëtare ligjore.

KORNIZA INSITUCIONALE

Për zbatimin e Marrëveshjes për bashkëpunim ndërmjet Maqedonisë dhe EUROJUST (EUROJUST), përmes të cilit mund të realizohet komunikimi i drejtpërdrejtë ndërmjet autoriteteve kompetente gjyqësore të Republikës së Maqedonisë dhe Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian në parandalimin dhe zgjidhjen e akteve të krimin të organizuar në qershor 2011 përfaqësues emërohet e prokurorit për krimin e organizuar dhe një përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë si persona kontakti të cilët do të punojnë direkt me EURIJUST në përputhje me marrëveshjen e lidhur.

Prej 01 prill deri më 21 nëntor 2011, janë pranuar 4.534 lëndë, ndaj të cilave është vepruar 8.687 herë. Janë realizuar 69 ekstradime, duke përfshirë edhe nga jashtë në Republikën e Maqedonisë ka ekstraduar 47 shtetas maqedonas nga Maqedonia dhe jashtë vendit janë ekstraduar 22 të huaj

Gjithashtu, gjatë 2011 është bërë transferim i 16 persona, 7 prej të cilëve janë nga vendet e huaja në Maqedoni, se pjesa tjetër e dënimit ata janë duke shërbyer në burgun Dhomën

Ndëshkimore-përmirësuese, dhe 9 shtetas të huaj të cilët janë transferuar nga Republika e Maqedonisë vendet shtetas e të cilëve janë.

~ Në 2011 në akademinë e gjykatësve dhe prokurorëve, janë mbajtur:

~ Në organizim të TAIEX, është mbajtur seminar me temën e Bashkëpunimit ndërkombëtar në materien penale.

~ Në organizim të OBSE, është mbajtur punëtori për zbatimin e Ligjit për procedurë penale.

Në kuadër të IPA projektit, është mbajtur seminar për të drejtën private ndërkombëtare;

PRIORITETET AFATSHKURTRA

KORNIZA JURIDIKE

Ngritje të procedurës për ratifikimin e protokollit të tretë plotësues të Konventës për ekstradim të Këshillit të Evropës prej 10 shtator 2010 të nënshkruar më 10.11.2010.

Gjatë 2012 parashikohet nënshkrimi / ratifikimi i marrëveshjeve dypalëshe me vendet fqinje për ndihmë juridike në çështjet civile dhe penale, për njohjen reciproke dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore, që do të kryejnë shtrirjes më tej me legjislacionin e BE-së në këtë sferë.

Është paraparë ratifikimi i tre marrëveshjeve dypalëshe ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Kosovës, për ndihmë juridike në çështjet penale, ekstradimin, transferimin e personave të dënuar.

Gjatë 2012, parashikohet ratifikimi i tri marrëveshjeve me Malin e Zi dhe traktateve të ekstradimit, marrëveshja për ndihmë juridike në çështjet civile dhe kriminale dhe marrëveshja për njohjen reciproke dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore, ratifikimi i tri marrëveshjeve me R. e Serbisë dhe atë marrëveshja për ekstradim, Marrëveshja për ndihmë juridike në lëndë civile dhe penale dhe marrëveshja për njohjen reciproke dhe zbatimin e vendimeve të gjykatave, ratifikimi i tri marrëveshjeve për ndryshimin dhe plotësimin e tri marrëveshjeve (Marrëveshja për ekstradim,, marrëveshja për ndihmë juridike në lëndë civile dhe penale dhe Marrëveshja për njohjen e ndërsjellë dhe zbatimin e vendimeve të gjykatës) të lidhura me Bosnjë dhe Hercegovinën si dhe ratifikimi i Marrëveshjes për ekstradim me Kroacinë.

KORNIZA INSITUCIONALE

Është paraparë trajnimin i vazhdueshëm i të punësuarve në Sektorin për Asistencës Ligjore Ndërkombëtare dhe punonjësve të tjerë në Ministrinë e Drejtësisë, gjyqtarëve dhe prokurorëve me anë të Akademisë për trajnim të gjykatësve dhe prokurorëve publikë në pjesën e materies penale, me theks të veçantë në Konventën Evropiane për Ndihmë të Ndërsjellë Ligjore, ekstradimi transferim, transferim të procedurave ndëshkuese me protokolle shtesë, Eurojust, urdhër-arrestin evropian, dhe zbatimi i Ligjit për bashkëpunim ndërkombëtar në materien penale.

Do të vazhdojnë aktivitetet për realizimin e Marrëveshjes për bashkëpunim ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe DREJTËSISË EVROPIANE (EUROJUST).

PRIORITETET AFATMESME KORNIZA JURIDIKE

Lidhje e marrëveshjeve të dyanshme në sferën penale dhe civile në nivel rajonal dhe ndërkombëtar.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Për zbatimin e mëtutjeshëm të marrëveshjes bilaterale dhe multilaterale nevojitet trajnim i vazhdueshëm, seminare, këshillime për aplikimin e Konventave Evropiane në sferën civile dhe penale, i të punësuarve në Sektorin për ndihmë juridike ndërkombëtare dhe të punësuarve të tjerë në Ministrinë e Drejtësisë, gjykatësve dhe prokurorëve publikë nëpërmjet Akademisë për gjykatës dhe prokurorë publikë.

Do të realizohen aktivitete edhe për përmirësimin e sistemit për mbajtjen e evidencës së lëndëve të ndihmës juridike reciproke në materien civile dhe penale.

3.24.6 BASHKËPUNIMI POLICOR DHE LUFTA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR GJENDJA AKTUALE KORNIZA JURIDIKE

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e miratoi Ligjin për ratifikimin e Konventës për Qendrën e zbatimit të ligjit në Evropën Juglindore 10 (SELEC).

U miratua Ligji për ratifikimin e Marrëveshjes për bashkëpunim operues dhe strategjik me Zyrën e policisë evropiane (EUROPOLL)¹¹

U nënshkrua Memorandum për përforcimin e bashkëpunimit në sferën e kontrollit të brendshëm ndërmjet ministrive të punëve të brendshme të Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Serbisë.

Me qëllim të rregullimit të mënyrës së realizimit të koordinimit për bashkëpunim ndërkombëtar, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Financave: Policia financiare, Drejtoria Doganore, Ministria e Drejtësisë dhe Prokuroria publike nënshkruan Memorandum për bashkëpunim, me të cilin u obliguan t'i realizojnë të gjitha aktivitetet e nevojshme për funksionimin e Njesisë për koordinim ndërkombëtar të organeve kompetente për zbatimin e ligjit. “

Në drejtim të adresimit të kundërthënies së konstatuar në pikëpamje të aplikimit të a.q. përcjellje ambientale, u miratuan ndryshime dhe plotësime të Ligjit për procedurë penale¹². Gjithashtu rregullohet kontrollimi i shtëpisë dhe personit pa praninë e dy dëshmitarëve të cilët janë në moshë madhore, ndërsa personit me të cilin ka të bëjë urdhri për kontrollim i jepet e drejta të jetë i pranishëm si mbrojtës gjatë kryerjes së kontrollit.

Në muajin maj 2011 u miratua Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë¹³, me të cilin futen dispozitat nga sfera e mbrojtjes së fëmijëve nga abuzimi seksual, si dhe inkriminimet nga sfera e korrupsionit. Paralelisht me këto dispozita u ndryshuan edhe disa inkriminime zbatimi i deritanishëm i të cilëve tregoi dobësi të caktuara në praktikë.

U miratua Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kontrollimin dhe vulosjen përkatësisht shënimin e armëve të zjarrit dhe municionit 14 me të cilin bëhet harmonizimi me Direktivën 2008/51/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit prej 21 maj 2008 me të cilën ndryshohet dhe plotësohet Direktiva për kontrollimin dhe furnizimin dhe posedimin e armës 91/477/EES të Këshillit të Evropës, 18.06.1991.

KORNIZA INSTITUCIONALE

U formua Njësia për koordinim ndërkombëtar të organeve kompetente për zbatimin e ligjit (ILCUs).

Sektori për bashkëpunim ndërkombëtar është caktuar si Njësi qendrore nacionale për bashkëpunim me vendet nënshkruese të Konventës për bashkëpunim policor në Evropën Juglindore.

Në pajtim me Aktin e ri për sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Seksioni për krimin e organizuar u shndërrua në Qendër për zbulimin e krimit serioz dhe të organizuar. Në procedurë transparente u realizuan shpallje interne për të gjitha vendet udhëheqëse në Qendrën. Në rrjedhë janë aktivitetet për fillimin e procedurës për shpalljen e konkursit për 169 vende të paplotësuara në Qendrën, prej të cilave në: Seksionin për krim financiar - 30 përmbaues; Seksioni për tregti të palejuar me drogë - 9 përmbaues; Seksioni për zbulime kriminalistike- 26 përmbaues; Seksioni për analizë për kundërzbulim kriminalistik - 19 përmbaues, Seksioni për operacione të fshehta- 45 përmbaues; Seksioni për krim serioz- 30 përmbaues.

Republika e Maqedonisë është e ranguar në grupin TIER 1, në vendet të cilat plotësisht i plotësojnë standardet në luftën kundër trafikimit me njerëz nga ana e Stejt departamentit në SHBA.

U sigurua lokal adekuat për Seksionin për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe u siguruan pajisje adekuate. Me qëllim të përforcimit të kapacitetit të Seksionit për mbrojtjen e dëshmitarëve,

¹⁰ Gazeta zyrtare e RM-së nr. 18/ 2011

¹¹ Gazeta zyrtare e RM-së nr. 6p.172/2011

¹² Gazeta zyrtare e RM-së nr.51/2011

¹³ Gazeta zyrtare e RM-së nr. 51/2011

¹⁴ Gazeta zyrtare e RM-së nr.. 47/2011

realizohet Projekt Rajonal IPA 2009: Bashkëpunimi në sferën e të drejtës penale: mbrojtja e dëshmitarëve në luftën kundër krimit serioz dhe terrorizmit (WINPRO).

Edukimi dhe përsosmëria e të punësuarve në Ministrinë e Punëve të Brendshme realizohet në mënyrë të vazhdueshme, në bashkëpunim edhe me më shumë organizata ndërkombëtare¹⁵ si dhe me ambasada dhe ministritë e punëve të brendshme¹⁶. Në periudhën janar-shtator 2011 u realizua trajnim për 155 të punësuar në Qendër.

Drejtoria për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit realizoi numër të madh trajnimesh për të punësuarit si dhe për subjektet të obliguar të japin raporte për qëllimet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

U realizua bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme me BAFA- (Federal office of economics and export control) i cili paraqet Qendër për kontrollin e eksportit. U rinovuan lokale për magazinimin e gëzhojave të plasura nga armët të cilat në mënyrë legale i posedojnë qytetarët, pajisje kompjuterike, mobilje dhe ngjashëm, me pajisje në vlerë prej përafërsisht 70.000,00 EURO e dhuruar nga ana e SEESAC (South Eastern and Eastern Europe Clearinghouse for the Control of Small Arms and Light Weapons) Komisioni nacional për luftë kundër trafikimit me njerëz dhe imigrimit legal në vazhdimësi i realizon aktivitetet e tij të planifikuara. U realizuan 3 takime pune me qëllim të përforcimit të kapaciteteve të këshillave lokalë për parandalimin në luftën kundër trafikimit me njerëz. Në bashkëpunim me OSBE-në u përpilua formular për përcjelljen dhe njoftimin e Raportuesit nacional për raste të trafikimit me njerëz.

Qendra për personat-viktimë të trafikimit me njerëz gjatë vitit 2011 ka pranuar 8 persona viktimë të trafikimit me njerëz në moshë prej 16 deri 21 vjet, të përkatësisë maqedonase, rome dhe shqiptare. Kjo qendër punon me ndihmën e OJQ-së "Portë e hapur" në të cilën janë 7 persona të punësuar, OJQ-së "Fëmijë i gëzuar" në të cilën janë 3 persona të punësuar, OJQ-së "Qasje të barabartë" e cila siguron integritet të sërishëm të personave-viktimë të trafikimit me njerëz.

Me qëllim të përforcimit të bashkëpunimit rajonal në luftë kundër trafikimit me njerëz u realizua projekti "Qasja e integruar për parandalimin e keqpërdorimit të punës ndërmjet vendeve të origjinës dhe desitacionit" i cili u realizua në bashkëpunim me vendet në rajon. Bartës i projektit është Romania, ndërsa pjesëmarrës në projektin janë 6 vende: RM-ja, Bulgaria, Greqia, Qiproja, Hungaria.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë miratoi Strategji nacionale për pastrim parash dhe financimin e terrorizmit për periudhën prej vitit 2012-214.

Në mënyrë plotësuese, Qeveria e Republikës së Maqedonisë e miratoi Strategjinë dhe Planin aksional për koordinimin e aktiviteteve në luftë kundër krimit të organizuar me të cilat parashihet formimi i Qendrës koordinuese nacionale për luftë kundër krimit të organizuar.

U nënshkrua memorandum për bashkëpunimin e Drejtorisë për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit me Agjencinë për zbulim.

Në drejtim të përforcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar, Drejtoria për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit nënshkroi memorandum për bashkëpunim me Republikën e Hungarisë dhe Izraelin.

U miratua Vendim për formimin e Këshillit për parandalimin e larjes së parave dhe financimin e terrorizmit¹⁷.

U miratua Ligji për ratifikimin e Marrëveshjes për bashkëpunim operues dhe strategjik me Zyrën e policisë evropiane.

PRIORITETET AFATSHKURTRA KORNIZA JURIDIKE

Gjatë vitit 2012, në sferën e bashkëpunimit policor do të miratohen aktet juridike në vijim:

– Ligji për ratifikimin e Konventës për mbrojtjen e grave nga dhuna shtëpiake dhe seksuale;

– Nënshkrimi i Marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Maqedonisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë për hapjen dhe funksionimin e qendrës së përbashkët kontaktuese për bashkëpunim policor.

– Miratimi i Udhëzimit për definimin e statusit dhe kompetencave të njësisë ILECU

¹⁵ OBSE, UNDP, ICITAP, ILECU, CIVIPOL, IOM, FRONTEX, TAIEX, UNODC e tj)

¹⁶ SHBA, Franca, Sllovenia, Austria, Bulgaria etj.

¹⁷ Gazeta zyrtare e RM-së nr.. 159/2011

- Me Europoll do të nënshkruhet marrëveshje bilaterale për lidhjen e rrjeteve kompjuterike dhe Memorandum për krijimin e lidhjes së re të sigurt për komunikim, me të cilat do të mundësohet lidhja e drejtpërdrejtë me aplikimin për shkëmbimin e sigurt të informatave dhe analizave të rrjeteve të Europoll - SIENA.

- Në drejtim të implementimit të Strategjisë dhe Planit aksionar për koordinimin e aktiviteteve në luftën kundër krimit të organizuar, në vitin 2012 do të miratohet akt juridik me të cilin rregullohet mënyra e funksionimit të Qendrës koordinuese nacionale për luftë kundër krimit të organizuar.

Në pajtim me Planin aksionar për implementimin e Ligjit për procedurë penale, do të miratohen ligjet në vijim:

- Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për përcjelljen e komunikimeve, me të cilin ndër të tjerash, do të adresohen vërejtjet nga Raporti i Komisionit Evropian për progresin e RM-së në vitin 2011;

- Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurori publike dhe miratimin e akteve nënligjore me të cilin do të rregullohet formimi i qendrave për hulumtim;

- Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për punë të brendshme;

- Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për policinë;

- Ligji për policinë financiare.

Pas përfundimit të procedurës së zgjedhjes së ofruesit më të mirë në kuadër të furnizimit të sistemit të Bazës nacionale kriminalistike për zbulim do të nënshkruhet Marrëveshje me ofertuesin më të volitshëm për kryerjen e punëve. Për funksionimin e Bazës së të dhënave nacionale për zbulim do të miratohet:

- Vendimi për formimin e Komisionit për Menaxhim me Bazën e të Dhënave Nacionale Kriminilastike për zbulim.

- Rregullore për mënyrën e ndarjes së qasjes, nivelin e qasjes, kriteret sipas të cilave rregullohet niveli i qasjes, kohëzgjatjen e qasjes, procedurën për rregullimin e ndërprerjes dhe për heqjen e të drejtës së qasjes.

- Rregullore për mënyrën e përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave në bazë.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Në drejtim të implementimit të suksesshëm të Marrëveshjes për bashkëpunim me Europoll, Ministria e Punëve të Brendshme do të emërojë oficer për lidhje në selinë e Europoll në Hagë, Holandë.

Kapacitetet e Sektorit për bashkëpunim policor ndërkombëtar do të përforcohen me 8 përmbaues të rinj, prej të cilave 2 në Seksionin për Europoll.

Drejtoria Doganore dhe Ministria e Punëve të Brendshme - Sektori për punë kufitare dhe migrim do të emërojë oficerë për lidhje në Njësinë për koordinim ndërkombëtar të organeve kompetentë për zbatimin e ligjit (ILECUs).

Do të formohen qendra për hulumtim dhe do të formohet grup policor gjyqësor në pajtim me Ligjin për procedurë penale.

Do të vazhdohet me implementimin e Projektit për themelimin e bazës së të dhënave nacionale kriminalistike për zbulim.

Në kuadër të aktiviteteve për themelimin e bazës së të dhënave nacionale kriminalistike për zbulim, periudha për zgjedhjen e ofruesit më të mirë është prolonguar deri në fund të janarit 2012 për shkak të nevojës për periudhë plotësuese për analizë të ofertave të dorëzuara, me çka te operatorët ekonomikë është dorëzuar kërkesë për vazhdimin e vlefshmërisë së kufijve.

Në drejtim të luftës së vazhdueshme kundër krimit të organizuar, gjatë vitit 2012 Komisioni Nacional për Luftë Kundër Trafikimit me Njerëz dhe Migrimit Ilegal do të miratohet Strategji e re për luftë kundër trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal me Plan aksionar për periudhën e vitit 2013-2015.

Me qëllim të sigurimit të qasjes strategjike dhe sistimore në zhvillimin dhe implementimin e modelit nacional për zbulimin kriminalistik në Prokurorinë publike, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Drejtorinë Doganore, Policinë Financiare, Drejtorinë për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe Drejtorinë për të Hyra Publike, do të miratohet Strategji dhe Plan aksional për krijimin e Modelit nacional për zbulim kriminalistik.

Në drejtim të implementimit të Strategjisë dhe Planit aksionar për koordinimin e aktiviteteve në luftë kundër krimit të organizuar, në vitin 2013 do të përpilohet studiojë për realizim për themelimin e Qendrës koordinuese nacionale për luftë kundër krimit të organizuar.

Do të përforcohen kapacitete e Qendrës për luftë kundër krimit të organizuar nëpërmjet:

- përforcimit kadrovik të njësive në kuadër të Qendrës për luftë kundër krimit të organizuar në pajtim me aktin për sistematizimin e vendeve të punës,
- pajimit materialo-teknik të Qendrës për luftë kundër krimit të organizuar;
- trajnimet e specializuar do të realizohen në pajtim me Planin vjetor për trajnime të MPB dhe me përkrahjen e ekspertëve të huaj, me theks të veçantë në trajnimet për zgjidhjet e reja ligjore dhe zhvillimin e procesit kriminalistik-zbulues.

Do të vazhdojë procesi i pajimit materialo-teknik i Seksionit për mbrojtjen e dëshmitarëve.

Komisioni Nacional për Luftë kundër Trafikimit me Njerëz dhe Migrimit ilegal do të bëjë evalvimin e plotësisë së Planit aksional për luftë kundër trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal 2009-2012.

Në kuadër të projektit "Qasje e integruar për parandalimin e eksploatimit të punës ndërmjet vendeve të origjinë dhe destinacionit" që është në drejtim të përforcimit të bashkëpunimit rajonal në luftën kundër trafikimit me njerëz do të realizohet "Studiojë për gjendjen e trafikimit me njerëz për eksploatim të punës".

Do të vazhdojnë aktivitetet e realizimit të Planit aksionar për implementimin e Ligjit për procedurë penale.

Do të vazhdojë realizimi i aktivitetëve nga Plani aksionar për implementimin e Strategjisë për armë të vogël dhe të lehtë.

PRIORITETET AFATMESME KORNIZA JURIDIKE

Në periudhë afatmesme parashihet përpunimi i Analizës për harmonizimin e legjislacionit nacional me Qëndrimin e përbashkët për eksport të armëve të Këshillit të UE 2008/944/CFSP dhe shqyrtimi i mundësisë për transponim në legjislacionin nacional.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Parashihet pjesëmarrje në dosjet e punës për analizë të Europoll, aktivitet i cili do të bëhet i mundshëm me nënshkrimin e Marrëveshjes për bashkëpunim operativ dhe strategjik ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Europoll.

Do të themelohet dhe do të vihet në funksion Baza e të dhënave nacionale kriminalistike për zbulim si dhe Qendra koordinuese nacionale për luftë kundër krimit të organizuar.

Do të implementohet Modeli nacional për zbulim kriminalistik në Prokurorinë Publike, Ministrisë e Punëve të Brendshme, Drejtorinë Doganore, Policinë Financiare, Drejtorinë për parandalimin e pastrimit të parave dhe Financimin e terrorizmit dhe Drejtorinë për të Hyra Publike.

Pajimi i mëtutjeshëm teknik i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Drejtorisë për policinë financiare, Prokurorinë publike dhe Drejtorinë për parandalimin e larjes së pastrimit të parave në sferën e luftës kundër krimit të organizuar.

Do të vazhdohet me trajnimin e mëtutjeshëm të të punësuarve në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Drejtorinë për policinë financiare, Prokurorinë publike dhe Drejtorinë për parandalimin e pastrimit të parave në sferën e luftës kundër krimit të organizuar.

3.24.7 LUFTA KUNDËR TERRORIZMIT GJENDJA RRJEDHËSE KORNIZA JURIDIKE

U miratuan ndryshime dhe plotësime të Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe kontributeve tjera nga veprat ndëshkuese dhe financimi i terrorizmit¹⁸. U miratua Ligji për masat restriktive ndërkombëtare¹⁹. Në mënyrë plotësuese, u ratifikuan ndryshimet dhe plotësimet e Konventës për mbrojtjen fizike të materialit nuklear²⁰.

KORNIZA INSTITUCIONALE

U miratua Strategjia nacionale për luftë kundër terrorizmit të Republikës së Maqedonisë për periudhën 2012-2015, e cila është në pajtim me Strategjinë e Bashkimit Evropian për luftë kundër terrorizmit. Gjithashtu, u miratua Strategjia nacionale për luftë kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit për periudhën 2012-2014. Agjencia për zbulim miratoi Plan strategjik të

¹⁸ Gazeta zyrtare e RM-së nr.. 35/2011

¹⁹ Gazeta zyrtare e RM-së nr..36/2011

²⁰ Gazeta zyrtare e RM-së nr.. 148/11

Agjencisë për periudhën 2012-2014. Agjencia nënshkroi Memorandum për bashkëpunim me institucionet e vendit²¹ për çështjet që janë me interes të përbashkët, të cilat përfshijnë segmente lidhur me luftën kundër terrorizmit.

U formua Trup koordinues për zbatimin e masave restriktive ndërkombëtare, i përbërë nga përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Ekonomisë, Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Financave.

Republika e Maqedonisë u bë anëtare e "Counterterrorissam initiative-(CTI)" të Këshillit të Bashkimit Evropian, me çka mundësohet shfrytëzimi dhe këmbimi i informatave për zbulim në drejtim të përforsimit të bashkëpunimit rajonal në luftë kundër terrorizmit.

Vazhdimisht realizohet bashkëpunim ndërkombëtar efikas me Europoll, Interpoll, SEKI Qendrën në Bukuresht, Euroxhast, dhe OSBE-në.

U përpunua Elaborati për përmirësimin dhe zhvillimin e kapaciteteve zbuluese të Agjencisë për Zbulim.

Drejtoria për Siguri dhe Kundërzbulim dhe Agjencia për zbulim në vazhdimësi realizojnë bashkëpunim ndërkombëtar intensiv me shërbimet e huaja për siguri dhe zbulim me qëllim të këmbimit të njohurive, të dhënave për zbulim dhe informatave për veprim preventiv dhe marrjen e masave dhe aktivitetëve në drejtim të zbulimit dhe parandalimit të aktivitetëve terroriste dhe zgjidhjes së problemeve të sigurisë me interes të realizimit të sigurisë në nivel nacional-rajonale dhe global.

Vazhdon bashkëpunimi me NATO-n, përkatësisht NOS (Zyra e Natos për siguri), ILU (Njësia për zbulim për lidhje) dhe TTIU (Njësia për zbulim për kërcënime terroriste) nëpërmjet këmbimit të rregullt të informatave zbuluese me interes të përbashkët, dhe me qëllim të kërcënimeve terroriste të orientuara në NATO, vendet anëtare të Aleancës, Republikës së Maqedonisë dhe vendeve tjera. UBK dhe AR vazhduan me anëtarësim aktiv dhe bashkëpunim në kuadër të Konferencës së shërbimeve zbuluese të Evropës Juglindore (SEEIC) dhe konferencës së Evropës së mesme (MEC).

Komiteti për luftë kundër terrorizmit i Këshillit për siguri të KB-së i formuar me Rezolutën 1373 (2001) më 13 tetor 2011 bëri evaluimin e sistemit për luftë kundër terrorizmit në vend.

Gjatë vitit 2011 për të punësuarit në UBK dhe AR u realizuan më shumë trajnime dhe seminare të cilat kanë të bëjnë me tema për luftë kundër terrorizmit dhe financimit të tij.

Rregullisht u dorëzuan raporte tremujore dhe vjetore të Agjencia ndërkombëtare për energjinë atomike për aplikimin e garancive në lidhje me marrëveshjet për mospërhapjen e armës nukleare.

Është emëruar person kontaktues për përcjelljen e realizimit të obligimeve nga Konventa e përbashkët e ratifikuar për siguri gjatë menaxhimit me karburantin e shfrytëzuar nuklear dhe siguri gjatë menaxhimit me hedhurinë radioaktive.

U realizua inspeksion nga Agjencia ndërkombëtare për energji atomike të lokacioneve të deklaruara në pajtim me Protokollin e reviduar për sasi të vogla të Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Agjencisë ndërkombëtare për energji atomike për zbatimin e masave të sigurisë në lidhje me Marrëveshjen për mospërhapjen e armës nukleare²² „.

U realizuan 2 kurse rajonale për trajnim (Gatishmëria dhe përgjigja mjekësore në ngjarje nukleare dhe radiologjike dhe "Konferenca rajonale për përforsimin dhe bashkëpunimin në parandalimin e tregtisë joligjore me material radioaktiv") me qëllim të përforsimit të bashkëpunimit rajonal në fushën e sigurimit rrezatues dhe 1 takim pune nacional ("Takim pune nacional për Dizajn të vlerësimit të kërcënimeve për siguri nukleare") me qëllim të ngritjes së nivelit të njohurisë të sigurisë nukleare.

PRIORITETE AFATSHKURTËRA KORNIZA JURIDIKE

Do të miratohen ndryshime dhe plotësime të Ligjit për Agjencinë për zbulim në drejtim të harmonizimit të tij me ligjet tjera të segmentit të sigurisë për zbulim dhe legjislacionin e BE-së. Pas miratimit të ligjit të përmendur, do të miratohen akte interne me të cilat do të elaborohet puna e agjencisë për zbulim.

Do të miratohet Rregullore për organizimin dhe punën e Drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim.

²¹ Drejtoria për të hyra publike, Drejtoria për parandalimin e larjes së parave dhe financimit të terrorizmit, Drejtoria Doganore dhe Policia Financiare

²² Gazeta zyrtare e RM-së nr.. 43/2007

KORNIZA INSTITUCIONALE

Do të përpilohet Plan aksional për luftë kundër terrorizmit për periudhën 2012-2015.

Vazhdimisht do të implementohen masa dhe aktivitete të cilat dalin nga Strategjia për luftë kundër terrorizmit.

Do të informohet trup koordinues për luftë kundër terrorizmit në drejtim të implementimit të Strategjisë për luftë kundër terrorizmit.

Do të vazhdohet procesi i përcjelljes së zbatimit të masave ndërkombëtare restriktive.

Do të intensifikohet bashkëpunimi ndërinstitucional i organeve të sigurisë në Republikën e Maqedonisë dhe institucioneve domeni i kompetencave të cilave përfshin edhe aspekte tjera kundër terrorizmit dhe për përmirësimin e koordinimit të ndërsjellë;

Do të vazhdohet me intensifikimi i bashkëpunimit të përhershëm për zbulim me shërbimet e huaja të partneritetit për zbulim, në nivel bilateral dhe multilateral, si dhe Konferenca e shërbimeve për zbulim të JIE (SEEIK) dhe Konferenca e Evropës së Mesme (MEK);

Do të implementohet sistemi për komunikim sekret në Agjencinë për zbulim dhe këmbim të informatave të klasifikuara në kuadër të Konferencës së Evropës së Mesme (MEK). Në mënyrë plotësuese do të përforcohen kapacitetet e Agjencisë për zbulim nëpërmjet furnizimit të pajisjes së re (harduer) dhe sistemeve përkatëse operative (softuer), si dhe trajnimeve të specializuara.

Do të vazhdohet edhe trajnimi i të punësuarve në Drejtorinë për siguri dhe kundërzbulim si dhe Agjencinë për zbulim për format më të reja të kërcënimeve terroriste në nivel lokal.

PRIORITETET AFATMESME

KORNIZA JURIDIKE

Është paraparë ratifikimi i Konventës së KB-së për mbrojtjen e personave nga zhdukja e detyruar..

KORNIZA INSTITUCIONALE

Do të përgatitet analizë e Direktivës së BE-së për vendosjen e komizës juridike të Bashkësisë për siguri nukleare të instalacioneve dhe shqyrtim i mundësive për transponimin e saj në legjislacionin maqedonas.

Do të implementohet Strategjia nacionale kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Në mënyrë të vazhdueshme do të avancohet dhe intensifikohet bashkëpunimi i shërbimeve për siguri dhe zbulim në korniza ndërkombëtare në nivel bilateral dhe multilateral.

Do të sigurohet pajim teknik dhe material i AR dhe UBK për veprimin e tyre më efikas në kuadër të kompetencave të tyre ligjore.

3.24.8 LUFTA KUNDËR DROGËS

GJENDJA RRJEDHËSE

KORNIZA JURIDIKE

Legjislacioni i përgjithshëm në sferën e drogave është harmonizuar me standardet ndërkombëtare.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Vazhdoi implementimi i Planit aksional (për periudhën prej 2008-2012) në kuadër të Strategjisë nacionale. Nga ana e Qendrës për përcjellje të drogave dhe varësi nga droga, Sektori për substanca të kontrolluara, Ministria e Shëndetësisë, u bë evaluim i aktiviteteve të realizuara për strategjinë për droga për pjesën Zvogëlim të kërkesës së drogave dhe e njëjta u shqyrtua dhe u miratua nga ana e Komisionit Ndërsektorial Shtetëror për Luftë kundër Drogës, dhe nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Mblidhen të dhëna të nevojshme për evalvimin e aktiviteteve të realizuara të strategjisë për pjesën Zvogëlim i kërkesës së drogave, që do të realizohet në tremujorin e katër të vitit 2012.

U miratuan plane aksionare për të gjithë 8 Sektorët për punë të brendshme dhe 5 Qendra rajonale kufitare, për 2011.

PRIORITETET AFATSHKURTRA

KORNIZA JURIDIKE

Ministria e Punëve të Brendshme, gjatë tremujorit të parë të vitit 2012 do të përpilohet plan aksionar për aktivitet në vitin 2012, për të gjithë 8 Sektorët për punë të brendshme dhe 4 Qendra

rajonale kufitare, në pajtim me qëllimet për zvogëlim të furnizimit me drogë nga Strategjia nacionale për drogë të Republikës së Maqedonisë. Planet aksionare do të miratohen nga Komisioni Ndërrresorial Shtetëror për Luftë kundër Drogës. Planet aksionare kanë për qëllim që ta përmirësojnë koordinimin në nivel lokal dhe rajonal, efikasitetin dhe efektivitetin në luftë kundër krimit lidhur me drogën.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Ministria e Shëndetësisë do të përpilojë Plan aksional për trajnime të specializuara për drogë, substanca psikotropike dhe prekursorë të dedikuara për përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Përveç Sektorëve për punë të brendshme dhe Qendrave rajonale kufitare, në trajnim do të përfshihen edhe njësitë speciale, posaçërisht njësia për detyra speciale të MPB-së. Trajnimi do t'i përfshijë edhe përfaqësuesit e Shërbimeve doganore. Trajnimin do ta realizojnë ekipe të Ministrisë së Shëndetësisë, MPB-së dhe Drejtorisë doganore (përfaqësues të Komisionit Shtetëror Ndërrresorial për Luftë Kundër Drogës) dhe ky trajnim ka për qëllim zgjerimin e njohurive, shkathësisë si dhe zmadhimin e efikasitetit në parandalimin e tregtisë ilegale me drogë. Ky plan aksionar përpilohet për shkak të nevojës për përforcimin e resurseve njerëzore të MPB-së dhe Drejtorisë doganore. Me këtë, përveç punësimeve plotësuese të nëpunëve në Seksionin për luftë kundër krimit të organizuar, për të cilët procedura është në rrjedhë, do të bëhet përforcimi i potencialeve për luftë kundër drogës dhe në kuptim kualitativ nëpërmjet trajnimeve, por edhe me përfshirjen e njësisë për detyra speciale të MPB-së në aktivitetet e përgjithshme.

PRIORITETET AFATMESME

KORNIZA INSTITUCIONALE

Aktivitetet afatmesme do të orientohen në përpunimin e strategjisë së re për drogë, për të cilën do të sigurohen mjete përkatëse financiare nga IPA fondet. Bartës i aktivitetit do të jetë Sektori për substanca të kontrolluara, Byroja për Barna Ministria e Shëndetësisë, ndërsa monitorimi do të bëhet nga Komisioni Shtetëror Ndërrresorial për Luftë Kundër Drogës.

3.24.9 BASHKËPUNIMI DOGANOR

GJENDJA RRJEDHËSE

Rregullat themelore me të cilat rregullohet bashkëpunimi doganor në dispozitat ndëshkimore janë: Ligji doganor (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 39/05, 4/08, 48/10, 158/10 и 44/11) dhe Rregullorja për zbatimin e Ligjit për dogana ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 66/2005 dhe ndryshimet dhe plotësimet të botuara në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 73/2006, 40/2007, 62/2007, 42/2009, 38/2010, 46/2010 и 61/2010).

Në lidhje me Konventën për bashkëpunim ndërkombëtar dhe ndihmën e shërbimeve doganore, bazë juridike për bashkëpunim ndërkombëtar ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe shteteve anëtare të BE-së, është Protokollin 5 të Marrëveshjes për stabilizim dhe asociim ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Komunitetit të Evropës dhe shteteve të saj anëtare.

PRIORITETET AFATSHKURTRA

KORNIZA INSTITUCIONALE

Do të punohet në përmirësimin e strukturës institucionale për zbatimin e Konventës për ndihmë të ndërsjellë dhe bashkëpunim ndërmjet shërbimeve doganore me aktet përkatëse (Neapoll 2), si dhe për zbatimin e Konventës për përdorimin e teknologjisë informative për qëllime doganore.

PRIORITETET AFATMESME

KORNIZA JURIDIKE

Do të zbatohet Konventa për përdorimin e teknologjisë informatike për qëllime doganore dhe do të vazhdohet me aktivitetet për zbatimin e Konventës për ndihmë dhe bashkëpunim të ndërsjellë ndërmjet shërbimeve doganore me akte përkatëse.

3.24.10 FALSIFIKIMI I EUROS

GJENDJA RRJEDHËSE

KORNIZA JURIDIKE

Është marrë Vendimi për vendosjen e Zyrës qendrore për hetime në sferën e ndalimit të falsifikimit të parave (në tekstin e mëtejshëm: Zyra) nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë. Rolin e Zyrës e zhvillon Seksioni për krim financiar në Qendrën për ndalimin e krimit të organizuar dhe serioz, Ministria e Punëve të Brendshme.

U miratua Vendim për përcaktimin e procedurës për zbulimin dhe tërheqjen e falsifikimit të parave²³ nga Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në muajin mars 2011.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Në mënyrë të vazhdueshme realizohen trajnime nga Zyra qendrore për hetime në sferën e ndalimit të falsifikimit të parave, në të cilat prezantohet Doracaku për metodologjinë për zbulimin dhe dokumentimin e falsifikimit të parave i cili është në pajtim me doracakët që shfrytëzohen në vendet e Bashkimit Evropian.

U përpilua Plan për trajnime nga sfera e falsifikimit të euros. Në muajin nëntor 2011 u realizuan 8 trajnime edukative të falsifikimit të euros, në të cilat do të përfshihen të punësuarit nga 8 Sektorët e punëve të brendshme të MBP-së, Drejtorisë Doganore, Policisë financiare dhe Bankës Popullore të RM-së.

Për realizimin e aktiviteteve në kompetencë të Zyrës, u emëruan persona kontaktues për shkëmbimin e informatave nga sfera e ndalimit të falsifikimit të parave me Zyrën.

U nënshkrua Memorandumi për bashkëpunim ndërmjet institucioneve të ngarkuar për luftë kundër falsifikimit të parave.

Vazhduan aktivitetet e Qendrës Analitike Nacionale në kuadër të Bankës Popullore si person juridik i vetëm i autorizuar për dhënien e mendimit profesional për autenticitetin e parave prej letre dhe hekuri të denominuar në denarë ose në valutë të huaj në Republikën e Maqedonisë.

PRIORITETET AFATSHKURTRA

KORNIZA JURIDIKE

Në vitin 2012 do të miratohet Rregullore për shfrytëzimin e bazës për para të falsifikuara dhe Procedurat për bashkëpunim dhe veprim të nënshkruesve të memorandumit për bashkëpunim nga sfera e falsifikimit të parave.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Në drejtim të përfundimit të kapaciteteve institucionale në këtë sferë do të krijohet bazë e të dhënave për falsifikimin e parave. Paralelisht, do të realizohen trajnime të të punësuarve për shfrytëzimin e bazës për falsifikim të parave.

Do të përfordohen kapacitetet kadrovike të Zyrës me dy përmbarues të rinj, ndërmjet të cilëve një analist dhe një dokumentues teknik.

PRIORITETET AFATMESME

KORNIZA JURIDIKE

Do të ndryshohet Rregullorja për mbajtjen e evidencave-regjistri lidhur me problematikën e falsifikimit të parave.

Do të vazhdojnë aktivitetet për harmonizimin e legjislacionit nacional me rregullativat e BE-së në sferën e falsifikimit të euros.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Përfordimi i vazhdueshëm i kapaciteteve materiale, teknike dhe kadrovike të Zyrës qendrore.

3.25 SHKENCA DHE HULUMTIMI

3.25.1 POLITIKA E HULUMTIMIT

GJENDJA RRJEDHËSE

Sigurimi i kornizës strategjike dhe legjislative për zhvillimin e politikës hulumtuese

Gjatë vitit 2011 u përfordua korniza legjislative me miratimin e Ligjit për ndryshimin e veprimtarisë shkencore-hulumtuese ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 24/11) dhe Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për procedurën dhe kriteret e përafërta për financimin dhe mbikëqyrjen e programeve vjetore për veprimtari shkencore-hulumtuese të

²³ Gazeta zyrtare e RM-së nr.42/11

subjekteve të veprimtarisë shkencore-hulumtuese ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 25/11).

U miratua Ligji për nxitje dhe ndihmë të zhvillimit teknologjik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 47/11). Qëllimi themelor i ligjit të ri është që zhvillimi teknologjik të ketë rëndësinë e aktivitetit prioritar për MASH-in dhe Qeverinë e RM-së. Formimi i Komisionit për zhvillim teknologjik, si trup ndërresorial, do të sigurojë që programimi i veprimtarisë të harmonizohet me politikat qeveritare në veprimtaritë tjera, me çka do të mundësohet përcaktim real i prioriteteve të zhvillimit teknologjik. Komiteti për zhvillim teknologjik e shqyrtoi Programin për zhvillim teknologjik, të cilin e miraton Qeveria. Ligji i ri ka parapa bashkëfinancimin e projekteve të vogla zhvillimore-hulumtuese dhe projekteve inovative për përmirësimin dhe zhvillimin e infrastrukturës teknologjike, si dhe projekteve të inovative në shumë deri në 50.000 euro në kundërvlerë me denarë dhe projekteve të mëdha në lartësi mbi këtë shumë. Ky ligj parash zvogëlimin e pjesëmarrjes së shtetit në bashkëfinancimin e projekteve, përkatësisht programeve me qëllim të zmadhimit të pjesëmarrjes së sektorit të biznesit në hulumtimet.

Në muajin nëntor 2011 u formua Komision për Zhvillim Teknologjik i cili është trup profesional për Komitetin për Zhvillim Teknologjik. Komisionin e formon Ministri i Arsimit dhe Shkencës, dhe ky trup bën analizimin e trendëve dhe standardeve evropiane dhe botërore në zhvillimin teknologjik dhe propozon masa për zbatimin e tyre në Republikën e Maqedonisë; jep mendime dhe propozime për zhvillimin teknologjik; jep mendime, propozime dhe orientime për bashkëpunimin ndërkombëtar; bën evalvimin e propozim-projekteve të vlerësuara nga ana e ekspertëve dhe bën zgjedhjen e projekteve të vogla të cilat do të kofinancohen nga ana e Ministrisë, bën evalvimin e propozim-projekteve të vlerësuara nga ana e ekspertëve dhe i propozon dhe i rekomandon Komitetit për Zhvillim Teknologjik për zgjedhje të projekteve të mëdha të cilat do të kofinancohen nga ana e Ministrisë dhe kryen edhe punë tjera të cilat do t'i caktojë Komiteti për Zhvillim Teknologjik.

Gjatë muajit gusht 2011 u formua Komiteti Nacional për Veprimtari Shkencore-Hulumtuese, si trup ekspert dhe këshillëdhënës i Qeverisë së RM-së për politikat e shkencës dhe zhvillimin e veprimtarisë së përgjithshme shkencore.

U përpilua Draft-programi nacional për veprimtari shkencore-hulumtuese për vitin 2012-2016. Në programin përcaktohen bazat e nisjes, qëllimet, përmbajtja dhe vëllimi i detyrave në sferën e shkencës, mënyra e koordinimit dhe zbatimit, infrastruktura e nevojshme hulumtuese, mënyra e financimit të veprimtarisë shkencore-hulumtuese, resurset njerëzore, indikatorët e realizimit të veprimtarisë shkencore-hulumtuese, dimensionin ndërkombëtar dhe lidhshmëria me ekonominë.

U realizuan aktivitetet e rregullta për zhvillimin e veprimtarisë shkencore hulumtuese. Projektet/programet e bartësve të autorizimeve publike në kulturën teknike për vitin 2011, u evaluan programe/projekte të 24 bartësve të autorizimeve publike, u përpiluan dhe u nënshkruan marrëveshje për kofinancimin e projekteve/programet.

U sigurua qasje deri në 50 gazeta shkencore elektronike me faktor ndikimi.

U realizua konkurs për ndarjen e 20 bursave "Boris Trajkovski" për studentët për ciklin e dytë të studimeve për MBA programin e realizuar të Universitetit Shefilld në Greqi, për vitin 2011/2012 dhe u bë zgjedhja e 20 kandidatëve.

U ndanë bursa për gjashtë kandidatë (tre kandidatë të regjistruar në 20 universitetet e para të ranguara në Evropë dhe tre kandidatë të regjistruar në Akademinë e artit filmik dhe të TV-së - FAMU, në Pragë, Republika e Çekisë.

Projekti për "Furnizimin e pajisjes mësimore-shkencore për institucionet publike shkencore dhe universitetet shtetërore", u realizua suksesshëm vitin e kaluar, si rezultat i gjithë asaj që u dorëzua deri më tani është pajisja për gjithsej 42 laboratorë për shfrytëzuesit e fundit.

U promovua Projekti "Përkthimi i 1000 librave shkencore dhe shkollorë me të cilët zhvillohet procesi mësimor në universitetet më të larta, më të mira dhe më të njohura në SHBA dhe Angli, ndërsa nga sfera drejtësisë në Francë dhe Gjermani". Në periudhën e kaluar, nga fillimi i vitit 2011 deri më tani, u realizuan shtatë promovime, ku gjithsej u promovuan 101 tituj, me çka deri më tani numri i librave të përkthyer në kuadër të projektit është 527.

PRIORITETET AFATSHKURTRA

Miratimi i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veprimtari shkencore-hulumtuese. Me miratimin e ndryshimeve të ligjit për veprimtari shkencore-hulumtuese do të krijohet bazë juridike për miratimin e rregullave nënligjore me të cilat do të rregullohen kritere më të veçanta për zgjedhje dhe evalvim të Qendrave të ekselencës për kërkime shkencore. Arritja e statusit qendër

ekselence për kërkime shkencore, institucionit ose grupit hulumtues i siguron bazë të rëndësishme për hulumtime, bashkëveprim dhe bashkëpunim me qendrat kryesore evropiane dhe botërore për hulumtime, përmirësimin e pjesëmarrjes së hulumtuesve maqedonas në projektet e Bashkimit Evropian dhe përfundimin kapaciteteve të partnerëve hulumtues të cilët e përkrahin industrinë. Gjithashtu, do të rregullohen mundësitë për lidhjen e marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale për partneritet me qendra ekselence tashmë të etabluara jashtë vendit për hulumtime të përbashkëta shkencore në fushat shkencore me interes nacional, shfrytëzimin e mjeteve të partnerëve ndërkombëtarë, veçanërisht në sferën e ekonomisë, shëndetësisë, bujqësisë, mjedisit jetësor, ndërtimtarisë, me çka do të sigurohet financimi stabil i qendrave të ekselencës për kërkime shkencore dhe efikasiteti i hulumtimeve shkencore.

Miratimi i Programit nacional për veprimtari shkencore-hulumtuese për vitin 2012-2016. Miratimi i Programit nacional për veprimtari shkencore-hulumtuese nënkupton përcaktimin dhe aktivizimin e të gjitha mekanizmave me qëllim të krijimit të impulseve të reja në veprimtarinë shkencore-hulumtuese; përcaktimin e prioriteteve në veprimtarinë shkencore-hulumtuese në nivel nacional në funksion të nevojave të ekonomisë dhe shoqërisë, si dhe integrimin e Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian; krijimin e klimës për konkurrencë më të madhe në veprimtarinë shkencore-hulumtuese, në plan vendas dhe ndërkombëtar; krijimin e kornizës për bashkëpunim partnerësh ndërmjet institucioneve për hulumtime shkencore dhe sektorit privat, etj.

Miratimi i Programit për zhvillim teknologjik në të cilin do të përcaktohen drejtimet e zhvillimit të politikave dhe aktiviteteve në zhvillimin teknologjik dhe sferat prioritare të hulumtimeve zhvillimore në funksion të zhvillimit teknologjik.

Formimi i Këshillit të etikës. Kompetenca themelore e Këshillit do të jetë përcjellja dhe vlerësimi i zbatimit të parimeve dhe vlerave etike në veprimtarinë shkencore-hulumtuese, mbrojtja e integritetit njerëzor në hulumtimet shkencore dhe etika në marrëdhëniet afariste ndërmjet subjekteve për ushtrimin e veprimtarisë shkencore-hulumtuese. Në pajtim me Ligjin për veprimtari shkencore-hulumtuese, Akademia maqedonase e shkencave dhe arteve dhe Konferenca ndëruniversitare, te kabineti i ministrit, dorëzoi propozim-listë të kandidatëve potencial për anëtarë të Këshillit. Nga kandidatët e propozuara Qeveria emëron anëtarë të Këshillit.

Përcaktimi i kriteve për shpalljen e Qendrave të ekselencës. Arritja e statusit qendër ekselence për kërkime shkencore, institucionit ose grupit hulumtues, i siguron stimul për hulumtimet e orientuara, bashkëveprim dhe bashkëpunim me qendrat kryesore evropiane dhe botërore për hulumtime, e stimulon bashkëpunimin ndërkombëtar, inicon hulumtime të përbashkëta të orientuara në problemet specifike dhe në përmirësimin e pjesëmarrjes së hulumtuesve maqedonas në projektet e Bashkimit Evropian. Proklamimi i qendrave të ekselencës për kërkime shkencore do ta nxisë edhe garën ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë dhe shkencore, dhe me këtë do të zmadhohet edhe përfundimi cilësia e punës shkencore-hulumtuese në Republikën e Maqedonisë. Qendrat ekselence për kërkime shkencore përveç që janë të rëndësishme për zhvillimin e shkencës në Republikën e Maqedonisë edhe zhvillimin e dimensionit të saj, ato kanë rëndësi esenciale edhe për zhvillimin ekonomik dhe tërheqjen e investimeve. Me qëllim të sigurimit të zhvillimit të veprimtarisë shkencore-hulumtuese të qendrave ekselence për kërkime shkencore nevojitet siguri i mjeteve stabile financiare. Qendra ekselence për kërkime shkencore duhet të jetë në gjendje që një pjesë të atyre mjeteve t'i sigurojë si rezultat i aktiviteteve të parapara dhe si të tilla ato të përfshihen në kriteret për zgjedhje dhe evalvim të qendrave ekselence për kërkime shkencore.

Formimi i Komitetit për Zhvillim Teknologjik. Komitetin për Zhvillim Teknologjik e formon Qeveria e RM-së. Përbëhet nga kryetari dhe gjashtë anëtarë: zëvendëskryetari i Qeverisë i ngarkuar për çështje ekonomike, ministri i Financave, ministri i Ekonomisë, ministri i Arsimit dhe Shkencës, ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës, ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave dhe ministri i Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.

Vazhdimi me realizimin e Projektit për "Furnizimin e pajisjes mësimore-shkencore dhe hulumtuese për institucionet shkencore publike dhe universitetet shtetërore".

Vazhdimi me realizimin e projektit "Përkthimi i 1000 librave shkencore dhe shkollore me të cilët zhvillohet procesi mësimor në universitetet më të larta, më të mira dhe më të njohura në SHBA dhe Angli, ndërsa nga sfera drejtësisë në Francë dhe Gjermani".

Vazhdimi me aktivitetet për përkrahje financiare të kuadrit të rinj shkencore-hulumtuese

Vazhdimi me aktivitete për financimin e programeve shkencore-hulumtuese përkatësisht projektet e institucioneve publike për hulumtime shkencore.

Vazhdimi me realizimin e Projektit për "Furnizimin e pajisjes mësimore-shkencore dhe hulumtuese për institucionet shkencore publike dhe universitetet shtetërore".

Vazhdimi me realizimin e projektit "Përkthimi i 1000 librave shkencorë dhe shkollorë me të cilat zhvillohet procesi mësimor në universitetet më të larta, më të mira dhe më të njohura në SHBA dhe Angli, ndërsa nga sfera drejtësisë në Francë dhe Gjermani".

Vazhdimi me aktivitetet për përkrahje financiare të kuadrit të ri shkencor-hulumtues

Vazhdimi me aktivitete për financimin e programeve shkencore-hulumtuese përkatësisht projektet e institucioneve publike për hulumtime shkencore.

3.25.2 PROGRAMET KORNIZË

GJENDJA RRJEDHËSE

Në kuadër të Programit të shtatë kornizë, në periudhën e kaluar u realizuan aktivitete të shumta.

Gjatë muajit prill 2011 u mbajt prezantimi i FP7 Programi me temë "Hulumtimi në shkencat shoqërore-ekonomike dhe humanitare në kontekst të FP7" Konferenca" Gjendja e hulumtimeve në shkencat shoqërore në RM dhe promovimi i programit FP7 dhe prioriteti i shkencave shoqërore të Fakultetit për turizëm dhe transport në Ohër.

Përfaqësuesit maqedonas morën pjesë në mbledhjen e punës në organizim të Shoqatës slovene për biznes dhe hulumtime, Qendrës Evropiane për Paqe dhe Dhomës Ekonomike të Maqedonisë. Prezantimi i realizuar ishte observim edhe për komentimet e përvojave të deritanishme.

Në 2 maj 2011 u realizua dita informative në të cilën do të mundësohet promovimi i mundësive të aksioneve Mari Kiri në kuadër të Programit të shtatë kornizë.

Gjatë muajit maj, në Ohër u mbajt mbledhja e përfaqësuesve të vendeve për zgjerim të BE-së, në të cilën u diskutua për përgatitjen e dokumentit për të shprehurit e qëndrimit të përbashkët për pjesëmarrjen e mëtutjeshme në programin e 8-të Kornizë. Në periudhën prej 7 qershor deri 9 qershor të vitit 2011 u realizua pjesëmarrja në Javën e rajoneve inovative në Evropë dhe në mbledhjen e punës Vlerësimi i sfidave të reja për potencialin hulumtues, në të cilën morën pjesë koordinatorët, anëtarët e Komiteteve programore dhe Personat nacional kontaktues të FP 7 nënprogramet Rajone dhe Potenciale hulumtuese, në Hungari. Temat kryesore në Konferencën ishin bashkëveprimi i politikave rajonale, nacionale dhe evropiane në lidhje me infrastrukturën hulumtuese; stimulimi i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror: zhvillimi i infrastrukturës për hulumtim dhe klasterët; tregjet e diturisë dhe konkurrencë, dimensionin rajonal i Unionit inovativ.

Mbledhja e punës për Vlerësimin dhe sfidave të reja për potencialin hulumtues ishte me rëndësi të veçantë për të gjithë vendet e rajonit tonë si dhe vendet më reja anëtare (Polonia, Bellorusia etj), por gjithashtu edhe për disa nga Vendet anëtare të BE-së si Spanja, Italia, Greqia, rajonet e të cilëve janë më dobët të zhvilluara, meqë u mundësoi pjesëmarrësve të prononcohen për konceptin e kornizës së re për hulumtim dhe zhvillim 2014-2020 me të cilën parashihet përjashtim të përkrahjes projektuese nga ky program për përforcimin e potencialit hulumtues dhe transferimin e saj në IPA fondet dhe fondet strukturore, që e pavalitshme dhe e papërshtatshme për të gjitha këto vende, meqë në këtë mënyrë do të zvogëlohen mundësitë për vendosjen e bashkëpunimit dhe për formimin e rrjeteve dhe konzorciumeve me Qendrat Evropiane për Hulumtim, pjesëmarrjen në projektet hulumtuese shkencore, që është edhe nevojë themelore dhe interes për pjesëmarrje në këtë Program. U morr qëndrim i fortë rreth kësaj çështjeje me rekomandim që për këtë çështje të diskutohet në instancat më të larta dhe të merret parasysh gjatë koncipimit të Programit të ri Kornizë.

Gjatë muajit shtator u realizua "Prezantimi i thirrjeve të hapura për vitin 2012" për të gjitha sferat tematike: transporti, mjedisi jetësor, shkencat shoqërore dhe humanistike, shëndetësia, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, teknologjia informatike dhe komunikuese, ushqimi, bujqësia dhe bioteknologjia, mobiliteti, energjia, reg-pot (kapacitetet hulumtuese), nano shkencat, nano teknologjitë, teknologjitë materiale dhe teknologjitë e reja prodhuese.

Maqedonia mori pjesë në Konferencën rajonale ministrore që u mbajt në Bruksel, në të cilën ishte i pranishëm edhe ministri i Arsimit dhe Shkencës. U diskutua për përpjekjet të cilat shtetet e rajonit i bëjnë për avancimin e hulumtimeve dhe inovacioneve dhe pozicionimin e tyre në nivel më të lartë të agjendës politike të vendit; sukseset dhe nevojën e pjesëmarrjes së mëtutjeshme të

vendeve të rajonit në FP7; përforcimin e bashkëpunimit me Qendrat e përbashkëta për hulumtim të KE si sugjerime për masat dhe aktivitetet për pjesëmarrje të suksesshme të vendeve të rajonit në Programin e ardhshëm kornizë "Horizont 2020".

Gjatë muajit shtator 2011 u mbajt promovimi i aktiviteteve të Manifestimit panevropian "Nata e hulumtuesve 2011", Forum "Gratë në shkencën", ligjërimi për jetën dhe veprimtarinë e Marija Kirit në kuadër të projektit "Dukshmëria hulumtuese 2011 - Meqedonia", si dhe Info ditë "Prezantimi i thirrjeve të hapura për vitin 2012" dedikuar për komunitetin e biznesit. Njëkohësisht, u realizuan edhe takime individuale të Personave institucional kontaktues me përfaqësues të kompanive dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme me qëllim të përkrahjes gjatë përgatitjes së propozim-projektit.

Promovimi vazhdoi edhe gjatë muajit nëntor 2011, në kuadër të rrjetit të Personave nacionale kontaktues për FP7 prioriteti Shëndetësia, në Bukuresht, Rumani u mbajt mbledhje e rregullt e rrjetit dhe mbledhjes së punës për Pronësi intelektuale. Në muajin dhjetor 2011, në Dhomën ekonomike të RM-së u mbajt ngjarje të emëruar me temë "Nga firmat për Firmat - përvoja e FP7 projekteve" ku prezantimet kryesore dhanë firma dhe NVM të cilat morën pjesë në FP7 projektet dhe të cilat e ndanë përvojën dhe njohurinë e tyre për pjesëmarrjen.

PRIORITETE AFATSHKURTRA

Promovimi i mundësive të cilat i ofron Programi i 7-të kornizë. Mbjatja e trendit pozitiv të aplikimeve për pjesëmarrje në PK të 7-të, nëpërmjet mbajtjet së info ditëve, trajnimeve për të gjithë palët e interesuar dhe informimit për thirrjet e hapura.

Realizimi i aktiviteteve me qëllim të intensifikimit të mobilitetit të hulumtuesve maqedonas dhe lidhshmërisë me sektorin e biznesit - aktivitetet e Mari Kirit.

Realizimi i aktiviteteve me qëllim të arritjes së përfshirjes më të madhe të Ndërmarrjeve të vogla dhe mesme në FP7.

PRIORITETET AFATMESME

Diseminimi i vazhdueshëm i informatave për Programin e 7-të kornizë me qëllim të sigurimit të informimit dhe transparencës më të madhe për mundësitë që i ofron Programi me theks të veçantë të thirrjeve aktuale.

Organizimi i seminareve, info ditëve, trajnimeve dhe prezantimeve me të cilat do të përfshihen universitetet shtetërore dhe private, institucionet publike dhe private, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, hulumtues të mëvetësishëm dhe vetadministrimi lokal.

Gatishmëria e sektorit hulumtues dhe të biznesit për Programin vijues kornizë.

3.25.3. HAPËSIRA HULUMTUESE EVROPIANE

GJENDJA RRJEDHËSE

WBC - INCO-NET u SEE ERA NET plus projekte

Vazhdohet me realizimin e WBC - INCO - NET projektit, të financuar në kuadër të FP7, i cili ka për qëllim përkrahjen e dialogut bilateral dhe rajonal në bashkëpunim shkencor-teknik, identifikimin e prioriteteve dhe potencialeve të vendeve nga Ballkani perëndimor dhe përforcimi i përforcimi i pjesëmarrjes së hulumtimeve të Ballkanit Perëndimor në projektet evropiane me interes të përbashkët. Ministria e Arsimit dhe Shkencës në periudhën prej 24 deri 27 maj 2011 organizoi mbledhje të rëndësishme në kuadër të projekteve WBC INCO NET dhe SEE ERA NET PLUS të cilat u mbajtën në Ohër. U mbajtën mbledhje të Këshillit Drejtues të projektit WBC INCO NET dhe SEE ERA NET PLUS, me qëllim të zgjerimit dhe thellimit të bashkëpunimit në sferën e shkencës me vendet nga rajoni dhe vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Njëkohësisht u mbajt Forum për risi të fokusuar në mekanizmat e ardhshme për financim. Ngjarja më e rëndësishme, Platforma ekzekutive u mbajt më 26 maj 2011. Platforma ekzekutive është organ i lartë për krijimin dhe koordinimin e politikave në sferën e hulumtimit dhe zhvillimit për vendet e Ballkanit Perëndimor. Qëllim i mbledhjes ishte përgatitja e vendeve të Rajonit për pjesëmarrje më të madhe dhe më të suksesshme në Programin e 7-të kornizë dhe përgatitja për Programin e ardhshëm të 8-të kornizë. U realizuan ngjarje të rëndësishme plotësuese gjatë tetorit. U financua pjesëmarrja e 4 ekspertëve nga RM-ja të cilët prezantuan propozim-ide për aplikimin e thirrjes nga sfera e transportit, në seminar nga sfera e transportit si dhe në kuadër të Konferencës botërore për sferën e njëjtë të cilët u mbajtën në Selanik, Greqi. Pala maqedonase me qëllim të përforcimit të kapacitetit mori pjesë në mbledhjen e punës të organizuar nga projekti WBC-inco-net me temë Çështjet financiare dhe legale dhe Revizioni i BE projekteve. Nga 23 deri në 25 nëntor 2011, në Beograd u mbajt ngjarje oficiale

për fillimin e projektit Strategjia rajonale për hulumtim dhe zhvillim të inovacioneve për Ballkanin Perëndimor të financuar nga BE-ja dhe Banka botërore. Qëllimi kryesor i ngjarjes ishte definimi i strukturës udhëheqëse për implementimin e projektit, metodologjinë, aktivitetet që do të implementohen në 2 vitet e ardhshme. Nga 28 nëntori deri 1 dhjetor 2011, në Sarajevë u mbajtën mbledhje të Këshillit drejtues të projektit WBC INCO NET dhe Platforma ekzekutive në prani të përfaqësuesve të lartë të Komisionit Evropian përfaqësues nga 20 vende të Bashkimit Evropian, dhe partnerët në projektin nga rajoni i Ballkanit Perëndimor. Qëllim i mbledhjes ishte përgatitja e vendeve të Rajonit për pjesëmarrje më të madhe dhe me të suksesshme në Programin kornizë të 7-të dhe përgatitja për Programin e ardhshëm kornizë Horizont 2020.

Bashkëpunimi me Qendrat e përbashkëta hulumtuese KE

10 hulumtues nga Republika e Maqedonisë e vizituan Institutin në Ispra, si rezultat i aktiviteteve të intensifikuara për bashkëpunim me Qendrën e përbashkët hulumtuese (QPH) të Komisionit Evropian, ndërsa me ftesë të institutit në Ispra. QPH-ja hapi 40 pozicione për hulumtues korrespondent të destinuar për vendet e Ballkanit Perëndimor. U realizua promovimi i Programi FP7 dhe QPH-ja në mediumet elektronike. U ngrit iniciativë për mbajtjen e mbledhjes së përbashkët të Vendeve të Rajonit dhe QPH me qëllim përforsim i pozicioneve në bashkëpunimin e mëtutjeshëm në planifikimin e aktiviteteve të ardhshme të QPH-së për zgjerim dhe integrim. Personi nacional kontaktues i RM-së mori pjesë aktive në përgatitjet e iniciativës me propozime konstruktive të cilat në mbledhjen në Bruksel u pranuan nga përfaqësues të rajonit edhe nga përfaqësues të rajonit edhe nga QPH-ja. Gjatë muajit nëntor 2011, përfaqësuesi i Bordit të Guvernatorëve të RM-së mori pjesë aktive në mbledhjen e punës të rrjetit të Personave nacionalë kontaktues ku u konstatua se do të përshpejtohet procedura për pranimin dhe nënshkrimin e Memorandumit për mirëkuptim ndërmjet RM-së dhe QPH.

Pjesëmarrje në trupat e sferës hulumtuese evropiane

Gjatë muajit maj, u vendos komunikim i rregullt me shërbimet e Komitetit të hapësirës hulumtuese evropiane dhe u dorëzuan përgjigje në Pyetësor të detajuar për investimin në hulumtimin dhe zhvillimin për vitin 2011.

Pjesëmarrje në programin EUREKA

Në kuadër të programit EUREKA, u nënshkrua marrëveshje për kofinancimin e projektit ndërmjet Fakultetit të përzier në Universitetin "Shën Cirili dhe Metodi" Shkup, ndërmarrjes "Rade Konçar" - Shkup dhe kompanisë "ArcelorMittal" - Shkup, nga pala maqedonase dhe Universitetit të Lubjanës së bashku me kompaninë "Gorenje Orodjarna" nga Velenje dhe ndërmarrjes LIV HIDRAULIKA IN KOLESA nga Postojna, nga pala slovene. Në kuadër të programit të njëjtë, u nënshkrua edhe marrëveshje për kofinancimin e projektit në kuadër të programit EUREKA ndërmjet ndërmarrjes "ELMED" - Shkup dhe Fakultetit për komunikime elektroteknike dhe informuese - Shkup, nga pala maqedonase dhe ndërmarrjes "Iskra Medikall" - Lubjana dhe Institutit për hulumtim dhe zhvillim "IskraTehno"-Podnart, nga pala slovene.

EURAKSES

Në muajin mars, në Akademinë Maqedonisë të Shkencave dhe Arteve u promovua projekti EURAKSES për mobilitetin të hulumtuesve. Faza e parë e realizimit të këtij projekti, që nënkupton internet portal të përpunuar dhe aktiv është në fazë përfundimtare.

Agjencia ndërkombëtare për energji atomike (MAAE)

Në periudhën prej 19 deri 23 shtator 2011, në selinë e OKB-së në Vjenë u mbajt mbledhja e 55-të me radhë e Konferencës së përgjithshme (KP) të Agjencisë ndërkombëtare për energji atomike (MAAE). Në konferencë mori pjesë delegacioni i Republikës së Maqedonisë i kryesuar nga ministri i Arsimit dhe Shkencës. Republika e Maqedonisë tashmë u qas në instrumentet më të rëndësishme juridike ndërkombëtare për siguri nukleare dhe në tërësi është përkushtuar në përforsimin e mëtejshëm të mekanizmave të sigurisë dhe në përforsimin e bashkëpunimit ndërkombëtar. Vëmendje të veçantë i përkushtohet edhe luftës kundër tregtisë ilegale me

materiale radioaktive dhe nukleare me kontrollin e rregullt të përforcuar në pikat kufitare. Për ciklin e ri të projektit 2012-2013 Republika e Maqedonisë propozoi 6 projekte, prej të cilave pas evaluimit të realizuar teknik nga ana e Agjencisë, u lejua implementimi i tre projekteve. Cikli i kaluar shënon shkallë implementimi prej 95% dhe si rezultat i gatishmërisë profesionale të ekipeve projektuese shënon edhe menaxhim të suksesshëm të bashkëpunimit nga ana e koordinatorit nacional nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe bashkëpunimit me Misionin ekzistues në Vjenë.

Bashkëpunimi bilateral

Në muajin shtator filloi zgjedhja e recensentëve (ekspertëve) të cilët do t'i recensojnë propozim-fletëparaqitjet e dorëzuara për të dy konkurset: Konkursi për kofinancimin e projekteve bilaterale ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Sllovenisë për periudhën 2012-2013 dhe Konkursi për kofinancimin e projekteve bilaterale ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Kroacisë për periudhën 2012-2013.

Në pajtim me Marrëveshjen për bashkëpunim në sferën e arsimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Malit të Zi filluan negociatat dhe u paraqitën draft-versionet për nënshkrimin e Programit për bashkëpunim në sferën e arsimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Malit të Zi.

Bashkëpunimi bilateral me Republikën e Serbisë në sferën e shkencës dhe teknologjisë deri më tani është realizuar në bazë të Marrëveshjes për bashkëpunim shkencor-teknik ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Republikës Federative të Jugosllavisë, i nënshkruar në vitin 1997, por shkak të intensifikimit të bashkëpunimit, lindi nevoja për lidhjen e Marrëveshjes së re. Nga pala maqedonase u dorëzua Propozim-Marrëveshje për bashkëpunim në sferën e shkencës dhe teknologjisë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Republikës së Serbisë. Marrëveshja u pranua nga pala serbe dhe u harmonizuan tekstet ndërmjet të dy ministrive. Për shkak të organizimit dhe punës së organeve të administratës shtetërore të Republikës së Serbisë, më saktësisht, për shkak të formimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, procedura nuk ishte aktive. Tani aktivitet përsëri janë në rrjedhë.

U përpilua draft-Marrëveshje për bashkëpunim në sferën e arsimit dhe shkencës ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës. Pas harmonizimeve të caktuara teknike u dorëzua te pala kosovare.

PRIORITETET AFATSHKURTRA

Nënshkrimi i Memorandumit për mirëkuptim për bashkëpunim me Qendrat e përbashkëta hulumtuese.

Prezantimi i projekteve WBC INCO-NET, SEE ERA NET plus para opinionit shkencor hulumtues, me qëllim të transparencës dhe shpërndarjes më të madh të informatave dhe rezultateve të cilat dalin nga puna e organeve të tyre dhe nga realizimi i projekteve.

Implementimi i WBC INCO-NET и SEE ERA NET plus me qëllim të pjesëmarrjes së zmadhuar të opinionit shkencor nga Republika e Maqedonisë në ERA, nëpërmjet realizimit të trajnimeve dhe prezantimeve përkatëse.

Vazhdimi me realizimin e aktiviteteve në kuadër të programeve EYPEKA, KOCT и MAAE

Nënshkrimi i Programit për bashkëpunim në sferën e arsimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Malit të Zi,.

Nënshkrimi i Marrëveshjes për bashkëpunim me Republikën e Serbisë në sferën e shkencës dhe teknologjisë.

Nënshkrimi i Marrëveshjes për bashkëpunim në sferën e arsimit dhe shkencës me Kosovën (pritet informacion kthyes nga pala kosovare që të mund të zbatohet procedura përkatëse e cila do të shpjerë në nënshkrimin e Marrëveshjes për bashkëpunim në sferën e arsimit dhe shkencës ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës).

PRIORITETET AFATMESME

Përgatitja e Horizontit 2020

Implementimi i aktiviteteve të parapara me Memorandumin për mirëkuptim me Qendrat e përbashkëta hulumtuese.

Implementimi i Strategjisë rajonale për hulumtim dhe zhvillim të inovacioneve për vendet e Ballkanit Perëndimor u realizua në kuadër të projektit WBC-INCO-NET. Ministria e Arsimit dhe Shkencës do të marrë pjesë aktive dhe do të japë kontribut të plotë për realizimin e suksesshëm të saj.

Vazhdimi me realizimin e aktiviteteve në kuadër të programeve EYPEKA, KOCT и MAAE

3.26 ARSIMI DHE KULTURA

3.26.1 ARSIMI, TRAJNIMI DHE TË RINJTË

Edukimi parashkollor dhe arsimit

Byroja për Zhvillim dhe Arsim (BZHA) përpiloi mjete ndihmëse didaktike dhe metodike për arsimin parashkollor. Inspektorati Shtetëror i Arsimit kryen kontroll në institucionet publike parashkollore në pjesën e procesit edukativo-arsimor.

Në rrjedha është pilot-projekti "Socializimi i hershëm", me të cilin do të sigurohen informata të nevojshme për krijimin e politikave për socializimin e hershëm dhe numri i zmadhuar i fëmijëve në institucionet edukativo-arsimore parashkollore në vitin para ardhjes së tyre në shkollë. Në ato korniza, në vijim është hulumtimi "Ndikimet pozitive të punës edukativo-arsimore në kopshtet e fëmijëve mbi suksesin e nxënësve me zotërimin e programeve mësimore në klasë të parë".

Prioritetet afatshkurtra:

- Realizimi i hulumtimit "Ndikime pozitive të punës edukativo-arsimore në kopshtet e fëmijëve mbi suksesin e nxënësve në zotërimin e programeve mësimore në klasën e parë"
- Aktivitetet e Inspektoratit shtetëror të arsimit për kontroll të institucioneve publike parashkollore në pjesën e procesit edukativo-arsimor
- Implementimi i mëtutjeshëm i Programit "Integrimi i edukimit ekologjik në sistemin arsimor maqedonas" në institucionet parashkollore.

Reformat dhe përforcimet institucionale në arsimin fillor dhe të mesëm.

Legjislativi/koncepcione/programe mësimore

U miratua Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për arsim të mesëm dhe Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 18/11) me të cilat komunat dhe Qyteti i Shkupit mund të themelojnë shkollë publike ndërkombëtare për mësimin e gjuhëve të huaja (anglisht, frëngjisht, gjermanisht), u përforcua roli edukativ i shkollës, u parapa këshillimi i prindërve dhe organizimi i detyrueshëm i mësimin plotësues dhe shtesë në shkollë. Në drejtim të përforcimit të kompetencave të mësuesve, me ndryshimet dhe plotësimet parashihet përgatitja pedagogjike-psikologjike dhe metodike dhe futja e testit të personalitetit për mësuesit e ardhshëm. Për përmirësimin e administrimit, transparencës dhe informimit, u fut e-ditar.

Me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për arsim të mesëm ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 51/11), përcaktohen procedurat për verifikimin e shkollave të mesme.

Me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 51/11), u parapa afat prej 60 ditësh për miratimin e aktvendimit për pranimin e dëftesave të pranuar në vend të huaj.

Në rrjedha është formimi i qendrave për karrierë në shkollat e mesme dhe në fakultetet pranë universiteteve shtetërore.

BZHA realizoi hulumtim për identifikim të nxënësve të talentuar nga shkollat themelore dhe hulumtim për nevojat për futjen e përmbytjes nga sfera inovacioneve dhe sipërmarrësve në planet mësimore për arsimin fillor dhe të mesëm.

U miratua vendimi për futjen e përfaqësisë si lëndë në arsimin e mesëm. Në kuadër të projektit rajonal për arsim për sipërmarrësi SEECCEL, u formua rrjeti i shkollave fillore për pilotimin e arsimit për sipërmarrësi, në të cilin janë përfshirë 4 shkolla fillore nga RM-ja.

BZHA realizoi rreth 70 lloje të ndryshme të trajnimeve me mbi 30.000 pjesëmarrës, prej të cilëve më të rëndësishëm janë: trajnime për rreth 5.500 mësues nga shkollat fillore dhe 800

mësues nga shkollat e mesme për programet e reja mësimore, trajnime për zhvillimin e përmbajtjeve digjitale për lëndët në arsimin fillor, trajnime për kriteret për përpunimin e librave shkollorë dhe metodologji për vlerësimin e tyre, si dhe trajnime për planifikimin e mësimit, përcjelljen e suksesit të nxënësve dhe vlerësim. U realizuan seminare, takime profesionale me aktivët e mësuesve, këshillime dhe vizita në 150 shkolla filllore dhe të mesme.

ISHA monitoron implementimin e projektit "Kompjuter për çdo fëmijë", në aspekt të strukturës së TKI dhe aplikimit të tij aktiv në procesin edukativo-arsimor. Vazhdojnë aktivitetet për implementimin e EMIS, i cili do të kontribuojë për përmirësimin e statistikës dhe mbledhjes së të dhënave për arsimin fillor dhe të mesëm.

Shkollat nga Republika e Maqedonisë përfshihen në bashkëpunimin ndërkombëtar dhe zhvillojnë rrjete me pjesëmarrje aktive të nxënësve dhe mësuesve. Pjesëmarrja posaçërisht është e suksesshme në projektin **aces** të programit EVROPA të financuar nga fondacioni Erste, projekti "Qytetarët e Maqedonisë", të financuar nga Qeveria e Italisë dhe projekti i UNESKO-s "Pjesëmarrja e të rinjve në mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë botërore".

Sigurimi i cilësisë në arsimin fillor dhe të mesëm.

U publikua doracak Indikatorë për cilësinë e punës së shkollave.

Inspektorati shtetëror i arsimit (ISHA) përpilon Rregullore për vetevaluimin e shkollave. Qendra shtetërore e provimit (QSHP) realizoi maturë shtetërore 2011 dhe bëri analizë zë rezultateve nga matura; realizoi trajnime dhe provime për kandidatët për drejtorë të shkollave filllore dhe të mesme në gjuhën maqedonase dhe gjuhën shqipe; realizoi kontroll provues dhe ekstern të suksesit të nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm; realizoi testim në kuadër të studios ndërkombëtare TIMSS; aktivizoi bankë elektronike të test detyrave, me test detyrat për lëndë të ndryshme mësimore, të cilat mësuesit mund t'i shfrytëzojnë në mësimin; realizoi trajnime të kuadrit edukativo-arsimor dhe udhëheqës për procedurat për kontroll ekstern të suksesit të nxënësve në vitet finale të arsimit të mesëm dhe e përgatit maturën shtetërore 2012.

ISHA bëri evalvim integral në 152 shkolla filllore dhe të mesme. Mbikëqyrjet inspektuese (6 muaj pas evalvimit integral), shënuan përmirësim, veçanërisht në lidhje me respektimin e procedurave për zgjedhje të kuadrit mësimor dhe mirëmbajtjen higjienike.

Republika e Maqedonisë mori pjesë në projektin rajonal për cilësinë në arsimin, i koordinuar nga Fondacioni Evropian për Trajnim (ETF), i cili rekomandoi përf forcim të vetëevaluimit. Rekomandimet implementohen në kuadër të evaluimit integral të shkollave.

Kohezioni social dhe barabarësia

U analizua arsimimi i fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore. Nevojitet statistikë për fëmijë me nevoja të veçanta në arsimin e rregullt. Nxënësve me nevoja të veçanta arsimore u është mundësuar kalueshmëri më e lehtë nëpërmjet sistemin arsimor. Nxënësve me shikim dhe me dëgjim të dëmtuar u është mundësuar arsimit katërvjeçar për periudhë prej pesë vjet, dhënia e maturës shtetërore dhe regjistrimi në arsimin e lartë. Në shumë gjuhë u publikua manuali për mbrojtjen nga diskriminimi dhe parandalimin e tij. U realizua promovim dhe trajnim për realizimin e tij.

Vazhdoi dhënia e librave shkollorë falas për arsimin fillor dhe të mesëm, transporti falas për 18.000 nxënës në arsimin fillor dhe 45.000 nxënës në arsimin e mesëm, shtëpia e të cilëve është më larg se 2 km nga shkolla, si dhe strehim falas nëpër konvikte. U ndanë: 146 bursa për sportistët, 61 bursa për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, 50 bursa për studentë të talentuar dhe 339 bursa për nxënës të talentuar me gjendje më të dobët materiale.

Në vitin kur Republika e Maqedonisë kryeson me Dekadën e Romëve, vazhdojnë aktivitetet për numrin e zmadhuar të nxënësve Romë. Romët mund të regjistrohen në arsimin e mesëm me 10% më pak pikë se pikat e paraparë me Konkursin. Realizohet projekt për dhënie e bursave dhe ushtrimin e veprimtarisë si mentor për 800 nxënës Romë dhe si tutor për nxënësit e shkollës së mesme të komunitetit Romë. Vazhdojnë trajnimet e mësuesve për arsimim më të suksesshëm inkluziv. Vazhdon qasja e lehtësuar e Romëve në arsimin e lartë.

Në kuadër të projektit rajonal i koordinuar nga ETF në periudhën 2008-2011, Republika e Maqedonisë është përfshirë në rrjetin rajonal për politika nga sfera e arsimit dhe trajnimit të mësuesve për arsimin inkluziv. U përpunua fise projektuese nga IPA programi shumëshfrytëzues, për promovimin e mëtejme të konceptit, politikave dhe praktikave për arsim inkluziv. Projekti ka katër komponentë: përf forcimi i vetëdijes dhe fushatës; rrjeti për politika nga sfera; zhvillimi rajonal i

moduleve për trajnim të mësuesve (2 për zhvillim inicial dhe një zhvillim të vazhdueshëm profesional) dhe përkrahja e shkollave për arsim inkluziv (gjithsej 48 shkolla, prej çdo shteti nga 6).

Në pajtim me rekomandimet nga Raporti për progresin e Republikës së Maqedonisë në vitin 2011, në periudhën e ardhshme afatmesme do të ndërmerren aktivitete të shumta për implementimin e Strategjisë për arsim të integruar në koordinim me Sekretariatit për implementimin e Marrëveshjes kornizë të Ohrit (SMKO). Për efikasitetin dhe sinergjinë e zmadhuar formohet Këshill Drejtues, i bashkëkryesuar nga ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe zëvendëskryetari i Qeverisë i ngarkuar për Marrëveshjen kornizë të Ohrit. Bashkësia donatore në mënyrë aktive e përkrah implementimin e Strategjisë me më shumë projekte, prej të cilave më të rëndësishme janë: projekti bilateral i Mbretërisë norvegjeze dhe Republikës së Maqedonisë për arsim multietnik; projekti i USAID-it për përkrahjen e integritit ndëretnik në arsim me katër përkrahës reciprok dhe komponentë reciprokisht të lidhur; plani dyvjeçar i punës për arsim cilësor dhe efektiv, i nënshkrua ndërmjet MON-it dhe UNICEF-it (2020-2011), me aktivitete për:

avancimin e politikës dhe kornizës normative lidhur me arsimin inkluziv, përgatitjen e planeve dhe programeve për trajnimin e mësuesve në vendin e punës, me theks në programin *arsimi për shkathtësi jetësore*; definimin e politikave dhe programeve për avancimin e marrëdhënieve ndëretnike në arsim, si dhe avancimin e programit *shkolla mike e fëmijës*; aktivitetet për arsimin në kuadër të Programit të përbashkët të OKB-së "Përforcimi i dialogut ndëretnik dhe bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve", të implementuara nga UNICEF-i dhe nga UNESCO për projektin "Trashëgimia botërore në duar të të rinjve" dhe nga UNESCO seli të institucioneve të arsimit të lartë në RM, si dhe projekti të përkrahur nga Ministria e Punëve të Jashtme të Mbretërisë norvegjeze për përhapjen e rrjetit të shkollave të integruar, të implementuar nga pika e Qendrës për dialog Nansen në Republikën e Maqedonisë.

Filloi realizimi i tuining projektit për masën 2.2. Sigurimi i qasjes në arsimin cilësor për pjesëtarët e komuniteteve etnike në kuadër të IPA komponentit 4 - Zhvillimi i resurseve njerëzore me të cilin do të përfshihet Drejtoria për avancimin dhe zhvillimin e arsimit të gjuhëve të pjesëtarëve të komuniteteve në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

Projektet investuese dhe decentralizimi

Në vitin 2011, në fazën e dytë të decentralizimit u përfshinë 5 komuna.

Vazhdoi realizimi i programeve të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për ndërtimin dhe rikonstruktimin e shkollave fillore dhe të mesme. Përfundoi ndërtimi i 5 shkollave fillore, vazhdoi ndërtimi i 6 shkollave fillore, përfundoi rikonstruktimi i 9 shkollave fillore (prej të cilave 5 janë në gjuhën shqipe, 1 me paralele të përzier në gjuhën shqipe dhe maqedonase dhe 3 në gjuhën maqedonase) dhe vazhdon rikonstruktimi i shkollave fillore, prej të cilave 1 në gjuhën shqipe dhe 1 në gjuhën maqedonase). Në pajtim me Programin për arsimin e mesëm: vazhdon ndërtimi i 2 shkollave të mesme (prej të cilave 1 për fëmijë të komunitetit romë në lagjen Shuto Orizare - Shkup dhe 1 në Strugë, me mësim në gjuhën shqipe); përfundoi rikonstruktimi i ndërtimit të shkollës së mesme të artit në Shkup, në të cilën mësojnë fëmijë nga të gjithë nacionalitetet në Republikën e Maqedonisë.

Filloi Projekti për ndërtimin e shkollave modulare për ndërtimin e 44 shkollave të montuara fillore në mjediset rurale. Obligimet janë të ndarë ndërmjet komunave dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Me fazën e parë janë përfshirë 20 shkolla, prej të cilave 6 janë shkolla me mësim në gjuhën shqipe. Përfundoi ndërtimi 3 shkollave, ndërsa në 12 shkollat të punuarit ende vazhdon.

Në kuadër të Projektit për ndërtimin e 145 sallave sportive shkollore, u ndërtuan 21 salla, ndërsa momentalisht ndërtohen edhe 28 salla. Në pajtim me Projektin, qëllimi i të cilit është përmirësimi i kushteve për realizimin e mësimin, në shtatë shkolla të mesme në të cilat ndërtohen salla sportive, janë bërë intervenime infrastrukturore për përmirësimin e kushteve për realizimin e mësimin. Në vitin 2011 filloi nënprojekti për pajimin plotësues të sallave eskziestuese sportive në 49 shkolla të mesme, përfshirë edhe instalimin e 170 tavolinave për ping-pong. Projekti realizohet me mjete nga buxheti i RM-së dhe me hua nga banka e Këshillit të Evropës. Në periudhën 2012-2014, përveç sallave shkollore, në kuadër të projektit do të rikonstruktohen edhe 130 shkolla fillore dhe të mesme.

Prioritetet afatshkurtra:

Legjislativi / planet mësimore/ koncepcione

- Miratimi i Ligjit për arsim të mesëm, në të cilin do të transponohet Direktiva për arsimimin e fëmijëve -migrues (Direktiva e Këshillit 77/486/EEC - zbatimi i kësaj pjese të ligjit të shtyhet).
- Futja e mësimit për ndërmarrësi në plan-programet mësimore.
- Realizimi i trajnimeve të ndryshme për mësues (trajnime të 10.000 mësues nga arsimi fillor nëntëvjeçar, trajnimeve sipas programeve të akredituar të ofertuesve të shërbimeve për rreth 36.000 pjesëmarrës, trajnimeve të 1.400 mësues të matematikës në arsimin fillor dhe të mesëm)
- Përforcimi i kapacitetit për sigurimin e përkrahjes të EMIS Implementimi i mëtejshëm i Programit "Integrimi i edukimit ekologjik në sistemin arsimor maqedonas" në arsimin fillor dhe të mesëm
- Përforcimi i bashkëpunimit rajonal nëpërmjet vazhdimin të rrjeteve veç më të instaluar dhe instalimit të rrjeteve të reja.

Sigurimi i cilësisë në arsimin fillor dhe të mesëm.

Do të vazhdojë implementimi i aktiviteteve për sigurimin e cilësisë në arsimin fillor dhe të mesëm në pajtim me trendët evropiane dhe Programit nacional për zhvillimin e arsimit 2005-2015. Me rëndësi të veçantë janë edhe aktivitetet e:

- Qendra shtetërore për provim (përgatitja dhe realizimi i maturës shtetërore, realizimi i trajnimeve të kandidatëve për drejtorë të shkollave publike fillore dhe të mesme dhe realizimi i provimeve në gjuhën maqedonase dhe shqipe, vlerësimi provues ekstern i suksesit të nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm, përpunimi i të dhënave nga studioja ndërkombëtare TIMSS, zhvillimi dhe avancimi i programeve për provim për maturën dhe provim final etj.)
- Inspektorati shtetëror i arsimit (realizimi i evaluimit integral në 100 shkolla, si dhe përforcimi i resurseve njerëzore të ISHA me trajnime të inspektorëve për mbikëqyrje mbi zbatimin e ligjeve, zbatimin e dispozitave ndëshkuese dhe realizimin e evaluimeve cilësore integrale).

Kohezioni social dhe barabarësia.

- Përkrahja e nxënësve me nevoja të veçantë arsimore
- Aktivitetet për inkluzion social të Romëve nëpërmjet arsimit dhe trajnimit, përfshirë edhe tutorinë dhe veprimtarinë e mentorit.
- Implementimi i Strategjisë për arsimin e integruar, veçanërisht në aspekt të sinergjisë ndërmjet projekteve: IPA tuining projekti "Përkrahja e integritit të komuniteteve etnike në sistemin arsimor"; projekti bilateral ndërmjet Mbretërisë norvegjeze dhe Republikës së Maqedonisë; projekti i përkrahur nga USAID; projekti i OKB-së "Përforcimi i dialogut ndëretnik dhe bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve" dhe projekti për përhapjen e rrjetit të shkollave të integruara.

Projektet investuese dhe decentralizimi

- Vazhdimi i avancimit të infrastrukturës arsimore në arsimin fillor: fillimi i ndërtimit të lokalit të ri shkollor për 8 shkolla fillore; vazhdimi me ndërtimin e 5 shkollave fillore; rikonstruktimi i 8 shkollave
- Vazhdimi i avancimit të infrastrukturës arsimore në arsimin e mesëm: fillimi i ndërtimit të lokalit të ri shkollor për 5 shkolla të mesme; vazhdimi me ndërtimin e 4 shkollave të mesme; rikonstruktimi i 9 objekteve shkollave
- Përfundimi i ndërtimit të sallave të filluara sportive dhe rikonstruktive të nevojshme të shkollave, si dhe fillimi i ndërtimit të 13 sallave sportive në shkollat fillore.
- Vazhdimi i ndërtimit të 20 shkollave të fazës së parë të Projektit për shkolla të montuara në mjediset rurale.
- Ndërtimi i sallave sportive për pesë shkolla të mesme.

Prioritete afatmesme

- Zmadhimi i investimit në arsimin fillor dhe të mesëm

- Zhvillimi dhe avancimi i vazhdueshëm i plan-programeve mësimore dhe trajnimi i mësuesve
- Viti përfundimtar i Programit "Integrimi i edukimit ekologjik në sistemin arsimor maqedonas"

Sigurimi i cilësisë në arsimin fillor dhe të mesëm.

- Pjesëmarrja e mëtejme në matjet ndërkombëtare për suksesin e nxënësve
- Implementimi i aktiviteteve për sigurimin e cilësisë në arsimin fillor dhe të mesëm në pajtim me programet për punën e Qendrës shtetërore për provim dhe Inspektoratit shtetëror të arsimit.

Kohezioni social dhe barabarësia.

- Përkrahja e nxënësve me nevoja të veçante arsimore
- Përkrahja e përfshirjes së Romëve në sistemin e arsimit dhe trajnimit
- Implementimi i Strategjisë për arsimin e integruar.

Projekte investuese dhe decentralizimi

- Vazhdimi i avancimit të infrastrukturës arsimore në shkollat fillore dhe të mesme në pajtim me programet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë
- Ndërtimi i 24 shkollave të fazës së dytë të Projektit për ndërtimin e shkollave të montuara në mjediset rurale.
- Fillimi i ndërtimit të 25 sallave sportive në vitin 2013. Ndërtimi i sallave tjera sportive do të fillojë në vitin 2014.
- Hyrja e të gjitha komunave të Republikës së Maqedonisë në fazë të dytë të decentralizimit.

Arsimi profesional dhe trajnimi Gjendja rrjedhëse

U përpilua koncepti integral për arsimin profesional në Republikën e Maqedonisë. Filluan aktivitetet përgatitëse për përpunimin e Strategjisë për zhvillim dhe arsim profesional dhe trajnim. Me përkrahjen e Fondacionit evropian për trajnim (ETF), u mbajtën mbledhje pune me palët e interesuar dhe u zgjodhën dy ekspertë nacionalë për analizimin e gjendjes ekzistuese në COO si bazë për përpunimin e Strategjisë.

U përpiluan 14 standarde të flamujve në 14 sfera në arsimin profesional, me pjesëmarrje të përfaqësuesve nga punëdhënësit, Qendrën për arsim profesional dhe trajnim (CSOO) dhe mësues nga shkollat profesionale (përkrahja e këshillit britanik)

Vazhdoi përgatitja e programeve dhe standardeve mësimore në pajtim me nevojat e tregut të punës. U miratuan 3 programe për provim për kalueshmëri vertikale të nxënësve nga arsimit trevjeçar në arsimin profesional katërvjeçar.

Në pajtim me Planin operativ të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për masa dhe politika aktive 2011 për zvogëlimin e numrit të papunësisë, CSOO mori pjesë në përgatitjen e programeve për trajnime dhe realizimin e tyre për profesione të caktuara.

Filloi realizimi i tuining projekteve Përkrahja e Modernizimit të sistemit për arsim dhe trajnim, IPA komponenta IV, Masa 2.1 Modernizimi i sistemit të arsimit dhe trajnimit në kuadër të Programit operativ shumëvjeçar për zhvillimin e resurseve njerëzore 2007-2013, në kuadër të të cilit përgatiten standarde për kualifikime profesionale. Realizohen trajnime të palëve të tanguara kryesore të projektit.

Prioritete afatshkurtra:

Reforma në arsimin dhe trajnimin profesional të sistemit për COO me nevojat e tregut të punës:

- Përpunimi i Strategjisë për zhvillimin e arsimit dhe trajnimit profesional në RM.
- Përgatitja e plan-programeve mësimore dhe dokumenteve tjera programore në pajtim me nevojat e tregut të punës

- Vazhdimi i reformave në arsimin profesional në pjesën e përgatitjes së standardeve për profesionet, pjesën e sferave dhe profileve arsimore.
- Implementimi i tuining projektit *Përkrahja e modernizimit të sistemit për arsim dhe trajnim* MK/07/IB/SO/03, IPA komponenti IV për përpunimin e standardeve për kualifikime profesionale, plan-programe mësimore për aftësim profesional dhe arsimim profesional për profesione dhe trajnime të trajnuesve në arsimin profesional.

Prioritetet afatmesme

- Avancimi i teknologjisë arsimore që shfrytëzohet për arsimin fillor dhe furnizimi i laboratorive për shkollat për arsim profesional në kuadër të projektit "Të shkathët dhe kompetentë"
- Finalizimi i tuining projekteve *Përkrahja për modernizimin e sistemit për arsim dhe shkencë* MK/07/IB/SO/03
- Implementimi i Strategjisë për zhvillimin e arsimit dhe trajnimit profesional.

Reformat në sferën e arsimit të të mësuarve Gjendja rrjedhëse

U miratua Statuti i ri i Qendrës për arsimin e të moshuarve - Shkup (QAM). U miratua Rregullorja për verifikimin e programit për arsimin e të moshuarve.

U miratua Strategjia për arsimin e të mësuarve 2010-2015 dhe Plani aksionar për implementimin e Strategjisë për vitin 2011. U përcaktuan qëllimet strategjike si vijojnë: përforcimi i sistemit arsimor i të moshuarve nëpërmjet zhvillimit të sistemit statistikor dhe informues për përcjelljen e mobilitetit të të moshuarve; krijimi i kushteve mësim gjatë gjithë jetës dhe mobilitet të bëhen realitet; përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit të arsimit dhe trajnimit të të moshuarve; promovimi i barabarësisë, kohezionit social dhe qytetarisë aktive; promovimi i arsimit të të moshuarve dhe kulturës së të mësuarit nëpërmjet qasjes në arsimin dhe trajnimin e të moshuarve.

U nënshkrua Memorandum për bashkëpunim ndërmjet QAM dhe UNDP, në pajtim me: Manualin për procedurën për verifikimin e programeve për arsimin e të moshuarve, Manualin për procedurën e licencimit të institucioneve përkatësisht ofruesve të shërbimeve të programeve për arsimin e të moshuarve, Kriteret për përpunimin e listës (regjistrit) të ofruesve të shërbimeve dhe programeve për arsimin e të moshuarve, si dhe Rekomandimet në lidhje me kriteret për anëtarësimin e bashkëpunëtorëve profesionalë në komisionet në komisionet për verifikimin e programeve për arsimin e të moshuarve.

QAM u bë anëtar shoqëruar i Asociacionit Evropian për arsimin e të moshuarve (EAEA).

Filloi implementimi i Tuining Projektit "Përkrahja e ndërtimit të kapaciteteve të Qendrës për arsimin e të moshuarve, zhvillimi i programit për arsimin e të moshuarve dhe programit për përmirësimin e cilësisë dhe formësimin plotësues të arsimit fillor për persona ekskluzivë", në kuadër të IPA Programit operativ për komponentën 4 - Zhvillim i resurseve njerëzore. Në rrjedhë është vlerësimi i nevojave për trajnimin e të punësuarve në QAM dhe zhvillimi i strategjisë dhe planit për trajnim në bazë të vlerësimit të nevojave për trajnim.

Prioritetet afatshkurtra:

- Përpilimi dhe miratimi i Planit aksionar për realizimin e Strategjisë për arsimin e të moshuarve 2010-2015 për 2012.
- Verifikimi i programeve dhe licencimi i institucioneve ofrues të arsimit të të moshuarve.
- Lëshimi i katalogut të programeve të verifikuara
- Lëshimi i katalogut të institucioneve të licencuara për arsimin e të moshuarve
- Organizimi i fushatës për vetëdijësimin e popullatës për mundësitë në sferën e arsimit të të moshuarve.
- Implementimi i projektit për arsimin e mesëm të të moshuarve në më shumë komuna të Republikës së Maqedonisë.
- Implementimi i IPA tuining projektit: përforcimi i kapaciteteve të QAM, përpilimi i 6 programeve për arsimin e të moshuarve në bazë të analizës së tregut të punës dhe 6 programe për alfabetizmin dhe për formësimin plotësues të arsimit fillor të personave ekskluzivë, në bazë të vlerësimit të nevojave të të moshuarve për programe të tilla.
- Pjesëmarrja në realizimin e Planit operativ për programe dhe masa aktive për punësim 2012 të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë (QAM do të përfshihet në masën Trajnim për plotësimin e profesioneve të kërkuara në tregun e punës me verifikimin e profesioneve)

- Punësime të reja në QAM, të nevojshme për realizimin e aktiviteteve të parapara, ndërsa veçanërisht për vazhdimin dhe realizimin e suksesshëm të IPA tuining projektit.

Prioritetet Afatmesme

- Miratimi i implementimit të planit aksionar për realizimin e mëtejshëm të Strategjisë për arsimin e të moshuarve 2010-2015, për 2013 dhe 2014.
- Vazhdimi i implementimit të IPA tuining projektit dhe përfundimi i tij në korrik 2013.
- Zhvillimi i sistemit informatik-statistikor për përcjelljen e mobilitetit të të moshuarve.

Arsimi i lartë dhe Programe të komuniteteve të cilat mbështesin reforma në sistemin e arsimit të lartë

Gjendja rrjedhëse

Legjislativi

U miratuan dy ndryshime dhe plotësime të Ligjit për arsim të lartë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/11 dhe 51/11), me të cilat: u mundësua formimi i Këshillit për akreditimin dhe evalvimin në arsimin e lartë si trup nacional për sigurimin e cilësisë, u përcaktuan metoda të evalvimit për evalvim ekstern, vetevalvimi dhe vlerësimi i cilësisë së kuadrit akademik, u përforcuan kriteret për mentorë në kuadër të studimeve të doktoraturë, u fut edhe kontrolli ekstern i njohurive të studimeve, u precizua procedura për pranimin e kualifikimeve të lartë të huaj etj.

U miratua Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për komponentë të detyrueshëm që duhet t'i posedojnë programet studimore të ciklit të parë, dytë dhe tretë të studimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 154/11).

Ministria e arsimit dhe shkencës miratoi Metodologji për mënyrën e rangimit të institucioneve të arsimit të lartë. Qendra për universitete të klasës botërore nga Xhiao Tong Universiteti nga Shanghai (Kinë) u zgjodh në tenderin ndërkombëtar të bëjë rangimin e institucioneve të arsimit të lartë të Republikës së Maqedonisë në pajtim me Metodologjinë e miratuar. Në rrjedhë është mbledhja e të dhënave dhe përpunimi i tyre.

Reforma në arsimin e lartë.

Si anëtare e Hapësirës evropiane të arsimit të lartë, Republika e Maqedonisë vazhdon të realizojë aktivitete në pajtim me Procesin e Bolonjës.

U themelua Këshilli për akreditim dhe evalvim në arsimin e lartë, i cili përveç akreditimit të programeve studimore për ciklin e parë dhe të dytë, filloi me akreditimin e studimeve të ciklit të tretë (studime të doktoraturës). Në mbledhjen e Asamblesë së përgjithshme të Asociacionit evropian për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë (ENQA), (Bukuresh-Romani, tetor 2011), Këshilli fitoi status të anëtarit shoqërues të Asociacionit.

Gjatë shqyrtimin të kërkesës për akreditimin e programeve studimore, Këshilli për akreditim dhe evalvim e shqyrton bazimin e tyre në rezultatet nga mësimi (learning outcomes) dhe deskriptorët e shfrytëzuara dhe e vlerëson harmonizimin e tyre me Rregulloren për Kornizë nacionale për kualifikimet e arsimit të lartë.

Në vitin akademik 2011/2012, u organizuan 72 programe të disperzuara studimore në 16 qytete të Republikës së Maqedonisë.

Vazhdoi realizimi i projektit Arsimi i lartë i të moshuarve (35/45), për inkuadrimin e të moshuarve në arsimin e lartë. Në vitin akademik 2011/2012 u regjistrua gjenerata e dytë prej 295 studentëve, me çka numri i përgjithshëm i studentëve është rreth 700.

Në Universitetin "Shën Cirili dhe Metodi" - Shkup filloi me punë Fakultetit i ri i shkencave informatike dhe inxhinierisë kompjuterike, me 8 programe studimore.

Prioritetet afatshkurtra:

- Miratimi i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për arsim të lartë, që do të ofrojë mekanizma për përmirësimin e sistemit të financimit të arsimit të lartë dhe futjen e kuotës shtetërore për studentë të ciklit të dytë dhe tretë të studimeve.
- Miratimi i Ligjit për standardin studentor, me qëllim të harmonizimit me Ligjin për arsimin e lartë, përmirësimin të cilësisë së standardit studentor, përmirësimin të kriterëve për ndarjen

e bursave për studentët të më shumë kategorive (të talentuar, bursistë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe nga familjet e rrezikuara socialë).

- Miratimi i akteve nënligjore të cilat dalin nga ligji për arsimin e lartë.
 - Rregullore për organizimin, punën dhe mënyrën e vendimmarrjes për çështjet nën kompetencë të Këshillit për akreditim dhe evalvim në arsimin e lartë.
 - Rregullore për njësitë matëse dhe kriteret për financimin e veprimtarisë së institucioneve të arsimit të lartë.
 - Rregullore për njësitë matëse dhe kriteret për stimulimin e studentëve të talentuar dhe për dhënien e bursave për studentë të cilët kanë arritur rezultate mbi mesatare në studime
 - Rregullore për njësitë matëse dhe kriteret për kofinancimin e studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe për participimet e dhënësve tjerë të studentëve në institucionet e arsimit të lartë.
 - Rregullore për metodën e financimit projektues të arsimit të lartë.

Reforma në arsimin e lartë

- Aktivitetet për implementimin e mëtutjeshëm të procesit të Bolonjës.
- Themelimi i Këshillit për Zhvillim dhe Financim të Arsimit të Lartë
- Përshtatja e procedurave nacionalë për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë me standardet dhe rekomandimet evropiane në kuadër të procesit të Bolonjës.
- Përfundimi i projektit për rangimin e institucioneve të arsimit të lartë të Republikës së Maqedonisë
 - Vazhdimi i projektit Arsimi i lartë i të moshuarve (35/45)
 - Miratim i Programit për veprimtarinë e arsimit të lartë, me të cilin do të përcaktohen qëllimet, drejtimit e zhvillimit, burimi dhe vëllimi i mjeteve të nevojshme për financimin e nevojave shtetërore dhe për realizimin e zhvillimit të veprimtarisë së institucioneve publike të arsimit të lartë, drejtimit në të cilët do të zhvillohet rrejt i institucioneve të arsimit të lartë etj.

Korniza nacionale e kualifikimeve

- Vazhdimi i aktiviteteve për zhvillimin dhe implementimin e Kornizës nacionale të kualifikimeve.

Prioritetet afatmesme

- Paraqitja e aplikimeve dhe zbatimi i procedurës për anëtarësim të plotfuqishëm të Këshillit për akreditim dhe evalvim në arsimin e lartë në ENQA
- Implementimi i mëtutjeshëm i procesit të Bolonjës.

Programet e komunitetit dhe bashkëpunimi rajonal

Tempus dhe Erasmus Mundus

Nga viti 2011, institucionet e arsimit të lartë të Republikës së Maqedonisë mund të marrin pjesë në programin e bazës për vetëfinancim. Zyra nacionale Tempus vazhdoi me monitorimin e projekteve rrjedhëse Tempus. Në shtator 2011 u mbajt "Pllakati javor nacional Tempus", në të cilin u prezantuan 33 projekte.

Republika e Maqedonisë mori pjesë në Aksionin 1 dhe Aksionin 2 të programit Erasmus Mundus (2009-2013). U organizua ditë informative dhe u ndanë materiale informative.

Bashkëpunimi rajonal në sferën e arsimit

Republika e Maqedonisë bashkëpunon me vendet e Evropës Qendrore-Lindore në proceset e integritimit në sferën e arsimit të lartë evropian dhe zmadhimit të mobilitetit akademik në kuadër të Programit të Evropës Qendrore-Lindore për këmbimin në sferën e studimeve universitare (CEEPUS). Në rrjedhë janë qëndrimet studimore në semestrin veror të vitit shkollor 2011/2012 në RM dhe nga RM-ja në vendet anëtare të programit CEEPUS. Institucionet e arsimit të lartë të Republikës së Maqedonisë janë përfshirë në 28 programe CEEPUS.

Në kuadër të Iniciativës për bashkëpunim në sferën e reformave të arsimit në Evropën Juglindore (Education Reform Initiative in South East Europe - ERI SEE), përfaqësues të institucioneve arsimore dhe shtetërore marrin pjesë në rrjetet rajonale, klustere të njohurive, si dhe në takime lidhur me aspekte të rëndësishme të reformave arsimore.

Prioritetet afatshkurtra:

- Konferenca përfundimtare për mbylljen zyrtare të Programit Tempus.
- Vazhdimi i pjesëmarrjes në programin Erasmus Mundus në vitin 2012.
- Mobilitet të studentëve të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë dhe profesorëve vizitues nga Republika e Maqedonisë në vendet anëtare të rrjetit CEEPUS dhe anasjelltas.

Prioritetet afatmesme

- Vazhdimi i pjesëmarrjes në programin Erasmus Mundus në vitin 2013.
- Vazhdimi i pjesëmarrjes në fazën e tretë të programit CEEPUS me emërtim "Nga këmbimi deri në hulumtim"
- Vazhdimi i pjesëmarrjes në Iniciativën për bashkëpunim në sferën e reformave të arsimit në Evropën Juglindore ERI SEE.

Të rinjtë

Gjendja rrjedhëse

Ministria e Drejtësisë dhe grupi punues i formuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë përpiluan draft Ligj për të rinj. Drafti është në procedurë përpunimi.

Agjencia për të rinj dhe sport (ARS) në vitin 2011 vazhdoi me realizimin e Planit aksionar për realizimin e Strategjisë nacionale për të rinj.

Në sferën prioritare *Puna lokale e rinisë*, ARS në bashkëpunim me Koalicionin SEGA, e realizoi projektin Krijimi i strategjive lokale të rinisë në tri komuna (Dibër, Veles dhe Negotinë). Me atë, numri i përgjithshëm i Strategjive lokalë të rinisë është 13.

Në sferën prioritare *Participimi i rinisë*, është vendosur mekanizëm në tre komuna (Strumicë, Kavadar dhe Negotinë) për pjesëmarrjen e zmadhuar të rinisë në procesin e miratimit të vendimeve në NJVL, me formimin e Këshillave lokalë të të rinjve.

Në sferën prioritare *Cilësia e të jetuarit*: nga projekti Ndërtimi i 35 sallave sportive janë përfunduar 27; nga projekti Ndërtimi i 50 fushave ndihmëse të futbollit, deri në fund të vitit të gjithë 50 fusha ndihmëse të futbollit do të lëshohen në përdorim; nga projekti Ndërtimi i 100 fushave të tenisit, deri në fund të vitit 2011 u lëshuan në përdorim 31 fusha; u lëshua në përdorim shkëmbi artificial për ngjitje sportive.

U ndanë 500 bursa sportive për të rinj - sportistë të talentuar - Shpresë sportive.

Prioritetet afatshkurtra

- Miratimi dhe implementimi i Ligjit për të rinj
- Revizioni i Strategjisë nacionale për të rinj dhe përpunimin e Planit aksionar (2012-2015) për realizimin e Strategjisë nacionale për të rinj
- Përpunimi i Strategjive lokalë të rinisë.
- Formimi Këshillave lokalë të të rinjve.
- Formimi i Këshillit shtetëror për të rinj
- Investime kapitale për përmirësimin e infrastrukturës sportive

Prioritetet afatmesme

- Formimi Këshillave lokalë të të rinjve.
- Përpunimi i Strategjive lokale të rinisë.
- Ndarja e bursave për sportistë të rinj të talentuar
- Vazhdimi i investimeve kapitale për përmirësimin e infrastrukturës sportive.

3.26.2 Programet e Komunitetit

Mësimi gjatë gjithë jetës dhe Të rinjtë në aksion - aksione të decentralizuara

Në pajtim me ndryshimet e Ligjit për themelimin e Agjencisë nacionale për programe arsimore evropiane dhe mobilitet (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 24/11), aktet vijuese të NAEOPM: Manual për procedurat e brendshme të Agjencisë nacionale për programe arsimore evropiane dhe mobilitet, Rregullore për sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë nacionale për programe arsimore evropiane dhe mobilitet, Pasqyrë tabelore të vendeve të punës dhe titujve në Agjencisë nacionale për programe arsimore evropiane dhe mobilitet dhe Organigram të Agjencisë nacionale për programe arsimore evropiane dhe mobilitet, janë harmonizuar me Ligjin për nëpunës shtetërorë (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 35/10 и 167/10).

Doracakët për punë me programet "Mësim gjatë gjithë jetës" dhe "Të rinjtë në aksion" u harmonizuan me Udhëzuesin për NAEOPM për vitin 2011, i përpiluar nga Komisioni Evropian (KE). Ndryshimet u inkorporuan në tekstin integral të Manualit për procedura të brendshme të NAEOPM.

MASH dhe NAEOPM i realizuan të gjitha aktivitetet e parapara me Planin aksionar për ngritjen e suspensionit të programeve, si rezultat i saj që DP-ja e Arsimit dhe kulturës solli vendim për ngritjen e suspensionit të programeve "Mësim gjatë gjithë jetës" dhe "Të Rinjtë në aksion" për Republikën e Maqedonisë (31 tetor 2011).

Zhvillimi i sistemit efektiv i monitoringut mbi NAEOPM nga ana e MASH

U përpilua Metodologjia për vendosjen e sistemit të kontroleve të shkallës së dytë të punës së Agjencisë nacionale. E njëjta plotësohet me lista për kontroll, të cilat harmonizohen me Komisionin Evropian. Në dhjetor 2011 u nënshkrua Marrëveshje e re për bashkëpunim ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Agjencisë nacionale për programe arsimore evropiane dhe mobilitet.

Prioritetet afatmesme të NAEOPM dhe Ministrisë së arsimit dhe shkencës

NAEOPM:

- Përgatitja dhe miratimi i programeve të punës për fazën përgatitore 2012 për programet "Mësim gjatë gjithë jetës dhe për "Të rinjtë në aksion"
- Nënshkrimi i Marrëveshjes ndërmjet Agjencisë nacionale për programet arsimore evropiane dhe mobilitet dhe Drejtoria e përgjithshme për arsimin dhe kulturën e Komisionit Evropian për fazën përgatitore 2012.
- Trajnimi i të punësuarve dhe përforcimi administrativ i kapaciteteve të NAEOPM me qëllim të implementimit të programeve dhe aktivitetet tjera përgatitore
- Organizimi i 12 info ditëve për programin Mësim gjatë gjithë jetës dhe 8 info ditë për programin "Të rinjtë në aksion" në Shkup dhe nëpër rajone.
- Mirëmbajtja dhe përmirësimi i Ueb portaleve të NAEOPM
- Menaxhimi i ciklit jetësor i pilot projekteve nga programet Mësim gjatë gjithë jetës dhe Të rinjtë në aksion.
- Përforcimi kadrovik i NAEOPM - punësimi i 3 personave në vitin 2012.

Ministria e arsimit dhe shkencës:

- Plotësimi i Metodologjisë për kontrole të shkallës së dytë të NAEOPM me listë për kontroll
- Miratimi i programit vjetor të punës të NAEOPM
- Kontrole të shkallës së dytë të punës së NAEOPM
- Kontrole të shkallës së dytë të shfrytëzuesve të fundit të NAEOPM.

Prioritetet afatmesme të NAEOPM dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës

NAEOPM:

- Diseminimi dhe eksploatimi i rezultateve nga projektet e realizuara në kuadër të aksioneve nga programet sektoriale.
- Përgatitjet e NAEOPM për koordinimin e Europas.
- Marrja e akreditimit të NAEOPM për menaxhment të plotë të decentralizuar të programeve arsimore evropiane.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës:

- Monitorim dhe supervizion të vazhdueshëm të punës së NAEOPM
- Dhënia e Deklaratës vjetore për garancinë e punës së NAEOPM

- Miratimi i programit vjetor të punës të NAEOPM
- Kontrollë të shkallës së dytë të punës së NAEOPM
- Kontrollë të shkallës së dytë të shfrytëzuesve të fundit të NAEOPM.

Programi EU "Mësimi gjatë gjithë jetës" - aksione të centralizuara

Nënshkrimi i Memorandumit për mirëkuptim për pjesëmarrjen e Republikës së Maqedonisë në aksionet e centralizuara të programit "Mësim gjatë Gjithë jetës" në vitin 2012 dhe 2013. Institucione përkatëse nga Republika e Maqedonisë do të mund të marrin pjesë në projekte dhe rrjete multilaterale, rrjete shoqëruese etj. Republika e Maqedonisë do të mund të inkuadrohet në rrjetet Eurydice, Europass dhe Euroguidance.

Programi Evropa për qytetarët 2007-2013

U pagua biletë hyrëse për pjesëmarrjen e Republikës së Maqedonisë në Programin në vitin 2011. U organizuan gjithsej 7 takime informative, prej të cilave 4 ditë informative për promovimin e mundësive të programit (në Shkup, Veles, Kumanovë dhe Kavadar), 2 takime informative të dedikuara veçanërisht në Aksionin 4 "Të kujtuarit aktiv evropian" dhe 1 takim për Aksionin 2, Masat 1 dhe 2: "Përkrahja strukturore e BE-së tink tanke" dhe "Përkrahja strukturore e organizatave të shoqërisë civile në nivel të BE-së". U mbajtën mbi 30 konsultime individuale me ekipe të interesuara për përgatitjen e aplikacioneve për të gjitha aksionet dhe masat e Programit.

Mbahen të azhurnuara bazat e organizatave joqeveritare, komunat, përfaqësuesit rajonal të vetadministrimit lokal dhe institucioneve arsimore - pjesëmarrës potencial në Programin.

Udhëzuesi për Programin u përkthye nga gjuha angleze në gjuhën maqedonase. Versioni elektronik i përkthimit është publikuar në ueb faqen e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në tetor 2011 dhe është dorëzuar te përfaqësuesit e organizatave joqeveritare, komunave dhe strukturave rajonale të vetadministrimit lokal, institucioneve arsimore dhe pjesëmarrësit tjerë potencialë në Programin.

Përfundimisht me thirrjen e shtatorit në vitin 2011, aplikantët ose partnerët morën pjesë në 24 projekte për aksione dhe masa të ndryshme të Programit, me buxhet total prej 1.509.282.73 €

U siguria pjesëmarrja në mbledhjen e Komitetit Programor në maj 2011 dhe në mbledhjen konsultative për Programin në periudhën 2014-2020, si dhe në sesionin e pikave kontaktuese për shkëmbimin e përvojave dhe propozimeve për funksionimin e Programit në periudhën 2014-2020.

Prioritetet afatshkurtra:

- Përkthimi, përgatitja dhe të shtypurit e Udhëzuesit për Programin Evropa për qytetarët 2007-2013 në gjuhën shqipe
- Organizimi i vizitave dhe realizimi i 5 prezantimeve në komunat në RM për promovimin e komponentëve dhe nënkomponentëve të Programit
- Organizimi i mbajtja info ditë për promovimin e komponentëve dhe nënkomponentëve të Programit
- Pjesëmarrja e mbledhjeve të Pikave kontaktuese dhe të Komitetit të Programit Evropa për qytetarët.

Prioritetet afatmesme

- Azhurnimi i bazës së të dhënave të pjesëmarrësve potencialë në Programin
- Organizimi i Info ditëve për promovimin e komponentëve dhe nënkomponentëve të Programit
- Pjesëmarrja në mbledhje të Pikave kontaktuese dhe të Komitetit të Programit Evropa për qytetarët.

3.26.2 KULTURA

Bashkëpunimi në sferën e kulturës

Në kuadër të Konferencës ministrore të mbajtur gjatë kryesimit të maqedonisë me Komitetin e ministrave të Këshillit të Evropës 2010, u nënshkrua *Konventa komizë për vlerën e trashëgimisë kulturore për shoqërinë* - Konventa Faro 2005, e cila u ratifikua dhe hyri në fuqi më 1 nëntor 2011.

Projekt për digjitalizimin e trashëgimisë kulturore

Vazhdoi implementimi i Projektit për digjitalizimin e trashëgimisë kulturore, të mbështetur nga UNESCO. U miratua Strategjia nacionale për digjitalizimin e trashëgimisë kulturore. U përforcuan kapacitetet e përfaqësuesve nga institucionet kompetente për trashëgimi kulturore të tundshme dhe të patundshme nëpërmjet trajnimeve për digjitalizimin e trashëgimisë kulturore, në organizimin e UNESCO-s me ekspertë të huaj dhe të vendit. Plotësohet sistemi informativ nacional për trashëgimi kulturore të tundshme dhe të patundshme. U përgatit pjesa e cila ka të bëjë me digjitalizimin e trashëgimisë kulturore jomateriale si pjesë e sistemit informativ nacional.

Gjatë periudhës së ardhshme prioritetet afatmesme do të fokusohen në aktivitetet e mëtejshëm për futjen e të dhënave në sistemin informativ nacional.

Zhvillimi i industrisë kreative

Ministria e Kulturës ndërmori aktivitete përgatitore për promovimin dhe koordinimin e realizimit të Strategjisë nacionale për zhvillimin e industrisë kreative. Në periudhën e ardhshme prioritetet afatmesme do të fokusohen në Promovimin e Strategjisë nacionale për zhvillimin e industrisë kreative në Republikën e Maqedonisë dhe realizimin mbledhjeve tematike të punës për industri kreative.

Programi rajonal për trashëgimi kulturore të Evropës Juglindore

Pas përfundimit të projektit Plan-projekti i përbashkët për rehabilitim/Vlerësimi i trashëgimisë arkitektonike dhe arkeologjike të Evropës juglindore (projekt i përbashkët i Këshillit të Evropës dhe Komisionit Evropian), në vitin 2011 vazhdoi me procesin të titulluar si "Procesi i Lubjanës 2 - rehabilitimi i trashëgimisë së përbashkët". Projekti realizohet me mjetet e IPA programit shumëshfrytëzuese dhe koordinohet nga Këshilli për bashkëpunim rajonal. Në kuadër të prioritetëve afatmesme do të formohet Grup nacional i punës për implementimin e projektit në nivel nacional dhe do të përgatitet Revizion i Listës së intervenimeve prioritare dhe për vlerësime teknike preliminare dhe do të përpilohet projekt rehabilitues për monumentet/lokalitetet e reja të LPI-së.

Pilot-projekti për zhvillim lokal të rajonit të Dibrës dhe Rekës (Programi rajonal për trashëgimi kulturore dhe natyrore në Evropën Juglindore - Komponenti C)

Në vitin 2011 pjesë përfunduese nga faza diagnostiko: përfundoi misioni para-diagnostik dhe raporti u miratua nga Komiteti drejtues; u përpunua logoja e projektit; u përgatit Memorandumi për mirëkuptim dhe Strategjia e komunikimit; u formua Komisioni ndërmintor dhe Komitetit drejtues. Në periudhën e ardhshme do të përfundojë Faza diagnostike, do të përpunohet Strategjia zhvillimore dhe Realizimi i aktivitetëve të paraparë me Strategjinë e komunikimit.

Bashkëpunimi me UNESCO

Në muajin tetor 2011, Republika e Maqedonisë u bë anëtare e Bordit ekzekutiv të UNESCO-s në kryesimin e 36-të të konferencës së përgjithshme të UNESCO-s, me mandat prej 4 vitesh. Republika e Maqedonisë u bë anëtare e Komitetit Ndërkombëtar të UNESCO-s për Konventën për mbrojtjen dhe avancimin e shumëllojshmërisë së kulturës së të shprehurit (qershor 2011), me mandat prej 4 vitesh.

Në kuadër të Programit dy vjeçar të UNESCO-s për participimin 2010-2011 prej 9 alikantëve, u përkrahën 4 (1 - nga sfera e kulturës, 2 - nga sfera e arsimit dhe 1 - nga sfera e shkencës).

Drejtoria për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në bashkëpunim me Zyrën e UNESCO-s në Venedik dhe Komisionin Nacional për UNESCO-n të Maqedonisë, në tetor 2011 në Shkup organizoi Mbledhje ndërkombëtare ekspertësh me temë "Strategjitë për përforcimin e vetëdijes, për komunikime dhe afrimi tek publiku: lufta kundër tregtisë ilegale me të mira kulturore në Evropën Juglindore".

U themelua katedra e UNESCO-s për "Mediune, dialog dhe mirëkuptim", pranë Shkollës së Lartë për Gazetari dhe Marrëdhënie me Publikun. Katedra u promovua në konferencën "Arsimi për gazetarë, vlerat profesionale dhe shumëllojshmëria kulturore" (qershor 2011). U themelua katedra e UNESCO-s dhe Fakultetit filozofik pranë Universitetit "Cirili dhe Medodi" për studime interkulturore dhe për hulumtime. Në kuadër të prioritetëve afatshkurtër do të organizohen dy mbledhje të Komitetit Ndërkombëtar për organizimin e Konferencës së tretë botërore, e cila do të mbahet në vitin 2013.

Pjesëmarrja në IPA

Në kuadër të prioritetëve afatshkurtër do të vazhdojë implementimi i Projekteve IPA "CULTEMA" dhe IPA projektit "CHERPLAN".

Programi i Komunitetit "Kultura" 2007-2013

Në vitin 2011, KKT Maqedonia vazhdoi me realizimin e Programit Kulturë në pajtim me programet e paraparë vjetore në Marrëveshjet grant operative të KKT Maqedonisë dhe pjesëmarrja e numrit sa më të madh të operatorëve kulturor në projektet të përkrahur nga Programi Kulturë 2007-2013.

Promovimi i EU Programit Kulturë 2007-2013 në nivel nacional dhe rajonal/lokal, me qëllim të afrimit të një numër sa më të madh të operatorëve kulturorë nga RM-ja, si dhe promovimi i projekteve të suksesshme nga RM-ja si dhe shembuj të praktikës së mirë nëpërmjet organizimit të ngjarjeve publike (info ditë/seminare/mbledhje pune/), ueb faqe të KKT, materiale promovuese, fushata të medimeve dhe ngjashëm.

Në periudhën e ardhshme në kuadër të prioritetëve afatshkurtër do të realizohen aktivitete në vijim:

Parashihet pjesëmarrja e KKT Maqedonisë në 9 ngjarje (seminare, mbledhje pune dhe ngjashëm) në Maqedoni në organizimin e palëve dhe organizatave tjerë të interesuar dhe në kuadër të realizimit të projekteve rrjedhëse të përkrahur nga Programi Kulturë me qëllim të promovimit të Programit Kulturë, shembuj të praktikës së mirë, proceset aktuale në politikën kulturore të BE-së, Programi i ri pas vitit 2013-2012 dhe ngjashëm.

Do të realizohen 10 ngjarje (info ditë, mbledhje pune, seminare) në organizim të KKT Maqedonisë në nivel nacional (Shkup) dhe rajonal/lokal (Strugë, Gostivar, Prilep, Gjevgjeli) për qasje më të lehtë në Programin dhe ndihmën teknike gjatë përgatitjes së aplikimeve.

Planifikohet realizimi i 5 ngjarjeve në Maqedoni në bashkëpunim me pikat tjera kontaktuese kulturore (KKT Kroacia, Sllovenia, Finlanda, Bullgaria, Çekia, Serbia) dhe pikat kontaktuese nacionale (NKT e Evropës për qytetarët e RM) të Programeve tjera të BE-së në RM.

Do të zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme ndihma teknike e operatorëve gjatë përgatitjes së projekt aplikimeve: mbledhje konsultative individuale me operatorë kulturorë maqedonas dhe Zhvillimi i bazës së të dhënave për operatorë kulturorë në RM. Do të përgatitet broshura për Programin Kultura të BE-së, Përkthimi i Udhëzuesit nëpërmjet programit në gjuhën maqedonase në formë elektronike. Do të vazhdohet me promovimin e medimeve të ngjarjeve dhe informatave më të rëndësishme për implementimin e Programit Kulturë në nivel nacional.

Si prioritet afatmesëm do të vazhdojë realizimi i Programit Kulturë nga ana e KKT Maqedonisë në pajtim me programet e paraparë vjetore në Marrëveshjet grant operative të KKT Maqedonisë dhe pjesëmarrja e numrit sa më të madh të operatorëve kulturorë në projektet të përkrahur nga Programi Kulturë 2007-2013 të BE-së.

3.27 MJEDISI JETËSOR

3.27.1 LEGJISLACIONI HORIZONTAL

GJENDJA RRJEDHËSE

KORNIZA JURIDIKE

Gjatë vitit 2011, u realizuan shumë aktivitete në sferën e mjedisit jetësor. U finalizua skringu i 6-të, përkatësisht Progres monitorimi në sferën e mjedisit jetësor me të cilin vlerësohet shkalla e përfrimit të legjislacionit nacional të Republikës së Maqedonisë ndaj legjislacionit të Bashkimit Evropian. Progres monitorimi bëhet në kuadër të Rrjetit rajonal për mjedisin jetësor për anëtarësim në BE (RENA), në bashkëpunim me Komisionin Evropian - DP për mjedisin jetësor ndërsa Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikim Hapësinor (MMJPH) është kompetente për realizimin e tij.

Gjatë vitit 2011 u miratua Ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për mjedisin jetësor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 51/2011) me të cilin u bë ndryshimi i procedurës për vlerësim strategjik me qëllim të zbatimit më efikas dhe më të shpejtë ti saj si dhe harmonizimi me masën e BE-së 32001L0042.

Për ndryshimin e procedurës u miratua edhe Rregullore e re për formën, përmbajtjen, dhe formularin e vendimit për realizimin përkatësisht mosrealizimin e vlerësimit strategjik dhe formularëve për nevojën e realizimit përkatësisht mosrealizimin e vlerësimit strategjik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 122/11). Me rregulloren futet formular i cili mundëson që vlerësohet nevoja për realizimin përkatësisht mosrealizimin e vlerësimit strategjik si dhe përcaktimin e vëllimit të vlerësimit ende në fazën më të hershme të përgatitjes së dokumenteve të planifikimit.

Njëkohësisht u bënë ndryshime të akteve nënligjore të cilat kanë të bëjnë me zbatimin e procedurës për vlerësim strategjik dhe pjesëmarrjen e publikut dhe atë:

- Rregullore për ndryshimin e Rregullores për pjesëmarrjen e publikut gjatë përpunimit të rregullave dhe akteve tjera, si dhe planeve dhe programeve nga sfera mjedisit jetësor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 45/11).

- Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për strategjitë, planet dhe programet, duke përfshirë edhe ndryshimet e atyre strategjive, planeve dhe programeve për të cilat detyrimisht zbatohet procedura për vlerësimin e ndikimit të tyre mbi mjedisin jetësor dhe mbi jetën dhe shëndetin e njerëzve ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 45/11);

Në vitin 2011 u miratuan aktet nënligjore në vijim:

Vendimi për formimin e Rrjetit shtetëror për monitorimin e mjedisit jetësor, i cili përbëhet nga rrjetet shtetërore për monitorimin e medimeve dhe sferave të caktuara të mjedisit jetësor dhe atë në ajër, ujë dhe zhurmë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 122/11) Rregullore për formën, përmbajtjen, metodologjinë dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit për lëshimin dhe bartjen e ndotësve, në të cilin transponohet EU Rregullativa 32006R0166 për formimin e Regjistrit Evropian për lëshimin dhe bartjen e ndotësve. ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 27/11)

Qeveria e Republikës së Maqedonisë e miratoi Programin për investimin në mjedisin jetësor për vitin 2011 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 6/11) me të cilin alokohen 122.500.00 denarë për financimin dhe kofinancimin e projekteve nga sfera e mjedisit jetësor për vitin 2011 dhe atë për përpunimin e dokumentacionit teknik dhe realizimin e projekteve dhe aktiviteteve për mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së ujërave, mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit, vetëdijesimin, edukimin dhe trajnimin nga sfera e mjedisit jetësor, nxitjen studimeve arsimore, hulumtuese dhe zhvillimore për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe natyrës, përkrahjen e projekteve dhe aktiviteteve të OJQ-së, kofinancimin e projekteve rrjedhëse, realizimin e projekteve dhe aktiviteteve të miratuara në pajtim me Programin për investim për vitin 2010 dhe shpenzime për realizimin e programit. Konkursi për realizimin e programit u shpall në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 12/11 ndërsa rezultatet nga konkursi në lidhje me subjektet dhe projektet e zgjedhura u shpallën në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 39/11.

Në vitin 2011 u përpunua edhe Pasqyrë e gjendjeve me mjedisin jetësor në bashkëpunim me Komisionin Evropian për Çështje Ekonomike të Kombeve të Bashkuara.

MMJPH në bashkëpunim me UNDP-në përgatiti aplikacion për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e aktiviteteve - përpunimin e Planit nacional për ballafaqim me dezertifikimin dhe zbutjen e efekteve nga thatësitat, të harmonizuar me Strategjinë dhe i cili i përcjell rekomandimet e Konventës për luftë kundër dezertifikimit (UNCCD). Në procedurë përgatitjeje është metodologjia për përpunimin e Planit nacional për ballafaqimin me dezertifikimin dhe zbutjen e efekteve prej thatësirrave i cili miratohet në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor.

KORNIZA INSTITUCIONALE

MMJPH rregullisht bë grumbullimin, përpunimin dhe njoftimin e të dhënave dhe informatave të marrë nëpërmjet rrjetit monitorues për medime në mjedisin jetësor dhe sferat - ajri, uji, zhurma, toka dhe hedhurina. MMJPH dorëzon 75% nga totali i të dhënave të kërkuara te Agjencia evropiane për mjedisin jetësor (EEA) ku ka status të vendit bashkëpunëtor dhe është pjesë e grupeve punuese të Agjencisë. U përpiluan 12 indikatorë për mjedisin jetësor në kuadër të publikimit "Indikatorë rajonalë për mjedisin jetësor" dhe u përpilua raport për gjendjen e mjedisit jetësor për konferencën ministrore për mjedisin jetësor që u mbajt në Astana në tetor 2011.

Gjatë vitit 2011 u azhurnuan dhe u publikuan Indikatorë për mjedisin jetësor të Republikës së Maqedonisë. Në rrjedhë është përgatitja e publikimit dy vjeçar - Statistika në mjedisin jetësor 2011, në bashkëpunim me Entin Shtetëror për Statistikë. Gjithashtu u publikuan edhe broshura për punën dhe bashkëpunimin me Agjencinë evropiane për mjedisin jetësor dhe broshura për Kadastrat e ndotësve dhe materieve ndotëse.

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për mjedisin jetësor filloi edhe përpunimi i Listës së indikatorëve të parametrave për mjedisin jetësor.

Gjatë vitit 2011 u ndërmarrën një seri aktivitete për vetëdijesimin e publikut nëpërmjet shënimit të ditëve nga kalendari ekologjik, promovimeve, prezantimeve, mbledhjeve të punës, takimeve konsultative dhe emetimit të emisioneve televizivë me tema që kanë të bëjnë me ekologjinë.

Edhe vitin e kaluar rregullisht u zbatuan procedurat për kundërvajtje për ndërmjetësim nga Komisioni për Kundërvajtje dhe Komisioni për Ndërmjetësim të MMJPH.

Në vitin 2011 vazhdoi realizimi i projektit "Përforcimi i kapaciteteve në nivel qendror dhe lokal për realizimin e vlerësimit strategjik për mjedisin jetësor (VSNMJ)", të financuar nga Mbretëria e Holandës. Në muajin dhjetor u mbajt Konferenca e parë nacionale për vlerësim strategjik të ndikimit mbi mjedisin jetësor në Maqedoni. Njëkohësisht, në kuadër të këtij projekti u mbajtën më shumë mbledhje pune dhe trajnime të cilat kishin të bëjnë me përforcimin e kapaciteteve në nivel qendror dhe lokal për realizimin e vlerësimit strategjik. U krijua faqe e internetit për VSNMJ (www.sea-info.mk) në gjuhën maqedonase, shqipe dhe angleze me qëllim të zmadhimit të mundësisë për pjesëmarrjen e publikut në miratimin e dokumenteve të planifikimit dhe në sigurimin e ndihmës në realizimin e vlerësimit strategjik. Vazhduan aktivitetet për realizimin e dy pilot-projekteve për realizimin e VSNMJ për Planin për menaxhim me grykën e lumit të Parkut të Prespës dhe Planin e përgjithshëm urbanistik të qytetit të Shkupit.

Në mënyrë plotësuere, në kuadër të projektit "Standarde teknike në mjedisin jetësor", u realizuan tre trajnime me temë: "Praktika të mira për zbatimin e vlerësimit strategjik të ndikimit mbi mjedisin jetësor (VSNMJ)", në organizim të MMJH dhe Shoqërisë gjermane për bashkëpunim ndërkombëtar - (GIZ) në të cilën morën pjesë përfaqësues nga MMJPH, vetadministrimi lokal dhe sektori joqeveritar.

Në lidhje me procedurën për vlerësim të ndikimit mbi mjedisin jetësor në muajin nëntor 2011 u mbajtën katër debate publike për realizimin e projekteve: "Gërmim sipërfaqësor i lëndëve të para minerale të bakrit dhe arit në lokalitetin dhe "Ndërtimi i autostradës Milladinovski - Shën Nikolle - Shtip". U përpilua raporti për përkatësinë e studios për vlerësimin e ndikimit mbi mjedisin jetësor të projektit: "Gërmim sipërfaqësor i lëndëve të para minerale të bakrit dhe arit në lokalitetin Illovisa". U lëshua aktvendim për përcaktimin e nevojës për realizimin e projektit: "Ndërtimi i rrugës magjistrale M-6 Shtip - Strumicë në autostradë".

MMJPH miratoi Plan për mbikëqyrje mbi ligjshmërinë e punës së organeve të komunave, të qytetit të Shkupit dhe të komunave në qytetin e Shkupit për vitin 2011 në pajtim me Komisionin për Kryerjen e Mbikëqyrjes mbi Ligjshmërinë e punës së organeve të komunave, të qytetit të Shkupit dhe të komunave në qytetin e Shkupit ushtroi mbikëqyrje mbi katër komuna dhe atë në: komunën Gjorgje Petrov, Aerodrom, Gostivar, Kavadar, Strugë dhe Berovë. Mbikëqyrja u realizua në lidhje me kompetencat në vijim: procedura për miratimin e elaborateve për mjedisin jetësor, procedura për lëshimin e lejes së integruar ekologjike të kategorisë B dhe mbikëqyrje të kompetencave të organeve të komunave në pajtim me Ligjin për mbrojtje nga zhurma në mjedisin jetësor.

Në vitin 2011 vazhdoi realizimi i projektit "Përkrahja e përgatitjes nacionale për anëtarësim në BE nga sfera e mjedisit jetësor shikuar nga perspektiva e vendit anëtar" ndërmjet MMJPH dhe Agjencisë zvicerane për mbrojtjen e mjedisit jetësor (SEPA). Gjegjësisht, në kuadër të projektit në periudhën prej 12 deri 16 shtator 2011 u organizuan seminare të vogla në të cilat praktikisht u diskutua për përgatitjen e pozicioneve negociuese dhe për instruksionet për 4 BE direktiva nga sfera e mjedisit jetësor (hedhurina, ajër, ujë dhe natyrë). U përpilua Manuali për punë për çështje lidhur me BE-në në sferën e mjedisit jetësor. Në 14 dhe 15 nëntor 2011 në Shkup në kuadër të projektit u mbajt seminar me temë "Roli i sektorit joqeveritar në procesin e negociatave dhe aderimit në BE në sferën e mjedisit jetësor". Në seminarin u diskutua për rolin dhe ndarjen e sektorit joqeveritar në procesin e përgatitjes për fillimin e negociatave me Komisionin Evropian, si dhe mënyra e inkuadrimin, komunikimit dhe bashkëpunimit në kuadër të këtij procesi. Si rezultat i seminarit në datën 12 dhjetor 2011 u mbajt mbledhje e veçantë me organizata joqeveritare, në prani të Ministrit të Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor dhe përfaqësuesve të organizatave joqeveritare të cilat veprojnë në sferën e mjedisit jetësor.

Ndryshimet klimatike

Gjatë vitit 2011, aktivitetet e Republikës së Maqedonisë u zhvilluan në më shumë sfera, madje duke zhvilluar bashkëpunim ndërkombëtar, rajonal dhe bilateral me Bashkimin Evropian në

fushën e zvogëlimit të ndryshimeve klimatike dhe zvogëlimit të vulnerabilitetit të sektorëve të cilët janë më vulnerabil ndaj ndryshimeve klimatike.

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor merr pjesë në punën e Rrjetit Rajonaë RENA, në grupin punues 2 për ndryshime klimatike.

Përfaqësues të MMJPH morën pjesë në krijimin e programeve të reja për strategji zhvillimore me emisione të ulëta (me iniciativë të USAID-it dhe Qeverisë së Republikës së Sllovenisë nëpërmjet Bashkëpunimit Territorial Evropian 2007-2013), si dhe në iniciativën për projekt të ri rajonal për adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike në grykën e lumit Drin të mbështetur nga GIZ. Në atë drejtim filluan diskutimet preliminare me USAID-in për fillimin e projektit të ri për strategji zhvillimore me nivel të ulët karboni, në pajtim me obligimin që e ka ndërmarrë Qeveria e SHBA-së në Samitin për çështje klimatike në Kopenhagë në vitin 2009, si dhe në pajtim me iniciativën e SHBA-së për avancimin e kapaciteteve për strategji zhvillimore me emision të ulët, është iniciuar ndihmë për vendet që janë anëtare të komunitetit energjetik për tejkalimin e barrierave për rrije të ulët të karbonit. Njëkohësisht, në nivel të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë filluan aktivitetet për zhvillimin e politikave për "zhvillimin e gjelbër" që realizohen nëpërmjet Bankës Botërore.

U iniciua propozim për zvogëlimin e ndryshimeve klimatike nëpërmjet masave të efikasitetit energjetik industrial për shfrytëzimin e mjeteve nga GEF - pjesë e ndryshimeve klimatike nëpërmjet Programit të KB-së për zhvillim industrial. U zhvillua mjeti softuerik për realizimin e obligimit ligjor të komunave për përpunimin e Programeve për efikasitet energjetik, të përkrahur me trajnime të personave përgjegjës për përdorimin dhe mirëmbajtjen e të njëjtit.

Gjatë vitit 2011 u promovua Plani i parë aksionar për kampus me emision të ulët me pilot ndërtesë ekologjike të universitetit të Evropës Juglindore në kuadër të bashkëpunimit bilateral dhe Memorandumit për bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit Jetësor, Territorit dhe Detit të Republikës së Italisë.

Drejtoria për punë hidrometeorologjike

Republika e Maqedonisë vazhdoi me përforcimin e bashkëpunimit bilateral në sferën e çështjeve hidrometeorologjike me vendet nga Bashkimi Evropian, si rezultat i kësaj u nënshkrua Memorandum për mirëkuptim dhe bashkëpunim në sferën shkencore-teknike të meteorologjisë dhe hidrologjisë ndërmjet Drejtorisë për çështje hidrometeorologjike të Republikës së Maqedonisë dhe Institutit Slloven Hidrometeorologjik.

U realizua vizitë nga ana e Instituteve të Qendër së përbashkët për hulumtim në Ispra në Itali (JRC) për bashkëpunim të Republikës së Maqedonisë me JRC, ku organizator ishte Komisioni Evropian - Qendra e përbashkët për hulumtim. Në kuadër të Projektit "Qendra për menaxhim me thatësira në Evropën Juglindore" (DMCSEE) u organizua trajnim për punën praktike me të dhënat klimatike (MASH, MISH). Përfaqësues plotësues të UHMR morën pjesë në më shumë trajnime, mbledhje pune dhe seminare të cilat kanë për qëllim përforcimin e kapaciteteve të drejtorisë dhe kanë të bëjnë me menaxhimin me të dhënat klimatologjike dhe meteorologjike, shfrytëzimin dhe menaxhimin e të dhënave, aftësimin për punë me EUMETSAT dhe ngjashëm.

PRIORITETET AFATSHKURTRA

KORNIZA JURIDIKE

Në fillim të vitit 2012 u parapa të fillohet Progres monitorimi i 7-të në sferën e mjedisit jetësor me të cilin vlerësohet shkalla e përfrimit të legjislacionit nacional të Republikës së Maqedonisë ndaj legjislacionit të Bashkimit Evropian.

Në fillim të vitit 2012 do të fillohet procedura për përpunimin e Raportit për gjendjen me mjedisin jetësor që del nga detyrimi i Ligjit për mjedisin jetësor dhe në pajtim me Rregulloren për formën, përmbajtjen, qëllimet, mënyrën e përpunimit, llojin dhe burimet e të dhënave për përpilimin e Raportit për gjendjen e mjedisit jetësor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 81/2010). Njëkohësisht do të përpilohet Lista e indikatorëve për mjedisin jetësor dhe Indikatorëve për mjedisin jetësor të Republikës së Maqedonisë për vitin 2012.

Edhe në vitin 2012 do të vazhdojnë aktivitetet për realizimin e programit GLOBE.

Deri në fund të vitit 2012 do të miratohet Protokollin për vlerësim strategjik të mjedisit jetësor i cili del nga Konventa për vlerësimin e ndikimit mbi mjedisin jetësor në kontekst tejkuftar (Konventa ESPO).

Do të miratohet Programi për ushtrimin e mbikëqyrjes inspektuese për Inspektoratin shtetëror për mjedisin jetësor dhe inspektorët e autorizuar për mjedisin jetësor, do të ushtrohet mbikëqyrje mbi realizimin e tij dhe do të miratohet raport për mbikëqyrjen inspektuese.

Në vitin 2012 është paraparë miratimi i Planit për mbikëqyrje administrative mbi punën e Njësive të vetadministrimit lokal (NJVL) për vitin 2012 dhe realizim i tij. Me planin do të caktohen sferat në të cilat do të ushtrohet mbikëqyrja administrative në periudhën për vitin 2012. Mbikëqyrja administrative do të ushtrohet nga ana e Komisionit të formuar për këtë qëllim.

Në këtë periudhë do të transponohet Direktiva për kriminalin ekologjik në Kodin Penal, ndërsa institucion kompetent për miratimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të Kodit Penal është Minsitria e Drejtësisë.

MMJPH në bashkëpunim me UHMR do të fillojë me aktivitetet për miratimin e Planin nacional për ballafaqim me dezertifikimin dhe zbutjen e efekteve nga thatësitat. Ky plan del si detyrim nga Konventa e OKB-së për luftë kundër dezertifikimit në vendet që ballafaqohen me thatësi serioze dhe/ose me dezertifikimin, veçanërisht në Afrikë nga viti 2002, si dhe nga Ligji për mjedisin jetësor.

Ndryshimet klimatike

Në vitin 2012 pritet raport primar për hapat e nevojshme për zbatimin e Vendimit të BE-së për monitorim, njoftim dhe verifikim të gazrave serrë për pjesëmarrjen në skemën për tregti me emisione të BE-së (2003/87/EC и 2009/29/EC). U planifikua promovimi i Raportit për modelet për vlerësimin e pasojave nga ndryshimet klimatike mbi sektorë të caktuar në vende të caktuara.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Në vitin 2012 u planifikua pjesëmarrja e përfaqësuesve nga MMJPH në mbledhje pune në lidhje me obligimet që dalin nga Direktiva INSPIRE, në organizim të rrejtit rajonal RENA.

Gjithashtu nëpërmjet TAIEX, MMJPH aplikoi për mbajtjen e mbledhjes së punës në të cilën do të prezantohen obligimet që dalin nga Direktiva Inspire. Pas mbajtjes së mbledhjes së punës MMJPH do të mund të përgatitë koncept për transponimin e saj në legjislacionin nacional.

Nevojitet përforsimi i kapaciteteve në nive qendror dhe lokal për zbatimin e legjislacionit, veçanërisht për kompetencat e njësisë së vetadministrimit lokal (NJVL). Kjo do të bëhet nëpërmjet sigurimit të punësimeve të reja dhe realizimit të trajnimeve për organet kompetente, përfshirë edhe inspektorët e mjedisit jetësor në nivel qendror dhe lokal. Gjegjësisht, aktivitetet do t'u referohen:

- përforsimit të kapaciteteve në nivel qendror dhe lokal dhe industrisë në lidhje me obligimet që dalin nga Ligji për ratifikimin e Protokollit për Regjistrin e ndotësve dhe Rregullores së ndotësve, të miratuar në bazë të Ligjit për mjedisin jetësor;

- përforsimit të kapaciteteve në nivel qendror dhe lokal në lidhje me procedurat për VNMJ, VSNMJ dhe PKIN.

- Sigurimi i pajisjes së Inspektoratit shtetëror për mjedisin jetësor.

Në periudhën e ardhshme do të vazhdohet me përkrahjen e realizimit të projekteve të NJVL për ndërtimin e objekteve infrastrukturore në sferën e hedhurinave dhe ujërave, si dhe në sfera tjera të financuar nëpërmjet Programit vjetor për investim në mjedisin jetësor për vitin 2012 dhe nëpërmjet buxheteve të MMJPH dhe Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve (MTL).

Në kuadër të projektit "Përkrahja e përgatitjes nacionale për anëtarësim në BE nga sfera e mjedisit jetësor shikuar nga perspektiva e vendeve anëtare, faza 2" në vitin 2012 është paraparë mbajtja e mbledhjeve të punës me njësitë e vetadministrimit lokal për njoftimin me obligimet të cilat do të vijojnë në procesin e negociatave, si dhe mini seminare plotësuese për përgatitjen e pozicioneve negociuese dhe planeve implementuese për direktiva të caktuara të BE-së. Gjithashtu, në lidhje me përkrahjen e procesit të përgatitjes nacionale për anëtarësim në BE nga sfera e mjedisit jetësor në vitin 2012 është parapa përgatitja e rregullave interne me MMJPH për zbatimin e procesit për negociata.

Me qëllim të plotësimit përmirësues të Rrjetit shtetëror të medimeve dhe sferave në mjedisin jetësor, do të vazhdojnë aktivitetet për vlerësimin e rrjeteve ekzistuese (faqe të monitorimit) që bëjnë matjen e kualitetit të medimeve (ujë dhe ajër) dhe sferave (zhurmë) të mjedisit jetësor.

Edhe në këtë periudhë do të vazhdohet me mbajtjen e Listës së ekspertëve për vlerësimin e ndikimit mbi mjedisin jetësor dhe Listës së ekspertëve për vlerësim strategjik të ndikimit mbi mjedisin jetësor. Do të vazhdojë zbatimi i procedurës për kundërvajtje, procedurës për ndërmjetësim dhe procedurës së mbikëqyrjes inspektuese.

Ndryshimet klimatike

Deri në shtator 2012 pritet të formohet zyrë e projekteve për realizimin e raportit të tretë për ndryshime klimatike. Me vendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë do të vendoset mekanizëm për përcjelljen e progresit në realizimin e Programit për zhvillim "të gjelbër" të Republikës së Maqedonisë, të koordinuar nga ana e zyrës së nënkryetarit të Qeverisë të ngarkuar për çështje ekonomike. Njëkohësisht, në kuadër të RENA, do të mbahet trajnim për politika dhe legjislacionin e BE-së në sferën e klimës.

Drejtoria për çështje hidrometeorologjike

Do të bëhet përforsimi i kapaciteteve të UHMR me punësime të reja dhe me aftësim dhe përsosje profesionale të të punësuarve dhe do të përforsohen potencialet e Drejtorisë për përgatitjen e parashikimeve të sakta të motit, më saktësisht për parashikimet dhe vlerësimet klimatike dhe parashikimet dhe vlerësimet më precize hidrologjike.

Në vitin 2012 do të mbahen më shumë mbledhje pune dhe trajnime të organizuara nga EUMETSAT, ESMWF, EUMETNET, Meteo France, si dhe takime pune të trupave koordinuese në ECMWF.

Do të fillohet me rikonstruktimin e sistemit për telekomunikim, si dhe do të fillojnë aktivitete për akreditimin e laboratorit për determinizmin e materieve dhe substancave kërcënuese në ujërat, ajrin dhe tokën.

PRIORITETET AFATMESME

KORNIZA JURIDIKE

Deri në fund të vitit 2013 është paraparë miratimi i Ligjit për sistem hapësinor informativ në të cilin do të transponohet Direktiva INSPIRE (2007/2/KE).

Në vitin 2013 do të miratohet Raport për gjendjen me mjedisin jetësor dhe Statistikat për mjedisin jetësor 2013. Në periudhën prej vitit 2013 deri 2014, në veçanti për çdo vit do të përgatitet dhe miratohet plan i ri për mbikëqyrjen administrative për sferat nga fusha e mjedisit jetësor dhe komunitat të cilat nuk janë përfshirë me planin e miratuar paraprak nga viti 2011 dhe 2012.

Ndryshimet klimatike

Pritet të miratohen strategji për zhvillim me emision të ulët, si rezultat i aktiviteteve programore të mbështetura nga Banka botërore dhe USAID-i për rritje të gjelbër me nivel të ulët emisionesh. Në këtë periudhë pritet rezultat për iniciativë rajonale të Qeverisë së Republikës së Sllovenisë për Evropë Juglindore me nivel të ulët karboni në kuadër të bashkëpunimit territorial evropian 2007-2013. Gjithashtu, pritet të fillohet me realizimin e projektit në kuadër të IPA komponentit 120120-13 - në pjesën për klimën.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Në periudhën e ardhshme do të vazhdojnë aktivitetet për përforsimin e kapaciteteve të sektorëve dhe organeve në përbërje të MMJPH dhe atë: Drejtoria për Mjedisin Jetësor (MMJPH_DMJ), Inspektorati shtetëror për mjedisin jetësor (MMJPH_ISHMJ) dhe Shërbimi për sistem informativ hapësinor, organet në përbërje të MMJPH, nëpërmjet punësimeve të reja, furnizimeve të pajisjes dhe trajnimeve në lidhje me zbatimin e rregullave nga sfera e mjedisit jetësor.

Në vitin 2013 pritet të fillojë projekti nga IPA komponenti 1 me çka do të sigurohet përforsimi i kapaciteteve për mbikëqyrje inspektuese të inspektorëve shtetërorë dhe lokalë për mjedisin jetësor.

Vëmendje të veçantë do t'u kushtohet trajnimeve në drejtim të përforsimit të kapaciteteve për zbatimin e rregullave për përgjegjësi për dëmin në mjedisin jetësor; trajnimeve për implementimin e E-PRTR dhe modelimin me të dhënat, shfrytëzimin e aplikacionit softuerik nga PRTR; trajnimeve për teknologji informatike; furnizimeve të pajisjes për monitorim, modelim dhe për sistem informativ nacional. Njëkohësisht u planifikua të vazhdohet me përforsimin e kapaciteteve të NJVL për menaxhimin me mjetet jetësore në nivel lokal, nëpërmjet sigurimit të: punësimeve të reja;

pajimit teknik dhe sigurimit të trajnimeve të të punësuarve në institucionet kompetente në nivel lokal për realizimin e obligimeve ligjore që dalin nga sfera e mjedisit jetësor.

Do të miratohet Plan nacional për ballafaqim me dezertifikimin dhe zbutjen e efekteve nga thatësia.

Deri në vitin 2014 është paraparë vendosja e Regjistrit të ndotësve në Maqedoni.

Edhe në këtë periudhë do të vazhdojë realizimi i fushatës për vetëdijesimin publik në mjedisin jetësor, si dhe nxitjen e studimeve arsimore, hulumtuese dhe zhvillimore, programeve dhe projekteve për mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetësor dhe natyrës.

Edhe më tutje do të vazhdojë dorëzimi i të dhënave dhe bashkëpunimi me Agjencinë evropiane për mjedisin jetësor (EEA) dhe do të insistohet që të sigurohet përqindja më e madhe e dorëzimit të të dhënave për mjedisin jetësor.

Në mënyrë afatmesme planifikohet përmirësimi i Rrjetit shtetëror për monitorimin e medimeve dhe sferave në mjedisin jetësor, dhe do të vazhdojë përkrahja për realizimin e projekteve të NJVL për ndërtimin e objekteve infrastrukturore në sferën e hedhurinës dhe ujërave, të financuar nëpërmjet programeve vjetore në mjedisin jetësor, nëpërmjet buxhetit të MMJPH dhe MTL si dhe nëpërmjet fondeve evropiane dhe bashkëpunimeve tjera bilaterale dhe multilaterale.

Ndryshimet klimatike

Pritet të fillojë zbatimi i Vendimit për monitorim, njoftim dhe verifikim të gazrave serrë, me propozim zgjidhje institucionale për zbatimin e Vendimit. Në këtë periudhë pritet të përfundojë revizioni dhe plotësimin e inventarëve të gazrave serrë dhe skenarëve për ndryshime klimatike. Gjithashtu, pritet të harmonizohet fisheja sektoriale si dhe të fillojë realizimi i IPA komponentit 1 2012-2013- pjesë e klimës.

Në vitin 2014 do të miratohet Plani i tretë nacional për ndryshime klimatike, në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor dhe Konventën për ndryshime klimatike të KB.

UHMR

Do të vazhdojë përforcimi i kapaciteteve të UHMR-së për realizimin e aktiviteteve të tyre nëpërmjet punësimeve të reja dhe trajnimeve, madje do të vazhdohet me realizimin e aktiviteteve të ndërmarrë paraprakisht lidhur me sanimin, rikonstruktimin e objekteve ndërtimore të stacioneve kryesore meteorologjike në Republikën e Maqedonisë, automatizimin e instrumenteve meteorologjike dhe shkëmbimin e informatave meteorologjike.

Do të fillojë procesi i shfrytëzimit të udhëzimeve nga Organizata meteorologjike botërore për përcaktimin e kriterëve për formimin dhe vendosjen dhe mënyrën e punës së rrjetit shtetëror hidrometeorologjik dhe për ndërtimin, pajimin, mirëmbajtjen, punën, mbrojtjen dhe zhvillimin e rrjetit shtetëror hidrometeorologjik të stacioneve.

Do të ndërmerren aktivitetet për përtëritjen dhe modernizimin e rrjetit të stacioneve hidrologjike për ujëra sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe pajimin e tyre me pajisje të sofistikuar; furnizim të sistemit të ri të radarit për mbulimin e pjesës juglindore të Republikës së Maqedonisë (trekëndëshi: Kavadar-Strumicë-Gjevgjeli), përtërije të sistemit të telekomunikimit, përpunimi i bazës qendrore të të dhënave hidrometeorologjike, akreditimi i laboratorisë për determinimin e materieve dhe substancave ndotëse në ujërat, ajrin dhe tokën.

3.27.2 KUALITETI I AJRIT

GJENDJA RRJEDHËSE

KORNIZA JURIDIKE

Gjatë vitit 2011 vazhdoi harmonizimi i legjislacionit nacional me BE acquis nëpërmjet miratimit të Rregullores për përcaktimin e kapaciteteve djegëse të cilat duhet të ndërmarrin masa për mbrojtjen e ajrit të ambientit nga ndotja, nëpërmjet zvogëlimit të emisioneve të substancave të caktuara ndotëse në ajër (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 112/2011), në të cilën u transponua një pjesë e BE masës 32001I0080.

Gjatë vitit 2011 u miratuan aktet nënligjore, të cilat edhe pse nuk transponojnë BE masa, janë me rëndësi të madhe për legjislacionin nacional nga sfera e ajrit, si vijojnë:

- Rregullore për kushte të përafërta për kryerjen e llojeve të caktuara të punëve profesionale, në pikëpamje të pajisjes, aparaturës, instrumenteve dhe hapësirave përkatëse afariste të cilat duhet t'i plotësojnë subjektet të cilat kryejnë punë të caktuara profesionale për

monitorimin e kualitetit të ajrit të ambientit (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 69/2011);

- Rregullore për formën dhe përmbajtjen e formularëve për dorëzimin e të dhënave nga emisionet në ambientin ajror nga burimet stacionare, mënyrën dhe afatin kohor të dorëzimit në pajtim me kapacitetin e instalimit, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së ditarit të emisioneve në ajrin e ambientit (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 79/2011);

Gjatë vitit 2011 u miratua Programi për punën e Rrjetit monitorues shtetëror automatik për cilësinë e ajrit të ambientit për vitin 2012, të menaxhuar nga Ministria e Ambientit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.

U përgatit Rregullorja për metodën, mënyrat dhe metodologjinë për matjen e emisioneve në ajrin nga burimet stacionare, në të cilën u transponua pjesa e BE masës 320010080.

U përpilua Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kualitetin e ajrit të ambientit me të cilin u bë transponimi i BE masave 32008L0050.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Mbrojta e kualitetit të ajrit në Republikën e Maqedonisë është institucionalizuar me punën e më shumë organeve dhe trupave të administratës shtetërore dhe sektorit publik të cilat kanë kompetenca të drejtpërdrejta dhe të tërthorta në këtë domen, të përcaktuara me Ligjin për mjedisin jetësor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. (53/2005, 81/2005, 24/2007, 159/2008, 83/2009, 48/2010 и 124/2010) dhe Ligjin për kualitetin e ajrit të ambientit ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. (67/2004, 92/2007 и 35/2010 и 47/2011).

Aktivitetet kryesore në pjesën e sigurimit të të dhënave të monitorimit të kualitetit të ajrit të ambientit, si dhe inventarizimin e emisioneve nga burimet stacionare i bën Sektori Qendra informative maqedonase për mjedisin jetësor (QIMMJ) në MMJPH. Në kuadër të këtij sektori funksionon edhe Seksioni për monitorimin e kualitetit të ajrit të ambientit në kuadër të të cilit punon Sistemi monitorues automatik për kualitetin e ajrit të ambientit të MMJPH. Të dhënat nga rrjeti monitorues dhe matjet e bëra dorëzohen te QIMMJ dhe përpunohen në mënyrë përkatëse. Matje të veçanta të emisioneve në ajrin nga instalimet kryen Laboratoria qendrore, seksion në përbërje të Drejtorisë të mjedisit jetësor (DMJ).

Mbrojtja e ajrit realizohet nga DMJ nëpërmjet lëshimit dhe kontrollit të lejeve për harmonizimin me planin operativ të cilat janë të detyrueshme për të gjitha instalimet ekzistuese të cilat janë nën regjimin e lejeve të integruara ekologjike. Gjegjësisht në DMJ funksionon Sektori për ndotjen industriale dhe menaxhimin me rrezik, në të cilin ekziston Seksioni për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes (PKIN) dhe Seksioni për menaxhim me rrezik dhe kimikale, si dhe Seksioni për Atmosferë. Njëkohësisht, Inspektorati shtetëror i mjedisit jetësor (ISHMJ) ushtron mbikëqyrje mbi instalimet të cilat emitojnë substanca ndotëse në ajrin dhe kur është e nevojshme lëshon detyrime për ndërmarrjen e masave me qëllim të zvogëlimin të emisioneve dhe shpjerja e tyre në kufijtë e lejuara.

Në gusht 2011 u formua Rrjeti shtetëror për monitorim të medimeve dhe sferave në mjedisin jetësor në kuadër të të cilit u përcaktua Rrjeti shtetëror për monitorimin e kualitetit të ajrit të ambientit. Rrjeti shtetëror për monitorimin e kualitetit të ajrit i përfshin stacionet për matje të cilat janë pjesë e Sistemit shtetëror automatik monitorues për cilësinë e ajrit të ambientit me të cilin menaxhon MMJPH, pastaj vendet për matje për monitorimin e metaleve të rënda në aerosediment në kompetencë të Institutit për shëndetësi publike (ISHP) dhe vendet për matje për monitorim të rezeve radioaktive në ajër dhe shtresat atmosferike gjithashtu nën kompetencë të ISHP.

Sistemi shtetëror automatik monitorues për kualitetin e ajrit të ambientit u plotësua me dy stacione automatike monitoruese. Stacionet janë të vendosura në Shkup, në komunat e Karposhit dhe Qendrës. Stacionet në Karposh i përcjell kualitetin e ajrit në a.q prapavijën urbane me qëllim që të fitohen informata për nivele mesatare të cilësisë së ajrit dhe ekspozimin në mjediset urbane. Stacioni për monitorim në komunën e Qendrës e mat kualitetin e ajrit në sferën ku ka frekuencë më të madhe në komunikacion. Me këto stacione për së pari herë filloi monitorimi i grimcave të suspenduara me madhësi prej 2.5 mikro metra (PM 2.5). Stacionet për monitorim janë pjesë e përkrahjes teknike të projektit të IPA programit 2008 "Përforcimi i kapaciteteve në nivel lokal dhe qendror për menaxhimin e mjedisit jetësor". Në kuadër të projektit të njëjtë u siguroa softuer AIRVIRO për menaxhimin me të dhënat për kualitetin e ajrit, me qëllim të vendosjes së sistemit informativ për kualitetin e ajrit. Njëkohësisht u përgatit plan për matje indikative dhe në pajtim me të njëjtin filloi me matjet indikative të bashkëdyzimeve të avullueshme organike (VOS) në dy vende për matje. Analizat e ekzemplareve të marrë bëhen në Institutin meteorologjik të finlandez.

Në vitin 2011 u finalizua CORINAIR inventari me të dhëna për vitin 2009 dhe i njëjti u dërgua tek UNECE dhe tek Agjencia evropiane për mjedisin jetësor.

Përfaqësuesit nga Seksioni për analitikë dhe njoftim në sferën e cilësisë dhe emisioneve në ajrin dhe Seksioni për monitorimin e kualitetit të ajrit nga QIMMJ morën pjesë në më shumë mbledhje pune dhe seminare me qëllim të transponimit dhe implementimit të BE masave për përmirësimin e kualitetit të ajrit.

Në kuadër të tuining projektit të programit të IPA komponentit 1 për vitin 2008 u realizuan më shumë trajnime për realizimin e monitorimit të kualitetit të ajrit të ambientit me zbatimin e procedurave për kontroll të kualitetit, përpunimin e të dhënave të marrë nga monitorimi, modelimi dhe zbatimi i tyre për vlerësimin e kualitetit të ajrit, servisimin dhe mirëmbajtjen e stacioneve për monitorim për ajër, menaxhim me kualitetin dhe emisionet në ajër dhe realizimin e aktiviteteve për ndërmarrjen e masave për përmirësimin e kualitetit të ajrit dhe përgatitjen e plan-programeve aksionare për përmirësimin dhe mbrojtjen e kualitetit të ajrit të ambientit.

Në kuadër të fazës së dytë të "Projektit për ndihmë të vendeve të Ballkanit Perëndimor për ratifikimin dhe përgatitjen e planeve implementuese për tre protokolle të Konventës për bartje tejkufitare të aerodotësve të UNECE nga viti 1979 dhe atë: Protokollin për metale të rënda nga viti 1998, Protokollin për ndotës organik perzistent (POPC) nga viti 1998 dhe Protokollin për zvogëlimin e thartimit, eurotrofikimit dhe ozonit tokësor nga viti 1999", filloi përgatitja e Planit nacional për mbrojtjen e kualitetit të ajrit të ambientit, Planit nacional për reduksionin e emisioneve dhe përfundoi përpunimi i Inventarit për metale të rënda. Në muajin kusht 2011 u nënshkrua Memorandumi për bashkëpunim ndërmjet MMJPH dhe Ambasadës holandeze nga Beogradi, për realizimin e fazës së tretë nga projekti i lartpërmendur.

PRIORITETET AFATSHKURTRA KORNIZA JURIDIKE

Gjatë vitit 2012 do të përgatiten ndryshime dhe plotësime të akteve ekzistuese nënligjore: Rregullore për kritere, metoda dhe procedura për vlerësimin e kualitetit të ajrit të ambientit dhe Rregullorja për vlerat kufitare për nivelet dhe llojet e substancave ndotëse në ajrin e ambientit dhe pragjet e alarmimit, afatet për arritjen e vlerave tejkufitare, margjinat e tolerancës për vlerë kufitare, vlerë qëllimore dhe qëllime afatgjate me qëllim të zhvendosjes së BE masave 32008L0050 dhe 32004L017, ndërsa në mënyrë plotësuese do të përgatitet akt nënligjor me të cilat do të caktohen masat kundër emisionit të substancave të gazta dhe të ngurta nga motorët me djegie brendshme të mjeteve që nuk janë për udhëtim, në pajtim me BE masën 31997L0068.

Ministria e Ekonomisë do të miratojë Rregullore për kualitetin e karburanteve lëngëzore, në pajtim me ligjin e ri për energjetikë. Rregullorja e re është fokusuar në azhurnimin dhe përmirësimin e transponimit të BE masave 31999L0032, 31998L0070, 32003L0030 të cilat kanë të bëjnë me kualitetin e benzinës, diselit dhe biokarburanteve, përpunimin dhe implementimin e sistemit për analizë dhe kontroll të rregullt të cilësisë së karburanteve lëngëzore.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Do të përpunohet Programi për punën e Mbikëqyrjes automatike Shtetërore sistem për kualitetin e ajrit të ambientit për vitin 2013. Në këtë periudhë do të sigurohet përforcimi i kapacitetit të organeve të cilat kryejnë mbikëqyrjen e ajrit përmes punësimit të kuadrit të ri dhe zbatimit të trajnimeve.

Si aktivitet në vazhdimësi i MMJPH do të vazhdohet me mirëmbajtjen e rregullt të rrjetit mbikëqyrës për ajrin të cilin e menaxhon MMJPH-ja. Gjatë vitit 2012 do të kryhen edhe matje plotësuese indikative të bashkëdyzime organike të avullueshme në dy vende matëse (në Shkup, në vendin matës rektorat dhe në Milladinovcë, në afërsi të rafinerisë OKTA).

Gjatë vitit 2012 do të finalizohet përpunimi i Planit Financiar për reduktimin e emisioneve me çka do të implementohet një pjesë e direktivës 32001L0081 dhe 32001L0080 me çka do të përcaktohen e projekcionet për sasi të substancave ndotëse në ajër për periudhën 2010-2020. Gjithashtu do kryhet përgatitja edhe e Planit Nacional për mbrojtjen e ajrit të ambientit që del nga Ligji për kualitetin e ajrit të ambientit me çka do të definohen masat tjera të ardhshme për përmirësimin e kualitetit të ajrit të ambientit dhe për minimizimin ose mënjanimin e përgjithshëm të efekteve negative ndaj kualitetit të ajrit të ambientit në zonat dhe aglomacionin në Republikën e Maqedonisë.

Në suaza të tvinging projektit të programit të komponentës IPA 1 për vitin 2008 do të përfordohen kapacitetet e administratës së nivelit lokal dhe qendror përmes zbatimit të trajnimeve edhe të për: zbatimin e monitorimit të kualitetit të ajrit të ambientit me zbatimin e procedurave për kontrollin e kualitetit, përpunimin e të dhënave të fituara nga mbikëqyrja, modelimin e zbatimit të tyre për vlerësimin e kualitetit të ajrit, servisimin dhe mirëmbajtjen e stacioneve për mbikëqyrje të ajrit, menaxhim me kualitetin e emisioneve në ajër si dhe kryerjen e aktiviteteve për ndërmarrjen e masave për përmirësimin e kualitetit të ajrit dhe përgatitjen e planeve dhe programeve aksionare për përmirësim dhe për mbrojtjen e kualitetit të ajrit të ambientit.

Inventari CORONAIR me të dhëna do të revidohet edhe në gjysmën e parë të shkurtit 2012, ndërsa të dhënat do të dorëzohen në Agjencinë Evropiane për Mjedisin Jetësorë dhe të UNECE-së.

Në suaza të kampanjave të rregullta të cilat i zbaton MMJPH-ja, do të përfshihen edhe aktivitete të cilat do të drejtohen drejt ngritjes së vetëdijes publike për përmirësimin e kualitetit të ajrit të ambientit, përmes përgatitjes së broshurave dhe materialeve promovuese për kualitetin e ajrit.

Në këtë periudhë do të vendoset sistem për përcjelljen e kualitetit të derivateve të lëngshme që do të kryhet në bazë të planit vjetor për kontrollin e kualitetit të derivateve të lëngshme të lëshuara në tregun e Republikës së Maqedonisë që do të miratohet nga ane e ME-së.

Për plotësimin e aktiviteteve të planifikuara do të realizohen punësime të reja në Seksionin për Mbikëqyrjen e kualitetit të ambientit të ajrit gjatë MMJPH-së.

PRIORITETET AFATMESME KORNIZA JURIDIKE

Gjatë periudhës 2013-2014 do të vazhdohet me miratimin ose me ndryshimin e akteve ekzistuese të reja nënligjore për emisione në ajër.

Për zbatim adekuat të shfrytëzimit të drejtë të Rregullores për vlerat kufitare për nivelet e lejuara të emisioneve dhe llojeve për të substancave ndotëse në gazrat e hedhurinave dhe avujve të cilat i emitojnë burimet stacionuese në ajër dhe rregulloren për metodologjinë, mënyrat, procedurat, metodat dhe mjetet për matjen e emisioneve nga burimet stacionuese, do të përgatitet Udhëzim në suaza të projektit tvinging të programit të komponentës IPA 1 për vitin 2008.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Në seksionin për atmosferë pranë DMJ-së duhet të fillojnë aktivitete për vendosjen e Sistemit Nacional për inventarizim me të cilin do të kryhet inventarizimi i emisioneve vjetore nga të gjithë substancat ndotëse në nivel nacional. Njëkohësisht inventarizimi do të kryhet në pajtim me nomenklaturat dhe me metodologjitë e CLRTAP, UNFCCC dhe me Konventën për mbrojtjen e mbështjellësit të ozonit dhe me të gjithë substancat me domethënie nacionale. Njëkohësisht, do të përmirësohet kapaciteti i MMJPH-së përmes punësimit të kuadrit të ri dhe zbatimit të trajnimeve.

Përfordcimi i kapacitetit të administratës me qëllim të përmirësimit në menaxhimin me kualitetin e ajrit do të jetë një nga aktivitetet të cilëve do tu përkushtohet kujdes edhe në këtë periudhë. Në këto aktivitete janë përfshirë punësime të reja dhe trajnime të të punësuarve në MMJPH-në në Seksionin për Mbikëqyrje të kualitetit të ajrit pranë MIZHC-së dhe Ministrisë së Ekonomisë në Seksionin për derivate të lëngshme dhe të ngurta pranë Sektorit për energjetikë. Planifikohen trajnime për kryerjen e aktiviteteve për ndërmarrjen e masave për përmirësimin e kualitetit të ajrit, për zbatimin e mbikëqyrjes Një pjesë e trajnimeve do të zbatohen në suaza të tvinging projektit dhe në to do të përfshihen edhe NJVL.

Do të vazhdohet me mbindërtimin e rrjetit për mbikëqyrje të kualitetit të ambientit të ajrit përmes mirëmbajtjes së rregullt të stacioneve ekzistuese për mbikëqyrje dhe zgjerimin e rrjetit me vendosjen e stacioneve të reja automatike për mbikëqyrje. Do të përgatitet Program për punën e Rrjetit Shtetërorë për mbikëqyrjen e mjedisit jetësorë ku do të përfshihen rrjeti i kualitetit të ajrit. Pas kryerjes së përgatitjeve në suaza të tvinging projektit planifikohet akreditimi i laboratorisë për kalibrimin e instrumenteve të sistemit automatik të mbikëqyrjes për kualitetin e ajrit për vitin 2014.

Do të fillohet me ndërmarrjen e masave për akreditimin e laboratorisë së pavarur të cilën do ta përcjellë dhe do ta hulumtojë kualitetin e derivateve në pajtim me Ligjin për sigurinë e prodhimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 33/2006 dhe 63/2007). Zbatimi i planit vjetorë për kontrollin e kualitetit të derivateve të lëngshme të lëshuara në tregun e Republikës së Maqedonisë do të paraqesë bazë për përgatitjen e raporteve mujore dhe vjetore për sasi të derivateve të lëngshme dhe për kualitetin e tyre të cilat përdoren në Republikën e Maqedonisë.

Raportet do të dorëzohen te Ministria e Ekonomisë dhe te MMJPH-ja, me qëllim të përpunimit të mëtejshëm të të dhënave.

Në pajtim me dokumentet e miratuara të planit nga sfera e ajrit (Plani nacional për mbrojtjen e ajrit të ambientit, Plani nacional për emisione në ajër, dhe planet për implementimin e konventës LRTAB), do të sigurohet përfundim institucional i DMJ-së me qëllim të përcjelljes së implementimit të të njëjtave.

3.27.3 MENAXHIMI ME HEDHURINAT

GJENDJA RRJEDHËSE

KORNIZA JURIDIKE

Më vitin 2011 u miratua Ligji për menaxhim me hedhurinat e pajisjes elektrike dhe elektronike me të cilin transponohen masat e BE-së: 32002L0096 dhe 32002L0095.

Gjithashtu në bazë të Ligjit për menaxhim me bateritë dhe akumulatorët dhe me bateri dhe akumulatorë të hedhur janë miratuar këto akte nënligjore:

- Rregullore për mënyrën e shënimit të baterive dhe akumulatorëve dhe të paketimeve të baterive, si formën dhe përmbajtjen e simboleve për grumbullime të posaçme edhe të metaleve të rënda. ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 52 /2011)

- Rregullore për mënyrën e mbajtjes si dhe formën dhe përmbajtjen e formularëve të bazës së të dhënave për përcjelljen e përdorimit të sërishëm dhe përpunimin e automjeteve të përdorura dhe të qëllimeve që duhet të arrihen me përdorimin e sërishëm dhe përpunimin e automjeteve të shfrytëzuara ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 74/2011).

- Rregullore për metodologjinë për mënyrën e përcjelljes së llogaritjes së realizimit të shkallëve për grumbullimin e baterive të hedhura dhe të akumulatorëve si dhe për formën dhe përmbajtjen e formularit për përcjelljen e llogaritjes ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 67/11)

- Rregullore për formën dhe përmbajtjen e formularit të raportit vjetor për veprim me bateritë e hedhura dhe akumulatorët dhe mënyrën e dorëzimit të tyre, si dhe për formën dhe përmbajtjen e formularit për mbajtjen e evidencës për sasi të dhe për llojet e baterive dhe akumulatorëve të cilët nuk janë lëshuar në tregun e Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 167/10).

- Rregullore për mënyrën dhe kushtet për tejkalimin e përmbajtjes së metaleve të rënda në paketim, për mënyrën e mbajtjes së paketimeve dhe përmbajtjen e evidencës dhe raportin për veprim me hedhurinat e paketuara ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 78/11).

KORNIZA INSTITUCIONALE

Në pajtim me Ligjin për menaxhim me hedhurina ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 68/2004, 107/2007, 102/2008, 143/2008 dhe 124/2010), MMJPH, DMJ dhe DIZHS janë organe përgjegjëse në nivel nacional për zbatimin e vet. Përgjegjësi të veta kanë edhe Ministria e Shëndetësisë (Inspektorati Shtetërorë Sanitar dhe Shëndetësorë) në lidhje me kontrollin e hedhurinave mjekësore, Ministria e Ekonomisë dhe Inspektorati Shtetërorë i Tregut në lidhje me hedhurinat nga gërmimet e lëndëve të para minerale dhe kontrollin e shënimeve të paketimit të baterive që janë lëshuar në tregun e RM-së.

Njësitë e Vetadministrimit Lokal (NJVL), inspektorët e autorizuar për mjedisin jetësorë dhe inspektorët komunal janë kompetent dhe përgjegjës për menaxhimin me hedhurinat komunale dhe të llojeve të tjera të hedhurinave të pa rrezikshme dhe për pastërtinë publike në nivel lokal.

Më vitin 2011 Komisioni për dhënien e provimit profesional për kryerjen e punëve të menaxhuesit me hedhurinat, zbatoi provim për menaxhues me hedhurinat, me çka ka dhënë gjithsej 33 vërtetime për menaxhues me hedhurinat.

Me përkrahjen e Republikës së Sllovenisë, më vitin 2011 u miratua plan me studimin fizibilitet për vendosjen e sistemit për menaxhim me hedhurinat e pajisjeve elektrike dhe elektronike dhe menaxhimin me bateritë dhe me akumulatorët e hedhur në Republikën e Maqedonisë.

Vazhdoi aktiviteti për lëshimin e lejeve nga sfera e menaxhimit me hedhurinat për lëshimin e të cilave është kompetente DMJ-ja. Gjithashtu, është vendosur sistem për regjistrimin e prodhimeve që lëshojnë në tregun e RM-së bateri dhe akumulatorë dhe janë lëshuar katër vërtetime për regjistrim në regjistrin e prodhuesve të cilët lëshojnë në treg ose importojnë si shfrytëzues përfundimtar bateri dhe akumulatorë në RM-së.

Në pajtim me Ligjin për menaxhim me paketimin e hedhurinave nga paketimi, është formuar Komision për Menaxhim me hedhurinat nga paketimi, (Gazeta Zyrtare nr. 112/11), është miratuar program për menaxhim me hedhurinat e paketimit dhe është lëshuar një leje për person juridik për menaxhim me paketimin dhe me hedhurinat nga paketimi. Më vitin 2011 në mënyrë të vazhdueshme zhvillohej faza e tretë e procesit për azhurnim dhe plotësimi i bazës së Kadastrit të krijuesve të hedhurinave dhe mbindërtimin e softuerit për aplikimin e të dhënave në kadastrën për hedhurina. Pikërisht baza elektronike plotësohet dhe azhurnohet me të dhënat e marra nga pyetësorët e shpërndarë te subjektet e identifikuar, kontrollin e të dhënave dhe matjet sipas nevojës.

Më vitin 2011 rrodhën aktivitetet në suaza të projekteve vijuese:

"Ndërtimi i kapaciteteve për implementimin e direktivës së BE-së për deponi - mbylljen e deponive të pa lejuara dhe inspektim", i përkrahur nga Mbretëria SuedBEe dhe i implementuar përmes Agjencisë SuedBEe për mjedis jetësorë (SEPA) - është realizuar vizitë studiuese me përfaqësuesit e DIZHS-së dhe me përfaqësuesit e Rajonit Lindor dhe Verilindor dhe është përgatitur propozim tekst për programin për mbylljen e deponive të cilat nuk janë në pajtim me kërkesat e direktivave të Be-së për deponi si dhe lista për kontrollin e inspektorëve.

Në suaza të projektit për përpunimin e Planit dhe studimit për realizim për veprim dhe zvogëlimin e sasive të hedhurinave bioshpërndarëse, që filloi në dhjetor 2010, i financuar përmes Qeverisë së Mbretërisë së Holandës nga programi G2G, është prBEantuar versioni i parë i studimit për realizim të përgatitur në suaza të këtij projekti dhe është realizuar vizitë studimi;

Në suaza të projektit "Përforcimi i kapaciteteve të nivelit qendror dhe lokal për implementimin dhe zbatimin e legjislativës nga sfera për menaxhimin me hedhurinat dhe ISKZ-së", në suaza të programit IPA komponenta 1 për vitin 2008, u mbajtën punëtori rajonale, me qëllim të njoftimit me qasjen e integruar për menaxhim me hedhurinat në shtetet e BE-së (për rajonin Lindor dhe Verilindor të RM-së), dhe u zbatua: vlerësimi dhe grumbullimi i informatave ekzistuese në lidhje me menaxhimin me hedhurinat; revidimi i rregullativës ligjore në pjesën e hedhurinave dhe në pajtim me kërkesat e BE-së; përforcimi i kapaciteteve për implementimin e legjislativës; përforcimi i koordinimit përmes nivelit lokal, rajonal dhe qendror; u përpunua model i Planit Lokal për menaxhim me hedhurinat; përkrahje e trupave rajonale për menaxhim me hedhurinat; zhvillimi dhe implementimi i programit për të gjithë subjektet e involvuara; përgatitja e vetëdijes publike dhe zhvillimi i pilotit për sistemin për informim;

Në suaza të projektit për "Mënjanimin e bifenile të polokloruara (BPK) dhe pajisje të kontaminuar me BPK", të financuar nga fondi Global për mjedis jetësorë (GEF), i cili implementohet së bashku me UNIDO, më vitin 2011 u shpall tender ndërkombëtar për furnizimin e teknologjisë për tretman të BPK-pajisjes dhe u zgjodh teknologji për tretman të BPK pajisjes. Në suaza të projektit definohet orari sipas së cilit do të kryhet dekontaminimi i BPK pajisjes.

Në pjesën e rritjes së nivelit të investimeve vendosjes së sistemit për menaxhim të integruar me hedhurina u realizuan këto aktivitete:

Përfundoi faza e dytë e thirrjes publike për dialog konkurrues nr. 2 për plotësimin e koncesionit për financim, projektim, ndërtim dhe menaxhim me deponinë rajonale për hedhurinë të fortë rajonale në rajonin Juglindor.

Përfundoi faza e dytë e thirrjes publike për dialog konkurrues për ndarjen e koncesionit për financim, projektim, ndërtim dhe menaxhim me deponinë rajonale për hedhurinë të fortë rajonale në rajonin e Pollogut

Në pjesën për menaxhim me hedhurinat, MMJPH ndau 4.680.000,00 denarë për projektet për edukim dhe ngritjes së vetëdijet publike të Organizatave Joqeveritare në Republikën e Maqedonisë, në bazë të konkursit të shpallur sipas Programit për investim në mjedisin jetësorë për vitin 2011.

Kapacitetet administrative të Ministrisë së Mjedisit Jetësorë dhe Planifikim Hapësinorë në pjesën e menaxhimit me hedhurina u përforcuan përmes pjesëmarrjes në më shumë seminare dhe udhëtime studiuese. U mbajtën trajnime të shumta dhe punëtori për menaxhim me hedhurinat, një pjesë janë të organizuara me përkrahje të TAIEX dhe IFC-së, një pjesë në suaza të projekteve bilaterale që realizohen në MMJPH-në. Njëkohësisht, MMJPH-ja organizoi disa trajnime për NJVL dhe për ndërmarrjet Publike Komunale, si dhe për biznes sektorin në odat ekonomike në Maqedoni, me qëllim të sigurimit të zbatimit më të mirë të Ligjit për menaxhim me paketimin dhe me hedhurinat nga paketimi dhe të ligjit për menaxhim me bateritë dhe akumulatorët dhe hedhurinave të baterive dhe akumulatorëve. Gjithashtu u mbajt edhe punëtori për OJQ me temë "Legjislativë Nacional në pjesën e menaxhimit me hedhurinat". Është mbajtur edhe Konferenca e dytë ndërkombëtare për menaxhim me hedhurinat me temë "Menaxhim i qëndrueshëm me materialet - arsyetim ekonomik

në veprimin me hedhurinat", në organizim të MMJPH-së, ADKOM-së dhe JKP-së "Higjiena Komunale" Shkup.

PRIORITETET AFATSHKURTA KORNIZA JURIDIKE

Në këtë periudhë do të kryhet harmonizim i mëtejshëm i legjislativës nacionale me të drejtën e BE-së në pjesën e rrjedhjeve të posaçme të hedhurinave me përgatitjen dhe miratimin e Ligjit për menaxhim me hedhurinat nga lëndët e para minerale, me çka do të transponohet masa e BE-së 32006L0021.

Më vitin 2012 do të bëhen ndryshime dhe plotësime të Ligjit për menaxhim me hedhurinat me qëllim për vendosjen e bazës juridike për formimin e trupave rajonal për menaxhim me hedhurinat.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Aktivitetet më të rëndësishme në këtë periudhë do të jenë implementimi i menaxhimit rajonal të integruar me hedhurinat në rajonet tjera të planit në Republikën e Maqedonisë (Rajoni i Vardarit, i Pellagonisë dhe i Shkupit).

Në këtë periudhë do të përforcohen kapacitetet dhe implementimi i Ligjit për menaxhim me paketimin dhe hedhurinat nga paketimi dhe Ligji për menaxhim me bateritë dhe akumulatorët dhe hedhurinat e baterive dhe akumulatorëve për nivelin qendror dhe lokal si dhe për bashkësinë e biznesit përmes mbajtjes së punëtorive dhe trajnimeve.

Do të realizohet ndarja e koncesioneve për financim, projektim, ndërtim dhe menaxhim me deponinë rajonale për hedhurinat e forta komunale në rajonin e Juglindjes dhe në rajonin e Pollogut.

Njëkohësisht do të përforcohen kapacitetet e Sektorit për hedhurina pranë DMJ-së me punësime të reja dhe zbatimi i trajnimeve për menaxhim me hedhurinat. Deri në fund të vitit 2012 do të miratohet Programi për menaxhim me deponitë e pa rregullta si pjesë e projektit "Programi për mbylljen e deponive ilegale dhe përforcimi i kapaciteteve të DIZHS-së në sferën e mbikëqyrjes inspektuese mbi deponitë" i financuar nga Agjencia Suedeze për mjedis jetësorë. Gjithashtu, deri në mesin e vitit 2012 do të përgatitet Studim për realizim dhe Program për zvogëlimin e sasive të hedhurinave biozbërthyesë të deponive si pjesë e projektit "Plan dhe studim për realizim për veprimin dhe zvogëlimin e sasive të hedhurinave biozbërthyesë të deponive" i financuar nga Qeveria e Mbretërisë HolandBEe në suaza të programit G2G.

Në këtë periudhë do të vazhdojë procedura për bisedime me kërkesat tjera për marrjen e lejeve për harmonizim me planin operativ të deponive ekzistuese në Republikën e Maqedonisë.

Lëshimi i lejeve për veprim me hedhurinat në pajtim me kërkesat e arritura do të vazhdojë, mbajtja e regjistrave në pajtim me procedurën ligjore si dhe aktivitetet për azhurnim dhe mosplotësimin e bazës së Kadastrit të krijuesve të hedhurinave. Gjithashtu do të zhvillohet sistemi informativ për menaxhim me hedhurinat (përpunimi i aplikimit të softuerit për menaxhim me bazën e të dhënave për hedhurina).

Do të fillojë të realizohet projekti "Vendosja e sistemit financiar të vetëmbajtur të integruar për menaxhim me hedhurinat" në suaza të IPA komponenti 3 Masa 3.2 nga Programi operativ për zhvillim rajonal (POZHR) 2007-2009 përmes përpunimit të planeve rajonale për menaxhim me hedhurinat dhe studime për vlerësim strategjik të ndikimit mbi mjedisin jetësorë për rajonin Lindor dhe Verilindor.

Në suaza të projektit "Përforcimi i kapaciteteve të nivelit qendror dhe lokal për implementimin e zbatimit të legjislationit nga sfera e menaxhimit me hedhurina dhe ISKZ" - IPA komponenti 1 për vitin 2008, do të përfundojnë vlerësimet e kapaciteteve institucionale për menaxhim me hedhurinat dhe mekanizmat për koordinimin e menaxhimit me hedhurina në nivelin qendror dhe lokal, do të zhvillohen dhe do të implementohen plane për trajnime dhe do të realizohet vizitë studimi në Irlandë. Gjithashtu, do të zhvillohet sistemi informativ për menaxhim me hedhurinat (përpunimi i aplikimit të softuerit për menaxhim me bazën e të dhënave për hedhurina).

Në suaza të projektit "Zgjedhja e teknologjisë për tretman të PHB-pajisjes" do të ndërtohet përkohësisht magazinim për PHB-në.

Më vitin 2012 do të fillojë edhe Projekti Pilot për eliminimin e 10 ton HCH hedhurinave dhe hedhurinës së kontaminuar me zhivë nga OXIS, Projekti do të financohet nga kompanitë K+S -

Gjermani, SETCAR - Romani dhe K+S Entsorgung GmbH – Gjermani, ndërsa institucione përgjegjëse janë Ohis dhe MMJPH.

PRIORITETET AFATMESME KORNIZA JURIDIKE

Deri në fund të vitit 2013, në bazë të Ligjit për menaxhim me hedhurina nga pajisjet elektrike dhe elektronike do të miratohen këto akte nënligjore:

- Lista e prodhimeve të cilat i takojnë kategorisë së pajisjes elektrike dhe elektronike të harmonizuar me BE-masën 32002L096 (Aneks 1);
- Lista e pajisjeve në të cilën nuk kanë të bëjnë masat për ndalimin e kufizimit si dhe vlerat maksimale për koncentrimet e substancave të rrezikshme, afatet deri kur është e lejuar prezenca e substancave të caktuara në pajisjen pjesët dhe materialet e sajë përbërës të harmonizuar me masën e BE-së 32010D0571;
- Rregullore për formën dhe përmbajtjen e shënimit të grumbullimit të caktuar të Harmonizuar me masën e BE-së 32002L096 (Aneks 4);
- Rregullore për kërkesat minimale për tretman të dyfishuar të pajisjes së hedhurinave, materialeve dhe pjesëve të pajisjes së hedhurinave, si dhe kushtet minimale teknike për magazinimin e tretmanit të pajisjes së hedhurinave të Harmonizuar me masën e BE-së 32002L096 (Aneks 3);
- Rregullore për formën dhe përmbajtjen e formularit për raportin or për veprimin me pajisjen e hedhurinave të harmonizuar me masën e BE-së 32005D0369.

Deri më 31 dhjetor 2014, do të përgatitet Ligj i ri për menaxhim me hedhurina i cili do ta transponojë masën e BE-së 32008L098.

Gjithashtu deri më vitin 2014 do të përcaktohen llojet e hedhurinave, kushtet për eksport, import dhe transit të hedhurinave të llojeve të caktuara të hedhurinave, metodat për mbikëqyrje mbi eksportin, importin dhe transitin e hedhurinave, si dhe formën dhe përmbajtjen e formularit të lejes për eksport, import dhe transit të hedhurinave me çka do të kryhet transponomi i BE masës 32006R1013.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Për përcaktimin e politikave në menaxhimin e rrjedhjeve të veçanta të hedhurinave, në këtë periudhë do të përpunohet Plan me fizibilitet studim për vendosjen e sistemit për menaxhim me mjetet e përdorura dhe sistem të lidhur me verifikimin dhe regjistrimin dhe asgjësimin.

Do të kompletohet azhurnimi dhe plotësimi i bazës së Kadastrit të krijuesve të hedhurinave. Kontrolli dhe lëshimi i lejeve për veprim me hedhurinat në pajtim me kërkesat e arritura dhe gjendjen në teren do të vazhdojë edhe në këtë periudhë. Gjithashtu do të vazhdojë edhe regjistrimi i prodhuesve të cilët lëshojnë në tregun e RM-së bateri dhe akumulatorë.

Në mënyrë afatmesme planifikohet përforcimi i kapaciteteve të DMJ-së me punësime të reja dhe trajnime në menaxhimin e hedhurinave.

Do të vazhdojë përkrahja e NJVL-së përmes trajnimeve për menaxhim me hedhurinat e nivelit rajonal dhe implementimin e rregullativës ligjore, veçanërisht në lidhje me implementimin e Ligjit për menaxhim me paketimin dhe hedhurinat nga paketimi, Ligji për menaxhim me bateritë dhe akumulatorët dhe hedhurinat e baterive dhe akumulatorëve dhe Ligji për menaxhim me hedhurinat e pajisjes elektrike dhe elektronike.

Gjithashtu do të vazhdojë përkrahja e NJVL-së në Republikën e Maqedonisë për Realizimin e projektit nga sfera e menaxhimit të integruar me hedhurinat, para së gjithash në pjesën e përpunimit të studimit fizibilitet, dokumentacionit teknik dhe ndërtimin e deponive rajonale për menaxhim me hedhurinat përmes IPA programit, përmes Programit Vjetor për investim në mjedisin jetësorë dhe në programet e MMJPH-së në suaza të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë.

Njëkohësisht, deri në fund të vitit 2014 do të formohen trupa rajonale për menaxhim me hedhurinat për çdo rajon dhe deri në fund të vitit 2014 do të formohet trupi rregullator për punë komunale.

Do të vendoset menaxhim rajonal me hedhurina dhe do të miratohen plane rajonale për menaxhim me hedhurinat për rajonin Lindor dhe Verilindor, të shoqëruara me Studime për vlerësim strategjik të këtyre dokumenteve të planit. Gjithashtu do të vazhdojë procedura e ndërtimit të pjesëve rajonale në rajonin e Pollogut dhe në rajonin Juglindor.

Më vitin 2013 do të miratohet Studimi për realizim për menaxhim me hedhurinat e rrBEikshme, që do të përgatitet në suaza të projektit "Përforcimi i kapaciteteve të MMJPH-së për kontroll të integruar të ndotjes dhe menaxhim me hedhurinat e rrBEikshme" i realizuar nga Mbretëria e Norvegjisë dhe MMJPH-ja.

3.27.4 KUALITETI I UJIT

GJENDJA RRJEDHËSE

KORNIZA JURIDIKE

Më vitin 2011 u përpunuan 12 akte nënligjore që dalin nga Ligji për ujërat. Me këto akte nënligjore rregullohen kushtet më të afërta për grumbullim, derdhjen dhe pastrimin e ujërave të zBEa urbane, mënyra dhe kushtet e projektimit, ndërtimi dhe eksploatimi i sistemeve dhe standardeve për pastrimin e ujërave të zeza urbane, vlerat e lejuara maksimale dhe koncentrimet e parametrave të ujërave të zeza urbane të pastruara për shfrytëzimin e tyre të sërishëm, mënyra dhe procedura e shfrytëzimit të lymorit, vlerat maksimale të koncentrimëve të metaleve të rënda në truallin në të cilin shfrytëzohet lymori, forma, përmbajtja dhe mënyra e dorëzimit të të dhënave dhe lloji i informatave për shfrytëzimin e lymorit, si dhe vlerat kufitare të emisionit për lëshimin e ujërave të zeza pas pastrimit të tyre. Në këto akte nënligjore janë transponuar masat e BE-së: 31991L0271 dhe 31986L0278. Gjithashtu me rregulloret përcaktohen kushtet, mënyra dhe vlerat kufitare të lëshimit të ujërave të zeza pas pastrimit të tyre, do të përcaktohen materiet e dëmshme dhe substancat dhe standardet e tyre të emisionit dhe të caktohen kufijtë e rajonit të derdhjes së lumenjve. Do të bëhet edhe listë e materieve dhe substancave ndotëse, kushtet për instalim dhe punë të instalimeve që punojnë me materie dhe substanca të rrezikshme dhe mënyra e testimit të tyre para lëshimit në punë. Një pjesë e këtyre akteve nënligjore janë përpunuar nga ana e MMJPH-së me mjete të siguruara nga fondi i kompensimit të ndihmës së huaj të Zvicrës.

Është formuar grup punuese nga MMJPH-ja, UHMP-ja dhe MPJ-ja me qëllim të përcaktimit të kufijve të rajoneve të derdhjes së lumenjve.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Nga 01.01.2011 u fillua me implementimin e Ligjit për ujëra, me të cilin kompetencat për menaxhim me ujërat kaluan në MMJPH-në. Sektori për ujëra në Drejtorinë e Mjedisit Jetësorë (DMJ) i ndërmori obligimet të cilat dalin nga ligji.

Në pajtim me Ligjin për ujëra Fondi për ujëra pushoi së punuari në përfundim me 01.01.2011, me çka Drejtoria për Mjedis Jetësorë i merr të punësuarit nga Fondi. Me qëllim të formimit të trupave për menaxhim me ujërat nëpër derdhjet e lumenjve si njësi të organizuara për arritjen e qasjes së integruar në shfrytëzimin e ujërave, në Sektorin për ujëra në DMJ-në u formuan 6 seksione të veçanta edhe atë: Seksioni për planifikim në menaxhimin me ujërat, Seksioni për të drejtat e ujërave, Seksioni për koncesione dhe bashkëpunim ndërresorjal, Seksioni për menaxhim me derdhjen rajonale tl lumit Vardar, Seksioni për menaxhim me derdhjen rajonale të lumit Drini i Zi dhe Seksioni për menaxhim me derdhjen rajonale të lumit Strumicë.

Me përkrahje të pjesshme të Republikës së Sllovenisë, është përpunuar Strategjia Nacionale për ujëra. Për Strategjinë u përpunua edhe Raport për vlerësim strategjik dhe u mbajtën tre debate publike edhe atë për sektorin joqeveritar, për sektorin ekonomik dhe për institucionet shkencore.

Përfundoi Projekti "Implementimi i Ligjit për ujëra" që zbatohet me mjete nga mdihma teknike e Gjermanisë (NTGJ). Në suaza të Projektit u mbajtën më shumë punëtori dhe vende pune nga ana e ekspertëve të huaj me qëllim të zbatimit të trajnimit dhe bartjes së diturive në pjesën e implementimit të Ligjit për ujëra të nëpunësve shtetërorë.

U përpunua dokumentacion teknik në suaza të projektit "Ndërtimi i mureve mbrojtëse në lumin e Vardarit" i cili ishte vazhdim i projektit regjimi hidrologjik i lumit Vardar për shtratin e lumit nëpër luginën e Shkupit.

Më vitin 2011 vazhduan aktivitetet për projektin për "Ndërtimin e stacionit për pastrim Prilep për ujëra të zeza dhe rekonstruimi dhe mbindërtimi i një pjese të rrjetit të kanalizimit - Prilep", i financuar nga BE Programi IPA - Komponenti 3 dhe u nënshkrua marrëveshje për realizimin e projektit. Më vitin 2011 vazhdoi Projekti për ndërtimin e stacionit për pastrim për ujëra të zBEa në Vollkovë, komuna Gjoçe Petrov - Shkup me çka u realizuan rreth 80% të punëve ndërtimore. Gjithashtu ka filluar ndërtimi i stacionit për pastrim në komunën Saraj për vendet e banuara Gllumovë dhe Shishevë.

Në gjysmën e parë të vitit 2011 u nënshkrua marrëveshje për realizimin e projektit: "Projektimi dhe ndërtimi i stacionit të filtrimit të sistemit për furnizim me ujë në Gostivar" përmes MMJPH-së, komuna e Gostivarit dhe JKP "Komunalec" Gostivar, i cili është shfrytëzues përfundimtar i projektit investues. Në këtë mënyrë do të zgjidhet problemi me sigurimin e ujit kualitativ për pije për rreth 65.000 banorë.

Te Agjencia Evropiane për mjedis jetësorë (EEA) janë dërguar të dhëna vjetore për kualitetin e lumenjve, liqeneve dhe për ujërat nëntokësore në Republikën e Maqedonisë dhe të dhëna për sasinë dhe për shfrytëzimin e ujërave dhe kualitetin e ujërave të zeza.

Në suaza të projektit "Menaxhimi i integruar me eko sistemin në derdhjen e Liqenit të Prespës në Shqipëri, Maqedoni dhe Greqi", të përkrahur nga GEF dhe UNDP-ja, në këtë periudhë u finalizua Plani për menaxhim me derdhjen e liqenit të Prespës, për çka u bënë hulumtime studimore dhe monitorim të ujërave në liqenin e Prespës dhe të ujërave që derdhen në të njëjtin. Njëkohësisht u hartua Raport për vlerësimin strategjik të planit.

Edhe gjatë vitit të kaluar filloi të realizohet Projekti për implementimin e Direktivës për përmbytjet - Pilot projekti, me çka u bënë analiza me përmbytjet në rajonin e komunës së Radovishit, në suaza të së cilit do të hartohet Plan për menaxhim me përmbytjet në rajonin e komunës së Radovishit.

Më vitin 2011 përfundoi projekti "Siguria në sigurimin me ujë në Maqedoni përmes përforcimit të Ekonomisë së Ujëryve". Projekti u përkrah nga Banka Botërore, ndërsa implementimi i të njëjtit është nga ana e MMJPH, MZSHV, ML dhe SB. Qëllimi i projektit është që t'i ndihmohet Republikës së Maqedonisë që të arrihet siguri afatgjate në sektorin e ekonomisë së ujërave, në situatën e nevojës nga zhvillimi urgjent, rritja e kërkesës së ujit, ndryshimet klimatike dhe përkufizimet e shprehura të financimit privat dhe publik.

Stacioni për pastrimin e ujërave të zBEa të cilat janë të ndotura nga kromi gjashtvalent në Silmak, Jagunovca vazhdoi me punën e vet edhe në vitin 2011, me përkrahjen e MMJPH-së.

Gjatë vitit 2011 u vazhdua me projektin "Zhvillimi i sistemit tarifor nacional për furnizim, derdhje dhe tretmanin e ujërave të zBEa" nga Komponenta 3 masa 4.3 IPA. U shpall trend ndërkombëtar i cili është në fazën e zgjedhjes së kampanjës që do ta zbatojë projektin.

Më 18.04.2011 në Ohër u mbajt Konferencë Rajonale e Ministrisë e emëruar "Menaxhimi i integruar me derdhjet e lumenjve-platformë për këmbimin e përvojave". Në Konferencë ishin të pranishëm ministra dhe përfaqësues të lartë të një numri më të madh të shteteve të rajonit. Në konferencë u miratuan dy deklaratatë të përbashkëta: Deklaratë e përbashkët për menaxhim të integruar me derdhjet e lumenjve, si dhe Deklaratë për menaxhim me derdhjen më të gjerë të lumit Drin. Miratimi i deklaratave e tregon përgatitjen e një shteti të rajonit për bashkëpunim të përbashkët me qëllim për menaxhim të qëndrueshëm dhe të integruar në resurset e ujërave, si dhe bevoja e rajonit për financim të forcuar për zbatimin e obligimeve që dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare dhe rajonale, si dhe nga legjislati i BE-së.

Më 25.11.2011 në Tiranë u nënshkrua Memorandum për menaxhim të përbashkët me pishinën e Drinit ndërmjet Maqedonisë, Shqipërisë, Kosovës, Malit të Zi dhe Greqisë. Memorandumi është rBEultat i bashkëpunimit disa vjeçar të pesë shteteve rreth derdhjes së Drinit që i përfshin Liqenin e Ohrit, të Prespës dhe Liqenin e Skadarit dhe derdhjen e lumit të Drinit. Marrëveshja ka për qëllim që të sigurojë kornizë për bashkëpunim të shteteve për menaxhim të përbashkët me derdhjen e lumit Drini i Zi, realizimin e projektit, si dhe koordinim më të mirë të aktiviteteve të ndërsjella.

PRIORITETET AFATSHKURTA KORNIZA JURIDIKE

Në këtë periudhë do të vazhdohet me miratimin e akteve nënligjore që dalin nga Ligji për ujëra me çka do të sigurohet harmonizim i mëtejme me aktet juridike relevante të BE-së në sferën e ujërave. Njëkohësisht gjatë vitit 2012 do të miratohen aktet nënligjore me të cilat do të rregullohen kushtet, mënyra dhe procedura për përcaktimin e zonave të mbrojtura për ujë të dedikuar për konsumim nga ana e njeriut të cilat do të paraqiten në pasqyrën kartografike, si dhe kritere, qëllime për kualitetin e ujit për larje, si dhe rregullimin e formës dhe përmbajtjes së regjistrit të zonave të mbrojtura të trupave ujore të dedikuar për konsumim nga ana e njeriut, do të përcaktohet forma dhe përmbajta e regjistrit për zonat e mbrojtura të cilat janë të ndjeshme nga nitratat. Gjithashtu do të miratohen akte nënligjore me çka do të rregullohen kushtet e veçanta për lëshim të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të ujërave të zeza, do të përcaktohen kriteret për përcaktimin e zonave të ndjeshme nga nitratat, si dhe kritere për përcaktimin e zonave të ndjeshme nga lëshimi i ujërave të zBEa

urbane, si dhe mënyra e shënimit dhe e shfrytëzimit të zonave për notim. Me rregulloret do të rregullohen metodologjia dhe metodat referente, kushtet, mënyra dhe procedura për monitorim si dhe parametrat e kualitetit për ujë për larje, do të rregullohet mënyra e informimit të publikut për kualitetin e ujit për larje, mënyra dhe procedura për transmetimin e të dhënave të monitorimit për kualitetin e ujit për larje dhe konsumim nga ana e njeriut do të përcaktohet metodologjia dhe mënyra e përcaktimit të parametrave dhe metodave matëse referente të kualitetit dhe kualitetit të trupave ujore të shpallura si zona të ndjeshme në lidhje me derdhjen e ujërave të zeza urbane, si dhe të trupave ujore të cilat ranë rajone të mbrojtura si trashëgimi natyrore. Me aktet nënligjore do të transponohen kërkesat e drejtorisë kornizë për ujërat 2000/60/BE, Direktiva për kullimin dhe tretmanin e ujërave të zeza - 1991/271/BE, Direktiva për mbrojtjen e ujërave nga ndotja e shkaktuar nga nitratet nga burimet bujqësore - 1991/676/BE dhe Direktiva për kualitetin e ujit për larje - 1976/160/BE.

Do të miratohet Rregullimi për përcaktimin e kufijve të rajoneve të lumenjve e cila në mënyrë të drejtpërdrejtë na transponon BE masa, por është e rëndësishme për zbatimin e Ligjit për ujërat.

Do të fillojnë aktivitete me qëllim të sigurimit të mjeteve për përpunimin e Planeve për menaxhim me derdhjet e lumenjve në Republikën e Maqedonisë për Planin për menaxhim me derdhjen e lumit Vardar, Plan për menaxhim me derdhjen e lumit Drini i Zi, Plan për menaxhim me derdhjen e lumit Strumicë.

Në suaza të projektit "Menaxhim i integruar me eko sistemin në derdhjen e Lumit të Prespës në Shqipëri, Maqedoni dhe Greqi", të përkrahur nga GEF dhe UNDP-ja, në këtë periudhë do të miratohet Plani për menaxhim me pishinën e liqenit të Prespës.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Më vitin 2012 do të formohen Këshillat e menaxhimit me derdhjet e lumenjve në Republikën e Maqedonisë. Në lidhje me menaxhimin e integruar me eko sistemin në derdhjen e Liqenit të Prespës, do të vazhdohet me aktivitetet për realizimin e stacioneve të pastruara dhe zvogëlimin e ndotjes në Liqen dhe në derdhjet e tij.

Në suaza të projektit Ndërtimi i sistemit kolektor dhe stacioneve të pastruara Gjorçe Petrov dhe Saraj, do të përfundojë ndërtimi i stacionit për pastrim për ujërat e zeza në vendin e banuar Vollkovë, komuna Gjorçe Petrov dhe komunat Saraj (Grçec, Gllumovë, Shishevë, Matka e Poshtme, Matka e Epërme, Krushopek dhe Llaki).

Do të fillojë edhe realizimi i Projektit "Ndërtimi i mureve kaskave në lumin Vardar", me ndërtimin e mureve kaskave.

Gjithashtu do të vazhdojnë aktivitete nga Projekti "Përforcimi i kapaciteteve institucionale për aproksimim dhe implementim të legjisllacionit nga sfera e menaxhimit me ujërat - IPA 2009 komponenti 1. Me projektin është planifikuar përpunim i Planeve për menaxhim me derdhjen e lumit, si dhe hartimin e pilot planit për derdhje lumore që është derdhje në basenin e lumit Vardar (rajoni i derdhjes në lumin Treska). Me këtë projekt parashihet edhe vendosja e regjistrit për rajonet e mbrojtura për rrjedhën lumore të lumit Vardar. Do të bëhet mbindërtim dhe vendosje e piBEomtrave me qëllim të funksionimit të rrjetit të monitorimit të ujërave nëntokësore, si dhe mbindërtim dhe mirëmbajtje të rrjetit për monitorim të lumenjve.

Edhe në vitin 2012 do të vazhdojnë të rikonstruohen dhe të ndërtohen stacione të pastruara dhe objekte të tjera të financuara me buxhetin e MMJPH-së dhe MTL-së. Do të ndërmerren aktivitete me qëllim të përpunimit të dokumentacionit teknik për sistemet për tretman të ujërave të zBEa për disa rajone, analiza financiare dhe ekonomike, studime për OVZHS dhe projekte kryesore. Do të vazhdojnë aktivitetet për rindërtimin e sistemin për furnizim me ujë Zhelinë dhe ndërtimin e stacionit për pastrim në Gjevgjeli.

Në këtë periudhë do të miratohet plani për menaxhim me përmytjet në rajonin e komunës Radovish në suaza të projektit "Implementimi i Direktivës për përmytje" me përkrahje të Qeverisë së Belgjikës.

Do të vazhdohet me dorëzim të vazhdueshëm vjetor për të dhënat e përpunuara për kualitetin e ujërave në Republikën e Maqedonisë të EEA-ja.

Në këtë periudhë do të fillojë ndërtimi i stacionit për pastrim për në Prilep që zbatohet në suaza të projektit "Ndërtimi i stacionit për pastrim Prilep për ujërat e zeza dhe rekonstruimin dhe mbindërtimin e një pjese të rrjetit të kanalizimit - Prilep", i financuar nga BE Programi IPA - Komponenti 3.

Do të përpunohet studim për OVZHS për "Ndërtimin e Stacionit për pastrim për ujëra të zeza në Strumicë" dhe do të fillohet me përgatitjen e Projektit Ideor për Stacionin për pastrim.

Në këtë periudhë do të fillojnë aktivitetet e parapara me Projektin për menaxhim me rrjedhjen lumore Bregallnicë i përkrahur financiarisht nga Qeveria e Zvicrës.

Njëherë do të fillojë realizimi i "Projektit për zhvillimin e sistemin tarifor nacional për furnizim, kullimin dhe tretmanin e ujërave".

PRIORITETET AFATMESME KORNIZA JURIDIKE

Në këtë periudhë është planifikuar që të fillojë përgatitja e akteve nënligjore me të cilat do të transponohen kërkesat e Direktivës kornizë të BE-së për ujëra 2000/60/BE dhe e direktivave të tjera relevante dhe do të zbatohen trajnime që do të drejtohen drejt ngritjes së kapaciteteve të administratës për implementimin e Ligjit për ujëra.

Është planifikuar që të vazhdojë përgatitja e akteve nënligjore, do të miratohet Program i masave për arritjen e qëllimeve për mjedis jetësorë dhe do të themelohet regjistër për rajonet e mbrojtura për rrjedhjen lumore të lumit Vardar. Gjithashtu do të përcaktohen karakteristikat dhe kriteret për përcaktimin e gjendjes së mirë të ujërave sipërfaqësore, gjendjen kimike, potencialin ekologjik të ujit dhe të ujërave sipërfaqësore, duke i përfshirë kushtet për përcaktimin e trupave ujorë artificial të trupave ujorë sipërfaqësorë të ndryshuar në mënyrë të fuqishme si dhe afatin për arritjen e gjendjes së mirë të ujit sipërfaqësorë. Do të përcaktohen kriteret dhe karakteristikat e gjendjes së mirë kuantitative dhe kimike të ujërave nëntokësore, si masat e nevojshme për pengimin e përkufizimit që të arrihet gjendja e mirë e ujërave nëntokësore. Do të definohet klasifikimi i kategorizimit të ujërave, si dhe afati për arritjen e qëllimeve të kualitetit të ujërave dhe minimum standardeve për kualitetin e ujërave, do të rregullohen kushtet me të cilat lejohet largimi i qëllimeve për kualitet të mjedisit jetësorë ujorë.

Në këtë periudhë planifikohet që të fillojë revizioni i Bazës së Ekonomisë së Ujërave në Republikën e Maqedonisë, si dhe të hartohen Plane për menaxhim me rrjedhjet lumore në Republikën e Maqedonisë për disa nënrrjedhje edhe atë Plan për menaxhim me rrjedhjen lumore të lumit Drini i Zi dhe plan për menaxhim me rrjedhjen lumore të lumit Strumicë dhe do të përgatitet në fazën përfundimtare Plani për menaxhim me rrjedhjen lumore të lumit Vardar, dhe do të miratohet edhe Plani për menaxhim me rrjedhjen e lumit Bregallnicë.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Në këtë periudhë planifikohet të fillojë përpunimi i studimit fizibilitet me plan nacional për menaxhim me milta nga ana stacionet për pastrimin e ujërave të zeza si dhe studim për definimin e zonave të ndjeshme dhe definimin e aglomeracioneve në pajtim me kërkesat e Direktivës për tretman të ujërave të zBEa urbane.

Gjithashtu do të përfundojnë aktivitetet nga Projekti "Përforsimi i kapaciteteve institucionale për aproksimim dhe implementim të legjislationit nga sfera e menaxhimit me ujërat - IPA 2009 komponenti 1. Me këtë projekt do të themelohet regjistër për rajonet e mbrojtura për rrjedhjen lumore të lumit Vardar. Do të behet mbindërtim dhe vendosje e piezometrave të rinj me qëllim për funksionimin e rrjetit të monitorimit të ujërave nëntokësore si dhe do të bëhet edhe mbindërtim dhe mirëmbajtje e rrjetit për monitorim të lumenjve.

Në mënyrë të vazhdueshme do të vazhdojnë që të rikonstruohen dhe të ndërtojnë stacione për pastrim dhe objekte të tjera të financuara me buxhetin e MMJPH-së, si dhe do të hartohen dokumentacione adekuate teknike. Do të bëhet mbrojtje e rajonit të pusit Nerez - Lepenec. Njëherë do të përfundojë Projekti "Ndërtimi i mureve kaskave të lumit Vardar".

Në suaza të "Projektit për zhvillimin e sistemin tarifor nacional për furnizim, kullimin dhe tretmanin e ujërave" do të hartohet sistem tarifor nacional për ujëra në Maqedoni dhe do të vendosen kushte për formimin e trupit Rregullator për punë komunale.

Do të ndërtohet stacion për pastrim në Prilep për ujërat e zeza dhe do të kryhet rikonstruimi dhe ndërtimi i një pjese të rrjetit të kanalizimit - Prilep, i financuar nga Programi IPA - Komponenta 3.

Do të përfundojnë aktivitetet për rindërtim të sistemit për furnizim me ujë Zhelinë dhe ndërtimi i stacioni për pastrim në Gjevgjeli, si dhe aktivitetet në suaza të Projektit "Ndërtimi i stacionit për pastrim për ujërat e zBEa në Strumicë".

Në këtë periudhë planifikohet të përfundojë faza e dytë dhe e tretë e projektit për ndërtimin e Hidrosistemit Zletovicë.

Gjithashtu do të rrumbullakohen aktivitetet të cilat janë paraparë me Projektin "Përforcimi i kapaciteteve institucionale për aproksimimin dhe implementimin e legjislacionit nga sfera e menaxhimit me ujërat - IPA 2009 komponenti 1.

3.27.5 MBROJTJA E NATYRËS

GJENDJA RRJEDHESE

KORNIZA JURIDIKE

Më vitin 2011 u miratua Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e natyrës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 47/11) me çka u bë transpozicioni i mëtejshëm i masave të BE-së: 32009L0147 dhe 31992L043 dhe u siguruan kushte zbatimit më të mirë të tyre. Ndryshimet dhe plotësimet e propozuara të ligjit kanë të bëjnë me aspektet kyçe të materies që e rregullon këtë ligj, duke përfshirë hartimin dhe zbatimin e sistemit të masave dhe aktivitetëve për mbrojtjen e llojeve të egra, habitatet e tyre dhe ekosistemet. Me ndryshimet dhe plotësimet e propozuara të ligjit sqarohet korniza juridike për përcaktimin e rajoneve të rëndësishme ekologjike të Bashkimit Evropian - Natura 2000, është bërë përpjekje që të mundësohet menaxhimi më efikas me rajonet e mbrojtura dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i shfrytëzimit të pasurisë natyrore në interes të zhvillimit të tanishëm dhe të ardhshëm të Republikës së Maqedonisë. Me ndryshimet dhe propozimet e propozuara të ligjit futen më shumë instrumente të shumëllojshme financiare me qëllim që të sigurohet financim i qëndrueshëm i rajoneve të mbrojtura.

Në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e natyrës janë miratuar Ligji për shpalljen e një pjese të Galicicës si rajon i mbrojtur në kategorinë Park Nacional (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 171/10), Ligji për shpalljen e shpellës Sllatinski Izvor si përmendore natyrore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 23/11), Ligji për shpalljen e Liqenit të Prespës si përmendore natyrore dhe Ligji për shpalljen e Liqenit të Dojranit si përmendore natyrore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 51/11).

Në pajtim me këtë ligj janë mbajtur debate publike në lidhje me propozimin për shpalljen e lokalitetit BEerani si sonë e mbrojtur në kategorinë park natyrorë (komuna e Prespës, 21.02.2011), propozim për shpalljen e lokalitetit Monospitosvko Bllato si rajon i mbrojtur në kategorinë përmendore e natyrës (komuna e Bosilovës 21.03.2011, 2011) dhe propozim për shpalljen e sërishme të Burimeve të Vefçanit si rajon mbrojtës në kategorinë përmendore e natyrës (komuna e Vefçanit 01.12.2012)

Qeveria e Republikës së Maqedonisë e miratoi Vendimin për pranimin e propozimit për shpallje të sërishme të Burimeve të Vefçanit si rajon i mbrojtur në kategorinë përmendore e natyrës (nr. 51-6501/1 prej 8.11.2011).

Më vitin 2011 është miratuar akt nënligjor për listat për përcaktimin e mbrojtjes së rreptë dhe mbrojtjes së llojeve të egra ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 139/11) me të cilin u transponuan masat e BE-së: 32009L0147 dhe 31992L043.

Akti nënligjor për Listat e llojeve të kafshëve të egra të prekura dhe të mbrojtura, të bimëve dhe kërpudhave dhe të llojeve të tyre qarkullimi i të cilave është rregulluar me marrëveshje ndërkombëtare, legjislacioni i Bashkimit Evropian dhe legjislacioni nacional me të cilin transponohet masa e BE-së 31997R0338 është në fazën e miratimit.

Në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e natyrës, Përdorimi për mënyrën e veprimit gjatë qarkullimit me llojet e prekura dhe të mbrojtura të bimëve të egra, kërpudhave kafshëve dhe pjesëve të tyre nga ana e organeve doganore, organeve tjera kompetente dhe shërbimeve të kalimeve kufitare dhe institucioneve shkencore dhe profesionale, si dhe të depozitarëve të autorizuar të ekzemplarëve të konfiskuar gjatë qarkullimit pa leje, Rregullores për përmbajtjen e studimit për valorizimin ja për ose revalorizimin të rajonit të mbrojtur dhe Rregullores për përmbajtjen e planeve për menaxhim me rajonet e mbrojtura dhe programet vjetore për mbrojtjen e natyrës gjithashtu janë në fazën e miratimit.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Përfundoi projekti i UNDP/GEF/MMJPH-së për përforcimin e ruajtjes ekologjike, institucionale dhe financiare të sistemit të rajoneve të mbrojtura në Maqedoni. Në suaza të këtij projekti është bërë valorizimi i vlerave natyrore të rajonit të më shumë dedikimeve Jasen dhe

Bellasica malore. Janë përgatitur plani për menaxhim me rajonin e më shumë dedikimeve Jasen dhe plani për menaxhim me përmendoret e natyrës Ujëvarat Koleshesli dhe Smilaroski.

U zbatuan 5 trajnime prioritare edhe atë: rregullativa, aspektet normative dhe institucionale të valorizimit, shpalljes, planifikimit dhe menaxhimit për rajone të mbrojtura; bazat e hulumtimit të shumëllojshmërisë biologjike, aftësive të monitorimit dhe menaxhimit me mbrojtjen e natyrës në rajonet e mbrojtura; komunikimi, ngritja e vetëdijes dhe marrëdhëniet me publikun; financimi, donacionet dhe ndikimi mbi zhvillimin lokal ekonomik me aksent të turizmit dhe trajnim themelor për GIS-në. Trajnimet u zbatuan në tremujorin e parë të vitit 2011 në katër qendra: Shkup, Manastir, Shtip dhe Strumicë me pjesëmarrje të përfaqësueseve të Sektorit për natyrën, 85 njësi të vetadministrimit lokal, drejtues të rajoneve të mbrojtura, organizata jo qeveritare dhe palë të tjera të pa interesuara.

Në suaza të projektit më MMJPH-në u përgatit, aplikim i softuerit i instaluar dhe i testuar me sukses në bazën qendrore të të dhënave të Sistemit Informativ Nacional për shumëllojshmëri biologjike (SINB) në Ueb qasjen e klientëve. Baza qendrore e SINB-së ishte e plotësuar me të dhëna të verifikuara shkencërisht dhe të qasshme për llojet e habitateve të tyre në vend duke përfshirë të dhëna për rajonet e mbrojtura dhe për rajonet e propozuara për mbrojtje. Gjithashtu, në suaza të projektit është përgatitur propozim i rrjetit Nacional reprBEentativ të rajoneve të mbrojtura dhe të rajoneve të propozuara për mbrojtje, si bazë për vendosjen e sistemit të rajoneve të mbrojtura dhe rajoneve të propozuara për mbrojtje.

Në parqet nacionale u zbatuan aktivitete me qëllim të avancimit të menaxhimit me vlerat natyrore dhe dhënien e kushteve për zhvillimin e eko-turizmit.

Përfundoi projekti: "Përkrahja e Parkut Nacional Galiçicë", i cili u përkrah nga Banka e KfW-së dhe përmes së cilës u rregulluan disa rrugica për këmbësorë, pamje dhe u rregullua dhe u hap qendra për vizitorë në fsh. Stanje në anën e Prespës. Institucioni Publik Parku nacional Galiçicë e miratoi Planin për menaxhim me PN Galiçicë.

Përfundoi projekti: "Mbrojtja e mjedisit jetësorë, zhvillimi ekonomik dhe promovimi i eko-turizmit të qëndrueshëm në PN Mavrovë" ku në bazë të raporteve tematike eksperte, u përgatit Studimi për revalorizimin e rajonit të mbrojtur Mavrovë. Gjithashtu, u përgatit Katalog (Lista) e llojeve të cilat janë regjistruar në territorin e rajonit të mbrojtur Mavrovë si pjesë e integruar e studimit. Në drejtim të zhvillimit të eko-turizmit dhe tërheqjes së vizitorëve në park u hapën rrugë këmbësorësh në rajonin e PN të Mavrovës.

Përfundoi projekti: "Zhvillimi i Rrjetit Ekologjik Nacional në Republikën e Maqedonisë (MAK-NEN)" përmes së cilit u përgatitën propozimi i Rrjetit Ekologjik Nacional në Republikën e Maqedonisë dhe Plani për menaxhim me korridoret e arushës së kaftë.

U përgatit dokumenti i projektit nga IPA projekti (TAIB 2009) - Përforcimi i kapaciteteve administrative për mbrojtjen e monitorimit të biodiversitetit dhe të trashëgimisë natyrore.

Gjatë vitit 2011 u mbajtën trajnime, punëtori dhe seminare përmes të cilave u përforcuan kapacitetet e Sektorit për natyrën pranë MMJPH-së, parqet nacionale, komunat, subjektet e tjera për menaxhim me rajonet e mbrojtura dhe me organizatat joqeveritare.

Në suaza të projektit "Rrjeti rajonal për mjedis jetësorë për qasje drejt BE-së" (RENA) përfaqësuesit e sektorit për natyrën morën pjesë në tre trajnime ushtruese në rajonet e mbrojtura në Kroaci, Maqedoni dhe Serbi. Trajnimet kanë të bëjnë me çështjet lidhur me përgatitjen e implementimit të planeve për menaxhim me rajonet e mbrojtura, menaxhim me natyrën dhe përforcim të ekonomisë lokale në rajonet tej kufitare dhe në strategjitë e komunikimit me palët e prekura.

PRIORITETET AFATSHKURTRA KORNIZA JURIDIKE

Në pajtim me obligimet që dalin nga Ligji për mbrojtjen e natyrës, do të miratohen Ligje për shpalljen e lokaliteteve: Kanjoni i Matkës, Burimet e Vefçanit dhe balta e Monospitovës për përmendore të natyrës, BEeren në Liqenin e Prespës si park i natyrës dhe Mavrova si park nacional.

Në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e natyrës do të miratohet akt nënligjor për mbajtjen e evidencës për mbrojtjen e natyrës.

Do të fillohet me përpunimin e Strategjisë Nacionale për mbrojtjen e natyrës me plan Aksionar, qëllimi i së cilës do të jetë që të mbrohet dhe të ruhet natyra e Republikës së Maqedonisë në gjendje burimore dhe të sigurohet përdorim i qëndrueshëm i sajë, duke i zbatuar gjatë kësaj principet dhe mekanizmat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Do të përgatitet plani i Dytë Aksionar për mbrojtjen e shumëllojshmërisë biologjike për shkak të zbatimit të masave dhe aktiviteteve që dalin nga Strategjia për mbrojtjen e shumëllojshmërisë biologjike dhe Konventa për shumëllojshmëri biologjike.

Do të fillohet me revizionin e Strategjisë Nacionale për shumëllojshmëri biologjike me plan Aksionar, në pajtim me rekomandimet e Konventës për shumëllojshmëri biologjike.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Më vitin 2012 do të përfordohen kapacitetet e MMIPH-së DMJ-së, Institucionet Publike parku nacional Pelister, Mavrovë dhe Galicicë dhe i subjekteve të tjera për menaxhim me rajonet e mbrojtura përmes qëndrueshmërisë së trajnimeve dhe punësive. Sektori për natyrën pranë DMJ-së do të përfordohet me punësime të reja.

Për shkak të menaxhimit me sistemin e rajoneve të mbrojtura në Republikën e Maqedonisë do të përcaktohen subjekte për menaxhim me rajonet e mbrojtura të shpallura.

Në suaza të projektit: Menaxhim i integruar me ekosistemin në rrjedhjen e Liqenit të Prespës në Shqipëri, Maqedoni dhe Greqi dhe do të përgatitet Plani për menaxhim me parkun e natyrës Ezeran të Liqenit të Prespës. Gjithashtu, do të përgatitet Plan për menaxhim me PN Mavrovë për periudhën 2012-2021.

Do të fillohet me implementimin e IPA projektit (TAIB 2009) - Përfordimi i kapaciteteve administrative për mbrojtjen e monitorimit të biodiversitetit dhe të trashëgimisë natyrore.

Në suaza të projektit: "Rrjeti rajonal për mjedis jetësorë për aderim drejt BE-së " (RENA) do të mbahen trajnime për vlerësimin e ndikimeve ndaj natyrës, përgatitjes së propozim projekteve për natyrën për aplikimin e tyre te donatorët potencial dhe për monitorim të natyrës në rajonet e mbrojtura.

Do të mbahet trajnim për zbatimin e masave të BE-së nga sfera e mbrojtjes së natyrës.

Do të përfordohet bashkëpunimi i MMJPH-së për subjektet për menaxhim me rajonet e mbrojtura, pushtetet lokale, shërbimet inspektuese, institucionet shkencore dhe profesionale, palët tjera të prekura (fermerët, pronarët e tokës, gjuetarët dhe peshkatarët), sektori jo qeveritarë i kyçur në mbrojtjen e natyrës, përmes organizimit të mbledhjeve dhe trajnimeve.

PRIORITETET AFATMESME KORNIZA JURIDIKE

Në periudhën 2013-2014 në pajtim me obligimet që dalin nga Ligji për mbrojtjen e natyrës do të përgatiten ligje për shpalljen e Maleve të Osogovës, Malin e Sharrit, Tikveshin, Jasenin, dhe Liqenin e Ohrit, Koleshinën, Baltën e Katllanovës, Baltën e Bellçishtës, Bazi Babën dhe Jabllanicën për rajone të projtura.

Në periudhën e paraparë do të miratohen akte nënligjore në të cilat do të transponohen masat relevante të BE-së të kësaj sfere. Do të përcaktohet Rrjeti Ekologjik Nacional në përbërjen e të cilit hynë rajonet e rëndësishme ekologjike, sistemi i korridoreve ekologjike, sistemi i rajoneve të mbrojtura dhe rajonet e propozuara për mbrojtje dhe rajonet e rëndësishme ekologjike për BE-Natura 2000 me çka do të transponohen masat e BE-së 32009L0147; 31992L0043 dhe 31997D0266. Në këtë periudhë do të miratohen 3 akte nënligjore me të cilat do të përcaktohen llojet e habitateve, shkalla e rrBEikimit të tyre dhe rëndësia, shënimi në hartë, si dhe masat për ruajtjen e llojeve të habitateve, në të cilat do të transponohen masat e BE-së: 32009L0147 dhe 31992L0043. Do të rregullohet metodologjia për monitorimin e gjendjes me natyrën, me çka do të transponohen masat e BE-së 32009L0147 dhe 31992L0043.

Do të përgatitet Strategji për mbrojtjen e natyrës me plan Aksionar në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e natyrës dhe do të përgatitet Strategji e Reviduar Nacionale për shumëllojshmëri biologjike me Plan Aksionar.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Do të përmirësohen kapacitetet e Sektorit për natyrën përmes punësimit të kuadrit të ri profesional. Për shkak të menaxhimit me sistemin e rajoneve të mbrojtura në Republikën e Maqedonisë do të përcaktohen subjekte për menaxhim me rajonet e mbrojtura të shpallura dhe do të përfordohen kapacitetet e tyre përmes zbatimit të trajnimeve dhe edukimeve.

Do të zbatohen trajnime për ngritjen e vetëdijes së publikut për rëndësinë e rrjetit ekologjik Natura 2000, për menaxhim me të dhënat për biodiversitetin dhe zbatimin e monitorimit të natyrës.

Në suaza të projektit IPA (TAIB 2009) - Përforcimi i kapaciteteve administrative për mbrojtjen e monitorimit të biodiversitetit dhe trashëgimisë natyrore, do të përgatitet metodologji për monitorimin e natyrës dhe do të përforcohen kapacitetet institucionale për mënyrën e grumbullimit analizës dhe vlerësimit të të dhënave për biodiversitetin dhe vendosjen e sistemit të monitorimit për menaxhim me të dhënat për biodiversitet në dy pilot rajonet (Balta e Bellçishtës dhe rajoni i rrjedhjes së ulët të lumenjve Topollkë dhe Babunë).

Në suaza të IPA projektit (TAIB 2011) do të fillohet me identifikimin e llojeve të habitateve dhe të egërsirave të egra me rëndësi evropiane, në pajtim me Direktivën për hapitate (31992L0043) për shkak të përgatitjes së Listës me rajonet e propozuara me interes të BE-së, si dhe me identifikimin e sferave të veçanta të mbrojtura, në pajtim me Direktivën për shpezët e egra 32009L0147.

Do të përforcohet bashkëpunimi i MMJPH-së për subjektet për menaxhim me rajonet e mbrojtura, pushtetet lokale, shërbimet inspektuese, institucionet shkencore dhe profesionale, sektori joqeveritar dhe palët tjera të prekura (fermerët, pronaret e tokave, gjuetarët dhe peshkatarët), të involvuar në mbrojtjen e natyrës, përmes organizimit të mbledhjeve dhe trajnimeve.

3.27.6 KONTROLLI I NDOTJES INDUSTRIALE DHE MENAXHIMI ME RREZIQET

GJENDJA RRJEDHËSE

KORNIZA JURIDIKE

Në pjesën e pengimit të kontrollit të havarive me pjesëmarrje të substancave të dëmshme, u miratua Rregullore për përmbajtjen e të informatave për masat për siguri, si dhe mënyrën e veprimit të personave në të cilët do të ndikojë havaria e shkaktuar nga sistemi ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 22/2011), me çka transponohet Aneks V nga masat e BE-së 31996L0082.

Në pajtim me periudhën kohore për paraqitjen e kërkesës për marrjen e lejes për harmonizim me planin operativ, gjatë vitit 2011 në MMJPH-në u dorëzuan gjithsej 3 kërkesa të reja për marrjen e lejes A për harmonizim me planin operativ dhe 1 kërkesë për marrjen e lejes B për harmonizim me planin operativ, me çka numri i përgjithshëm i kërkesave të parashtruara arrin 120. Me këtë më shumë se 96% të instalimeve kanë parashtruar kërkesë për marrjen e lejes për harmonizim me planin operativ. Më vitin 2011 u lëshuan 9 leje A për harmonizim me planin operativ, 1A - leje e integruar ekologjike dhe 2 ndryshimet e lejes dhe 1 B leje për harmonizim me planin operativ.

Njëkohësisht, janë përgatitur 3 A Projekt - leje ekologjike të integruara respektivisht leje për harmonizim me planin operativ, dhe në fazë të shqyrtimit janë 23 kërkesa për marrjen e lejes së integruar ekologjike. Lejet për harmonizim me planin operativ e menaxhojnë dinamikën për arritjen e standardeve me qëllim për marrjen e lejes së integruar ekologjike. Me qëllim të përgatitjes së bazës së lejeve të lëshuara, mbahet regjistër i lejeve të integruara ekologjike A dhe B dhe leje për harmonizim me planin operativ.

Edhe gjatë vitit 2011 punonte komisioni Shkencor Teknik për teknikat më të mira të qasshme e krijuar nga ekspertët e theksuar nga sfera e teknikës, ekologjisë dhe mjedisit jetësorë.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Me qëllim të intenzivimit të përpunimit të lejeve të integruara ekologjike filluan tre projekte.

Në bashkëpunim me Norck Energi nga Norvegjia u realizuan Projekti "Përforcimi i kapaciteteve nga sfera e pengimit të integruar dhe kontrolli i ndotjes dhe menaxhimi me hedhurinat e rrBEikshme". Gjatë vitit 2011 përmes projektit u sigurua ndihmë gjatë përgatitjes së lejeve për harmonizimin e planit operativ nga sektori i energjetikës dhe përpunimi i metaleve. Në suaza të projektit është Leja Draftit A- për harmonizim me planin operativ për Rafinerinë e naftës OKTA, u punua për përgatitjen e Draftit A - leje për legurat e Shkupit dhe shqyrtimin e kërkesës për marrjen e lejes për harmonizim me planin operativ për REK Manastir. Në suaza të këtij programi u mbajtën disa punëtori dhe u bënë mbikëqyrje në instalimet që janë përfshirë me këtë projekt.

Në bashkëpunim me GIZ u realizua Projekti "Integrimi i teknikave të standardeve të BE-së nga sfera e mjedisit jetësorë". Projekti ka të bëjë me dhënien e ndihmës gjatë përgatitjes së lejeve nga sektori industria kimike, veprimtari të tjera dhe menaxhimi me hedhurinat. Me këtë projekt

punohej në përgatitjen e lejes për Zorka kolor SHPKPV Shkup (paraprakisht Alkaloid) Ngjyra dhe Llaqe, NP Deponia Drislla - Shkup, Shtypshkronja Kiro Dandario - Manastir. Si pjesë e aktiviteteve të projektit është realizuar vizitë studimore në Frankfurt të Gjermanisë ku morën pjesë 15 persona nga MMJPH dhe u vizituan instalime të ngjashme me ato të cilat janë pjesë e projektit.

U përgatit raport për kornizë institucionale dhe juridike në pjesën e menaxhimit me havariet me pjesëmarrje të substancave të rrezikshme. Njëherë, është përgatitur edhe pyetësor shpërndarës për identifikimin e aktiviteteve të rrezikshme me qëllim të lehtësimit të punës për njoftim nga ana e operatorëve që del nga Ligji për mjedis jetësorë. Kanë arritur 32 pyetësorë të plotësuar për identifikimin e aktiviteteve të rrezikshme nga operatorët. Bëhet evoluim ekzistues i pyetësorëve dhe futja e të dhënave në regjistrin preliminar në sistemin me pjesëmarrje të substancave të rrezikshme.

Përfaqësuesit e Drejtorisë për mjedis jetësorë/Seksioni për kimikalie dhe fatkeqësi industriale, Inspektorati Shtetërorë për mjedis jetësorë, Direktiva për mbrojtje dhe shpëtim/Inspektorati Gjeneral, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale/Inspektorati Shtetërorë i Punës morën pjesë në trajnimin Rajonal për evoluimin e raportit për masat e sigurisë - Faza 2. Trajnimi u mundëson pjesëmarrësve maqedonas që të marrin pjesë në evoluimin e raportit konkret për masat për siguri edhe atë me shfrytëzimin e listës për kontroll. Gjithashtu, në pjesën praktike të trajnimit u organizua inspektim në vend ngjarje e instalimit të referuar në raport.

PRIORITETET AFATSHKURTRA KORNIZA JURIDIKE

Më vitin 2012 do të përgatiten respektivisht do të revidohen Dokumentet referente nacionale (udhëzime) për Teknika e Qasme më të mira për përpunimin e metaleve fero dhe të ngjyrosur, prodhim i çelikut dhe për monitorim.

Në mënyrë të vazhdueshme do të vazhdojë shqyrtimi i kërkesave të marra për marrjen e lejes së integruar ekologjike. Lejet do të lëshohen në pajtim me procedurën për marrjen e lejeve të integruara ekologjike për harmonizim me planin operativ me çka do të mundësohet pjesëmarrja e publikut në pajtim me Ligjin për Mjedis jetësorë.

Do të miratohet Ndryshimi i rregullores për lartësinë e kompensimit që do ta paguajnë operatorët e instalimeve të cilët kryejnë aktivitete për të cilat lëshohet leje për harmonizim me planin operativ.

Nga sfera e pengimit dhe kontrollit të havarieve me pjesëmarrje të substancave të dëmshme, do të bëjnë ndryshime dhe plotësime të Ligjit për mjedisin jetësorë dhe me qëllim që të sigurohet transpozicion i Seveso II Direktivës dhe do të miratohen Rregullore për përmbajtjen e raportit, për masat e sigurisë, me çka do të transponohet Aneks II i Direktivës SEVEKO II (31996L0082 dhe 32003L0105), Rregullore për përmbajtjen e politikës për pengimin e havarieve, me çka transponohet neni 7 i Aneks III i Direktivës SEVEKO II (31996L0082 dhe 32003L0105) dhe Rregullore për përmbajtjen dhe formën e Regjistrit të sistemeve me pjesëmarrje të substancave të rrezikshme, me çka transponohet Aneks VI i masës BE 32003L0105)

KORNIZA INSTITUCIONALE

Në pjesën për pengim të integruar dhe kontroll të ndotjes do të zbatohet trajnimi për tretmanin e ujërave të zeza nga prodhimi i verës, prodhimi i qumështit, prodhimi i birrës dhe pijeve joalkoolike dhe tretman të ujërave të zeza nga theoret, që do të përkrahët përmes TAIEK.

Në pjesën e fatkeqësive industriale do të mbahet TAIEK punëtoria për përgatitjen e raportit të masave për siguri. Në bazë të raportit për kornizë institucionale dhe juridike në menaxhimin me havariet me pjesëmarrje të substancave të rrezikshme, më vitin 2012 do të përgatitet plani Aksionar për pengimin dhe kontrollin e havarieve me pjesëmarrje të substancave të rrezikshme.

Do të fillojë aktivitetet për futjen e shënimit ekologjik për kapacitetet turistike, si dhe për shënimin e prodhimeve dhe shërbimeve të tjera.

PRIORITETET AFATMESME KORNIZA JURIDIKE

Në këtë periudhë do të bëhet analizë e ndryshimeve në legjislacionin e BE-së lidhur me pengimin e integruar dhe kontrollin e ndotjes, me qëllim të transponimit të tyre në legjislacionin e

Republikës së Maqedonisë. Në pajtim me direktivën e BE-së për emisione nga industria 2010/75/BE do të miratohet Ligj për pengimin e kontrollit të ndotjes industriale.

Njëkohësisht do të përgatiten respektivisht do të revidohen Dokumentet Referente Nacionale (udhëzimet) për teknikat e qasshme më të mira për tretmani e ujërave të zBEa dhe gazrave, për ruajtjen intensive të shpezëve, klinkerin e çimentos dhe qeramikë.

Deri në fund të vitit 2012 është paraparë futja e rëndësisë ekologjike e së paku 10 kapaciteteve për vendosje turistike dhe futjen e futjen e së paku 10 prodhimeve dhe shërbimeve ekologjike të shënuara.

Nga sfera e etiketimit ekologjik do të bëhet promovimi i shënimit ekologjik në Republikën e Maqedonisë. Do të miratohet Rregullore për kriteret që duhet të plotësohen për marrjen e shenjës ekologjike për mbështjellëse të forta të dyshemeve, me çka do të transponohet masa e BE-së 32009D0607 dhe Rregullore për kriteret që duhet të plotësohen për marrjen e shenjës ekologjike për shërbim në kampet turistike, me çka do të transponohet masa e BE-së 32009D0578.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Në sferën e pengimit të integruar dhe kontrollit të ndotjes do të realizohen aktivitete për përforcimin e kapaciteteve të njërive të vetadministrimit lokal nga në sferën e pengimit industrial dhe kontrollit të ndotjes. Do të zbatohen trajnime për zbatimin e procedurës për lëshimin e lejeve ekologjike të integruara dhe menaxhim me fatkeqësitë industriale. Në mënyrë të vazhdueshme do të realizohet procedura për lëshimin e lejeve për harmonizim me planin operativ, e cila do të duhet të rumbullakohet në këtë periudhë.

Do të përfordhet Seksioni për standarde me qëllim të sigurimit të kushteve për promovimin dhe implementimin e shënimit ekologjik, si dhe promovimin e ISO standardeve dhe standardeve të tjera të BE-së, përmes punësimeve të reja dhe zbatimit të trajnimeve.

Si aktivitet i kontinuar i MMJPH-së do të zbatohet azhurnim i rregullt i Regjistrit të sistemeve me pjesëmarrje të substancave të rrBEikshme (në pajtim me kërkesat e masave të BE-së).

Për shkak të lehtësimit të përpunimit të raportit për masat e sigurisë, është planifikuar definimi i metodologjisë për përpunimin e Raportit për masat e sigurisë. Në metodologjinë do të ndërtohen edhe principet e përgatitjes së politikës për pengim nga havariet dhe sistemi për menaxhim të sigurt. Evaluimi i raportit për masat e sigurisë do të përkrahët me pyetësor për evaluim të raportit për masat e sigurisë.

3.27.7 KIMIKALET

GJENDJA RRJEDHËSE

KORNIZA JURIDIKE

Me miratimin e Ligjit të ri për kimikale u dha kontribut drejt zvogëlimit të efektit negativ të përdorimit të kimikaleve mbi shëndetin e njerëzve dhe mjedisit jetësorë, vendosjen e rrjedhjes së lirë të mallrave me qëllim që të rritet mbrojtja nga kimikalet dhe arritja e zhvillimit të qëndrueshëm në Republikën e Maqedonisë, përmes vendosjes të sistemit adekuat për plasman të shfrytëzimit të kimikaleve në lidhje me rrezikun dhe me rrezikun të cilin e mbajnë të njëjtat dhe kapacitete institucionale adekuate dhe lëshimin e veglave administrative.

Në mars 2011 u formua Byroja për ndihmë, që siguron rekomandime te prodhuesit, importuesit, shpërndarësit, shfrytëzuesit përfundimtar dhe te palët tjera të prekura me obligimet dhe përgjegjësitë e tyre që dalin nga Ligji i ri për kimikale.

Me qëllim të ngritjes së vetëdijes së banorëve, në veçanti për obligimet në sektorin industrial në pjesën e REASH që dalin nga ligji i ri për kimikale, u përgatitën broshura dhe të njëjtat u botuan në faqen e internetit www.hemikalii.com.mk.

Në faqen e njëjtë të internetit u shpallën edhe drejtimet për përgatitjen e listës së sigurisë, të nënshkruar nga ana e ministrit të Shëndetësisë, Këto drejtime i transponojnë kërkesat nga REACH Rregullativa 1907/2006.

Gjatë vitit 2011 u vazhdua me procesin e transponimit të legjislativës evropiane në legjislacionin nacional.

Në bazë të Ligjit për kimikale, u miratuan këto akte nënligjore:

- Listë për ndalime dhe përkufizime për përdorimin e kimikaleve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 57/2011), që transponon kërkesat e REACH Rregullativës 1907/2006
- Listë e substancave me rrezik të lartë (të cilat paraqesin brengosje), ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 156/2011), që transponon kërkesat e REACH Rregullativës 1907/2006
- Rregullorja për mënyrën në të cilën kryhet vlerësimi i sigurisë së kimikaleve dhe përmbajtja e raportit të sigurisë së kimikalies. ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. ehgullore82/2011), duke e transponuar masën e BE-së 32006R1907
- Rregullore për metodat për përcaktimin e bioshpërndarjes të substancave aktive sipërfaqësore në detergjentet, si dhe metodat referente për hulumtimin dhe analizën e detergjenteve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 74/2011), duke e transponuar masën e BE-se 32004R0648;
- Rregullorja për të dhënat për përmbajtjen e detergjenteve të cilat duhet të jenë të theksuar në paketimin, si dhe rregullat e përgjithshme dhe veçanta të shënimit të detergjentit;
- Rregullorja për listën e të dhënave për përmbajtjen e detergjenteve, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 84/2011), të cilën e transponuar masa e BE-së 32008R0689;
- Rregullorja për rastet në të cilat zbatohet PIC procedura dhe përmbajtja e kërkesës për zbatimin e PIC procedurës; ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 82/2011), të cilën e transponuar masa e BE-së 32008R0689;
- Rregullorja për rastet në të cilat zbatohet procedura e njoftimit paraprak, rastet në të cilat nuk nevojitet zbatim i mëtejshëm i procedurës së njoftuar paraprakisht, përmbajtja e procedurës për eksportin e dokumenteve të cilat dorëzohen për shkak të zbatimit të procedurës së njoftimit paraprak ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 82/2011), duke e transponuar masën e BE-së 32008R0689;
- Lista e kimikaleve dhe prodhimeve të rrBEikshme eksporti i të cilave është i ndaluar ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 82/2011), duke e transponuar masën e BE-së 32008R0689;
- Lista e shteteve anëtare të Konventës së Roterdamit që kërkojnë informata për transitin e kimikaleve dhe përmbajtjen e atyre informatave, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 82/2011), duke e transponuar masën e BE-së 32008R0689;
- Rregullore për listën e të dhënave për përmbajtjen e detergjenteve, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 84/2011), duke e transponuar masën e BE-së 32004R0648
- Rregullorja për metodat për testimin e kimikaleve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 127/2011), duke e transponuar masën e BE-se 32008R0440

Në fillim të tetorit 2011 Qeveria e Republikës së Maqedonisë e miratoi Raportin për gjendjen e kimikaleve në Republikën e Maqedonisë dhe Planin Aksionar Nacional për qasje strategjike në menaxhimin me kimikalet.

Gjithashtu, u miratua edhe Plani Nacional për eliminimin dehidroklorofluorokarbonateve (HCFCs)

KORNIZA INSTITUCIONALE

Në nëntor 2011 u formua trupi Ndërsektorial për kimikale, i cili siguroi përmirësim të bashkëpunimit ndërsektorial për zbatimin e Ligjit për kimikale dhe në të janë anëtarë përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë, Ministria e Mjedisit Jetësorë dhe Planifikim Hapësinor, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Financave dhe Drejtoria Doganore, Ministria për Transport dhe Lidhje dhe përfaqësuesi i Shoqërisë për industri kimike.

Për shkak të vendosjes së bazës së të dhënave të rezervave të vjetërsuara të kimikaleve, është instaluar softuer special për bazën e të dhënave të rezervave të vjetërsuara të kimikaleve. Futja e të dhënave për rezervat e vjetërsuara të kimikaleve është aktivitet i kontinuar i Ministrisë së Mjedisit Jetësorë dhe Planifikimit Hapësinorë.

Në suaza të Projektit i cili është financuar nga fondet IPA të Evropës, me Agjencinë Evropiane për kimikale, Byroja e barnave më vitin 2011 mbajti tre mbledhje në lidhje me përforcimin e kapaciteteve administrative të palëve të prekura të cilat punojnë me problematikën e menaxhimit

me kimikalet edhe atë: mbledhje e rëndomtë e trupave të Komitetit për rrezikun nga kimikalet në HNJVLinki; punëtori për Vlerësimin e rrBEikut nga kimikaliet, ku ishin të pranishëm përfaqësues të MMJPH-së, fakulteti i Farmacisë, Klinika e Toksikologjisë, Qendra Nacionale për informim për helmim nga kameliet dhe Industria; seminar për shtetet me status të kandidatit në pjesën e Autorizimit dhe Evaluimit të kimikalieve".

Përfaqësuesit nga Republika e Maqedonisë morën pjesë në mbledhjet e rregullta të grupit për REACH dhe CLP (CARACAL) në Brisell, si dhe në mbledhjen e 10-të të Autoriteteve Nacionale për implementimin e Konventës për ndalimin e armëve kimike në shtetet e Evropës lindore, ku mori pjesë një përfaqësues i Republikës së Maqedonisë.

Për informimin e të gjithë palëve të prekura për obligimet që dalin nga Ligji i ri për kimikale dhe REACH Rregullativa, u organizuan dy punëtori njëditore, në bashkëpunim me Odën Ekonomike të Republikës së Maqedonisë.

Në suaza të implementimit të Planit për eliminimin e HCFC substancave në Republikë

Në mënyrë të vazhdueshme zbatohen aktivitetet për reduktimin dhe eliminimin e substancave e varfërojnë mbështjellësin e ozonit ku u zbatua kontroll i importit, eksportit dhe shpenzimit të substancave që e varfërojnë mbështjellësin e ozonit në Republikën e Maqedonisë dhe janë koordinuar të gjithë aktivitetet për implementimin e planit nacional për eliminimin e HCFCs.

Maqedoni, është përgatitur Rregullore për eliminimin e HCFC mjete për ftohje dhe metodologji për zbatimin e trajnimeve për eliminimin e HCFC mjeteve për ftohje dhe u mbajt seri të punëtorive për praktikë të mirë gjatë përdorimit të mjeteve dhe pajisjeve për ftohje për servisimin e pajisjeve për ftohje: Punëtori përgatitore për zbatimin e Planit për eliminimin e HCFC në Strumicë me pjesëmarrje të 20 serviserëve të pajisjeve për ftohje; Në qershor 2011 u mbajt punëtorja për menaxhim me mjetet për ftohje dhe me pajisjet që përmbajnë HCFC për profesorët e 11 shkollave të mesme profesionale në Republikën e Maqedonisë. Në punëtori u trajnuan 20 profesorë të shkollave të mesme profesionale për implementimin e programit "Eliminimi i mjeteve për ftohje HCFC": ndërsa trajnim të sferës së njëjtë për 10 profesorë të SOTU "Gjorgji Naumov" u mbajt edhe në Manastir.

Në tetor u mbajt punëtori për praktikë të mirë gjatë punimit me mjetet për ftohje dhe pajisje për serviserët e pajisjeve për ftohje për 70 serviserë të pajisjeve ftohëse

Në hapësirat e shkollës së mesme "Mihajlo Pupin", në hapësirat e servilit për pajisjet ftohëse "Mani", në hapësirat e shkollës së mesme "Mihajlo Pupin" në Shkup.

PRIORITETET AFATSHKURTA KORNIZA JURIDIKE

Në këtë periudhë do të vazhdojë transponomi i legjislacionit të BE-së në sferën e kimikaleve në legjislacionin nacional me miratimin e akteve nënligjore që dalin nga Ligji i ri për kimikale edhe atë;

- regullore për mënyrën e veprimit me substancat që e varfërojnë mbështjellësin e ozonit, me çka do të transponohet Rregullativa (BE) 1005/2009

- regullore për cilësitë e substancës për të cilën mund të përdoret emri kimik alternativ, si dhe përmbajtja e kërkesës për përdorimin e emrit kimik alternativ me të cilin do të transponohet masa e BE-së 32006R1907

- dryshimi dhe plotësimi i Listës së ndalesave dhe përkufizimeve për përdorim, me të cilën do të transponohet masa e BE-së 32006R1907

- rdhër për ndalimin e qarkullimit të substancave që e varfërojnë shënimin mbështjellësi në cilindra për përdorim të njehershëm, me të cilin do të transponohet Rregullativa (BE) 1005/2009

Njëkohësisht do të punohet për mbindërtimin ekzistues dhe plotësimin e Listës Nacionale të substancave të klasifikuara; dhe Lista substancave aktive në prodhimet biocide.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Më vitin 2012 do të vazhdojë regjistrimi i të gjithë personave juridik dhe fizik të cilët punojnë me kimikale. Për qëllimet e këmbimit të të dhënave dhe të menaxhimit të integruar me kimikalet Byroja për barëra do të vazhdojë të mbaj regjistër të Integruar të kimikaleve i cili do të përbëhet nga Regjistri i kimikaleve dhe nga Regjistri i prodhimeve biocide. Ky regjistër do të përmbaj do të përmbaj të dhëna për preparatet për mbrojtjen e bimëve.

Edhe në këtë periudhë do të vazhdojë përforsimi i kapaciteteve materiale i institucioneve kompetente të rajonit të kimikaleve përmes punësimeve të reja në Sektorin për kimikale në Byronë për barëra dhe zbatimi i trajnimeve të të punësuarve dhe të inspektorëve përgjegjës për implementimin e dispozitave të Ligjin për kimikale,.

Në suaza të implementimit të Planit Nacional për eliminimin e hidroklorofluokarbonateve (HCFCs) do të organizohet trajnim "Praktikë e mirë gjatë përdorimit të mjeteve për ftohje dhe pajisjeve për serviserët e pajisjeve për ftohje" për 60 persona.

Është planifikuar përgatitje e projektit për azhurnimin e Planit Nacional të Implementuar për reduktimin dhe eliminimin e POPs. Më vitin 2012 parashihet revizion i gjendjes me ndotësit organik perzistent, në veçanti në lidhje me 10 kimikalet e reja në anekset e Konventës së Stokholmit për POPs. Si aktivitet i kontinuar mbetet koordinimi i aktiviteteve të REACH Held Desk-in dhe rrjetësimin e tij me help desk-ët ekzistues të regjistruar në Bashkimin Evropian dhe me institucionin përgjegjës në nivel të BE-së respektivisht Agjencisë Evropiane për kimikale (ECHA) me seli në HNJVLinki.

PRIORITETET AFATMESME KORNIZA JURIDIKE

Në këtë periudhë do të vazhdojë transponimi i acquis BE-së në legjislacionin nacional në pjesën e kimikaleve në bazë të Ligjit për kimikale, me çka planifikohet që të miratohen këto akte nënligjore:

- Rregullore për mënyrën dhe procedurën me substancat ndotëse organike perzistente, me çka do të transponohet masa e BE-së 32004R0850
- Rregullore për sasitë kufitare të substancave të reja për të cilat kërkohet hulumtime plotësuese, lloji dhe përfshirja e hulumtimeve, si dhe metodat për hulumtim në bazë të të cilave të dhënat e marra për qëllimin e njëjtë nga notifikatori i njëjtë mund të shfrytëzohen, me të cilën do të transponohet masa e BE-së 31967L0548,
- Ndryshimi dhe plotësimi i Listës së substancave me rrBEik të lartë (të cilat shkaktojnë brengosje), me të cilën do të transponohet masa e BE-së 32006R1907

KORNIZA INSTITUCIONALE

Në suaza të implementimit të Planit Nacional për implementimin e hidroklorofluokarbonateve (HCFCs) do të organizohet trajnim për serviserët e pajisjeve për ftohje dhe të doganierëve për kontrollin e HCFCs në kalimet kufitare. Për këtë qëllim, do të përgatiten materiale për trajnim të doganierëve për kontroll të importit të HCFC në kalimet kufitare. Gjithashtu, është planifikuar sigurimi i shpërndarjes së pajisjes për tërheqjen dhe riciklimin e fluideve për ftohje.

Është planifikuar përgatitje e projektit për azhurnimin e Planit Nacional të Implementuar për reduktimin dhe eliminimin e POPs. Gjatë vitit 2013 parashihet azhurnimi i planit aksionar për reduktimin dhe eliminimin e ndotësve organik perzistent (POPs).

3.27.8 ORGANIZMAT GJENETIKISHT TË MODIFIKUAR

GJENDJA RRJEDHËSE

KORNIZA JURIDIKE

Në pajtim me Ligjin për organizmat gjenetikisht të modifikuar ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 35/2008) më vitin 2011 u miratua Rregullorja për shfrytëzimin e kufizuar të organizmat gjenetikisht të modifikuar si dhe informata të cilat janë të nevojshme që t'i dorëzojë shfrytëzuesi gjatë paraqitjes së notifikimit për hapësirën ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 8/2011), ku do të transponohet masa e BE-së 31998L0081.

Në pajtim me nenin 33 (Monitorim dhe njoftim) nga Kartagjenasi Protokollit për biosiguri dhe Vendimi nga Mbledhja e 5-të Mbledhja e Konferencës e Palëve të Konventës për shumëllojshmëri

biologjike në cilësi të palëve të Protokollit Kartagjenas për bio siguri, është përgatitur raporti i Dytë nacional për implementimin e protokollit kartagjenas për biosiguri. I njëjti është në fazë të dorëzimit të Sekretariati i Konventës për shumëllojshmëri biologjike.

U miratua Dispozita për principet themelore, përmbajtjen, vëllimin dhe metodologjinë për vlerësim, adekuate për karakterin e GMO-së së futur dhe mjedisit jetësorë, në pajtim me të cilat bëhet vlerësimi i rrezikut mbi mjedisin jetësorë me çka transponohet masa e BE-së 32001L0018 (Aneks II) dhe 32002DO623.

Në bazë të Ligjit për sigurinë e ushqimit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 157/2010), Agjencia për ushqim dhe veterinar, është kompetente për lëshimin e lejeve për prodhimin e ushqimit nga GMO. (për më shumë detaje shih kreun 3.12 Siguria e Ushqimit, politika veterinare dhe fitosanitare).

KORNIZA INSTITUCIONALE

MMJPH-ja si organ kompetent për zbatimin e Protokollit Kartagjenas për biosiguri, në suaza të Konventës për shumëllojshmëri biologjike, ngriti procedurë për marrjen e Projektit të ri UNEP/GEF "Përkrahja për implementimin e kornizës Nationale për biosiguri të RM-së." Projekti është miratuar në mars 2011 nga ana e GEF-it (Fondi Global për Mjedis Jetësorë). Qëllimi kryesor i projektit është përforsimi i kapaciteteve nacionale në drejtim të plotësimit të kërkesave që dalin nga Protokollit Kartagjenas i ratifikuar për biosiguri ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 40/05) si dhe harmonizimi i legjislacionit nacional me legjislacionin e BE-së për biosiguri.

Në shtator 2011, në suaza të të emëruarit në fjalë Projektit UNEP/GEF formohet Komiteti Administrativ i Projektit, si trup këshillëdhënës, i përgjegjshëm për realizimin e aktiviteteve të projektit, të cilin e përbëjnë përfaqësues të institucioneve kompetente dhe organe të cilat në pajtim me kompetencat e veta e mbulojnë rajonin organizmat gjenetiksht të modifikuar në Republikën e Maqedonisë.

Në vitin 2011 në Lubjanë, Republika e Sllovenisë, një përfaqësues i Drejtorisë së Doganave merre pjesë në trajnimin rajonal për Evropën Qendrore dhe Lindore për identifikimin dhe dokumentacionin e organizmave të gjallë të modifikuar në pajtim me Protokollin Kartagjenas për biosiguri

Në pajtim me Ligjin për GMO, Drejtoria për mjedis jetësorë (DMJ), organ në përbërje të MMJPH-së dhe Inspektoratit Shtetërorë për mjedis jetësorë janë organe përgjegjëse të nivelit nacional për GMO në mjedisin jetësorë. Në suaza të DMJ-së formohet seksion për GMO-në në Sektorin për mbrojtjen e natyrës. Kompetenca në menaxhim me GMO-në ka edhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave (MZSHV) në pjesën e procedurës për lëshimin e Prodhimeve të GMO-së në treg.

PRIORITETET AFATSHKURTA KORNIZA JURIDIKE

Në bazë të Ligjit për organizmat gjenetiksht të modifikuar, në tremujorin e dytë të vitit 2012 planifikohet të miratohet Rregullore për metodologjinë dhe elementet e vlerësimit, parametrave, kriterëve në minimum dhe kërkesave që duhet të merren parasysht gjatë kryerjes së vlerësimit, procedurës për kryerjen e vlerësimit, si dhe përkufizimet e masave për siguri, duke përfshirë edhe kushte të tjera teknike për çdo seksion në veçanti nëse është e domosdoshme për sigurimin e mbrojtjes së shëndetit të njerëzve dhe mjedisin jetësorë, në pajtim me llojin e organizmit, mjedisit dhe llojit të hapësirave në të cilat kihet parasysht që të shfrytëzohet GMO që do të transponohen dispozita të Direktivës 31998L0081

Në pajtim me dinamikën e propozuar, do të vazhdojë përgatitja dhe miratimi i akteve nënligjore që e rregullojnë lirin me vetëdije të GMO-së në mjedisin Jetësorë, me të cilat do të bëhet transhonim i mëtejme i direktivave të BE-së 32001L0018 dhe 31998L0081. Njëherë planifikohet miratimi i:

- Rregullore për përmbajtjen e shpalljes për të dhënat për vendin ku mund të kryhet mbikëqyrje në të dhënat e notifikimit
- Rregullore për metodologjinë dhe elementet e vlerësimit, parametrave, kriterëve në minimum dhe kërkesave që duhet të merren parasysht gjatë kryerjes së vlerësimit, procedurës për kryerjen e vlerësimit, si dhe përkufizimet dhe masat për siguri, duke përfshirë edhe kushte të tjera teknike për çdo seksion në veçanti nëse është e domosdoshme për sigurimin e mbrojtjes së

shëndetit të njerëzve dhe mjedisin jetësorë, në pajtim me llojin e organizmit, mjedisin dhe hapësirat ku kihet parasysh të shfrytëzohet GMO

- Rregull për informatat dhe të dhënat që dorëzohen në shtesë të notifikimit për eksport të prodhimeve të GMO dhe GMO-së.

Përkrahja e detyrueshme për kyçjen e ekspertëve ndërkombëtar në sferën e GMO-së gjatë përgatitjes dhe miratimit të akteve nënligjore dhe implementimit të Ligjit për GMO, sigurohet si aktivitet në komponentën e 2-të të Projektit të ri UNEP/GEF "Përkrahje për implementimin e kornizës nacionale për biosiguri në Republikën e Maqedonisë".

KORNIZA INSTITUCIONALE

Si parakusht për përcjellje efikase dhe menaxhim me organizmat gjenetiksht të modifikuar e domosdoshme është që të përfordhet seksioni i ri për GMO në suaza të MMJPH-së, të punësohen dhe të trajnohen persona të cilët do të jenë përgjegjës për përcjelljen e gjendjes me GMO-në gjatë shfrytëzimit të kufizuar, lirit me qëllim në mjedisin jetësorë, lirim në treg etj.

Në këtë periudhë, planifikohet të fillojnë aktivitetet në suaza të Projektit të ri UNEP/GEF "Përkrahja e implementimit të kornizës nacionale për biosiguri të RM-së" përmes mbajtjes së trajnimeve të dedikuara për përfordhimin e kapaciteteve të institucioneve Trupat profesional të formuar në pajtim me Ligjin për GMO ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr 11/2010.), MANU dhe organizatat joqeveritare të kyçura në rajonin organizmat gjenetiksht të modifikuar.

Në suaza të Projektit planifikohet pajisje teknike e DMJ-së me sigurinë e pajisjes së Llaboratorive për hulumtimin e GMO-së, si dhe përgatitjen e akteve nënligjore.

Me punë do të fillojë edhe Komiteti Shkencor për GMO, me qëllim të shqyrtimit të çështjeve nga sfera e GMO-së dhe dhëniet e mendimeve dhe propozimeve.

PRIORITETET AFATMESME KORNIZA JURIDIKE

Në këtë periudhë do të sigurohet transpozicioni i plotë i Direktivës 32001L0018 përmes miratimit të akteve nënligjore në lidhje me rregullimin e lëshimit në treg të prodhimeve të cilat përmbajnë GMO. Në këtë periudhë do të rregullohet mënyra dhe procedura për pjesëmarrje të publikut në lëshimin e lejeve për GMO dhe GMO prodhim; mënyra dhe procedura për këmbimin e informatave për fatkeqësinë e ndodhur, masat e ndërmarra dhe efikasiteti i tyre dhe analiza e fatkeqësive, duke përfshirë edhe rekomandime për përkufizimin e efekteve dhe tejkalimin e fatkeqësive të ngjashme në të ardhmen; do të caktohet forma dhe përmbajtja e lejes për eksport të GMO-së dhe/ose GMO-prodhimeve, dhe në fund do të rregullohet forma, përmbajtja, metodologjia dhe mënyra e mbajtjes së regjistrit të GMO-së.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Do të themelohet dhe mbahet Regjistër për GMO dhe do të sigurohen kushte për pjesëmarrjen e publikut në miratimin e vendimeve. Trupat profesional, respektivisht Komisioni për menaxhimin e GMO-së dhe Komiteti shkencor për GMO do të vazhdojnë në mënyrë të rregullt të mbledhen dhe të japin propozime konsultative.

Do të realizohet trajnim për menaxhim me GMO-zbatimin e procedurave për notifikim, në suaza të UNEP-GEF projektit "Përkrahja për implementimin e kornizës nacionale për biosiguri në Republikën e Maqedonisë". Njëherë do të zbatohen kampanja publike të cilat kanë për qëllim që ta ngrenë vetëdijen e publikut për menaxhimin e GMO-së dhe ta rrisin përgjegjësinë e personave publik që do të jenë të kyçur në veprimin e GMO-së dhe Prodhimeve të GMO-së.

3.27.9 ZHURMA

GJENDJA RRJEDHËSE

KORNIZA JURIDIKE

Më vitin 2011 u miratua Rregull për aglomeracionet, rrugët kryesore, hekurudhat kryesore, dhe për aeroportet kryesore për të cilat përgatiten karta strategjike për zhurmë, që paraqet akt

përfundimtar me të cilin transponohet masa e BE-së 32002L0049, që ka të bëjë me vlerësimin dhe menaxhimin me zhurmën në mjedisin jetësorë.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Organi kompetent për rajonin zhurma në mjedisin jetësorë, në veçanti për zbatimin e Ligjit për mbrojtjen nga zhurma në mjedisin jetësorë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 79/2007 dhe 124/2010) dhe rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji është MMJPH-ja dhe DMJ-ja. Në Qershor 2011 në suaza të DMJ-së në Sektorin për mjedis jetësorë formohet Seksion i ri për mbrojtje nga zhurma në mjedisin jetësorë ku janë paraparë vende të punës me detyra të punës lidhur me mbrojtjen e zhurmës, përpunimin e kartave strategjike për zhurmë dhe plane aksionare për zhurmën dhe grumbullimin dhe analizën e të dhënave për zhurmën gjatë kryerjes së monitorimit. Mbikëqyrje inspektuese të zbatimit të ligjit dhe të rregullave të miratuara në bazë të ligjit kryen Inspektorati shtetërorë për mjedis jetësorë, organi në përbërje të MMJPH-së, si dhe inspektorët e autorizuar për mjedis jetësorë të njëjste të vetadministrimit lokal (NJVL). Kompetencat e caktuara në menaxhim me zhurmën kanë edhe Inspektorati Shtetërorë Sanitar dhe Shëndetësorë, organi në përbërje të Ministrisë së Shëndetësisë në lidhje me kontrollin për zhurmën nga aspekti shtetërorë, Ministrisë së Ekonomisë në lidhje me kontrollin e zhurmës e cila krijohet nga prodhimet e NJVL-së në lidhje me zhurmën e cila krijohet nga veprimtaritë hotelerike, të zejtarisë dhe nga veprimtaritë turistike.

Në lidhje me monitorimin e zhurmës, në MMJPH-në grumbullohen dhe përpunohen të dhëna për matjet e zhurmës komunale që i kryen Instituti për shëndet publik dhe 10 Qendra për shëndet publik, nga të cilat vetëm 3 qendra (Shkup, Manastir dhe Kumanovë) grumbullojnë dhe përpunojnë të dhëna, si dhe matje të bëra nga ana e laboratorisë qendrore pranë MMJPH-së, dhe që kanë të bëjnë me zhurmën e krijuar nga kategoritë e ndryshme të krijuesve të zhurmës (industria, aerodromi, kapacitetet hotelerike-turistike dhe aktivitete të tjera).

Është vendosur rrjet shtetërorë për monitorimin e zhurmës në mjedisin jetësorë me miratimin e Vendimit për formimin e rrjetit shtetërorë për monitorimin e mjedisit jetësorë.

Më vitin 2011 në MMJPH-në u zhvillua projekti me titull "Përforcimi i kapaciteteve të nivelit qendror dhe lokal për mbrojtje nga zhurma në mjedisin jetësorë" Projekti u përkrah nga ana e Qeverisë së Holandës, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit Jetësorë dhe Planifikim Hapësinorë. Qëllimi i këtij projekti ishte përforcimi i kapaciteteve të nivelit qendror dhe lokal për mbrojtjen nga zhurma në mjedisin jetësorë, njohjen me njohuritë themelore për zhurmën në mjedisin jetësorë, shqetësimin dhe efektet shëndetësore, implementimin e Direktivës së BE-së për zhurmën në mjedisin jetësorë, njohje me politikën sociale për zhurmën në Holandë, legjislati, rekomandimet për zhvillimin e politikës për zhurmën në mjedisin jetësorë për nivele të ndryshme administrative si dhe trajnim për përgatitjen e kartave strategjike për zhurmë. Në suaza të projektit u mbajtën pesë punëtori të lidhura ndërmjet veti dhe u përgatit piloti Karta Strategjike në një pjesë të Qytetit të Shkupit.

PRIORITETET AFATSHKURTA KORNIZA JURIDIKE

Në gjysmën e parë të vitit 2012 do të miratohet Rregullore për llojet më të përafërta të burimeve të veçanta të zhurmës, si dhe kushtet që duhet t'i plotësojnë stabilimentet, pajisjen, instalimet dhe pajisjet që përdoren në hapësirë të hapur në pikëpamje të zhurmës së emituar dhe të standardeve për mbrojtjen e zhurmës, me çka do të transponohet Direktiva 2000/14/BE, ndryshimi me Direktivën 2005/88/BE, dhe ka të bëjë me emisionin e zhurmës në rrethinën e pajisjes që përdoret në të hapur.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Gjatë vitit 2012 me punësime dhe trajnime të reja do të përforcohen kapacitetet e DMJ-së Sektorit për mjedis jetësorë dhe Sektorit të Qendrës Informative të Maqedonisë për mjedis jetësorë me qëllim për zbatimin e ligjit dhe të akteve nënligjore. Në seksionin e pa formuar për mbrojtjen nga zhurma në mjedisin jetësorë në suaza të sektorit për mjedis jetësorë në DMJ-në do të punësohen së paku 4 persona.

Njëkohësisht, do të përforcohen edhe kapacitetet e NJVL-së për menaxhim me zhurmën në nivel lokal përmes punësimeve dhe zbatimit të trajnimit që kanë të bëjnë në pikë të parë për

zbatimin e legjislacionit nga sfera e zhurmës në mjedisin jetësorë dhe nivelin lokal. Është paraparë zbatimi i trajnimit të të punësuarve në NJVL-në për shkak të përmirësimit të kapaciteteve gjatë menaxhimit me të dhënat për zhurmën dhe monitorimin e rrjetit për zhurmën, si dhe trajnime për përdorimin e instrumenteve për matjen e zhurmës.

Është paraparë zbatimi i trajnimit të të punësuarve në MMJPH-në dhe NJVL-në (Qyteti i Shkupit, Kumanovë, Manastir dhe Tetovë) që në pajtim me Rregulloren për aglomeracionet, rrugët kryesore, hekurudhat kryesore dhe aerodromet kryesore për të cilat duhet të përgatiten karta strategjike për zhurmë (Gazeta Zyrtare e RM-së. 122/11) do të fillojnë me përgatitjen e kartave strategjike për zhurmë plane aksionare për zhurmën gjatë vitit 2014.

MMJPH-ja aplikon për vazhdimin e projektit "Përforcimi i kapaciteteve të MMJPH-së për implementimin e direktivës 2002/49/BE që ka të bëjë me vlerësimin e menaxhimit me zhurmën në mjedisin jetësorë, të përkrahur nga ana e Qeverisë së Holandës në suaza të programit Matra G2G, i cili zhvillohej më vitin 2011. Në suaza të projektit do të realizojnë mëshomë trajnime për menaxhim me zhurmën dhe do të sigurohet përkrahje për përpunimin e akteve nënligjore. Aktivitetet e projektit nëse është i miratuar, do të përcaktohen në tremujorin e parë të vitit 2012.

Në suaza të propozim projektit "Përforcimi i kapaciteteve administrative të nivelit qendror dhe lokal për implementimin e zbatimit të legjislacionit të BE-së nga sfera e mjedisit jetësorë dhe ndryshimet klimatike" (IPA), është përfshirë mbrojtja e zhurmës në mjedisin jetësorë përmes ndihmës në implementimin e direktivave të BE-së nga sfera e zhurmës dhe furnizimit të pajisjes për kryerjen e monitorimit të zhurmës në mjedisin jetësorë. Propozimi është dorëzuar te EK-ja dhe pritet miratimi i tij.

Për shkak të miratimit të monitorimit të rregullt të rrjetit shtetëror për monitorim të zhurmës do të fillohet me përpunimin e Programit për punimin e të njëjtit. Në bazë të të dhënave të stacioneve ekzistuese për monitorimin e zhurmës, do të fillojnë aktivitetet përgatitore të aglomeracioneve dhe rajoneve për të cilat duhet të përpunohen Karta strategjike për zhurmën e planeve aksionare përmes furnizimit të pajisjes së nevojshme për monitorimin dhe përpunimin e kartave strategjike për zhurmë dhe trajnime për shfrytëzimin e pajisjes.

Është paraparë që të zbatohen trajnime të të punësuarve në MMJPH-në, IJZ dhe qendrat për shëndet publik të NJVL-së, me qëllim të njoftimit me përvojat e vendeve anëtare të BE-së për implementimin e Direktivës së BE-së në Parlamentin Evropian dhe në Këshillin nga 25.06.2002 që ka të bëjë me vlerësimin dhe menaxhimin me zhurmën në mjedisin jetësorë (32002L0049).

Në këtë periudhë do të realizohet punëtorja për përforcimin e kapaciteteve të MMJPH-së dhe të institucioneve të tjera për menaxhim me zhurmën në mjedisin jetësorë në suaza të ndihmës së TAIEX-it, që do të ishin prezantuar kërkesat e Direktivës 2000/14/BE, ndryshimi me Direktivën 2005/88/BE dhe përvojat e shteteve anëtarëve të BE-së gjatë implementimit të njëjtit

Ne plan është realizimi i udhëtimit studiues për menaxhim me zhurmën në mjedisin jetësorë në suaza të ndihmës së TAIEX-it, në të cilën do të ishin prezantuar kërkesat e Direktivës 2000/14/BE, ndryshimi me Direktivën 2005/88/BE dhe përvojat e shteteve anëtare te BE-së gjatë implementimit të të njëjtit.

PRIORITETET AFATMESME KORNIZA JURIDIKE

Në këtë periudhë pritet të miratohen aktet nënligjore me të cilat do të rumbullakohet korniza juridike në rajonet e zhurmës dhe do të sigurohet harmonizim i përgjithshëm me BE-acquis.

Gjegjësisht, me aktet nënligjore do të përcaktohen llojet më të afërta të burimeve të veçanta të zhurmës, si dhe kushtet për mbrojtje nga zhurma të shkaktuar nga komunikacioni rrugor, hekurudhorë, ajror dhe ujor, si dhe nga llojet më të afërta të burimeve të veçanta me të cilat do të kryhet transponimi i këtyre masave të BE-së: 31984L0372, 31989L0629 dhe 31998L0020. Gjithashtu, do të përcaktohen llojet më të afërta të burimeve të veçanta të zhurmës, si dhe kushtet që duhet t'i plotësojnë pajisjet, mjetet dhe aparatet për ekonomi familjare me propozim të standardeve për mbrojtje nga zhurma, me çka do të kryhet transponimi i Direktivës 32009L0125.

Deri në fund të vitit 2013 do të fillojnë aktivitetet për vendosjen e GIS të të dhënave të zhurmës në mjedisin jetësorë me qëllim të zbatimit të plotë të kërkesave të Direktivës INSPIRE e cila siguron kornizë ligjore për implementimin e të dhënave Hapësinore Infrastrukturore Evropiane dhe do të jetë një nga komponentët kryesorë të Sistemit Infrastruktural Evropian për mjedis jetësorë.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Në këtë periudhë do të fillojnë aktivitetet për vendosjen e sistemit informativ për gjendjen e zhurms në mjedisin jetësorë si pjesë e sistemit të përgjithshëm informativ për mjedis jetësorë në Republikën e Maqedonisë, i cili do t'i përfshi të dhënat e marra nga monitorimi i zhurms, kartave strategjike, planeve aksionare dhe të dhënave tjera relevante të fituara me matje individuale të zhurms.

Do të fillojnë aktivitetet për vendosjen dhe mbajtjen e kadastrës të krijesve të zhurms në mjedisin jetësorë.

Në këtë periudhë do të fillojnë aktivitete konkrete për përpunimin e kartave strategjike dhe të planeve aksionare për zhurme.

3.27.10 PALLTARIA

GJENDJA RRJEDHËSE

KORNIZA JURIDIKE

Në pajtim me Ligjin për pyje ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 64/09, 24/11 dhe 53/11) është miratuar program për reproduksion e zgjeruar të pyjeve për vitin 2011 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 3/11). Me programin janë siguruar mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë për financimin e aktiviteteve të shumta, si që janë: pyllëzimin e tokave të zbrazëta, kujdesin e kulturave të pyjeve me rrallimin, sanimin e sipërfaqeve të ndezura pyjore dhe ripërtëritjen e tyre artificiale, sigurimin e mbëltimeve pyjore për pyllëzim privat dhe mbrojtjen e pyjeve dhe kulturave pyjore nga sëmundjet bimore dhe nga insektet e dëmshme. Njëkohësisht, Qeveria e Republikës së Maqedonisë e miratoi Raportin për realizimin e Programit për reproduksion të zgjeruar të pyjeve për vitin 2010 dhe të Informatës për gjendjen shëndetësore të pyjeve në Republikën e Maqedonisë për vitin 2010, me propozim masa.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Gjatë muajit qershor u nënshkruan marrëveshje për kryerjen e punëve për Programin për reproduksion të zgjeruar të pyjeve për vitin 2011 përmes IZSHV-së dhe përmbaruesve të punëve edhe atë NP "Pyjet e Maqedonisë": Marrëveshje për pyllëzimin e tokave të zbrazëta dhe erozive, Marrëveshje për kujdesin e pyjeve me rrallimin dhe Marrëveshje për mënjanimin e pasojave nga zjarret e pyjeve dhe me fakultetin e Pylltarisë- Shkup-Marrëveshje për mbrojtje preventive të pyjeve dhe të kulturave të pyjeve, ndërsa me pronarët e pyjeve private u nënshkruan 35 marrëveshje për pyllëzimin e tokave të zbrazëta dhe të tokave erozive dhe 4 marrëveshje për kujdes të pyjeve me rrallim.

Deri në fund të vitit 2011 u pyllëzuam 700 ha toka të zbrazëta dhe tokë erozive, u bë kujdes me rrallimin e pyjeve dhe kulturave të pyjeve me sipërfaqe prej 420 ha, u bë sanimi i sipërfaqeve pyjore të përfshira nga zjarri për 98 ha dhe u siguruan 100.000 mbëltime për pyllëzimin e tokave me pronësi private.

Në periudhën prej 14-18 mars 2011 u realizua vizitë studimore në Spanjë, në suaza të projektit "Përforcimi i gatishmërisë për mbrojtjen e pyjeve nacionale nga zjarri" që të shihet vendosja dhe mënyra e organizuar e funksionimit të institucioneve gjatë mbrojtjes së pyjeve nga zjarri.

Në periudhën prej 20-22 maj 2011, në Shkup, u mbajt dy punëtori me temë: "Punëtorja me pjesëmarrje për faktorët e prekur në mbrojtjen e pyjeve nga zjarret" dhe "Preventiva dhe vetëdija për zjarrin e pyjeve" në suaza të projektit "përforcimi i përgatitjes për ballafaqimin me zjarret e pyjeve", në organizim të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, dhe e financuar nga FAO/ON. Gjatë punëtorisë së parë u promovua logoja nacionale për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri (buvot Bybo) dhe u fillua me kampanjë nacionale për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri. Në nëntor në suaza projektit të njëjtë u realizua proces i trajnimit të trajnerëve për "Menaxhim të Integruar me zjarret dhe teknikat për shuarjen e zjarreve të pyjeve" me pjesëmarrje të të gjithë palëve të interesuara.

Inspektorati Shtetëror i Pylltarisë dhe Gjuetisë (MZSHV_DISHL) bën mbikëqyrje mbi zbatimin e rregullave ligjore nga sfera e pylltarisë dhe gjuetisë dhe nga sfera e shëndetit të bimëve. MZSHV_DISHL përgatiti raport për zjarret e shkaktuara në pyll për periudhën nga 01.01. deri 31.10.2011 edhe atë: Numri i zjarreve - 340, sipërfaqe e kapluar nga zjarri - 18.041,80 ha, nga e cila nën pishat - 905,40 ha, nën gjethet - 8.243,50 ha dhe nën të tjerat - 8.892,90 ha, masë drush e

kapluar nga zjarri - 30.258,80 m³, nga e cila nga pishat - 11.621,10 m³ dhe nga gjethet - 18.631,70 m³.

PRIORITETET AFATSHKURTA KORNIZA JURIDIKE

Në bazë të Ligjit për pyje do të miratohen akte nënligjore me të cilat do të rregullohet monitorimi mbi ekosistemet e pyjeve dhe monitorimi mbi zjarrin e pyjeve, me të cilat do të transponohet rregullativa (BE) 1737/2006/BE për implementimin e rregullativës (BE) 2152/2003 për monitorimin e pyjeve dhe interaksionet me mjedisin jetësorë në Bashkësinë.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Në këtë periudhë do të ndërmerren aktivitete për realizimin e punësimeve të reja dhe përforcimin e kapaciteteve në batë të sistematizimit të Sektorit të MZSHV-së për pylltari dhe gjueti dhe të DISHL-së, për mbajtjen e trajnimeve profesionale për të punësuarit përmes TAIEK, furnizimit të pajisjeve (mjeteve, automjeteve për teren, pajisjeve kompjuteristike, softuer adekuat dhe të ngjashme).

Si një nga instrumentet për krijimin dhe zbatimin e politikës për pylltari në Republikën e Maqedonisë do të miratohet Programi për reproduksion të zgjeruar të pyjeve për vitin 2012 dhe e njëjta do të zbatohet deri në fund të vitit 2012.

Sektorit i MZSHV-së pylltaria dhe gjuetia në nivel vjetor përpunon raport për realizimin e Programit për reproduksion të zgjeruar të pyjeve për vitin 2011 dhe Informacion për gjendjen shëndetësore të pyjeve për vitin 2011, me propozim masa.

PRIORITETET AFATMESME KORNIZA JURIDIKE

Në këtë periudhë do të fillojë implementimi i Ligjit për pyje dhe i akteve nënligjore me të cilat rregullohet monitorimi mbi ekosistemet e pyjeve dhe monitorimi mbi zjarrin e pyjeve, dhe me të është transponuar rregullativa (BE) 1737/2006/BE për implementimin e rregullativës (BE) 2152/2003 për monitorimin e pyjeve dhe interaksionet me mjedisin jetësorë në Bashkësi.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Me qëllim të përforcimit të kapaciteteve të institucioneve nacionale planifikohet rritja e numrit të resurseve njerëzore dhe sigurimi trajnimeve profesionale për të punësuar.

Sektorit i MZSHV-së për pylltari dhe gjueti në nivel vjetor harton Program për reproduksion të zgjeruar të pyjeve, Raport për realizimin e Programit për reproduksion të zgjeruar të pyjeve për vitin paraprak dhe informatë për gjendjen shëndetësore të pyjeve për vitin paraprak, me propozim masa. Në këtë periudhë do të hartohet Sistem Informativ i Pylltarisë në Republikën e Maqedonisë, në pajtim me Ligjin për pyjet dhe për Strategjinë për zhvillim të qëndrueshëm të pylltarisë në RM-së.

3.28 MROJTJA E KONSUMATORËVE DHE SHËNDETI

3.28.1 MBROJTJA E KONSUMATORËVE

GJENDJA RRJEDHËSE

KORNIZA JURIDIKE

Harmonizimi i legjisllacionit

Në sferën e mbrojtjes së konsumatorëve, në shkurt 2011 u miratua Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për konsumatorët ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë (RM)" nr. 24/2011). Në ligj janë transponuar dy direktiva të Bashkimit Evropian (BE) edhe atë: Direktiva 32005L0029 për veprim tregtar të pa ndershëm nga ana e subjekteve afariste të tregut të brendshëm dhe Direktiva 31998L0027 për urdhërat me të cilat mbrohen interesat e konsumatorëve (mbrojtje kolektive e konsumatorëve).

Në pajtim me Ligjin u miratua Rregullore për formën dhe përmbajtjen e ftesës për edukim, mënyrën e zbatimit të edukimit dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës për zbatimin e edukimit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 24/2011). Edukimin e personave juridikë e kryejnë inspektorët shtetëror të tregut nëpunësit shtetëror udhëheqës në Inspektoratin Shtetëror të Tregut.

Në raportin e progresit të Republikës së Maqedonisë për vitin 2011 u theksua se ka përparim të mirë në harmonizim me acquis-in.

Në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve gjatë marrëveshjeve për kreditë e konsumatorëve ("Gazeta Zyrtare e RM-së" 51 nga 13.04.2011), më vitin 2011 Ministria e Ekonomisë i miratoi këto rregullore:

- Rregullore për formën dhe përmbajtjen e kërkesës për miratimin e vendimit për lëshimin e lejes, respektivisht për zhvillimin e kërkesës për lëshimin e lejes për miratimin e kredisë konsumuare ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 88 nga 30.06.2011);

- Rregullore për përcaktimin e formës dhe përmbajtjes së kërkesës për marrjen e lejes për miratimin e kredisë konsumatore dhe formën dhe përmbajtjen e lejes për miratimin e kredisë konsumatore ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 88 nga 30.06.2011);

- Rregullore për pajisje teknike, respektivisht kushte teknike që duhet t'i plotësojë parashtruesi i kërkesës për marrjen e lejes për miratimin e kredisë konsumatore ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 88/11); dhe

- Rregullore për formën dhe përmbajtjen e etiketës për lejen e dhënë për miratimin e kredive konsumatore. ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 88/11).

- Rregullore për formën dhe përmbajtjen e mënyrës së mbajtjes së Regjistrit të kredive konsumatore dhe regjistrit të ndërmjetësuesve kreditorë te kreditori i kredive ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 142/11); dhe

- Rregullore për formën, përmbajtjen dhe mënyrën e dorëzimit të raportit për numrin dhe vlerën e marrëveshjeve të lidhura për kredi konsumatore dhe shkalla e kontraktuar vjetore e shpenzimeve të përgjithshme të kredisë ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 142/11).

Me miratimin e këtyre rregulloreve është rrumbullakuar korniza juridike e Ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve gjatë marrëveshjeve për kredi konsumatore.

Rregullore për lojërat e fëmijëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 140/10).

Komisioni Evropian (KE) më 7 mars 2011 i dërgoi komentet për rregulloren, për të cilat Ministria e Ekonomisë (ME) përgatiti ndryshim të Rregullores dhe të njëjtin e dorëzoi përmes Sekretariatit për Çështje Evropiane (SÇE) sërish te KE për miratimin më 20 maj 2011. Më 19 gusht u morën komente nga KE për ndryshimet e kryera të Rregullores. Është vepruar sipas të njëjtave edhe gjatë harmonizimit të ndryshimeve me Sekretariatit për legjislacion.

Agjencia për ushqim dhe veterinar (AUV)

Aktivitetet në kornizën juridike janë të drejtuara drejt implementimit të Ligjit për siguri të ushqimit të miratuar më vitin 2010. Aktivitetet dhe rregullat e miratuara në bazë të Ligjit janë paraqitur në Kreun 3. 12.

Agjencia për ushqim dhe veterinar i RM-së si për kontakt për sistemin për paralajmërim të shpejtë të ushqimit dhe ushqimit për kafshë **RASFF (Rapid Alert System for Food and Feed)** për Republikën e Maqedonisë, gjatë vitit 2011 ka marrë dy njoftime nga Komisioni Evropian për prodhim të pa sigurt (alert notifikim) dhe në lidhje me të njëjtit janë ndërmarrë masa në pajtim me procedurat e hartuara.

Ministria e Financave është kompetente për supervizionin e kreditorëve të cilët punojnë në bazë të lejes për themelim dhe punë të dhënë nga ministri i financave. Në konkluzion me 30 nëntorin 2011 është lëshuar një leje për themelimin dhe punën e shoqërisë financiare që miraton kredi.

Është miratuar Rregullore për formën, përmbajtjen, mënyrën dhe afatet për dorëzimin e raportit për numrin dhe vlerën e marrëveshjeve të lidhura për kredi konsumatore dhe shkallën e kontraktuar vjetore të shpenzimeve të përgjithshme ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 119/2011).

Me miratimin e kësaj rregulloreje është rumbullakuar korniza juridike e Ligjit për mbrojtjen e konsumatoreve gjatë marrëveshjeve për kredi konsumatore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 51/2011).

Programi i miratuar për mbrojtjen e konsumatorëve për periudhën 2011-2012 është notuar në Raportin për përparimin e Republikës së Maqedonisë për vitin 2011 dhe vërtetohet se ka përmirësim në lidhje me aspektet horizontale, si dhe në lidhje me aktivitetet që i ndërmerr Organizata e konsumatorëve edhe krahas vëllimit të pa mjaftueshëm të mjeteve financiare.

Më vitin 2011 Ministria e Ekonomisë i rregullon aktivitetet e Programit në bashkëpunim me organizatat joqeveritare nga sfera e mbrojtjes së konsumatorëve me anë të Marrëveshjes për dhënie të mjeteve financiare për realizimin e programit (projekt) për shoqëritë e konsumatorëve në pajtim me thirrjen e zbatuar publike dhe në dinamikën e përcaktuar kohore.

Janë realizuar:

- 15 marsi është shënuar - Ditë botërore e konsumatorëve me moton "Stop për sjelljen e pandershme në tregu (tryezë e rumbullakët dhe pres konferencë);
 - Seminare rajonale në tre komuna Manastir, Shtip dhe Tetovë për promovimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve nga sfera e sjelljes në treg drejt konsumatorëve nga ana e subjekteve afariste të tregut të brendshëm, si dhe mundësia për mbrojtje kolektive të konsumatorëve para gjykatave kompetente;
 - dy takime pune të Këshillit për mbrojtjen e konsumatorëve, me kryetarët e këshillave nga komunat ku janë formuar këshillet. Qëllimi i takimit ishte përparimi i bashkëpunimit si miratimi i programeve për mbrojtjen e konsumatorëve në nivel komunal, në pajtim me Programin e Qeverisë për mbrojtjen e konsumatorëve për periudhën 2011-2012;
 - Seminare rajonale në tre komuna - Koçan, Gostivar dhe Ohër për promovimin e Rregullores për lojërat për fëmijë; dhe
 - mbledhje rajonale e punës në Strugë për promovimin e rregullativës ligjore nga sfera e turizmit dhe hotelerisë nga aspekti i të drejtave dhe obligimeve të konsumatorëve dhe dhënësve të këtyre shërbimeve.
- Për anëtarët e organizatës së konsumatorëve të Maqedonisë në Organizatën Evropiane të konsumimit (BEUC), me vendim të Ministrisë së Ekonomisë janë paguar 65.000 denarë (1.060 EUR).

Në lidhje me të lartpërmendurën se aktivitetet janë koncentruar kryesisht në sferat urbane dhe jo edhe në ato rurale, ndërmerren aktivitete për formimin e Këshillave për mbrojtjen e konsumatorëve në numër më të madh të komunave për shkak të organizimit të kampanjave dhe ngjarjeve edhe në sferat rurale.

Në pajtim me dispozitat mjetet në Buxhetin për vitin 2012, Ministria e Ekonomisë përgatiti Propozim-Program për ndryshimin dhe plotësimin e Programit për mbrojtjen e konsumatorëve për periudhën 2011-2012 me çka janë planifikuar aktivitetet më vitin 2012 që të realizohen me anë të zbatimit të thirrjes publike për ndarjen e mjeteve financiare të organizatave joqeveritare për mbrojtjen e konsumatorëve. Deri në fund të vitit vijues Programi do të dorëzohet te Qeveria e Republikës së Maqedonisë për miratim.

Agjencia për ushqim dhe veterinar i në pajtim me marrëveshjen e lidhur për bashkëpunim me shoqërinë qytetare "Organizimi i konsumatorëve të Maqedonisë" me ndarjen e mjeteve financiare janë përgatitur shtatë publikime edhe atë:

Udhërrëfyes në Ligj për sigurinë e ushqimit/ të dedikuar për konsumatorët; Udhërrëfyes në Ligj për sigurinë e ushqimit/ të dedikuar për biznes operatorët; Udhërrëfyes në Ligj për sigurinë e ushqimit/ të dedikuar për inspektorët; Broshura: "Aditivë në ushqim dhe konsumatorë" Broshura: "Donacionet e ushqimit" Broshura: "Ushqimi për nurtitivë të posaçme" dhe Broshurë: „Ushqim i pasur me vitamine dhe minerale"

Në rrjedhë janë aktivitetet për shtypjen e tyre.

Deri në fund të vitit vijues do të promovohen publikime me organizimin e ngjarjeve në qytetet në pajtim me programin.

Në agjencinë për ushqim dhe veterinar, në vijueshmëri pranohen parashtresa/ ankesa dhe propozime nga konsumatorët nga sfera e sigurisë së ushqimit. Veprimi dhe evidentimi kryhet në pajtim me Ligjin për veprim për parashtresat dhe propozimet. Për periudhën 01.01.2011 deri

15.11.2011 janë evidentuar 85 parashtrës dhe propozime të konsumatorëve në sferën e sigurisë së ushqimit. Në seksionin për mbrojtjen e ushqimit rregullisht azhurnohet **baza e të dhënave** për ankesat dhe propozimet e parashtruara. Të dhënat shfrytëzohen **për analizimin e rreziqeve për të cilat sugjerojnë konsumatorët**. Në lidhje me analizën, në vitin vijues Agjencia për ushqim dhe veterinarin i forcon kontrollet e operatorëve me ushqim për përdorim të posaçëm nutritiv, prodhime dietale dhe donacione të ushqimit, duke i marrë parasysh rreziqet për të cilat sugjeruan konsumatorët në prononcimet e tyre.

Në lidhje me çështjet horizontale në drejtim të realizimit të **aktiviteteve për vitin 2011 nga Programi Nacional për koordinimin dhe ndërmarrjen e masave efektive për mbikëqyrje të tregut për vitin 2011 dhe 2012** realizohen aktivitete koordinuese të inspektorëve për ushqim dhe të inspektorëve të tregut / mbikëqyrje e sigurisë së ushqimeve dhe materialeve që vinë në kontakt me ushqimin/.

Inspektorati Shtetërorë Sanitar dhe Shëndetësorë (ISHSSH)

U mbajt punëtori me temë **"Mbrojtja e të drejtave dhe kapaciteteve - obligimet e komunave"** me përfaqësues të komunave të juglindjes dhe të disa komunave të rajonit qendror të shtetit (gjithsej 12 komuna), si dhe këshilltar të emëruar për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve në institucionet shëndetësore. Këshilltarëve iu mbajt trajnim në lidhje me veprimin e Ligjit për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve dhe nga ana e ISHSSH-së u përgatit edhe Instruksion në lidhje me kompetencat dhe veprimet e tyre.

U mbajt TAIEX Punëtorin me temë **"Etablimi dhe implementimi i dispozitave për sigurinë e lojërave për fëmijë, kontrolli dhe lëvizja e lirë e tregut në Republikën e Maqedonisë"** dhe në lidhje me Direktivën e BE-së 2009/48/BE dhe "Rregulloren për sigurinë e lojërave për fëmijë".

Punëtorin u mbajt me ndihmën e Zyrës për përkrahje teknike dhe këmbim informativ TAIEX, nga Brukseli ndërsa në bashkëpunim dhe me kërkesë të ISHSSH-së. Në punëtorin ishin prezent rreth 70 pjesëmarrës.

Është përgatitur gjithashtu edhe Raporti për punën e Inspektoratit në Lidhje me Ligjin për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve.

Ministria e Transportit dhe Lidhjeve i zbatoi këto aktivitete:

- U mbajtën tribuna publike dhe këshillime të nivelit nacional dhe lokal për implementimin e Ligjit për banimin e përfaqësuesve të të gjithë komunave të organizuar nga ana e Bashkësisë së njësive të vetadministrimit lokal (BNJVL), qytetarë të interesuar me qëllim të harmonizimit të problemeve me të cilat ballafaqohen qytetarët në zbatim praktik të Ligjit dhe promovimit të Broshurës "Udhëheqës drejt menaxhimit me ndërtesat për banim".

Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Byroja për Zhvillim dhe Arsim

-u realizuan gjashtë punëtori me temë "Nxënësi si konsumator" me arsimtarët e lëndëve që e ligjërojnë lëndën "Aftësitë për jetesë në arsimin nëntëvjeçar ku është e përfshirë edhe tema "Mbrojtja e nxënësit konsumator", në tre rajone: Rajoni perëndimor, rajoni i Shkupit dhe rajoni Lindor.

MBIKËQYRJA E TREGUT

Në raport është theksuar se është arritur përparim i caktuar në lidhje me çështjet e lidhura me sigurinë e prodhimeve. Në kreun 1.1 Lëvizja e lirë e mallrave janë aktivitetet në pjesën e mbikëqyrjes së tregut.

Në lidhje me aksionet e koordinuara të paraqitura në pajtim me Ligjin për mbikëqyrje mbi tregun, Inspektorati Shtetërorë Shëndetësorë dhe Sanitar mori pjesë në aksionin e përbashkët të koordinuar nga Inspektorati Shtetërorë i Tregut, në pajtim me konkluzionet e mbledhjes së Trupit Koordinues për mbikëqyrje mbi tregun, dhe në lidhje me mbikëqyrjen mbi sigurinë e lojërave për fëmijë, në muajin shkurt-mars me çka janë bërë mbikëqyrje më 49 objekte janë gjithsej 37 mostra për analizë. Në lidhje me kontrollet e bëra nga ISHSSH gjatë vitit 2011 në prodhimin dhe qarkullimin për kozmetikë, lojëra për fëmijë dhe lëndë për përdorim të përgjithshëm janë bërë 460 kontrole, janë përgatitur 220 vendime, janë marrë 55 mostra për analizë nga të cilat 14 janë të parregullta.

Në lidhje me mbikëqyrjet e kryera mbi dërgesat e importit të lojërave për fëmijë për vitin 2011 nga ana e Seksionit për mbikëqyrje kufitare në Inspektorat, u zgjodhën 600 kërkesa për importin e dërgesave, janë marrë 427 mostra për hulumtim laboratorik.

Është përgatitur gjithashtu edhe Raporti për punën e Inspektoratit në Lidhje me Ligjin për mbrojtjen e të drejtave të pacienteve në periudhën janar-dhjetor 2011.

Në pajtim me raportin është bërë mbikëqyrje e rregullt më 163 Institucione Shëndetësore - spitalore 594 Institucione shëndetësore në të cilat nuk janë vendosur pacientë. Janë miratuar 2 vendime që kanë të bëjnë me institucionet shëndetësore - spitalore dhe 16 për Institucionet shëndetësore në të cilat nuk janë vendosur pacientë. 81 fletëparaqitjet e dërguara me shkrim dhe 29 fletëparaqitjet gojore përmes telefonit janë zgjedhur në afat pozitiv në pajtim me mundësitë ligjore.

Vendosja Institucionale dhe ekuipimi kadrovik

Në **Ministrinë e Ekonomisë**, në seksionin për mbrojtjen e konsumatorëve punojnë dy (2) persona.

Agjencia për Ushqim dhe Veterinari

Në drejtim të përforcimit të kapaciteteve administrative të njësisë organizative për mbrojtjen e konsumatorëve, për shkak të zbatimit të politikës konsumatore, në Seksionin për mbrojtjen e konsumatorëve edhe më tej punon një person. Punësime në shërbimet inspektuese për shkak mbikëqyrjes së tregut me prodhime ushqimore dhe trajnime /Kreu 3.12/

Në **Ministrinë e Financave**, Sektori për sistem financiar - seksioni për institucione bankare dhe jobankare janë punësuar tre (3) persona.

PRIORITETET AFATSHKURTA

Më vitin 2012 **Ministria e Ekonomisë** në bashkëpunim me **Agjencinë për Ushqim dhe Veterinari, Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor dhe Sanitar, me Ministrinë për Transport dhe Lidhje, me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës - Byroja për Zhvillimin e Arsimit** do të përgatisë Program për mbrojtjen e konsumatorëve për periudhën 2013-2014 dhe në dhjetor do ta dorëzojë te Qeveria e RM-së për miratim.

Realizimi i aktiviteteve nga Programi për mbrojtjen e konsumatorëve për vitin 2012 do të kryhet në vazhdimësi gjatë vitit nga ana e institucioneve të kyçura me aktivitete të veta në Program dhe në bashkëpunim me sektorin joqeveritar për mbrojtjen e konsumatorëve.

Ministria e Ekonomisë

- Seminare rajonale në 2 komuna për promovimin dhe njoftimin e konsumatorëve dhe operatorëve ekonomik për të drejtat dhe obligimet në pajtim me rregullativën ligjore nga sfera e mbrojtjes së konsumatorëve;

- seminare rajonale në 2 komuna për informimin e konsumatorëve për Kodekset e sjelljes nga ana e tregtarëve, si dhe mundësi për mbrojtje kolektive të konsumatorëve në pajtim me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve;

- seminare rajonale në 3 komuna për promovimin e broshurave dhe materialeve tjera promovuese për të drejtat e konsumatorëve;

- organizimin dhe mbajtjen e dy mbledhjeve të punës me Këshillat për mbrojtjen e konsumatorëve nga komunat e caktuara dhe Qytetin e Shkupit; dhe

- përkrahje financiare të shoqërive të konsumatorëve për realizimin e programit (projektit) për përforcimin dhe ngritjen e vetëdijes dhe kulturës së konsumimit.

Agjencia për ushqim dhe veterinari

Aktivitetet lidhur me prezantimin e gjendjeve me implementimin e sistemit NAASR në Republikën e Maqedonisë. Aktiviteti është planifikuar me organizimin e tribunave /4 qytete/ku do të marrin pjesë të gjithë palët e interesuara në sistemin për sigurinë e ushqimit duke përfshirë edhe përfaqësues nga pushteti lokal.

Aktivitetet lidhur me rregullat për etiketimin e ushqimit, që janë të rëndësishëm për konsumatorët. Përgatitjen e lifletëve, me të cilat do të informohen dhe edukohen konsumatorët si ta lezojnë shënimin e ushqimit, që është informatë e rëndësishme me të cilën do të mund ta tejkalojnë konsumimin e ushqimit ose përbërjeve në ushqim nga të cilat janë të ndjeshëm ose ndikojnë në shëndetin e tyre. Organizimin e seminareve /5 qytete/ ku do të informohen dhe edukohen konsumatorët si t'i lexojnë sugjerimet shëndetësore dhe informatat nutritive nga etiketimi.

Aktiviteti lidhur me prezantimin e gjendjes me kontrollin e ushqimit nga importi dhe të prodhuar në Republikën e Maqedonisë, - Aktiviteti është planifikuar me organizimin e tribunave, ku do të prezantohet kontrolli përmes raporteve inspektuese dhe procedurave për kontroll, me pjesëmarrje të ët gjithë palëve të interesuara në sistemin e sigurisë së ushqimit duke përfshirë edhe përfaqësues të pushtetit lokal.

Inspektorati Shtetëror Sanitar dhe Shëndetësor

-Vendosja e bashkëpunimit me institucionet nga rajoni, si dhe vendet anëtare të BE-së kompetent për mbrojtjen e konsumatorëve, me qëllim të këmbimit të përvojave dhe zbatimit praktik të Ligjit për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve, Ligji për mbrojtje shëndetësore, Rregullore për sigurinë e lojërave për fëmijë, Rregullore për përmbajtjen dhe mënyrën e shënimit të prodhimeve kozmetike.

Ministria e Transportit dhe Lidhjeve

- organizimin e këshillave dhe tribunave në katër (4) komuna për shqyrtimin e zbatimit të Ligjit për banim dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të të njëjtit.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Byroja për Zhvillimin e Arsimit

-organizimin e punëtorive në dy (2) shkolla fillore dhe çerdhe për fëmijë në dy (2) komuna në suaza të vazhdimet të procesit të edukimit të popullatës së re nga sfera e mbrojtjes së konsumatorëve;

- mbajtja e vizitave profesionale në shkollat fillore në orët mësimore për lëndën "Aftësitë për jetesë me ndihmë instruktive për arsimtarin, në shkollat të cilat kanë kaluar trajnim dhe kanë formuar kapacitete edukative.

-përpunimi i versionit elektronik të përmbajtjeve nga sfera e mbrojtjes së konsumatorëve për shkollat e arsimit të mesëm me qëllim që nxënësit e shkollave të mesme të punojnë në projekte të përbashkëta të asaj problematike, lidhur ndërmjet më shumë shkollave, qyteteve dhe më gjërë.

Ministria e Financave në vazhdimësi i përcjell të rehat nga sfera e mbrojtjes së konsumatorëve te shërbimet financiare dhe në mënyrë adekuate do t'i zbatojë në ligjet në kompetencë të tij.

Ministria e Financave në vazhdimësi do të bëjë supervizion mbi kreditorët që punojnë në bazë të lejes për themelim dhe punën e dhënë nga ministri i Financave.

Vendosja Institucionale dhe ekipimi kadrovik

Përforcimi i Seksionit për mbrojtjen e konsumatorëve në **Ministrinë e Ekonomisë**, me 1 (një) punësim të ri.

Agjencia për Ushqim dhe Veterinari

Përforcimi i kapaciteteve administrative të njësisë së Organizuar për mbrojtjen e konsumatorëve shpërndarjen nga sektorët tjerë në Agjencinë /1/. Për shkak të përforcimit të inspektimit të tregut me prodhime ushqimore punësime në shërbimet inspektuese dhe trajnime /Kreu 12/.

PRIORITETET AFATMESME

Lidhur me projektin IPA "Harmonizimi i legjislacionit dhe përforcimi i kapacitetit të fushës së mbrojtjes së konsumatorëve" deri në shtator 2013 do të përgatitet ligj i ri për mbrojtjen e konsumatorëve ku do të zbatohen direktivat e reja nga sfera e Mbrojtjes së konsumatorëve.

Për shkak të nevojës së transponimit të **Rregullativës 2006/2004/ BE** për bashkëpunim ndërmjet trupave kompetent përgjegjës për zbatimin e rregullave ligjore për mbrojtjen e konsumatorëve, në shtator 2013 **Ministria e Ekonomisë** në bashkëpunim me institucionet do të përgadisë analizë dhe Plan aksionar për transponimin e kësaj Rregullative.

Realizimi i aktiviteve nga Programi për mbrojtjen e konsumatorëve për periudhën 2013-2014, më vitin 2013.

Agjencia për ushqim dhe veterinari do të vazhdojë me azhurnimin e bazës së të dhënave për ankesat e paraqitura nga konsumatorët me qëllim të analizimit të rreziqeve për të cilat sugjerojnë konsumatorët. Do të azhurnohen të dhëna, këshilla, informata në Ueb faqen në hapësirën e caktuar për konsumatorët.

Përforcimi i bashkëpunimit me sektorin joqeveritar me planifikim të projekteve të përbashkëta në implementimin e politikës së konsumimit.

Vendosja Institucionale dhe ekuipimi kadrovik

Përforcimi i Seksionit për mbrojtjen e konsumatoreve në **Ministrinë e Ekonomisë**, me 1 (një) punësim të ri.

Në **Agjencinë për Ushqim dhe Veterinari** do të vazhdojë përforcimi i njësisë Organizative për mbrojtjen e konsumatorëve me punësime të reja. /1/. Për shkak të përforcimit të mbikëqyrjes së tregut me prodhime ushqimore punësime në shërbimet inspektuese dhe trajnime /Kreu 12/.

PËRKRAHJA E HUAJ

Projekti IPA për përkrahjen organizatave joqeveritare (OJQ) për përkrahjen e konsumatorëve

,ë vitin 2012 do të fillojë realizimi i projektit IPA "Harmonizimi i legjislacionit dhe përforcimi i kapacitetit të fushës së mbrojtjes së konsumatorëve".

Projekti do të zgjasë nga 2012-2014 dhe pritet harmonizim i plotë i legjislacionit konsumues, afërsisht mbrojtje e njëjtë e konsumatorëve si ano në BE-në dhe ngritje e veçantë e kapacitetit të institucioneve qeveritare dhe joqeveritare për krijim të mëtejshëm të mëvetësishëm dhe mbajtjen e politikës së mbrojtjes së konsumatorëve.

Shpenzimet e përgjithshme për projektin arrijnë 1.400.000 EUR, me çka pjesëmarrja në BE arrin 1.260.000 EUR. Projekti përbëhet nga dy komponentë.

Për komponentin e parë të projektit - Harmonizimi i legjislacionit nacional me Acquis komunitare dhe ndërtimit të kapacitetit të Ministrisë së Ekonomisë janë paraparë 700.000 EUR (Service Contract) prej të cilave 560.000 EUR nga IPA dhe 40.000 EUR Pjesëmarrje Nationale (Buxheti i RM-së).

Për komponentën e dytë - Përkrahje financiare e drejtpërdrejtë e organizatave joqeveritare (OJQ) nga sfera e mbrojtjes së konsumatorëve është paraparë 800.000 EUR (Grant Contract) nga të cilat 760.000 EUR të BE, 40.000 EUR kofinancim nacional dhe 40.000 EUR pjesëmarrje private.

3.28.2. SHËNDETI PUBLIK

GJENDJA RRJEDHËSE

Masat horizontale (legjislacioni, resurset njerëzore, investimet)

1. Legjislacioni shëndetësor

Legjislacioni nga sfera e sigurisë së gjakut, sëmundjet ngjitëse, kontrollit të duhanit, është harmonizuar me legjislacionin evropian. Në sferat tjera, legjislacioni nacional i përcjell rekomandimet dhe politikat evropiane.

Është miratuar Strategji për amësi të sigurt, dhe në fazë të përgatitjes janë Strategjia për përparimin e shëndetit seksual dhe reprodutiv dhe Strategjia për kontroll të rezistencës antimikrobike.

Është arritur përfshirje të përgjithshme të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë (RM) me siguri shëndetësore. Për kategori të caktuara të banorëve sigurohen shërbime shëndetësore të domosdoshme themelore dhe plotësuese përmes implementimit të 17 programeve shëndetësore nacionale vertikale të financuara çdo vit nga ana e Buxhetit të RM-së, në bazë të Ligjit për mbrojtje shëndetësore.

Ministria e Shëndetësisë (MSH) vendosi praktikë të rregullt për punë me organizatat joqeveritare nga sfera dhe hapi qendër për komunikim me publikun të ashtuquajtur "Telefon të bardhë." Ku do të pranohen thirrjet nga qytetarët dhe do të sigurohet ndihmë për zgjedhje juridike ose zgjedhje tjetër për problemin e tyre, ankesë, keqardhje etj.

Në përgatitje është Ligji i ri për mbrojtje shëndetësore me të cilin avancohet shëndetësia publike. Vendimet e Propozim-ligjeve përfshinë qasje më të mirë të shërbimit shëndetësor për qytetarët (financiare, Fizike, gjeografike), në veçanti për grupe të prekura të popullatës, si dhe grumbullimin e mjeteve plotësuese të prodhimit dhe qarkullimit të prodhimeve të duhanit dhe prodhimeve të alkoolit, të dedikuara për programet publike-shëndetësore.

Resurset njerëzore në shëndetësi

Zhvillimi i resurseve njerëzore është një nga qëllimet kryesore të Strategjisë Shëndetësore. Në pajtim me Ligjin për evidentime në shëndetësi, në Institutin për shëndet publik (ISHP) është formuar regjistër për resurse njerëzore. Ekziston mjedis përkrahës i legjislacionit për zhvillim të mëtejshëm të resurseve njerëzore (dhe në sektorin arsimor dhe të shëndetësisë).

Në rrjedhë është edhe vendosja e hartës medicinale (www.medicinskamapa.gov.mk) si institut për përcaktimin e gjendjes faktike në lidhje me hapësirën, pajisjen dhe kuadrit në shëndetësi, dhe i cili do të ndihmojë në miratimin e politikave për zhvillim në shëndetësi.

Gjatë vitit në vazhdimësi janë bërë trajnime të inspektorëve shtetërorë sanitar dhe shëndetësorë nga sfera e të drejtave të pacientëve, sëmundjeve ngjitëse dhe jo ngjitëse dhe janë përgatitur instruksione për punën e sferave të caktuara.

ISHP-ja është nominuar si Qendër Zhvillimore për sisteme dhe shërbime shëndetësore-publike të Evropës Juglindore, nga ana e Rrjetit Shëndetësorë të Evropës Juglindore (RRSHEJL) dhe është koordinator i projektit rajonal është realizuar projekt i përbashkët me shkollën e Londrës për higjienë dhe mjekësi tropikale dhe është nënshkruar Memorandum për kuptueshmëri dhe bashkëpunim. ISHP-ja zhvillon kapacitete në qendrën për edukim në shëndetin publik dhe koordinator të aktiviteteve për përgjigje të shpejtë të gjendjeve të krizës.

Në suaza të projektit për menaxhim në sektorin shëndetësorë është formuar edhe qendër edukative plotësisht e pajisur për mjekësi familjare në suaza të së cilës vazhdon implementimi i aktiviteteve edukative për specialistët me mjekësi familjare dhe trajnimin plotësues të mjekëve për mbrojtjen primare shëndetësore të mjekët familjarë.

2. Investimet në shëndetësi

Në fazën përfundimtare është realizimi i projektit për rekonstruimin dhe ndërtimin e objekteve të institucioneve shëndetësore publike, si dhe implementimin e projektit për ndërtimin e 17 objekteve shëndetësore - ambulanca në rajonet e largëta të fshatrave ku deri tani nuk kanë ekzistuar objekte shëndetësore, me çka do të përmirësohet qasshmëria e kualitetit e shërbimeve shëndetësore, si dhe siguria pacientëve.

Zbatohet projekti për rekonstruimin e ndërtimit të objekteve në institucionet publike shëndetësore në Maqedoni, ndërsa është realizuar furnizimi e një pjese të pajisjes medicinale në suaza të projektit për furnizimin e pajisjes medicinale për Institucionet Publike Shëndetësore.

Shërbimi për ndihmë urgjente mjekësore është modernizuar me GPRS aparatet dhe me softuerin për përcjelljen e lëvizjes së automjeteve.

Vazhdojnë aktivitetet për implementimin e kartelës elektronike shëndetësore Janë lëshuar rreth 22000 E -kartela shëndetësore për ekipet mjekësore dhe për pacientët në pilot ordinancat, ndërsa në vazhdimësi zhvillohen edhe trajnime për punën e sistemit ku janë kyçur personeli shëndetësorë, personeli IT nga Fondi për Sigurim Shëndetësor i Maqedonisë (FSSHM) dhe personeli i njësisë rajonale të FSHS-së në Shkup.

Në suaza të implementimit të sistemit për sistem të integruar shëndetësor informativ është furnizuar harduer, softuer i sistemit për Institucionet Publike Shëndetësore (IPSH) dhe sistem plotësues për magazinimin e të dhënave për FZOM-në me shumë të përgjithshme prej rreth 2,65 mil OSD.

Investimet në sigurinë e gjakut vazhdojnë përmes projektit IPA. Me marrjen e mjeteve nga ORIO programi i qeverisë Holandeze, në shumë të përgjithshme prej 6,3 milion euro do të përforcohen kapacitetet për amësi të sigurt.

1. KONTROLI I DUHANIT

Korniza juridike

Ligji për mbrojtje kundër duhanit (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 36/95,70/03,29/04,37/05,103/08,140/08) e zbaton masa e BE-së 32001L0033 për reklamimin dhe sponzorimin e prodhimeve të duhanit. Ndalim të plotë të pirjes së duhanit në vendet publike zbatohet nga 01 janari 2010. Nga prilli 2010 filloi edhe implementimi i "Rregullores së fotografive për ndikimin e dëmshëm të duhanit "(Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 94/09, 135/09) me të cilën janë

përcaktuar fotografitë si paralajmërim nga të cilat duket qartë ndikimi i dëmshëm i pirjes së duhanit. masa BE

Kapaciteti institucional

Inspektorati Shtetëror Sanitar dhe Shëndetësor (ISHSSH), inspektorët e Drejtorisë për ushqim (DU), inspekcioni tregtar, inspekcioni i arsimit janë kompetent për kontrollin e implementimit të legjislacionit. DSZI gjatë vitit 2010 zbatoi mbikëqyrje të forcuar në lidhje me kontrollin e zbatimit të Ligjit për mbrojtje nga pirja e duhanit në organizatat shëndetësore. Gjatë vitit 2010 DZSI-ja zbatoi mbi 1500 kontrole mbikëqyrëse.

IJZ-ja botoi Raport për rezultatet nga hulumtimi i zbatuar për përdorimin e duhanit te nxënësit nga 13-15 vjet.

2. SËMUNDJET NGJITËSE

Korniza juridike

Ligji për mbrojtjen e popullatës nga sëmundjet ngjitëse (Gazeta Zyrtare e RM-së 99/09) siguron bazë juridike për aktivitetet nga sfera. Aktet nënligjore me të cilat legjislacioni evropian është bartur plotësisht në sistemin nacional juridik janë miratuar që nënkupton harmonizim të plotë me masat e BE-së 32000D0096 dhe 32000D0057. Sistemi për zbulim dhe njoftim të hershëm, me ndihmën e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh), është futur në tërë vendin. Paraqitje e detyrueshme është theksuar në pajtim me ALERT sistemin. Ligji për shëndet publik siguron aktivitete më të fokusuar për implementimin e Rregullave Shëndetësore Ndërkombëtare (RRSHN).

Është përgatitur Udhëzim për definimin e rastit me çka në tërësi do të kryhet transponimi i masës së BE-së 31998D2119, si dhe Rregullorja për kontrole shëndetësore të personave që vuajtur tifon e kuqe, dizenterinë bacilare ose salmonelozën.

Është përgatitur plan pesëvjeçar për imunizim. Është futur vaksinë për HPV te vajzat me moshë prej 12 vite, dhe është zbatuar kampanjë për njoftimin e popullatës me vaksinën e re. Bashkëpunim me qendrën Evropiane për kontrollin e sëmundjeve ngjitëse të BE-së në Stokholm (ECDC) do të formohet përmes miratimit të planit aksionar për bashkëpunim bilateral.

Gjatë vitit 2010 vazhdoi implementimi i aktiviteteve të planifikuara për preventivën dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse dhe imunizimin, të parapara në Programet publike shëndetësore (Programi për shëndetin publik, Programi për hulumtimin e paraqitjes, zgjerimit, pengimin dhe luftimin e brucelozës te njerëzit në RM-së, Program për mbrojtjen e popullatës nga HIV/SIDA, Program për imunizim të detyrueshëm të popullatës në RM-së).

Komisioni për sëmundje infektive pranë MSH miratoi Program për eliminimin e fruthit të vogël dhe rubeolës dhe preventivën nga infektimi me rubeolën kongjenitale në RM-së 2010-2015.

Kapaciteti institucional

Është vendosur rrjet i mirë institucioneve shëndetësore. Koordinimi nga sfera është vendosur përmes Komitetit ekspert për sëmundje ngjitëse. Bashkëpunimi i organizatave nga sfera: MSH (MSH), IJZ-së, DU-së dhe ISHSSH-së është në bazë përditshme.

ISHSSH-ja zbaton mbikëqyrje të forcuara në lidhje me zbatimin e imunizimit, paraqitjen dhe evidentimin e sëmundjeve ngjitëse, infeksioneve intraspitalore dhe kontrollin e udhëtarëve në komunikacionin ndërkombëtar në kalimet kufitare për personat të cilët shkojnë dhe kthehen nga tubime masovike (HAXH-i).

Gjatë vitit 2010 u mbajtën tre seminare për edukimin e punëtorëve shëndetësorë të involvuar në zbatimin e kontrollit mbi zbatimin e imunizimit (ekipet preventive në shtëpitë e shëndetit, epidemiologët nga qendrat për shëndet publik (QSHP), përfaqësues nga ISHSSH-ja), për zbatim praktik të Rregullores së re për imunoprofilaksë, hemioprofilaksë, peronat të cilët u nënshtrohen këtyre masave, mënyra e realizimit dhe mbajtjes së evidencës dhe dokumentacioni, me theks të posaçëm të formularëve të ri për evidentimin dhe njoftimin për punën e kryer, si dhe 14 trajnime influencë pandemike me të cilën janë përfshirë mbi 800 të punësuar shëndetësorë.

Inspektorët e ISHSSH-së vizituan trajnim edhe për rezistencë antimikrobike (RAM), për preventivën e shëndetit oral dhe për menaxhim me hedhurinat medicinale.

Ka vazhduar bashkëpunimi me SZO-në në fushën e sëmundjeve infektive dhe imunizimit, si dhe me UNICEF-in, ndërsa ekspertët që punojnë në sferën e epidemiologjisë me ftesë të ECDC-së

dhe SZO-së vizituan më shumë seminare, punëtori dhe mbledhje të punës me tema që i mbulon kjo sferë e mjekësisë.

HIV/SIDA

Më vitin 2010 u vazhdua me implementimin e aktiviteteve në pajtim me Programin për Mbrojtjen e popullatës nga HIV-SIDA dhe Strategjia për HIV-SIDA-në 2007-2011, ndërsa u implementuan edhe aktivitetet e parapara me programin e financuar nga Fondi Global për luftë kundër HIV-SIDA-së, tuberkulozës dhe malaries (FGATM), me qëllim për preventivën së zgjerimit të HIV-SIDA-së dhe mbajtjes së preventivës ende të ulët nga kjo sëmundje në RM-së.

Aktivitete nga programit zbatohen përmes MSH-së, 11 Organizatave Joqeveritare (OJQ), si dhe Ministrisë së Drejtësisë, Spitalit Psikiatrik "Shkup" të Shkupit, Klinika për sëmundje infektive dhe gjendje afebrile dhe IJZ-ja.

Gjatë tërë vitit zbatohet këshillim institucional dhe testim në IJZ, si dhe studimet biobehaviorale te popullatat me rrezik më të madh dhe ka përfunduar studimi te të dënuarit, pjesëtarët e popullatës së MSM-së (meshkujt që bëjnë seks me meshkuj), dhe PID (personat të cilët injektojnë drogë). Në rrjedhë është zbatimi studimit të njëjtë biobehavioral te popullata te punëtorët seksual (PS). Në muajt e fundit nga viti 2010 filloi edhe studimi bibehavioral për HIV-SIDA-në te popullata njerëz të rinj të moshës 15-24 vite. Përmes HVO-së të kyçur në programin janë zbatuar aktivitete të drejtuara drejt grupeve të rrezikshme (shfrytëzuesve të drogës të cilët injektojnë, punëtorë seksual, MSM dhe të dënuar) edhe atë: Sigurimin e mbrojtjes psiko-sociale, kondomë, lubrikantë, sigurimin e ndihmës themelore mjekësore, aktivitete edukative, këshilla në teren dhe testim.

Është paraqitur aplikim i ri te Fondi global për luftë kundër sidës dhe tuberkulozës (FGATM) e quajtur si qasje e qëndrueshme drejt përgjigjes për HIV-SIDA për grupet në rrezik në RM-së në lartësi prej 9.407.934 EUR Përgjigja për aplikimin pritët deri më 15 Dhjetor 2010.

TUBERKULOZA

Zbatohen aktivitetet e Strategjisë për kontrollin e tuberkulozit (TB) përmes implementimit të Programit "Përforsimi i kontrollit të tuberkulozit në suaza të decentralizimit të shërbimeve shëndetësore në RM-së", të financuar përmes grantit nga GFATM-ja. Programi i plotëson aktivitetet e Programit për masat preventive për pengimin e tuberkulozit te popullata, i financuar nga Buxheti i RM-së. Zbatimin e aktiviteteve e zbaton Instituti për sëmundjet e mushkërive të bardha dhe tuberkulozë me rrjetin prej 17 ente medicinave në gjithë vendin, si dhe 4 organizata joqeveritare.

Në qershor 2011 është miratuar Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për zbatimin e Ligjit për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.82/2011), me çka u shfuqizuan kompensimet e caktuara në shumë prej 5.000 dhe 2.000 denarë, që u paguan për përpunimin e kërkesës për ndërmarrjen e veprimeve doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale, respektivisht për përpunimin e kërkesës për vazhdimin e afatit të kërkesës për ndërmarrjen e veprimeve doganore.

Në tetor 2011, është miratuar Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 135/2011), me çka u saktësuan obligimet e bartësve të së drejtës, sipas të cilës ata në afatin e përcaktuar prej dhjetë ditëve të punës pas marrjes së njoftimit për mbajtjen e përkohshme të mallit nën dyshimin se e njëjta e shkel të drejtën e pronësisë intelektuale, duhet ta njoftojnë organin doganor se nëse me mallin është shkellur e drejta e pronësisë intelektuale, me dorëzimin e argumentit për procedurën e filluar para gjykatës kompetente ose kërkesës për zbatimin e procedurës së thjeshtësuar me pëlqim me shkrim për shkatërrimin e mallit. Nëse nuk e bëjnë këtë, Drejtoria Doganore mund ta shfuqizojë vendimin për pranimin e kërkesës së tyre për ndërmarrjen e veprimeve doganore, në rast kur bartësi i së drejtës e humb të drejtën që të parashtrojë kërkesë të re para përfundimit të një viti nga dita e plotfuqisë së vendimit për shfuqizim.

Me miratimin e ndryshimeve në Rregulloren për zbatimin e Ligjit për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.82/2011), fshihet neni 6 me të cilën është përcaktuar shuma, respektivisht sasia në denarë për përpunimin e kërkesës për përpunimin e kërkesës së parashtruar nga bartësi i së drejtës së pronësisë intelektuale kur ndërmerren veprimet nga ana e organit doganor. Me propozim-ligjin për ndryshimin e Ligjit për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale, që është në procedurë Qeveritare, propozohet edhe fshierja e dispozitës nga ky ligj me të cilin përcaktohet baza se mund të paguhet ky kompensim në shumën e përcaktuar nga ministri i Financave.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Drejtoria Doganore vendosi një portal të jashtëm për parashtrimin elektronik të kërkesës për ndërmarrjen e veprimeve doganore në sistemin elektronik për menaxhimin me dokumentet (EDMS), si dhe bazën e të dhënave të kërkesave të pranuar që është e vendosur në internet portalin e Drejtorisë Doganore, për përdorim intern dhe shkëmbimin e informatave në mes të njëjësive organizative.

PRIORITETET AFATSHKURTA KORNIZA JURIDIKE

Në kuadër të Projektit IPA 2008, do të kryhet harmonizim plotësues i Ligjit të doganave dhe Rregullores për zbatimin e Ligjit doganor me ligjvënien doganore të BE-së, sidomos në pjesën e dispozitave të transistit elektronik, në drejtim të realizimit të kushteve të domosdoshme ligjore për inoperabilitet dhe interkonektime me sistemet e BE-së dhe Konventën për transit të përbashkët, që është kusht për vendosjen dhe përdorimin e NCTS sistemit transit, për të cilën tregon edhe rekomandimi i udhëzimeve doganore (Customs Blueprints) të Komisionit Evropian.

Ndryshimet dhe plotësimet e reja të Rregullores për zbatimin e Ligjit doganor do të jenë në drejtim të harmonizimit të dispozitave që kanë të bëjnë me procedurën elektronike të transistit me dispozitat e Konventës për transit të përbashkët. Me këto ndryshime inkorporohen dhe definojnë nocionet e reja si psh "pika transite", definohet përdorimi i llojeve të reja të deklaratave transite „T-“, „T2“ dhe „T2 F“, kryhet ndryshimi i shënimeve të Rregullores që janë në lidhje me përdorimin e procedurës transite dhe kryhen ndryshime të reja të domosdoshme për zbatimin e procedurës së përbashkët transite, në pajtim me rregullat e Konventës për transit të përbashkët.

Do të kryhen edhe ndryshime plotësuese në Rregulloren për mënyrën e plotësimit të deklaratës doganore dhe Kodit të shifrave që përdore, që pritet të miratohet në vitin 2012, në pajtim me dispozitat e Konventës për transistin e përbashkët. Me këtë ndryshim do të rregullohet përdorimi i deklaratave transite, eksportuese, hyrëse, dalje dhe përmbledhëse të parashtruara me përdorimin e teknikës për përpunim elektronik të të dhënave (deklaratat elektronike) dhe përdorimit të shifrave plotësuese për sistemin kompjuterik të doganave që përdoret për plotësimin e këtyre deklaratave.

Në vitin 2012, planifikohet harmonizimi i mëtejshëm i Ligjit për tarifën doganore me Rregullativën e Këshillit (EEC) Nr. 2658/87 për nomenklaturë tarifore dhe statistikore.

Gjithashtu, planifikohet miratimi i Vendimit për harmonizimin dhe ndryshimin e Tarifës Doganore për vitin 2013, që do të harmonizohet me nomenklaturën e Kombinuar për vitin 2013, si dhe miratimin e rregullativave të Komisionit për bashkësitë Evropiane për renditjen e mallrave të caktuara në Nomenklaturën e kombinuar që janë miratuar në vitin vijues me plotësimin e Rregullores për zbatimin e rregullativave të Komisionit për Bashkësisë evropiane për renditjen e mallrave të caktuara në nomenklaturën e kombinuar.

Drejtoria Doganore do të përgatis ndryshime dhe plotësime të reja të Ligjit për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale, me çka do të saktësohen obligimet e bartësve të të drejtave për dorëzimin e të dhënave në lidhje me mallrat që janë origjinale (para se gjithash për vlerën prodhuese të origjinalit), do të përcaktohet afat konkret në të cilin bartësit e të drejtës do të jenë të obliguar që të zbatojnë shkatërrimin e mallit për të cilin Drejtoria Doganore në procedurë të thjeshtësuar ka miratuar leje për shkatërrimin, e njëherit e shkel të drejtën e pronësisë intelektuale. Do të përcaktohet edhe e drejta e Drejtorisë doganore pas përfundimit të afatit të përcaktuar për shkatërrim që vet të zbatojë procedurë për shkatërrimin e mallit në fjalë, me çrast shpenzimet e shkatërrimit do të bien mbi bartësin e të drejtës. Në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë do të kryhet edhe revidimi i politikës ndëshkuese të vendosur me këtë ligj, me mundësinë e futjes së përgjegjësisë kundërvajtëse për personat që kanë paraqitur për hyrje, dalje ose transit të mallrave që e shkelin të drejtën e pronësisë intelektuale.

Pas miratimit të këtyre ndryshimeve ligjore do të pasojnë ndryshime dhe plotësime të Rregullores për zbatimin e Ligjit për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale, sidomos të formularin e Kërkesës për ndërmarrjen e veprimeve doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Në bazë të ndryshimeve të miratuara në legjislativë (aktet ligjore dhe nënligjore), Drejtoria Doganore do t'i avancojë procedurat interne për zbatimin e ligjvënies doganore dhe

akcionare. Gajtë përgatitjes së procedurave të avancuara interne në veçanti do të kemi parasysh sistemin e ri për përpunimin e dokumenteve doganore dhe të akcizave.

Në vijim janë aktivitetet e projektit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për vendosjen e sistemit të integruar elektronik për menaxhim me rrezik - CAP, që ka për qëllim të mundësojë kontroll më efikas, të koordinuar, tejkufitar të mallrave që hyjnë në Republikën e Maqedonisë dhe ta përshejtojë procedurën për zbatimin e formaliteteve të nevojshme në kalimet kufitare, me zbatimin e analizës paraprake të rreziqeve dhe shkëmbimit në kohë të informatave të nevojshme në mes të organeve kompetente.

Në kuadër të aktiviteteve projektuese të fazës initiale, në janar 2011 Qeveria e Republikës së Maqedonisë e miratoi Elaboratin për inkorporimin e sistemit unik t elektronik për analizën e rrezikut gjatë zbatimit të kontrolleve gjatë importit dhe transitit të mallit, të përgatitur nga grupi i punës i formuar nga ana e Qeverisë. Në vijim është faza e planifikimit të projektit, në kuadër të të cilit janë definuar proceset e reja të punës që do të përfshihen me CAP sistemin dhe po punohet në përgatitjen e specifikimit teknik dhe të përdoruesve të sistemit dhe harmonizimin e rregullativës së nevojshme për zbatimin e sistemit.

PRIORITETET AFATMESME KORNIZA JURIDIKE

Drejtoria doganore do të punojë në inkorporimin e ligjit të modernizuar doganore të BE-së dhe të Rregullores për zbatimin e ligjit të modernizuar doganor. Me ndryshimet e ligjvënies doganore do të fillojë procedura për inkorporimin e tërësishëm të dispozitave nga LDM dhe aktivitetet për zbatimin e saj të plotë dhe zbatim praktik, në pajtim me rekomandimin e udhëzimeve doganore (Customs Blueprints), që mestjerash e potencon edhe nevojën për harmonizimin në domenin e dorëzimit të informatave para arritjes (pre-arrival) dhe para nisjes (pre-departure) së dërgesave.

Në pjesën e lirimit nga pagesa e shpenzimeve importuese do të kryhet harmonizim i plotë me Rregullativën e BE-së për lirimin nga pagesa e shpenzimeve doganore dhe inkorporimin e tyre në ligjin nacional doganor.

Drejtoria doganore do të marr pjesë në ndryshimin e ligjit për kontrollin e eksportit të mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfshtë me çka do të bëhet harmonizimin me ndryshimet e Rregullativës së BE 428/2009 dhe ndryshimn e listës nga Lista 1 e Rregullativës.

Do të miratohen ndryshime në Ligjin për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe të Rregullores për zbatimin e Ligjit për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale, për miratimin e rregullativës së re të BE-së për masa për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale, që do t'i ndryshojë Rregullivat Ekzistuese nr. 1383 nga 2003 dhe nr.1891 nga 2004.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Drejtoria doganore do të organizohet në aspekt institucional dhe do të adaptohet ndaj ndryshimeve në ligjvënien.

3.29.2 KAPACITETI ADMINISTRATIVE DHE OPERATIV

GJENDJA VIJUESE

KORNIZA JURIDIKE

Drejtoria doganore mbetet e përkushtuar ndaj përpjekjeve të saja për arritjen e nivelit më të lartë të përsosjes dhe harmonizimit me rekomandimet praktike rreth kriterëve precize të definuara sipas zbatimeve më të mira praktike të BE-së në domenin e doganës dhe tatimit (Customs and Fiscal Blueprints) dhe ligjvënies evropiane. Përcillet zhvillimi i kapacitetit operativ dhe në bazë të dallimeve të konstatuara në mes të gjendjes aktuale dhe standardeve evropiane, planifikohen aktivitetet e ardhshme reformuese.

Në maj 2011 në Drejtorinë doganore është miratuar Plani strategjik i Drejtorisë Doganore të Republikës së Maqedonisë 2011- 2013, që i pasqyron qëllimet dhe detyrat e Drejtorisë Doganore për periudhë prej tre viteve.

Në dhjetor 2011 do të miratohet plan Aksionar i Drejtorisë Doganore të Republikës së Maqedonisë për vitin 2012, në të cilin janë përcaktuar misioni i Drejtorisë Doganore dhe funksionet e saja institucionale, vizioni, detyrat dhe obligimet që janë përcaktuar në Planin Strategjik të Drejtorisë Doganore 2011-2013, lista e prioriteteve qëllimeve strategjike për periudhën 2011-2013 dhe formularin aksionar me aktivitetet e shërbimeve në Drejtorinë Doganore. Gjatë definimit të Planit aksionar janë pranuar rekomandimet e udhëzimeve doganore (Customs Blueprints) të Komisionit Evropian që tregojnë për domosdoshmërinë e detyrave të definuara saktë, të disa njësive të caktuara organizative, me funksione të veçanta dhe përgjegjësi që janë të përpunuara në udhëzimet për metodat e punës.

Në prill 2011 janë miratuar ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Drejtorinë doganore (Gazeta zyrtar e Republikës së Maqedonisë nr. 53/2011), me çka u krye harmonizimi me Ligjin për procedurën penale që doli nga kompetenca e re e Drejtorisë doganore për ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve dhe hulumtimit kriminalistik të veprave penale nga sfera e punës doganore dhe harmonizimit të Ligjit për themelimin e Komisionit shtetëror për vendimarrje në procedurë administrative dhe procedurën e mardhënies së punës në shkallë të dytë, me të cilën e drejta e ankimit nga sfera e marrhënies të punës do të realizohet para një organi të veçantë të formuar nga ana e Kuvendit të RM. Me këtë ndryshim dhe plotësim u bë edhe saktësim plotësues të mënyrës së krijimit dhe përfundimit të marrhënies së punës, punës provuese, vendosjes dhe përgjegjësisë disiplinore të nëpunësve doganor. Njëherë u bë edhe përjashtimi nga ky rregull i të punësuarve me statusin e fituar të nëpunësve doganor nga kategoria e nëpunësve shtetëror që u inkorporua për kompetenca të caktuara që i kryen Drejtoria Doganore. Si rezultat i këtyre ndryshimeve, janë bërë edhe ndryshime adekuate në Rregulloren për organizimin e punës së Drejtorisë doganore dhe Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës. Ndryshimet e miratuara në Ligjin e drejtorisë doganore janë pjesë e aktiviteteve që në vazhdimësi janë ndërmarrë në sferën e përmirësimit të kapacitetit organizativ dhe operativ, me harmonizimin e standardeve dhe zbatimeve më të mira praktike në BE.

Masat preventive për eliminimin e korrupsionit në rradhët e drejtorisë doganore e përfshijnë funksionimin e plotë të saj si institucion dhe nuk janë në lidhje vetëm me statusin e të punësuarve. Janë vendosur sisteme të qëndrueshme që mundësojnë kontroll të dukurive korruptive dhe devijuese dhe pengimit të tyre në kohë, kontrollit të vazhdueshëm dhe të drejtpërdrejtë të rreziqeve të profiluara me inkorporimin e vazhdueshëm të kapaciteteve të veta institucionale dhe administrative. Për atë qëllim është përgatitur udhëzimi për mënyrën e sjelljes së nëpunësve doganor dhe të punësuarve në Drejtorinë doganore në rastet kur ju ofrohet mitmarrje, e cila është në pajtim me rekomandimet e GRECO.

Është miratuar strategjia për integritet dhe luftë kundër korrupsionit në Drejtorinë Doganore 2011 - 2014, në të cilën janë inkorporuar parimet dhe obligimet që dalin nga konventat që Republika e Maqedonisë i ka ratifikuar, e që kanë të bëjnë me Drejtorinë doganore dhe ekspozimin ndaj korrupsionit dhe rreziqeve tjera operative si Konventat e Këshillit të Evropës për vepra penale dhe të drejta civile (ETC 173 udhe ETC 174), Konventës së KB kundër korrupsionit (Dokumenti A/PEC/58/4 nga 2003). Është dorëzuar informatë deri te Qeveria e Republikës së Maqedonisë për shkallën e realizimit, që është pranuar. Në pajtim me Rekomandimet e Raportit për përparimin e arritur të Republikës së Maqedonisë nga tetori 2011, Drejtoria doganore si organ i zbatimit dhe kryerjes së ekzekutimit të ligjeve do të ndahet si shtyllë e veçantë në Planin Aksionar të Programit shtetëror për prevenim dhe shkeljen e korrupsionit 2011-2015. Në fazë përfunduese janë përgatitjet e planit ku do të inkorporohen indikatorë të veçantë dhe aktivitete për plotësimin e tyre nga ana e Drejtorisë doganore. Së këndej, miratimi i Planit aksionar i Drejtorisë doganore për prevenim të korrupsionit mvaret nga miratimi i Programit shtetëror për prevenim dhe eliminimin e korrupsionit 2011-2015.

Janë ridefinuar pikat e qëllimit që janë më të prekshme ndaj korrupsionit, që më pas do të pasonte analizimi i vazhdueshëm dhe mbikqyrja e organizuar në të gjitha nivelet. Është vendosur evidence e obligimeve të ndërmarra nga Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit. Drejtoria Doganore e Republikës së Maqedonisë merr pjesë në grupin punues të BE-së për matjen e rezultateve nga zbatimi i rregullativave ligjore dhe reformave. Në vijim është miratimi i metodologjisë adekuate që në mënyrë të plotë do të harmonizohet me qëllimet strategjike të Drejtorisë doganore, me indikator të harmonizuar kyç për matjen e suksesit të pjesmarrjes së nga puna e doganës së vendeve anëtare të BE-së. Këto indikator duhet të përfshihen në përgaditjen e pilot projektit për matjen e rezultateve nga zbatimi i rregullativave ligjore dhe reformave.

Në tetor 2011 Drejtoria Doganore miratoi rregullore për mënyrën e avancimit të nëpunësve doganor, me të cilin është përcaktuar sistemi për avancimin e nëpunësve doganor, respektivisht mënyra dhe procedura e realizimit të karrierës. Njëkohësisht sigurohet që avancimi të kryhet në procedurë transparente, në bazë të aktiviteteve dhe kualifikimeve profesionale të nëpunësve doganor, aftësisë së tyre të punës, trajnimeve të kryera gjatë marrëdhënies së punës dhe vlerësimit për punën e realizuar, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra e lëkurës, bindja politike dhe fetare.

Në shtator 2011 është miratuar Strategjia për menaxhim me resurset njerëzore të Drejtorisë doganore 2012-2014, për zhvillimin e elementeve themelore të sistemit për menaxhim me resurse njerëzore në Drejtorinë doganore në periudhën nga viti 2011-2013. Me këtë Strategji përcaktohet qëllimi i menaxhimit me resurset njerëzore, parimet themelore të menaxhimit, politikat për menaxhim dhe aktivitetet strategjike për periudhën 2012-2014, me qëllim të sigurimit, ndërtimit, ruajtjes dhe zhvillimit profesional të të punësuarve. Strategjia për menaxhim me resurse njerëzore i pasqyron hapat pozitiv që ndërmerren për përmirësimin e menaxhimit me resurset njerëzore, zhvillimit të procedurave administrative, ndërtimit të karrierës, trajnimit të avancuar dhe nivelit të rritur të kapacitetit organizativ, trajtimit të njëjtë të të gjithë të punësuarve, në plotësimin e rekomandimit të dhënë me udhëzimet doganore të Komisionit Evropian rreth strategjisë së menaxhimit me resurset njerëzore, politikat dhe sistemet për përkrahje të plotë të realizimit të qëllimeve të vendosura.

Gjatë vitit 2011 janë vendosur kritere për matjen e suksesit të lëndëve kundërvajtëse, administrative, disiplinore dhe penale dhe përfaqësimit para gjykatave, është formuar Komitet për zhvillimin e kapacitetit institucional dhe administrativ të Drejtorisë doganore dhe është rregulluar procedura për ndarjen dhe marrjen e shenjave dhe gradave të nëpunësve doganor.

Aktivitetet e ndërmarra në sferën e forcimit të kontrolleve dhe veprimeve për sigurimin e zbatimit të rregullave ligjore, në periudhën e kaluar u konkretizuan me: Miratimin e Strategjisë për menaxhim me rrezikun 2011-2014, projektit të miratuar për analizë dhe selektim të automatizuar të dërgesave në pajtim me analizën dhe vlerësimin e rrezikut, dhe informatat para arritjes nga sistemi SEED, aplikimit të përgatitur për evidencë elektronike dhe dhënien e TIR certifikateve, sistem elektronik për evidentimin dhe përcjelljen e vëllimit të punës së kalimeve kufitare (qarkullimit të automjeteve, udhtarëve, kundërvajtjeve, kontrolleve, etj.) - SIM, zbatimin e stop listave në Border aplikimin për shkak të selektimit të automatizuar të dërgesave në kalimet kufitare. Aktivitetet e ndërmarra dhe ato që janë planifikuar për të ardhmen, bazohen në standardet evropiane për shkëmbimin e përmirësuar të informatave, zhvillimin e mëtejshëm të moduleve të selektuara (të përpunuara enkas për kalimet kufitare), programe gjithpërfshirëse për trajnimin e të punësuarve që kryejnë funksione operative dhe analizën e rrezikut.

Aktivitetet e përsosjes së vazhdueshme të punës së Laboratorit doganor vitin e kaluar rezultuan me rregullimin e procedurës së kryerjes së analizave dhe dhënies së rezultateve, si dhe zgjerimit të mënyrës së ruajtjes së pajisjes dhe hapsirave punues , me miratimin e

udhëzimeve adekuate dhe vendosjes së procedurave të defuinuara. Në laboratorin doganor përpunohen dhe inkorporohen metoda standarde, sipas rregulativave të BE-së dhe metodat në pajtim me udhëzuesin laboratorik të Organizatës botërore doganore.

Në pajtim me rekomandimet dhe IT misionin e parë të DG TAXUD, Drejtoria doganore ndërmerr aktivitete për zhvillimin dhe implementimin e sistemit të ri SPDD (Sistemi për përpunimin e deklaracioneve doganore).

Në janar 2009, Drejtoria Doganore lidhi marrveshje me Konzorciumin ITAMAK, e udhëhequr nga Administrata Doganore e Republikës së Italisë, për implementimin e sistemit. Në prill 2011, përfunduan afatet e fundit të përcaktuara me marrveshje, respektivisht realizuesi nuk e dërgon sistemin në afatin e kontraktuar. Drejtoria doganore në drejtim të realizimit të kushteve të domosdoshme për interoperabilitet dhe interkonektive me sistemet e BE-së, në shtator 2011 shpallën tender të ri për blerjen e SPDD.

Me këtë projekt, në periudhën 2012 – 2014, Drejtoria doganore do të inkorporojë edhe implementojë Sistem të ri për përpunimin e deklaratave doganore dhe dokumenteve të akcizave (SOCDAD) – zgjidhje që në kuadër të procedurave doganore dhe akcize do t'i sigurojë Drjetorisë doganore menaxhim me deklaratat doganore dhe dokumentet e akcizave (parashtrimin, pranimin, evidentimin, përpunimin, arkivimin), kontrollin e lëvizjes së mallrave të akcizave dhe shkëmbimit të porosive elektronike në kuadër të kryerjes automatike administrative të operacioneve, efikasitetit në zbatimin e kontrolleve rreth shpenzimeve të paguara dhe të kthyerat doganore, akcizave, taksave dhe shpenzimeve tjera, lehtësimin e tregtisë përmes qarkullimit të përsheptuar të mallit, përmirësimin të sigurisë në zinxhirin e furnizimit, në pajtim me standardet e Bashkimit Evropian dhe Organizatës botërore Doganore.

Qëllimi strategjik për vendosjen e ambientit pa letra, do të sigurohet me implementimin e deklaratës elektronike. Ky sistem do të mundësojë shkëmbimin e të dhënave në mes të organeve doganore dhe operatorëve ekonomik, si dhe në mes të organeve doganore dhe institucioneve qeveritare. Në kuadër të implementimit të SOCDAD të ri është paraparë interkonektimi i NCTS dhe ITE sistemeve të BE-së, që do të realizohet përmes projekteve të finansuara nga IPA 2008 dhe IPA 2009 Me implementimin e sistemit të ri të përpunimit të të dhënave do të inkorporohet edhe nomenklatura e integruar doganore dhe statistikore e BE- TARIC (TARIM), në drejtim të realizimit të prioriteteve strategjike, siç është rritja e numrit të kompanive që përdorin procedura më të thjeshta dhe forcimin e mekanizmave të mbikqyrjes.

Është paraparë dërgesë me faza e SOCDAD në këto faza:

Faza 1 - Sistemi për transit dhe nënsistemet e SOCDAD (me realizim të planifikuar deri më 31.08.2012)

Faza 2 - Sisteme për import dhe kontroll të importit (me realizim të planifikuar deri më 31.12.2012)

Faza 3 - Sisteme për eksport dhe kontroll të eksportit (me realizim të planifikuar deri më 30.04.2012)

Faza 4 - Sisteme për menaxhim me akciza, mbrojtjen e pronësisë intelektuale dhe laboratorinë doganore (me realizim të planifikuar deri më 31.08.2012)

Faza 5 - Integrimi final i SOCDAD (me realizim të planifikuar deri më 31.12.2013)

Në nëntor 2011 përfundoi faza e dytë për avansimin e EXIM sistemit në kuadër të të cilit është kryer përgatitja e EXIM sistemit për integrimin me CDPS sistemin e Drjetorisë doganore, integrimin e EXIM sistemit në Sistemin e përcjelljes së dërgesave veterinerë të Agjencisë për ushqim dhe veterineri. Janë përpunuar dhe implementuar ndryshimet e nevojshme për bartjen e kontrollit të Inspektoratit shtetëror për bujqësi nga terminalët e brendshme të kalimeve kufitare, janë kryer edhe ndryshime për inkorporimin e lejeve të reja dhe shfuqizimin e lejeve ekzistuese, si rezultat i ndryshimeve në rregullativën ligjore, janë përpunuar më shumë regjistra dhe kontrolle të reja. Është përpunuar modul i ri për

evidentimin e lejeve për transport ndërkombëtar të mallrave dhe udhtarëve. Është kryer revision i sigurisë së sistemit dhe janë implementuar vërejtjet e dorëzuara.

Në nëntor 2011 filloi faza e tretë e avancimit të sistemit, që realizohet në kuadër të marrveshjes për mirmbajtje vijuese të EXIM sistemit. E njëjta duhet të realizohet deri në shkurt 2012, në të cilën është paraparë avancimi i funksionaliteteve të sistemit dhe implementimin e ndryshimeve në rregullativën që ka të bëjë me këtë sferë.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Reformat që i zbaton drejtoria doganore për forcimin e efikasitetit organizativ dhe operativ, përmes zbatimit të kontrolleve të rregullsisë, në pikat kufitare, lehtësimin e kalimit legal të udhtarëve dhe mallrave, sigurimin e pagesës së shpenzimeve doganore, sigurimin e sigurisë publike dhe përforcimin e kapaciteteve të angazhuara në luftën kundër mashtrimeve dhe korpursionit, u përkrahën nga Projekti IPA 2007 "Përkrahja teknike për përforcimin e kontrollit kufitar", i financuar nga Bashkimi Evropian, që përfundoi në kuartalin e parë të vitit 2011.

Përpjekja e forcuar në luftën për parandalimin e tregtisë ilegale dhe aktiviteteve kriminale, manifesohej në vazhdimësi edhe përmes bashkpunimit me institucionet tjera. Në shtatori 2011 është nënshkruar memorandum për bashkpunim në mes Ministrisë së Punëve të Brendshme, Drejtorisë Doganore, Drejtorisë së policisë financiare, dhe Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë, me çka rregullohet mënyra e realizimit të koordinimit dhe bashkpunimit të ndërjellë në sferën e shkatërrimit të falsifikimit të parave. Në sferën e veprimit për eliminimin e falsifikimit të parave, janë realizuar edhe trajnime të përbashkëta dhe është vendosir Zyre personale për hetime në sferën e luftës kundër eliminimit të falsifikimit të parave, pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme. Trajnimet e përbashkëta do të vazhdojnë të jenë pjesë përbërëse e aktiviteteve të realizuara në bashkpunim me institucionet tjera që janë përgjegjëse për hetime dhe zbatimin e ligjit, një përcaktim i definuar me standardet evropiane.

Përcaktimi për bashkpunim më të mirë me institucionet dhe organet tjera u vërtetua edhe me lidhjen e Memorandumit për mirkuptim dhe bashkëpunim në mes organeve të mbikqyrjes së tregut dhe Drejtorisë Doganore (shkurt 2011), me të cilin rregullohet koordinimi i mbikqyrjes së tregut të prodhimeve që futen në treg, si dhe zbatimi i parimeve të përgjithshme të "CE" shënimit.

Nga puna e Trupit koordinues për mbikqyrjen e tregut, dolën konkluzione rreth grupeve të prodhimeve për të cilët gjatë importit zbatohen masa të forcuara afatshkurte përmes profilimit të kriterëve të rrezikut. Përmes trajnimit të nëpunësve doganore u inkorporuan dispozitat e Ligjit për mbikqyrjen e tregut, për njohjen e suksesshme të prodhimeve dhe definimin e grupeve të prodhimeve ku bëjnë pjesë.

Është përgatitur propozim-plan projektues për implementimin e modulit "Mbikqyrje e tregut" në SIM aplikacionin, me qëllim që të sigurohet baza elektronike e të dhënave, qasje e njëanshme dhe lehtësimi i shkëmbimit të informatave me organet e mbikqyrjes së tregut.

Në pajtim me Strategjinë për zhvillimin e IKT dhe Strategjisë për implementimin e interoperabilitetit, janë përgatitur nga Drejtoria doganore dhe janë miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, u definuan këto aktivitete me plan për realizimin e tyre (Aktivitete në pajtim me Strategjinë për zhvillimin e IKT), Aktivitete për zbatimin e politikës për menaxhim me resurset njerëzore në IKT sektorin, Analiza dhe plane për trajnim në pajtim me nevojat, Përgatitja dhe realizimi i planit për angazhimin e përkrahjes nga jashtë, Inkorporimin dhe zbatimin e metodologjisë për menaxhim të përgjithshëm me projektet, Konsolidimi i sistemeve (platformave harduerike dhe softuerike), Azhurnimin e procedurave ekzistuese dhe inkorporimin e procedurave (IT) operative, Inkorporimin e sistemit për mbrojtjen e të dhënave dhe rikrijimin pas katastrofave.

Në pajtim me rekomandimin e dhënë për vlerësimin sipas zbatimeve më të mira praktike në BE në domenin e doganave (Customs Blueprints), në lidhje me marrëdhëniet me opinionin dhe komunikimin, ku theks i vihet promovimit të rolit të ri të Doganës dhe sigurimit të informatave të nevojshme për mediet, është përgatitur Strategjia për marrëdhënie me opinionin nga ana e Drejtorisë Doganore. Qëllimi kryesor i Strategjisë është dorëzimi në kohë, i saktë dhe i organizuar i informatave deri te të gjitha grupet e interesuara. Aktivitetet e parapara do të jete për qëllim të japë një kuptim më të mirë të rolit të Drejtorisë doganore, ruajtjen e besimit politike dhe publike, mbeshtetje dhe qëndrim pozitiv për të administratës doganore dhe punonjësit e saj nepermjet një rrjedhje të dyanshem e informacionit, promovimit, prezantimit dhe transmetimit të rezultateve dhe sukseseve të arritura në operacionet doganore për publikun, ngritjen e vetedijes publike rreth punës së oficerëve të doganave është vendimtare për të mirën publike dhe të sigurisë.

Në maj 2011 Qendra Rajonale e Trajnimit të Organizatës Botërore të Doganave u mbajt në Shkup Punetori rajonale në kuadër të standardeve të autorizuar operatorit ekonomik, në mënyrë që të shqyrtoje zbatimin e Kornizës së standardeve të Organizatës Botërore të Doganave dhe koncepti i operatorit të autorizuar ekonomik e cila përfshin miratimin e Programit për krijimin e konceptit të operatorit të autorizuar ekonomik.

Në prill 2011 është miratuar Strategjia për punë e qendrës Trajnuese rajonale të Organizatës botërore doganore në Shkup. Strategjia i definon qëllimet dhe politikën e sistemit të trajnimeve dhe grupeve të qëllimit, si dhe rreziqet në lidhje me të. Ky dokument është i dedikuar që t'i përmirësojë aktivitetet rajonale për trajnim, që të sigurojë programe për trajnime të vazhdueshme specializuese dhe trajnime profesionale për nëpunës doganor dhe biznes bashkësia, që të mundësojë avancimin e nëpunësve doganor në punën profesionale, në pajtim me standardet e Organizatës botërore doganore, përdorimin e metodave dhe formave bashkëkohore për sigurimin e trajnimeve të vazhdueshme, siguron platformë për e-mësim.

Në janar 2011 është miratuar Strategjia për trajnime dhe përsosje profesionale të nëpunësve doganor. Strategjia duhet të vendos një sistem të qëndrueshëm, stabil dhe gjithpërfshirës dhe zhvillim të nëpunësve doganor që do t'i plotësojë nevojat e ndryshme të nëpunësve doganore dhe Drejtorisë doganore si individ dhe njëherë do të kontribuojë drejt realizimit të qëllimeve strategjike të shtetit dhe Drejtorisë doganore. Në strategjinë përcaktohet politika dhe definohet sistemi i trajnimeve që do të mundësojë që Drejtoria doganore t'i realizohu qëllimet e përcaktuara me Ligjin dhe planin strategjik - vënien e potencialeve të përgjithshme në funksion të krijimit të shërbimit profesional dhe kompetent doganor, e aftë që të japë shërbime me kualitet të lartë. Strategjia e trajnimit dhe aftësimin profesional të oficerëve të doganave duhet të ofrojë një game të gjere të metodave interaktive të trajnimit të zhvilluar nga plotësisht të shfrytëzuar mundësitë për trajnim, në baze të zbatimit të praktikave më të mira në BE.

Në korrik 2011 u miratua një program të trajnimit fizik dhe i arteve marciale të doganiereve, nën të cilat aktivitetet do të zbatohet në trajnimit fizik dhe trajnimin për përdorimin e armëve.

Gjatë vitit 2011 në kuadër të Programit Dogana 2013, u perkthye kursi për mësim elektronik për TVSH Direktivën e BE-së dhe i njëjti është vendosur në internet dhe intranet faqen e Drejtorisë doganore. Është nënshkruar memorandum për perkthimin e kursit për mësim elektronik të Sistemit për percjelljen e prodhimeve të akcizës. Është nënshkruar memorandum për perkthimin e kursit për mësim elektronik të Sistemit për percjelljen e prodhimeve të akcizës.

Aktivitetet e modernizimit të Shërbimit Doganor janë kryer në fushën e rritjes së standardeve në kalimet kufitare, në baze të rekomandimeve të bera nga udhëzimet

doganore te Komisionit Evropian per nevojen per redizajnimin e kalimeve kufitare ne Republikën e Maqedonisë. Në kuadër të Projektit TTFSE II, jane ndertuar objekte të reja dhe jane rikonstruktuar ato ekzistuese në kalimin kufitar të udhëtarëve në Bllacë. Per lehtësimin e mëtejshëm qarkullimin e mallrave dhe udhetareve duke rritur kapacitetin e kalimeve kufitare, te kryer pergatitjet per ndertimin e input-output terminale me te gjitha te lidhura GP GP permbajtjen Qafthane dhe prodhimin terminal Tabanovc (pergatitjen e dokumentacionit te projektit dhe te dokumentacionit teknik leje).

PRIORITETET AFATSHKURTËRA KORNIZA JURIDIKE

Ne 2012 do te miratohet nje ligj i ri i Drejtorisë doganore që do t'i qartesoje pergjegjesite e Drejtorise doganore ne baze te ndryshimeve te legjislacionit ne sistemin e ligjeve qe lidhen me operacionet doganore te cilat ndjekin trendet evropiane dhe ndryshimet dhe percaktimin e sakte te shprehjeve te caktuara ligjore dhe institutet, e cila do te kontribuojne ne funksionimin me mire dhe me funksionale te Drejtorise doganore.

Ne 2012 do te fillojne dhe te perfundojne dy fazat e para të sistemit te shperndarjes per perpunimin e deklaratave doganore dhe dokumentet e akcizes (SOCDAD), qe mbulon krijimin e nje sistemi transit dhe nensistemet e SOCDAD dhe Sistemet për import dhe kontroll te importit. Gjate fazes se katert per avancimin e sistemit të EXIM, jane planifikuar aktivite per te bere ndryshimet e nevojshme dhe permiresimet e sistemit dhe integrimin te saj me sistemin e ri elektronik per menaxhimin e rrezikut (SAR), e cila duhet te themelohet si rezultat i aktiviteve ne kuader te grandit të Qeverise se Republikes se Maqedonise per te vendosur sistemin e integruar elektronik per menaxhimin e rrezikut - CAP.

Drejtoria doganore e fuqizon rekomandimin e dalur nga Projekti rajonal për standarde doganore dhe tatimore, që e potencon nevojën që të vazhdohet me zbatimin e SEED aplikimit, si mjet për përkahje të aktiviteve për zbatimin e ligjit dhe aktiviteve të ndërmarra në sferën e sigurimit dhe sigurisë. Projekti SEED që ka për qëllim që të vendoset sistem për shkëmbimin e të dhënave në mes të Drejtorisë Doganore dhe Republikës së Maqedonisë dhe administratave doganore të Kosovës, Serbisë dhe Shqipërisë, pas zbatimit të suksesshëm të fazës së parë (si pjesë e projektit TACTA e BE-së me të cilin sigurohet ndihma teknike e vendeve në rajon dhe përpunimi i domenit të përbashkët në zgjidhjen softuerike) tani zbatohet në fazën e dytë, me përkrahjen e projektit ndërkombëtar në kuadër të IPA 2010 - Shkëmbim elektkronik sistematik të të dhënave në vendet e ballkanit perëndimor (Systematic Electronic Exchange of Data (SEED) in the Eastern Balkans) Aktivitetet e kesaj faze jane planifikuar per t'u zbatuar deri ne fund te gjysmes se pare te vitit 2012 e përfshijnë: [ndihmën teknike per perdoruesit ne zbatimin e aktiviteve te projektit dhe prokurimi i sherbimeve keshilluese per prokurimin e pajisjeve te nevojshme dhe licencave softëare te nevojshme per funksionimin e SEED aplikacioneve..](#)

Financimi dhe blerja e pajisjes do të jenë në përgjegjësi të administratave dhe përdoruesve ose do të sigurohen me ndihmë tjetër të donatorëve potencial.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Drejtoria doganore në kuadër të procedurës për furnizimin e softuerit të ri për përpunimin e deklaratave doganore dhe dokumenteve të akcizave - SOCDAD, parasheh një aplikacion të ri për evidentimin e konfiskimeve në bazë të shkeljes së të drejtave të pronësisë intelektuale. Me këtë aplikacion dukshëm do të avancohet sistemi për mbajtjen e evidencës për kërkesat e pranuar për ndërmarrjen e veprimeve doganore dhe për mallrat e bllokuara për të cilat ekziston dyshim se shkelin të drejtën e pronësisë intelektuale. Zbatimi i këtij aktiviteti do të paraqes edhe një plotësim të standardit evropian, të prononcuar si rekomandim gjatë vlerësimit të fundit të kapacitetit administrativ dhe operativ, të kryer në kuadër të projektit Rajonal për standarde doganore dhe tatimore.

Aktivitetet e planifikuara në sferën e të drejtave të pronësisë intelektuale do të përfshijnë edhe kampanjen për ngritjen e vetedijes për pasojat e demshme për shendetin nga

perdorimi i prodhimeve të falsifikuara, sidomos tek popullata më e re. Propozim-programi për realizimin e kampanjes është në fazën perfundimtare të përgaditjes.

Marreveshje institucionale dhe organizimi për veprim të suksesshem në fushën e aktiviteteve doganore hetimore në vitin e ardhshëm do të përfshijë në mesin e rregullimeve të tjera në baze të ligjit të ri të Procedurës Penale i cili hyn në fuqi në nëntor 2012, miratimi i një strategjie për parandalimin e trafikut ilegal të narkotikeve dhe do të thotë që rrezikojnë shëndetin e njeriut, miratimi i strategjise për parandalimin e trafikimit të paligjshëm të armeve, krijimin e një sistemi të shkëmbimit të informatave në formë elektronike nga linjat ajrore (para nisjes dhe para-ardhjen) dhe analiza automatizuar dhe perzgjedhjen e udhëtareve dhe mallrave bazuar në vlerësimin e rrezikut për t'u marrë me kercenimet ndaj sigurisë, krijimit të një sistemi të analizave të automatizuar dhe zgjedhja e ngarkesave në analizat dhe vlerësimin e rrezikut, dhe informacione të para ardhjes së sistemit SEED, krijimi i një sistemi informacioni të automatizuar (njoftimet) për të ndryshuar të dhënat e kompanive të regjistruara dhe statusin e rrezikut të personave në të njëjtin (në mënyrë që të merren me shmangien e mundshme të tatimeve), zbatimi i një moduli elektronik për "mbikeqyrjen e tregut" (me modul zgjerimin dhe zhvillimin e softuerit të zgjidhjeve për shkëmbimin elektronik të informacionit dhe njoftimeve midis autoriteteve doganore dhe mbikeqyrjen e tregut.

Mirembajtjen e planifikuar është paraqitja e të kuptojnë me mirë drejtimin për zhvillimin e zyrtareve të doganave dhe punonjësit e Drejtorisë doganore në rastet kur është ofruar mito. Do të vendosen standarde për vlerësimin e suksesit në parandalimin e korrupsionit dhe forcimin e integritetit të Drejtorisë doganore.

Varësisht nga zbatimi i ligjit të ri për procedurë penale janë paraparë procedura dhe instruksione për të punësuarit në Sektorin e përgjegjësisë profesionale dhe trajnimit të tyre. Sipas Rregullores së re për organizimin e punës së DDRM është planifikuar inkorporimi i Seksionit për integritet në përbërje të Sektorit për standarde profesionale.

Është parashikuar se të paktën 20% e punës me kohe të pjesëshme oficeret doganor të rrotullohen në përputhje me udhëzimet e miratuara për ripozicionimin dhe rotacionin e personelit në administratën doganore, veçanërisht ata që punojnë në punë të profilizuara me rrezik të lartë të korrupsionit dhe të sjelljes të paligjshme.

Sektori për përgjegjësi profesionale do të vazhdojë me analizë të detajuar dhe adaptimin e pikave të caktuara të qëllimit që janë më të nenshtruar për korrupsion, si dhe me evidencën e obligimeve të ndermarra nga Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit. Gjate miratimit të metodologjise se duhur që do të përafronet plotësisht me objektivat strategjike të administratës doganore, në përputhje me treguesit kryesorë për matjen e suksesit të performancës së doganave të Shteteve Anetare. Këto indikatorë duhet të përfshihen në përgaditjen e Pilot projektit për matjen e rezultateve nga zbatimi i rregullativave ligjore dhe reformave.

Në vitin 2012 do të miratohet Rregullore e re për organizimin e punës së Drejtorisë doganore me të cilin do të bëhen ndryshime më të mëdha në strukturën organizative të Drejtorisë doganore. Njësitë e reja organizative në Drejtorinë doganore do të konstituohen në bazë të parimit të ndarjes funksionale të proceseve themelore të punës në Drejtorinë doganore, si dhe funksionet përkrahëse dhe krahasuese në korelacion me proceset themelore dhe vitale. Me çrast duhet të merren parasysh edhe të gjitha ndryshimet në rregullativën ligjore të dalura nga vetë procesi i punës, ose të dalura nga harmonizimi i ligjvënies nacionale me atë evropiane.

Si rezultat i Rregullorës së miratuar për organizimin e punës së Drejtorisë doganore do të miratohet edhe rregullore e re për sistematizimin e vendeve të punës në drejtorinë doganore, me të cilin do të formohen përshkrime nga të gjitha vendet e punës sipas standardeve bashkëkohore evropiane, me një përmbledhje të kompetencave, aftësive dhe aftësive karakteristike për çdo vend pune, vlerësim adekuat t.e vlerësimi i vendeve të punës dhe sistematizimin dhe ekipimin e tyre.

Për afrimin ndaj standardeve evropiane dhe për plotësimin e kushteve për akreditim të Laboratorit doganor, gjatë vitit 2012 do të përkushtohet një vëmendje të veçantë në kualifikimin plotësues të të punësuarve në Laboratorin doganor, përmes trajnimeve të planifikuara sipas kërkesave të standardit 17025. Pritet që Laboratori të jetë i akredituar më së voni deri më 2015.

Në kuadër të projektit për inkorporimin e NCTS, janë paraparë trajnime përgatitore për përdorues kyç, që do të vazhdojnë edhe në 2012. Pas përfundimit të trajnimeve për përdoruesit kyç parashihen trajnime për trajnues, që më pas do t'i trajnojnë nëpunësit doganor. Aktivitetet për trajnimin në lidhje me procedurën transituëse, do të realizohen në pajtim me rekomandimin e drejtorive Doganore të Komisionit Evropian, si lidhje e aktiviteteve që duhet të ndërmerren për plotësimin e kapaciteteve të angazhuara në domenin e transitit.

PRIORITETET AFATMESME

KORNIZA JURIDIKE

Me Strategjinë për zhvillimin e IKT dhe Strategjisë për implementimin e interoperabilitetit u përcaktuan nevojat, hapat dhe modalitetet për fillimin e procedurës administrative për lidhjen me sistemet e BE-së, para se gjithash CCN/CSI и NCTS, si dhe ITE.

Në pajtim me atë, është realizuar veprimi ndaj IPA fondeve me këto aktivitete:

Në kuadër të IPA 2008, „Interoperability of the Customs Administration of the Republic of Macedonia IT System ëith the EU Customs IT Systems – NCTS and CCN/CSI“, janë paraparë këto aktivitete:

- Asistenca teknike në menaxhimin e implementimit të NCTS,
- Zhvillimi i softuerit (implementimi i NCTS)

Në kuadër të IPA 2009 - Implementimi i sistemit të integruar tarifor i Bashkësisë Evropiane, (Community Integrated Tariff Environment – CITE) do të realizohen këto aktivitete:

- Asistenca teknike në menaxhimin me implementimin e ITE (Ambient i integruar tarifor - Integrated tariff environment);
- Implementimi i ITE;
- Blerja e pajisjes së nevojshme.

Në kuadër të IPA 2010, është planifikuar harmonizim i mëtejshëm i ligjvënies doganore dhe të akcizës. Theks i veçantë do të vihet në harmonizimin e ligjvënies së Ligjit të moderuar doganore të BE-së dhe rregullativës për implementimin e të njëjtit. Paralelisht do të qaset drejt forcimit të kapaciteteve në domenin e menaxhimit me akcizat.

Në kuadër të IPA 2011, në kontekst të forcimit të kapaciteteve për plotësimin e obligimeve për anëtarësim në BE, përmes Komponentës për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, nënkomponenta - Përforsimi i kapaciteteve të Drejtorisë doganore për përdorimin dhe zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, është planifikuar që të jepet kontribut drejt zhvillimit ekonomik të shtetit përmes mbrojtjes efikase dhe adekuate dhe zbatimit të të drejtave të pronësisë intelektuale, në pajtim me kërkesat evropiane dhe ndërkombëtare. Aktivitetet projektuese në veçanti do të kontribuojnë në harmonizimin e mëtejshëm të ligjvënies dhe procedurave të BE-së dhe praktikës më të mirë në zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale nga ana e doganës, si dhe përforsimit të mëtejshëm të kapaciteteve operative për: zhvillimin e strategjisë për zbatimin e hetimeve për prezencën e mundshme të krimit, zbatimit të metodologjive dhe teknikave për zbatimin me forcë të ligjvënies dhe vendosjes së analizës së përmirësuar të rrezikut dhe sistemi për menaxhim me rrezikun në këtë sferë.

Është implementuar edhe sistemi i integruar informativ (IIS). Për përdorimin e drejtë dhe të sigurtë të sistemit, janë miratuar udhëzime dhe doracak për përdoruesit. Në vijim e sipër është përsosja e të njëjtit. Sistemi përfshin edhe automatizimin e proceseve të punës në të gjitha pjesët organizative të Drejtorisë doganore. IT zgjidhjen e IIS e përbëjnë më shumë module, komponenta softuerike dhe zgjidhje për integrimin e tyre si Sistem për menaxhim elektronik të dokumenteve (EDMS) përmes arkivimit elektronik dhe përcjelljes së lëndëve,

Sistem për menaxhim me resurse njerëzore (HRM) dhe Sistem për planifikimin e resurseve (ERP) planifikimin e resurseve dhe punë materiale financiare. Në veçanti janë përpunuar modulet e Pranimit të kuadrove, Matjes së pjesëmarrjes së të punësuarve dhe Evidencës së listave anketuese për të punësuarit. Është bërë test për inkorporimin e integritit të plotës të të dhënave të sistemit për orarin e punës dhe punës jashtë orarit me ERP sistemin për llogaritjen e pagesave të të punësuarve në Drejtorinë doganore.

Sistemi për menaxhim elektronik me dokumente (EDMS) përfshinë arkivimin dhe përpunimin e dokumenteve elektronike dhe kopjeve elektronike të dokumenteve në letër, qarkullimin e dokumenteve elektronike dhe nënshkrime elektronike, përcjellje elektronike të statusit të dokumenteve nga aspekti i përgatitjes, distribucionit, lëvizjes, arkivimit, lokacionit, autenticitetit, sigurisë dhe historisë. Sistemi përfshin 170 procese të identifikuar dhe të përshkruara të punës, përcakton afate maksimale për përfundimin e proceseve të punës, identifikon lidhje në mes të proceseve të punës, llojeve standarde të dokumenteve dhe nënshkrimin elektronik të dokumenteve. Në muajin qershor të këtij viti janë implementuar këto funksionalitete të reja: mbajtja e Rregullores për lëndë të besueshme dhe dokumente, udhëheqje të avancuar të lëndëve në të cilan zbatohet procedura administrative dhe procedura kundërvajtëse. Në vijim është zhvillimi i funksionaliteteve për Evidentimin e taksave të paguara administrative dhe Evidentimi i denimeve mandatare, si dhe implementimi i një moduli të veçantë në sistemin LUCA për procedurat disiplinore dhe lidhjen e tyre me paditë nga të punësuarit. I njëjti është përsosur me allate për mbajtjen e historisë së ndryshimeve dhe qasjeve në EDMS, me mundësi për nënshkrim elektronik, mbajtjen elektronike dhe pagesën (përmes SMS) të taksave administrative, mbajtjes elektronike dhe denimeve madnatare për personat fizik dhe juridik. Në këtë periudhë do të bëhet azhurnimi dhe rregullimi i tyre i vazhdueshëm.

Laboratori doganor deri në vitin 2015 planifikon që të ketë laborator të akredituar, kryesisht për dy grupe të metodave analitike në fushën e mallrave të akcizave - metoda analitike për naftë dhe derivate të naftës dhe analizën e alkoolit dhe prodhimeve alkoolike. Aktivitetet që do të ndërmerren për akreditimin e laboratorit Doganor do të zhvillohet në përputhje me rekomandimin e udhëzimeve doganore të Komisionit Evropian për nevojën për ekipimit plotësues, sistemit për menaxhimin e kualitetit të bazuar në standardet të pranuar ndërkombëtarisht për kualitet, trajnimin plotësues të të punësuarve në laborator për aplikimin e metodave analitike të përdorura për qëllime doganore.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Për mundësimin e interkonektimin funksional me sistemet evropiane, në periudhën e nënshkrimit të Konventës për transit të përbashkët të Bashkimit Evropian, është e nevojshme vendoja e portës CCN/CSI.

Ajo ka të bëjë me vendosjen e pajisjes komunikuese me sisteme evropiane - CCN/CSI përmes këtyre aktiviteteve:

- Krijimit të ekipit për realizimin e interkonektimit;
- Blerjes së pajisjes;
- Uintegrimin e CCN/CSI infrastrukturës dhe NCTS sistemit dhe instalimit të CCN/CSI harduerit dhe softuerit;
- Teste të detyrueshme për interkonektim për CCN/CSI;
- Trajnime operative për përdorim, CCN/CSI rultje dhe central help desk funksionalitete.

Në periudhën nga 2012 deri 2014 do të bëhet avancimi i mëtejshëm i kapacitetit për menaxhimin e resurseve njerëzore, përmes mekanizmave të reja dhe atyre ekzistuese. përosjes së sistemit dhe avancimit të procedurës së selektimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve, ndërtimit të kriterëve dhe procedurave për sistemin e vetëvlerësimit të të punësuarve në aspekt të rezultateve personale nga puna, kushtet e punës dhe knaqësite e punëtorëve nga vendet e tyre të punës dhe detyrave përmes përgatitjes së pyetësorve dhe

anketave. Do të miratohet edhe akt i ri për përcjelljen dhe zhvillimin e të punësuarve dhe avancimin e tyre.

Në periudhën e ardhshme nga 2012 - 2015, do të monitorojnë aktivitetet e riorganizimit e laboratorit doganor dhe veprimet për të përmirësuar kushtet e infrastrukturës dhe teknike në laborator, i plotësimit të dokumentacionit, trajnimit e personelit për të kryer kërkesat analiza kimike e ISO 17025 përmes zbatimit të trajnimit, testeve ndër laboratorike dhe bashkëpunimi me laboratorë doganore të tjera në mbështetje të programit Customs 2013 dhe projekte të tjera.

3.30 MARRËDHËNIET E JASHTME

3.30.1 POLITIKA E PËRBASHKËT TREGTARE

GJENDJA VIJUESE

Republika e Maqedonisë në vitin 2011 ka vazhduar të zbatojë politikën e tregtisë në përputhje me detyrimet e ndërmarra ndërkombëtare që rrjedhin nga anëtarësimi në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT), Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, CEFTA, si dhe marrëveshjeve të tjera të tregtisë së lirë që detyrimet për regjimi preferencial tregtar.

Gjithashtu, vazhdoi dorëzimin e njoftimeve në OBT për masat që janë marrë në fushën e politikës tregtare, me qëllim të zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet shumëpalëshe për tregtinë e mallrave. Për masat e ndërmarra të përkohshme në fushën e politikës tregtare, u informuan edhe shërbimet kompetente të Komisionit Evropian në pajtim me Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit.

Në lidhje me raundin vijues të negociatave shumëpalëshe tregtare që mbahen në OBT - Agjenda zhvillimore nga Doha, (Doha Development Agenda) epublika e Maqedonisë ka status të vendit anëtar që sapo janë anëtarësuar (RAM - Recently Acceded Members) ga të cilët nuk do të kërkohet të ndërmarrin lëshime të mëtejshme, siç janë në bujqësi dhe NAMA (Non Agricultural Market Access). Në fushat e tjera për të cilat po negociohet, Republika e Maqedonisë si vend kandidat për anëtarësim në BE, vazhdon t'i koordinojë dhe harmonizojë qëndrimet e saja me qëndrimet e BE-së.

Republika e Maqedonis nga fillimi i vitit 2011 në mënyrë aktive u përfshi në implementimin e prioriteteve të Programit të kryesuesit të CEFTA 2006 në 2011. Ajo ishte në lidhje me hapjen e tregjeve të prokurimit qeveritare dhe arritjen e harmonisë në konkurs, dhe për të vendosur interesat e përbashkëta dhe qëllimet për të hyrë në negociata për liberalizimin e shërbimeve. Në kuadër të aktiviteteve të CEFTA 2006 për liberalizimin e tregtisë me shërbime është mbajtur një takim i Grupit Punues për Tregtinë me Shërbime, me çrast është konstatuar nevoja për shqyrtimin e barrierave ekzistuese në sektorët e shërbimeve, për të vlerësuar transparencën e tregut të shërbimeve në këto vende.

Në trupat e CEFTA-s është debatuar për eliminimin e barrierave jotarifore dhe pengesave teknike të tregtisë të vendeve të CEFTA-s, të mbështetur nga pasqyrimet e studimeve në kuadër të aktiviteteve dhe projekteve që realizohen në CEFTA, janë realizuar kontakte bilaterale me disa vende të CEFTA-s me qëllim të eliminimit të barrierave të inkorporuara jotarifore në tregtinë bilaterale. Në veçanti është intensifikuar përpilimi i rekomandimeve dhe raporteve në kuadër të Projektit ëpr kornizën multilaterale monitoruese të barrierave jotarifore të financuara nga OECD, Filloi me funksioni ueb portali tregtar i vendeve të CEFTA-s me çrast u implementua Plani aksionar në kuadër të aktiviteteve të Task Force.

Protokolli plotësues për liberalizimin në bujqësi u ratifikua dhe filloi që të zbatohet për R. e Maqedonisë, R.Shqipërisë nga 13.11.2011 Republika e Maqedonisë kontrakttoi një liberalizim të plotë në tregtinë në prodhimet bujqësore dhe ushqimore me Republikën e Shqipërisë, një Republika e Moldovës ranë dakord për një liberalizim të plotë, me përjashtim të verës të cilat është rënë dakord kuotën dypalëshe Implementimin i këtyre ndryshimeve në Aneksin 3 të Protokollit plotësues me Republikën e Moldovës do të fillojë pas njoftimit nga Depozitari për procesin e kryer të ratifikimit të Protokollit plotësues në Republikën e Moldovës.

Funksionimi i trupave në kuadër të CEFTA zhvillohej në pajtim me Marrëveshjen, respektivisht afatet për implementimin e qëllimeve të Marrëveshjes në bazë të Programit të kryesuesit të CEFTA, për vitin 2011 për Republikën e Kosovës.

Në takimin e Komitetit të përzier të CEFTA, palët e përkrahën implementimin e Programit të kryesuesit të vitit 2011, Republikën e Kosovës, si dhe funksionimit të trupave në kuadër të zbatimit të prioriteteve të Programit.

ME CEFTA, gjatë vitit 2011 u ndërmorrën aktivitete rreth fillimit të zbatimit të kumulimit diagonal në mes të R.Maqedonisë, R.Shqipërisë dhe R.Serbisë.

Konventa Rajonale për Rregulla Pan-evro-mediterane preferenciale për prejardhjen e mallrave, që Republika e Maqedonisë e nënshkroi më 15 qershor 2011 me 47 vendet anëtare, dhe e njëjta pas ratifikimit nga ana e Republikës së Maqedonisë do të mundësojë kyçjen e Republikës së Maqedonisë në Pan-evro-med kumulacionin e prejardhjes së mallrave.

Në nëntor 2011 është bërë analizë krahasuese me një pikvështrim të veçantë të rregullimit të aktiviteteve nga sigurimi kreditor, lëshimin e garancive dhe sigurimin e të njëjtave, me plan konkret aksionar për zbatimin e aktiviteteve të nevojshme për rregullimin e sigurimit afatmesëm dhe afatgjatë.

Në vitin 2011 me sukses u zbatua Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kontroll të importit të mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë (Gz.zyrtare e RM-së nr. 158/2010) me çka u bë harmonizimi i ligjit me Rregullativën e re të Këshillit (BE) 428/2009, me të cilën përcaktohet kontrolli i eksportit, transferit, brokerimit dhe tranzitit të mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë.

Në sferën e regjimit dhe kontrollit të importit të mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë, në vitin 2011 zbatohet Vendimi për përcaktimin e listës të mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 148/08). Lista e marrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë në tërësi është ndërmarrë nga rregullativa 32004R1504, Aneksi 1

KORNIZA INSTITUCIONALE

Institucione kompetente për zbatimin e politikës tregtare në Republikën e Maqedonisë janë Ministria e Ekonomisë, Ministria e Financave dhe Drejtoria Doganore e RM.

Me qëllim të përforcimit të kapaciteteve administrative, në vitin 2011 të punësuarit e Ministrisë për Ekonomi nga Sektori për bashkëpunim ndërkombëtar tregtar morën pjesë në seminare të organizuara nga Organizata botërore tregtare. Seminar rajonal për Marrëveshjen e OBT për zgjidhjen e kontesteve, Teknikave për mbajtjen e negociatave tregtare

PRIORITETE AFATSHKURTËRA

Republika e Maqedonisë do të vazhdojë me implementimin e obligimeve të ndërmarra që dalin nga aderimi në OBT si dhe obligimeve që dalin nga marrëveshjet tjera për tregëti të lirë. Në tarifën doganore për vitin 2012 do të bëhet ulja e doganave në pajtim me obligimet e ndërmarra të OBT, me çka përfundon periudha transitive për uljen e doganave për prodhimet industriale dhe në tërësi do të zbatohen obligimet e ndërmarra ndaj Protokollit për aderim me OBT.

Në dhjetor 2011 Republika e Maqedonisë si anëtare do të merr pjesë në Konferencën e tetë ministrore të OBT. Në lidhje me negociatat tregtare multilaterale – Agjendë zhvillimore nga Doha (Doha Development Agenda), Republika e Maqedonisë, si vend kandidat për anëtarësim në BE, do të bazhdojë t'i koordinojë dhe harmonizojë qëndrimet e veta me qëndrimet e BE-së në sferat që janë me interes të përbashkët.

Republika e Maqedonisë do të vazhdojë me implementimin e CEFTA dhe të Protokollit Plotësues për liberalizimin e bujqësisë në CEFTA. Gjithashtu në periudhën e ardhshme në mënyrë aktive do të kyçet në implemenim të prioriteteve sipas Programit të kryesuesit (Republikës së Shqipërisë) për CEFTA 2006 dhe 2012.

Do të vazhdojnë edhe aktivitetet e nevojshme të CEFTA Grupit të punës për tregëti me shërbime në pajtim me Planin e miratuar aksionar për periudhën 2011-2012 në të cilin janë të shënuara aktivitetet për vlerësimin e potencialeve edhe për fillimin e negociatave për liberalizimin e tregtisë me shërbime në kuadër të CEFTA me dinamikën e realizimit të tyre.

R.Maqedonisë, R.Shqipërisë dhe R.Serbisë nga 1 janari 2012 do të fillojnë me zbatimin e kumulacionit diagonal me vendet e CEFTA-s.

Republika e Maqedonisë do ta ratifikohë Konventën Rajonale për rregulla Pan-evr—mediterane preferenciale për prejardhjen e mallrave, me çka do të mundësohet përfshierja e Republikës së Maqedonisë në Pan-evro-med kumulacionin e prejardhjes së mallrave.

Në kuadër të Programit të prioriteteve të Kryesuesit të CEFTA për vitin 2012 dhe së bashku me OECD Projektin do të ndërmerren aktivitete intensive për uljen e mundësive për paraqitjen e barrierave jotarifore dhe teknike në të ardhmen. Gjithashtu do të ndërmerren aktivitete për implementimin e Planit aksionar për funksionimin e Ueb portalit tregtar me qëllim të transparencës në informimin e biznes bashkësisë.

Deri në fund të vitit 2012 është planifikuar transponimi i Direktivave 31998L0029 dhe 31984L0568 si dhe vendimeve 32001D0076 dhe 32001D0077 që kanë të bëjnë me parimet e përbashkëta dhe kriteret e vendeve anëtare të BE-së në sferën e sigurimit importues në ligjin e sigurimit të eksportit.

3.30.2 MARRËVESHJET BILATERALE ME VENDET E TRETA

GJENDJA VIJUESE

Ministra e Ekonomisë – Sektori për bashkëpunim tregtar ndërkombëtar dhe Ministria e Financave – Sektori për sistem Financiar, janë kompetente për marrëveshjet bilaterale me vendet e treta.

Republika e Maqedonisë ka lidhur më shumë marrëveshje për bashkëpunim tregtar-ekonomik me shtete tjera, që duhet të harmonizohet me obligimet që dalin nga anëtarësimi në BE. Marrëveshja në mes të Qeverisë së R. Maqedonisë dhe Qeverisë së Rumanisë për bashkëpunim ekonomik, shkencor dhe teknik është nënshkruar më 6.10.2011

Në vitin 2011 Hynë në fuqi Marrëveshja për bashkëpunim ekonomik në mes të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Hungarisë dhe Marrëveshja për bashkëpunim ekonomik në mes të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Malit të Zi.

Republika e Maqedonisë deri më tani ka nënshkruar 37 marrëveshje bilaterale për nxitjen e mbrojtjes së ndërsjellë të investimeve. Nga të gjitha marrëveshjet e nënshkruara, 31 marrëveshje kanë hyrë në fuqi, përdërisa 6 marrëveshje janë ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë dhe pritet njoftim nga palët adekuate të marrëveshjeve që t'i kenë kryer procedurat interne në vendet e tyre, që të mund që edhe këto marrëveshje të hyjnë në fuqi.

Nga numri i përgjithsëhm i marrëveshjeve të nënshkruara, 16 marrëveshje janë të nënshkruara me vende anëtare të Bashkimit Evropian dhe të gjitha 16 marrëveshjet kanë hyrë në fuqi.

Gjatë vitit 2011 janë nënshkruar Marrëveshjet për nxitjen e mbrojtjes së ndërsjellë të investimeve në mes të Republikës së Maqedonisë dhe Lituanisë dhe Republikës së Maqedonisë dhe shtetit të Katarit.

Gjithashtu gjatë vitit 2011 u ratifikua Marrëveshja për nxitjen e mbrojtjes së ndërsjellë të investimeve në mes të Republikës së Maqedonisë dhe Malit të Zi.

Në vitin 2011 tre Marrëveshje për nxitjen e mbrojtjes së ndërsjellë të investimeve hynë në fuqi edhe atë Marrëveshjet për nxitjen e mbrojtjes së ndërsjellë të investimeve të Republikës së Maqedonisë dhe Kuvajtit, në mes të Republikës së Maqedonisë dhe Sllovakisë dhe në mes të Republikës së Maqedonisë dhe Malit të Zi.

Republika e Maqedonisë në nëntor 2011 ngriti iniciativë për fillimin e procedurave për harmonizimin e tekstit të Marrëveshjes për nxitjen e mbrojtjes së ndërsjellë të investimeve me 33 shtete të reja. Dinamika e negociatave dhe harmonizimit me këto shtete do të përcaktohet në mënyrë plotësuese në varësi prej interesit të treguar nga ana e tyre dhe nga prioritetet e përcaktuara në Republikën e Maqedonisë.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Ministria e Ekonomisë – Sektori për bashkëpunim ndërkombëtar tregtar dhe Ministria e Financave – Sektori për sistem financiar, janë kompetente për harmonizimin dhe parafimin e marrëveshjeve bilaterale me vende të treta.

PRIORITETE AFATSHKURTËRA

Republika e Maqedonisë do të vazhdojë aktivitetet për analizimin dhe implementimin e marrëveshjeve për bashkëpunim tregtar dhe financiar që veç më janë nënshkruar dhe kanë hyrë në fuqi, me qëllim të harmonizimit të tyre me ligjvënien e BE-së. Në atë drejtim është paraparë që të përcaktohet kornizë kohore për harmonizimin e marrëveshjeve ekzistuese me ligjvënien e BE-së.

Marrëveshja në mes të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Rumanisë për bashkëpunim ekonomik, shkencor dhe teknik pritet që të ratifikohet në vitin 2012.

Gjatë vitit 2012 parashihet që Republika e Maqedonisë të fillojë procedurën e harmonizimit dhe parafimit të Marrëveshjes për nxitjen e mbrojtjes së ndërsjellë të investimeve me Kanadën, Republikën e Moldavisë dhe Republikën e Kosovës.

Gjithashtu gjatë vitit 2012 parashihet që Republika e Maqedonisë ta përfundojë procedurën për harmonizim dhe ta parafojë Marrëveshjen për nxitjen e mbrojtjes së ndërsjellë të

investimeve me Izraelin, si dhe Protokollin për ndryshime dhe plotësime të Marrëveshjes për nxitjen e mbrojtjes së ndërsjellë të investimeve me Republikën e Kroacisë.

3.30.3 NDIHMA ZHVILLIMORE DHE HUMANITARE

GJENDJA VIJUESE

Gjatë vitit 2011 nuk është regjistruar ndihmë zhvillimore e Republikës së Maqedonisë ndaj vendeve të treta.

Në vitin 2011, Seksioni për ndihmë zhvillimore dhe humanitare në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme realizoi aktivitete për ndarjen e ndihmës humanitare për Japonin dhe Turqinë.

Seksioni për ndihmë zhvillimore dhe humanitare, në Sektorin për marrëdhënie ekonomike multilaterale – Drejtorati për diplomaci ekonomike në Ministrinë e Punëve të Jashtme është kompetente për përcjelljen dhe krijimin e politikës në pjesën e ndihmës zhvillimore dhe humanitare.

PRIORITETE AFATSHKURTËRA

Në vitin 2012 parashihet formimi i trupit ndërresorial me qëllim të gjetjes së modelit më adekuat institucional për rregullimin e pjesë së ndihmës zhvillimore. Në atë drejtim është paraparë miratimi i Ligjit për zbatimin e politikës zhvillimore, i harmonizuar me ligjvënien e BE-së në këtë sferë.

PRIORITETE AFATMESME

Përveç miratimit të Ligjit për zbatimin e politikës zhvilluese, është e nevojshme që të definohen kriteret të qarta për përcaktimin e rrethit më të ngushtë të vendene me të cilat Republika e Maqedonisë do të vendoste bashkëpunim afatgjatë. Në mënyrë plotësuese do të përcaktohet dhe miratohet metodologjia për llogaritjen e ndihmës së dhënë, kurse do të inkorporohej edhe mekanizmi për bashkimin e të dhënave për ndihmë dhe ndarë zhvillimore.. Gjithashtu do të përgatitet edhe Strategjia për dhënien e ndihmës zhvillimore..

Njëherë, është planifikuar që të vendoset bashkëpunim i sektorit joqeveritar edhe me vendet tjera anëtare ose agjencitë e specializuara nga vendet tjera për zbatimin e projekteve zhvillimore trilaterale.

Në pjesën e ndihmës humanitare është paraparë pranimi i Rregullativës 31996R1257 për ndihmë humanitare. Gjithashtu planifikohet harmonizimi me koncenzusin Evropian për ndihmë 52007DC0317.

Është planifikuar përforcimi i kapaciteteve ekzistuese administrative me punësime të reja të Seksionit për ndihmë zhvillimore dhe humanitare.

MBROJTJE DHE SHPËTIM

Në pjesën e mbrojtjes civile, Propozim-ligji për ratifikimin e Memorandumit për mirëkuptim në mes të Republikës së Maqedonisë dhe Bashkimit Evropian për pjesmarrje në Mekanizmin për mbrojtje civile të Bashkësisë dhe Instrumentit Financiar për mbrojtje civile është miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe është dorëzuar deri te Kuvendi. Në pjesën e bashkëpunimit me Komisionin Evropian, aktivitetet vazhdojnë përmes pjesmarrjes në projektin e financiar përmes Instrumentit për ndihmë para-aderuese në pjesën e ambientit jetësor me uljen e rreziqeve nga katastrofat të titulluar "Bashkëpunimi në mbrojtjen civile me vendet me status të kandidatit dhe kandidate potenciale". Qëllimi i

projekteve është afrimi i vendeve pjesmarrëse (vendeve kandidatë për anëtarësim në BE dhe kandidatët potencial) deri te Mekanizmi i mbrojtjes civile të Bashkësisë dhe kontribuimin për zhvillimin e kapaciteteve të tyre për ballafaqim me rastet urgjente. Aktivitetet e këtyre projekteve janë ndarë në disa komponenta që përfshijnë trajnime dhe shkëmbimin e ekspertëve, pjesmarrje në ushtrime rajonale trajnuese si dhe puntori me tema të rëndësishme për mbrojtjen civile. Të punësuarit nga Drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim morën pjesë në dy kurse themelore dhe një Kurs për menaxhment operativ qëllimi i të cilit është forcimi i kapaciteteve dhe të koordinimit gjatë zbatimit të operacioneve për dhënien dhe pranimin e ekipeve ndërkombëtare për mbrojtje civile si dhe lehtësimin e komunikimit dhe bashkpunimit me Mekanizmin për mbrojtje civile të Bashkësisë. Gjithashtu një ekip nga Drejtoria e mbrojtjes dhe shpëtimit mori pjesë në një trajnim ndërkombëtar IPA SI-KVEJK 2011 që u mbajt në Slloveni nga 20-23 tetor të këtij viti. Qëllimi i trajnimit është që vendet që përdorin IPA, të afrohen më afër mënyrës së punës së Mekanizmit për mbrojtje civile të BE-së, që t'i forcojnë kapacitetet personale për përgjigje dhe ta avancojnë bashkëpunimin rajonal.

Në aspekt të trajnimeve ndërkombëtare, Drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim gjithashtu këtë vit mori pjesë në NATO/EADRCC trajnimin në Republikën e Maqedonisë, KODRII 2011. Qëllimi i trajnimit është forcimi i bashkëpunimit në mes të vendeve pjesmarrëse përmes komunikimit të lehtësuar tej-kufitar në mes të shteteve, ushtrimin e koordinimit dhe bashkëpunimit në mes të organizatave ndërkombëtare etj.

Në aspekt të kornizës juridike janë miratuar të gjitha dokumentet strategjike të parapara me Ligjin për mbrojtje dhe shpëtim, të nevojshme për funksionimin efikas të sistemit.

Implementimi i obligimeve të dalura nga Memorandumi i mirkuptimit dhe bashkëpunimit në sferën e mbrojtjes dhe shpëtimit të njerëzve dhe të mirave materiale nga katastrofa natyrore dhe të tjera, në mes të Drejtorisë për mbrojtje dhe shpëtim dhe Agjencisë Daneze për menaxhim me situata të jashtëzakonshme, i nënshkruar në shtator 2010, vazhdon në fazën e dytë me projekt që do ta përfshijë bashkëpunimin në pjesën e mbulimit të pjesmarrjes së Republikës së Maqedonisë në aktivitetet ndërkombëtare në sferën e mbrojtjes dhe shpëtimit, në pjesën e ndërtimit dhe forcimit të kapaciteteve gjatë kryerjes së operacioneve për mbrojtje dhe shpëtim etj. Gjithashtu këtë vit është bërë donacion i ARGOS sistemit, që do të përdoret për detektimin dhe paralajmërimin e hershëm nga rreziqet radiologjike, kimike, biologjike dhe nukleare si dhe për përmirësimin e menaxhimit me kriza incidente RHBN, si dhe pajisje për një ekim për RHBN mbrojtje dhe shpëtim. Në aspekt të ARGOS sistemit, të punësuar na Drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim po vijojnë trajnimet e pjesës së dytë për përdorimin e të njëjtit.

Bashkëpunimi në mes të Drejtorisë për mbrojtje dhe shpëtim dhe Agjencisë Daneze për menaxhim me situata të jashtëzakonshme do të vazhdojë edhe në vitin 2012 dhe 2013 me çka në masë të madhe do të forcohet kapaciteti institucional i Drejtorisë në pjesën e organizimit dhe zbatimit të trajnimit të forcave për mbrojtje dhe shpëtim.

Qendra për menaxhim me kriza ishte kryesuese në emër të Republikës së Maqedonisë në Këshillin e planifikimit civil-ushtarak në situata të jashtëzakonshme për vendet e Evropës Juglindore (CMEP SEE) për vitin 2011. Në pajtim me programin e aktiviteteve për vitin 2011, QMK në bashkëpunim me Ambasadën e SHBA në Republikën e Maqedonisë, organizoi evenimente të numërta. Me pjesmarrje të përbashkët në formatin CMEP SEE, vendet me status të kandidatit dhe vendet anëtare të BE-së me shkëmbimin e përvojave dhe roleve të përbashkëta në skenaret për gjendjen emergjente civile i forcojnë kapacitetet rajonale në aspekt të pranimit dhe ofrimit të ndihmës ndërkombëtare.

Drejtoria Gjenerale e Bashkimit Evropian për ndihmë humanitare dhe mbrojtje civile e miratoi IPA programin "Bashkëpunimi në sferën e mbrojtjes civile për vendet kandidatë dhe kandidatët potencial" (2011-2012), me qëllim të afrimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë drejt Mekanizmit për mbrojtje civile të BE-së. Qendra për menaxhim me kriza mori pjesë në punëtori që kanë të bëjnë me miratimin teorik dhe praktik të parimeve të Mekanizmit për mbrojtje civile të BE-së, duke i përgatitur ekspertët që të punojnë me Mekanizmin, respektivisht me EU MIC në procesin e kërkesës dhe ofrimit të ndihmës, si dhe të forcohet bashkëpunimin në mes të përdoruesve dhe atyre që ofrojnë ndihmë.

Qendra për menaxhim me kriza është institucion implementues i numrit të vetëm evropian për thirrje urgjente E-112, që derl nga BE direktivat në vijim: 2009/136/EC, 2002/58/EC dhe Rregullativa 2006/2004. Në bazë të gjithë kësaj të përmendur më lartë është përpunuar fizibiliteti studim që udhëzon në zgjidhjen e plotës dhe e njëjta është miratuar nga ana e Qeverisë së RM-së.

Vendosja e sistemit E-112 dhe inkorporimit të numrit të vetëm për thirrje urgjente është përcaktuar me dispozita të Ligjit për menaxhim me kriza për çka në vitin 2011 u bënë ndryshime dhe plotësime në këtë drejtim, kurse gjithashtu u bënë edhe ndryshime të caktuara edhe në Ligjin për komunikime elektronike.

Në kuadër të implementimit të qëllimit partnerial të NATO-s "Menaxhimi me gjendje emergjente përfshirë edhe sulme terroriste", nga ana e Qendrës për menaxhim me kriza është përgaditur draft verizon për procedurat standarde operative për bashkëpunim ndërresorjal, koordinim dhe përdorim të resurseve në kushtet e gjendjes së krizës, në të cilët është përfshirë edhe segmenti i Pranimit të ndihmës humanitare (Host Nation Support). Me këto procedura operative do të forcohet gatishmëria e RM-së për pranimit të koordinuar dhe efikas të ndihmës ndërkombëtare humanitare, përfshir edhe nga BE-ja.

Në periudhën nga 26-27.05.2011 u realizua vizitë tripalëshe e drejtorëve të institucioneve të ngjashme nga Republika e Shqipërisë dhe Kosovës në të cilën konkluzione të përbashkëta për zhvillim dhe thellimin e bashkëpunimit rajonal në mes të Republikës së Maqedonisë, Shqipërisë dhe Kosovës në sferën e menaxhimit të krizave.

Qendra për menaxhim me kriza ishte bashk-organizator dhe bashk-pjesmarrës me MIND-Alliance Systems të NATO-s Punëtori e avancuar hulumtuese "Zhvillimi i planeve për shkëmbim ndërinstitucional të informatave për sigurinë" në kuadër të NATO Programit - Shkencë për paqë dhe shtet.

Edhe në vitin 2011 QMK ishte pjesmarrës aktiv në Programin e Qendrës Evropiane për studime të Sigurisë Xhorxh Marshall në Garmish, Gjermani me pjesmarrje të 8 përfaqësuesve gjatë bitit në trajnime dhe seminare të ndryshme.

PRIORITETE AFATSHKURTËRA

KORNIZA JURIDIKE

Në periudhën e radhës do të realizohen qëllime prioritare të vendosura në Strategjinë nacionale për mbrojtje dhe shpëtim.

Në fazë finale është procedura për nënshkrimin e marrëveshjes bilaterale me Republikën e Bullgarisë që duhet të nënshkruhet deri në fund të vitit 2012. Gjithashtu do të vazhdojë procesi i nënshkrimit të marrëveshjeve bilaterale për bashkëpunim në pjesën e mbrojtjes dhe shpëtimit me vendet e rajonit. Në fazë finale janë edhe negociatat për nënshkrimin e marrëveshjes bilaterale për bashkëpunim në rast të katastrofave me Republikën e Serbisë. Gjithashtu në vitin 2012 do të vazhdojnë negociatat për nënshkrimin e marrëveshjeve

bilaterale me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Maqedonisë, me Republikën e Italisë dhe me Rusinë.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Forcimi i kapaciteteve institucionale të Drejtorisë për mbrojtje dhe shpëtim do të kryhet përmes trajnimit të vazhdueshëm të të punësuarve dhe forcave të mbrojtjes dhe shpëtimit. Për vitin 2012 në maj është paraparë pjesmarrje në IPA-KRO VËRSHIMET 2012, trajnim në teren që do të mbahet në Kroaci. Drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim gjithashtu do të jetë e përfshirë në mënyrë aktive në realizimin e SEESIM 12, trajnimit ndërkombëtar në të cilin vend anëtar do të jetë Republika e Bullgarisë, që do të mbahet në tetor të vitit 2012. Vitin e ardhëm Drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim me ekip të saj do të merr pjesë në trajnimin ndërkombëtar Rezistenca e përbashkët 2012, që do të mbahet në Bosnjë dhe Hercegovinë. Në lidhje me NATO/PzM trajnimet, vitin e ardhëm Drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim do të merr pjesë në trajnimin ndërkombëtar Cooperative Longboë/Lancer 12 që do të mbahet në Shkup në maj të vitit 2012.

Do të vazhdojë bashkëpunimi me fondin Ndërkombëtar për deminim dhe mbrojtjen e viktimave nga minat në pjesën e trajnimit të ekipit për heqjen e mjeteve të paeksploduara vrasëse dhe fillimin e projekteve të rjea për pastrimin e territorit të Republikës së Maqedonisë nga mjetet e paeksploduara vrasëse.

Në kuadër të Iniciativës për gatishmëri dhe prevenim nga katastrovat për Evropën Juglindore, e në pajtim me programin trajnues, është paraparë edhe realizimi i pesëmbëdhjetë kurseve dhe trajnimeve nga sfera të ndryshme.

Drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim në mënyrë aktive do të merr pjesë në punën e Këshillit për planifikime civile-ushtarake të vendeve anëtare të EJK, si anëtare e nominuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, nga ku do të dalin një sërë aktivitetesh, seminare, trajnime dhe ushtrime.

Në pajtim me Memorandumin për mirkuptim dhe bashkëpunim në sferën e mbrojtjes dhe shpëtimit të njerëzve dhe të mirave materiale nga katastrofa natyrore dhe katastrofa tjera në mes të Drejtorisë për mbrojtje dhe shpëtim dhe Agjencisë Daneze për menaxhim me situata të jashtzakonshme për vitin 2012 është planifikuar mbajtja e disa seminareve dhe trajnimeve në pjesën e vlerësimit të rreziqeve nga katastrofa dhe fatkeqësi tjera. Është paraparë edhe trajnim plotësues për përdorimin e softuerit, që do të përdoret për detektimin dhe paralajmërimin e hershëm nga rreziqet radiologjike, kimike, biologjike dhe nukleare.

Qendra për menaxhim me kriza gjatë vitit 2012 në kuadër të Konkluzioneve të përbashkëta për zhvillimin dhe themelimin e bashkëpunimit rajonal në mes të Republikës së Maqedonisë, Shqipërisë dhe Kosovës në sferën e menaxhimit të krizave, do t'i realizojë projektet e kontraktuara në kontekst të forcimit të kapaciteteve institucionale për shkëmbimin e informatave në mes të palëve të kontraktuara.

Në pajtim me programin e aktiviteteve për vitin 2012 Këshilli për planifikime civile-ushtarake për vendet e EJK, QMK do të merr pjesë në evenimente në rajon të organizuara nga ana e vendeve anëtare të Këshillit të CMEP, kurse në muajin maj 2012 do të jetë nikoqir dhe organizator i punëtorisë rajonale për menaxhim me kriza.

Në kuadër të IPA programit "Bashkëpunimi në sferën e mbrojtjes civile për vendet candidate dhe kandidat potencial" gjatë vitit 2012 është paraparë pjesmarrje në trajnime në kuadër të Lot 1, 2 dhe 3 si dhe pjesmarrje në ushtrim të shtabit dhe të terrenit në Vërshimet Kroate.

Edhe në vitin 2012 QMK me përfaqësues të saj do të jetë pjesmarrës aktiv në Programin e Qendrës Evropiane për studime të sigurisë Xhorxh Marshall në Garmish, Gjermani.

PRIORITET AFATMESME

KORNIZA JURIDIKE

Do të vazhdohet në drejtim të përsosjes së rregullativës ekzistuese ligjore dhe nënligjore, dhe do të punohet edhe në miratimin e rregullave të reja në pjesën e mbrojtjes dhe shpëtimit.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Në këtë periudhë do të vazhdojë forcimi i kapacitetit administrative me blerjen e pajisjes dhe zbatimin të trajnimeve për nevojat e ekipeve për reagim të shpejtë, Forcave republikane për mbrojtje dhe shpëtim, kurse do të sigurohet edhe pjesmarrje e përfaqësuesve të Drejtorisë për mbrojtje dhe shpëtim në ushtrime, seminare dhe trajnime ndërkombëtare.

3.31 POLITIKA E JASHTME MBROJTËSE DHE E SIGURISË

3.31.1. POLITIKA E PËRBASHKËT E MBROJTJES DHE SIGURISË

GJENDJA VIJUESE

KORNIZA JURIDIKE

Korniza juridike për pjesmarrje të Republikës së Maqedonisë në PPMS e përbëjnë Ligji për mbrojtje, Ligji për policinë, Ligji për dërgimin e personave në misione ndërkombëtare dhe organizata ndërkombëtare, si dhe aktet e tyre nënligjore.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Kornizën institucionale e përbëjnë: (1) Seksioni i PPMS dhe ndihmës udhëheqësi i sektorit në kuadër të Drejtorisë për Bashkimin Evropian në Ministrinë e Punëve të Jashtme, gjithsejtë 4 persona; (2) Seksioni i PPMS në Ministrinë e Mbrojtjes gjithsejtë 2 persona; dhe (3) Seksioni për planifikimin dhe implementimin e trajnimit për NATO aktivitetet në kuadër të Sektorit për bashkëpunim me NATO dhe informata të klasifikuara në Ministrinë e Punëve të Brendshme, i ekipuar me 3 zbatues dhe udhëheqës.

Është formuar edhe komision ndërresorjal për zbatimin e politikës për dërgimin e personave nga Republika e Maqedonisë në misione ndërkombëtare dhe organizata ndërkombëtare.

Vazhdon pjesmarrja në programet për trajnim në domenin e PPMS në organizim të Kolexhit Evropian për mbrojtje dhe siguri.

Pjesmarrje në misione të BE-së

Republika e Maqedonisë vazhdon me kontributin e vet drejt misionit ushtarak të BE-së në BeH Altea. Në pajtim me strukturën e re të forcave të EUFOR në Altea, Republika e Maqedonisë kontribuon me ekip mjekësor për ROLE 1 përkrahje mjekësore të kampit në Butmir dhe një person ndihmës këshilltar në Komandën e EUFOR, me pjesmarrje të gjithsejtë prej 11 personave.

Në kuadër të kontributit veç më të deklaruar ndja kapaciteteve ushtarake të BE-së dhe interesit të shprehur për përfshirje në Konceptin e BE-së për Grupet luftarake, Republika e Maqedonisë është pjesë e BE BG II/2012, në të cilën marrin pjesë Gjermania, Austria, Çekia, Irlanda dhe Kroacia. Republika e maqedonisë deklaroi forca dhe kapacitete prej në numri maksimal prej 150 persona. Ky grup luftarak do të jetë në gjendje të gatishmërisë në gjysmën e dytë të vitit 2012.

Në aspekt të përgatitjeve për pjesmarrje në misioni ndërkombëtare civile, Ministria e Punëve të Brendshme, inicoi aktivitete për krijimin e kapaciteteve dhe aftësive të nëpunësve policor për pjesmarrje të ardhshme në misione të udhëqura nga BE, KB dhe NATO.

Dialogu politik

Republika e Maqedonisë rregullisht merr pjesë në takimet për dialog politik PU për punë të jashtme, dhe siguri politike me ministrat e Mbrojtjes të anëtarëve evropian të NATO-s që nuk janë antare të BE-së dhe vendeve kandidatë për anëtarësim, si dhe në takimet joformale të MB të BE-së në format +7, në nivel të ministrave të Punëve të Jashtme dhe në takimet e Komitetit ushtarak të BE-së, formatin KU të BE+7, si edhe në takimet e komitetit të kontribuesve në operacionin e BE-së në BeHm Altea.

PRIORITETE AFATSHKURTËRA KORNIZA JURDIKE

Është harmonizuar draft teksti i Marrëveshjes në mes të Bashkimit Evropian dhe Republikës së Maqedonisë për vendosjen e kornizës për pjesmarrje të Republikës së Maqedonisë në operacionet e Bashkimit Evropian për menaxhim me kriza, që pritet të ndodh gjatë vitit 2012.

Përgatitja e aktit nënligjor për dërgimin e nëpunësve policor në misione ndërkombëtare.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Planifikohet ekipim shtesë kadrovik i Sektorit të PPMS në Ministrinë e Mbrojtjes me vendosje të brendshme.

Inicimi i bashkëpunimit bilateral me më shumë vende për përdorimin e përvojës për përgatitjet për pjesmarrje të nëpunësve policor në misione ndërkombëtare, përfshirë edhe lidhjen e marrëveshjeve dhe memorandumeve bilaterale për mirëkuptim të atij qëllimi.

Do të ndërmerren aktivitete për sigurimin e pjesmarrjes në programet për trajnim të Sekretariatit Gjeneral të Këshillit të BE-së të dedikuara për PPMS.

Do të vazhdohet me trajnimet e personelit policor me qëllim të përforcimit të kapaciteteve për pjesmarrje në misionet paqësore.

Pjesmarrja në misione të BE-së

Në pajtim me përcaktimin e deklaruar të RM-së për kontribut në BE BG II/2012, në vitin 2012 janë planifikuar më shumë aktivitete në lidhje me përgatitjen dhe trajnimin e personelit të deklaruar të ARM-së, si dhe pjesmarrjen në ushtrimin European Endeavour 2012. Certifikimi i forcave të deklaruara që e përbëjnë BEBG II/2012, që do të kryhet përmes pjesmarrjes në ushtrimin internacional komendues-të shtabit „European Endeavour 2012“ (Vildfleken, Gjermani nga 29.05.2012 deri më 08.06.2012).

Republika e Maqedonisë do të vazhdojë me kontributin në operacionin e BE-së në BeH, Altea edhe në vitin 2012 me ekipin mjekësor (10 persona) për Role 1 përkrahjen mjekësore të kampit Butmir dhe pozitën e jurstit ushtarak, ndihmës këshilltarit juridik (1 person) në Komandën e EUFOR, me gjithsejtë 11 persona.

150 personat e deklaruar nga ARM për pjesmarrje në BE BG II/2012 do të jenë në gjendje të gatishmërisë në gjysmën e dytë të vitit 2012, të stacionuar në Republikën e Maqedonisë, kurse për dërgimin eventual në operacione (gjysmën e dytë të 2012/1korrik – 31 dhjetor 2012) do të jetë e nevojshme që të miratohet Vendimi nga ana a Kuvendit të RM-së.

PRIORITETET AFATMESME

Pjesmarrje në misione të BE-së.

Republika e Maqedonisë do ta vazhdojë kontributin e deritanishëm në operacionin e BE-së në BeH, Altea edhe gjatë vitit 2013.

Inicimi i bashkëpunimit bilateral me më shumë vende për përdorimin e përvojës së përgatitjes për pjesmarrje të nëpunësve policor në misione ndërkombëtare, përfshirë edhe lidhjen e marrëveshjeve dhe memorandumeve bilaterale për mirëkuptim për atë qëllim.

Do të ndërmerren aktivitete për sigurimin e pjesmarrjes së përfaqësuesve nga Republika e Maqedonisë në programet për trajnim në sferën e PPMS.

3.31.2 POLITKA E PËRBASHKËT, E JASHTME DHE E SIGURISË

GJENDJA VIJUESE

KORNIZA JURIDIKE

Kornizën juridike, që e përbëjnë Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Ligji për organizimn dhe punën e organeve të administratës shtetërore, Ligji për punë të jashtme, Ligji për mbrojtje, Ligji për informata të klasifikuara, Ligji për masat ndërkombëtare restriktive, Ligji për prodhimin dhe qarkullimin e armatimit dhe pajisjeve ushtarake.

Me qëllim të rritjes së efikasitetit në zbatimin të masave ndërkombëtare restriktive dhe veprimi sipas rekomandimeve të Moneyval, u miratu Ligji i ri për masat ndërkombëtare restriktive (Gazeta zyrtare nr. 36 nga 23.03.2011), si dhe aktet e tij nënligjor: Vendimi për formimin e trupit koordinues për përcjelljen e zbatimit të masave ndërkombëtare restriktive dhe Rregullores për formimin e Regjistrimit për vendime për inkorporimin e masave ndërkombëtare restriktive.

Republika e Maqedonisë, deri më tani ka lidhur marrëveshje bilaterale për shkëmbim dhe mbrojtje të informative të klasifikuara me BE, NATO, Slloveni, Poloni, Francë, Kroaci, Estoni, Bullgari, Ukrainë, Shqipëri, Çeki dhe Sllovaki.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Kornizën institucionale e përbëjnë: (1) Seksioni i PBJS dhe ndihmës udhëheqësi i sektorit në kuadër të Drejtorisë për Bashkim Evropian pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme, gjithsejtë 4 persona; (2) Seksioni për kontroll të armatimit në kuadër të Drejtorisë për bashkëpunim politik-të sigurisë dhe marrëdhënie multilaterale në Ministrinë e Punëve të Jashtme, i ekipuar me 2 nëpunës dhe Udhëheqës Sektori.

Një segment i rëndësishëm në kornizën institucionale janë Misioni i Republikës së Maqedonisë praën Bashkimit Evropian në Bruksel, ku është angazhuar një diplomat për përcjelljen vijeuse të PBJS, si dhe misionet e përhershme të Republikës së Maqedonisë në Vienë, Zhenevë, Strazbur dhe Njujork, që janë të kyçura në procesin e përcjelljes drejt pozitive të përbashkëta dhe deklaratave të Bashkimit Evropian.

Në ministrinë e punëve të jashtme dhe në Misionin e Republikës së Maqedonisë praën BE-së në Bruksel, rrjeti i instaluar asociativ komunikues për shkëmbimin e informatave të klasifikuara në formë elektronike (ACN) deri në shkallën "interne" në mes të Republikës së Maqedonisë dhe BE-së, vazhdon të funksionojë pa probleme.

Vazhdojnë aktivitetet për vendosjen e regjistrave dhe nënregjistrave për informata të klasifikuara në ministritë dhe institucionet tjera në shtet. Duke pasur parasysh sistematizimin e ri të vendeve të punës në Byronë e Sigurisë Publike pranë MPB-së është arritur pajtim për nevojën që të fitohet leje paraprake nga DSIK gjatë hapjes së regjistrave të rinj dhe pikave kontrolluese në njësitë organizative të Byrosë.

Dialogu politik

Republika e Maqedonisë vazhdoi që të zhvilloi dialog të rregullt politik me BE-në në bazë bilaterale dhe në suaza multilaterale. Vazhdon përmbajtja ndaj vendimeve të Këshillit të BE-së, deklaratave të BE-së, qoftë në bazë të ftesës së marrë nga BE-ja, qoftë në mënyrë unilaterale. Vendimet e Këshillit të BE-së dhe listës së deklaratave të VE-së ndaj të cilave përmbahet Republika e Maqedonisë publikohen në Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë.

Në vitin 2011 vazhdoi praktika e pjesmarrjes së Republikës së Maqedonisë në konsultimet e rregullta të BE-së me vendet-kandidate për çështje në lidhje me rrespektimin e të drejtave njerëzore dhe nga agjenda e Kombeve të Bashkuara.

Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare

Republika e Maqedonisë është anëtare e KB, OSBE, Këshillit të Evropës dhe organizatave tjera ndërkombëtare dhe është pjesëmarrëse aktive në iniciativat rajonale.

Kontrolli armatimit (joproliferimi i armatimit për shkatërrim masiv; eksporti i armatimit konvencional; armatimit të lehtë dhe të vogël; prodhimeve dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë)

Republika e Maqedonisë vazhdoi me praktikën e përgatitjes së raporteve të rregullta nacionale në aspekt të Kodit të BE-së për sjelleje gjatë eksportit të armatimit, si dhe për zbatimin e Planit aksionar të KB për parandalimin, luftën dhe çrrënjosjen e tregtisë së palejuar të armatimit të lehtë dhe të vogël në të gjitha aspektet e saja.

Për planifikimin, përcjelljen dhe analizimin e gjendjes me kontrollin e armatimit të lehtë dhe të vogël dhe koordinimit të aktiviteteve të institucioneve kompetent, komisionit të formuar nacional për armatimin e lehtë, vazhdon me zbatimin e aktiviteteve të saja (më shumë informata në lidhje me armatimin e lehtë ka në Kapitullin 24).

Zbatimi i sanksioneve dhe masave restriktive

Republika e Maqedonisë rregullisht u përmbahet vendimeve të Bashkimit Evropian, me të cilin inkorporohen masat restriktive dhe sanksionet kundër shteteve, entiteteve dhe personave. Pas miratimit të vendimit të Qeverisë, zbatimit të masave restriktive realizohet nga ana e ministrive dhe institucioneve kompetente, në pajtim me kompetencat e tyre, e në bazë të Ligjit Për masa ndërkombëtare restriktive.

Në pajtim me ligjin e ri për masa ndërkombëtare restriktive, është formuar trupi koordinues për përcjelljen e zbatimit të masave ndërkombëtare restriktive ku bëjnë pjesë përfaqësues nga Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Financave. Trupi koordinues mban takime të rregullta në drejtim të implementimit efikas të masave ndërkombëtare restrictive që Republika e Maqedonisë i zbaton sipas vendimeve të Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara dhe në kuadër të pjesmarrjes së Politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë së BE-së.

Gjithashtu është formuar edhe Regjistri për vendimet për inkorporimin e masave ndërkombëtare restriktive, kurse të njëjtin e udhëheq Ministria e Punëve të Jashtme. Regjistri është i publikuar në faqen e jashtme elektronike të Ministrisë (www.mfa.gov.mk) në pjesën e masave ndërkombëtare restriktive. Regjistri njëherit azhurnohet në pajtim me përcjelljen dhe miratimin e vendimeve nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. Në dhjetori të vitit 2011 në Shkup u mbajt TAIEK seminar rajonal, i dedikuar për ministrinë, instancionet dhe organet e administratës shtetërore që janë të obliguar për implementimin e masave ndërkombëtare restrictive.

PRIORITETET AFATSHKURTËRA KORNIZA JURIDIKE

Në vitin 2012 do të vazhdojnë edhe aktivitetet për lidhjen e marrëveshjeve bilaterale për shkëmbimin dhe mbrojtjen e ndërsjellë të informatave të klasifikuara me vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Në atë contest, negociatat me Gjermanin kanë përfunduar dhe pritet nënshkrimi i marrëveshjes në fillim të vitit 2012.

Në vitin 2012 do të bëhen ndryshime dhe plotësime në Ligjin për prodhim dhe qarkullim të armatimit dhe pajisjes ushtarake, me qëllim të rregullimit të materies së ndërmjetësimit, transistit, offset programeve dhe transfereve jomateriale. Me atë do të mundësohet, mes tjerash edhe zbatimi më i mirë i Pozitës së përbashkët të Këshillit të Bashkimit Evropian nr. 2008/944/CFSP nga 8.12.2008 për definimin e rregullave të përbashkëta për kontroll të eksportit të teknologjisë dhe pajisjes ushtarake, ndaj së cilës Republika e Maqedonisë në mënyrë unanime u bashkangjiti në vitin 2010. Në vijim janë aktivitetet për formimin e grupit të punës që do ta përgatis tekstin e Propozim-ligjit.

Në vitin 2012 do të vazhdojë puna e tekstit të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për informata të klasifikuara në domenin e sigurisë informatike për informatat e klasifikuara me theks të veçantë për kriptombrojtjen. Në mënyrë të përsheptuar po punohet edhe në tekstin e Rregullores së re për kriptombrojtje. Pritet që ligji dhe rregullorja të miratohen deri në shtator të vitit 2012. Me këtë do të rregullohet puna e trupave nacional të sigurisë për siguri informatike të informatave të klasifikuara, që do të kontribuojë për vendosjen e strukturës së re të sistemit të kriptombrojtjes në Republikën e Maqedonisë.

{0}<<0{>0} KORNIZA INSTITUCIONALE

Seksioni për Politikë të Përbashkët të Jashtme dhe Siguruese në Ministrinë e Punëve të Jashtme në vitin 2012, parashihet në mënyrë kadrovike të ekipohet në mënyrë plotësuese edhe me një realizues.

Do të vazhdojnë aktivitetet për trajnim të realizuesve nga Seksioni për Politikë të Përbashkët të Jashtme dhe Siguruese dhe nga Seksioni për Kontroll të Armës në Ministrinë e Punëve të Jashtme. DSJK-ja do të vazhdojë me trajnim të personave që punojnë me informata të klasifikuara, duke i përfshirë edhe përmes bashkëpunimit me vendet-anëtare të UE-së.

Deri në fund të vitit 2012, parashihet formimi i CBRN nacionale (Chemical, Biological, Radiological & Nuclear) trupi koordinues.

Dialogu politikë

Republika e Maqedonisë do të vazhdojë të kontribuojë për përparim të dialogut politik bilateral me UE-në dhe të jetë pjesëmarrës aktiv në dialogun politik multilateral me UE-në. Në vitin 2012 do të vazhdojë me shoqërim / pranim të akteve juridike të UE-së në domenin e PPJS-së.

Bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare

Republika e Maqedonisë do të vazhdojë me angazhimin e vet aktiv në organizatat ndërkombëtare (KB, OSBE, Këshillin e Evropës etj.), si mënyrë më efektive për mbrojtje të paqes dhe sigurisë botërore nga kërcënimet globale të së tanishmes - terrorizmi, proliferacionin e armës për asgjësim masovik, krimin e organizuar, ndotjen e rrethinës së njeriut, si dhe ballafaqimi me problemet ekonomike dhe sociale dhe mosrespektimi i të drejtave të njeriut.

Nga 1 shtatori 2012 deri më 1 janar 2013, Republika e Maqedonisë do të kryesojë me Forumin për Bashkëpunim në Siguri (Forum for Security Cooperation) të OSBE-së.

Republika e Maqedonisë do të vazhdojë me aktivitetet për anëtarësim në Aranzhmanin Vasenar, Grupin e Australisë dhe Grupin e Furnizuesve Nuklearë.

PRIORITETE AFATMESME

KORNIZA JURIDIKE

Vazhdimi me përpjekjet për gjetje të zgjidhjes për sugjerimet e UE-së për nevojën e harmonizimit të Marrëveshjes Bilaterale me SHBA-në për dhënie të vizave të Gjykatës Penale Ndërkombëtare me Parimet Udhëheqëse të UE-së.

Në drejtim të ndërmarrjes së aktiviteteve për forcim të joproloferacionit, Republika e Maqedonisë do të vazhdojë me aktivitetet për anëtarësim në Aranzhmanin Vasenar, Grupin e Australisë dhe Grupin e Furnizuesve Nuklearë.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Do të zbatohet trajnimi i vazhdueshëm për Politikë të Përbashkët të Jashtme dhe Siguruese të realizuesve në ministrinë dhe institucionet e përfshira në zbatimin e kësaj politike të UE-së.

Edukimi i vazhdueshëm i shfrytëzuesve të informatave të klasifikuara në institucionet shtetërore dhe private.

Vazhdimi i aktiviteteve për lëshim të certifikatave të sigurisë personave juridikë, si dhe për ngritje të shkallës së klasifikimit të lidhjes mbrojtëse ndërmjet DSJK-së dhe regjistrin në Misionin e RM-së pranë UE-së në Bruksel.

3.32 KONTROLLI FINANCIAR

3.32.1 KONTROLLI FINANCIAR I BRENDSHËM PUBLIK DHE REVIZIONI I JASHTËM

GJENDJA RRJEDHËSE

Kontrolli Financiar i Brendshëm Publik (KFBP) është koncept gjithëpërfshirës i zhvilluar nga Komisioni Evropian në vitin 1999 që ka për qëllim të mbajë zhvillimin e sistemeve për kontroll të brendshëm dhe mbrojtje të interesave financiare të qeverive në tërësi. Krahas kësaj, KFBP-ja paraqet edhe strategji për reformë të menaxhimit në sektorin publik në vendet kandidate për anëtarësim në UE.

Republika e Maqedonisë, në disa vitet e fundit, në mënyrë intensive i zbaton reformat me qëllim të zhvillimit në menaxhimin e financave publike. Është me rëndësi të theksohet se qëllimi i reformave nuk është vetëm të plotësohen kërkesat për marrje të anëtarësimit, por edhe përparimi i sistemeve për menaxhim dhe kontroll të mjeteve publike, me çka si vend-anëtar në mënyrë të gatshme do të ballafaqohet me sfidat që i bart anëtarësimi dhe mundësitë për shfrytëzim të fondeve të UE-së.

Në vitet e fundit në Republikën e Maqedonisë është bërë përparim i mirë, sepse në bazë të Ligjit për KFBP-në janë miratuar të gjitha aktet nënligjore që janë në fuqi. Janë themeluar Njësi për Çështje Financiare (NJÇF), kurse funksioni i revizionit të brendshëm u bë më proporcional. Tani para nesh është periudha e zbatimit të plotë të KFBP-së. Koncepti i KFBP-së, gjithashtu, do të zbatohet edhe në komuna, për shkak që vëmendje të posaçme do t'i kushtohet kësaj në periudhën e ardhshme.

KORNIZA JURIDIKE

Korniza juridike që e rregullon sistemin e kontrollit financiar të brendshëm publik dhe revizionit të jashtëm në Republikën e Maqedonisë është si vijon:

- Ligji për kontrollin financiar të brendshëm publik ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 90/09 dhe 12/11);
- Rregullorja për mënyrën për dhënie të autorizimeve ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 147/10 dhe 34/11);
- Rregullorja për mënyrën e zbatimit të proceseve të përgjithshme financiare ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 147/10 dhe 34/11);

- Rregullorja për mënyrën e kryerjes së punëve nga kompetenca e njësisve të çështjeve financiare ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 147/10 dhe 34/11);
- Standardet për kontroll të brendshëm në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 147/10);
- Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e raporteve dhe deklarata për kualitetin dhe gjendjen e kontrolleve të brendshme ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 147/10 dhe 34/11);
- Rregullorja për mënyrën e kryerjes së revizionit të brendshëm dhe mënyra e njoftimit për revizion ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 136/10) ;
- Standardet ndërkombëtare për kryerje profesionale të revizionit të brendshëm ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 136/10);
- Rregullorja për kodeksin etik të revizorëve të brendshëm ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 136/10) ;
- Rregullorja për konventën për revizion të brendshëm ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 136/10);
- Rregullorja për programin dhe mënyrën e dhënies së këtij për revizor të brendshëm të autorizuar në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 136/10);
- Dekreti për procedurën për parandalim të parregullsive, mënyra e bashkëpunimit të ndërsjellë, forma dhe përmbajtja, afatet dhe mënyra për njoftim për parregullsitë ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 63/11) ;
- Doracaku për menaxhim dhe kontroll financiar të publikuar në internet faqen e Ministrisë së Financave;
- Doracaku për revizionin e brendshëm të publikuar në internet faqen e Ministrisë së Financave;
- Ligji për revizion shtetëror ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 66/2010 dhe 145/2010);
- Rregullorja për mënyrën e kryerjes së revizionit shtetëror ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 158/2011);
- Ligji për revizion të instrumentit për ndihmën paraaderuese (IPA) ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 66/2010);
- Programi për dhënie të këtij për marrje të titullit revizor i autorizuar shtetëror të publikuar në ueb faqen e Entit Shtetëror për Revizion;
- Kodeksi i etikës së INTOSAI - të publikuar në ueb faqen e Entit Shtetëror për Revizion;
- Memorandumi për bashkëpunim të ndërsjellë ndërmjet ESHZ-së dhe MF-së në sferën e sistemit të menaxhimit dhe kontrollit financiar, revizionit të brendshëm në sektorin publik dhe revizionit shtetëror, 2006;
- Memorandumi për bashkëpunim të lidhur ndërmjet Entit Shtetëror për Revizion dhe Trupit të Revizorit për Revizion të instrumentit për ndihmën paraaderuese, tetor 2011;
- Protokollin për bashkëpunim për parandalim dhe represion të korrupsionit dhe konfliktit të interesave ndërmjet 11 institucioneve kompetente në RM-në, dhjetor 2007.

PRIORITETE AFATSHKURTA

Ministria e Financave hartoi Projekt - Strategji për zhvillim të kontrollit financiar të brendshëm publik prej vitit 2012 deri më 2014, për të cilën mbahet diskutim publik. Strategjia pritet të miratohet nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë në fillim të vitit 2012.

Me qëllim që politikat e KFBP-së të jenë gjithëpërfshirëse, më konsistente dhe më lehtë të zbatohen deri në fund të vitit 2012 do të ndryshohet dhe plotësohet në mënyrë adekuate Ligji për kontrollin financiar të brendshëm publik. Për shkak të lehtësisë të zbatimit të ligjit do të përcaktohen kriteret në pajtim me të cilat do të caktohet se cilat subjekte të vogla do të lirohen nga obligimi për themelim të njësisve të posaçme organizative për çështje financiare, e do të mundësohet që menaxhimin dhe kontrollin financiar ta zbatojë një person udhëheqës financiar, i cili do të jetë edhe person i autorizuar për pagesë. Krahas kësaj, me qëllim të mbulimit të njësisve për revizion të brendshëm do të ndryshohen dhe plotësohen në mënyrë adekuate kriteret për themelim të njësisve për revizion të brendshëm, e do të përcaktohen masat për themelim të komiteteve të revizorit dhe komiteteve për menaxhim dhe kontroll financiar në subjektet e sektorit publik.

Deri në fund të marsit 2012 do të miratohet Ligji për inspeksion financiar në sektorin publik me të cilën rregullohen parimet, kompetencat, organizimi i inspeksionit financiar në sektorin publik, si dhe procedura për kryerje të inspeksionit financiar dhe kompensimin e dëmit të shkaktuar.

MENAXHIMI DHE KONTROLLI FINANCIAR

KORNIZA JURIDIKE

Korniza juridike për sistemin e menaxhimit dhe kontrollit financiar është si vijon:

- Ligji për kontrollin financiar të brendshëm publik ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 90/09 dhe 12/11);
- Rregullorja për mënyrën për dhënie të autorizimeve ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 147/10 dhe 34/11);
- Rregullorja për mënyrën e zbatimit të proceseve të përgjithshme financiare ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 147/10 dhe 34/11);
- Rregullorja për mënyrën e kryerjes së punëve nga kompetenca e njësisve për çështje financiare ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 147/10 dhe 34/11);
- Standardet për kontroll të brendshëm në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 147/10);

- Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e raporteve dhe deklaratës për kualitetin dhe gjendjen e kontrolleve të brendshme. ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 147/10 dhe 34/11), dhe
 - Doracaku për menaxhim dhe kontroll financiar të publikuar në ueb faqen e Ministrisë së Financave.
- Funksionimi i këtij sistemi rregullohet me ligje dhe akte tjera nënligjore, në mesin e të cilave, më të rëndësishme janë: Ligji për buxhete, Ligji për realizimin e buxheteve, Ligji për financim të njësive të vetadministrimit lokal, Ligji për kontabilitetin e buxheteve dhe shfrytëzuesit e buxheteve, Rregullativa për punën e thesarit etj.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për kontroll financiar të brendshëm publik ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 90/09 më 31 korrik 2009 filloi procesin e vendosjes së njësive për çështje financiare që janë përgjegjëse për menaxhimin dhe kontrollin financiar të subjektet: shfrytëzuesit e buxheteve nga sfera e ligjvënies, pushtetit ekzekutiv dhe gjyqësor (pushteti qendror), fondet, komunat dhe qytetit të Shkupit.

Nga gjithsej 71 institucione nga pushteti ekzekutiv, ligjvënës dhe gjyqësor në linjën e parë shfrytëzuesit buxhetorë, 36 institucione e përfunduan procedurën për themelimin të njësive organizative për çështje financiare (51%), kurse në 29 institucione u emëruan udhëheqës të njësive për çështje financiare (41%).

Obligimin për emërim të personit të ngarkuar për parregullsi nga 71 institucione në nivel qendror, e plotësuan 55 institucione (77%).

Nga gjithsej 85 njësi të vetadministrimit lokal duke e përfshirë edhe Qytetin e Shkupit, 24 institucione e përfunduan procedurën për themelimin të njësive të posaçme organizative për çështje financiare (28%). Udhëheqësit e njësive për çështje financiare u emëruan në 19 njësi të vetadministrimit lokal (22%).

Obligimin për emërim të personit të ngarkuar për parregullsi e plotësuan 53 njësi të vetadministrimit lokal (62%).

Në kornizat e Tvinging projektit "Mbështetja e procesit të decentralizimit fiskal përmes forcimit të kapaciteteve për menaxhim financiar stabil dhe kontroll të brendshëm financiar në nivel lokal dhe qendror" që filloi të realizohet në shkurt 2011 dhe do të zgjasë deri në fund të shkurtit 2013, u zbatuan aktivitetet si vijon:

- Trajnimi njëditor "Ngritja e vetëdijes në udhëheqësin e lartë në 40 komuna lidhur me menaxhimin dhe kontrollin financiar dhe revizionin e brendshëm (pjesa 1 dhe 2)" të mbajtur prej 5 deri më 7 prill 2011 dhe prej 9 deri më 11 maj 2011. Në trajnimin morën pjesë kryetarët e komunave, sekretarët dhe udhëheqësit e njësive për revizion të brendshëm dhe të njësive për çështje financiare nga 40 komuna dhe Njësia Qendrore për Harmonizim;
- Zbatimi i analizës së gjendjes lidhur me suksesin dhe dobësitë në zbatimin e KFBP-së nga 11 - 15 prill 2011 në: Sekretariatit për Çështje Evropiane, Drejtorinë për Punë Hidrometeorologjike, Agjencinë për Mbështetje Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Qytetin e Shkupit, komunën e Butelit dhe komunën e Gazi Babës.
- Trajnimi njëditor "Gap analiza dhe lehtësimi për përgatitje të planeve të aksionit" të mbajtur më 7 dhe 8 korrik për udhëheqësit e njësive për çështje financiare dhe njësive për revizion të brendshëm në nivel qendror.
- Punëtorja njëditore për planet e aksionit që u mbajt nga 12 - 16 shtator 2011, për të punësuarit nga 25 pilot institucionet në nivel qendror, 40 pilot komuna dhe 25 institucione nga niveli qendror nga projektet paraprahe.
- Trajnimi njëditor "Menaxhimi financiar në praktikë dhe menaxhimi me rreziqe" që u mbajt nga 27 deri më 30 shtator 2011 të dedikuar për udhëheqësit dhe të punësuarit në njësitë për çështje financiare dhe sektorët tjerë në 25 pilot institucione nga niveli qendror dhe 15 ministrinë.
- Takim pune "Udhëheqja e suksesshme dhe realizimi i qëllimeve të shtruara" të mbajtur më 13 dhe 14 tetor 2011, të dedikuar për udhëheqësin e lartë në nivel qendror (drejtorë të 25 pilot institucioneve në nivel qendror dhe sekretarë shtetërorë nga 15 ministri).
- Trajnimi njëditor "Menaxhimi dhe kontrolli financiar në praktikë dhe menaxhimi me rreziqe" të mbajtur nga 1 deri më 3 nëntor 2011, të dedikuar për udhëheqësit dhe të punësuarit në njësitë për çështje financiare dhe udhëheqësit e sektorëve tjerë në 40 komuna.
- Trajnimi njëditor "Për menaxhim me ndryshime dhe zbatimin e metodave (procedurave) të reja të punës" të mbajtur nga 7 deri më 9 nëntor 2011, të dedikuar për drejtorët e 25 pilot institucioneve në nivel qendror, kryetarët e komunave nga pilot komunat, si dhe udhëheqësit dhe të punësuarit në njësitë për çështje financiare nga 25 pilot institucione në nivel qendror dhe 40 komuna.

Harmonizimin e menaxhimit dhe kontrollit financiar e zbatoi Sektori për kontroll financiar të brendshëm publik përmes Seksionit për harmonizim të menaxhimit dhe kontrollit financiar.

PRIORITETE AFATSHKURTA

KORNIZA INSTITUCIONALE

Forcimi i kapaciteteve institucionale në Ministrinë e Financave

Forcimi i kapaciteteve institucionale në Ministrinë e Financave do të zbatohet me miratim të Rregullores për punë dhe financim të Komitetit për menaxhim dhe kontroll financiar si trup këshillëdhënës i ministrit të Financave. Në vitin 2012 në

kornizat e Tving projektit do të forcohen kapacitetet e Sektorit për kontroll financiar të brendshëm publik përmes zbatimit të menaxhimit adekuatë të të punësuarve dhe trajnimit të tyre.

Forcimi i kapaciteteve institucionale për menaxhim dhe kontroll financiar në subjektet e sektorit publik

Në vitin 2012 do të forcohen aktivitetet për themelim të njësive për çështje financiare dhe emërim të udhëheqësve në këto në të gjitha ministrinë, fondet dhe shfrytëzuesit e drejtpërdrejtë buxhetorë, buxheti i të cilëve tejkalon 1 miliardë denarë.

MBËSHËTETJA E HUAJ

Forcimi i kapaciteteve për zbatim të sistemit për menaxhim dhe kontroll financiar në nivel qendror do të realizohet me zbatim të Tving projektit "Mbështetja e procesit të decentralizimit fiskal përmes forcimit të kapaciteteve për menaxhim financiar stabil dhe kontroll të brendshëm financiar në nivel lokal dhe qendror" që filloi me realizim në shkurt 2011 dhe do të zgjasë deri në shkurt 2013, dhe ky financohet nga UE-ja në kornizat e IPA 2008.

Në kornizat e këtij projekti do të zbatohen trajnime për menaxhim dhe kontroll financiar për udhëheqësin dhe të punësuarit në 25 subjekte në nivel qendror dhe në 40 njësi të vetadministrimit lokal.²⁴

PRIORITETE AFATMESME

Në vitin 2013 do të ndërmerren masa për forcim të kapaciteteve në institucionet nga pushteti qendror në të cilat nuk janë formuar dhe ekipuar njësi për çështje financiare dhe nuk janë emëruar udhëheqës.

Deri në vitin 2013 do të vazhdojë realizimi i Tving projektit "Mbështetja e procesit të decentralizimit fiskal përmes forcimit të kapaciteteve për menaxhim financiar stabil dhe kontroll të brendshëm financiar në nivel lokal dhe qendror".

REVIZIONI I BRENDSHËM

KORNIZA JURIDIKE

Korniza juridike për zbatim të revizionit të brendshëm në sektorin publik është si vijon:

- Ligji për kontrollin financiar të brendshëm publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 90/09 dhe 12/11);
- Rregullorja për mënyrën e kryerjes së revizionit të brendshëm dhe mënyra për njoftim për revizionin ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 136/2010),
- Rregullorja për Programin dhe mënyrën e dhënies së këtij për revizor të brendshëm të autorizuar në sektoin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 136/2010),
- Rregullorja për Konventën për revizion të brendshëm ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 136/2010),
- Rregullorja për Kodeksin Etik të revizorëve të brendshëm ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 136/2010),
- Standardet ndërkombëtare për kryerje profesionale të revizionit të brendshëm (IIA) ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 136/2010), dhe
- Doracaku për revizion të brendshëm të publikuar në internet faqen e Ministrisë së Financave paraqet kornizë juridike për kryerje të revizionit të brendshëm.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Funksionin e revizionit të brendshëm në sektorin publik në Republikën e Maqedonisë e kryejnë njësitë e revizionit të brendshëm të themeluara në subjektet e sektorit publik në nivel qendror dhe lokal, kurse harmonizimin e revizionit të brendshëm e zbaton Seksioni për harmonizim të revizorit të brendshëm në kornizat e Sektorit për kontroll financiar të brendshëm publik. Seksioni për harmonizim të revizionit të brendshëm është ekipuar në mënyrë kadrovike me 5 të punësuar (1 bashkëpunëtor dhe 4 bashkëpunëtorë të rinj). Seksioni për harmonizim të revizionit të brendshëm nuk ka udhëheqës.

Te subjektet e sektorit publik janë themeluar gjithsej 128 njësi për revizion të brendshëm nga të cilat 69 njësi te subjektet në nivel qendror dhe 59 njësi te subjektet në nivel lokal.

Njësitë për revizion të brendshëm janë vendosur në të gjitha ministrinë dhe fondet, kurse 9 institucione në nivel qendror kanë lidhur marrëveshje për kryerje të revizionit të brendshëm nga njësia për revizion të brendshëm nga subjekti tjetër.

Funksionin e revizionit të brendshëm në Republikën e Maqedonisë e kryejnë 166 revizorë të brendshëm, nga të cilat 116 në nivel qendror dhe 50 në nivel lokal.

Në shkurt 2011 filloi me realizim Tving projekti "Mbështetja e procesit të decentralizimit fiskal përmes forcimit të kapaciteteve për menaxhim financiar stabil dhe kontroll të brendshëm financiar në nivel lokal dhe qendror, në të cilat zbatohen aktivitetet si vijon: "

- Takime të punës në 9 pilot subjekte nga sektori publik (6 subjekte nga sektori publik në nivel qendror dhe 3 në nivel lokal) me temë: "Analiza e gjendjes rrjedhëse dhe përcaktimi i mangësive në procesin e ndërtimit të sistemit të

²⁴Manastiri, Bogovinja, Velesi, Vinica, Gjevgjella, Gostivari, Dibra, Dellçeva, Ilinden, Jegunovce, Kavadarci, Kërçova, Koçani, Kratova, Kriva Pallanka, Kumanova, Lipkova, Makedonski Brod, Negotino, Ohri, Prilepi, Radovishi, Resnja, Shën Nikolla, Struga, Strumica, Tearca, Tetova, Shtipi, Aerodromi, Buteli, Gazi Baba, Gjorgje Petrovi, Karposhi, Kisella Voda, Saraji, Qendra, Çairi, Oyteti i Shkupit).

kontrollit financiar të brendshëm publik dhe miratimit të konkluzioneve në nivel të përgjithshëm", ku morën pjesë udhëheqësit e subjekteve, të punësuarit në njësitë për çështje financiare dhe njësitë për revizion të brendshëm;

- Takim pune "Dobia e menaxhimit financiar stabil dhe revizioni i brendshëm si mjet i përgjegjësishë udhëheqëse", ku morën pjesë kryetarët e komunave, udhëheqësit dhe të punësuarit në njësitë për revizion të brendshëm;

- Takim pune me temë: "Roli dhe funksioni i Komiteteve të Revizorit", ku morën pjesë udhëheqësit e njësive për revizion të brendshëm / revizorë të brendshëm;

- Trajnimi fillestar për trajnuesit "Prezantimi dhe teknikat e nxënies", ku morën pjesë të punësuarit në njësitë për çështje financiare dhe njësitë për revizion të brendshëm në nivel qendror dhe lokal;

- Trajnimi avancues për trajnuesit "Prezantimi dhe teknikat e nxënies", ku morën pjesë të punësuarit në njësitë për çështje financiare dhe njësitë për revizion të brendshëm në nivel qendror dhe lokal dhe të punësuarit e Sektorit për kontroll financiar të brendshëm publik;

- Takime të punës me temë: "Zhvillimi i Strategjisë për kontroll financiar të brendshëm publik", ku morën pjesë udhëheqësit e njësive për revizion të brendshëm / revizorë të brendshëm;

- Trajnimi fillestar për revizion të brendshëm, ku morën pjesë udhëheqësit e njësive për revizion të brendshëm / revizorë të brendshëm të komunave;

- Trajnimi avancues për revizion të brendshëm, ku morën pjesë udhëheqësit e njësive për revizion të brendshëm / revizorë të brendshëm nga subjektet në nivel qendror dhe të punësuarit nga Ministria e Financave - Sektori për kontroll financiar të brendshëm publik.

Në gusht 2011 formohet Komiteti i Revizorit si trup konsultues për çështje lidhur me revizionin e brendshëm, kurse në dhjetor filloi edhe me punë.

PRIORITETE AFATSHKURTA

KORNIZA JURIDIKE

Në vitin 2012 do të vazhdojnë aktivitetet në kornizat e Tvinging projektit "Mbështetja e procesit të decentralizimit fiskal përmes forcimit të kapaciteteve për menaxhim financiar stabil dhe kontroll të brendshëm financiar në nivel lokal dhe qendror", i financuar nga UE-ja.

Në kornizat e Tvinging projektit do të zbatohen trajnime për revizorë të brendshëm në nivel qendror dhe lokal, si dhe trajnime për të punësuarit në Sektorin për kontroll financiar të brendshëm publik.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Forcimi i kapaciteteve institucionale për revizion të brendshëm në subjektet e sektorit publik

Procesi i themelimit të njësive për revizion të brendshëm te subjektet e sektorit publik dhe ekipimi i tyre, si dhe lidhja e marrëveshjeve për kryerje të revizionit të brendshëm do të vazhdojë edhe në vitin 2012 me punësim / sistemim të 113 personave.

Në kornizat e Tvinging projektit për forcim të kontrollit financiar të brendshëm publik në nivel qendror dhe lokal të financuar nga UE-ja, në vitin 2012, për revizorët në nivel qendror do të zbatohet trajnimi fillestar për revizion të brendshëm, trajnimi avancues për revizion të brendshëm, trajnimi për shkathtësitë e revizorit dhe do të kryhen 8 pilot revizione, kurse në nivel lokal do të zbatohet trajnimi avancues për revizion të brendshëm, trajnimi për njoftim dhe 8 pilot revizione.

MBËSHTETJA E HUAJ

Forcimi i kapaciteteve për zbatim të revizionit të brendshëm në nivel qendror dhe lokal do të realizohet me zbatim të aktiviteve në kornizat e Tvinging projektit "Mbështetja e procesit të decentralizimit fiskal përmes forcimit të kapaciteteve për menaxhim financiar stabil dhe kontroll të brendshëm financiar në nivel lokal dhe qendror" që filloi në shkurt 2011 dhe do të zgjasë deri në shkurt 2013. Ky financohet nga UE-ja në kornizat e IPA 2008.

Në kornizat e këtij projekti do të zbatohen trajnime për revizion të brendshëm në 25 subjekte në nivel qendror dhe në 40 njësi të vetadministrimit lokal.²⁵

PRIORITETE AFATMESME

Forcimi i revizionit të brendshëm në sektorin publik në Republikën e Maqedonisë në vitet 2013 dhe 2014 do të vazhdojë me ekipim të njësive për revizion të brendshëm.

REVIZIONI SHTETËROR (I JASHTËM)

Enti Shtetëror për Revizion (ESHR) është institucion i lartë i revizorit (ILR), i themeluar me Ligjin për revizion shtetëror i miratuar në vitin 1997, me qëllim të sigurohet shfrytëzimi ligjor, me dedikim, ekonomik, efikas dhe efektiv i mjeteve publike. ESHR-ja zbaton revizione dhe harton raporte që i publikon në ueb faqe, kurse në Kuvendin e Republikës së

²⁵ Manastiri, Bogovinja, Veles, Vinica, Gjevgjelia, Gostivari, Dibra, Dellçeva, Ilinden, Jegunovce, Kavadarci, Kërçova, Koçani, Kratova, Kriva Pallanka, Kumanova, Lipkova, Makedonski Brod, Negotino, Ohri, Prilepi, Radovishi, Resnja, Shën Nikolla, Struga, Strumica, Tearca, Tetova, Shtipi, Aerodromi, Buteli, Gazi Baba, Gjorgje Petrovi, Karposhi, Kisella Voda, Saraji, Qendra, Çairi, Qyteti i Shkupit).

Maqedonisë parashtron raport vjetor për punën dhe revizionet e realizuara dhe të gjitha raportet përfundimtare të revizorit.

Puna e Entit Shtetëror për Revizion rregullohet me Ligjin për revizion shtetëror që është në pajtim me parimet e LIMA Deklaratës dhe MEKSIKO Deklaratës për pavarësi të institucioneve të larta të revizorit.

Në bazë të aktiviteteve të Tvinging projektit me Gjykatën e Holandës për Revizion dhe vlerësimi për punën e ESHR-së, në kornizat e Misionit të Vlerësuar të ILR-së Gjermane, në Entin Shtetëror për Revizion vazhduan aktivitetet për përmirësim të pavarësisë operative dhe financiare dhe sigurimi i kualitetit në punë.

GJENDJA RRJEDHËSE

Në maj 2010 u miratua Ligji për revizion shtetëror me të cilën u siguroa forcimi i kapaciteteve operative dhe pavarësisë funksionale dhe financiare të ESHR-së në pajtim me rekomandimet e LIMA Deklaratës, Deklaratës së Meksikës për pavarësi, Deklaratës së Pragës dhe praktikat e mira të vendeve anëtare të UE-së dhe Komisionit Evropian. Me këtë ligj rregullohet vetëm puna e revizionit shtetëror. Puna e Trupit të Revizorit rregullohet me ligj të veçantë. Ligji për revizion shtetëror siguron zhvillim profesional adekuat të revizorëve shtetërorë dhe ndjekje më efikase të zbatimit të rekomandimeve në raportet e revizorit.

Grupi prej 58 deputetësh në Kuvendin e RM-së në shkurt 2011 parashtruan iniciativa për fillim të procedurës për ndryshimet e Kushtetutës së RM-së me çka do të sigurohet pavarësia e ESHR-së në Kushtetutën e RM-së.

Në vitin 2011, miratohet Rregullorja për mënyrën e kryerjes së revizionit shtetëror, si akt nënligjor i Ligjit për revizion shtetëror, me të cilën përcaktohet mënyra e planifikimit, kryerjes dhe njoftimit për revizionin e realizuar.

Për shkak të shfrytëzimit të praktikave të mira të UE-së, Enti Shtetëror për Revizion në vitin 2010 mori pjesë në dy revizione të koordinuara paralele të suksesit të EUROSAI dhe INTOSAI/IDI të programeve për rritje të punësimit të personave me nevoja të posaçme në sektorin publik dhe menaxhimit me borxhin publik, së bashku me Institucionet tjera të Larta të Revizorit (ILR) nga Evropa dhe Afrika. Me revizionet e zbatuara dhe raportet e hartuara nacionale, në vitin 2011 u hartuan raporte të përbashkëta përfundimtare në të cilat u prezantuan përvojat nacionale, këshillat dhe efekti i aktivitetit të përbashkët.

Në vitin 2011 u miratuan aktet dhe udhëzimet metodologjike si vijon:

- Udhëzimi për dërgim të raporteve të revizorit;
- Udhëzimi për kontroll të kualitetit të revizioneve;
- Udhëzimi për plotësimin dhe dërgimin e informatave për masat e ndërmarra me rekomandimet e dhëna në raportet përfundimtare të revizorit;
- Udhëzimi për numërim të raporteve të revizorit;
- Futet funksioni dhe instrumentet për sigurim të kualitetit të revizioneve, në pajtim me Udhëzimin e miratuar për sigurim të kualitetit në kryerjen e revizioneve;
- Zbatohet softueri për analiza të të dhënave nga raportet, konstatimet dhe rekomandimet e revizorit.

Gjithashtu, në vitin 2011 u realizuan më tepër trajnime për të punësuarit në ESHR-në nga sfera e furnizimeve publike, përmirësimi i shkathtësive të kontabilitetit, revizioni i suksesit, përparimi i punëve ekipore etj. Numri i realizuesve në ESHR-në në vitin 2011 arrin 95.

PRIORITETE AFATSHKURTA

KORNIZA JURIDIKE

Për shkak të arritjes së pavarësisë së plotë të ESHR-së, do të vazhdojë procedura për qasje për ndryshimet e Kushtetutës së RM-së, me qëllim të përkufizimit të ESHR-së si kategori kushtetuese.

Me qëllim të përparimit të bashkëpunimit me Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në vitin 2012 do të nënshkruhet Memorandumi për bashkëpunim i ESHR-së me Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, kurse në bashkëpunim me Gjykatën Holandeze për Revizion do të realizohen edhe aktivitetet në kornizat e Projektit të orientuar në vendosje të relacioneve profesionale të qëndrueshme dhe efektive ndërmjet ESHR-së dhe Kuvendit të RM-së.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Forcimi i kapaciteteve institucionale të ESHR-së në vitin 2012 do të sigurohet me 3 punësime të reja me çka numri i realizuesve në ESHR-në do të jetë 98.

Për forcim të kapaciteteve të ESHR-së në vitin 2012 do të miratohen:

- Rregullorja e Re dhe Programi për dhënie të këtij për revizor të autorizuar shtetëror;
- Zbatimi i aktiviteteve për forcim të njohurive të revizorëve për standardet ndërkombëtare ISSAI;
- Shqyrtimi i rezultateve nga zbatimi i softuerit të ri për analiza të të dhënave nga raportet, konstatimet dhe rekomandimet e revizorit;
- Operacionalizimi i funksionit për sigurim të kualitetit të revizioneve, në pajtim me Udhëzimin e miratuar për sigurim të kualitetit të revizioneve.

Në vitin 2012 do të zbatohen më tepër trajnime për aspekte të ndryshme të revizionit shtetëror.

MBËSHTETJA E HUAJ

Pas pauzës njëvjeçare, bashkëpunimi me Gjykatën Holandeze të Revizionit do të vazhdojë me projekt të ri që do të realizohet në gjysmën e parë të vitit 2012. Projekti do të orientohet në vendosje të relacioneve profesionale të qëndrueshme dhe efektive ndërmjet ESHR-së dhe Kuvendit të RM-së. Projekti përfshinë më tepër aktivitete, në mesin e të cilave, hartimi i doracakut me këshilla praktike për shfrytëzim të raporteve të revizorit të dedikuar për deputetë, punëtori për përcaktim të zbatimit të tij së bashku me deputetët, si dhe prezantimi i praktikës së mirë të ILR-ve tjera lidhur me bashkëpunimin me parlamentin.

PRIORITETE AFATMESME

KORNIZA INSTITUCIONALE

Forcimi i kapaciteteve operative dhe funksionale të ESHR-së në periudhën 2013 - 2014, do të realizohet përmes:

- Rritjes së numrit të të punësuarve për 10 realizues me çka numri i përgjithshëm i realizuesve do të jetë 108;
- Përparimit të bashkëpunimit me Kuvendin e Republikës së Maqedonisë;
- Plotësimin të TI sistemit me mundësi për menaxhim me procesin e revizionit dhe me dokumente (Audit Management System);
- Trajnimeve për aspekte të ndryshme të revizionit shtetëror.

3.32 2. MBROJTJA E INTERESAVE FINANCIARE TË UE-SË

MBROJTJA E INTERESAVE FINANCIARE TË UE-SË

KORNIZA JURIDIKE

Mbrojtja e interesave financiare të UE-së rregullohet me:

- Ligjin për kontroll financiar të brendshëm publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 90/09 dhe 12/11).
- Dekretin për procedurën për parandalim të parregullive, mënyrën e bashkëpunimit të ndërsjellë, formën dhe përmbajtjen, afatet dhe mënyrën për njoftim për parregullsi ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 63/11).
- Marrëveshjen Kornizë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Komisionit të Bashkësive Evropiane për rregulla për bashkëpunim lidhur me ndihmën financiare të BE-së për Republikën e Maqedonisë në kornizat e zbatimit të ndihmës sipas IPA-së ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 18/2008).
- Marrëveshjen Financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Komisionit të Bashkësive Evropiane lidhur me komponentin e tretë të IPA-së - programi shumëvjeçar për Zhvillim Rajonal.
- Dekretin për përcaktim të marrëdhënieve të ndërsjella të organeve dhe strukturave të menaxhimit të decentralizuar me katër komponentët e parë të IPA-së ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 132/2008, 119/2009).
- Dekretin për përcaktim të marrëdhënieve të ndërsjella të organeve dhe strukturave të menaxhimit të decentralizuar të plotë me komponentin e pestë të IPA-së ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 144/2008, 123/2009).
- Doracakët për procedura të brendshme të Koordinatorit Nacional për Autorizim (KNA), Fondit Nacional (FN) dhe Sektorit për Financim Qendror dhe Lidhje të Marrëveshjeve (FQLM), ministritë resore dhe institucionet shfrytëzuese.
- Marrëveshjen për zbatim të IPA projekteve ndërmjet KNA/FN-së dhe FQLM-së.
- Marrëveshjet Operative ndërmjet FQLM-së dhe ministrive resore.
- Memorandumin për Bashkëpunim për mbrojtje, zbulim, njoftim dhe hetim të parregullive lidhur me zbatimin e IPA ndihmës në Republikën e Maqedonisë të nënshkruar ndërmjet KNA-së dhe Seksionit për Koordinim të Parandalimit të Mashtrimeve (AFCOS).
- Doracakun për procedura të brendshme të Agjencisë për Mbështetje Financiare të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
- Marrëveshjen ndërmjet Fondit Nacional dhe Agjencisë për Mbështetje Financiare të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatim të projekteve të IPARD-it sipas sistemit plotësisht të decentralizuar për menaxhim.

Me Ligjin për kontroll financiar të brendshëm publik në sektorin publik dhe Dekretin për procedurën për parandalim të parregullive, mënyrën e bashkëpunimit të ndërsjellë, formën dhe përmbajtjen, afatet dhe mënyrën për njoftim për parregullsitë, rregullohet obligimi për udhëheqësit e subjekteve nga sektori publik ta parandalojnë rrezikun nga parregullsitë dhe mashtrimet dhe të ndërmarrin aktivitete kundër parregullive dhe mashtrimeve dhe të emërojnë person të ngarkuar për parregullsi që do t'i pranojë raportet për parregullsitë dhe mashtrimet dhe në mënyrë të mëvetësishme do të ndërmerr veprime për parandalim të parregullive dhe mashtrimeve.

Revizorët e brendshëm, personat e përfshirë në menaxhimin dhe kontrollin financiar dhe të punësuarit tjerë kanë obligim për dyshimet për mashtrime apo për konstatimet adekuate për parregullsi njëkohësisht ta njoftojnë udhëheqësin e subjektit dhe personin e ngarkuar për parregullsi.

Revizorëve të brendshëm, personave të përfshirë në menaxhimin dhe kontrollin financiar, si dhe të punësuarit tjerë që njoftojnë për çfarëdo parregullsie u garantohet mbrojtja e identitetit dhe të drejtat e marrëdhënies së punës në pajtim me legjislacionin nacional.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Në vitin 2012, Seksioni për Koordinim të Parandalimit të Mashtrimeve (AFCOS) do të hartojë Strategji Nacionale për parandalim të mashtrimeve për mbrojtje të interesave financiare të Unionit Evropian në Republikën e Maqedonisë për periudhën prej 2012 deri më 2014.

Në pajtim me këtë strategji, Seksioni për Koordinim të Parandalimit të Mashtrimeve (AFCOS) do të ketë mbështetje nga trupat dhe institucionet në vend të cilat drejtpërdrejtë apo tërthorazi përfshihen në mbrojtjen e interesave financiare të UE-së, e njëkohësisht do të propozojë masa për forcim të këtyre aktiviteteve.

Në vitin 2012, gjithashtu, do të zbatohet trajnimi për personat e ngarkuar për parregullsi dhe të punësuarit në AFCOS për veprime me fletëparaqitjet e marra për parregullsi dhe mënyrën e njoftimit në bashkëpunim me TAEX dhe OLAF.

PRIORITETE AFATSHKURTA

KORNIZA JURIDIKE

Njësia për parandalim të parregullsi dhe mashtrimeve do të ndërmerr aktivitete përgatitëse për plotësim të obligimeve në pajtim me Dekretin për procedurën për parandalim të parregullsi, mënyrën e bashkëpunimit të ndërsjellë, formën, përmbajtjen, afatet, mënyrën e njoftimit për parregullsitë.

Seksioni për Koordinim të Parandalimit të Mashtrimeve (AFCOS) do të ketë mbështetje nga trupat dhe institucionet në vend të cilat drejtpërdrejtë apo tërthorazi përfshihen në mbrojtjen e interesave financiare të UE-së, e njëkohësisht do të propozojë masa për forcim ligjvënës dhe administrativ të aktiviteteve për mbrojtje të interesave financiare të UE-së.

REVIZIONI I UE FONDEVE

KORNIZA JURIDIKE

Korniza juridike për revizion të IPA fondeve në Republikën e Maqedonisë rregullohet me:

- Ligjin për revizion të instrumentit për ndihmën paraaderuese (IPA) ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 66/2010)
- Marrëveshjen Kornizë ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Komisionit Evropian për rregulla për bashkëpunim lidhur me ndihmën financiare të Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë në kornizat e zbatimit të ndihmës sipas Instrumentit për ndihmën paraaderuese (IPA) ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 18/08)
- Marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Komisionit të Bashkësive Evropiane për rregulla për bashkëpunim lidhur me ndihmën financiare të KE-së të Republikës së Maqedonisë dhe zbatimit të ndihmës sipas Komponentit 5 (IPARD) nga Instrumenti për ndihmën paraaderuese. ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 165/08).

Në pajtim me Ligjin për revizion të instrumentit për ndihmën paraaderuese (IPA), në qershor 2011 me Aktvendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, emërohet Revizori Kryesor për IPA-në dhe bëhet përkrahimi i personit të ri juridik në Regjistrimin Qendror të Republikës së Maqedonisë me emër Trupi i Revizorit për revizion të instrumentit për ndihmën paraaderuese. Ky përcaktohet të funksionojë si person juridik i mëvetësishëm dhe i pavarur që në mënyrë funksionale është i pavarur nga të gjithë pjesëmarrësit në sistemet për menaxhim dhe kontroll me instrumentin për ndihmën paraaderuese.

Në qershor 2011, miratohet Rregullorja për sistematizim të vendeve të punës dhe Rregullorja për organizim dhe punë të Trupit të Revizorit për revizion të instrumentit për ndihmën paraaderuese në pajtim me Ligjin për revizion të instrumentit për ndihmën paraaderuese (IPA).

Në shtator 2011, miratohet Strategjia për revizion 2011 - 2013, në pajtim me të cilën do të zbatohet Plani Vjetor i Punës për revizion të TR-së për vitin 2012.

Në tetor 2011, lidhet Memorandumi për bashkëpunim ndërmjet ESHR-së dhe TR-së me qëllim të përparimit të bashkëpunimit në kryerje të kompetencave nga sferë veprimi i të dyja institucioneve, si dhe këmbimi i të dhënave dhe përvojave, me çka pritet të rritet efikasiteti i bashkëpunimit të ndërsjellë të deritanishëm.

Në periudhën maj - tetor 2011, në Trupin e Revizorit u realizuan dy misione të revizorit, edhe atë misioni i revizorit të Drejtorisë së Përgjithshme për punësim, me qëllim të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve nga konstatimet e dhëna në Aneksin 1 të Vendimit për bartje të menaxhimit për IPA Komponenti 4 dhe misioni i revizorit të Drejtorisë së Përgjithshme për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, me qëllim të kryerjes së mbikëqyrjes.

Në nëntor 2011, nga Trupi i Revizorit në bashkëpunim me GIZ (Bashkëpunimi Ndërkombëtar Gjerman) nga Mali i Zi, organizohet Konferenca Rajonale e trupave të revizorit të vendeve kandidatë dhe kandidatëve potencialë për anëtarësim në Unionin Evropian, me qëllim të këmbimit të përvojave ndërmjet trupave të revizorit në kryerje të revizionit të fondeve nga Unioni Evropian dhe afrimit në praktikën evropiane.

Organizimi i kësaj Konference është ngjarje me rëndësi të madhe edhe për Republikën e Maqedonisë nga aspekti i angazhimit të saj për afrim në Unionin Evropian në cilësi të vendit kandidat.

Në pajtim me Ligjin, Trupi i Revizorit është kompetent për kryerje të revizionit të sistemit për zbatim, udhëheqje dhe kontroll në zbatimin e ndihmës paraaderuese të Unionit Evropian në Republikën e Maqedonisë gjatë menaxhimit të decentralizuar me dhe pa ex-ante kontroll nga Komisioni Evropian.

Trupi i revizorit deri më 30 shtator çdo vjet miraton Plan Vjetor të Punës për revizion, i cili përfshinë revizione që kanë për qëllim verifikimin e funksionimit efektiv të sistemeve për menaxhim dhe kontroll për IPA-në dhe verifikimin e besueshmërisë së informatave të kontabilitetit të dërguara nga institucionet kompetente në Republikën e Maqedonisë për Komisionin Evropian gjatë menaxhimit të decentralizuar me fondet e Unionit Evropian. Plani Vjetor i Punës për revizion dërgohet në Komisionin Evropian dhe Koordinatorin Nacional për Autorizim para fillimit të secilit vit.

Trupi i Revizorit në afatin e përcaktuar me ligj në Komisionin Evropian, Koordinatorin Nacional për Akreditim dhe kopjen në Koordinatorin Nacional për Autorizim e dërgon:

- Raportin Vjetor për aktivitetet e revizorit të IPA komponentit,
- Mendimin Vjetor të Revizorit për funksionim efektiv të sistemeve për menaxhim dhe kontroll me IPA, të IPA komponentit,
- Mendimin Vjetor të Revizorit për llogaritë dhe ekstraktin e shpenzimeve për mjetet e komponentit 5 të IPA (IPARD) të parashtruara nga KNA-ja në Komisionin Evropian.
- Mendimin e Revizorit për ekstraktin e përfunduar për shpenzime të dërguar nga Koordinatorin Nacional për Autorizim në Komisionin Evropian për mbyllje të programit apo të pjesëve të programit.

Gjatë vitit 2011 vazhdoi me edukimin e vazhdueshëm dhe përsosjen profesionale të revizorëve në Trupin e Revizorit që ishin të pranishëm në trajnime për zhvillim dhe përparim të shkathtësive komunikuese, qasjen e revizorit të Gjykatës Evropiane të Revizorëve, e organizuar nga Gjykata Evropiane e Revizorëve, strategjia e revizorit dhe planifikimit në organizim të GIZ-it, njoftimi dhe ndjekja - faza në revizion, korrupsioni dhe mashtrimi, roli i revizorit, menaxhimi me borxhet dhe parregullsitë, udhëzimi për trupin e revizorit për revizione për kontroll financiar dhe vërtetimi i llogarive në organizim të Komisionit Evropian, Drejtorisë së Përgjithshme për Zgjerim, në kornizat e TAIEK instrumentit.

Numri i realizuesve në Trupin e Revizorit, përfundimisht në dhjetor 2011, arrin 28.

PRIORITETE AFATSHKURTA

Me Planin Vjetor të Punës për revizion për vitin 2012, planifikohet ndjekja e rekomandimeve të dhëna nga misionet e zbatuara gjatë vitit 2011, kryerja e misioneve të revizionit sistematik, misioneve të revizionit të operacioneve dhe misioneve të revizionit financiar për IPA Komponentin 5, për periudhën referuese.

Gjithashtu, Trupi i Revizorit do të fokusohet në trajnime dhe forcim të kapaciteteve për aktivitetet e ardhshme për kryerje të revizionit të IPA Komponentit 2 - Bashkëpunimi tejkuftar, për të cilën pritet bartja e autorizimeve për menaxhim nga Komisioni Evropian.

Lidhur me planifikimin e ardhshëm të revizioneve me bartjen e autorizimeve për menaxhim për Komponentin 2, do të kryhen ndryshime adekuate të Planit Vjetor të Punës për revizion të Trupit të Revizorit.

Me qëllim të realizimit të aktiviteteve të revizorit për vitin 2012, Trupi i Revizorit do të fokusohet në realizim të strategjisë 3-vjeçare për revizion për periudhën 2011 - 2013. Në vitin 2012, do të revidohen dhe azhurnohen doracakët për revizion të IPA-së. Gjithashtu, gjatë vitit 2012 do të vazhdojë bashkëpunimi me trupat revizore kompetente nga vendet-anëtare të UE-së dhe vendet tjera kandidate për anëtarësim në UE, Gjykata Evropiane e Revizorëve e Luksemburgut, me qëllim të përkufizimit dhe promovimit të praktikave më të mira ndërmjet trupave revizore përgjegjëse dhe këmbimit të përvojave të revizorit përmes organizimit të vizitave studimore.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Në vitin 2012 do të realizohen 5 punësime të reja, me çka numri i realizuesve të Trupit të Revizorit do të arrijë 33 realizues.

PRIORITETE AFATMESME

Në periudhën 2012 - 2013 do të miratohet Strategjia për Zhvillim të Trupit të Revizorit.

Forcimi i kapaciteteve operative dhe funksionale të Trupit të Revizorit në periudhën 2012 - 2013 do të realizohet përmes:

- Rritjes së numrit të realizuesve, dhe
- Trajnimeve për forcim të shkathtësive të revizorit.

MBROJTJA E EUROS NGA FALSIFIKIMI

KORNIZA JURIDIKE

• Korniza juridike për mbrojtje nga falsifikimi në Republikën e Maqedonisë përcaktohet me aktet juridike si vijon:

- Kodi penal i Republikës së Maqedonisë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 37/1996; 80/1999; 4/2002; 43/2003; 19/2004; 81/2005; 60/2006; 73/2006; 7/2008; 139/2008 и 114/2009). Vendimi i Gjykatës kushtetuese të Republikës së Maqedonisë, nr. 220/2000 nga 30 maj 2011, i botuar në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 48/2011; nr. 210/2001 nga 6 shkurt 2002, botuar në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 16/2002; nr. 206/2003 nga 9 qershor 2004, botuar në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 40/2004 dhe nr. 228/2005 nga 5 prill 2006, botuar në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 50/2006. Ligji për drejtësi të të miturve ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 87/2007; 103/2008 dhe 161/2008).

- Ligji për procedurë penale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 15/1997; 44/2002; 74/2004; 83/2008 dhe 67/2009). Vendimet e Gjykatës kushtetuese të Republikës së Maqedonisë, nr. 36/1998 nga 24 shkurt 1999, botuar në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 18/1999; nr. 1444/2003 nga 15 prill 2004, botuar në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 27/2004; nr. 34/2005 nga 31 maj 2006, botuar në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 75/2006 dhe nr. 63/2008 nga 8 prill 2009, botuar në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 53/2009. Ligji për Policinë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 114/2006 dhe 6/2009). Vendimi i Gjykatës kushtetuese të Republikës së Maqedonisë, nr. 211/2006 nga 05.11.2008, botuar në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 148/2008. Ligji për punë të brendshme ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 92/2009).

- Rregullore për përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së evidencave të Policisë dhe formën dhe përmbajtjen e formularit të evidencave në Policinë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 78/07) në të cilën është rregulluar mënyra e mbajtjes së regjistrit për zbulimin e parave të falsifikuara (euro dhe valuta tjera të huaja);

- Konventa ndërkombëtare për parandalimin e falsifikimit nga viti 1927 e ratifikuar në RM në mars 2005.

- Ligji për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 3/2002; 51/2003; 85/2003; 40/2004, 61/2005 dhe 129/2006).

- Mbrojta e euros nga falsifikimi në Republikën e Maqedonisë bëhet në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Në Ministrinë e Punëve të Brendshme është formuar Zyrë qendrore për hetime e cila do të kontribuojë për lehtësimin e hetimit dhe parandalimin përkatës, përkatësisht dënimin për prodhimin, përpunimin dhe distribuimin e eurove të falsifikuara.

Ekspertim forenzik të eurove të falsifikuara dhe valutave tjera të huaja bën Seksioni për hetime të dokumenteve kontestuese në Repartin e Teknikës kriminalistike pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ky seksion bën analiza të euros në pikëpamje të origjinalitetit të tyre për të cilat përgatit dëshmi dhe mendim për (mos) origjinalitetin e bankënotave, si dhe fotodokumentacion dhe evidencë për bankënotat të cilat kanë qenë objekt të analizës.

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë - Direksioni i punës së thesarit është kompetente për kryerjen e ekspertizës së parave të falsifikuara përkatësisht parave të dyshimta të vendit - denarë.

PRIORITETE AFATMESME

Me qëllim të përforcimit të kapaciteteve kadrovike të Zyrës qendrore për hetime në vitin 2011 do të realizohet trajnim për të punësuarit "mbrojtja e euros nga falsifikimi".

3.33. DISPOZITAT FINANCIARE DHE BUXHETORE

GJENDJA AKTUALE

KORNIZA JURIDIKE

Në drejtim të instalimit dhe funksionimit efikas të sistemit të resurseve personale nga dita e hyrjes së Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian, do të vazhdojnë aktivitetet për harmonizimin e legjislacionit nacional dhe instalimin e kapacitetit të nevojshëm institucional të institucioneve kompetente.

Ligji për buxhete dhe ndryshimet përkatëse të ligjit, paraqet ligj sistemor me të cilin rregullohet sistemi i financave publike në Republikën e Maqedonisë. Me këtë ligj rregullohen qëllimet, parimet, planifikimi dhe realizimi si dhe struktura e buxhetit dhe të njëjtit plotësisht harmonizohen me parimet dhe rregullat e Bashkimit Evropian dhe standardet ndërkombëtare.

Ministria e Financave e përpiloi dhe e dorëzoi në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë për vitin 2012 në afatin ligjor. Buxheti edhe këtë vit u përgatit në softuerin buxhetor, i cili u përmirësua me qëllim të sigurimit të raporteve të reja në funksion të paraqitjes më transparente të financave publike. Njëkohësisht u përpilua edhe Ligji për realizimin e Buxhetit për vitin 2011 si dhe ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për buxhetet, me të cilat përfordhet procedura për menaxhim me mjetet buxhetore dhe krijimin e bazës për planifikim buxhetor shumëvjeçar.

Me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për financimin e njërive të vetadministrimit lokal u bë rregullimi i ngarkimit me borxh të komunave plotësisht i harmonizuar me Ligjin për borxh publik, kushte precize dhe objektive për shpalljen e mosstabilitetit financiar të komunës, si dhe futja e mundësisë për huamarrje të komunave, me qëllim të përforcimit të kapacitetit fiskal dhe finalizimit të suksesshëm të procesit të decentralizimit në Republikën e Maqedonisë. Gjithashtu, Ministria e financave prezantoi mundësi të re, që komunat t'i financojnë nevojat e tyre nëpërmjet lëshimit të obligacioneve komunale.

Me iniciativë të Ministrisë së Financave dhe Sekretariatit për Çështje Evropiane, u realizua vizitë studimore në Francë në organizim të TAEIX, me qëllim të njoftimit me implementimin e suksesshëm të reformave buxhetore dhe procesin e përgatitjes së planifikimit buxhetor shumëvjeçar në Francë. Lidhur me nevojën për realizimin e nevojshëm të reformave në Procesin buxhetor, u realizua mision teknik nga FNM-ja, gjatë të cilit u imponua nevoja për përgatitjen e Klasifikimit të ri programor dhe organizues në kuadër të procesit buxhetor për vitin 2013. Njëkohësisht gjatë misionit u shqyrtuan edhe aktivitetet e nevojshme të cilat duhet të ndërmerren, me qëllim të kalimit gradual në planifikimin buxhetor shumëvjeçar.

Me plotësimet e cekura të Ligjit për vlerë të shtuar u dhanë autorizime për Drejtorinë për të hyra publike:

- të mund të refuzojë kërkesë për regjistrimin për qëllimet e TVSH-së nëse gjatë përcaktimit të aftësisë tatimore të detyruesit nuk mund që të njëjtin ta gjejë në adresën e paraqitur për realizimin e aktiviteteve afariste, ose nëse detyruesi nuk mund ta vërtetojë qëllimin real, ose tek detyruesi paraprakisht është identifikuar evazoni fiskal,

- nuk mund të bëjë ndërprerjen zyrtare të regjistrimit për qëllimet e TVSH-së ndaj tatim paguesve të cilat nuk mund t'i gjejnë në adresën e paraqitur për kryerjen e aktiviteteve afariste, të cilat nuk e paraqesin tatimin në afatet ligjore, ose tek të cilët është identifikuar evazoni fiskal

- u implementuan aktivitete për zhvillimin e funksioneve, nëpërmjet futjes së metodave dhe programeve të reja të cilat kanë për qëllim zvogëlimin e ekonomisë së zezë, përhapjen e bazës për tatimin dhe realizim të nivelit të planifikuar të të hyrave publike për arkëtimin e të cilave kompetent është DHP dhe atë nëpërmjet: futjes dhe zhvillimit të sistemit të përpunimit të centralizuar të fletëparaqitjeve tatimore dhe të shtypurit të centralizuar të aktvendimeve dhe akteve tjera tatimore, u sigurova risistemimi i kuadrit në funksione esenciale të analizave të të dhënave për përcaktimin dhe arkëtimin e tatimeve dhe futjes së metodave të reja për informim dhe njoftim paraprak për pagesën e borxheve (aktivitete të filluara).

- përforcimit të kapaciteteve të Inspektoratit tatimor në luftën kundër evazionit fiskal. me formimin e Inspektoratit për kontrole speciale; automatizimin e proceseve për seleksionimin e tatim paguesve sipas kriterëve të përcaktuara për rrezik, futja e kontroleve kompjuterike dhe edukimit të inspektorëve; ndërtimi i sistemit për rreziqe, metoda dhe teknika për kontrole në veprimtarisë specifike; përforcimi i bashkëpunimit me organet tjera inspektuese nëpërmjet zmadhimit të numrit të kontroleve të përbashkëta, veçanërisht bashkëpunimit me Inspektorin e tregut, MPB dhe organet tjera inspektuese (aktivitetet e filluara).

- Vazhdimin e proceseve për zhvillimin e metodologjive të reja për arkëtim të detyrueshme, veçanërisht me futjen dhe zhvillimin e e-ankandit të të mirave të konfiskuara për arkëtimin e borxheve tatimore me çka pritet përshpejtimi i procesit për arkëtimin e borxheve, zmadhimi i shumave të borxheve të arkëtuara dhe zvogëlimi i shpenzimeve të arkëtimin të detyrueshëm. Në kuadër të DHP u informua edhe "Qendra për magazinimin dhe shndërrimin në para të sendeve të tundshme" si njësi e re organizuese me të cilën u modernizua edhe zmadhua efikasiteti i proceseve afariste me procedurat e arkëtimin të detyrueshëm të borxheve tatimore, me çka nëpërmjet shërbimeve për praninë, vendosje dhe ruajtje të sendeve të konfiskuara dhe për vlerësimin e shitjes së sendeve të konfiskuara do të shndërrohen në para borxhet e debitorëve tatimorë (aktivitete të filluara).

- u fut shërbim i ri elektronik për tatim paguesit - "Kontroll elektronik në kartelën tatimore", që mundëson në çdo moment në formë elektronike të bëhet kontroll i gjendjeve të kërkesave dhe detyrimeve tatimore.

- në kuadër të DHP u formua Akademia tatimore, e cila nëpërmjet implementimit të programit të saj vjetor i ngre standardet cilësore të punës, e përforcon integritetin profesional dhe siguron përkrahje në futjen e shkallës së lartë të kompjuterizimit të proceseve të punës nëpërmjet edukimit sistemor dhe modern të të punësuarve, me qëllim të përafrimit ndaj praktikave dhe standardeve të Bashkimit Evropian dhe instalimin e Drejtorisë për të hyra publike si model për organizim profesional në sektorin publik, e cila siguron cilësi të lartë të shërbimeve për tatim paguesit.

- u mundësua paraqitje elektronike të parregullsive tatimore dhe korrupsionit nëpërmjet UEB portalit të DHP.

Me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit doganor, në Drejtorinë doganore aplikohet mënyrë e re e arkëtimin të detyrueshëm të borxhit doganor në bazë të Ligjit për procedurë tatimore, përkatësisht u vendos kornizë ligjore për arkëtimin e borxhit të krijuar doganor i cili nuk është arkëtuar, krahas bllokimit të llogarive në bankat afariste dhe me konfiskimin e pronës dhe mjeteve monetare të debitorëve doganorë. Në këtë drejtim Drejtoria doganore tashmë e implementoi Udhëzimin për arkëtim të detyrueshëm të borxhit doganor.

Llogaritë nacionale në Maqedoni zhvillohen në pajtim me kërkesat metodologjike të sistemit evropian të llogarive (European System of Accounts - ESA 95). Enti shtetëror për statistikë është përgjegjës për arrijten e

të dhënave cilësore, konsistent dhe të sakta në pajtim me ESA 95 Rregullativën 96/2223, direktiva 89/130 dhe Vendimin 94/168. Në këtë kontekst është bërë përmirësimi i përlogaritjes së Prodhimit bruto vendor (PBV) si komponentë kryesore të të hyrave bruto nacional (HBN) dhe atë në pjesën e shterimit (exhaustiveness), në përlogaritjen e alokimit të shërbimeve financiare të matura tërthorazi (FISIM) dhe përlogaritjet e rentave të inputuar. Gjatë përlogaritjes së të hyrave bruto nacionale, Enti shtetëror për statistikë i shfrytëzon të dhënat për të hyrat primare neto nga vendi i huaj, të cilat janë përfshirë në Bilancin e pagesës në BPRM-në. Lidhur me përshkrimin e metodave, përlogaritjen dhe klasifikimet të shfrytëzuara në llogaritë nacionale si dhe përshkrimin e kalimit nga PBV në HBN, Enti shtetëror për statistikë përpiloi dokument të veçantë për progresin dhe ky është dorëzuar në Eurostat.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Ministria e financave është kompetent për përgatitjen dhe realizimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë dhe për dorëzimin e tij në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë. Bazë për përgatitjen e buxheteve janë prioritetet strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, strategjia fiskale afatmesme, propozim-planet strategjike të shfrytëzuesve buxhetor, si dhe prioritetet e komunave.

Mjetet nga fondet e Bashkimit Evropian si dhe kofinancimi nacional paraqiten në buxhetin dhe të njëjtët janë pjesë përbërëse në programet për zhvillimin e shfrytëzuesve të caktuar buxhetorë. Në pajtim me Ligjin për realizimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë për vitin 2012, gjatë transferit jo në kohë të mjeteve nga BE-ja të dedikuara për financimin e projekteve të komponentëve të caktuara të IPA mjeteve do të sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, në pajtim me procedurat interne të Ministrisë së Financave. Gjatë realizimit të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë prioritet në pagesën e mjeteve do të kenë financimi i projekteve nga komponentët e caktuara nga IPA.

Ekipimi i bërë dhe krijimi i kuadrit profesional në Drejtorinë për të hyra publike si dhe vlerësimi i rezultateve nga puna nëpërmjet sistemit objektiv për matjen e rezultateve, mundëson që Drejtoria e të hyrave publike të bëhet institucion me cilësi të lartë për mbledhjen e të dhënave. Etablimi i Administratës tatimore në kuadër ndërkombëtar shkëmbimi i të dhënave dhe përvojave në nivel ndërkombëtar, e përshpejtoi procesin e modernizimit të DHP dhe barazimit me praktikat evropiane.

Në Drejtorinë doganore vazhdojnë aktivitetet për përforcimin e mëtutjeshëm të kapacitetit institucional të doganës për lehtësimin dhe zvogëlimin e shpenzimeve të transportit dhe tregtisë, si dhe për arritjen e rezultateve të matshme në luftë kundër korrupsionit dhe tregtisë joligjore, mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale, nëpërmjet udhëheqjes së procedurave për përgjegjësi disiplinore dhe për ngritjen e kallëzimit penal kundër nëpunësve të korruptuar doganor. Në pjesën e tregtisë joligjore vazhduan aktivitetet për ngritjen e procedurave për kundërvajtje për vepra më të lehtë, si dhe ngritjet e kallëzimeve penale për forma më të rënda të tregtisë ilegale dhe atë kundër personave juridikë dhe personave përgjegjës në firmat.

Me instalimin e sistemit unik për analizë të rrezikut mundësohet evidencë të të gjithë pjesëmarrësve në procedurën doganore të cilat i nënshtrohen regjimit të veçantë të kontrollit, në pajtim me parametrat e përcaktuara në Udhëzimin për kryerjen e kontrolleve të seleksionuara, që është harmonizuar me Kornizën për menaxhim me rrezik të BE-së, ndërsa kanë të bëjnë me përcaktimin e shkallës së rrezikut të firmave, duke pasur parasysh punën e tyre paraprake.

Gjithashtu u bë ndryshimi i Sistemit për procesimin e deklaratave doganore, me zgjerimin me përpunimin e dokumenteve të akcizave (SOCDAD), me ç'rast aktivitetet do të fillojnë në vitin 2012.

PRIORITETE AFATMESME

KORNIZA JURIDIKE

Në pajtim me Raportin e Komisionit Evropian për progresin e Republikës së Maqedonisë është konstatuar se nuk ekzistojnë dallime në legjislacionin maqedonas me legjislacionin e BE-së në pikëpamje të principeve themelore dhe institucioneve kompetente për implementimin e sistemit të mjeteve personale. Madje vazhdimi i procesit të harmonizimit të sferës së doganave, tatimi, statistika dhe kontrolli financiar do të sigurojë që RM-ja në mënyrë afatmesme t'i tejkalojë sfidat në plotësimin e obligimeve për instalimin e sistemit të mjeteve personale.

Ministria e Financave në procesin e avancimit të këtyre proceseve do të orientohet në realizimin e prioriteteve në vijim:

- Avancimi i procesit buxhetor, programeve buxhetore dhe zhvillimi i indikatorëve të rinj të suksesit për çdo program në veçanti, me qëllim të zmadhimit të transparencës së Buxhetit.
- Ridefinimi i Klasifikimit programor dhe organizues në kuadër të procesit buxhetor për vitin 2013;
- Përmirësimi i softuerit për përgatitjen e buxhetit dhe ekipimi përkatës të Ministrisë së Financave

Me përmirësimin e shërbimeve ndaj tatim paguesve do të sigurohet zmadhimi i besimit ndaj Drejtorisë për të hyra publike si institucion profesional gati për t'i zgjidhur në mënyrë efikase punët tatimore dhe me atë të sigurojë shkallë më të lartë të paraqitjes vullnetare të tatimeve dhe pagesës së tyre. Gjithashtu, DHP do të orientohet edhe në përfundimin e kapacitetit të kontrollit të jashtëm dhe zhvillimit të metodave të reja për luftë kundër korrupsionit dhe ekonomisë së zezë. Për atë qëllim, Drejtoria për të hyra publike me prioritetet e saj do t'i orientojë në:

Avancimin e mëtejshëm të qasjes sistematike në menaxhimin me kategoritë e ndryshme të tatimpaguesve "Menaxhimi me harmonizimin Menaxhimi me rrezik", përkatësisht me rreziqet të cilat ato i shkaktajnë në sistemin tatimor. Me qëllim që të arrihet efekt më i mirë nga instalimi i këtij sistemi të punës, duhet të mbahet seminar me ekspertë të huaj të cilat do t'i përcjellin përvojat dhe praktikat më të mira.

Do të instalohet sistem automatik të integruar për komunikim të vazhdueshëm elektronik të tatim paguesve me DHP për përcjelljen automatike të të dhënave nga sistemi fiskal në pajisjen në formë të raportit financiar ditor (GPRS), me çka pritet të fitohen informata të shpejta dhe të sakta për kryerjen e qarkullimeve dhe do të zvogëlohet nevoja për kontrole të drejtpërdrejta për këtë dedikim të tatimpaguesit.

Do të instalohet sistemi i numërimit të faturave të TVSH-së për obligacionet të cilat lëshojnë fatura të TVSH-së (E-TVSH) me çka në mënyrë të konsiderueshme do të zvogëlohet rreziku për mashtrime tatimore, veçanërisht nga mashtrimet e obligacioneve joekzistuese ose të humbura.

Do të futet E-regjistër për ndryshim të statusit për qëllime tatimore i cili do t'u mundësojë tatimpaguesve, falas, në fillim nëpërmjet info linjës, ndërsa më vonë edhe në formë elektronike, të paraqesin një pjesë e ndryshimeve të bëra të të dhënave të tyre drejtpërdrejtë në Drejtorinë për të hyra publike, siç janë adresa dhe telefoni në seli të vërtetë për kontakt, emër dhe mbiemër të kontabilitetit përkatësisht emërtim të byrosë kontabël, adresë dhe telefon të kontabilitetit, llogari tek bartësi i qarkullimit pagesor.

Për nevojat e tatim paguesve do të hapen sportel të rinj tatimor nëpër komunat në vendet më të vogla ku DHP nuk ka zyra të saj. Për komunat më të vogla do të organizohen sportel tatimor mobil (automjete të pajisura).

Do të vazhdojë procesi i sigurimit të shkallës së lartë të zhvillimit të shërbimit elektronik, zmadhimi i shfrytëzimit të e-shërbimeve dhe veçanërisht zmadhimi i numrit të fletëparaqitjeve të dorëzuara tatimore, me qëllim të zmadhimit të numrit të tatimpaguesve, veçanërisht, tatim pagues të mesëm dhe të vegjël dhe qytetarë, të cilët i dorëzojnë fletëparaqitjet tatimore në formë elektronike. Në pajtim me programin "E-shërbime të qytetarëve", shërbimet elektronike të DHP, në vitin 2012, do të bëhet të arritshme edhe për personat fizikë, ndërsa programi "E-tatime" i referohet zhvillimit të metodave të komunikimit elektronik me tatimpaguesit, që në të ardhmen duhet të bëhet obligim ligjor. (aktivitete të filluara). DHP do të fut mundësi për aplikimin për certifikata për tatime të paguara dhe certifikata për të hyra të realizuara si e-shërbim i ri, si dhe mundësi të gjithë kërkesat tjera në DHP të paraqiten në formë elektronike nëpërmjet serviseve elektronike të cilat i ofron DHP-ja.

Futja e arkivit elektronik me orar dhe përcjellje të lëvizjes së dokumenteve dhe formimi i dosjeve tatimore elektronike të tatimpaguesve, si dhe skenimi i dokumentacionit të përhershëm arkivor dhe kyçja e tij në dosjet elektronike (aktivitete të filluara).

Zhvillimi i sistemit të revizionit të brendshëm me të cilin do të zmadhohet numri i procedurave të futura dhe të përshkruara për punë me rreziqe të vlerësuara dhe kontrole të inkuorporuar (aktivitete të filluara).

Zhvillimi i sistemit të standardeve profesionale i cili i zhvillon metodat e parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit dhe sjelljes joprofesionale të të punësuarve (aktivitete të filluara).

Ndërtimi dhe zhvillimi i sistemit të integruar informativ si bazë për fitimin e informatave të sakta dhe në kohë dhe evidencave për sistemet e tatimeve publike dhe tatimpaguesve (aktivitete të filluara).

Shkëmbimi i të dhënave dhe lidhja e sistemeve të DHP-së me institucione tjera me instalim të njëkohshëm të: Sistemit njësportel - që do të thotë se qytetari do të dorëzojë vetëm një kërkesë deri në institucionet, ndërsa ato kanë për detyrë që t'i sigurojnë të dhënat dhe dokumentet me të cilat disponojnë institucionet tjera shtetërore; e-Dokumente-instalim të sistemit ku qytetarët do të mund që nëpërmjet Internetit me shfrytëzimin e nënshkrimit elektronik t'i fitojnë dokumentet nga institucionet shtetërore; Interoperabilitet ku gjithë dokumentet dhe shërbimet që i ofrojnë institucionet shtetërore për nevojat e qytetarëve do të jenë të arritshëm nëpërmjet internetit.

Do të instalohen përkujtues për pagesën për obligime tatimore individuale të tatimpaguesve me dërgimin e sms porosive njoftimin nëpërmjet postës elektronike, me qëllim të përshpejtitimit të arkëtimit të borxheve tatimore.

Në bashkëpunim me MIA do të punohet në projektin "M-Qeveri" me të cilin do të realizohet mundësia për plotësimin e fletëparaqitjeve tatimore nëpërmjet telefonave smart. (masat dhe aktivitete e paraparë në Drejtorinë për të hyra publike u prezantuan në Kapitullin 3.016 Tatimim)

Në drejtim të përforsimit të mbikëqyrjes tatimore dhe kontrolleve doganore, në kuadër të tremujorit nga viti 2012, në pajtim me Udhëzimin për punë me sistemin për video mbikëqyrje incizim dhe transimion ose televizion të llojit të mbyllur të Drejtorisë doganore të RM-së, planifikohet dislokimi i kamerave nga sistemi për video mbikëqyrje të pikave kufitare, me qëllim që të mundësohet precizitet gjatë incizimit dhe transimionit të të dhënave, të nevojshme për sektorin për kontroll dhe hetime, me çka do të tejkalohen vështirësitë e deritanishme rreth leximit të targave. Në kontekst të këtij ndryshimi do të krijohet mundësia për shkëmbim elektronik të informatave ndërmjet Seksionit për koordinim dhe komunikim gjatë Drejtorisë doganore me Qendrën kujdestarie Qendrën nacionale për menaxhim kufitar, në MPB. Sistemin unik për analizë të rrezikut, përveç Drejtorisë doganore do ta shfrytëzojë edhe Drejtoria për veterineri dhe siguri të ushqimit dhe Drejtoria fitosanitare, me çka do të sigurohet qasja e vetme në zbatimin e procedurave dhe kryerjen e kontrolleve gjatë importit, eksportit dhe tranzitit të mallit dhe do të mundësohet kryerje më efikase të detyrave të punës, sipas parimit "one stop one shop". Do të vazhdojnë aktivitetet për përpunimin e llogarive nacionale, aplikimin e Metodologjisë së ESA 95, vlerësime më precize dhe përfshirje më të plotë të ekonomisë joformale. (më hollësisht për aktivitet afatshkurtër dhe afatmesëm në këtë sferë në Kapitullin 18. Statistike).

Nëpërmjet përforsimit të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm në mbledhjen dhe arkëtimin e tatimeve doganore dhe tatimit të vlerës së shtuar do të intensifikohen reformat në drejtim të unifikimit të sistemit të mbledhjes së "Resurseve tradicionale personale".

KORNIZA INSTIUCIONALE

Në drejtim të përforsimit të kapaciteteve administrative të Drejtorisë së të hyrave publike për zbatimin e suksesshëm të legjislacionit dhe luftën kundër shmangies së pagesës së tatimeve do të realizojë ekipim kadrovik dhe pajim teknik të Inspektoratit për kontrolle speciale në kuadër të inspektoratit të përgjithshëm tatimor si dhe formimit, ekipimit kadrovik dhe pajimit teknik të IT laboratorisë forenzike.

Në tremujorin e parë të vitit 2012, Drejtoria doganore planifikon ndryshime dhe plotësime të Rregullores për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës, me çka do të futen vende të reja të punës, pikat më frekuentuese kufitare, të cilat krahas punëve rrjedhëse do të veprojnë sipas udhëzimit të karakterit zbulues, të cilat do t'i fitojnë drejtpërdrejt nga Sektori për kontroll dhe hetime.

Në vitin e ardhshëm do të realizohen trajnime të nevojshme të të punësuarve në institucionet kompetente, lidhur me zbatimin e standardeve të reja kontabël, metodologjinë ESA 95, dhe edukimin dhe përsosjen profesionale, si dhe studimin permanent të strukturës së resurseve personale, procedurave dhe përvojave të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian.

NDIHMA E HUAJ

- Në kuadër të IPA 2007 Vazhdojnë aktivitetet për përpunimin e llogarive nacionale, aplikimin e Metodologjisë së ESA 95 dhe vlerësimet më precize dhe përfshirje më të plotë të ekonomisë joformale.

- Në kuadër të IPA 2008, vazhdojnë aktivitetet për realizimin e projektit "Ndëroperativitet të IT sistemeve të Drejtorisë doganore me IT sistemet doganore të BE-së", në kohëzgjatje prej 24 muajsh, që përfshin 2 komponentë (1) Përkrahje në menaxhimin e Sistemit të ri transit të kompjuterizuar (NCTS); (2) Implementimi i NCTS. Ky projekt nëpërmjet aplikimit të praktikave më të mira ka për qëllim instalimin e versionit më të ri të aplikimit të sistemit doganor modern, në pajtim me standardet e BE-së. Projekti paraqet përkrahje të qëllimit strategjik të Drejtorisë doganore për plotësimin e standardeve dhe kërkesave në sferën e Procedurës së përbashkët transite të BE-së dhe EFTA shteteve dhe plotësimin e kriterëve për anëtarësim në Konventën e transitit të përbashkët të BE-së. Sistemi i instaluar transit i cili do të instalohet dhe i cili do të jetë plotësisht operativ dhe kompatibil me IT sistemet transite doganore të BE-së dhe i cili do t'i plotësojë kërkesat e nevojshme për ndërlidhje dhe ndërveprim.

- Në kuadër të IPA 2010 " do të realizohet shkëmbimi elektronik sistematik i të dhënave në Ballkanin perëndimor".

- Në kuadër të IPA 2007 në rrjedhë është edhe projekti "Përkrahja e reformës tatimore" i cili përfundon në janar 2012.

PRIORITETE AFATMESME

KORNIZA JURIDIKE

Në periudhën e ardhshme afatmesme Ministria e Financave si organ kompetent për menaxhim me financat publike, aktivitetet e saj do t'i orientojë në:

- Zhvillimin dhe avancimin e procesit buxhetor në funksion të planifikimit dhe përgatitjes shumëvjeçar të buxhetit shumëvjeçar.
- Harmonizimi i metodologjisë për përlllogaritjen e të Ardhurave bruto nacional me standardet ESA 95.

- Vendosija e strukturës operative për koordinim me qëllim të sigurimit të përlogaritjes së plotë, parashikimit, mbledhjes, pagesës dhe shqyrtimit të resurseve dhe njoftimeve personale të BE-së për zbatimin e rregullave për resurse personale. Ministria e Financave duke marrë parasysh kompetencën në periudhën e ardhshme do të ndërmerr aktivitete për formimin e organit të veçantë për menaxhimin e sistemit të resurseve personale dhe ekipimin e tij përkatës i cili në pajtim me nevojat dhe afatin kohor do të jetë kompetent për përgatitjen e modelit dhe manualit përkatës për vlerësim.
- Instalimi i sistemit të integruar informativ për menaxhim efikas qeveritar.

Drejtoria doganore do ta implementojë tërësisht Sistemin për përpunimin e deklaratave doganore (SPDD), i cili nuk është në përputhshmëri me standardet e BE-së dhe do t'i përforcojë sistemet për import, eksport, transit, eksport/import kontrollues dhe nënsistemet: TARIM/TARIK, menaxhimi me pagesë dhe garanci, menaxhimi me rrezik, autorizime doganore, Sistemi për përpunimin e deklaratave doganore (në gjerësisht në Kapitullin 29, Unioni doganor).

Aktivitetet e Drejtorisë për të hyra publike në periudhën e ardhshme afatmesme do të orientohen në:

- Implementimin e projektit "Top menaxhment" me qëllim të përforcimit të cilësisë dhe profesionalitetit të nëpunësve më të lartë udhëheqës; do të instalohet sistem të transferimit të detyrueshëm dhe aplikimi i njohurive të përfituara nga pjesëmarrësit në trajnime ndërkombëtare;
- Futja e Sistemit elektronik për menaxhim me njohuritë (LMS) që nënkupton formimin e dosjes për trajnime dhe kurse të vizituara të njohurisë që e posedon çdo i punësuar si parakusht për avancimin në sistemin e karrierës dhe
- Përforcimi i mëtutjeshëm i Inspektoratit të përgjithshëm tatimor nëpërmjet avancimit të IT laboratorisë forensike për qëllime tatimore"

Do të vazhdojnë aktivitetet për realizimin e projektit "Akademia rajonale tatimore". Edukimi nëpërmjet akademisë tatimore do të zhvillohet në katër faza. Në fazën e parë do të edukohen të punësuarit në DHP, faza e dytë do t'i përfshijë edhe të punësuarit tjerë në administratën shtetërore të cilat bashkëpunojnë drejtpërdrejtë me Drejtorinë, faza e tretë do t'i përfshijë edhe subjektet privatë dhe subjektet tjera të shtetit veprimtaria e të cilave është e lidhur me DHP. Faza e katërt e akademisë tatimore, e cila duhet të fillojë kah mesi i vitit 2013, është akademi tatimore rajonale, e destinuar për trajnime të administratave tatimore të vendeve nga Evropa Juglindore dhe pritet që të kontribuojë për zvogëlimin e evazionit tatimor në nivel rajonal.

Nëpërmjet komunikimit dhe bashkëpunimit me institucione, organizata ndërkombëtare dhe me administratat tatimore të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe vendet tjera jashtë tij do të vendoset kornizë stabile për bashkëpunim të ardhshëm për këmbimin e njohurive dhe përvojave (aktivitete të filluara).

Në kuadër të procesit eurointegruar u implementua procesi i përafrimit të DHP me standardet e punës të cilat zbatohet në administratat tatimore të vendeve anëtare të BE-së me çka jepet kontribut në aktivitetet e përgjithshme të vendit në proceset e integritit më të shpejtë në BE; implementimi i Programit IPA; impelmentimi i Programit FISKALIS (aktivitete të filluara).

Janë paraparë aktivitetet për formimin e Zyrës për lidhje për këmbimin e të dhënave nga sfera e TVSH-së. (masat dhe aktivitete e parapare në Drejtorinë për të hyra publike u prezantuan në Kapitullin 3.016 Tatimi)

KORNIZA INSTIUCIONALE

Me qëllim të avancimit të procesit të planifikimit të Buxhetit, u planifikua përforcimi i kapacitetit administrativ i Sektorit Buxheti dhe fondet me punësime të reja në seksionin lidhur me përgatitjen e buxhetit shumëvjeçar, analizat buxhetore dhe seksioni për buxhetim zhvillimor, si dhe përforcimi i kapacitetit administrativ i Sektorit për thesar - seksioni për statistikë fiskale dhe analizë dhe seksioni për menaxhim me likuidim.

Do të fillojë përpunimi i analizës përkatëse për caktimin e institucioneve dhe sektorëve të cilat do ta formojnë organin kompetent për sistemin për përcjelljen dhe përlogaritjen e resurseve personale.

Do të vazhdojë realizimi i trajnimeve të nevojshme të të punësuarve në institucionet kompetente lidhur me zbatimin e standardeve të reja kontabël, Metodologjinë ESA 95, dhe trajnimeve për koordinim, menaxhim, kontroll dhe mbikëqyrje të mjeteve personale.

NDIHMJA E HUAJ

Në kuadër IPA 2011, u miratua Projekti përgatitja e Buxhetit shumëvjeçar, në pajtim me të cilat pritet marrja e ndihmës teknike për përgatitjen e buxhetit shumëvjeçar dhe aplikimi i Metodologjisë ESA 95.

Në kuadër të IPA 2010, u miratua Projekti "Përmirësimi i shërbimeve nga ana e DHP për tatimpaguesit" me të cilin pritet të përmirësohen performansat e DHP-së me theks të veçantë të sigurimit të shërbimeve më të mira të tatimpaguesve me qëllim të zmadhimit të harmonizimit vullnetar.

IV. KAPACITETE ADMINISTRATIVE

GJENDJA AKTUALE

Në drejtim të përmirësimit institucional të strukturave administrative dhe përforcimit të kapaciteteve administrative, dhe atë si në bazë horizontale, ashtu edhe në bazë vertikale si dhe në drejtim të përmirësimit të transparencës dhe përgjegjësisë së administratës, Sekretariati i përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, ndër të tjerash edhe më tutje do të vazhdojë me realizimin e rezultateve pozitive gjatë koordinimit të procesit të planifikimit strategjik dhe dhënien e këshillave profesionale për përgatitjen e planeve strategjike të ministrive; analizën e politikave; reformat ekonomike në funksion të përmirësimit të klimës së biznesit tërheqjen e investimeve; sigurimin e zhvillimit profesional të nëpunësve shtetërorë; realizimin e revizionit të brendshëm; koordinimin e zbatimit të amendamenteve kushtetuese të cilat dalin nga Marrëveshja kornizë; si dhe përmirësimin e transparencës në punën e Qeverisë - bashkëpunimi me organizatat joqeveritare.

PRIORITETE AFATMESME

KORNIZA JURIDIKE

U planifikua analiza e zbatimit të Ligjit për nëpunës shtetërorë dhe Ligjit për nëpunës publikë. Gjithashtu u planifikua definimi i mënyrës optimale të vlerësimit të nëpunësve në Republikën e Maqedonisë. Në vitin 2012 do të funksionojë Regjistri i nëpunësve publikë në pajtim me Ligjin për nëpunës publikë. MIOA në vitin 2012 do të ndërmerr aktivitete në pajtim me Planin aksionar për avancimin e Ditarit civil për zmadhimin e njohurisë dhe shfrytëzimit nga ana e opinionit.

KORNIZA INSTITUTE

MIOA në vitin 2012 do të fillojë përforcimi plotësues i kapaciteteve personale administrative dhe financiare për koordinimin e procesit të reformave të administratës publike dhe realizimin cilësor të aktiviteteve të caktuara në pajtim me Strategjinë dhe Planin aksionar për reformë në administratën publike 2010-2015.

Në pajtim me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, përqindja e vlerësimit të rregullativës do të kalojë në kompetencë të Ministrisë për shoqëri informatike dhe administratë. Në pjesën e menaxhimit me resurse njerëzore, MIOA gjatë vitit 2012 do të fillojë me realizimin e projektit "Formimi i administratës me të cilën menaxhohet baza e kompetencave dhe është orientuar në shkathtësitë e të punësuarve." U parapa përgatitja e Sistemit nacional për koordinimin e aftësimin profesional dhe trajnimin të nëpunësve shtetërorë në Republikën e Maqedonisë dhe Strategjia për trajnimin e administratës në Republikën e Maqedonisë 2012-2014. Lidhur me përfaqësimin e drejtë të komuniteteve joshumicë në administratën publike, do të fillojë përgatitja e metodologjisë për planifikimin e definimit të nevojës për punë sipas përfaqësimit adekuat dhe të drejtë, avancimi i mëtejshëm i sistemit njësportel për këmbim elektronik të dokumenteve ndërmjet institucioneve kryesore dhe bashkëveprimi ndërmjet institucioneve.

Me qëllim të përmirësimit të transparencës dhe përgjegjësisë së administratës Sekretariati i përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë deri në fund të muajit mars 2012 do të përgatitet Strategji e re, në kuadër të IPA projektit 2008: "Përkrahja teknike e Seksionit për bashkëpunim me organizatat joqeveritare në Sekretariatit e përgjithshme".

Aktivitetet e këtij komponenti të projektit filluan në shtator 2011, me angazhimin e 2 (dy) ekspertëve dhe grupit të formuar për përkrahjen e procesit të përpunimit të Strategjisë formuar nga përfaqësues të Seksionit për bashkëpunim me organizata joqeveritare, rrjetin e nëpunësve shtetërorë për bashkëpunim me organizatat joqeveritare nga ministrinë dhe përfaqësitë nga organizatat qytetare nëpërmjet shpalljes. Grupi mbajti dy mbledhje dhe u përpilua tekst i Konceptit të Strategjisë për bashkëpunim të Qeverisë me sektorin civil 2012-2017. Gjatë muajit dhjetor 2011 pritet të përpilohet tekst i Propozim-Strategjisë, sipas të cilit pas mendimit të marrë nga ministrinë resore do të organizohen disa debate publike. Strategjia do të parashtrahet te Qeveria në muajin shkurt 2012.

Nëpërmjet IPA 2008 edhe në periudhën e ardhshme do të vazhdohet me përkrahjen e vazhdueshme të pjesëmarrjes së sektorit civil në procesin e miratimit të vendimeve dhe sigurimin e shërbimeve sociale. Ky aktivitet plotësisht do të implementohet deri në fund të vitit 2012.

Zhvillimi i vazhdueshëm i sektorit civil si pjesë edhe më tutje do të përkrahët me një seri aktivitete të cilat do të realizohen në përputhje të Strategjisë për bashkëpunim me sektorin civil. Njëkohësisht, në pajtim me

rekomandimet të përmbajtur në Raportin e Komisionit Evropian për progresin e Republikës së Maqedonisë për vitin 2011, deri në fund të muajit mars 2012, do të formohet Komisioni për organizime me status të interesit publike.

Në funksion të përforcimit të kapaciteteve për planifikim strategjik dhe buxhetim të njësive të vetadministrimit lokal (komunat) në organizim të Sekretariatit të përgjithshëm të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë në bashkëpunim me Ministrinë për vetadministrim lokal dhe qendrat për zhvillim rajonal, tashmë janë organizuar trajnime gjenerike njëditore realizimi i të cilëve është në rrjedhë. Gjatë formimit të trajnimeve kihen parasysh specifikimet dhe nevojat e njësive të vetadministrimit lokal. Me gjithsej tetë trajnime gjenerike njëditore të cilat do të realizohen nëpër qendrat rajonale të shtetit, do të përfshihen gjithsej 84 komuna përfshirë edhe Qytetin e Shkupit. Ky aktivitet do të realizohet deri në fund të muajit prill 2012.

Me qëllim të përforcimit të mëtutjeshëm të kapaciteteve të Seksionit për bashkëpunim me organizatat joqeveritare deri në fund të vitit 2012 do të realizohen trajnime për të punësuarit në këtë seksion dhe ministrinë, ndërsa në kuadër të projektit IPA 2010 "Sektori i qëndrueshëm civil", komponenti 1, në periudhën 2012-2014 janë parapa trajnime për instalimin e mekanizmit të qëndrueshëm për bashkëpunim ndërmjet komunave dhe organizatave qytetare në tetë pilot komuna.

PRIORITETE AFATMESME *KORNIZA INSTIUCIONALE*

U planifikua vendosja e CAF standardeve për cilësi në administratën publike. Në pikëpamje të resurseve njerëzore, në vitin 2013 do të vazhdohet me avancimin plotësues të konceptit "Formimi i administratës me të cilën menaxhohet baza e kompetencave dhe është orientuar në realizimin e punës së të punësuarve". Si prioritet afatmesëm definohet instalimi i Sistemit për menaxhim me realizim (Performance Management System) që do të fillojë në vitin 2014 pas Analizës së bërë për funksionalitetin e aplikimit të kompetencave të të punësuarve në administratë. Avancimi i Regjistrimit të nëpunësve shtetërorë dhe formimi i e-dosjeve për nëpunës shtetërorë.

V. PËRGATITJA E VERSIONIT MAQEDONAS TË ACQUIS

GJENDJA AKTUALE *KORNIZA JURIDIKE*

Përgatitja e versionit nacional i *acquis communautaire* (e drejta e Bashkimit Evropian) është proces multidisiplinar në të cilin janë përfshirë linguistë, persona profesionalë nga të gjitha sferat e jetës shoqërore dhe juristë. Qëllimi i procesit është të përgatitet version cilësor i të drejtës së Bashkimit Evropian i cili do të paraqet burim të sigurt të të drerjave dhe obligimeve për qytetarët e Republikës së Maqedonisë. Vlerësohet se e drejta e plotë e Bashkimit Evropian është 130.000 faqe, por kjo vazhdimisht u nështrohet ndryshimeve, kështu që numri përfundimtar është shumë më i madh dhe relativ.

Qëllimet dhe funksioni i procesit të përgatitjes së versionit maqedonas të *acquis communautaire* janë përfshirë me dokumentet në vijim:

Draft-plani strategjik i Sekretariatit për çështje evropiane 2012-2014

Procesi i përgatitjes së versionit maqedonas i *acquis communautaire* hollësisht është përcaktuar me:

- Draft-udhëzim teknik për avancimin e dokumenteve gjatë përkthimit të akteve të Bashkimit evropian, gusht 2010.
- Manual për përkthimin e akteve juridike të Bashkimit Evropian, dhjetor 2010 (botimi i dytë).
- Manual për përkthimin e akteve juridike të Republikës së Maqedonisë, dhjetor 2010 (botimi i parë)
- Vendimi për përshpejtimin e komiteteve teknike përfshirë në procesin e përgatitjes së versionit nacional të *acquis communautaire*
- Rregullore për punën e komiteteve teknike për revizion profesional dhe juridike
- Rregullore për punën e Komitetit teknik për verifikimin e terminologjisë dhe të versionit nacional të së drejtës së Bashkimit Evropian.
- Udhëzimi për veprim gjatë përkthimit të akteve juridike dhe dokumenteve tjera nga ana e Sekretariatit për çështje evropiane - Sektori për përgatitjen e versionit nacional të *acquis communautaire*, maj 2009.

Deri në fund të muajit nëntor 2011 janë përkthyer gjithsej 5.668 masa ose 68.102 faqe nga Gazeta zyrtare e Bashkimit Evropian.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Sektori për përgatitjen e versionit nacional të *acquis communautaire* të Sekretariatit për çështje evropiane është kompetent për zbatimin e procesit të përgatitjes së versionit maqedonas të *acquis communautaire*. Në kuadër të Sektorit për përgatitjen e versionit nacional të *acquis communautaire* ekzistojnë dy seksione:

Seksioni për revizion dhe terminologji i ngarkuar për përcaktimin e kriterëve për konsistencë gjatë përkthimit të akteve juridike të Bashkimit Evropian, ndërtimi i terminologjisë, realizimi i revizionit gjuhësor të përkthimeve të akteve juridike të BE-së, të RM-së dhe dokumenteve tjera të rëndësishme për procesin e integritimit evropian të RM-së.

Seksioni për përkthimin dhe koordinimin e procesit të përkthimit i ngarkuar për përpunimin e planit për përkthim, përcjelle dhe koordinim të procesit të përkthimit nëpërmjet bazave të centralizuara të të dhënave, përkthim të akteve juridike të BE-së, të RM-së dhe dokumenteve tjera të rëndësishme për procesin e integritimit evropian të RM-së dhe përcjelle të revizionit profesional dhe juridik të akteve juridike të BE-së.

Sektori për përgatitjen e versionit nacional të *acquis communautaire* ekzistojnë gjithsej 23 të punësuar nëpunës shtetërorë.

PRIORITETET AFATSHKURTËRA

KORNIZA JURIDIKE

Gjatë vitit 2012 u planifikua të realizohen aktivitete në drejtim të përfundimit të strukturës për përgatitjen e versionit nacional të së drejtës së Bashkimit Evropian, mirëmbajtjes së bazave të të dhënave të cilat janë në funksion të përkrahjes dhe përcjelljes së procesit.

Në funksion të përcjelljes së përkrahjes së gjithë procesit të përgatitjes së versionit nacional të së drejtës së Bashkimit Evropian nevojitet mirëmbajtje të vazhdueshme të bazave të të dhënave: Regjistri për përcjelljen e procesit të përkthimit, baza terminologjike e të dhënave dhe CC Vista baza e Bashkimit Evropian.

Gjatë vitit 2012 planifikohet të përkthehen 12.200 faqe të akteve juridike nga Gazeta zyrtare e BE-së, të RM-së dhe dokumenteve tjera të rëndësishme për procesin e integritimit evropian, si dhe 1000 faqe nga legjislacioni primar i BE-së.

Gjatë vitit 2012 planifikohet që gjuhësisht të revidohen 7.500 faqe të akteve juridike nga Gazeta zyrtare e BE-së, të RM-së dhe dokumenteve tjera të rëndësishme për procesin e integritimit në Evropë.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Me qëllim të realizimit të suksesshëm të prioritetëve afatshkurtër, është e domosdoshme deri në fund të vitit 2012 të bëhet përfundimi i nevojshëm kadrovik dhe teknik i Sektorit për përgatitjen e versionit nacional të *acquis*.

PRIORITETET AFATMESME

KORNIZA JURIDIKE

Në periudhën 2013-2014 është planifikuar të vazhdohet me realizimin e aktiviteteve në drejtim të përfundimit të strukturës së përgatitjes së versionit nacional të së drejtës së Bashkimit Evropian, mirëmbajtjes së bazave të të dhënave të cilat janë në funksion të përkrahjes dhe përcjelljes së procesit, si dhe në drejtim të përhapjes së aktiviteteve në sferën e plotësimit të kërkesave në domenin e gjuhës.

Në funksion të përcjelljes së përkrahjes së gjithë procesit të përgatitjes së versionit nacional të së drejtës së Bashkimit Evropian nevojitet mirëmbajtje të vazhdueshme të bazave të të dhënave: Regjistri për përcjelljen e procesit të përkthimit, baza terminologjike e të dhënave dhe CC Lista baza e Bashkimit Evropian.

Gjatë vitit 2013 planifikohet të kryhet revizion gjuhësor i akteve të legjislacionit primar të Bashkimit Evropian, që do të përkthehen gjatë vitit 2012.

Në periudhën e ardhshme, planifikohet të përfundohen aktivitetet lidhur me përpunimin e versionit maqedonas të Evropës.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Gjatë vitit 2013 dhe 2014 janë parapa trajnime të rregullta të cilat i realizon Sektori për përgatitjen e versionit nacional të acquis, për të gjitha pjesëmarrësit në procesin e përgatitjes së versionit nacional të së drejtës së Bashkimit evropian.

VI. INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI ME OPINIONIN

Anëtarësimi i Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian është një nga prioritetet më të rëndësishëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe e ka përkrahjen nga të gjitha grupet shoqërore. Të gjithë partitë politike në Republikën e Maqedonisë anëtarësimin në BE e kanë përcaktuar në programet e tyre. Biznes sektorët, pjesa më e madhe e organizatave joqeveritare dhe asociacionet civile e përkrahin anëtarësimin në BE.

Informimi dhe komunikimi me opinionin për integrim evropian janë segment i rëndësishëm për përafrimin e BE-së të qytetarët veçanërisht nëse kihet parasysh përvoja e disa vendeve anëtare se përkrahja për anëtarësim në BE dobësohet drejtpërdrejt para anëtarësimin. Që këtu lind nevoja për realizimin e projekteve projektuese të dedikuara si për opinionin e gjerë publik ashti edhe për target grupet specifike me qëllim që të zmadhohet njohuria të popullata për përfitimet dhe obligimet nga anëtarësimi dhe të mbahet përkrahja e lartë.

Sekretariati për çështje evropiane në mënyrë të vazhdueshme realizon projekte dhe aktivitete të cilat kanë për qëllim të mundësojnë qarkullim në kohë dhe të saktë të informatave në opinionin për të gjitha aspektet e integritit evropian. Në drejtim të adresimit përkatës të nevojave të opinionit, SEP do të përpilojë Strategji për informimin dhe komunikimin me opinionin 2011-2014, e cila do të paraqet vazhdim të strategjive komunikuese paraprake.

Krahas qëllimit kryesor të aktiviteteve për komunikim me opinion - mbajtja e përkrahjes nga opinionin për politikën e Qeverisë për anëtarësi në BE, qëllime më të gjera do të jenë që të përmirësohet vetëdija në opinionin për procesin e aderimit, veçanërisht ndërmjet bashkësive lokale, të ndërtohet besimi në kapacitetet e institucioneve të involvuar maqedonas dhe evropian, të sigurohet se sektorët specifike plotësisht e dinë se çka pritet prej tyre, dhe si mund të kontribuojnë në procesin reformues.

Gjatë vitit 2012 është planifikuar të realizohen aktivitetet dhe projektet në vijim:

AKTIVITETET RRJEDHËSE

- Azhurnimi i rregullt i faqes së internet të SEP e cila është në dispozicion në tri gjuhë, maqedonisht, shqip dhe anglisht.
- Mirëmbajtja e konferencës së shtypit, udhëzimeve dhe intervistave për medime të shtypit dhe elektronik,
- Azhurnimi rrjedhës dhe mirëmbajtja e bazës virtuale e materialeve audiovizuale.
- Lëshimi i buletinit elektronik,
- Përgatitja dhe botimi i broshurave për procesin e integritit evropian, dhe
- Organizimi i ligjërimeve tematike informative, debateve, tribunave, konferencave, forumeve ndërkombëtare vendore.
- Analizimi i mendimit publik

MK-BE INFO QENDRA

MK-BE info qendra do të vazhdojë me punën e saj në pajtim me aktivitete e definuara, siç janë dhënia e përgjigjeve ndaj pyetjeve për aktivitetet dhe reformat lidhur me integrimin evropian të qytetarëve të interesuar, sigurimi i qasjes së lirë të internetit, shfrytëzimi i literaturës nga biblioteka e Info qendrës dhe ngjashëm.

FUSHATA

Fushatat janë në mënyrë të përgjithshme të dedikuara për target grupe specifike dhe kanë për qëllim të sigurojnë informata më konkrete për aspekte të caktuara të reformave të cilat bëhen në drejtim të futjes së standardeve evropiane.

Fushata "BE dhe biznesi"- projekt i cili ka për qëllim të promovojë standarde evropiane lidhur me komunitetin e biznesit me qëllim që të nxitet zbatimi i tyre në punën e kompanive në Republikën e Maqedonisë.

Projekt për promovimin e politikës për përfshirje sociale - fillimi me projektin i cili do të kontribuojë në harmonizimin e politikës qeveritare për sinkronizimin e përpjekjeve të të gjithë faktorëve relevantë në vend në sferën sociale - "Përfshirja sociale (inkluzioni) në Maqedoni dhe nevojat për sinkronizimin e saj me Metodën e hapur të koordinimit të inkluzionit social të Bashkimit Evropian".

Fushata "Sundimi i së drejtës në RM" - fushata për aktivitete promovuese dhe debatuese me temë "Sundimi i së drejtës, standardet e BE-së, sfidat dhe rezultatet e pritura".

Projekti "Alo BE" - hapja e telefonit falas ku qytetarët do të mund të marrin informata të përgjithshme për aktivitetet dhe reformat për futjen e standardeve evropiane në Republikën e Maqedonisë dhe për funksionimin e Bashkimit Evropian.